

Profesor Arben Hajrullahu si një intelektual, qytetar dhe ithtar i arkitekturës së një paqeje afatgjate dhe të qëndrueshme, analizon dhe skicon në këtë libër mënyrën se si paqja në rajonin e trazuar të Ballkanit Perëndimor do të mund të arrihej nëpërmjet integritimit në BE, e me të edhe jetësimi i rastit ideal për tejkalimin e konfliktit Serbi-Kosovë.

Johannes D. Rey,
Fondacioni-Konrad-Adenauer

T'i zëvendësosh policët e OKB-së me policë të BE-së dhe disa gjyqtarë e prokurorë ndërkombëtarë thjesht nuk do të mjaftojë. Për më tej, është e rëndësishme që burokracia e Brukselit më në fund po fillon ta „kuptojë” problematikën, se jo veç në Kosovë, por në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor nuk bëhet fjalë për një transformim dhe zgjerim „normal” të BE-së, gjatë të cilit pritet vetëm marrja përsipër e implementimit të *acquis communautaire*, por kërkohet që së pari të krijohen parakushtet themelore për „good governance”, pra për vetëdijen e një komuniteti politik, i cili kapërcen të menduarit vetëm përbrenda përkatësive dhe besnikërive etnike dhe vetëm kështu mundëson identitete të shumëfishta, përfshirë këtu edhe një identitet evropian. Edhe autori i këtij libri shprehet për krijimin e një „kombi politik të kosovarëve”, i cili ndërthet kosovarët shqipfolës dhe serbishtfolës, e që në literaturën e tërësishme rreth konfliktit të Kosovës, të cilën e njoh, mbetet i pashoq deri më sot.

Joseph Marko,
Universiteti i Gracit

Autori me të drejtë paralajmëron kundrejt çdo shprese të një „automatizmi integrues” lidhur me efektet e integritimit evropian që do të siguronin paqe e të zgjidhnin konflikte, duke rekomanduar që ky proces integrimi të shqyrtohet thelbësisht në dritën e realiteteve të veçanta komplekse që dëshmohen në Ballkan.

Alice Engl,
Akademia Evropian në Bolzano/Bozen (EURAC)

Pjesa qendrore e librit është modeli shumëdimensional i integritimit [...] gjithçka varet nga integrimi i (pa)suksesshëm i shteteve në fjalë. Nëse s'do të ketë fare integrim ose ky mbetet i pjesshëm, dhuna do të jetë e vazhdueshme, ose të paktën potenciali për të, e madje mund të priten gara mes kombeve për formim të shteteve të mëdha kombëtare si dhe luftëra të ardhshme. Edhe nëse projekti i integritimit në BE rezulton i suksesshëm, nuk do të ketë stabilitet të qëndrueshëm; ky është i mundshëm vetëm nëse shtetet në rajon e njohin njëri-tjetrin si të barabartë. Përndryshe, ende mund të vazhdojnë pasiguria, jostabiliteti, si dhe veprimtaritë terroriste.

Henriette Riegler,
Instituti Austriak i Çështjeve Ndërkombëtare, Vjenë

ISBN 978-9951-8871-3-7



9 789951 887137

Arben Hajrullahu Paqja afatgjate në Ballkanin Perëndimor përmes integritimit në BE



Konrad
Adenauer
Stiftung

Arben Hajrullahu

Paqja afatgjate në Ballkanin Perëndimor përmes integritimit në BE

Procesi i integritimit në BE si mundësi për tejkalimin e konfliktit serbo-kosovar



vajzave të mia, Alenës dhe Lizës,
me urimin që të rriten në paqe

Titulli: Paqja afatgjate në Ballkanin Perëndimor përmes integrimit në BE
Procesi i integrimit në BE si mundësi për tejkalimin e konfliktit serbo-kosovar

Titulli i origjinalit: Langfristiger Frieden am Westbalkan durch EU-Integration
*Der EU-Integrationsprozess als Chance für die Überwindung des
serbisch-kosovarischen Konfliktes*

EURAC Research
EUROPÄISCHE AKADEMIE / ACCADEMIA EUROPEA / EUROPEAN ACADEMY
BOZEN - BOLZANO

Schriftenreihe der Europäischen Akademie Bozen
Bereich „Minderheiten und Autonomien“
Herausgegeben von Joseph Marko und Francesco Palermo
Band 9
1. Auflage 2007
ISBN 978-3-8329-2975-6

Autor: Arben Hajrullahu
Përkthyes nga gjermanishtja në shqip: Rexhep Bajrami
Lektor i botimit në shqip: Gazmend Bërlajolli
Kordinatorator: Granit Tërnavë
Botues: Fondacioni-Konrad-Adenauer, Kosovë
Shtypi dhe dizajni: Shtypshkronja A1
Tirazhi: 500 ekzemplarë
Publikimi mund të shkarkohet falas në: www.kas.de/kosovo
Botuar në Prishtinë, 2015
ISBN 978-9951-8871-3-7

Vërejtje: Pikëpamjet e paraqitura në këtë libër janë pikëpamje personale të autorit dhe ato nuk paraqesin patjetër qëndrimet e Fondacionit Konrad Adenauer.

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës „Pjetër Bogdani”

327(497:4/9)

Hajrullahu, Arben
Paqja afatgjate në Ballkanin Perëndimor përmes integrimit në BE / Arben Hajrullahu
; përkthyes Rexhep Bajrami. – Prishtinë : Fondacioni Konrad Adenauer, 2015. – 323
f. ; 23 cm.

Titulli i origjinalit : Langfristiger Frieden am Westbalkan durch EU-Intergration. –
Parathënie për botimin në shqip dhe në serbisht: f. 7-8. – Bibliografia : f. 265-303. –
Indeksi : f. 305-309

I. Bajrami, Rexhep

ISBN 978-9951-8871-3-7

Lexues të nderuar,

ndërtimi i paqes afatgjate është synim i shumicës prej palëve të përfshira në zhvillimet e Ballkanit Perëndimor. Mundësitë për arritjen e paqes afatgjate ende mbeten tema të rëndësishme diskutimi dhe analize në rajon dhe përtej tij. Marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërshtetërore në rajonin e Ballkanit Perëndimor vazhdojnë të mbeten të brishta dhe shenjat e një paqeje të qëndrueshme e afatgjate ende nuk duken gjithmonë qartë në horizont.

Sikurse edhe shumë palë të tjera, edhe Fondacioni-Konrad-Adenauer gjatë tetë vjetëve të funksionimit në Kosovë ka synuar që përmes aktiviteteve të ndryshme ta ofrojë kontributin e vet modest për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike e ndërshtetërore, sidomos duke u fokusuar në marrëdhëniet mes shqiptarëve dhe serbëve dhe ato mes shtetit të Kosovës dhe të Serbisë. Mirëpo, trajtimi më i gjerë i kësaj teme bëhet duke gjurmuar më thellë edhe në aspektet politologjike, juridike e historike të këtij konflikti. Libri që keni para vetes, i shkruar nga politologu Arben Hajrullahu, profesor pranë Departamentit të Shkencës Politike në Universitetin e Prishtinës, ofron një gjurmim të tillë. Profesor Arben Hajrullahu si një intelektual, qytetar dhe ithtar i arkitekturës së një paqeje afatgjate dhe të qëndrueshme, analizon dhe skicon në këtë libër mënyrën se si paqja në rajonin e trazuar të Ballkanit Perëndimor do të mund të arrihej përmes integritimit në BE, e me këtë edhe jetësimi i rastit ideal për tejkalimin e konfliktit Serbi-Kosovë.

Fondacioni-Konrad-Adenauer ka pranuar me shumë kënaqësi propozimin për ta përkrahur përkthimin e këtij libri nga gjuha gjermane në atë shqipe dhe serbe. Botimit në gjuhën shqipe dhe serbe autori i ka shtuar edhe një kapitull, në të cilin shqyrton ngjarjet kyçe në konfliktin mes Serbisë dhe Kosovës në periudhën pas botimit të parë të librit në gjuhën gjermane, pra periudhën 2007-2014. Me këtë kapitull shtesë autori mëton të ofrojë një analizë aktuale si kontribut të mëtejshëm hulumtues për tejkalimin e një historiku të gjatë të marrëdhënieve konfliktuoze mes Serbisë dhe Kosovës. Ballkani Perëndimor, si pjesë integrale e Europës dhe me aspirata për të hyrë në BE, meriton një të ardhme më të mirë sesa e kaluara e vet. Fondacioni-Konrad-Adenauer do të vazhdojë të ofrojë mbështetjen e tij në fushat e promovimit të demokratizimit, integritimeve europiane por edhe ato që lidhen me fushën e ripajimit ndëretnik në rajon. E ky libër është një kontribut i tillë dhe Fondacioni-Konrad-Adenauer ju dëshiron lexim të këndshëm.

Johannes D. Rey, Përfaqësues Zyrtar
Granit Tërnavë, Menaxher i projektit
Fondacioni-Konrad-Adenauer, Zyra në Kosovë

Prishtinë, shtator 2015

Parathënie për botimin në shqip dhe në serbisht

Ky libër është rezultat i analizimit dhe reflektimit mbi mundësitë dhe potencialet që integrimi evropian ka për ta ndihmuar krijimin e paqes së qëndrueshme mes Serbisë e Kosovës. Libri që keni para vetes në gjuhën shqipe dhe serbe, u botua fillimisht në gjuhën gjermane (Langfristiger Frieden am Westbalkan durch EU-Integration, NOMOS, Baden-Baden, 2007). Botimeve në gjuhët shqip dhe serbisht u është shtuar edhe nga një pjesë përmbledhëse (kreu VIII), në të cilën paraqiten disa nga ngjarjet kyçe që karakterizuan periudhën vjeshtë 2007 – fundvit 2014 në marrëdhëniet dhe zhvillimet e raporteve mes Serbisë e Kosovës. Njëkohësisht, në pjesën e shtojcës është plotësuar lista e zhvillimeve kryesore gjatë kësaj periudhe.

Paraprakisht, dhe duke pasur parasysh shumëkuptimësinë eventuale gjuhësore dhe shumëllojshmërinë e perceptimeve të nocioneve të caktuara për lexuesit në gjuhën shqipe dhe ata në gjuhën serbe, dua të bëj sqarimin vijues: nocioni *komb politik* do kuptuar vetëm e vetëm si sinonim i shtetit të pavarur dhe sovran dhe jo domosdoshmërisht edhe në kuptimin etnik, kulturor, gjuhësor etj. Pra, në tërë tekstin, ky nocion do kuptuar sipas përkufizimit që kanë për bazë Kombet e Bashkuara (United Nations), d.m.th. „nation”, në kuptimin komb politik, siç njihet edhe në të drejtën ndërkombëtare dhe në gjuhën angleze.

Sikur deri më tani të arrihej paqja e qëndrueshme mes Serbisë dhe Kosovës në plotninë e saj, përkthimi i këtij libri në gjuhën shqipe dhe serbe ndoshta do të ishte më pak i nevojshëm. Fakti se edhe në mesin e dekadës së dytë të shekullit XXI, dhe gjashtëmbëdhjetë vjet pas luftës në e rreth Kosovës, përkthimi i një libri të tillë ende konsiderohet i nevojshëm dhe aktual, mund të kuptohet edhe si tregues i të arriturave të mangëta në tejkalimin e konfliktit të stërzgjatur mes Serbisë e Kosovës. Sido që të jetë, shpresoj se botimi i këtij libri në këto dy gjuhë do të kontribuojë që marrëdhëniet Serbi – Kosovë të kuptohen në dritën e një perspektive të re paradigmatiche — atë të integritit evropian — dhe përbrenda kësaj perspektive të gjendet edhe potenciali për tejkalimin e konfliktit dhe normalizimin e këtyre marrëdhënieve.

Pas botimit të këtij libri në gjuhën gjermane dhe kritikës që i është bërë nga studiues të fushave përkatëse, si dhe gjatë punës me studentë pranë Departamentit të Shkencës Politike në Universitetin e Prishtinës, krijova bindjen se do të ishte e dobishme që libri të përkthehej. Kështu, qysh më 2009 shtrova një kërkesë te Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës që ta mbështeste përkthimin e tij. Asnjëherë nuk mora përgjigje a sqarim lidhur me kërkesën. Sidoqoftë, tetë vjet pas botimit në gjermanisht, libri po botohet sot edhe në gjuhën shqipe e serbe vetëm falë mbështetjes së ofruar nga Konrad Adanauer Stiftung, institucion ky të cilit ia shpreh falënderimin dhe mirënjohjen time të thellë.

Për më shumë, dua të falënderoj edhe përkthyesit e librit, të gjithë bashkëpunëtorët që më kanë inkurajuar përgjatë këtyre viteve dhe me durim kanë dëgjuar diskutimet lidhur me hartimin dhe botimin e tij. Një mirënjohje të veçantë ia kam për borxh familjes sime, pa mirëkuptimin dhe durimin e të cilës vështirë se do ta mblidhja forcën që ta jetësoja edhe botimin në shqip e serbisht. Të gjithëve u jam shumë falënderues dhe mirënjohës.

Prishtinë, qershor 2015

Arben Hajrullahu

Parathënie

Shkatërrimi përfundimtar i Jugosllavisë komuniste më 1991 i gjeti krejt të papërgatitura shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Shenjat paralajmëruese u shfaqën nga fundi me mënjanimin në formë grushti të shtetit të udhëheqësive komuniste, republikane e krahinore, në Mal të Zi, Vojvodinë e Kosovë, me zëvendësimin e këtyre nga marioneta të varura prej Milošević-it në fund të 1989-ës dhe fillim të 1990-ës, si dhe me heqjen e plotë të autonomisë së Kosovës dhe vendosjen e një regjimi të shtetit policor nga viti 1990 e më tej. Menaxhimi reaktiv i krizave i Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe i Sigurisë së BE-së ishte plotësisht i papërgatitur për fillimin e luftërave sulmuese nga ana e Armatës Popullore „Jugosllave” — që ndodhej nën udhëheqjen e Serbisë — kundër Kroacisë më 1991 dhe Bosnjës më 1992, dhe prandaj edhe dështoi krejt. Ishte vetëm intervenimi i NATO-s nën drejtimin amerikan ai që më 1995 ia doli t’i jepte fund vrasjeve masive të përditshme dhe ta detyronte një paqe „negative” në Bosnjë. Mirëpo, në Dejton çështja e Kosovës mbeti e lënë pafalshëm mënjanë, prandaj historia u detyrua të përsëritej. Pas përshkallëzimit të konflikteve të armatosura më 1998, vetëm në pranverë 1999 dhe sërish me intervenimin e NATO-s, që e mundshme të ndërpritej spastrimi etnik dhe vrasjet masive të popullatës shqipfolëse dhe të vendosej një administratë ndërkombëtare nën drejtimin e OKB-së, e quajtur UNMIK. Sot duket se prapë kemi mbërritur te një pikë vendimtare, e cila pas bisedimeve të gjata rreth statusit — me a pa pëlqimin e Ruisë në Këshillin e Sigurimit — do të mund të përfundonte në një pavarësi shtetërore, ndonëse „të kushtëzuar” ose „të mbikëqyrur”.

Për një kohë të gjatë, motoja e administratës ndërkombëtare në Kosovë ishte „standardet para statusit”. Tani, pasi UNMIK-u nuk ia doli as ta stabilizonte demokracinë dhe sundimin e ligjit, as të sillte një rritje ekonomike e as madje ndonjë pajtim mes kosovarëve shqipfolës me ata serbishtfolës, a do të zëvendësohet kjo moto thjesht me „pavarësia pa standarde”? A është BE-ja, e cila do të duhej ta bartte pjesën më të madhe të veprimtarisë mbikëqyrëse, më e përshtatshme për t’iu qasur problemeve të Kosovës me një shoqëri thellësisht të ndarë mbi baza etnike, një bombë të kurdisur ekonomiko-demografike me afro 70 për qind papunësi brenda një popullate kryesisht të moshës rinore, si dhe me nevojën për ndërtimit të strukturave eficiente shtetërore? T’i zëvendësosh policët e OKB-së me policë të BE-së dhe disa gjyqtarë e prokurorë ndërkombëtarë thjesht nuk do të mjaftojë. Për më tej, është e rëndësishme që burokracia e Brukselit më në fund po fillon ta „kuptojë” problematikën, se jo veç në Kosovë, por në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor nuk bëhet fjalë për një transformim dhe zgjerim „normal” të BE-së, gjatë të cilit pritet vetëm marrja përsipër e implementimit të *acquis communautaire*, por kërkohet

që së pari të krijohen parakushtet themelore për „good governance”, pra për vetëdijen e një komuniteti politik, i cili kapërcen të menduarit vetëm përbrenda përkatësive dhe besnikërive etnike dhe vetëm kështu mundëson identitete të shumëfishta, përfshirë këtu edhe një identitet evropian. Edhe autori i këtij libri shprehet për krijimin e një „kombi politik të kosovarëve”, i cili ngërthen kosovarët shqipfolës dhe serbishtfolës, e që në literaturën e tërësishme rreth konfliktit të Kosovës, të cilën e njoh, mbetet i pashoq deri më sot. Me analizën e tij të thellë të orientuar kah aktorët, institucionet dhe politikat mbi bazën e fillesave teorike të transformimit dhe të demokracisë dhe mbi „kredon” për nevojën që krijimi i shtetit civil dhe i kombit të merret seriozisht dhe të përkrahet edhe në mënyrë aktive nga ana e Brukselit, autorit duhet t’i dëshirohet një rezonancë e gjerë jo vetëm ndërmjet Prishtinës e Brukselit, por edhe Uashingtonit e Moskës.

Sarajevë, 18 qershor 2007

Joseph Marko

Parathënie

Prej vitesh merrem me idenë e një forcimi afatgjatë të paqes në Ballkan nëpërmjet integritit në BE. E ardhmja politike e këtij rajoni në epokën sfiduese, por njëkohësisht edhe përplot shanse të integritit dhe të globalizimit, paraqet lajtmotivin e këtij libri dhe njëkohësisht arsyeton edhe interesimin tim për këtë temë. Qëllimin e kam që të jap një kontribut për zgjidhjen e konfliktit serbo-kosovar, i cili shpesh paraqitet si i pazgjidhshëm.

Ky punim nuk duhet të kuptohet në frymën e përpunimit të „të kaluarës tragjike” të një populli, por përkundrazi synon të lirohet nga mitet dhe stereotipet dhe të japë një kontribut për forcimin dhe sigurimin afatgjatë të paqes në këtë rajon. Fundja, për mua në qendër nuk qëndrojnë e kaluara dhe hakmarrja, por e ardhmja dhe ndërtimi.

Vetëm falë mbështetjes së shumë personave e pata të mundshme ta përfundoja këtë punim. Profesori Ottmar Höll nga Universiteti i Vjenës me vërejtjet e tij të çmueshme më dha guximin dhe lirinë që ta hartoja punimin. Profesori Joseph Marko nga Universiteti i Gracit nëpërmjet mësimave dhe kritikave të tij plot ide, la gjurmë të thella në „socializimin tim shkencor”. Dr. Henriette Riegler më mbështeti gjithmonë me diskutime objektive në veprimtarinë time shkencore. Të gjithëve u jam tejet mirënjohës.

Së fundi dëshiroj t’i falënderohem përzemësisht edhe rrethit të miqve dhe në veçanti familjes sime, të cilët me shumë durim më përkrahën në të gjitha stadet e ecurisë së deritashme.

Chapel Hill, 20 gusht 2007

Arben Hajrullahu

Përmbajtja

Indeksi i figurave	19
Indeksi i akronimeve dhe i shkurtesave	21
Hyrja	23

Pjesa I

Kreu I: Korniza teorike e konfliktit të Kosovës 33

A. Qasjet e tipologjizimit të konfliktit të Kosovës 33

B. Skema trekëndëshe e komunikimit „Kosovë – Serbi/Jugosllavi – Bashkësi ndërkombëtare” 35

C. Perceptimet e Kosovës nga ana e palëve në konfliktin e Kosovës 37

I. Vetëperceptimi nga ana e palës *Kosovë* (këndi A i skemës trekëndëshe të komunikimit) 37

II. Perceptimi i huaj nga ana e palës Serbi/Jugosllavi (këndi B i skemës trekëndëshe të komunikimit) 38

III. Perceptimi i huaj nga ana e palës bashkësi ndërkombëtare (këndi C i skemës trekëndëshe të komunikimit) 39

Kreu II: Aspektet historike dhe juridike të konfliktit të Kosovës 41

A. Mitologjizimi i ngjarjeve historike në Kosovës dhe zanafillat e politikës serbomadhe 41

I. Konstrukti i „të drejtës historike” mbi Kosovën, vendit me „dy histori” 42

II. Beteja e mitologjizuar në Fushën e Mëllenjave 43

III. Politika serbomadhe si zanafillë e konfliktit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë 44

B. Efektet e Kongresit të Berlinit dhe të Konferencës së	
Ambasadorëve në Londër në konfliktin e Kosovës	46
I. Sfondet dhe ngjarjet rreth Kongresit të Berlinit	46
II. Sfondi dhe ngjarjet rreth Konferencës së Ambasadorëve në Londër	47
III. Pushtimi i Kosovës më 1912	48
IV. Kufijtë e Shqipërisë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1913	50
V. Shënimi i kufijve në Ballkan në territoret e banuara me shqiptarë	52
C. Kosova në kohën ndërmjet luftërave dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore	54
I. Kosova nën sundimin e Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve	54
II. Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore	55
D. Kosova pas Luftës së Dytë Botërore	58
I. Mbetja e detyruar e Kosovës në Serbinë përkatësisht Jugosllavinë komuniste	58
II. Nga statusi i një territori autonom deri te ai i një <i>kuazi</i> -republike në kushtetutën e vitit 1974	60
1. Kosova si territor autonom	60
2. Kushtetuta e fundit e RSFJ-së e 21 shkurti 1974	61
E. Nga kërkesa deri te shpallja e Republikës së Kosovës	63
I. Trazirat masive në <i>strehën vorfënore</i> të Jugosllavisë në Kosovë më 1981	64
1. Modeli ekonomik jugosllav i „vetëqeverisjes”	66
2. Skicë e zhvillimit ekonomik dhe social të Kosovës në vitet e 1980-ta	67
II. Fillimi i fundit të RSFJ-së	71
III. Zhvillimet në Kosovë rreth vitit të kthesës 1989	72

Kreu III: Aktorët e brendshëm dhe të jashtëm në politikën e Kosovës të viteve të 1990-ta	76
A. Nga sistemi i shtetësisë paralele deri te administrata e UNMIK-ut	76
I. Konstituimi i Republikës së Kosovës në sistemin e shtetësisë paralele	76
II. Pozita e Kosovës sipas të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës shtetërore gjatë sistemit të shtetësisë paralele	79
III. Qëndrimi brenda-kosovar gjatë sistemit të shtetësisë paralele	81
B. Sjellja e aktorëve ndërkombëtar në konfliktin 1989 – 1999	84
I. Qëndrimi keqkuptues dhe pragmatik i bashkësisë ndërkombëtare	84
1. Konferenca për Jugosllavinë dhe Marrëveshja e Dejtonit	85
2. Shtetet e BE-së dhe Parlamenti Evropian	87
3. KSBE/OSBE	89
4. Shtetet e Bashkuara të Amerikës	90
II. Skicë e aspekteve ndërkombëtare të luftës në Kosovë më 1999	92
1. Interpretimet sipas të drejtës ndërkombëtare të të drejtës së secesionit dhe të intervenimit humanitar	93
2. Qëndrimi i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe operacioni i NATOS „Allied Force”	94
2.1. Qëndrimi i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara	94
2.1.1. Rezoluta e KS-së 1160 (1998) e 31 marsit 1998	95
2.1.2. Rezoluta e KS-së 1199 (1998) e 23 shtatorit 1998	96
2.1.3. Rezoluta e KS-së 1203 (1998) e 24 tetorit 1998	96
2.2. Operacioni i NATOS „Allied Force”	96
2.2.1. Ngjarjet në prag të operacionit të NATOS „Allied Force”	96
2.2.2. Sqarime rreth legalitetit dhe legjitimitetit të operacionit të NATO-s „Allied Force”	99
III. Vendosja e administrimit të UNMIK-ut në Kosovë më 1999	102

Pjesa II

Kreu IV: Modeli shumëdimensional i integrimit për Kosovën dhe shtetet e saj fqinje	107
A. Aktorët e procesit të integrimit në BE	112
B. Procesi i integrimit në BE	112
I. Procesi i denacionalizimit dhe i supranacionalizimit (pika a)	112
II. Zhvillimi i rrjeteve të komunikimit (pika b)	114
III. Krijimi i proceseve të bashkëpunimit (pika c)	114
C. Rezultati: Përfundimi i integrimit në BE në rajonin e Ballkanit Perëndimor	115
Kreu V: Proceset e demokratizimit dhe të integrimit në Ballkanin Perëndimor ndërmjet globalizimit dhe nacionalizmit	117
A. Rëndësia e qasjeve të teorisë së transformimit dhe të demokratizimit për rajonin e Ballkanit Perëndimor	117
I. Parakushtet socio-politike për procesin e demokratizimit	117
II. Ardhmëria e sovranitetit dhe demokracia konsensuale në rajonin e Ballkanit Perëndimor	127
B. Vendet e Ballkanit Perëndimor ndërmjet nacionalizmit dhe integrimit në BE	131
I. Mobilizimi për krijimin e shteteve kombëtare	131
II. Nacionalizmi dhe patriotizmi në epokën e globalizimit	135
III. Koncepti i kombit kulturor dhe i kombit shtetëror në kontekstin e proceseve të integrimit në BE në rajonin e Ballkanit Perëndimor	142
IV. Sqarime rreth qasjeve të integrimit në BE për vendet e Ballkanit Perëndimor	147
C. Demokratizimi dhe integrimi në BE i rajonit të Ballkanit Perëndimor – i vështirë, por jo i pamundshëm	155

Kreu VI: Proceset e integrimit në BE si instrumente për vendosjen dhe sigurimin e paqes në rajonin e Ballkanit Perëndimor	160
A. Nismat rajonale të bashkëpunimit	165
I. Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore	169
1. Koncepti i Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore	170
2. Vlerësimi i Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore	174
II. Strategjitë rajonale të BE-së për Ballkanin Perëndimor	177
B. Procesi i integrimit në BE në Kosovë	181
I. Integrimi në BE i Kosovës mes utopisë dhe realitetit	183
1. Perceptimi kosovar i ekspertizës së BE-së	187
2. Strategjitë dhe politikat e BE-së në Kosovë	188
II. Limitet e lëshimeve kosovare në vijën e procesit të integrimit në BE	190
C. Çështja e statusit të Kosovës në kontekstin e procesit të integrimit në BE	200
I. Pasqyrë hyrëse rreth ‘çështjes së Kosovës’	200
II. <i>Inkluzioni kundër ekskluzionit</i> – Dy qasje të kundërta rreth çështjes së statusit të Kosovës	210
1. Skicë e gjendjes kushtetuese të Kosovës nën administrim ndërkombëtar	214
2. Perceptimet kosovare të qasjes ‘ <i>Standardet para statusit</i> ’	216
3. Aspekte ekonomike të konfliktit serbo-kosovar	219
4. Rezume rreth çështjes së statusit të Kosovës	223
III. Mospërputhja mes të drejtës kushtetuese dhe realitetit kushtetues: Gjendja e komuniteteve në Kosovë	225
1. Të drejtat e garantuara me kushtetutë për komunitetet dhe institucioni i ombudspersonit	227
2. Participimi politik i komuniteteve	228
3. Diskursi rreth marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë	229
IV. Ndërmjet iluzionit dhe realitetit: ‘Procesi i pajtimit’ në konfliktin serbo-kosovar	231

Kreu VII: Konkluzionet dhe perspektiva: Shprehje për një të ardhme evropiane të rajonit të Ballkanit Perëndimor	237
Pasthënie	247
Kreu VIII: Përfytyrimi i integrimit evropian dhe vazhdimi i konfliktit serbo-kosovar	249
A. Konflikti që vazhdon	249
B. Sjelljet e palëve në konflikt	250
C. Sfidat dhe konteksti i integrimit evropian	256
D. Perspektiva e tejkalimit të konfliktit	261
Bibliografia	265
Indeksi	305
Shtojcat	311
I. Ngjarjet kryesore të konfliktit të Kosovës 1912 - 2014	311
II. Përpjekje e tipologjizimit të forcave politike në Kosovë pas 1989	315
III. Dokumentet	317
1. Kërkesë e Kryetarit të Qeverisë së Kosovës drejtuar Kryesuesit të Konferencës për Jugosllavinë dhe ministrave të jashtëm të shteteve të KE për njohjen e Kosovës si shtet sovran dhe të pavarur e datës 21 dhjetor 1991	317
2. Deklaratë Politike e Këshillit Koordinues të partive politike shqiptare në Jugosllavi e datës 22 dhjetor 1991	321

Indeksi i figurave

Figura nr. 1: Konflikti i Kosovës	36
Figura nr. 2: Modeli i integrimit për Kosovën dhe shtetet fqinje të saj: Aktorët dhe proceset	111
Figura nr. 3: Skenarët e procesit të integrimit në BE të Kosovës dhe të shteteve fqinje të saj	243

Indeksi i akronimeve dhe i shkurtesave

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
AVNOJ	Këshilli Antifashist për Çlirimin Popullor të Jugosllavisë
BE	Bashkimi Evropian
BSEC	Black Sea Economic Co-operation
CARDS	Community Assistance for Reconstruction, Development, and Stabilisation
CEFTA	Central European Free Trade Agreement
CEI	Central European Initiative
CIA	Central Intelligence Agency
CSEE	Conference on Good Neighbourliness, Stability, Security and Co-operation in South Eastern Europe
DCP	Danube Co-operation Process
ESI	European Stability Initiative
EULEX	European Union Rule of Law Mission in Kosovo
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FYROM	The Former Yugoslav Republic of Macedonia
GjND	International Court of Justice
GZ	Gazeta Zyrtare
ICG	International Crisis Group
IDEA	International Institute for Democracy and Electoral Assistance
ILM	International Legal Materials
IPA	Instrument for Pre-Accession Assistance
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
ISPA	Instrument for Structural Policies for Pre-Accession
JIAS	Joint Interim Administration Structure
KE	Komitetet Evropiane
KF	Kushtetuta federative
KFOR	Kosovo Force
KS	Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara
KSBE	Konferenca për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës

LKÇK	Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës
LPK	Lëvizja Popullore e Kosovës
MSA	Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asociimit
MVK	Misioni Verifikues i Kosovës
NAJ	Nisma Adriatiko-Joniane
NATO	North Atlantic Treaty Organisation
ODIHR	Office for Democratic Institutions and Human Rights
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
ÖMZ	Österreichische Militärische Zeitschrift
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PHARE	Poland and Hungary Assistance for the Restructuring of the Economy
PKJ	Partia Komuniste e Jugosllavisë
PSA	Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit për Evropën Juglindore
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara
Rez. OKB	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë
RSFJ	Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
SAPARD	Special Accession Programme for Agriculture and Rural Development
SECI	Southeast European Co-operative Initiative
SEECF	Southeast European Co-operation Process
Shteti SKS	Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve
STM	Stabilisation Tracking Mechanism
TINA	Transport Infrastructure Needs Assessment
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
TPNJ	Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UNESCO	United Nations Educational Scientific and Cultural Organization
UNHCR	United Nations High Commissioner for Refugees
UNMIK	United Nations Interim Administration Mission in Kosovo
USIP	United States Institute of Peace

Hyrja

Që nga fundi i diktaturave komuniste në fillim të viteve të nëntëdhjeta të shekullit XX në rajonin e Ballkanit Perëndimor¹ edhe një herë në histori për çdo ditë po dëshmohej „barbarizmi i politikës”² përpara syve të demokracive të etabluara. Ngjarjet pas vitit 1989 në Ballkan më fort linin përshtypjen se ishte arritur fundi i politikës së etablimit dhe sigurimit të paqes sesa fundi i historisë³, i paralajmëruar nga politologu Francis FUKUYAMA. Gazeta austriake *Die Presse*, duke bërë bilancin e konflikteve luftarake nja dhjetë vjet pasi kishte nisur shkatërrimi i Jugosllavisë, ngjarjet i përshkruan si vijon:

„Spastrimi etnik: Ky term përshkruan më mirë se çdo nocion tjetër luftën shkatërrimtare të Jugosllavisë së vjetër të Titos, e cila filloi para dhjetë vjetësh dhe ende nuk ka përfunduar. Një armatë e rregullt bombardon me artileri fshatrat dhe qytetet, frikëson popullsinë. Pastaj vijnë trupat tokësore, kryesisht

¹ Nocioni artificial Ballkani Perëndimor është relativisht i ri dhe përdoret në radhë të parë nga BE-ja për Jugosllavinë e dikurshme, duke përjashtuar Slloveninë dhe duke shtuar Shqipërinë. Vendet e Ballkanit Perëndimor: Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria, shtrihen, shikuar nga këndvështrimi gjeografik, në perëndim të vendeve të tjera të Ballkanit: Rumanisë, Bullgarisë, Turqisë e Greqisë, përkatësisht në perëndim të vargmaleve ballkanike në Bullgari. Ato përndryshe nuk shfaqin tipare të tjera të posaçme gjeografike a ekonomike për të qenë regjion i veçantë brenda Ballkanit. Mirëpo, shikuar nga një perspektivë e re historike, politike dhe e politikës së sigurisë, këto vende të përmbledhura nën nocionin Ballkani Perëndimor më së voni që nga viti 1989 kanë përjetuar një fat të përbashkët, i cili karakterizohet prej përndejes së të ashtuquajturave „çështje kombëtare”, nëpërmjet konflikteve luftarake dhe rrënimit ekonomik.

Meurs këtë nocion të „Ballkanit Perëndimor” të vënë në përdorim nga BE-ja më 1989, me të drejtë e quan vijë ndarëse imagjinare që hedh në letër dallimin ndërmjet Rumanisë dhe Bullgarisë dhe rajonit të krizës në Ballkan. Krah. Wim van Meurs: Den Balkan integrieren. Die Europäische Perspektive der Region nach 2004 [Të integrohet Ballkani. Perspektiva evropiane e regjionit pas 2004], në: Aus Politik und Zeitgeschichte. Beilage zur Wochenzeitung Das Parlament, 10-11/3 mars 2003, f. 37. Mes tjerash, sipas mendimit tim nocioni Ballkani Perëndimor semantikisht tingëllon më pozitiv, sepse emërtimi Perëndim në kundërshtim me Lindje deri më sot tingëllon më shumë çmues. Edhe në regjione të tjera post-komuniste kishte, përkatësisht ka vështirësi të emërimit. Krah. p.sh. Jerzy Macków: Die Voraussetzungen demokratischer Entwicklung in Mittel-, Nordost-, Südost- und Osteuropa [Parakushtet e zhvillimit demokratik në Evropën e Mesme, Verilindore, Juglindore dhe Lindore], në: Aus Politik und Zeitgeschichte, Beilage zur Wochenzeitung Das Parlament, 3-4/15 janar 1999, f. 3-17, rreth kësaj sidomos f. 4-7 ose rreth nocionit Ballkani Wolfgang Libal, Christine von Kohl: Balkan. Stabilität oder Chaos in Europa [Ballkani. Stabilitet apo kaos në Evropë], Hamburg, Vjenë 2000, f. 50 vv.

² Dieter Senghaas: Wohin driftet die Welt? [Kah shmanget bota?], Frankfurt mbi Main 1994, f. 88.

³ Shiko Francis Fukuyama: The End of History and the Last Man, Londër 1992.

paramilitarë, vrasës, grabitqarë, përdhunues, plaçkitës. Ata grumbullojnë parinë në sheshin e fshatit, i vrasin, mandej shkojnë nga shtëpia në shtëpi, i nxjerrin banorët në rrugë, marrin ç'u pëlqen, vënë zjarrin. Kolona refugjatësh lëvizin nëpër gjithë vendin. Organizatat ndërkombëtare ofrojnë ndihmë humanitare, nganjëherë madje qëndrojnë në gatishmëri përpara se të ketë përfunduar tërësisht dëbimi".⁴

Kosova,⁵ që nga *kthesa* në hapësirën e dikurshme jugosllave, paraqet një çështje qendrore, për të cilën me sa duket ende nuk ka një përgjigje të qartë e që do ta garantonte paqen në rajon.

Gjatë analizës së aspekteve historike dhe juridike në këtë libër do të shpalosen rrënjët historike të konfliktit mes Kosovës dhe Serbisë, të cilat janë relevante edhe për të kaluarën e paradokohshme. Arsyet e shkatërrimit të Jugosllavisë ishin të ngulitura brenda vendit dhe jo jashtë tij, e ndër to shfuqizimi kundërkushtetues i autonomisë së Kosovës (1989), *prishja e marrëveshjes*, duhet parë si pikënisja vendimtare. Zhvillimet e deritashme juridike dhe politike në marrëdhëniet ndërmjet aktorëve të përfshirë në konflikt (*Kosova – Serbia/Jugosllavia – Bashkësia ndërkombëtare*⁶) do të duhej të shërbenin si mësim për vendosje dhe sigurim afatgjatë të paqes në Kosovë dhe përreth saj.

Lidhur me të ardhmen, çështja është që paqja në Kosovë dhe përreth saj të bëhet ,e pathyeshme' brenda shtëpisë së përbashkët, Evropës. Mirëpo, kjo mund të arrihet vetëm nëse palët në konflikt — veçmas Serbia dhe Kosova — e kryejnë një ballafaqim të vetëdijshëm dhe plot përgjegjësi me të kaluarën dhe nëse potenciali ekzistues njerëzor përfshihet, me anë të pjesëmarrjes, në proceset e demokratizimit të shoqërisë dhe të rritjes së ekonomisë. Një hap kyç me këtë rast do të jetë përfshirja më e fortë në të ardhmen, dhe më vonë edhe integrimi i plotë, në Bashkimin Evropian (më tutje: BE), i cili duket i mundshëm vetëm nëse Serbia dhe Kosova e njohin njëra-tjetrën si shtete të barabarta. Përndryshe politikanët me qëndrim paqësor të të dyja palëve vazhdimisht do ta humbin qëndrueshmërinë, ndërkohë që forcat

⁴ Irene Miller: 10 Jahre Zerfall Jugoslawiens. Wir fürchten uns nicht. Wir gehen in jeden Kampf ... [10 vjet shkatërrim i Jugosllavisë. Nuk frikësohemi. Shkojmë në çdo luftim ...], në: Die Presse, 23 qershor 2001, f. 6.

⁵ Kosova shtrihet në një sipërfaqe prej 10.887 km². Në territorin e saj jetojnë afro 2 milionë banorë. Prej tyre afro 90% janë me origjinë shqiptare dhe afro 10 % janë serbë, malazias, boshnjakë, myslimanë, kroatë, romë etj. Kryeqyteti i Kosovës është Prishtina; qytete të tjera të mëdha janë Prizreni, Mitrovica, Peja, Gjakova, Gjilani dhe Ferizaji. Kosova kufizohet në perëndim me Shqipërinë, në veri dhe verilindje me Serbinë, në veriperëndim me Malin e Zi dhe në jug me Maqedoninë.

⁶ Me togfjalëshin bashkësia ndërkombëtare në këtë punim do të emërtohen në radhë të parë shtetet dhe organizatat ndërkombëtare si Organizata e Kombeve të Bashkuara (më tutje: OKB), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (më tutje: OSBE), Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (më tutje: NATO), të cilat drejtpërsëdrejti ose tërthorazi janë të përfshira në rrjedhat politike dhe ushtarake në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

etno-nacionaliste — rrezik i vazhdueshëm këto për proceset e nisura të demokratizimit dhe të stabilizimit — do të bëheshin të pakontrollueshme. Pajtimi që do të arrihej gjatë njohjes së ndërsjellë të shteteve si të barabarta do t'i bënte të pakthyeshme proceset e demokratizimit dhe do t'i dobësonte forcat ekstremiste e nacionaliste, duke çuar te një përmirësim i ndjeshëm i gjendjes së pakicave etnike në të dyja vendet.

Me përfundimin e regjimit komunist në rajonin e Ballkanit Perëndimor duket se vetëm shpresa për një integrim të afërm⁷ të rajonit të Ballkanit Perëndimor në BE mund t'i japë fund jostabilitetit të vazhdueshëm politik dhe ekonomik. Fenomenet socio-politike të nacionalizmit dhe të integritit në rajonin e Ballkanit Perëndimor ndërlidhen në një mënyrë të veçantë. Është pikërisht kjo lidhje ajo që sqaron nevojën e shqyrtimit të të dyja fenomeneve në këtë libër. Një dimension qendror të këtij punimi ofrojnë fushat e ndërveprimit mes demokracisë, sundimit të ligjit, nacionalizmit dhe integritit.

Aktualisht duhen dalluar dy qasje të përgjithshme, të cilat i vlerësojnë në mënyrë reciproke gjasat e ardhshme të hapësirës së Ballkanit në procesin e transformimit dhe të demokratizimit. Përfaqësuesit e një *qasjeje optimiste* shohin gjasa, deri më tani krejtësisht të paqena, për një *evropianizim* të hapësirës ballkanike. Kështu p.sh. publicistja Elizabeth POND, shkruan: „Asnjëherë më parë Ballkani nuk kishte gjasa të tilla të mira për një integrim të vërtetë në Evropë”.⁸ Diçka e ngjashme mund të lexohet edhe në një raport të Institutit Amerikan për Paqe (United States Institute of Peace – më tutje: USIP):

„Për herë të parë pothuajse të gjitha qeveritë në Ballkan janë të zgjedhura në mënyrë demokratike dhe po shprehin dëshirën e tyre për përfundimin, një herë e përgjithmonë, të konflikteve që u nisën në fillim të viteve të 1990-ta [...] Stabiliteti në Ballkan është bërë mision afatgjatë për NATO-n dhe për BE-në”.⁹

Ndryshe nga përfaqësuesit e *qasjes optimiste*, përfaqësuesit e një *qasjeje pesimiste*, të cilët njëanshëm vizatojnë në mur një „rrezik shqiptar”, nuk shohin fort gjasa të mira për një stabilizim të hapësirës ballkanike as në vitet e ardhshme të këtij

⁷ Nocioni „integrim” dhe funksioni i tij në këtë libër duhen kuptuar në frymën e citatit vijues: „Integrimi’ nënkupton në përgjithësi krijimin e një tërësie nëpërmjet përfshirjes konstituive të elementeve përkatëse, që gjenden brenda ose jashtë [...]. Rezultat i integritit është ose duhet të jetë formësimi i identitetit kolektiv”. Gerhard Göhler: Konflikt und Integration [Konflikti dhe integriti], në: Beate Kohler-Koch (ed.): Staat und Demokratie in Europa [Shteti dhe demokracia në Evropë], Opladen 1992, f. 141.

⁸ Elizabeth Pond: Ist Frieden auf dem Balkan möglich? [A është e mundur paqja në Ballkan], në: Internationale Politik – Europa Archiv 5/2002, f. 4.

⁹ United States Institute of Peace (USIP), Special Report, Albanians in the Balkans [Raport Special, Shqiptarët në Ballkan], Uashington DC, nëntor 2001, f. 11 (www.usip.org).

shekulli. Kështu p.sh. hulumtuesja e Evropës Juglindore Antonina ZHELYAZKOVA profetizon:

„Në tërësi, perspektivat politike për Ballkanin mund të cilësohen vetëm si të zymta. Serbia, Mali i Zi, Maqedonia dhe mbase edhe Greqia dhe të gjitha shtetet e tjera të Ballkanit, në dhjetëvjetëshin e parë të shekullit XXI vazhdimisht do të destabilizohen prej proceseve të kombformimit dhe të bashkimit të shqiptarëve”.¹⁰

Nëse do të kenë të drejtë ndjekësit e qasjes *optimiste* apo të asaj *pesimiste* varet fort edhe nga sa shpejt e në ç'mënyrë do të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme për çështjen ende të pazgjidhur të statusit të Kosovës, e cila paraqiste pikënisjen e shpërbërjes së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (me tutje: RSFJ) dhe të konflikteve që pasuan në këtë territor.¹¹

Veç kësaj, mund të konstatohet se të dyja qasjet e lënë pa e marrë në shqyrtim një pjesë të realitetit. Ndërsa *qasja optimiste* shpërfill rreziqet potenciale, p.sh. se jo në çdo konstelacion gjasat e mira do të çonin te një integrim dhe para së gjithash te një vendosje e sigurim i përhershëm i paqes, *qasja pesimiste* shpërfill gjasat e etablimit të idesë së integritimit evropian dhe të sundimit të ligjit.

Nisem nga hipoteza themelore se integrimi në BE paraqet një instrument të zgjidhjes së konfliktit dhe të sigurimit të paqes, me ç'rast më duket e nevojshme që në mënyrë të diferencuar të identifikohen parakushtet dhe kushtet, nën të cilat integrimi në BE, në mënyrë vërtet të qëndrueshme, mund të krijojë paqe në Ballkanin Perëndimor, sidomos në rastin e konfliktit mes Serbisë dhe Kosovës. Motivi dhe caku i këtij punimi është që të japë kontributin për një të ardhme më të mirë dhe më paqësore në rajonin e Ballkanit Perëndimor me shpresë që ngjarjet çnjerëzore në këtë pjesë të Evropës, në prag të shekullit XXI, të paraqesin përmbylljen e një procesi dhe jo bartjen në shekullin e sapofilluar.

Ky punim dhe rezultatet e tij synojnë, ndonëse në përmasa të vogla, të stimulojnë procesin e integritimit në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Këtë proces të integritimit e kuptoj në frymën e teoricienit të integritimit Karl W. DEUTSCH, i cili funksionet kryesore të integritimit në mënyrë të përmbledhur i përshkruan si më poshtë:

„Detyrat kryesore të integritimit mund të përmbledhen në katër pika: 1. Ruajtja e paqes, 2. Arritja e një potenciali më të madh shumëqëllimësh, 3. Zgjidhja e

¹⁰ Antonina Zhelyazkova: Ethnische Minderheiten in Serbien und Montenegro. Die Angst der Balkan-Länder vor Separatismus [Pakicat etnike në Serbi dhe Mal të Zi. Frika e vendeve të Ballkanit nga separatizmi], në: Internationale Politik – Europa Archiv 5/2002, f. 13.

¹¹ Duke u nisur nga ky supozim, në këtë punim do të kufizohem kryesisht te Kosova.

një detyre specifike dhe 4. Fitimi i një vetëkuptimi dhe identiteti të ri të roleve”.¹²

Krahasuar me literaturën ekzistuese për Ballkanin Perëndimor, njohuria e re e këtij punimi, krahas projektimit të një *skeme trekëndëshe të komunikimit* të aktorëve të përfshirë në konfliktin e Kosovës, qëndron sidomos në konceptimin e një *modeli shumëdimensional të integritimit* për rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe përdorimin e këtij modeli në strukturat aktuale politike, juridike dhe ekonomike. Hipoteza, të cilën e paraqes në këtë model të mendimit, sipas njohurive të mia ende nuk është trajtuar më parë në këtë formë dhe në këtë kontekst në literaturën ekzistuese rreth Ballkanit Perëndimor.

Ky libër merr parasysh aspektet politologjike, juridike dhe ekonomike dhe ndjek prandaj një qasje ndërdisiplinore. Unë këto aspekte i përzgjedh krejt qëllimisht, sepse përgjithësisht bashkëpërcaktojnë integrimin nga njësi më të vogla në hapësira më të mëdha dhe në procesin e etablimit të shtetit ligjor në kuptimin liberal-demokratik lidhen ngushtë me njëra-tjetrën. Qasja që kam zgjedhur ndërtohet përveç kësaj mbi teoritë e integritimit, të transformimit, të hulumtimit të konflikteve dhe të demokracisë, të cilat janë relevante për temën. Qasja merr në konsideratë rezultatet kërkimore nga fushat e politikës së sigurisë dhe të drejtës kushtetuese, sidomos të inxhinieringut kushtetues.

Metoda kërkimore synon të mbështetet në një qasje empiriko-analitike dhe hermeneutike. Ballafaqimi im me temat socio-politike të rajonit të Ballkanit Perëndimor bazohet në supozimin se proceset e njohjes dhe të kërkimit nuk janë në vetvete pa parakushte. Andaj përvojat e mia personale të socializimit në hapësirën e Ballkanit Perëndimor, por edhe aftësitë e mia për empati ndaj mentalitetit dhe kulturës politike në shoqëritë post-totalitare dhe autoritare, sidomos në vendet e Ballkanit Perëndimor, do të derdhen në diskutimin kritik shkencor.

Lajtmotivi i këtij punimi përvijon një shteg të mundshëm për vendosjen dhe sigurimin e përhershëm të paqes në procesin e integritimit në BE, duke përfshirë dimensionet historike, juridike si dhe politologjike të konfliktit të Kosovës. Në fund jap një pasqyrë të shkurtër të çështjeve të trajtuara, që lexuesve të këtij punimi t’u shërbejë si udhërrëfyes.

Libri është i ndarë në dy pjesë, me gjithsej shtatë kapituj. Botimeve në gjuhët shqip dhe serbisht u është shtuar edhe kreu tetë, në të cilin paraqiten disa nga ngjarjet kyçe që e karakterizuan periudhën vjeshtë 2007 – fundvit 2014. Në pjesën e parë sqarohet sfondi historik i konfliktit serbo-kosovar. Në pjesën e dytë paraqitet perspektiva e integritimit në BE si një shans real për kapërcimin e këtij konflikti.

¹² Karl W. Deutsch: Frieden und die Problematik politischer Gemeinschaftsbildung auf internationaler Ebene [Paqja dhe problematika e krijimit të komuniteteve politike në rrafshin ndërkombëtar], në: Dieter Senghaas (ed.): Den Frieden denken, *Si vi pacem, para pacem* [Ta mendosh paqen, *Si vi pacem, para pacem*], Frankfurt mbi Main 1995, f. 363.

„Boshti sqarues” qendror në kreun e parë, rreth kornizës teorike të konfliktit të Kosovës, është një *skemë trekëndëshe e komunikimit* ndërmjet palëve të përfshira në konfliktin e Kosovës, e zhvilluar prej meje. Përveç kësaj, në këtë krye të parë gjendet edhe një përpjekje e tipologjizimit të konfliktit të Kosovës, e cila përfshin qasjet e ndryshme të tipologjizimit. Këtë skemë e përdor në një *qasje historike empiriko-analitike* në kreun e dytë gjatë analizës së aspekteve historike, juridike dhe politologjike të konfliktit të Kosovës, si dhe në kreun e tretë, te perspektivat e tashme, përkatësisht të ardhshmet.

Me kreun e katërt fillon pjesa e dytë, në të cilën prezantoj modelin shumëdimensional të integritimit që e kam zhvilluar, me titullin: *Modeli i integritimit për Kosovën dhe vendet e saj fqinje: aktorët dhe proceset*. Ky model formon kornizën e pjesës së dytë të këtij libri. Duke u nisur nga konflikti mes Serbisë dhe Kosovës duhet treguar një rrugë e mundshme se si mund të tejkalohen pasojat e totalitarizmave dhe autoritarizmave të shekullit XX në rajonin e Ballkanit Perëndimor nëpërmjet etablimit të *shtetit ligjor*. Shteti ligjor paraqet për mua *tipin ideal* të rendit shtetëror si dhe një *alternativë të pashmangshme* për rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Në kreun e pestë arsyetohet korniza teorike e pjesës së dytë, e cila mbështetet si në teorinë e rekonstruktimit historiko-tipologjik të realitetit social, ashtu edhe në traditën pozitiviste të modelimit të realitetit. Ky krye synon të mundësojë diskutimin teorik me proceset e demokratizimit, të transformimit dhe të integritimit në BE, që janë relevante për këtë temë, por edhe ta krijojë një bazë për operacionalizimin e këtyre proceseve në kreun e gjashtë të këtij libri.

Në kreun e gjashtë jepet së pari një pasqyrë e iniciativave të bashkëpunimit dhe të integritimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor, e pasuar nga një analizë empirike e proceseve të integritimit në BE në Kosovë. Në vazhdim në shembullin e rastit të çështjes së statusit të pazgjidhur të Kosovës do të sqarohen pengesat dhe parakushtet për krijimin e një „paqeje pozitive”¹³ ndërmjet Serbisë dhe Kosovës në kontekstin e integritimit në BE.

Në kreun shtatë (të fundit në botimin në gjermanisht) formulohen konkluzat në formë të shprehjes për njohjen dhe integrimin e rajonit të Ballkanit Perëndimor, duke u ilustruar nëpërmjet skenarëve pozitivë e negativë.

Libri përmbyllet me një pashënie të shkurtër mbi zhvillimet aktuale rreth çështjes së statusit të Kosovës. Më tutje, në shtojcën e librit gjenden: datat kryesore

¹³ Në *Leksikonin e politikës* nga D. Nohlens, dallimi mes një paqeje ‘pozitive’ dhe ‘negative’ shpjegohet si vijon: “Nën nocionin e përcaktuar negativ të paqes nënkuptohet mungesa e luftës, ndërsa nën nocionin e përcaktuar pozitiv të paqes nënkuptohet realizimi shumëllojshmërisht i interpretueshëm i drejtësisë dhe barazisë sociale, i lirive politike dhe personale, i shprehjes së aftësive njerëzore dhe mundësive të vetërealizimit ose, thënë në përgjithësi, mungesa e dhunës strukturore dhe kolektive” Egbert Jahn: *Frieden [Paqja]*, në: Andreas Boeckh (ed.): *Internationale Beziehungen*, Bd. 6 [Marrëdhëniet ndërkombëtare, vëll. 6] (Lexikon der Politik [Leksikon i politikës], ed. Dieter Nohlen), Munihi 1994, f. 156.

të konfliktit të Kosovës (1912 – 2014); një përpjekje e tipologjizimit të forcave politike në Kosovë pas vitit 1989 si dhe dy dokumente relevante, të cilat kontribuojnë për një kuptim më të mirë të temës së trajtuar. Këto janë 1. *Kërkesa e kryetarit të qeverisë së Kosovës drejtuar Kryesuesit të Konferencës për Jugosllavinë dhe ministrave të jashtëm të shteteve të BE-së për njohjen e Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur* e datës 21 dhjetor 1991 dhe 2. *Deklarata politike e Këshillit Koordinues të partive politike shqiptare në Jugosllavi* e datës 22 dhjetor 1991.

Pjesa I

Kreu I: Korniza teorike e konfliktit të Kosovës

A. Qasjet e tipologjizimit të konfliktit të Kosovës

Konflikti i Kosovës ka jo vetëm përmasën etnike, por edhe atë territoriale, ekonomike dhe sidomos politike, siç bëhet e qartë në qasjet vijuese të tipologjizimit. Në përgjithësi, statistikat tregojnë se në Evropë „dhuna ndëretnike edhe më tej përbën përjashtim, [dhe] jo rregull”.¹⁴ Edhe pse në rastin e Jugosllavisë së dikurshme konfliktet e ndryshme shpesh i mbivihen njëri-tjetrit, konflikti i Kosovës në krahasim me konfliktet e tjera në këtë hapësirë ka një shprehje më të spikatur etnike.

Në përgjithësi, pozita gjeografike e Evropës Juglindore, përkatësisht e Ballkanit, mes Perëndimit dhe Lindjes bënte që fuqitë dhe perandoritë e mëdha në këtë rajon me shekuj t'i provonin forcat dhe dobësitë e tyre dhe prandaj u ofruan fare pak gjasa për ngjizjen e këtij rajoni me Evropën perëndimore. Edhe terreni i pakalueshëm dhe prandaj i papërshtatshëm për komunikim kontribuoi në brishtësinë e strukturës politike të tij.

Pas Luftës së Dytë Botërore, komunizmi u përpoq, përbrenda ideologjisë së vet, t'i zgjidhte problemet e nacionaliteteve, të trashëguara nga sundimi feudal i „Perandorisë” shumëkombëshe të Jugosllavisë, nëpërmjet krijimit të një „*mbinacionaliteti*”, ose — në linjë me modelin e kombit „sovjetik” — të një kombi „jugosllav”. Këto përpjekje për krijimin e identitetit „jugosllav” kulmuan në vitet e 60-ta dhe të 70-ta të shek. XX. Me këtë rast regjimi komunist, si „elitë e diturisë” dhe bartës i diskursit, synonte krijimin e një mendësie të përbashkët kulturore, e cila ta merrte kuptimin nga e kaluara duke e spikatur integrimin social, të përbashkëtën. Mbamendja kulturore iu përshtat kornizave referenciale të kohës, me ç'rast në vend të figurave të kujtesës që theksonin „kundërshtitë”, spikateshin ato që integrimin e „jugosllavëve” e arsyetonin nga e kaluara dhe e bënë të mundshëm për të tashmen dhe të ardhmen.¹⁵ Miti i Betejës së Kosovës, fjala vjen, në nivelin federativ u cilësua si një ngjarje fare e parëndësishme. Vendin e tij e zuri heroizmi i „luftës së paepshme partizane”. Së fundi, me dështimin praktik të ideologjisë komuniste, dështoi edhe konstrukti i „*mbinacionaliteti*”.

¹⁴ Stephan Kux: Ursachen und Lösungsansätze des Balkankonflikts: Folgerungen für das Abkommen von Dayton [Shkaqet dhe nismat për zgjidhjen e konfliktit të Ballkanit: Përfundimet për Marrëveshjen e Dejtonit], Europa Institut në Universitetin e Bazelit Nr.16/1996, f. 6.

¹⁵ Shih Jan Assmann: Das kulturelle Gedächtnis. Schrift, Erinnerung und politische Identität in frühen Hochkulturen [Mbamendja kulturore. Shkrimi, kujtesa dhe identiteti politik i kulturave të dikurshme të larta], Muni 1999.

Shqiptarët, të cilët para, por edhe pas Luftës së Dytë Botërore në Jugosllavi kundroheshin si „mish i huaj”,¹⁶ mbetën pothuajse të paprekur nga fenomeni i „të qenit jugosllav”, përkatësisht „të qenit elitë”. Dështimi i mbinacionalitetit, për shkak të shtypjes dhe shpërfilljes së etnive të ndryshme, mund të shihet edhe si një tjetër arsye për ringjalljen e fortë të nacionalizmit pas komunizmit dhe prandaj tërthorazi edhe si kontribut për etnizimin e konfliktit të Kosovës.

Megjithatë, konflikti mes Serbisë e Kosovës, përkatësisht mes popujve sllavë, veçmas serbëve, dhe popullsisë shqiptare në Federatën e Jugosllavisë, pavarësisht prej karakterit të konfliktit, nuk mund të interpretohet *vetëm* si „konflikt nacionalitetesh”. Në historinë e Kosovës dhe përgjithësisht të Ballkanit Perëndimor bashkëjetesa dhe bashkëveprimi i popujve të shumtën e kohës konsiderohej si gjë „e rëndomtë”. Tensionet në realitet dukshëm më shpesh kishin motive sociale sesa etnike ose madje fetare, mirëpo deri në kohën e tashme kjo qëllimisht u fsheh dhe u manipulua nga despotët.

Politologu Mir A. FERDOWSI e sheh përmasën etnike të konfliktit të Kosovës të lidhur vetëm me „mbrojtjen nga dominimi i huaj” dhe „mbrojtjen nga asimilimi” të pakicave kundër epërsisë reale ose të pandehur të një grupi tjetër etnik.¹⁷ Edhe eksperti për Ballkanin Jens REUTER e përshkruan konfliktin e Kosovës si një shembull klasik të konfliktit territorial, në të cilin pretendimet e arsyetuara historikisht përplasen me pretendimet e bazuara etnikisht.¹⁸

Vetëm me „rekonstruimin” e suksesshëm të identitetit serb mbi bazën e mitit të Kosovës¹⁹ nga shumica dërrmuese e elitës serbe, në krye me Akademinë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, e cila udhëheqësin serb Slobodan MILOŠEVIĆ e përzgjedhi si ekzekutues të „Programit të rekonstruimit për kombin serb”, në konfliktin e fundit për Kosovën pasoi një nacionalizim i shoqërisë dhe kështu edhe vazhdimi i konfliktit të pandërprerë që nga viti 1912, por me intensitet të ndryshëm, mes Kosovës dhe Serbisë. Programi i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, që gëzonte përkrahje masive edhe nga udhëheqësit e Kishës Ortodokse Serbe dhe mediat, ishte edhe shkaktari kryesor për procesin e dezintegrimit të ish-Jugosllavisë, prandaj

¹⁶ Jens Reuter: Die Albaner in Jugoslawien [Shqiptarët në Jugosllavi], Muni 1982, f. 25.

¹⁷ Shih Mir A. Ferdowski: Kriege seit dem Zweiten Weltkrieg. Dimensionen – Ursachen – Perspektiven [Luftërat që nga Lufta e Dytë Botërore. Dimensionet – shkaqet – perspektivat], në: Manfred Knapp etj. (ed.): Einführung in die Internationale Politik [Hyrye në Politikën Ndërkombëtare], Muni, Vjenë 1996, f. 322.

¹⁸ Shih Jens Reuter: Die Entstehung des Kosovo-Problems [Lindja e çështjes së Kosovës], në: Aus Politik und Zeitgeschichte. Beilage zur Wochenzeitung, Das Parlament, 34/20. gusht 1999, f. 3-10.

¹⁹ Për një këndvështrim të intelektualëve serbë, të ndriçuar nga kënde të ndryshme, lidhur me shkatërrimin e Jugosllavisë, fenomenin e nacionalizmit serb dhe „traumat kolektive serbe” që e shoqërojnë, siç është miti i Kosovës, shih Thomas Bremer etj. (ed.): Serbiens Weg in den Krieg. Kollektive Erinnerung, nationale Formierung und die ideologische Aufrüstung [Ruga e Serbisë për në luftë. Kujtesa kolektive, formimi kombëtar dhe armatosja ideologjike], Berlin 1998.

riintegrimi dhe konstituimi i paqes së përhershme duket i gjasshëm vetëm në kuadër të procesit të integritit në BE²⁰.

„Sepse dezintegrimi dokumenton erozionin e një komunitarizmi dukshëm të paqëndrueshëm, e shpesh, si në rastin e lëvizjeve nacionaliste-secesioniste, edhe kërkimin për një komunitarizëm të ri; proceset e integritit tregojnë se është tejkaluar gama e komunitarizmit të deritanishëm”.²¹

Pra, konflikti i Kosovës ishte dhe është para të gjithash një konflikt politiko-territorial me elemente sociale dhe ekonomike, përmasa etniko-nacionale e të cilit doli në plan të parë si „shkaku i mirëfilltë mbulues i konfliktit” vetëm nëpërmjet shpërdorimit të qëllimshëm nacional-etnik të konstrukteve të identitetit dhe të ngjarjeve historike.

B. Skema trekëndëshe e komunikimit „Kosovë – Serbi/Jugosllavi – Bashkësi ndërkombëtare”


Skema trekëndëshe e mëposhtme e komunikimit „Kosovë – Serbi/Jugosllavi – Bashkësi ndërkombëtare” që e kam zhvilluar, përdoret fillimisht në vetëperceptimin dhe perceptimin e jashtëm të palëve, kryesisht lidhur me zhvillimet pas vitit 1989 në konfliktin e Kosovës, por do të mund të përdorej edhe për periudhën para vitit 1989. Për më tej, skema kryen edhe funksionin e një kornize për pjesën e parë të këtij libri, sidomos për sa u përket palëve dhe institucioneve në konfliktin e Kosovës.

²⁰ Nga fusha e studimeve historiko-krahasuese mbi përpjekjet për bashkimin, integrimin, asociimin, *ndërtimin e komuniteteve* si dhe shpërbërjen, shkatërrimin, ndarjen dhe *shpartallimin e komuniteteve* shih, ndër të tjera, si vepër klasike të themeluesit të teorisë moderne të integritit Karl W. Deutsch: *Political Community and the North Atlantic Area. International Organizations on the Light of Historical Experience*, Princeton 1957.

²¹ Dieter Senghaas: *Frieden – Ein mehrfaches Komplexprogramm* [Paqja – Një program shumëfish kompleks], në: Dieter Senghaas (ed.): *Frieden machen* [Të bësh paqen], Frankfurt mbi Main 1997, f. 560 v.

Figura nr. 1:
KONFLIKTI I KOSOVËS

I. PALËT



II. VEPRIMET

(ndërmjet A dhe B)

{që nga 1912 veprime të vazhdueshme konflikti}

1. Kosova ←————→ **Serbia/Jugosllavia**

(ndërmjet A dhe C)

{lutje për përkrahje dhe njohje}

2. a. Bashkësia ndërkombëtare ←————→ **Kosova**

(ndërmjet C dhe A)

{veprim pragmatik deri në injorim}

b. Bashkësia ndërkombëtare —————→ **Kosova**

(ndërmjet B dhe C)

{dërgim i ndërsjellë i sinjaleve të keqkuptuara}

3. Bashkësia ndërkombëtare ←————→ **Serbia/Jugosllavia**

C. Perceptimet e Kosovës nga ana e palëve në konfliktin e Kosovës

I. Vetëperceptimi nga ana e palës Kosovë (këndi A i skemës trekëndëshe të komunikimit)

Kosovarët nuk e kuptonin dhe nuk e kuptojnë veten si pakicë kombëtare, por si popull dhe komb *shtetformues* me të drejtën e vetëvendosjes. Megjithatë, pas Luftës së Dytë Botërore kërkesa politike e kosovarëve nuk ishte ndarja nga Jugosllavia, por barazia statusore dhe institucionale si shprehje e vetëvendosjes së *brendshme* me të tjerët, kombet sllave në shtetin e sllavëve jugorë, Jugosllavi.

Vetëm nga fillimi i viteve të 1990-ta, në procesin e avancuar të shpërbërjes së Jugosllavisë (e cila më nuk ekzistonte si shtet) dhe shndërrimin në „Republikë Federale të Jugosllavisë” të sapothemeluar nga S. MILOŠEVIĆ më 1992, pa legjitimitet demokratik dhe pa bazë legale, pra në RFJ të *Milošević-it*²², ku vazhdonte diskriminimi *de jure* dhe *de facto*, kosovarët e ngritën zyrtarisht kërkesën për vetëvendosje të jashtme. E drejta për vetëvendosje të brendshme u ishte mohuar tri herë në 20 vjetët paraprakë: nëpërmjet refuzimit të statusit të republikës brenda RSFJ-së, nëpërmjet heqjes antikushtetuese të autonomisë *formale*, përkatësisht të statusit si „*republikë materiale*” nga ana e Republikës së Serbisë më 1990 dhe së treti nëpërmjet vënies nën rendin e ri kushtetues jugosllav më 1992, i cili u arrit pa pjesëmarrjen e tyre.

Që nga fundi i vitit 1991, kur u miratua një „*Deklaratë politike e Këshillit Koordinues të partive politike shqiptare në Jugosllavi*” (shih Shtojcën), kosovarët në parim ndiqnin vijën politike të kësaj Deklarate. Kjo p.sh. bëhet e qartë përmes një krahasimi të Deklaratës me Memorandumin e nënshkruar më 13 prill 2001 nga tri partitë kosovare, përkatësisht grupimet politike më të mëdha²³, në të cilin janë

²² Në literaturë nga gazetarët por edhe nga autorë të tjerë kjo krijesë shtetërore emërtohet kryesisht në mënyrë të gabuar vetëm si Republika Federale e Jugosllavisë (RFJ). Ndonjëherë përdoren edhe nocione si „Jugosllavia e cunuar”, „Jugosllavia e mbetur” ose vetëm Jugosllavia. Me këtë rast bëhet fjalë për „Serbinë e Madhe” pjesërisht të realizuar, sepse në kohën e themelimit, kjo krijesë shtetërore tashmë i kishte okupuar pjesët e tjera konstitutive të RSFJ-së, si p.sh. Kosovën. Për mendimin tim, këto janë të gjitha nocione të gabuara nga vështrimi juridik-historik (historikisht, sepse rrënja e termit shtetëror „jugosllav” tashmë i përkiste historisë). Prandaj në këtë punim kjo krijesë shtetërore në mënyrë të unifikuar do të quhet Republika Federale e Jugosllavisë e Milošević-it (më tutje: RFJ e *Milošević-it*), emërtim ky që, për mendimin tim, në një kontekst juridiko-historik është më korrekti për këtë krijesë shtetërore, e cila përkohësisht u quajt edhe Serbi-Mali i Zi.

²³ Ky Memorandum iu dorëzua ministrit të jashtëm amerikan Collin Powell gjatë vizitës së tij në Maqedoni. Mes tjerash aty përcaktohet: „[...] I. Qëllimet kryesore të kosovarëve janë: 1. Angazhimi për një Kosovë të pavarur si territor i pandarë dhe me të drejta të njëjta për të gjithë qytetarët e saj pa dallim etnik, racor, gjuhësor, fetar, gjinor ose tjetër. [...] 4. Angazhim më i madh i faktorëve vendorë dhe ndërkombëtarë për siguri më të madhe për të gjitha

sqaruar parimet themelore të vizioneve dhe të kërkesave politike kosovare në lidhje me Kosovën dhe rajonin e Ballkanit.

II. Perceptimi i huaj nga ana e palës Serbi/Jugosllavi (këndi B i skemës trekëndëshe të komunikimit)

Në perceptimin e Serbisë, përkatësisht Jugosllavisë, kosovarët që nga vendosja e sundimit mbi Kosovën më 1912 nuk përbënin popull, përkatësisht njësi federale konstitutive (sipas interpretimit të regjimit të S. Milošević-it) në kuptimin e të drejtës shtetërore dhe ndërkombëtare, por në rastin më të mirë vetëm një pakicë. Sipas interpretimit serb, kosovarët si pakicë në kuadër të Jugosllavisë komuniste gëzonin shkallën më të lartë të autonomisë dhe pas vitit 1989, nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Serbisë, gëzonin mbrojtje si pakicë të „standardeve evropiane”. Sipas këtij interpretimi nuk ekziston asnjë burim juridik ndërkombëtar, madje as Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare e miratuar nga Këshilli i Evropës, që t’ua njihnte të drejtat kolektive ose që të kërkonte njohjen e autonomisë territoriale.²⁴ Prandaj çdo kërkesë e Kosovës për njohje si komb konstitutiv brenda RSFJ-së u kualifikua nga ana serbe si hap i parë drejt secesionit dhe kështu u refuzua si e papranueshme. Kërkesat dhe veprimet e kosovarëve kundroheshin edhe si terrorizëm i rrezikshëm, i cili luftohej duke ushtruar pushtetin shtetëror „legjitim”.

Edhe bashkësia ndërkombëtare e ndoqi në njëfarë mënyre këtë model perceptimi, sepse çështja e Kosovës edhe pas vitit 1989 shihej vetëm si problem i të drejtave të njeriut dhe të pakicave, e jo si problem i një „kombi shtetformues”, përkatësisht i një Kosove si pjesë përbërëse konstitutive e Federatës së ish-Jugosllavisë. Rrjedhimisht, pushtetarët serbë, të ngatërruar në modele perceptimi që ishin dukshëm ‚armiqësore për pakicat’, e shihnin veten disi të mbështetur që problemin e Kosovës ta kundronin si problem pakice.

pakicat. [...]”. Për tekstin e plotë të këtij Memorandumi shih Koha Ditore, 14 prill 2001, f. 1 v. Ekziston edhe versioni në anglisht.

²⁴ Krah. Joseph Marko: Kosovo/a – Ein Gordischer Knoten? [Kosova – Nyjë gordiane?], në: Joseph Marko (ed.): Gordischer Knoten Kosovo/a: Durchschlagen oder entwirren? [Nyja gordiane Kosovë: të këputet apo të shthuret?], Baden-Baden 1999, sidomos f. 237 v.

III. Perceptimi i huaj nga ana e palës bashkësi ndërkombëtare (këndi C i skemës trekëndëshe të komunikimit)

Bashkësia ndërkombëtare si palë e tretë dhe vendimtare është, ose ishte, e përfshirë në konfliktin e Kosovës me intensitet të ndryshëm. Përgjithësisht, në perceptimin e bashkësisë ndërkombëtare — pa e analizuar më hollësisht sjelljen e aktorëve të veçantë — mund të dallohet një qëndrim ambivalent ndaj konfliktit. Ky qëndrim në skemën teorike të paraqitur më lart (Figura 1) emërtohet si *veprim pragmatik deri në injorim dhe dërgim i ndërsjellë i sinjaleve të keqkuptuara*.

Përkitazi me perceptimin e huaj ndaj Serbisë/Jugosllavisë, nga njëra anë në kuadër të konferencës për Jugosllavinë, fjala vjen, Komisioni i Badinterit²⁵ e refuzoi pretendimin e Serbisë dhe të Malit të Zi që RFJ-ja e *Milošević-it*, e krijuar më 1992, të pranohej si pasardhëse e ligjshme e RSFJ-së; në anën tjetër, kjo „Jugosllavi” që deri më 1996, përkatësisht 2000, nuk u pranua nga OKB-ja dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, në rrjedhën e mëtejme të konfliktit u perceptua në realitet si palë sipas të drejtës ndërkombëtare. Kështu faktet relevante të krijuara nga regjimi i S. S. Milošević-it sipas të drejtës ndërkombëtare, pra Kushtetuta Serbe e vitit 1990, Kushtetuta e re Federale e vitit 1992, legjislacioni special për realizimin e regjimit policor në Kosovë i vitit 1990, u pranuan në fillim në mënyrë *implicite* nëpërmjet tolerimit dhe gjatë veprimeve të hapura luftarake u njohën edhe në mënyrë *eksplicite* si kornizë ligjore e një zgjidhjeje të mundshme të konfliktit të Kosovës.

Sa i përket perceptimit të huaj për Kosovën, aktet *ligjore* dhe *legjitime* të institucioneve të Kosovës — Kushtetuta e „Republikës së Kosovës” nga viti 1990 (e ashtuquajtura Kushtetuta e Kaçanikut), referendumi i vitit 1991 dhe ngritja e strukturave shtetërore të Kosovës — në rastin më të mirë u shpërfillën nga bashkësia ndërkombëtare dhe nuk u pranuan si fakte që duhen marrë parasysh juridikisht. Një përjashtim nga ky vështrim i bashkësisë ndërkombëtare paraqet njohja në negociatat e iniciuara nga Franca dhe Britania e Madhe për *Marrëveshjen e Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje* (më tutje: *Marrëveshja e Rambujesë*)²⁶ e presidentit të

²⁵ Ky komision arbitrazhi u krijua më 27 gusht 1991 në kuadër të Konferencës së Hagës për Jugosllavinë. Meqenëse kryesimin e bënte ministri i dikurshëm francez i drejtësisë Robert Badinter, komisioni quhet Komisioni i Badinterit.

²⁶ Marrëveshja e Rambujesë u negociua nga 6 deri 23 shkurt dhe 15 deri 18 mars 1999 në Rambuje dhe Paris nga bashkësia ndërkombëtare me delegacion kosovar e serb. Për shkak të refuzimit të delegacionit serb për ta nënshkruar Marrëveshjen e Rambujesë, ajo nuk hyri në fuqi, por menjëherë pas dështimit të negociatave, më 24 mars 1999, filloi ndërhyrja e NATO-s. Veç kësaj, Marrëveshja e Rambujesë ishte edhe pikënisje për draftin e kornizës kushtetuese për vetëqeverisjen e përkohshme (UNMIK/RREG/2001/9 nga 15 maji 2001 Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme, më tutje: Korniza Kushtetuese). Për më shumë rreth kësaj shih Arben Hajrullahu, Michaela Salamun: Der Verfassungsrahmen für die Provisorische Selbstverwaltung in Kosova [Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë], në: Südosteuropa 1-3/2002, f. 122 vv. Teksti i Marrëveshjes së

Kosovës, Ibrahim RUGOVA, dy herë të zgjedhur në mënyrë demokratike, njohje kjo e realizuar me përfshirjen e tij të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në proceset negociuese të rrafshit ndërkombëtar.²⁷

Një tjetër përjashtim gjendet te themelimi i *Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ish-Jugosllavinë*²⁸ (më tutje: TPNJ), kompetencat e të cilit vërtet përfshinin edhe krimet kundër njerëzimit dhe krimet e rënda të luftës edhe në territorin e Kosovës, juridiksionin e të cilit tribunal mbi shtetasit e vet e refuzoi RFJ-ja e *Milošević-it*, përkatësisht shteti pasues i saj.²⁹

Rambujesë, e cila parashihte një rregullim të përkohshëm, mund të gjendet në adresën: <http://jurist.law.pitt.edu/ramb.htm>.

²⁷ Si „institucion i presidentit të Kosovës” ai ishte „pranuar” edhe nga S. Milošević-i më 1996 përmes lidhjes së të ashtuquajturës „Marrëveshje e Romës” për rihapjen e shkollave shqipe. Më shumë për këtë marrëveshje shih p.sh. Miranda Vickers: *Between Serb and Albanian. A History of Kosovo*, Londër 1998, f. 305 vv. Rreth kësaj shih edhe J. Marko: (ed.): *Gordischer Knoten Kosovo/a: Durchschlagen oder entwirren?* [Nyja gordiane Kosovë: Të çahet apo të shturet?], Baden-Baden 1999, sidomos f. 237 v.

²⁸ Sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (më tutje: Rez. OKB) 827 (1993) e datës 25 maj 1993.

²⁹ Gjykata Kushtetuese e RFJ-së së *Milošević-it* dëshironte që ekstradimin e S. Milošević-it në TPNJ në Hagë, të realizuar më 28 qershor 2001 nga kryeministri serb Zoran Đinđić, një ditë para ekstradimit ta ndalonte si jokushtetuese.

Nenad Čanak, kryetar i Lidhjes Socialdemokratike të Vojvodinës, „njëri prej politikanëve më rrezatues dhe më origjinal të Serbisë” (Matthias Rüb, në: *Frankfurter Allgemeine Zeitung*, 30 qershor 2001) e shpreh për presidentin jugosllav Vojislav Koštunica, i cili i përmbahej Jugosllavisë së krijuar nga S. Milošević-i, pra RFJ-së së *Milošević-it*, dhe ligjeve të saj, këtë mendim: „Po të zgjidhej Koštunica për president gjerman pas përfundimit të luftës më 1945, do të kishte vazhduar vrasja sistematike e hebrenjve. Sepse vrasja masive i përkiste përfytyrimit të ligjit dhe rendit gjatë diktaturës së Hitlerit, dhe si „legalist i përbetuar” Koštunica nuk do të guxonte të ndërmerre asgjë kundër kësaj”. Shih intervistën me Nenad Čanak në: *NIN*, 1 mars 2001, f. 18 vv.

Edhe intelektualë të tjerë tërheqin deri diku paralele mes sistemit të S. Milošević-it dhe atij të Hitlerit. Kështu shprehet p.sh. shkrimtarja Susan Sontag në referatin e saj: *Das einundzwanzigste Jahrhundert begann in Sarajevo. Von Italien aus gesehen: Keine Hoffnung auf ein schnelles Ende des Kosovo-Krieges* [Shekulli XXI filloi në Sarajevë. Shikuar nga Italia: Nuk ka shpresa për një përfundim të shpejtë të luftës në Kosovë], në: Frank Schirmacher (ed.): *Der westliche Kreuzzug: 41 Positionen zum Kosovo-Krieg* [Kryqëzata perëndimore: 41 pozita rreth luftës në Kosovë], Stuttgart 1999, f. 69 – gjatë luftës në Kosovë: „Kosova i përket fundja Serbisë së Madhe të re, e cila ende quhet Jugosllavi. [...] Përfytyroni sikur Gjermania e nazistëve të mos tregonte ambicie ekspansioniste, do të kishte mbetur brenda kufijve të saj dhe të ishte kufizuar [...] thjesht në vrasjen të gjithë hebrenjve gjermanë. A besojmë vërtet që një qeveri ka të drejtën që në territorin e vet të bëjë çfarë të dojë? Ndoshta qeveritë e Evropës kësaj pyetjeje para 60 vjetësh do t'i përgjigjeshin me „po”.”

Kreu II: Aspekte historike³⁰ dhe juridike³¹ të konfliktit të Kosovës

A. Mitologjizimi i ngjarjeve historike në Kosovë dhe zanafillat e politikës serbomadhe

Qëndrimi i historianëve dhe i politikanëve për kohë të gjatë mbizotërohej nga një historiografi mitologjizuese. Vetëm në shek. XIX historiografia kritike shkencore filloi të luante rol parësor, gjatë të cilës periudhë hulumtues dhe dijetarë perëndimorë po përpiqeshin t'i zbulonin dhe t'i „rifitonin” jo vetëm të kaluarën e „popujve të vet”, por edhe shoqëritë „ekzotike” e periferike. Mirëpo, vëreheshin edhe tendenca në drejtime të kundërta, para së gjithash në Evropën e Mesme Lindore dhe në Evropën Juglindore. Atje historiografia kombëtare shpesh mbetej e ndryrë në mendime mitike e pseudofetare, ndonëse ajo këtë e mohonte dhe, duke iu referuar mënyrave të punës së vet „ekzakte shkencore”, përpiqej të dëshmonte të kundërtën.³²

Nëpërmjet instrumentalizimit dhe mitologjizimit të ngjarjeve të caktuara historike në Kosovë nga politikanë e shkencëtarë serbë për periudhën deri te Kongresi i Berlinit, konflikti i Kosovës në fund të shek. XIX dhe në shek. XX interpretohej si konflikt politiko-etnik.

³⁰ Ngaqë këtu kemi vetëm një skicë historike në formë të vështrimit të përgjithshëm, e cila synon të përmbushë rolin e një „ure të kuptuari” të situatës aktuale, rreth historisë së Kosovës i referohem sidomos veprës së Noel Malcolm-it: *Kosovo a short History*, Londër 1998, si dhe të M. Vickers: *Between Serb and Albanian, A History of Kosovo*, Londër 1998; rreth hapësirës së Ballkanit në përgjithësi i referohem Edgar Hösch: *Geschichte der Balkanländer* [Historia e vendeve të Ballkanit], Munihi 1993 dhe Magarditsch Hatschikjan, Stefan Troebst (ed.): *Südosteuropa, Gesellschaft, Politik, Wirtschaft, Kultur, Ein Handbuch* [Evropa Juglindore, Shoqëria, politika, ekonomia, kultura, doracak], Munihi 1999.

³¹ I referohem sidomos studiuesve Joseph Marko, Hannes Tretter, Tomilav Boric: *Perspektiven des zukünftigen politischen und rechtlichen Status Kosovos* [Përspektivat e statusit të ardhshëm politik dhe juridik të Kosovës], në: *Journal für Rechtspolitik* Jhg. 1/1, Vjenë 1993 dhe Joseph Marko (ed.): *Gordischer Knoten Kosovo/a: Durchschlagen oder entwirren?* [Nyja gordiane Kosova: Të çahet apo të shturet?], Baden-Baden 1999.

³² Krah. rreth kësaj çështjeje Eliade Mircea: *Mythos und Wirklichkeit* [Miti dhe realiteti], Frankfurt mbi Main 1988; Eliade Mircea: *Ewige Bilder und Sinnbilder. Über die magisch-religiöse Symbolik* [Figura dhe simbole të përjetshme. Rreth simbolikës magjike-fetare], Frankfurt mbi Main 1986; Eliade Mircea: *Das Heilige und das Profane. Vom Wesen des Religiösen* [E shenjta dhe profania. Për qenien e fetares], Frankfurt mbi Main 1984; Andrew B. Wachtel: *Making a Nation, Breaking a Nation. Literature and Cultural Politics in Yugoslavia*, Stanford-Kalifornia 1998.

I. Konstrukti i „të drejtës historike” mbi Kosovën, vendit me „dy histori”

Fenomeni i Evropës Qendore Lindore dhe asaj Juglindore, sipas të cilit historiografitë kombëtare në Ballkan mbetën të ndryra në mendimin mitik dhe pseudofetar për kohë të gjatë, në rastin e konfliktit të Kosovës karakterizon sidomos historiografinë dhe interpretimin serb të historisë, përmes të cilëve krijohet një „traumë serbe historikisht e arsyetuar” lidhur me Kosovën, e që në fund të fundit kërkon ta arsyetojë „të drejtën e sundimit mbi Kosovën”.

Ndërsa në historiografinë shqiptare dhe kryesisht në atë perëndimoren mbizotëron mendimi³³ se shqiptarët janë pasardhësit e ilirëve të vjetër³⁴ dhe kështu edhe banorë më të hershëm të territorit të Kosovës sesa sllavët³⁵, historiografia bashkëkohore serbe me shumicë thekson se sundimi mesjetar i perandorisë serbe në Kosovë „arsyeton” të drejtën për sundim të sotëm.

Po u nisëm nga ideja se historia e vjetër dhe bashkëkohore e spikatur nga kosovarët³⁶, si dhe historia mesjetare e spikatur nga serbët, mund ta arsyetojnë të drejtën historike për një territor, atëherë e shpërfillim faktin se një periudhë arbitrarisht e përzgjedhur e historisë nuk mund të vlejë si bazë për legjitimitimin e sundimit në kohën e sotme. Kjo ngaqë pushteti në shtetin modern kushtetues të shek. XIX, XX dhe XXI del nga populli dhe prandaj legjitimitimi i sundimit nuk mund të mbështetet mbi njëfarë „të drejte historike”.³⁷

³³ Krah. Miranda Vickers: *The Albanians. A modern history*, Londër, Nju Jork, 1995; Stefanaq Pollo, Arben Puto: *The history of Albania from its origin to the present day*, Londër, Boston 1981 dhe sidomos rreth prejardhjes së shqiptarëve të Kosovës, serbëve dhe vllahëve shiko – *Origins; Serbs, Albanians and Vlachs* – te N. Malcolm: *Kosovo a Short History*, Londër 1998, f. 22-41.

³⁴ Veç në shek. XI u vendos emri Arbanon për emërtimin e Shqipërisë. Pasardhësit e ilirëve të vjetër u quajtën *albanoi* ose *arbanitai*. Krah. Stavro Skendi (ed.): *Albania*, Nju Jork 1956.

³⁵ Populli ilir i dardanëve duhet ta ketë banuar territorin e tërësishëm të Kosovës së sotme qysh në antikë. Krah. për këtë Jens Reuter: *Die Albaner in Jugoslawien* [Shqiptarët në Jugosllavi], Munihi 1982, f. 23.

³⁶ Krahas figurës identifikuese të kosovarëve si fis ilir i dardanëve edhe figura e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut (1405 – 1468) si hero kombëtar i të gjithë shqiptarëve, i cili një çerek shekulli i luftoi kundër Perandorisë Osmane dhe arriti bashkimin e shqiptarëve dhe përmes kësaj edhe sovranitetin e tyre, vlen si figurë e rëndësishme historike që karakterizon identitetin e shqiptarëve. Miti i Skënderbeut është deri sot figura qendrore për vullnetin shqiptar për vetafirmimin kombëtar. Krah. M. Vickers: *The Albanians. A modern history*, Londër, Nju Jork, 1995.

³⁷ Frank Münzel: *Lässt sich die Unabhängigkeit Kosovas völkerrechtlich begründen?* [A mund të arsyetohet pavarësia e Kosovës me të drejtën ndërkombëtare?], në: J. Marko (ed.): *Gordischer Knoten Kosovo/a: Durchschlagen oder entwirren?* [Nyja gordiane Kosova: Të çahet apo të shthuret?], Baden-Baden 1999, f. 217 v supozon rreth çështjes së „të drejtës historike mbi Kosovën” si vijon: „[...] vetë edhe në qoftë se legjendat serbe pranohen si fakte historike: [...] Me arsyetim të ngjashëm, historikisht vërtet më solid, Gjermania do të mund të kërkonte dorëzimin e Romës, Luksemburgut ose Pragës si qytete të vjetra rezidenciale të

Lidhur me „të drejtën historike” të Serbisë mbi Kosovën historiani Noel MALCOLM shpjegon:

„Kosova mesjetare shpeshherë përgjithësisht cilësohet si ‚djepi i serbëve’, sikur të kishte qenë zemra e Serbisë që nga fillimet; por realiteti është goxha ndryshe. Veç diçka mbi 800 vjet e ndajnë ardhjen e serbëve në Ballkan në shekullin VII nga pushtimi përfundimtar osman, në vitet 1450: nga këta tetë shekuj, Kosova u sundua nga serbët vetëm në dy shekuj e gjysmë të fundit, që është më pak se një e treta e krejt periudhës.”³⁸

Mes shek. VI dhe VII sllavët u ngulitën në gati të gjitha pjesët e Ballkanit; shumica e fiseve ilire që banonin aty iu nënshtruan një procesi të dalngadalshëm të asimilimit. Ngaqë kolonizatorët sllavë morën në pronësi rrafshet e pëlleshme, popullata vendore ishte e detyruar të shpërngulej në rajonet malore. Përmes kësaj fiset shqiptare vërtet i ikën sllavizimit, por ranë në një situatë krejtësisht të pavolitshme ekonomike dhe kulturore.³⁹ Fakti që serbët e sotëm erdhën në hapësirën e Ballkanit në shek. VI dhe VII në vazhden e dyndjes së sllavëve, paraqet një ngjarje historike përgjithësisht të njohur në interpretimin e „historisë së dyfishtë” të Kosovës, e cila nuk vihet në dyshim as nga serbët, as nga shqiptarët e Kosovës e as nga historianët ndërkombëtarë.

II. Beteja e mitologjizuar në Fushën e Mëllenjave

Më 15 qershor 1389 (sipas kalendarit të sotëm më 28 qershor) u zhvillua njëra prej betejave të shumta në Ballkan, Beteja në Fushën e Mëllenjave (shqip Fushë Kosovë ose serbisht Kosovo Polje), ndërmjet një „ushtrie të krishterë” dhe osmanëve. „Ushtria e armatosur e krishterë” udhëhiqej nga princi serb Lazar dhe sipas legendave historike thuhet se përbëhej nga trupat serbe, boshnjako-kroate, shqiptare, bullgare dhe arumune.

Perandorisë së shenjtë romake të kombit gjerman. Në qoftë se në Kosovë dëshirohet vërtet të argumentohet historikisht, atëherë mund të ketë kthim edhe të menjëhershëm në kohërat e 800 a më shumë vjetëve para betejës në „Fushën e Mëllenjave”, kur në këtë vis pa dyshim flitej shqip ose ndonjë formë e hershme e shqipes, por nuk flitej asnjë gjuhë sllave, dhe kështu të kërkohet që serbët të kthehen në Ukrainë ose kudo prej nga kanë ardhur”.

³⁸ N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 41. J. Reuter shpjegon në kontekstin e Kosovës rreth kësaj çështjeje si vijon: „Shqiptarët që jetonin në Kosovë në sytë serbë ishin një trup kombëtar i huaj; ata nuk kishin kurrfarë „të drejte historike” mbi këtë territor. Sipas kësaj historianët serbë ishin përpjekur të dëshmonin se shqiptarët paskan ardhur në Kosovë tek në shek. 17 dhe 18. Historianët shqiptarë theksojnë në anën tjerët ekzistimin e vendbanimeve shqiptare në Ballkan shumë herët para se sllavët të vendosnin këmbën në këtë territor.” J. Reuter: Die Albaner in Jugoslawien [Shqiptarët në Jugosllavi], Munihi 1982, f. 25.

³⁹ Krah. E. Hösche: Geschichte der Balkanländer [Historia e vendeve të Ballkanit], Munihi 1993, f. 18.

N. MALCOLM e përshkruan betejën në Fushën e Mëllenjave si vijon:

„Ato pak gjëra që dihen me siguri të vërtetë për këtë betejë, mund të thuhet me fare pak fjalë. Lufta ishte e ashpër dhe pati humbje të mëdha nga të dyja anët. U vranë si Lazari, ashtu edhe Murati. Në fund të betejës, turqit kishin mbetur zotë të fushëbetjës. Muratin e pasoi i biri, Bajaziti, i cili i komandonte disa njësi të forcave turke në betejë; ai më pas e ktheu ushtrinë e mbetur në qendrën e trojeve osmane, për ta siguruar trashëgiminë e vet. Lazarin e pasoi djali i vogël Stefan Lazarević, i cili, duke vepruar nën udhëzimet e të ëmës, mbretëreshës së ve Milica, më vonë pranoi të bëhej vasal i turqve. Gjithçka tjetër rreth Betejës së Kosovës mbetet e pasigurt: kush mori pjesë, sa të mëdha ishin ushtritë, cili ishte rendi i betejës, cilat mund të kenë qenë pikat kthesë kyçe në betejë, kur gjetën vdekjen Lazari dhe Murati dhe, së fundi, nëse ajo duhet cilësuar si fitore apo si barazim”.⁴⁰

Serbët e festojnë, si i vetmi popull në Ballkan, luftën gjoja të humbur, gjë që e ilustron ndenja e *humbjes si rilindje* në kulturën serbe. Në kundërshtim me faktet historike, Beteja në Fushën e Mëllenjave u barazua me rënien e perandorisë serbe. Përqendrimi sot nuk është te ngjarja historike e betejës, por te këngët dhe legjendat e shumta që vërtiteshin rreth saj dhe që e lanë të bëhej mit.⁴¹

Kritiku kroat i miteve Miroslav KRLEŽA angazhohet për kritikën e miteve si akt civilizues me qëllim që t'i ndërpresë pasojat destruktive të „sjelljes mitike”:

„[...] zbatimi i fjalëpërfjalshëm i mitit në vepër [paraqet] rrezik të përgjithshëm. Krijuesit guximtarë të miteve, këtë e tregon shembulli i autorëve të shumtë serbë, me a pa dashje bëhen zjarrvënës.”⁴²

Një i tillë „shpërdorim i historisë” gjendet sot vazhdimisht në konfliktin mes Kosovës dhe Serbisë dhe sipas mendimit tim pa dyshim i ka kontribuar ashpërsimit të vazhdueshëm të konfliktit.

III. Politika serbomadhe si zanafillë e konfliktit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Në fillim të vitit 1844 politikani serb Ilija GARAŠANIN prezantoi në një „plan”⁴³ për politikën e brendshme dhe të jashtme serbe, një program ky për politikën

⁴⁰ N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 61.

⁴¹ Krah. N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 58 vv.

⁴² Krah. Aus Mördern werden Helden [Nga vrasës bëhen heronj], në: Frankfurter Allgemeine Zeitung, 6 mars 1993.

serbomadhe.⁴⁴ Në „Načertanije”⁴⁵ („skica”) I. GARAŠANIN skicon objektivat afatgjatë të një politike të jashtme serbomadhe, efektet e të cilës shtrihen deri në kohën e sotme.⁴⁶

Politika ekspansioniste serbe e shek. XIX mbështetej mbi një ideologji raciste, mbi iluzione, mitet mesjetare dhe fundamentalizmin sllavo-ortodoks.⁴⁷ Sipas një bindjeje të rrënjosur thellë në „psikologjinë serbe” nacionaliste se duheshin sunduar të gjithë të tjerët përreth, krijimi i një hegjemonie serbe përgjatë shekujve u shpall si objektivi kryesor kombëtar për ta penguar „zhdukjen e popullit serb”⁴⁸. Kjo politikë mbizotëronte, edhe pse me intensitet të ndryshueshëm, deri në fund të shek. XX dhe çoi në konflikte të vazhdueshme me popujt fqinj, prandaj paraqet rrezik potencial për paqen në Ballkan edhe në kohën e sotme.

⁴³ Shkrimi sekret „Načertanije” (Skica) – programi politik i Ilija Garašanin-it – publikuar më 1906 ndodhet në Arkivin e Vjenës që nga viti 1883. Idetë e I. Garašanin-it kishin një ndikim të fortë në politikën serbe pas Kongresit të Berlinit, kur me sukses u realizua aneksimi dhe „spastrimi prej shqiptarëve” në territoret e banuara me shqiptarë në Perandorinë e atëhershme Osmane — territore këto rreth qytetit të sotëm të Nishit në Serbi — dhe që u vazhdua deri në ditën e sotme, edhe pse në territore të tjera. Kështu p.sh. në politikën e kryeministrit serb Nikola Pašić, politika e të cilit në vitet e 1930-ta lidhur me Kosovën luante një rol të rëndësishëm në Serbi, ose në shkrimet e historianit dhe profesorit beogradas Vasa Čubrilović, i cili vdiq më 1990 dhe në shoqërinë serbe ende gëzon reputacion të lartë (krah. rreth kësaj Johann G. Reißmüller: Der Krieg vor unserer Haustür: Hintergründe der kroatischen Tragödie [Lufta para derës së shtëpisë sonë: Prapavijat e tragjedisë kroate], Stuttgart 1992, »Aussiedlung der Arnauten« Serbische Vorstellungen zum Amselfeld [»Shpërngulja e arnautëve« Përfytyrimet serbe rreth Fushës së Mëllenjave], f. 52-6) e deri së fundi në politikën e Slobodan Milošević-it.

⁴⁴ Mbështetje e fortë në idetë e Adam Çartoriskit, ministër i jashtëm rus nga 1804 – 1806, përkatësisht Frantisek Zah-ut, 1843 emisar polak në Beograd. Afro 90 % e „Načertanije” bazohet mbi këto ide.

⁴⁵ E përmbledhur kjo është përmbajtja e këtij „drafti”: Rivendosja e shtetit mesjetar serb (Perandoria e Car Dušan-it) mbi „të drejtën e shenjtë historike”. Theksimi i kontinuitetit dhe legjitimitetit historik të shtetit serbomadh – i ndërprerë vetëm përmes Betejës në Fushën e Mëllenjave më 1389. Lidhja me „fiset vëllazërore” të sllavëve të jugut jashtë principatës së Serbisë. Territoret fqinje do të duhej t’i bashkoheshin gradualisht Serbisë, sepse Serbia nuk mundka të ekzistojë „në formën e tanishme”, nuk mundka të jetë faktor stabiliteti në Ballkan. Hapi i parë drejt „zgjerimit të Serbisë” do të duhej të ishte bashkimi i „tokave serbe” të Bosnjës dhe të Hercegovinës me „vendin amë”. Ishte i planifikuar edhe bashkimi i Malit të Zi (qasja në Adriatik) dhe i veriut të Shqipërisë.

⁴⁶ Shih Wolfgang Petritsch etj.: Kosovo Kosova, Mythen Daten Fakten [Kosova, mite, data, fakte], Klagenfurt etj. 1999, f. 67.

⁴⁷ Shih për këtë p.sh. Mark Krasniqi: The role of the Serbian orthodox church in anti-Albanian policies in Kosova, në: Kosova, historical, political Review 3/1994, f. 15-19.

⁴⁸ Shih për këtë Imanuel Geis: Hegemonie und Genozid: Das Serbien-Syndrom 1991/92 [Hegjemonia dhe gjenocidi: Sindromi i Serbisë 1991/92], në: Angelika Volle, Wolfgang Wagner (ed.): Der Krieg auf dem Balkan. Die Hilflosigkeit der Staatenwelt [Lufta në Ballkan. Pafuqia e botës së shteteve], Bon 1994, f. 72-84; Jens Reuter: Das Albanerproblem in Jugoslawien. Kosovo und Mazedonien als Brennpunkte [Problemi i shqiptarëve në Jugosllavi. Kosova dhe Maqedonia si vatra zjarri], në: Europäische Rundschau 17/1989, f. 61-8.

B. Efektet e Kongresit të Berlinit dhe të Konferencës së Ambasadorëve në Londër në konfliktin e Kosovës

„Epoka e kombeve dhe e nacionalizmit duket të jetë një periudhë e shkurtër në rrjedhën e historisë së përcjellë me gojë; mirëpo epoka e kombeve ka filluar në pjesë të ndryshme të botës në kohëra të ndryshme: Gjithkund ajo ndiqte epokat e fshatrave, të fiseve dhe të perandorive.”⁴⁹

Konfliktet e dhjetëvjeçarëve të fundit në Ballkan, e kështu edhe ai mes Kosovës e Serbisë, mund të shihen deri diku edhe si *fëmijë* të kongreseve dhe konferencave evropiane të shek. XIX dhe XX, në të cilat kënaqja e interesave të fuqive të mëdha me gjasë luante rol më të madh sesa sigurimi i paqes afatgjate. Sikur të ishin tërhequr disi më „kujdesshëm” kufijtë në Kongresin e Berlinit më 1878 dhe në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1913, ndoshta në pjesë të madhe do të shmangeshin tmerret e fundshekullit XX. Edhe sot, *politika* afatgjate e paqes i nënshtrohet edhe më tej rrezikut të një „orientimi të ngarkuar nga interesat”.

I. Sfondet dhe ngjarjet rreth Kongresit të Berlinit

Vetëm nga e ashtuquajtura *Kriza Lindore* e viteve e 1870-ta, kur u bë i qartë një rend i ri territorial në dëm të shqiptarëve, u krijua një perspektivë kombëtare gjithëshqiptare⁵⁰ me kërkesa për autonomi. Në marrëveshjen parapaqësore të Shën Stefanit, të cilën në mars 1878 Rusia ia imponoi Perandorisë Osmane, do të duhej të krijohej një Perandori Bullgaromadhe si dhe një Mal i Zi dhe një Serbi e pavarur. Territori i banuar me shqiptarë ishte paraparë vetëm si „masë e ndarjes” mes bullgarëve, serbëve dhe malazezëve.⁵¹

Duke marrë parasysh kanosjen e copëtimit të territoreve, më 10 qershor 1878, tri ditë para fillimit të Kongresit të Berlinit, i cili kishte marrë përsipër ta rishikonte marrëveshjen e Shën Stefanit, u konstituua „Lidhja për Mbrojtjen e të Drejtave të Popullit Shqiptar” ose „Lidhja e Prizrenit”, e quajtur sipas vendit të themelimit. Kërkesat kryesore të „Lidhjes së Prizrenit” ishin: refuzimi i aneksimit të territoreve

⁴⁹ Karl W. Deutsch: Nationenbildung – Nationalstaat – Integration [Krijimi i kombit – shteti kombëtar – integrimi] (ed.) nga A. Ashkenasi, P. Schulze, Dyseldorf 1972, f. 16.

⁵⁰ Faza më e rëndësishme e historisë së re shqiptare, që nga muajt e parë të vitit 1878, kur kishin përfunduar aksionet ushtarake të rusëve dhe aleatëve të tyre sllavë në Ballkan, deri në fund të vitit 1912, kur forcat serbe dhe malazeze okupuan Kosovën, në historiografinë shqiptare quhet faza e „Rilindjes Kombëtare”. Nocioni i „Rilindjes Kombëtare” në Ballkan etablohet në vazhden e çlirimit nga osmanët dhe gjendet te gati të gjithë popujt e Ballkanit.

⁵¹ Krah. J. Reuter: Die Albaner in Jugoslawien [Shqiptarët në Jugosllavi], Muni 1982, f. 18.

të banuara me shqiptarë, bashkimi i këtyre territoreve në një njësi administrative (*vilajet*⁵²), futja e shqipes si gjuhë zyrtare dhe ngritja e një ushtrie kombëtare.

Historiani dhe eksperti i Evropës Juglindore Peter BARTL e përshkruan Lidhjen e Prizrenit si vijon: „Lidhja ishte një lëvizje kombëtare shqiptare [...], e cila për krahinat shqiptare synonte një status autonomie, të cilin krahu radikal donte ta zgjeronte deri në pavarësi të plotë.”⁵³

Ideja e një Shqipërie autonome që do ta përfshinte Kosovën e tanishme, sipas historianit Robert R. KRITT mund të rrjedhë nga patosi i diplomacisë ndërkombëtare deri te vizita në Petersburg e Franz JOSEPH-it në prill 1897⁵⁴: „[...] nëse një ndryshim në *status quo* do të dëshmohej si i pashmangshëm, ministri i jashtëm austro-hungarez propozoi mes ndryshimeve të tjera të mundshme edhe krijimin e një Shqipërie autonome [...]”⁵⁵.

Në maj 1878, me iniciativën e Austrisë e nën kryesimin e kancelarit gjerman Otto von BISMARCK u thirr Kongresi i Berlinit⁵⁶. Kërkesat e parashtruara nga „Lidhja e Prizrenit” për njohjen e kombit shqiptar dhe të drejtave të tyre prapëseprapë u refuzuan. O. von BISMARCK madje deklaroi se nuk ka shqiptarë dhe se nocioni *Shqipëri* është vetëm term gjeografik.⁵⁷

II. Sfondi dhe ngjarjet rreth Konferencës së Ambasadorëve në Londër

Përprjekjet e shqiptarëve për pavarësi në kuptimin e rrjedhave nacionaliste të shek. XIX dhe XX vazhduan edhe pas Kongresit të Berlinit. Aty nga ndërrimi i shekujve shqiptarët i mbajtën shpresat te lëvizja e xhonturqve, e cila luftonte për heqjen e absolutizmit në Perandorinë Osmane, për një kushtetutë dhe për garantimin e të

⁵² Fillimisht vilajeti ishte një rajon i vogël në Perandorinë Osmane që paguante tatime. Në vitin 1864 në Perandorinë Osmane u aprovua një ligj i ri për vilajetet, me të cilin u rritën kompetencat e një vilajeti, përafërsisht të krahasueshme me të sotmin „shtet konfederal ose federal”, mirëpo nën rrethana feudale. Që atëherë Kosova ishte njëra prej katër vilajeteve shqiptare në Perandorinë Osmane, krahas Janinës (sot në Greqi), Manastirit (sot në Maqedoni) dhe Shkodrës (sot në Shqipëri).

⁵³ Peter Bartl: Die albanischen Muslime zur Zeit der nationalen Unabhängigkeitsbewegung (1878 – 1912) [Myslimanët shqiptarë në kohën e lëvizjes për çlirimin kombëtar (1878 – 1912)], Visbaden 1968, f. 129.

⁵⁴ Krahe Robert R. Kritt: Die Londoner Botschafterkonferenz 1912 – 1913, Dissertation an der Universität Wien [Konferenca e Ambasadorëve në Londër 1912 – 1913, disertacion në Universitetin e Vjenës], Vjenë 1960, f. 48.

⁵⁵ Alfred F. Pribram: Der Geheimvertrag von Österreich-Ungarn 1879 – 1914 [Marrëveshja sekrete e Austro-Hungarisë 1879 – 1914], Cambridge, Massachusetts 1920, 2 vëllime, v. 1, f. 185-95. Fay, I, f. 365. Cituar sipas R. R. Kritt: po aty.

⁵⁶ Të përmbledhura rezultatet e Kongresit të Berlinit ishin: kufijtë e Bullgarisë u korrigjuan shumë; Serbia, Mali i Zi dhe Rumania u pranuan ndërkombëtarisht.

⁵⁷ Krahe për këtë Robert L. Wolff: The Balkans in our Time, Harvard University Press 1956, f. 91.

drejtave qytetare. Lëvizja ndër caqet e veta e deklaroi edhe zhvillimin e lirë të kombësive joturke. Mirëpo, fitorja e xhonturqve tregoi se caqet e vërteta të kësaj lëvizjeje ishin otomanizimi i të gjithë të nënshtruarve të Perandorisë Osmane dhe krijimi i një shteti qendror. „Kjo politikë shoviniste e xhonturqve”⁵⁸ kishte si pasojë kryengritjet në Shqipërinë veriore dhe në Kosovë më 1909 dhe 1910, të cilat fillimisht u shuan nga trupat turke. Më 1911 në Shqipërinë veriore shpërtheu një kryengritje e re, e cila u zgjerua në Kosovë, Maqedoninë perëndimore dhe Shqipërinë jugore dhe po mernte përmasa gjithnjë e më të mëdha. 25.000 luftëtarë të armatosur, të cilët pjesërisht kishin dezertuar nga ushtria turke, u grumbulluan në Prishtinë; 20.000 të tjerë kontrollonin Kosovën juglindore, prandaj turqit filluan ta merrnin seriozisht kryengritjen.⁵⁹ Kryengritja plasi në një kohë strategjikisht të volitshme⁶⁰, në gjysmën e parë të vitit 1912. Historiografia shqiptare mes tjerash i referohet si kryengritja që simbolizonte mundësinë e çlirimit nga sundimi osman.

Që nga viti 1908 shqiptarët qenë përpjekur t'i zbatonin kërkesat e ngritura nga „Lidhja e Prizrenit” në kuadër të rezistencës. Në shtator 1912 qeveria turke më në fund dha pëlqimin për krijimin e një shteti autonom shqiptar që duhej të përbëhej nga krahinat e Janinës, Manastirit, Shkodrës dhe Kosovës. Megjithatë, pasi mbijetesa e këtij shteti do rrezikohej nga Lufta e Parë Ballkanike (tetor 1912) dhe përveç kësaj rënia e Perandorisë Osmane ishte e dukshme, udhëheqësit shqiptarë vendosën të përcaktoheshin për një politikë të pavarur nga turqit, e cila më 28 nëntor 1912 përfundoi me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë dhe krijimin e një qeverie të përkohshme.⁶¹

III. Pushtimi i Kosovës më 1912

Më 13 tetor 1912 Serbia, Bullgaria dhe Greqia ia paraqitën një ultimatum Perandorisë Osmane, në të cilin thirreshin në nenin 23 të Vendimeve të Kongresit të Berlinit dhe kërkonin garantimin e menjëhershëm të autonomisë për të gjithë

⁵⁸ J. Reuter: Die Albaner in Jugoslawien [Shqiptarët në Jugosllavi], Munihi 1982, f. 20.

⁵⁹ Për më shumë rreth kësaj shih N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 238 vv.

⁶⁰ Lufta e turqve dhe e italianëve për Tripolin në Libi krijoi kushte të volitshme për një çlirim të popujve ballkanik nga sundimi osman. Në Paqen e Lozanës më 1912 Libia u bë autonome dhe i ra *de facto* Italisë.

⁶¹ Krah. Ramadan Marmullaku: Albania and the Albanians, Londër 1975, f. 25 vv.; Kristo Frashëri: The History of Albania, Tiranë 1964, f.180 v; N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 239-64. Me disfatën e turqve në Ballkan pak para Konferencës së Ambasadorëve në Londër më 1913 nuk mund të etablohej asnjë pushtet shtetëror shqiptar stabil në territoret e banuara me shqiptarë. Shqiptarët gjendeshin në një „situatë gërrshëre”: Në njërin anë dëshironin të çliroheshin nga sundimi pesëqindvjeçar turk, e në tjetrën duhej të mendonin saktë se deri ku do ta shkundnin sundimin turk, ngaqë shtetet fqinje të Koalicionit Ballkanik ortodoks si sundimtarë të rinj tashmë ishin para „portës” së territoreve shqiptare. Kohë të gjatë ekzistonte mendimi se lufta kundër turqve do ta lehtësonte okupimin nga ana e shteteve fqinje.

shtetasit e krishterë të pjesës evropiane të Perandorisë Osmane. Pesë ditë më vonë, më 18 tetor 1912 ata i shpallën luftë Perandorisë, por Mali i Zi qysh më 8 tetor 1912, pra pesë ditë para ultimatimit, kishte filluar me invazionin e territoreve shqiptare që sundoheshin nga Perandoria Osmane.⁶² Kështu nisi Lufta e Parë Ballkanike.⁶³

Edhe depërtimi i armatës së tretë serbe në Kosovë më 16 tetor 1912 kishte filluar para shpalljes së luftës. Pas disa luftimeve mbrojtëse⁶⁴ të shqiptarëve u pushtua e tërë Kosova nga ushtria serbe, e cila mbushi vakuumin e pushtetit të shtetit shqiptar të shpallur më 1912 e që ende nuk zotëronte pushtet të mjaftueshëm ekzekutiv dhe vazhdoi me fushatën e saj pushtuese në drejtim të Shqipërisë veriore dhe Detit Adriatik. Pushtimi i Shqipërisë nga ana e shteteve fqinje do të ketë pasoja negative për kohë të gjatë për shqiptarët dhe për tërë rajonin.

Gjatë pushtimit, popullsia joortodokse u masakrua brutalisht nga ushtritë sllave⁶⁵ dhe

„[...] synimi serbomadh për një shtet të pastër serb nuk mori parasysh simbiozën shumëshekullore të shqiptarëve dhe të serbëve në Kosovë. Planet serbomëdha parashihnin ndryshimin e strukturës etnike të Kosovës përmes ringulitjeve të pjesëve të popullsisë sllave dhe përmes dëbimit të shqiptarëve [...]”⁶⁶.

Kjo e përshkruan llojin e ekspansionizmit të Serbisë në drejtim të Kosovës, e cila më 1878, kur ishte njohur pavarësia e Serbisë, nuk i kishte takuar territorit të saj. Me

⁶² Shih N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 262.

⁶³ Aleatët ballkanikë Serbia, Mali i Zi, Bullgaria dhe Greqia arritën një fitore të plotë mbi territoret shqiptare që deri para pak kohësh sundoheshin nga turqit. Serbia pushtoi Shqipërinë lindore dhe të mesme, Mali i Zi Shqipërinë veriore deri në Mat dhe Greqia Shqipërinë jugore deri në Korçë. Vendet fqinje të Shqipërisë përpiqeshin t'i ndanin mes tyre territoret shqiptare. Vetëm trekëndëshi mes Lushnjës, Vlorës dhe Beratit (qytete në Shqipërinë qendrore) nuk u okupua dhe mbeti nën pushtetin shqiptar.

⁶⁴ Për më shumë rreth kësaj shih N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 251 vv.

⁶⁵ Shih rreth kësaj Leo Freundlich: Albaniens Golgotha [Golgota e Shqipërisë], Vjenë 1913. Pjesë të saj janë të botuara në: W. Petritsch etj.: Kosovo Kosova, Mythen Daten Fakten [Kosova, mite, data, fakte], Klagenfurt etj. 1999, f. 89 v. Shih po aty p.sh. edhe pjesët e shtypit evropian të asaj kohe, f. 91 vv. Në vitin 1914 një komision ndërkombëtar hetues i krijuar nga Fondacioni Carnegie në lidhje me këto sjellje të ushtrisë serbe në Kosovë publikoi si vijon: „Shtëpi dhe fshatra të tëra ishin bërë hi, popullsia e paarmatosur dhe e pafajshme ishte masakruar ... të këtylla ishin mjetet që u përdorën dhe janë ende duke u përdorë nga ushtarët serbo-malazezë, me qëllim të ndryshimit rrënjësor të strukturës etnike të rajoneve të banuara ekskluzivisht nga shqiptarët”. Carnegie, Endowment Report, f. 151. Cituar sipas N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 254. N. Malcolm është i mendimit se Fondacioni Carnegie nuk kishte guximin ta publikonte numrin e të vvarëve, sipas raporteve perëndimore deri në 25.000, shih po aty.

⁶⁶ Shih Mihajlo Maletić (ed.): Kosovo nekad i danas [Kosova dikur dhe sot], Beograd 1973, f. 97-112. Cit. sipas: J. Reuter: Die Albaner in Jugoslawien [Shqiptarët në Jugosllavi], Munih 1982, f. 26.

atë rast, nën stilizimin ekstrem të miteve mesjetare, u manifestua „trauma sakrifikuese”⁶⁷ serbe si „hakmarrje për Kosovën”⁶⁸.

IV. Kufijtë e Shqipërisë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1913

Duke marrë në konsideratë Luftën e Parë Ballkanike, *status quo*-ja e lidhur me interesat e pushtetit të Fuqive të Mëdha në Ballkan filloi të lëkundej, prandaj Austro-Hungaria, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Italia dhe Rusia thirrën më 17 dhjetor 1912 Konferencën e Ambasadorëve në Londër.⁶⁹ Burrështetasit e Evropës ishin të bindur se në çdo çast mund të shpërthente një luftë panevropiane, në qoftë se nuk gjendej një zgjidhje e cila t'i kënaqte interesat në Ballkan të aktorëve kryesorë në konferencë: Austro-Hungarisë dhe Ruisë.⁷⁰

Italia dhe Austro-Hungaria u ngarkuan të paraqisnin një plan për qeverinë e ardhshme të Shqipërisë,⁷¹ i cili sollti në rend të ditës çështjen e përcaktimit të kufijve të saj. Gjatë diskutimit, përfaqësuesi i Austro-Hungarisë, A. von MENSENDORFF, kërkoi

⁶⁷ Krah. Juliane Besters-Digler: Das Herz Serbiens [Zemra e Serbisë], në: Neue Zürcher Zeitung, Folio, qershor 1999, f. 32-4.

⁶⁸ J. Reuter: Die Entstehung des Kosovo-Problems [Lindja e çështjes së Kosovës], në: Aus Politik und Zeitgeschichte. Beilage zur Wochenzeitung, Das Parlament, 34/20. gusht 1999, f. 5.

⁶⁹ Me atë rast fuqitë e mëdha evropiane Anglia, Franca si dhe Rusia që ishin të lidhura përmes „Antantës”, dhe Gjermania, Austro-Hungaria dhe Italia që krijonin lidhjen e trashes, kishin qëndrime të kundërta diplomatike. Përfaqësuesit diplomatikë të Fuqive të Mëdha ishin: Nikoqir dhe njëkohësisht kryesues i konferencës Sir Edward Grey – Anglia, Paul Cambon – Franca, konti Aleksander Benkendorf – Rusia, markezi Guglielmo Imperiali – Italia, princi Karl Max Lichnowsky – Gjermania dhe konti Albert von Mensdorff – Austro-Hungaria.

Edhe në të ashtuquajturin Grup të Kontaktit për Ballkanin të caktuar më 25 prill 1994 në Londër, i cili mbante „dizgjinin” e politikës ndërkombëtare rreth Ballkanit, janë të përfaqësuara të njëjtat shtete (Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Italia dhe Rusia), me përjashtim të Austro-Hungarisë dhe me pjesëmarrjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Objektivi i Grupit të Kontaktit për Ballkanin është të dizajnohet një politikë e koordinuar për Ballkanin të shteteve të përfaqësuara në këtë forum.

⁷⁰ Fuqitë e tjera të Mëdha, si p.sh. Gjermania dhe Anglia, morën më tepër një qëndrim neutral, sepse nuk kishin interesa qenësore lidhur me ngjarjet në Ballkan, përveç që të ruanin baraspeshën e fuqive përkatësisht *status quo*-n. Në çështjet e Ballkanit Franca më shumë ishte dora e djathtë e Ruisë, derisa Italia e mbështeste Austro-Hungarinë, përderisa nuk u krijua një Shqipëri vërtet e fortë që do të mund ta dobësonte ndikimin e Italisë në Shqipëri. Një Serbi me dalje në Detin Adriatik Austro-Hungaria e shikonte si një rrezik për monarkinë dhe për këtë arsye të papranueshme, ndërsa Rusia u deklarua e gatshme që ta përkrahte Serbinë me kërkesat e saj për një port adriatik.

⁷¹ Krah. për këtë Ludwig Bittner etj. (ed.): Österreich-Ungarns Außenpolitik von der Bosnischen Krise 1908 bis zum Kriegsausbruch 1914 [Politika e jashtme e Austro-Hungarisë nga Kriza Boshnjake më 1908 deri të shpërthimi i luftës më 1914], V, Nr. 4944, Vjenë, Lajpcig 1930.

një tërheqje kufijsh të tillë që të gjitha territoret e banuara kryesisht nga shqiptarët të gjendeshin brenda kufijve shqiptarë.⁷² Mirëpo, propozimi i Monarkisë Austro-Hungareze shqetësonte fuqitë e tjera të mëdha dhe u refuzua në mënyrë strikte nga Rusia, si aleate tradicionale e Serbisë, si dhe nga Franca.⁷³ Qëndrimet e dallueshme të Ruisë dhe të Austro-Hungarisë kanosnin suksesin e konferencës dhe vinin në pikëpyetje paqen në Evropë.

Kufijtë e shtetit të ri shqiptar u përcaktuan përfundimisht në mars 1913 në një tekst të formuluar nga Fuqitë e Mëdha.⁷⁴ Me atë rast aspektet etnike, ekonomike dhe gjuhësore u injoruan tërësisht si parime për kufijtë e rinj. Kështu përfaqësuesi i Britanisë së Madhe Sir E. GREY pranoi se aspektet etnike nuk luanin kurrfarë roli gjatë përcaktimit të kufijve.⁷⁵ Në vazhdim nisi punën komisioni që përbëhej nga

⁷² Austro-Hungaria dëshironte të krijonte një Shqipëri të fortë, të pavarur dhe të aftë për të jetuar, e cila do të kishte qëndrim miqësor ndaj monarkisë dhe do të ishte mjaft e fortë për t'i rezistuar përpjekjeve serbe ose italiane për depërtim, kurse Italia më shumë donte një Shqipëri të dobët dhe të varur.

⁷³ Ambasadori i Ruisë, A. Benckendorff, u pozicionua kundër synimit, që sulltanit t'i merrej pushteti suprem në Shqipëri dhe mendonte se kjo qenkej e padrejtë, ngaqë pjesa dërrmuese e popullsisë qenkëkan muhamedanë. Shkaku i vërtetë i refuzimit të pavarësisë së plotë të Shqipërisë nga ana e Ruisë ishte që një Shqipëri autonome, pasi të ishin larguar turqit nga territoret e fundit të okupuara në Ballkan, do të ishte ndarë përfundimisht ndërmjet shteteve sllave të Ballkanit. Rusia besonte që përmes kësaj të realizonte pretendimet e saja të politikës së Fuqive të Mëdha. Krah. për këtë Arben Puto: Çështja shqiptare në kohën e luftërave ballkanike dhe gjatë Luftës së parë Botërore, f. 20, në: Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit, v. II, Tiranë, 1987; Thoma Murzaku: Politika Ballkanike e Ruisë dhe çështja shqiptare, Tiranë 1999.

⁷⁴ Për shkak të kontestit mes Serbisë dhe Bullgarisë rreth territoreve të zaptuara në Maqedoni, si të thuash një kontesti rreth „shpërndarjes së presë”, Bullgaria e sulmoi Serbinë në qershor 1913, përmes kësaj filloi Lufta e Dytë Ballkanike (29 qershor – 18 gusht 1913). Me këtë dukej se puna e Konferencës së Ambasadorëve në Londër do të bëhej edhe më e ndërlikuar. Në këtë konflikt Greqia u vendos në anën e Serbisë dhe pak pas kësaj aleatët arritën ta zmbropsin armatën bullgare nga Maqedonia. Pas kësaj mes Malit të Zi dhe Serbisë shpërtheu një konflikt i mëtejshëm rreth territoreve të zaptuara, këtë herë në Kosovë, që u ndalë me një marrëveshje mes Serbisë dhe Malit të Zi nga nëntori 1913. Sipas kësaj marrëveshjeje Peja, Deçani dhe Gjakova (qytete në Kosovë) u takonit Malit të Zi. N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 257 e përshkruan këtë marrëveshje si vijon: „Marrëveshja përbante deri diku një paradoks, sepse Serbia tërë kohën okupimin e Kosovës përballë vendeve të jashtme përpqej ta arsyetonte me „të drejtën historike” të saj mbi Patrikanën e Pejës. Pikërisht këtë Patrikanë të Pejës ia dorëzoi tani një shteti të huaj, dhe atë Malit të Zi.”

⁷⁵ Krah. J. Reuter: Die Kosovo-Albaner im ehemaligen Jugoslawien [Shqiptarët e Kosovës në ish-Jugosllavi], në: Georg Brunner, Hans Lamberg (ed.): Volksgruppen in Ostmittel- und Südosteuropa [Grupet etnike në Evropën e Mesme Lindore dhe Juglindore], Baden-Baden 1994, f. 187-194. Më 26 mars 1913 të deleguarit e qeverisë së përkohshme shqiptare erdhën në Ministrinë e Jashtme Britanike, për t'i shprehur pikëpamjet e tyre rreth përcaktimit të kufijve. Ata ankoheshin se çështja shqiptare ishte rregulluar pa marrjen në konsideratë të shqiptarëve dhe që kufijtë ishin përcaktuar vetëm për të shmangur një thyerje mes Austro-Hungarisë dhe Ruisë. Të deleguarit e përfunduan me atë që nuk dëshironin drejtësi të plotë apo favorizime, por luteshin vetëm për „pak drejtësi” për të shmangur katastrofën të mëtejme për Shqipërinë. Krah. R. R. Kritt: Die Londoner Botschafterkonferenz 1912 – 1913,

oficerët e gjashtë Fuqive të Mëdha (tetor 1913 – korrik 1914), për të shënuar pikat kufitare. Mirëpo, komisioni nuk përparonte me punën e vet dhe e ndërpreu atë për shkak të shpërthimit të Luftës së Parë Botërore⁷⁶, pa i përcaktuar saktësisht kufijtë.⁷⁷ Kështu shënimi i kufijve në territorin e Kosovës mbeti fushë e „patrajtuar” nga Komisioni Ndërkombëtar. Kur më 11 gusht 1913 u takua për herë të fundit Konferenca e Ambasadorëve në Londër, mbi 40% e shqiptarëve jetonin në territoret e banuara në mënyrë kompakte që kufizoheshin me „shtetin amë” jashtë kufijve të shtetit të ri kombëtar shqiptar⁷⁸.

V. Shënimi i kufijve në Ballkan në territoret e banuara me shqiptarë

Sqarimet e mëposhtme rreth ndryshimeve të kufijve në Ballkan në fund të shek. XIX dhe në dhjetëvjeçarët e parë të shek. XX si dhe rreth madhësive numerike të territoreve të përcaktuara përqendrohen në ndryshimet e kufijve përkundruall Serbisë, e cila është aktor kryesor në konfliktin e Kosovës.⁷⁹

Dissertation an der Universität Wien [Konferenca e Ambasadorëve në Londër 1912 – 1913, disertacion pranë Universitetit të Vjenës], Vjenë 1960, f. 205 v.

Xhon Hoxhson [sic, John Hodgson]: Kolosi i brishtë, në: Kosova, Revistë historike politike, Prishtinë 5/1997, f. 47, në recensionin e tij të librit të Marie-Françoise Allain dhe Xavier Galmiche: La Question du Kosovo, Paris 1994, tërhiqte një „analogji” lidhur me vizitën e të deleguarit kosovar Isa Boletini më 1913 gjatë Konferencës së Ambasadorëve në Londër dhe të vizitës së presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova, gjatë Konferencës së Londrës për Jugosllavinë në gusht 1992.

⁷⁶ Gjatë Luftës së Parë Botërore Shqipëria u okupua nga trupat serbe, greke, italiane, austro-hungareze dhe franceze. Në qershor 1917 Italia proklamoi „Unitetin dhe pavarësinë e tërë Shqipërisë nën egjiden dhe mbrojtjen e Mbretërisë së Italisë” Krah. S. Skendi (ed.): Albania, Nju Jork 1956, f. 12.

⁷⁷ Krah. Th. Murzaku: Politika Ballkanike e Rusisë dhe çështja shqiptare, Tiranë 1999, f. 66.

⁷⁸ Udhëheqësit shqiptarë në janar 1920 thirrën Kongresin e Lushnjës (Shqipëri), i cili ia drejtoi një notë proteste Konferencës së Paqes në Paris dhe kërkoi pavarësinë e Shqipërisë „në kufijtë e saj etnik dhe natyror”. Çështja e kufijve shqiptarë u vendos tek përmes Konferencës së Ambasadorëve të fuqive fituese në nëntor 1921. Konferenca njohu pavarësinë e Shqipërisë dhe vërtetoi kufijtë kryesisht ashtu siç ishin përcaktuar në Konferencën e Ambasadorëve në Londër. Përcaktimi përfundimtar pasoi megjithatë tek më 1926 në Paris. Krah. Ramadan Marmullaku: Albania and the Albanians, Londër 1975, f. 34.

Profesori universitar kosovar i letërsisë Rexhep Qosja e shikon fatin e shqiptarëve në kohën e Konferencës së Ambasadorëve në Londër si vijon: „Argumentet e paraqitura në Memorandumin e shqiptarëve ishin të drejta dhe nuk mund të mohoheshin, por kishin një të metë të madhe, që i dobësonte shumë: ishin argumente të një populli jetim, që s’bënte pjesë në familjet e mëdha të popujve gjermanë, latinë a sllavë, të një populli, pas të cilit nuk qëndronte vendosmorisht asnjë Fuqi e Madhe.” Rexhep Qosja: Çështja shqiptare, Historia dhe politika, Tiranë 1998, f. 101.

⁷⁹ Sa i përket Malit të Zi dhe Greqisë del kjo pamje: Para luftës ruso-turke, serbo-turke dhe malazezo-turke në vitet 1876 – 1878 Mali i Zi shtrihej në një sipërfaqe prej 4.700 km². Pas luftës dhe pas Kongresit të Berlinit Malit të Zi iu shtuan edhe 4.400 km² territor. Pas luftërave ballkanike dhe pas Konferencës së Ambasadorëve në Londër Mali i Zi shtrihej në një

Para luftës ruso-turke dhe serbo-turke në vitet 1876 – 1878, Serbia shtrihej në një hapësirë prej rreth 37.700 km² gjithsej, kurse pas luftës dhe Kongresit të Berlinit prej rreth 48.300 km². Në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës Kosova, që ngërthente afro 11.000 km², dhe Maqedonia me 25.713 km², ranë nën sundimin e Serbisë. Veç në bazë të vendimeve të kësaj konference, Serbisë i takuan mbi 36.000 km² territor të ri shtetëror. Pas luftërave ballkanike dhe Konferencës së Ambasadorëve në Londër, Serbia përfshinte mbi 80.000 km²; pas Luftës së Parë Botërore edhe Vojvodina me 21.000 km² iu dha Serbisë.

Këta numra e bëjnë të qartë se historia serbe e 150 vjetëve të fundit — siç planifikohet nga „Načertanija” — ishte histori e zgjerimit të territorit shtetëror, e cila, siç tregojnë ngjarjet e dhjetëvjeçarit të fundit, vazhdoi edhe në të tashmen më të re.⁸⁰ Politika serbomadhe e vendoste bashkësinë ndërkombëtare kryesisht para fakteve të kryera, ndaj të cilave kjo reagonte fillimisht përmes një modeli sjelljeje të tolerimit dhe pastaj me njohjen e zgjerimit të territoreve.⁸¹

sipërfaqe prej gjithsej 13.812 km². Para Kongresit të Berlinit Greqia ishte e madhe gjithsej 51.860 km². Me zmadhimin e territorit shtetëror pas Kongresit të Berlinit dhe sidomos pas Konferencës së Ambasadorëve në Londër territori shtetëror i Greqisë përfshinte 130.938 km². Në lidhje me Greqinë shumica e territoreve të reja ishin të banuara me grekë, por shumë prej territoreve të sotme në veri të Greqisë, si për shembull krahina e Çamërisë, Konicë, Preveza, Arta, Janina etj., ishin të banuara me shqiptarë dhe banohen edhe deri më sot nga një pakicë e papranuar shqiptare. Për dallim nga Greqia, gati të gjitha territoret që në vitet e fundit të shek. 19 dhe në vitet e para të shek. 20 i fituan Serbia dhe Mali i Zi, ishin të banuara kryesisht me shqiptarë. Krah. për këtë R. Qosja: Çështja shqiptare, Historia dhe politika, Tiranë 1998, f. 110 vv.

⁸⁰ Krah. për shembull politikën e përfaqësuar hapur nga kryeministri serb Nikola Pašić në kohën e luftërave ballkanike më 1913. Pashiq u përgjigj kështu në pyetjen se çfarë do të duhej të ndodhte me miliona shqiptarë: „Do t’i serbizojmë dhe në qoftë se nuk lënë që të serbizohen, ne do t’i dëbojmë, dhe në qoftë se nuk lënë që të dëbohen, ne do t’i vrasim.” Cituar sipas Michael W. Weithmann: Balkan Chronik: 2000 Jahre zwischen Orient und Okzident [Kronika e Ballkanit: 2000 vjet mes Lindjes dhe Perëndimit], Grac etj. 1995, f. 323. Kjo politikë ndiqet me intensitet dhe kontinuitet të ndryshëm deri më sot nga regjimet e Beogradit në lidhje me Kosovën. Lufta e fundit në Kosovë në prag të shek. 21 është po ashtu një shembull për këtë.

⁸¹ Për shembull më 1990 – 1992 në lidhje me dezintegrimin e Bosnjës dhe Hercegovinës u shënua: „[...] sa më e ulët të jetë përqindja e popullatës serbe në territoret e pretenduara, aq më fort vija hegemoniale mban serbomadhia.” Janine M. Calic: Der Krieg in Bosnien und Herzegovina. Ursachen Konfliktstrukturen Internationale Lösungsversuche [Lufta në Bosnjë dhe Hercegovinë. Shkaqet, strukturat e konfliktit, përpjekjet ndërkombëtare për zgjidhje], Frankfurt mbi Main 1995, f. 72. Edhe raportuesi i posaçëm i Komisionit për të drejtat e njeriut i OKB-së për Jugosllavinë, Tadeusz Mazowiecki vjen në përfundim se „[...] spastrimet etnike nuk janë pasojë e kësaj lufte, por [...] caku i kësaj lufte”. Krah. intervistën me të ngarkuarin e OKB-së T. Mazowiecki: Nicht die gesamte serbische Nation beschuldigen [Të mos fajësohet i tërë kombi serb], në: Süddeutsche Zeitung, 19 dhjetor 1992. Kah fundi i luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë kjo politikë arriti pastaj një njohje të caktuar.

C. Kosova në kohën ndërmjet luftërave dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore⁸²

I. Kosova nën sundimin e Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve

E themeluar më 1 dhjetor 1918, Mbretëria unitariste e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve (më tutje: shteti i SKS-së), i bashkoi afro 20 grupime etnike si dhe hapësira kulturore të ndara me shekuj, por shqiptarët nuk i njohu si pakicë. Në shtetin e SKS-së sipas numërimit të popullsisë të vitit 1921 jetonin 439.657 „shqipfolës”, siç i quante emërtimi zyrtar, prej të cilëve vetëm në Kosovë 288.900.⁸³ Njohësi i Ballkanit Johann G. REISSMÜLLER e përshkruante kështu gjendjen e shqiptarëve në shtetin e SKS-së: „Jugosllavia e parë mbretërore ishte një shtet serbomadh që i shtypte kombet e tjera; në rastin e grupit etnik shqiptar në jug, kjo shkonte deri te përndjekja gjenocidale”.⁸⁴

Territoret e banuara me shqiptarë, përkatësisht rajoni i Kosovës në shtetin e SKS-së ndahej sipas „Ligjit mbi Ndarjen e Qarqeve Administrative (banovina)” të vitit 1921 në katër qarqe dhe sipas Ligjit të 3 tetorit 1929 „Për ndarjen e banovinave”, e së fundi sipas Ligjit të 7 tetorit 1929 „Për Administrimin e banovinave” në tri njësi të ndryshme administrative (banovina), Morava, Zeta dhe Vardari. Caku i kësaj politike paraqiste qartazi copëtimin e mëtejshëm të territoreve shqiptare dhe qëndronte në kundërshtim me kërkesën për autonominë e Kosovës, të paraqitur së pari nga fundi i shek. XIX por edhe më vonë në kuadër të Konferencës së Paqes së Parisit më 1919. Gjatë kësaj konference, delegacioni italian në kuadër të Komisionit për Mbrojtjen e Pakicave u angazhua për etablimin e dy territoreve autonome:⁸⁵ një autonomie territoriale politike në Maqedoni dhe një autonomie lokale në Kosovë. Megjithatë, gjatë kësaj kohe, programet serbe për një ndryshim të strukturës etnike të territoreve shqiptare në shtetin e SKS-së u bënë gjithnjë e më të detajuara dhe më sistematike.⁸⁶

⁸² Krah. rreth situatës në Kosovë në kohën mes luftërave sidomos N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 264-289.

⁸³ Krah. N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 268.

⁸⁴ J. G. Reissmüller: Der Krieg vor unserer Haustür: Hintergründe der kroatischen Tragödie [Lufta para derës së shtëpisë sonë: Prapavijat e tragjedisë kroate], Stuttgart 1992, f. 11.

⁸⁵ Propozimi italian dështoi me iniciativën e delegacionit serb të mbështetur nga francezët.

⁸⁶ Në lidhje me dëbimin e organizuar të shqiptarëve dhe me kolonizimin e territoreve të tyre me kolonistë sllavë (kryesisht serbë dhe malazezë) mes tjerash në fazën e kohës mes luftërave, krah. sidomos Jusuf Osmani: Kolonizimi serb i Kosovës, Prishtinë 2000; N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 264 vv; Hugh Poulton: The Balkans. Minorities and States in Conflict, Londër 1993, f. 57-75. Rreth programeve antishqiptare të intelektualëve serbë në periudhën 1937 – 1944 shiko Rexhep Qosja: The Albanian National Question in the Serb Political Programs during 1937 – 1944, në: The International Journal of Albanian Studies, New York 1/1 1997.

Sipas Marrëveshjes Paqësore të Shën Zhermenit më 1919, shteti i SKS-së⁸⁷ ishte i detyruar që „t'i mbronte interesat e të gjithë atyre banorëve që dallohen nga popullsia shumicë prej racës, gjuhës a fesë” (neni 51). Megjithatë, pasi qeveria e shtetit të SKS-së e mohonte ekzistimin e një pakice shqiptare, ajo mori qëndrimin se këto rregulla për mbrojtjen e pakicave vlenin vetëm për territoret e perandorisë që ishin shtuar në veri, ndërkohë që territoret e pushtuara nga Serbia qysh më 1913, përfshirë Kosovën, nuk prekeshin prej tyre.⁸⁸ Në këtë kontekst duhet përmendur stereotipi se autoritetet e Shtetit të Sllavëve të Jugut i shihnin shqiptarët në Kosovë si „më pak të besueshëm se gjermanët dhe hungarezët”⁸⁹ në veri të vendit.

II. Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore

Pas kapitullimit të Jugosllavisë⁹⁰ më 17 prill 1941 Kosova u nda në tri zona okupimi⁹¹, me ç'rast më 12 gusht 1941 zona italiane u bashkua „nga mëshira e Musolinit”⁹² me Shqipërinë e okupuar prej italianëve. Kjo „Shqipëri e Madhe” e krijuar nga fashistët italianë dhe e mbajtur në jetë nga viti 1943 prej forcave okupuese nacional-socialiste gjermane, përmendet edhe sot e kësaj dite nga propaganda serbe, sa herë është fjala për ta penguar njohjen ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.⁹³

⁸⁷ Në nenin 16 të Kushtetutës së 1921-ës të shtetit të SKS-ës pakicave të njohura u garantohej mësimi në gjuhën amtare në shkollat fillore. Në kushtetutën e 1931-ës kjo dispozitë për mbrojtjen e pakicave nuk gjindet më.

⁸⁸ Përderisa në shtetin e SKS-ës mbrojtje të pakicave gëzonin pakicat gjermane, hungareze, rumune, çeke, ruse dhe italiane që për nga numri ishin shumë më të vogla se grupi etnik shqiptar, shqiptarëve u mohoheshin të drejta themelore. Kështu p.sh. çdo kontakt me Shqipërinë, sikurse edhe importimi i librave, dënoheshin rreptë. Krahi, Ali Hadri: Narodno-oslobodački pokret na Kosovu 1941 – 1945 [Lëvizja nacionalçlirimtare në Kosovë 1941 – 1945], Beograd 1973, f. 27.

⁸⁹ A. Hadri: po aty, f. 20.

⁹⁰ Shteti i SKS-ës i themeluar më 1918, u transformua në një diktaturë ushtarake jugosllave përmes një grusht shteti të mbretit Aleksandar, ashtu që vendi u nda në nëntë njësi administrative („banovina”) duke mos marrë parasysh njësitë historike dhe etnografike. Shfuqizimi i diktaturës më 1931, e cila kishte të bënte me grindjet mes serbëve dhe kroatëve për epërsi, nuk çoi deri te një përmirësim i gjendjes së shqiptarëve.

⁹¹ Në veri Gjermania, në jugperëndim Italia dhe në një pjesë në lindje të Kosovës Bullgaria.

⁹² Christine von Kohl, Wolfgang Libal: Kosovo: gordischer Knoten des Balkans [Kosova: nyja gordiane e Ballkanit], Vjenë, Cyrih 1992, f. 46.

⁹³ Rreth çështjes së pavarësisë së Kosovës dhe me strategjinë e propagandës së ndjekur „automatiksht” nga pala serbe të një „Shqipërie të Madhe”, presidenti i Kroacisë Stjepan Mesić, i cili pas Luftës së Dytë Botërore ishte edhe presidenti i fundit të Jugosllavisë u shpreh si vijon: „[...] Beogradi duhet po ashtu ta pranojë, që republikat dhe krahinat jugosllave që më 1974 si elemente kushtetuese të federatës morën të drejtën për shkëputje, këtë e kanë edhe më tej, edhe në qoftë se Serbia ndërkohë ka një kushtetutë të re. [...] Pse e vizatojmë gjithmonë në mure fantazmën e një Shqipërie të Madhe? Pse të mos ketë dy shtete shqiptare? Ekzistojnë

Gjatë këshillimit të dytë të AVNOJ-it⁹⁴ më 29 nëntor 1943 u përcaktuan në „vija të vrazhda” vijat themelore të strukturës shtetërore të Jugosllavisë pas Luftës së Dytë Botërore. Duhej krijuar një sistem federal i përbërë prej gjashtë republikave. Mirëpo, meqë as komunistët e as nacionalistët nuk kishin ftuar përfaqësues të Kosovës për këshillim, ardhmëria e Kosovës në atë kohë ishte e pasigurt.

Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, Eduard KARDEL, njëri prej këshilltarëve më të afërt të presidentit jugosllav më vonë të emëruar për periudhë të përjetshme, Josip Broz TITO, konstatoi në shkurt 1945: „Zgjidhja më e mirë, tha ai në një mbledhje të Komitetit Qendror, do të ishte që Kosova të bashkohet me Shqipërinë, por meqë as faktorët e huaj, as faktori i brendshëm nuk e përkrahin këtë, ajo duhet të mbetet një krahinë kompakte në kuadër të Serbisë.”⁹⁵

Konferenca e Bujanit⁹⁶ (e emërtuar sipas vendit të mbajtjes) u mbajt nga 31 dhjetori 1943 deri më 2 janar 1944. Me atë rast u themelua Këshilli i Parë Çlirimtar për Kosovën (në lindje) dhe për Rrafshin e Dukagjinit (në perëndim, serbisht e quajtur Metohija⁹⁷) dhe u miratua njëzëri Rezoluta e Bujanit⁹⁸. Konferenca e Bujanit⁹⁹ mund të krahasohet me një kuvend popullor pluralist, duke siguruar

edhe Gjermania dhe Austria pranë njëra-tjetrës – pse jo edhe Kosova dhe Shqipëria”, intervistë me S. Mesić, në: Der Spiegel, Nr. 6/5 shkurt 2001, f. 166.

⁹⁴ Emërtimi i përhapur serb për Këshillin Antifashist për Çlirimin Popullor të Jugosllavisë, Jajce – Bosnjë dhe Hercegovinë 28-30 nëntor 1943.

⁹⁵ Cit. sipas N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 315.

⁹⁶ Konferenca e Bujanit duhet të shikohet në frymën e zhvillimeve të atëhershme ndërkombëtare. Ajo u mbajt dy vjet dhe katër muaj pas Deklaratës së Kartës së Atlantikut (14 gusht 1941), një muaj pas bisedimeve të ministrave të jashtëm aleatë në Moskë (19 – 30 tetor 1943) dhe tri javë pas Konferencës së Teheranit (1 dhjetor 1943). Viti 1944 u shpallë në Londër si vit i çlirimit të popujve me rëndësi të papërsëritshme për historinë. Krah. The New York Times, 31 dhjetor 1943, f. 4. Citat sipas Sami Repishti: Një qasje për Rezolutën e Bujanit, në: Fehmi Rexhepi etj. (ed.): Konferenca e Bujanit, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë 1998, f. 154.

⁹⁷ Termi Metohija, nga greqishtja metochi = pronë kishtare, përdoret nga Serbia për Kosovën Perëndimore dhe është për këtë arsye politikisht i motivuar, gjë që kosovarët e interpretojnë si përpjekje që Kosova si njësi juridike e krijuar gjatë historisë të ndahet në dy territore. Emërtimi „Kosova dhe Metohija” ose „Kosmet” i përgjigjet përdorimit gjuhësor zyrtar në serbishte deri më 1970 dhe filloi të përdoret përsëri kah fundi i viteve të 1980-ta.

⁹⁸ Në konferencë morën pjesë 40 të deleguar me këtë strukturë etnike dhe politike: 43 shqiptarë (84%), 7 serbë dhe malazezë (14%), 1 mysliman (2%). Kjo i përgjigjet pak a shumë përbërjet etnike të popullatës së Kosovës në atë kohë. Në mesin e të deleguarve ishin 31 komunistë (61%) dhe 20 antifashistë me bindje nacionaliste, d.m.th. nacionalistë, (39%). Edhe një përfaqësues i Anglisë, majori Baly, mori pjesë si vëzhgues.

⁹⁹ Në pyetjen, pse u themelua Këshilli i Parë Çlirimtar për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit, Sadik Bekteshi, një pjesëmarrës në konferencë dhe nënshkruer i Rezolutës së Bujanit u përgjigj kështu: „Në mbledhjen e AVNOJ-it partia e komunistëve jugosllavë e hodhi maskën dhe u shpreh haptas për një Jugosllavi federale, ku pas përfundimit të luftës të gjitha kombet e Jugosllavisë do të mbeteshin në federatë. Sipas vendimeve të AVNOJ-it, shqiptarët autoktonë do të duhej të mbeteshin në territoret e tyre në Jugosllavinë e dikurshme [Jugosllavinë para Luftës së Dytë Botërore] përsëri nën sundimin serbo-sllav. Në këtë situatë populli i Kosovës duhej të merrte pjesë pa shtyrje në këtë luftë, me qëllim që pas përfundimit të saj të ullej në

përfaqësimit e të gjitha grupeve etnike të Kosovës¹⁰⁰. Caku i Konferencës së Bujanit ishte që Rrafshin e Kosovës dhe Rrafshin e Dukagjinit¹⁰¹ t'i organizonte si njësi politike, juridike dhe ushtarake me institucione vetjake shtetërore, ashtu që kjo në fund të Luftës së Dytë Botërore në frymën e deklaratës së *Kartës së Atlantikut* (14 gusht 1941) dhe vendimeve dhe deklaratave të tjera të aleatëve të vlente si njësi e pavarur dhe kështu të mund të ushtronte të drejtën e brendshme dhe të jashtme të vetëvendosjes. Prandaj Konferenca e Bujanit e ngrinte Rrafshin e Kosovës dhe të Dukagjinit në të njëjtin nivel me njësitë e tjera territoriale jugosllave. Mirëpo, kjo qëndronte në kundërshtim me synimet dhe me politikën e komunistëve serbo-jugosllavë, përkatësisht me politikën serbomadhe.

N. MALCOLM mendon se te Konferenca e Bujanit bëhet fjalë pak a shumë për një lojë taktike nga ana e komunistëve jugosllavë, me të cilën donin t'i përfitonin shqiptarët e Kosovës dhe të territoreve të tjera, komunistët dhe nacionalistët e Jugosllavisë së vjetër.¹⁰² Hulumtuesi i historisë Sami REPISHTI e vlerëson Konferencën e Bujanit si një përgjigje të kosovarëve ndaj qëndrimeve oportuniste të komunistëve jugosllavë dhe të komunistëve shqiptarë nga Shqipëria në lidhje me Kosovën.¹⁰³

Rezoluta e Bujanit përcakton:

„[...] do të kenë mundësi me vetëvendosë mbi fatin e tyre, me të drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputje. Garanci për këtë është Ushtria Nacionalçlirimtare e Jugosllavisë dhe Ushtria Nacionalçlirimtare e Shqipërisë [...] dhe për këtë garantojnë aleatët tanë të mëdhenj, Bashkimi Sovjetik, Anglia dhe Amerika.”¹⁰⁴

Me ndërhyrjen e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë (letra e 28 marsit 1944) udhëheqësia e lëvizjes rezistuese në Kosovë u detyrua t'i fshinte

tryezën e paqes si fitues e jo si humbës”. Intervistë, në: Dardania, Tiranë, 2 janar 1993, f. 5, cit. sipas S. Repishti, Një qasje për Rezolutën e Bujanit, në: F. Rexhepi etj. (ed.): Konferenca e Bujanit, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë 1998, f. 161.

¹⁰⁰ Krah. Jusuf Bajraktari: Larpamësia e vendimeve të Konferencës së Bujanit, në: F. Rexhepi etj. (ed.): Konferenca e Bujanit, Instituti i Historisë, Prishtinë, 1998, f. 112 v si dhe shkrime të tjera të kësaj përmbledhjeje, ku është botuar edhe Rezoluta e Bujanit me tekst të plotë. Krah. edhe N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 307 v dhe referencat bibliografike të shënuara prej tij.

¹⁰¹ „Kosova dhe Dukagjini” ishte emërtimi i atëhershëm zyrtar për Kosovën e sotme.

¹⁰² Krah. N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 307 v.

¹⁰³ S. Repishti, në: Një qasje për Rezolutën e Bujanit, në: F. Rexhepi etj. (ed.): Konferenca e Bujanit, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë 1998, f. 163.

¹⁰⁴ Rezoluta e Bujanit është e botuar në anglisht te Kristaq Prifti, Marenglen Verli: The Thruth on Kosova, Tiranë 1993, f. 216 vv. ose në shqip te Hakif Bajrami: Kosova – Prej Bujanit në Kaçanik, Prishtinë 1997.

pasazhet rreth bashkimit të Kosovës me Shqipërinë¹⁰⁵, me ç'rast, megjithatë, nuk u prek e drejta e brendshme për vetëvendosje.

Edhe në konfliktin aktual midis Serbisë dhe Kosovës janë të rëndësishme rezultatet e Konferencës së Bujanit. Kështu, parlamenti federativ jugosllav më 13 dhjetor 1988 e shpalli Rezolutën e Bujanit si një „akt të pavlefshëm”.¹⁰⁶ Qeveria e përkohshme e Republikës së Kosovës, nga ana e saj, i referohej Rezolutës së Bujanit më 21 dhjetor 1991 në kërkesën drejtuar kryesuesit të Konferencës për Jugosllavinë dhe ministrave të jashtëm të shteteve anëtare të Komunitetit Evropian (shiko shtojcën) për ta njohur Kosovën si shtet sovran dhe të pavarur.

D. Kosova pas Luftës së Dytë Botërore

I. Mbetja e detyruar e Kosovës në Serbinë, përkatësisht Jugosllavinë komuniste

Pas tërheqjes së ushtrisë gjermane nga Kosova në vjeshtë 1944, pushtetin së pari e mori përsipër *Balli Kombëtar*, i cili për shkak të të drejtës për vetëvendosje të kosovarëve ishte në konflikt me komunistët jugosllavë. Rezistenca, para së gjithash në fshatrat e Kosovës qendrore, kundër pushtetit komunist që po etablohej, i shqetësonte komunistët jugosllavë, prandaj J. B. TITO më 8 shkurt 1945 dha urdhrin për ngritjen e një administrate ushtarake në Kosovë, e cila përfundimisht çoi deri te një „integrim” i dhunshëm i Kosovës në Jugosllavinë e sapoformuar.

Sot e kësaj dite mbetet e diskutueshme mes juristëve shqiptarë të Kosovës dhe juristëve serbë, nëse Kosova që para miratimit të Kushtetutës Federative (më tutje: KF)¹⁰⁷ ishte ose jo territor i aneksuar nga Serbia dhe kështu njësi jo drejtpërsëdrejti pjesëmarrëse në nivelin federativ. Por as njëri e as tjetri interpretim nuk mund ta vënë objektivisht në pikëpyetje faktin se ky lloj i „bashkimit vullnetar” sipas modelit stalinist ishte kryer pa respektuar parimin demokratik dhe vullnetin e popullatës përkatëse.

Në përpjekje për ta legjitimuar okupimin e sërishëm të Kosovës në „Konferencën e Prizrenit” të thirrur enkas për këtë më 10 qershor 1945, „u vendos bashkimi me

¹⁰⁵ Krah. R. Marmullaku: *Albania and the Albanians*, Londër 1975, f. 44.

¹⁰⁶ Krah. Rilindja, 14 dhjetor 1988, f. 5: Konkludimi i Dhomës Federative lidhur me Rezolutën e Bujanit.

¹⁰⁷ Kushtetuta e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë nga 31 janari 1946 mbështetej fort në kushtetutën sovjetike të vitit 1936, gjë që çoi faktikisht te një lloj shteti i decentralizuar. Krah. për këtë Franz Mayer etj.: *Staat-Verfassung-Recht-Verwaltung* [Shteti-kushtetuta-e drejta-administrata], në: Klaus D. Grothusen (ed.): *Südosteuropa Handbuch. Jugoslawien*, Bd. 1. [Doracaku i Evropës Juglindore. Jugosllavia, vëll. 1], Göttingen 1975, f. 34-149.

Serbinë” i Kosovës. Megjithatë, një rezolutë e arritur nën administrimin ushtarak nuk paraqet vendim demokratik, ku „popullsia e krahinës së Kosovës njëzëri shpreh dëshirën për një bashkim me Serbinë në rrafshin federal”.¹⁰⁸

Kjo e ashtuquajtur „*zgjidhje shqiptarovogël*”¹⁰⁹ mori „karakterin zyrtar” në janar 1945, kur qeveritë komuniste jugosllave dhe shqiptare lidhën një marrëveshje për reintegrimin e Kosovës në federatën jugosllave.¹¹⁰ Kësisoj shqiptarët, në këtë rast shqiptarët e Kosovës, u detyruan të mbeteshin në Jugosllavi, vendin e sllavëve të jugut, prej të cilit qenë përjashtuar si *shqiptarë* tashmë *per definitionem* dhe nuk iu dha kurrfarë rasti që ta shfrytëzonin të drejtën e tyre për vetëvendosje.

Publicisti Carl G. STRÖHM konstaton me të drejtë se shqiptarë të shumtë të Kosovës e shikonin sundimin jugosllav komunist si rivendosje të hegjemonisë serbe.¹¹¹ Para së gjithash koha nga 1944 deri më 1966 karakterizohej nga një politikë shtetërore e organizuar e terrorit dhe e represioneve, si dhe nga ushtrimi i dhunës sistematike e dëbimi i shqiptarëve — që „*de-facto* ishin shtetas të rendit të 2-të”¹¹² — për në Turqi¹¹³, të cilat u realizuan përmes ministrit të atëhershëm të brendshëm serb Aleksandar RANKOVIĆ¹¹⁴.

¹⁰⁸ Siç thuhet në Rezolutën e Konferencës së Prizrenit më 1945, sikur kjo të kishte qenë vullneti i popullatës së Kosovës. Literatura këtë e përshkruan si vijon: „[...] »Këshilli Popullor Rajonal«, i cili përfaqësonte 2250 anëtarët e Partisë Komuniste në Kosovë, [...] vendosi pa debat dhe pa votim përfshirjen e Kosovës në Serbi. Vendimi [me këtë mendohet Rezoluta] erdhi nën presionin e 50.000 ushtarëve që Tito në atë kohë i kishte stacionuar në Kosovë. Mbi bazën e këtij vendimi Kuvendi Kombëtar i Serbisë miratoi më 3 shtator një ligj, i cili Rajonin Autonom të Kosovës-Metohisë e shpalli si pjesë të Serbisë.” Fabian Schmidt: Im Griff der Großmächte. Das Kosovo in der wechselvollen Geschichte des Balkans [Në kthetrat e Fuqive të Mëdha. Kosova në historinë e Ballkanit plot tallaze], në: Thomas Schmidt: Krieg im Kosovo [Lufta në Kosovë], Hamburg 1999, f. 96.

¹⁰⁹ J. Reuter: Die Albaner in Jugoslawien [Shqiptarët në Jugosllavi], Munihi 1982, f. 38.

¹¹⁰ Krah. Nicholas C. Pano: The People’s Republic of Albania, Baltimore 1968, f. 63.

¹¹¹ Krah. Carl Gustav Ströhm: Ohne Tito. Kann Jugoslawien überleben? [Pa Titon. A mund të mbijetojë Jugosllavia], Graz etj. 1976, f. 226.

¹¹² Peter Bartl: Die Albaner [Shqiptarët], në: Michael W. Weithmann (ed.): Der Ruhelose Balkan. Die Konfliktregionen Südosteuropas [Ballkani i paqetë. Rajonet e konfliktit të Evropës Juglindore], Munihi 1993, f. 199.

¹¹³ P. Bartl e jep numrin e shqiptarëve, të cilët në këtë kohë, afro 1945 – 1966, e lëshuan Jugosllavinë, me më shumë se 200.000, po aty. N. Malcolm, në: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 323 vjen deri te përfundimi, se: „Për Kosovën nuk ka shënime të hollësishme, ndonëse numri i përgjithshëm prej 100.000 të shpërngulur nga Kosova gjatë tërë kësaj periudhe, ndoshta nuk është një supozim i paarsyeshëm”.

¹¹⁴ A. Ranković u shkarkua në korrik 1966 përmes „Plenumit të Brionit” (Mbledhja e 4-të e Komitetit Qendror të Lidhjes së Partisë Komuniste), sepse, sipas arsytimit zyrtar, me policinë sekrete që i nënshtrohej atij iu ishte shmangur kontrollit të partisë. Sipas pohimeve jozyrtare duhej të largohej, sepse ishte bërë e ditur se paskësh spiunuar edhe shefin e partisë J. B. Tito dhe paska mbajtur dosje të fshehta. Me këtë nisi edhe për disa koha një proces i rimendimit brenda partisë komuniste në lidhje me shqiptarët në RSFJ.

II. Nga statusi i një territori autonom deri te ai i një kuazi-republike në kushtetutën e vitit 1974

I. Kosova si territor autonom

Sikur në „të gjitha” vendet e dikurshme komuniste, edhe në Jugosllavi, duke u bazuar në teorinë dhe praktikën e ideologjive komuniste lidhur me zgjidhjen e çështjeve kombëtare, e drejta për *komb* vetjak iu dha vetëm atyre etniteteve që nuk kishin një „shtet të vetin” jashtë Jugosllavisë. Prandaj në Jugosllavi pas Luftës së Dytë Botërore u njohën si kombe „të reja”, ai i maqedonasve dhe i boshnjakëve, ndërsa shqiptarët praktikisht u klasifikuan si joekzistues, ngaqë në Shqipëri e kishin një „shtet të tyrin”. Me kalimin e kohës kjo megjithatë çoi faktikisht te krijimi i një *„kombi kosovar”*, megjithëse shumica e kosovarëve menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore identifikoheshin shumë fort me shqiptarët në Shqipëri.

Ndërsa Vojvodina pas Luftës së Dytë Botërore mori statusin e një krahine autonome në kuadër të Republikës së Serbisë, Kosovës iu dha vetëm statusi më i ulët i një territori autonom.¹¹⁵ Me këtë, pozita juridike e Kosovës në shtetin jugosllav, thënë në mënyrë paksë të ekzagjeruar, nuk ishte më e lartë se ajo e një „qarku administrativ serb me disa zbulime të pavarësisë”.¹¹⁶ Vetëm me KF të 1963-shit¹¹⁷ Kosova mori statusin e një krahine autonome¹¹⁸ dhe u barazua kështu me Vojvodinën. Në vitin 1967 filloi, së pari në Partinë Komuniste të Jugosllavisë (më tutje: PKJ) dhe në vijim edhe në një opinion më të gjerë, një diskutim rreth përmirësimit të statusit të autonomisë së Kosovës, i cili do të duhej të realizohej në kuadër të një rishikimi të kushtetutës.

Me ndryshimet e KF-së më 1968, 1969 dhe 1971¹¹⁹ krahinat autonome të Kosovës dhe të Vojvodinës u bënë, sikurse republikat e tjera, pjesë përbërëse dualiste-konstitutive të federatës dhe të Republikës së Serbisë. Procesi i ngritjes së pozitës ligjore të Kosovës në rrafshin federativ arriti kulmin me miratimin e një kushtetute të re federative më 1974, me të cilën statusi i Kosovës u ngrit deri në

¹¹⁵ Pas kësaj në Jugosllavi sipas shëmbëlltyrës sovjetike dalloheshin dy tipe të autonomisë.

¹¹⁶ Johann G. Reißmüller: Jugoslawien [Jugosllavia], Köln 1971, f. 93.

¹¹⁷ Službeni list SFRJ [Fletorja zyrtare e RSFJ-së], Nr. 14/ 1963. Përkthimi në gjermanisht të Ivo Krbek: Die Verfassung der Sozialistischen Föderativen Republik Jugoslawien vom 7.4.1963 [Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë nga 7.4.1963], në: Jahrbuch des öffentlichen Rechts [Vjetari i të Drejtës Publike] 13/1964, f. 243-324. Me këtë kushtetutë Republika Popullore Federative e Jugosllavisë u riemërtua në Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë (RSFJ).

¹¹⁸ Neni 111 KF nga viti 1963, me ç’rast edhe më tej midis republikave dhe krahinave autonome ekzistonte një raport i qartë i mbirenditjes dhe nënrenditjes. Kra. Monika Beckmann-Petey: Der jugoslawische Föderalismus [Federalizmi jugosllav], Muni, Vjenë 1990, f. 108.

¹¹⁹ Kra. Lothar Schulz: Die jüngste Verfassungsreform der Sozialistischen Föderativen Republik Jugoslawien [Reforma më e re kushtetuese e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë], në: Jahrbuch für Ostrecht [Vjetari për të Drejtën Lindore] 1972, f. 7-36.

kufirin e shtetësisë së saj, mirëpo jo deri në shtet¹²⁰, si dhe me kushtetutën e parë të Kosovës nga viti i njëjtë.¹²¹

2. Kushtetuta e fundit e RSFJ-së e 21 shkurtit 1974¹²²

Kushtetuta e vitit 1974 duhet parë si kompromis¹²³ në debatin kushtetues të viteve të 1960-ta rreth pozitës juridike dhe politike të Kosovës në Jugosllavi, në të cilën kosovarët angazhoheshin për një republikë të Kosovës. Ndërkaq, sipas përfytyrimeve serbe, Kosova duhet të mbetej një rajon i Serbisë. Josip Broz TITO përpiqej që ta krijonte një baraspeshë në politikën e pushtetit midis përbërësve konstitutivë të federatës, jo vetëm për ta zbutur „konfliktin e kombësive” mes centralizmit beogradas dhe njësisë të tjera të federatës¹²⁴ që po e kërcënonte ekzistencën e shtetit jugosllav. KF jugosllave e vitit 1974 prandaj e ngriti në mënyrë të ndjeshme pozitën e krahinave autonome por edhe atë të republikave brenda federatës.

¹²⁰ Krahinat Autonome mbetën të përfshira vërtet edhe më tej në strukturën e republikës sipas nenit 4 të KF-së nga viti 1974, por për herë të parë ato u bënë anëtare konstitutive të federatës sipas të drejtës shtetërore. Neni 2 i KF-së së RSFJ-së nga viti 1974 thotë: „Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë e përbëjnë: Republika Socialiste e Bosnjës dhe Hercegovinës, Republika Socialiste e Kroacisë, Republika Socialiste e Maqedonisë, Republika Socialiste e Malit të Zi, Republika Socialiste e Malit të Zi si dhe Krahina Socialiste Autonome e Kosovës dhe Krahina Socialiste Autonome e Vojvodinës në përbërje të Republikës Socialiste të Serbisë, dhe Republika Socialiste e Sllovenisë.”

¹²¹ Me Kushtetutën e vitit 1974 për herë të parë iu kthyen Kosovës kompetencat shtetërore, të cilat i kishte me statusin si vilajet i pavarur nën sundimin osman, mendon për shembull juristi Blerim Reka: Kontinuiteti politik, territorial dhe administrativ i Kosovës, në: Kosova, Revistë historike politike, Prishtinë 5/1997, f. 21. Ky krahasim sipas mendimit tim duhet të trajtohet me kujdes, sepse mes tjerash paraqet pyetjen se deri ku mund të krahasohen rrethanat në një sistem të sundimit feudal me ato të një sistemi diktatorial komunist, siç ishte në Jugosllavi në atë kohë. Megjithatë, unë e përmend këtë krahasim, sepse e qartëson „vetëkuptimin kosovar” në Jugosllavinë komuniste.

¹²² Krah. për këtë M. Beckmann-Petey: Der jugoslawische Föderalismus [Federalizmi jugosllav], Muni, Vjenë 1990. Ch. v. Kohl, W. Libal: Europa darf das Kosovo nicht vergessen [Evropa nuk guxon ta harrojë Kosovën], në: Europäische Rundschau 1992, f. 71-80; Ivan Kristan: Die Dritte Verfassungsrevision in Jugoslawien [Rishikimi i tretë i Kushtetutës në Jugosllavi], në: Die Verwaltung 1972, f. 446-72; Lothar Schulz: Die neue Verfassung der Sozialistischen Föderativen Republik vom 21. Februar 1974 [Kushtetuta e re e Republikës Socialiste Federative nga 21 shkurti 1974], në: Jahrbuch für Ostrecht 15/1974, f. 13-37; Paul Shoup: The Government and Constitutional Status of Kosovo: Some Brief Remarks, në: Arshi Pipa, Sami Repishti (ed.): Studies on Kosova, Nju Jork 1984, f. 233-38.

¹²³ J. Marko (ed.): Gordischer Knoten Kosovo/a: Durchschlagen oder entwirren? [Nyja gordiane Kosova: Të çahet apo të shthuret?], Baden-Baden 1999, f. 233 argumenton si vijon: „Forma sipas të drejtës shtetërore e autonomisë territoriale, megjithatë, pikërisht në rastin e Kosovës, mund të shikohet vetëm si „zëvendësim” për të drejtën eksterne të vetëvendosjes të shqiptarëve të Kosovës të pranuar nga komunistët jugosllavë qysh në Konferencën e Bujanit më 1944, [...]”.

¹²⁴ Si për shembull kërkesa kosovare për një „Republikë të Kosovës” të veten më 1968, „Pranvera kroate” më 1971 etj.

Si njëra prej tetë pjesëve përbërëse konstitutive të federatës, Kosova mori kompetenca të gjera legislative, judikative dhe ekzekutive. Përveç kësaj, sipas nenit 239 par. 2 të KF-së së 1974-shit edhe mbrojtja territoriale ra nën kompetencë të Kosovës, siç ishte te republikat e tjera, kurse sipas nenit 271 par. 3 të KF-së së 1974-shit edhe realizimi i pavarur i fushave të caktuara të politikës së jashtme. Pandashmëria e vendit të Kosovës u garantua, me ç'rast kufijtë e Kosovës nuk mund të ndryshoheshin pa pëlqimin e saj (nenet 2, 4 dhe 5 të KF-së së 1974-shit).¹²⁵ Kosova, sikurse edhe republikat, qëndronte në raport të drejtpërdrejtë me federatën dhe sipas nenit 206 të KF-së së vitit 1974 miratoi një kushtetutë të veten.¹²⁶ Krahu autonome e Kosovës dhe ajo e Vojvodinës ishin praktikisht të barabarta me republikat e tjera, me dallim që banorët e tyre nuk posedonin shtetësi të veten, sepse në nenin 1 të KF-së së 1974-shit, sipas mostrës së doktrinës sovjetike, emërtoheshin si „kombësi” (serbisht *narodnost*) dhe jo si „komb” (serbisht *narod*).

Sikurse republikat, edhe krahinat, sipas nenit 398 të lidhur me nenin 402 të KF-së së 1974-shit, posedonin të drejtën e vetos absolute për ndryshime të KF-së jugosllave, gjë që sipas botëkuptimit serb ishte diskriminuese¹²⁷ dhe prandaj jo më vonë sesa nga mesi i viteve të 1980-ta në opinion u instrumentalizua për „çështjen serbe”. Sipas juristit Tomislav BORIC¹²⁸ parimi i unanimitetit rrjedh nga nisma e J. B. TITOS, i cili me këtë synonte ta pengonte mbizotërimin e një republike gjatë vendimeve për çështje që lidheshin me shtetin e tërësishëm.

KF-ja e 1974-shit është edhe sot e rëndësishme, sepse si kushtetutë e fundit e shtetit të tërësishëm të Jugosllavisë në procesin e shpërbërjes së RSFJ-së paraqet „pikënisjen” për çështje të hapura midis njërive konstitutive të federatës, sikurse në rastin e këtushëm midis Kosovës dhe Serbisë.

¹²⁵ Për mbrojtjen e kufijve të vet Kosova krijoi edhe një mbrojtje të vet territoriale. Krahu. M. Beckmann-Petey: Der jugoslawische Föderalismus [Federalizmi jugosllav], Munihi, Vjenë 1990, f. 165 vv.

¹²⁶ Gazeta Zyrtare e Kosovës, Nr. 4/1974.

¹²⁷ Si pikë thelbësore e „diskriminimit serb” brenda federatës u shikua fakti se të deleguarit serbë nuk kishin kurrfarë autorizimesh vendimmarrëse në parlamentin kosovar, derisa të deleguarit kosovarë duhej të jepnin pëlqimin për ligjet „kooperative” republikane dhe mund të bashkëvendosnin në të gjitha çështjet e tjera. J. Marko tregon se ishte e paarsyeshme frika serbe nga një majorizim nga të deleguarit e Kosovës në Parlamentin e Serbisë tek ligjet dhe punët që preknin vetëm „Serbinë e brendshme” dhe që sipas nenit 343 të Kushtetutës serbe të vitit 1974 aprovohehin vetëm me shumicën e dy të tretave të të deleguarve të Serbisë së brendshme. Krahu. Joseph Marko: Die Rechtliche Stellung der Minderheiten in Serbien [Pozita juridike e pakicave në Serbi], në: Jochen A. Frowein etj. (ed.): Das Minderheitenrecht europäischer Staaten, Teil 2 [E drejta e pakicave në shtetet evropiane, Pjesa 2], Berlin etj. 1994, f. 307 vv.

¹²⁸ Krahu. Tomislav Borić: Perspektiven eines zukünftigen Jugoslawien [Përshkrimi i një Jugosllavie të ardhshme], në: Joseph Marko, Tomislav Borić (ed.): Slowenien-Kroatien-Serbien. Die neuen Verfassungen [Sllovenia-Kroacia-Serbia. Kushtetutat e reja], Vjenë etj. 1991, f. 51-79.

E. Nga kërkesa deri te shpallja e Republikës së Kosovës

Për kosovarët ngritja e Kosovës brenda federatës jugosllave në një pozitë të një *de facto* republike ishte hap i natyrshëm dhe logjik. Kërkesa për Republikë të Kosovës ishte ngritur për herë të parë publikisht në mbrëmjen para festës kombëtare shqiptare (Dita e Flamurit) më 27 nëntor 1968 në Prishtinë dhe në qytete të tjera të Kosovës.¹²⁹ Ajo u arsyetua nëpërmjet argumenteve të politikës demografike dhe demokratike si dhe mbi bazën e vendimeve të Konferencës së Bujanit. Me atë rast p.sh. u paraqit se Kosova, për dallim nga Mali i Zi dhe Maqedonia, nuk kishte një republikë të veten, edhe pse dendësia popullore e shqiptarëve në Kosovë ishte më e lartë se ajo e malazezëve në Mal të Zi dhe se përveç kësaj në tërë Jugosllavinë kishte më shumë shqiptarë se maqedonas.¹³⁰

Në kuadër të refuzimit të kërkesës për një Republikë të Kosovës brenda Jugosllavisë u argumentua se e drejta për një republikë të veten u takon vetëm atyre kombeve që nuk kanë „shtet amë”, e mbi këtë bazohej edhe dallimi dogmatik mes *kombeve* dhe *kombësive*. Për këtë arsye shqiptarët, edhe pse populli i tretë për nga madhësia në Jugosllavi pas serbëve dhe kroatëve, u klasifikuan si *kombësi*.

N. MALCOLM paraqet në lidhje me këtë krahasimin e saktë vijues:

„Është e vështirë të kuptosh se pse një parim i këtillë duhej të kishte fuqinë e një norme, kur ai në të vërtetë nuk përputhej me realitetin. Në bazë të një kriteri të tillë, popullata rumanishtfolëse e Moldavisë, që shtrihet në verilindje të Rumanisë, nuk është dashur kurrë ta kishte republikën e vet në Bashkimin Sovjetik.”¹³¹

Sipas disa autorëve, të cilët bazohen në burime historike, J. B. TITO duhet të ketë qenë i gatshëm, duke marrë parasysh gjendjen e tensionuar, që Kosovën ta ngrente

¹²⁹ Më shumë rreth demonstratave në Kosovë më 1968, gjatë të cilave u vra një person dhe si pasojë e të cilave u dënuan 44 veta të tjerë në: N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 325 v; J. Reuter: Die Albaner in Jugoslawien [Shqiptarët në Jugosllavi], Munihi 1982, f. 48 v; Arshi Pipa: Albanian Stalinism: Ideo-political Aspects, Nju Jork 1990, f. 162; Christine von Kohl, Wolfgang Libal: Kosovo: gordischer Knoten des Balkans [Kosova: nyja gordiane e Ballkanit], Vjenë, Cyrih 1992, f. 67 v.

¹³⁰ Kjo u tregua për shembull në prill 1968, kur shqiptari nga Kosova Mehmet Hoxha, një ministër i dikurshëm i Republikës së Serbisë, parashtrroi pyetjen retorike: „Pse 370.000 malazezë mund të kenë republikën e tyre, kurse 1,2 milionë shqiptarë të mos e kenë as një autonomi të plotë?” Borba, 10 prill 1968, cituar sipas J. Reuter: Die Albaner in Jugoslawien [Shqiptarët në Jugosllavi], Munihi 1982, f. 52; Krahe. edhe N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 325.

¹³¹ N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 328.

në republikë të shtatë të Jugosllavisë, por kjo paskësh dështuar për shkak të presionit të politikanëve serbë.¹³²

Në situatën plot konflikte midis Serbisë dhe Kosovës J. B. TITOS një „pajtim midis dy popujve” me gjasë i dukej i zbatueshëm vetëm nëpërmjet miratimit të KF-së së vitit 1974,¹³³ e cila megjithatë nuk do të mund të ruante për kohë të gjatë federatën jugosllave që bazohej mbi një konstruksion të brishtë. Si „zgjidhje me gjysmë zemre” KF e vitit 1974 nuk mund të pengonte fundja idetë e kombeve të mëdha si ato të Serbisë në raport me fqinjët e saj dhe nuk mund të sillte një zgjidhje të përhershme në Ballkanin e prapambetur ekonomikisht, por më shumë shkaktoi një kontinuitet të konflikteve.

I. Trazirat masive në strehën vorfënore të Jugosllavisë në Kosovë më 1981¹³⁴

Më 1981, një vit pak pas vdekjes së J. B. TITOS më 1980, kërkesa për një republikë vetjake të Kosovës brenda federatës u bart prapë në rrugë. Përmasat e trazirave tejkaluan të gjitha trazirat e shfaqura deri atëherë në Jugosllavi pas Luftës së Dytë Botërore¹³⁵, gjë që e qartëson edhe gjendja e jashtëzakonshme në Kosovë, e shpallur

¹³² Krah. P. Bartl: Die Albaner [Shqiptarët], në: Michael W. Weithmann (ed.): Der Ruhelose Balkan. Die Konfliktregionen Südosteuropas [Ballkani i paqetë. Rajonet e konfliktit të Evropës Juglindore], Muni 1993, f. 199.

¹³³ Një shembull për krijimin e një shteti të ri të një federate brenda një shteti federal paraqet themelimi i „Republikës dhe i Kantonit” Jura në Zvicër, siç thuhet në nenin 1 të kushtetutës së Juras. Një krahasim të Juras me rastin e Kosovës e bën J. Marko në librin e tij: Autonomie und Integration. Rechtsinstitute des Nationalitätenrechts im funktionalen Vergleich [Autonomia dhe integrimi. Institutet juridike të së drejtës së kombësive në krahasimin funksional], Vjenë etj. 1995, f. 488 vv. Për zhvillimin historik deri më tani unik të separatizmit që çon deri te themelimi i një kantoni të ri, krah. Christian Rauch: Struktur und Strukturwandel des jurassischen Separatismus zwischen 1974 und 1994 [Struktura dhe ndryshimi i strukturës së separatizmit të Juras mes 1974 dhe 1994], Bernë 2001.

¹³⁴ Krah. për këtë N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 334 vv. J. Reuter: Die Albaner in Jugoslawien [Shqiptarët në Jugosllavi], Muni 1982, f. 79 vv. Fee Rauer: Das Kosovo: eine völkerrechtliche Studie [Kosova: një studim sipas të drejtës ndërkombëtare], Vjenë 1999, f. 33 vv. e kështu me radhë.

¹³⁵ Rreth numrit të të vrarëve ka të dhëna të ndryshme. J. Reuter: Die Albaner in Jugoslawien [Shqiptarët në Jugosllavi], Muni 1982, f. 82 shkruan: „Numri i të vrarëve duhet të merret si më shumë se një mijë, numri i të lënduarve nuk mund as të vlerësohet.” Duke marrë parasysh faktin se shqiptarët e Kosovës duhej të druanin nga represaliet e rënda, në qoftë se do t’u jepnin ndihmë mjekësore viktimave dhe me këtë zbulonin pjesëmarrjen e tyre në demonstrata, Ch. v. Kohl, W. Libal: Kosovo: gordischer Knoten des Balkans [Kosova: nyja gordiane e Ballkanit], Vjenë, Cyrih 1992, f. 84, supozojnë se më shumë se 100 shqiptarë u vranë dhe mbi 300 u lënduan. Të dhënat zyrtare vetëm në mars 1981 flisnin për 11 njerëz të vrarë dhe 57 të lënduar. Sipas Amnesty International Jahresbericht 1981 [Amnesty International Raporti Vjetor 1981], Frankfurt mbi Main 1981, f. 405-7, në pranverë 1981 u akuzuan 883 veta, 585 u gjykuan me vendim të plotfuqishëm dhe me dënime joproporcionalisht të larta. Cituar sipas

për më se gjashtë muaj. Udhëheqja e PKJ-së, e cila e pretendonte krijimin e mendimit zyrtar, i quajti demonstratat „kundërrevolucionare”, të synuara për „destabilizimin e Jugosllavisë si dhe për shkatërrimin e tërësisë së saj shtetërore”.¹³⁶ Këtë reagim të politikës serbe ndaj trazirave të vitit 1981 në Kosovë e sqaron saktë shkencëtarja e të drejtës Fee RAUERT:

„Nën pretekstin e interesimit për ruajtjen e shtetit jugosllav do të duhej të mënjanohejshin, nga këndvështrimi serb, ndryshimet e paqëndrueshme të vitit 1974 dhe Kosova të lidhej prapë më ngusht me Serbinë. [...] Duke i larguar politikanët pro-shqiptarë me ndihmën e „masave spastruese”, duke i frikësuar intelektualët kritikë me dënime me burg dhe duke e vendosur jetën publike nën administrim ushtarak, udhëheqja e Beogradit, nën ndikimin e fortë serb, krijoi parakushtet politike që „çështja serbe” të zgjidhej përfundimisht.”¹³⁷

Për t’i kuptuar trazirat e vitit 1981 në Kosovë, është e nevojshme që ato të shikohen në kontekstin e situatës së mjerueshme ekonomike në *strehën vorfënore* të Jugosllavisë, në Kosovë, si dhe në kontekstin e përpjekjeve kosovare që zgjasin sot e kësaj dite për njohjen si komb në njërin anën dhe në anën tjetër në kontekstin e politikës represive e diskriminuese të Serbisë kundër shqiptarëve të Kosovës që zgjati deri më 1999, caku i të cilës ishte „eliminimi përfundimtar” i shqiptarëve, si „faktori më i madh pengues” i idesë serbomadhe. Këtu duhet pasur parasysh edhe këtë:

„Vitet nga 1981 deri 1998 lidhen me fazën e parë të politikës jugosllave ndaj Kosovës nën A. RANKOVIĆ-in. Tipare karakterizuese janë spastrimi i vazhdueshëm „etnik” në Kosovë si dhe shtypja brutale e popullsisë shqiptare.”¹³⁸

Në vazhdim do të skicohet politika ekonomike në Kosovën e kohës, e cila e përbënte një aspekt të politikës së vazhdueshme shtypëse që shoqërohej nga propaganda¹³⁹.

N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 335: Madje edhe vetë sipas revistës serbe NIN, 1.200 njerëz u dënuan me dënime të rënda me burg dhe 3.000 të tjerë me burgime deri në 3 muaj.

¹³⁶ Krah. Ch. v. Kohl, W. Libal: Kosovo: gordischer Knoten des Balkans [Kosova: nyja gordiane e Ballkanit], Vjenë, Cyrih 1992, f. 83.

¹³⁷ F. Rauert: Das Kosovo: eine völkerrechtliche Studie [Kosova: një studim sipas të drejtës ndërkombëtare], Vjenë 1999, f. 34.

¹³⁸ Po aty, f. 32.

¹³⁹ „U botua një seri e tërë librash dhe artikujsh pseudoshkencor [...]. Zhvillimet e shkaktuara nga proceset socio-ekonomike dhe nga emancipimi i vonshëm i shqiptarëve në Jugosllavi u interpretuan si dëmtim të vetëdijshëm dhe madje si ndjekje e pakicës serbe që jetonte aty”. Henriette Riegler: Der Kosovo im und nach dem Krieg [Kosova në luftë dhe pas luftës], në: Anton Kumer etj. (ed.): Europäisierung versus Nationalismus. Der ex-jugoslawische Raum

1. Modeli ekonomik jugosllav i „vetëqeverisjes”

Në krahasim me diktaturat e tjera komuniste, lloji i komunizmit jugosllav me „sistemin e tij të vetëqeverisjes” ishte „diçka më liberal” dhe për këtë arsye në kontekstin ekonomik u quajt si „socializëm i tregut”¹⁴⁰. Eksperimenti i socializmit të tregut në kuptim e tezës – „*Pushteti i shtetit është një pushtet i koncentrimit; prona është një pushtet i decentralizuar*”¹⁴¹ – çoi deri te njëfarë decentralizimi i pushtetit, mirëpo nuk mënjanoi tërësisht në realitet „kapitalizmin shtetëror” dhe nuk shëroi „këmbët e dobëta” me sëmundje kronike të ekonomisë jugosllave.¹⁴² Kriza e përgjithshme e sistemit jugosllav të ekonomisë „vetëqeverisëse”, i cili përveç kësaj në Kosovë shfaqte edhe elementet koloniale të eksploatimit të lëndëve të para, ishte shkaktari vendimtar i trazirave më 1981.

Politologu italian Giovanni SARTORI prosperitetin e Jugosllavisë që ishte relativ sipas standardeve lindore, e përshkroi si vijon:

„Prosperiteti i saj relativ (sipas standardeve lindore) rrjedh nga një ekonomi private, e cila kryesisht mbetet e lënë në vetvete, dhe nga importimi i kapitalit perëndimor, e jo nga struktura vetëqeverisëse”.¹⁴³

Ky prosperitet relativ ishte i theksuar dukshëm më dobët në Kosovë deri më 1999 nën sundimin jugosllav, përkatësisht serb, sesa në republikat e tjera, gjë që në vazhdim do të ilustron në bazë të të dhënave për zhvillimin ekonomik.

auf der Suche nach Stabilität [Evropianizimi kundër nacionalizmit. Hapësira ish-jugosllave në kërkim të stabilitetit], Frankfurt am Main etj. 2000, f. 109.

¹⁴⁰ Giovanni Sartori: *Demokratiethorien* [Teoritë e demokracisë], Darmshtat 1997, f. 412.

¹⁴¹ Krahe. po aty, f. 414 që mbështetet në thënien e P. J. Proudhon-it.

¹⁴² Krahe. po aty, v ku në lidhje me ekonominë i referohet Ota Sik: *Der dritte Weg. Die marxistisch-leninistische Theorie und die moderne Industriegesellschaft* [Rruga e tretë. Teoria marksiste-leniniste dhe shoqëria moderne industriale], Hamburg 1972, si dhe në kuptimin politik Milovan Djilas: *Die neue Klasse. Eine Analyse des kommunistischen Systems* [Klasa e re. Një analizë e sistemit komunist], Munihi 1961.

¹⁴³ G. Sartori: *Demokratiethorien* [Teoritë e demokracisë], Darmshtat 1997, f. 415.

2. Skicë e zhvillimit ekonomik dhe social të Kosovës në vitet e 1980-ta¹⁴⁴

Në federatën jugosllave, në krahasim me republikat e tjera, Kosova gjithmonë paraqiste një territor të prapambetur. Kjo diskrepancë në zhvillim midis Kosovës dhe përbërësve të tjerë të federatës mund të paraqitet si vijon: Më 1973 p.sh. të hyrat për frymë banori në Kosovë sipas burimeve zyrtare jugosllave arrinin 500 dollarë amerikanë, ndërsa në Slloveni arrinin 3000 dollarë amerikanë, që paraqiste pra një raport prej 6:1. Më 1947 Jugosllavia në krahasim me Kosovën gjendej në një shkallë dyfish më të lartë të zhvillimit, kurse relacioni më 1980 ishte 4:1.¹⁴⁵ As pas vitit 1980 gjendja ekonomike në Kosovë nuk u përmirësua, mes të tjerash edhe për shkak të një politike të gabuar ekonomike dhe zhvillimeve të caktuara politike, të cilat në vijim do të përshkruhen më hollësisht.

Në faza të caktuara ekzistonte megjithatë një përkrahje speciale për territoret e pazhvilluara, e cila prapëseprapë në Kosovë, duke i marrë parasysh objektivat afatgjatë, nuk orientohej në rrethanat e vendit, siç ishte p.sh. numrin i lartë i popullsisë, por favorizonte eksploatimin e pasurive nëntokësore në afat të shkurtër.

Nga 1947 deri më 1955, kur zhvillimi ekonomik ra në kompetenca të „republikës amë”, Serbisë, Kosova edhe pse paraqiste një territor të prapambetur, praktikisht nuk mori kurrfarë mbështetjesh.¹⁴⁶ Në anën tjetër, nga 1966 deri më 1970 u ndërmorën përpjekje të mëdha që të çohet përpara industrializimi i Kosovës, para së gjithash përmes investimeve në ato kapacitete industriale që bazoheshin mbi pasuritë e mëdha nëntokësore të Kosovës, si ekonomia energjetike dhe minierat.¹⁴⁷ Mirëpo, nga 1945 deri më 1980 u realizuan vetëm 20% e investimeve të planifikuara në Kosovë.¹⁴⁸ Përveç kësaj, nga 1981 deri më 1985 investimet për kokë banori në Kosovë ishin për afro 51 % më të ulëta (në vitet e 1970-ta 53,9%) sesa mesatarja jugosllave.¹⁴⁹

¹⁴⁴ Rreth pasurive natyrore dhe nëntokësore të Kosovës në statistikat jugosllave në fund të viteve të 1970 gjendej si vijon: Kishte 585.000 ha tokë bujqësore (53,7 % nga territori i tërësishëm i Kosovës prej 10.887 km²) dhe afro 446.000 ha pyje. Kosova kishte 51,5 % të rezervave të qymyrit të Jugosllavisë (më 1976 flitej për 12 miliardë t), 52 % të rezervave të plumbit dhe zinkut, 23 % të eksploatimit të arit, argjendit dhe kromit, 35,6 % të magnezit (më 1976 flitej për 9,85 milionë t) si dhe të rezervave të 20 llojeve të tjera të metaleve dhe lëndëve energjetike. Krah. Marenglen Verli: Shfrytëzimi ekonomik i Kosovës 1970/1990, Tiranë 1994. Me atë rast Kosova, me vetëm 4,2 % të territorit të tërë Jugosllavisë dhe 7,1 % të popullsisë (më 1981 kishte 1.595.000 banorë) posedonte mbi 10 % të pasurive natyrore dhe nëntokësore të tërë Jugosllavisë dhe ishte megjithatë njëkohësisht njësia më e varfër konstitutive e federatës së RSFJ-së.

¹⁴⁵ Krah. J. Reuter: Die Albaner in Jugoslawien [Shqiptarët në Jugosllavi], Muni 1982, f. 77.

¹⁴⁶ Midis 1947 – 1956 Kosova përfitoi vetëm 1,6 % të tërë buxhetit federal. Krah. M. Verli: Shfrytëzimi ekonomik i Kosovës 1970/1990, Tiranë 1994, f. 16.

¹⁴⁷ Krah. J. Reuter: Die Albaner in Jugoslawien [Shqiptarët në Jugosllavi], Muni 1982, f. 55.

¹⁴⁸ M. Verli: Shfrytëzimi ekonomik i Kosovës 1970/1990, Tiranë 1994, f. 17.

¹⁴⁹ Krah. po aty, f. 84.

J. REUTER¹⁵⁰ e përshkruan kështu industrializimin e Kosovës:

„Më 1957 fillojnë investimet për eksploatimin e rezervave të pasura të qymyrit në pellgun e Kosovës. [...] Paralelisht me këtë zgjerim të nxjerrjes së qymyrit [... u ndërtuan] 5 termocentrale. Këto termocentrale me vetëm një të tretën e prodhimit të tyre mbulojnë nevojën e tërësishme energjetike të Kosovës, dy të tretat e energjisë së prodhuar u furnizohen republikave të tjera”.¹⁵¹

Republikat e blinin rrymën me „çmimet e brendshme” të kontrolluara, të cilat ishin nën çmimin real dhe një pjesë të energjisë e shisnin më tutje jashtë vendit.¹⁵²

J. REUTER shton më tej:

„Krahas sasisë së ulët edhe struktura e investimeve ka ndikuar në mënyrë të pavolitshme në zhvillimin ekonomik të Kosovës. [...] Pjesa dërrmuese e të gjitha investimeve (58,3 për qind) shkonte pra në të mirë të ekonomisë energjetike dhe të metalurgjisë. Kështu u krijua në Kosovë një strukturë vërtet e pavolitshme ekonomike. Disa gjigantë të paktë të industrisë së lëndëve të para që investonin kapital, u mbështetën sistematikisht në mënyrë që të eksploatonin pasuritë nëntokësore të krahinës [...]”¹⁵³.

Kjo shprehej më së miri te miniera gjigante e Trepçës, e cila i furnizonte republikat e tjera me minerale me një çmim që ishte shumë nën nivelin botëror dhe përmes kësaj arrinte humbje çdo vit.¹⁵⁴ Para së gjithash në vitet e 1980-ta u krye një eksploatim i tillë i lëndëve të para, të cilat përbënin 84 % të eksporteve kosovare.

Fakti që u investua në industri (eksploatimin e lëndëve të para) me kaq shumë njëanshmëri — çka duke kundërshtuar numrit të madh të fuqive potenciale punëtore në vend e arriti vetëm një punësim shumë të kufizuar — lejon nxjerrjen e përfundimit se investimet në Kosovë synonin vetëm një shfrytëzim sistematik të pasurive nëntokësore, në vend se ta synonin zhvillimin ekonomik substancial.

Në kuadër të kësaj „politike zhvillimore” të planifikuar enkas për Kosovën, më 1979 vetëm çdo i dhjeti banor i Kosovës i aftë për punë kishte një vend pune. Në

¹⁵⁰ Në përmbledhje ai si faktorë kryesorë të prapambetjes ekonomike të Kosovës i përmend këto arsye: U investua tepër pak; U investua në pikat e gabuara; U krijuan po ashtu tepër pak vende të punës; Rritja ekonomike qëndronte në një disproporcion të qartë me rritjen e popullsisë. Krah. J. Reuter: Die Albaner in Jugoslawien [Shqiptarët në Jugosllavi], Munihi 1982, f. 67.

¹⁵¹ Konsumuesit kryesorë ishin Serbia dhe Maqedonia. J. Reuter: Die Albaner in Jugoslawien [Shqiptarët në Jugosllavi], Munihi 1982, f. 56.

¹⁵² Krah. M. Verli: Shfrytëzimi ekonomik i Kosovës 1970/1990, Tiranë 1994, f. 27.

¹⁵³ J. Reuter: Die Albaner in Jugoslawien [Shqiptarët në Jugosllavi], Munihi 1982, f. 67.

¹⁵⁴ Krah. po aty, f. 68.

politikën e punësimit në Kosovë konstatohej qartë edhe një diskriminim i kosovarëve të përkatësisë shqiptare. Për shembull më 1980 në Kosovë ishte i punësuar çdo i pesti serb dhe malazez, ndërsa vetëm çdo i njëmbëdhjeti shqiptar kishte një vend pune. Në disa qarqe të Kosovës ky proporcion arrinte në 5:25 në favor të serbëve dhe malazezëve¹⁵⁵; ky trend vazhdoi edhe në vitet pasuese. Në fund të vitit 1988 një vend pune e kishte 1 nga 4 – 5 kosovarët e përkatësisë serbe, 1 nga 6 kosovarët e përkatësisë turke dhe vetëm 1 nga 13 kosovarët e përkatësisë shqiptare.¹⁵⁶

Përveç kësaj, serbëve dhe malazezëve që dëshironin të jetonin në Kosovë, u siguroheshin beneficione si banesa ose troje, vendi i punës, gjë që mund të vlerësohet si vazhdim i politikës kolonizuese nga koha para Luftës së Dytë Botërore. Sipas gazetave kosovare, një pjesë e popullsisë serbishtfolëse „lëshonte” zyrtarisht vendbanimin e vet në Kosovë dhe „kthehej” pas një kohe të shkurtër që përmes kësaj të vinte deri te beneficionet e garantuara shtetërore.¹⁵⁷ Ngaqë ata së pari „lëshonin” Kosovën, ata nga propaganda serbe shpesh paraqiteshin si „viktima të terrorit shqiptar”. Pavarësisht nga kjo, të gjitha grupet etnike të Kosovës ishin të prekura nga emigrimi ekonomik.¹⁵⁸

Autoritetet jugosllave në propagandën zyrtare gjendjen e mjerueshme sociale të popullsisë së Kosovës e paraqitnin vetëm si pasojë të një „shpërthimi demografik”, me supozimin shovinist se gjendja e kosovarëve sqarohet si pasojë e një shumimi të qëllimshëm të shqiptarëve dhe të bazuar në arsye nacionale. Mirëpo, më 1980 nataliteti i serbëve në Kosovë ishte tri herë më i lartë se në rajonet e tjera të Jugosllavisë¹⁵⁹, gjë që tregon qartë se rritja e lartë e popullsisë në Kosovë duhet të kuptohet para së gjithash si pasojë e prapambetjes së saj ekonomike. Kjo propagandë jo vetëm që përpiqej të fshihte eksploatimin e resurseve të Kosovës, por njëkohësisht zhvillonte një politikë anti-shqiptare kundër „ekspasionit” të shqiptarëve. Pasazhi vijues e qartëson këtë:

„Rritja e fuqishme e popullsisë në Kosovë ka bërë që shqiptarët të kërkojnë hapësira të reja banimi në Jugosllavi. Kështu gjithnjë e më shumë shqiptarë shpërngulen në Serbinë Jugore dhe zgjerohen nga territoret e tyre tradicionale

¹⁵⁵ Krah. NIN, 9 gusht 1980. Cituar sipas: J. Reuter: Die Albaner in Jugoslawien [Shqiptarët në Jugosllavi], Muni 1982, f. 63.

¹⁵⁶ Krah. M. Verli: Shfrytëzimi ekonomik i Kosovës 1970/1990, Tiranë 1994, S. 104.

¹⁵⁷ Krah. Rilindja, 21 mars 1985, f. 4, Për të zënë punë shpërngulje e pastaj kthim.

¹⁵⁸ Në lidhje me uljen e përqindjes së popullatës serbe në Kosovë, shkencëtarët perëndimor janë kryesisht dakord që për këtë në radhë të parë vendimtare ishin arsyet ekonomike. Krah. p.sh. Svein Monnesland: Land ohne Wiederkehr. Ex-Jugoslawien: Die Wurzeln des Krieges [Vendi pa kthim. Ish-Jugosllavia: Rrënjët e luftës], Klagenfurt 1997, f. 312.

¹⁵⁹ Krah. J. Reuter: Die Albaner in Jugoslawien [Shqiptarët në Jugosllavi], Muni 1982, f. 70.

të banimit në perëndim të Maqedonisë drejt qendrës së republikës sikur edhe në Mal të Zi në drejtim të Titogradit [Podgoricës]¹⁶⁰.

Më 1981 politika zyrtare serbe, përkatësisht jugosllave, nuk ishte e interesuar që t'i përmendte arsyet e vërteta ekonomike të trazirave në Kosovë, sepse ajo me këtë do ta diskreditonte praktikën e vet ekonomike koloniale, prandaj e kishte më të thjeshtë të përdorte zemëratën antishqiptare.¹⁶¹ Propaganda antishqiptare tregon se shqiptarët në shtetin e sllavëve të jugut, pra në Jugosllavi, ishin të padëshiruar që nga themelimi i saj dhe cilësoheshin si „element i dyshimtë”, me ç'rast barazia e të gjithë shtetasve *para dhe përmes* ligjit realizohej të shumtën në faza të jashtëzakonshme.

Eksplotimi ekonomik i Kosovës ndodhi deri më 1989 nën ombrellën e ideologjisë komuniste. Pas vitit 1989 ekonomia e Kosovës po shkatërrohej nga Serbia sipas mostrave tipike koloniale që përdorte masa të ngjashme me aparteidin, përkatësisht masa gjenocidale, dhe ky shkatërrim po bëhej më sistematik e më i hapur.

Serbia pas vitit 1989 Kosovën e bëri treg të vetin të monopolizuar: filloi një shitje e plotë e pronës publike të Kosovës mbi bazën e interesave vetjake koloniale serbe.¹⁶² Në periudhën 1989 deri 1994 prodhimi kombëtar i Kosovës ra më tej për 47,5%. Ndërsa më 1989 prodhimi social bruto për banor kish qenë afro 700 dollarë amerikanë, në vitin 1995 ai ra në 340 dollarë amerikanë, me tendencë të rënies së mëtejme. Kështu Kosova u bë vendi më i varfër i Evropës, gjë që, krahas politikës së vazhdueshme të shtypjes dhe të terrorit, midis viteve 1989 dhe 1995 shkaktoi

¹⁶⁰ Shiko NIN, 9 nëntor 1980, cituar sipas: J Reuter: Die Albaner in Jugoslawien [Shqiptarët në Jugosllavi], Muni 1982, f. 70.

¹⁶¹ U dëgjuan megjithatë edhe zëra individualë, disa prej tyre edhe nga ana e aparatit të shtetit, të cilët përmendën arsyet e vërteta të trazirave në Kosovë, por që nuk mundën të nxisin asnjë ballafaqim të përgjithshëm me problematikën. Kështu për shembull Tihomir Vlaškalić, anëtar i Komitetit Qendror të Serbisë, „i cili theksoi se shkaku kryesor ishte problemi i udhëheqjes afatgjate joefikase të ekonomisë së Kosovës. Ai e kritikoi vënien në plan të parë të industrisë, në dëm të investimeve në bujqësi, dhe vërejtë se ekspansioni shumë i madh i arsimit të lartë ishte bërë thjesht një valvul sigurimi për papunësinë.”, Cit. sipas N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 336.

¹⁶² Edhe firmat perëndimore ishin të involvuara, si p.sh. gjatë shitjes së Telekomit të Kosovës, i cili ishte i okupuar nga Serbia dhe i „integruar” në Telekomin e Serbisë, që iu shit Telecom Italia më 1997, me ç'rast një shumë e caktuar shkoi si mito për S. Milošević-in. Sipas gazetës së përditshme italiane La Repubblica këtë biznes e kishte mbështetur në mënyrë masive ministri i jashtëm italian Lamberto Dini. E përditshmja thotë më tutje se S. Milošević-i me këtë shumë e paska armatosur ushtrinë dhe kështu i paska financuar operacionet ushtarake në Kosovë. Ndaj kësaj kritike të shprehur në medie, ministri i jashtëm italian deklaroi në shkurt 2001 se „në vitin 1997 Milošević-i ishte jo vetëm një bashkëbisedues legjitim, por u vlerësua madje pozitivisht në Bashkimin Evropian, sepse e kishte nënshkruar Marrëveshjen e Dejtonit”. Kra. Der Standard, 17/18 shkurt 2001.

shpërnguljen e afro 500.000 shqiptarëve të Kosovës. Ky trend zgjati deri më 1999, kur qenë deportuar afro një milion kosovarë të përkatësisë shqiptare¹⁶³.

II. Fillimi i fundit të RSFJ-së

Masat e para nga ana e pushtetmbajtësve lidhur me trazirat në Kosovë më 1981 ishin të ashtuquajturat „masa të spastrimit dhe diferencimit” që ishin gjithëpërfshirëse: së pari kundër intelektualëve dhe studentëve shqiptarë të Kosovës, pastaj edhe kundër politikanëve dhe qytetarëve „të thjeshtë”, të cilët sipas zhargonit zyrtar kishin përkrahur demonstratat „kundërrevolucionare, shoviniste e separatiste”.¹⁶⁴ Klima e debatit politik u përshkrua si vijon: „[...] fillimi i një vale të re të padive dhe kundërpasive kundër nacionalizmit shqiptar dhe atij serb.”¹⁶⁵

Ky lloj i ballafaqimit me problemet realpolitike dhe sociale e hapi rrugën për thyerjet e para konkrete politike me kompromiset e kushtetutës së vitit 1974 „mezi” të arritur nga J. B. TITO. Kjo politikë e re mori një karakter të fortë, më së fundi me memorandumimin e Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve „Rreth çështjeve aktuale shoqërore në vendin tonë” nga viti 1986.¹⁶⁶ Memorandumi mund të shihet si

¹⁶³ Rreth situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë në fazën përfundimtare të luftës krah.: Kosovo/Kosova. As Seen, As Told. An analysis of the human rights findings of the OSCE. Kosovo Verification Mission October 1998 to June 1999, publikuar nga OSBE/ODIHR 1999.

¹⁶⁴ 1980 – 1990 në Kosovë për shkak të bindjeve të tyre politike u shqiptuan gjithsej dënime me burg në lartësi prej 250.000 vjetëve (2500 shek.). Krah. Ismet Salihu: Pas zgjedhjes kalimtare ashtu si vepruan të tjerët, në: Kosova Sot, 4 dhjetor 1998, f. 9.

¹⁶⁵ N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 337.

¹⁶⁶ Teksti origjinal i memorandumit u publikua për herë të parë si „Memorandum’ grupa akademika Srpske Akademije Nauka i Umetnosti o aktuelnim društvenim pitanjima u našoj zemlji” [Memorandum i një grupi të akademikëve të Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve rreth çështjeve aktuale shoqërore në vendin tonë], në: Naše teme, Zagreb 1-2, 33/1989, f. 128-63. Një ribotim si publikim zyrtar i Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve, editor i të cilit ishte kryetari i atëhershëm i Akademisë Miroslav Pantić, u publikua nga Kosta Mihajlović dhe Vasilije Krestić („Memorandum SANU”. Odgovori na kritike [Memorandumi i ASShA’. Përgjigje në kritika], Beograd 1995) pas versionit në gjuhën angleze të botuar njëkohësisht (Memorandum of the Serbian Academy of Sciences and Arts: Answers to Criticisms, Belgrade 1995). Më hollësisht rreth kësaj, shiko Enver Hoxhaj: Das Memorandum der Serbischen Akademie und die Funktion politischer Mythologie im kosovarischen Konflikt [Memorandumi i Akademisë Serbe dhe funksioni i mitologjisë politike në konfliktin kosovar], në: Südosteuropa, 10-12/2002, f. 494-526. Si autor shpirtëror i këtij memorandumit vlen shkrimtari serb Dobrica Ćosić, i cili më vonë u bë president shteti i RFJ-së së Milošević-it. Lajtmotivi i memorandumit thotë: „Serbët fitojnë të gjitha luftërat dhe humbin gjithmonë paqen”, krah. Wolfgang Libal: Das Ende Jugoslawiens, Chronik einer Selbsterstörung [Fundi i Jugosllavisë, kronika e një vetëshkatërrimi], Vjenë, Cyrih 1991, f. 126; Krah. për këtë edhe Werner Weilguni: Serbien [Serbia], në: Valeria Heuberger etj. (ed.): Brennpunkt Osteuropa. Minderheiten im Kreuzfeuer des Nationalismus [Vatra e zjarrit Evropa Lindore. Pakicat në qendër të nacionalizmit], Vjenë, Munih 1996, f. 213 vv. Për

„i përshtatur me kohën” në kuptimin e politikës serbe të filluar në shek. XIX dhe u bë „deklaratë e fshehtë qeveritare”¹⁶⁷ e S. MILOŠEVIĆ-it, i cili kishte marrë përsipër ta zbatonte parimin famëkeq: *Kudo që jetojnë serbë ose ka varreza serbe, është Serbi*”¹⁶⁸. Kjo politikë serbe e reduktuar në parimin imperialist të territorialitetit¹⁶⁹ u pranua me entuziazëm të madh në shoqërinë serbe me përjashtime të pakta, çka tregon se Serbia e fundshekullit XX nuk ishte produkt i S. MILOŠEVIĆ-it, por më parë ishte e kundërta, S. MILOŠEVIĆ-i ishte produkt i kësaj Serbie.¹⁷⁰

III. Zhvillimet në Kosovë rreth vitit të kthesës 1989¹⁷¹

Më 1989, vitin e „kthesës së madhe” në Kosovë, nuk pati, sikurse gati në të gjitha shoqëritë e qeverisura në mënyrë komuniste deri atëherë, transformim nga një sistem i sundimit totalitar komunist në një demokraci liberale pluraliste. Në vend të kësaj përvijojë një kalim nga një sistem totalitar komunist në një sundim dhjetëvjeçar të ngjashëm me aparteidin¹⁷² dhe papërjashtimisht diskriminues të *regjimit nacional-socialist të Milošević-it*¹⁷³ (nga 1989 deri në qershor 1999). Nga viti 1998 gjendja e

„programe kombëtare” të tjera të ndryshme serbe kra. Nexhmedin Spahiu: Serbian Tendencies for Partitioning of Kosova, Budapest 1999, f. 38-75.

¹⁶⁷ J. Marko: Die Rechtliche Stellung der Minderheiten in Serbien [Pozita juridike e pakicave në Serbi], në: Jochen A. Frowein etj. (ed.): Das Minderheitenrecht europäischer Staaten, Teil 2 [E drejta e pakicave në shtetet evropiane, Pjesa 2], Berlin etj. 1994, f. 311.

¹⁶⁸ Kra. Michaela Wimmer, Stefan Braun, Joachim Spieringer: Brennpunkt Jugoslawien. Der Vielvölkerstaat in der Krise. Hintergründe, Geschichte, Analysen [Vatra e zjarrit Jugosllavia. Shteti shumëkombësh në krizë. Prapavijat, historia, analizat], Muni 1991, f. 123.

¹⁶⁹ Kra. F. Rauer: Das Kosovo: eine völkerrechtliche Studie [Kosova: një studim sipas të drejtës ndërkombëtare], Vjenë 1999, f. 37.

¹⁷⁰ „Për politikën e tij, e cila përfshinte vrasje dhe dëbim, Milošević-i mori gjithëherë një shumicë prej rrafsh 70 për qind; politika e tij sipas kësaj te populli serb ishte mazhoritare dhe demokratikisht e legjitimuar” Viktor Maier: Der Balkan auf dem Prüfstand [Ballkani në pikë prove], në: Internationale Politik – Europa Archiv 3/2001, f. 1; „Milošević-i nuk ishte diktator, por një „autokrat konsensual”, dikur grushti i hekurt i të cilit i përgjigjej vullnetit të shumicës së popullit serb.” Veton Surroi: Das Experiment Kosovo. Ehrgeizige Ziele – Unrealistische Erwartungen [Eksperimenti Kosovë. Çaqe ambicioze – pritje jorealiste], në: Internationale Politik – Europa Archiv 3/2001, f. 31.

¹⁷¹ Kra. Archiv der Gegenwart 8 gusht 1990, f. 34786 v.

¹⁷² Caku ishte që kosovarët e etnicitetit shqiptar „[...] të përjashtoheshin sistematikisht nga pozitat politike dhe resurset socioekonomike dhe të mbaheshin nën kontroll; një shembull ekstrem ishte aparteidi faktik midis serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë (1989 – 1998)” shkruan për shembull Ulrich Schneckener: Regulierung ethnischer Konflikte in Südosteuropa. Die Politik der Anerkennung [Rregullimi i konflikteve etnike në Evropën Juglindore. Politika e njohjes], në: Internationale Politik – Europa Archiv 9/1999, f. 8.

¹⁷³ Ky emërtim del në bazë të një krahasimi në lidhje me parimin e udhëheqësit, me monopolin e medieve dhe të pushtetit dhe me racizmin specifik anti-shqiptar. Kra. edhe J. Marko: Die staatsrechtliche Entwicklung des Kosovo/a von 1913 – 1995 [Zhvillimi i Kosovës sipas të drejtës shtetërore nga 1913 – 1995], në: Joseph Marko (ed.): Gordischer Knoten Kosovo/a: Durchschlagen oder entwirren? [Nyja gordiane Kosova: Të çahet apo të shturet?], Baden-

ngjashme me aparteidin në Kosovë arriti kulmin e saj në një sistem të sundimit gjenocidal.¹⁷⁴

Kjo „*kthesë speciale*” në rastin e Kosovës u mundësua përmes mënjanimit të „*konsensusit federal*” të garantuar në KF-në e vitit 1974, i cili pasojë të drejtpërdrejtë e kishte shkatërrimin e pakthyeshëm të shtetit federativ. Në shenjë proteste kundër shkeljes së KF-së së vitit 1974, në shkurt 1989 u mbajtën greva të përgjithshme masive që nisën nga miniera e „Trepçës” dhe bllokuan tërësisht jetën në Kosovë, të shoqëruara këto nga grevat solidarizuese të studentëve dhe të intelektualëve në mbarë Kosovën, në të cilat mbrohej e të drejta e vetëvendosjes së brendshme.

Pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme¹⁷⁵, në lidhje me arrestimet masive dhe me ndërrimin e imponuar të *politikanëve jobesnikë për Milošević-in me politikanë besnikë ndaj Milošević-it*¹⁷⁶, në „përmbysje të ngjashme me grusht shteti jo vetëm në Vojvodinë dhe Kosovë, por edhe në Republikën e Malit të Zi”¹⁷⁷ u „aprovua” plotësimi i kushtetutës republikane serbe me „pëlqimin” e parlamentit

Baden 1999, f. 25. G. Brunner e quan regjimin e S. Milošević-it si nacionalbolshevizëm serbomadh dhe supozon me të drejtë rreth kësaj: „Fundit i Jugosllavisë është fundja rezultat i nacionalbolshevizmit serbomadh të shkaktuar nga Milošević-i më 1987/88, i cili ka penguar një ridizajnim konfederativ të shtetit federal”. Georg Brunner: Nationalstaaten und Minderheiten im östlichen Teil Europas [Shtetet kombëtare dhe pakicat në pjesën lindore të Evropës], në: Dieter Blumenwitz, Hans von Mangoldt (ed.): Fortentwicklung des Minderheitenschutzes und der Volksgruppenrechte in Europa [Zhvillimi i mëtejshmë i mbrojtjes së pakicave dhe i të drejtave të grupeve etnike në Evropë], Bielefeld 1992, f. 15.

¹⁷⁴ Pikat e aktakuzës kundër S. Milošević-it përfshinin mes tjerash veprat me qëllim që të ndiqej një grup për shkak të kombësisë së tij, etnicitetit, racës apo përkatësisë fetare, p.sh. vrasje, torturë ose deportim. Krime kundër njerëzimit – vepra kundër popullsisë civile, p.sh. vrasje, torturim dhe përdhunim. Shkelje të rënda të Konventës së Gjenevës – vrasje të caktuara, torturim, shkatërrim i pronës dhe marrje peng e civilistëve. Shkelje të së drejtës ndërkombëtare të luftës – përdorimi i armëve të gazta, shkatërrimi i qëllimshëm, sulm ndaj vendbanimeve të pambrojtura, plaçkitje. Krah. për këtë për shembull rreth vlerësimit ndërkombëtar të krimeve të paraqitura të luftës dhe shkeljet e të drejtave të njeriut Hannes Tretter: Die Verfolgung der albanischen Volksgruppe im Kosovo [Ndjekja e grupit etnik shqiptar në Kosovë], në: J. Marko (ed.): Gordischer Knoten Kosovo/a: Durchschlagen oder entwirren? [Nyja gordiane Kosova: Të çahet apo të shthuret?], Baden-Baden 1999, f. 141 vv.

¹⁷⁵ W. Libal: Das Ende Jugoslawiens, Chronik einer Selbstzerstörung [Fundit i Jugosllavisë, kronika e një vetëshkatërrimi], Vjenë, Cyrih 1991, f. 130 vv. e përshkruan situatën si vijon: „[...] Më 27 shkurt [1989] kryesia shtetërore pastaj shpall «masa speciale» mbi territorin e krizës që nuk definohej më hollësisht; armata zhvillon manovra rreth Prishtinës, kryeqytetit të krahinës, të gjitha tubimet publike ndalohen, shpallet një ndalesë për lëvizje gjatë natës. Në fillim të marsit arrestohen Azem Vllasi dhe një numër i funksionarëve të tjerë shqiptarë, pasi që Milošević-i personalisht disa ditë më parë gjatë një tubimi anti-shqiptar në Beograd u kishte premtuar demonstruesve arrestimin e tij.”

¹⁷⁶ Krah. për këtë J. Reuter: Die jüngste Entwicklung in Kosovo [Zhvillimet e fundit në Kosovë], në: Südosteuropa 6/1989, f. 333-43; W. Libal: Das Ende Jugoslawiens, Chronik einer Selbstzerstörung [Fundit i Jugosllavisë, kronika e një vetëshkatërrimi], Vjenë, Cyrih 1991, f.130 vv.

¹⁷⁷ J. Marko (ed.): Gordischer Knoten Kosovo/a: Durchschlagen oder entwirren? [Nyja gordiane Kosova: Të çahet apo të shthuret?], Baden-Baden 1999, f. 21.

kosovar¹⁷⁸, i cili me këtë e shfuqizoi vetveten. Kur më 28 mars 1989 në parlamentin beogradas u shpall ndryshimi kushtetues dhe u deklarua se „Serbisë me këtë iu kthye sovraniteti shtetëror dhe kushtetues”¹⁷⁹, në Kosovë sundonin rrethana të ngjashme me luftë civile.¹⁸⁰ Në një raport të Helsinki Watch situata u cilësua me të drejtë si „okupim ushtarak” dhe „sundim kolonial”.¹⁸¹

Përkundër kësaj situatë të okupimit në Kosovë¹⁸² dhe pasi që

„[...] më 26 qershor 1990 nga ana e parlamentit serb u aprovua një „Ligj për procedurën e organeve republikane në rrethana të jashtëzakonshme” dhe për zbatimin e tyre në Kosovë, edhe pse një „gjendje” e tillë nuk kishte kurrfarë mbulose sipas të drejtës kushtetuese [...]”¹⁸³,

parlamenti i Kosovës më 2 korrik 1990 shpalli pavarësinë e Kosovës përmes një „deklarate kushtetuese” dhe e proklamoi njëkohësisht Kosovën si njësi të barabartë brenda federatës jugosllave me të njëjtin status kushtetues si republikat e tjera.¹⁸⁴

¹⁷⁸ „Pëlqimin e parlamentit të Kosovës” e vënë në dyshim Ch. v. Kohl, W. Libal: Kosovo: gordischer Knoten des Balkans [Kosova: nyja gordiane e Ballkanit], Vjenë, Cyrih 1992, f. 116 me udhëzimin se të pranishëm në parlament ishin bashkëpunëtorët e policisë shtetërore dhe numërimi i votave nuk u zhvillua në mënyrë korrekte. S. Monnesland: Land ohne Wiederkehr. Ex-Jugoslawien: Die Wurzeln des Krieges [Vendi pa kthim. Ish-Jugosllavia: Rrënjët e luftës], Klagenfurt 1997, f. 322 supozon po ashtu se parlamenti ishte i rrethuar me tanke dhe anëtarët e parlamentit ishin kërcënuar në mënyrë masive. J. Reuter: Die jüngste Entwicklung in Kosovo [Zhvillimet e fundit në Kosovë], në: Südosteuropa 6/1989, f. 339 raporton se si delegatët ishin thirrë një nga një në polici dhe aty u ishte treguar për mundësinë se ata apo familjet e tyre do të akuzoheshin si kundërrevolucionar në rast se votonin kundër. Edhe raporti i Helsinki Watch në mars 1990 përmend raste se si delegatët kishin humbur mandatin e tyre ose një pjesë të të ardhurave të tyre ose ishin arrestuar.

¹⁷⁹ W. Libal: Das Ende Jugoslawiens, Chronik einer Selbstzerstörung [Fundit i Jugosllavisë, kronika e një vetëshkatërrimi], Vjenë, Cyrih 1991, f.132 vv.

¹⁸⁰ Krah. për këtë Amnesty International, Jahresbericht 1990 [Raporti vjetor 1990], Frankfurt am Main 1990, f. 412; Helsinki Watch Report mars 1990; W. Libal: Das Ende Jugoslawiens, Chronik einer Selbstzerstörung [Fundit i Jugosllavisë, kronika e një vetëshkatërrimi], Vjenë, Cyrih 1991, f.130 vv; Ch. v. Kohl, W. Libal: Kosovo: gordischer Knoten des Balkans [Kosova: nyja gordiane e Ballkanit], Vjenë, Cyrih 1992.

¹⁸¹ Helsinki Watch Report mars 1990, f. 45.

¹⁸² „Vendimi rreth gjendjes në Kosovë në jug të Jugosllavisë” nga 13 prilli 1989, në: Gazeta Zyrtare e Komunitetit Evropian (më tutje: GZ) Nr. C 120/204 përcakton mes tjerash: „Parlamenti Evropian A. thellësisht i alarmuar rreth gjendjes shpërthyes në Kosovë, e cila gjendet në prag të luftës civile, [...] më 29 mars 1989 pas luftimeve dyditore ka shkaktuar viktima të shumta, B. i indinjuar për shtypjen përmes milicisë dhe forcave të armatosura si dhe për arrestimet e shumta, prej të cilave janë të prekur një numër i madh i personaliteteve të jetës publike, [...] 1. thekson se paqja është në rrezik, [...] dhe kjo mund të ketë pasoja të rënda për tërë Evropën; [...]”.

¹⁸³ J. Marko (ed.): Gordischer Knoten Kosovo/a: Durchschlagen oder entwirren? [Nyja gordiane Kosova: Të çahet apo të shturet?], Baden-Baden 1999, f. 22.

¹⁸⁴ Në një rezolutë të Parlamentit Evropian – „Vendim rreth të drejtave të njeriut në Kosovë” nga 12 korriku 1990, në GZ nr. C 231/175, – thuhet në lidhje me reagimet e Serbisë pas shpalljes

Kjo shpallje e Republikës së Kosovës përbrenda vetë Kosovës si dhe lidhur me konfliktin me Serbinë hapi një fazë të re, në të cilën aktualisht, përkundër një përmase të caktuar të pasigurisë mbi perspektivat e ardhshme të Kosovës, në kuadër të proceseve rajonale dhe tejracionale evropiane të transformimit dhe të integritimit shënon një trend pozitiv në drejtim të shuarjes përfundimtare të konfliktit.

së Kosovës si republikë: „Parlamenti Evropian A. duke u njoftuar me shpalljen e pavarësisë, e cila më 2 korrik 1990 u dha nga 114 prej 180 përfaqësuesve të popullit në parlamentin krahinor dhe në të cilën thuhet se Kosova është një njësi plotësisht autonome brenda Federatës Jugosllave, statusi kushtetues i së cilës është identik me atë të republikave të tjera, [...] 1. dënon shpërndarjen e parlamentit në Kosovë [...] dhe kërkon shfuqizimin e menjëhershëm të gjendjes së jashtëzakonshme [...] 4. thërret autoritetet serbe veçanërisht që, -të njohin kushtetutën e vitit 1974 dhe t’iu përmbahen në mënyrë strikte, -të njohin të drejtën e popullsisë shqiptare për autonomi kulturore dhe politike, -të ndalin dëbimin e shqiptarëve nga Kosova dhe të ndërprejnë projektin e „rikolonizimit; [...]”.

Kreu III: Aktorët e brendshëm dhe të jashtëm në politikën e Kosovës të viteve të 1990-ta

A. Nga sistemi i shtetësisë paralele deri te administrata e UNMIK-ut¹⁸⁵

Deri në fillim të viteve të 1990-ta kërkesat e kosovarëve nuk ishin të drejtuara kah një secesion nga shteti federal jugosllav, por që nga vitet e 1960-ta vetëm drejt njohjes formale e Republikës së Kosovës brenda federatës. Veç kur në fund të viteve të 1980-ta u shpall gjendja e luftës mbi Kosovë dhe Kosova *de facto* dhe *de jure* u okupua nga Serbia, nga një njësi tjetër përbërëse konstitutive e federatës, kosovarët kërkuan të drejtën e vetëvendosjes së jashtme.

I. Konstituimi i Republikës së Kosovës në sistemin e shtetësisë paralele

Proklamimit të parlamentit të Kosovës më 2 korrik 1990, i cili Kosovën e shpallte njësi të barabartë brenda federatës jugosllave me të njëjtin status konstitucional si republikat e tjera, Serbia iu përgjigj me një „lloj politike okupuese”¹⁸⁶. Republika e

¹⁸⁵ United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (më tutje: UNMIK). Veprimtaria e UNMIK-ut si dhe gjendja e përgjithshme në Kosovë dokumentohet në raporte të publikuara rregullisht të Sekretarit të Përgjithshëm për Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

¹⁸⁶ J. Marko (ed.): Gordischer Knoten Kosovo/a: Durchschlagen oder entwirren? [Nyja gordiane Kosova: Të çahet apo të shthuret?], Baden-Baden 1999, f. 22. Krahe për këtë edhe Hannes Tretter, Stephan Müller, Violeta Demaj: Die Verfolgung der albanischen Volksgruppe im Kosovo [Ndjekja e grupit etnik shqiptar në Kosovë], në: po aty, f. 125-55 si dhe disertacionin e Violeta Demajt pranë Universitetit të Vjenës: Die Entwicklungen in Kosova seit der Aufhebung der Autonomierechte im Jahre 1989 unter Berücksichtigung staatsrechtlicher, menschenrechtlicher und völkerrechtlicher Aspekte [Zhvillimet në Kosovë që nga shfuqizimi i të drejtave të autonomisë në vitin 1989 duke marrë parasysh aspektet e të drejtës shtetërore, të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare], Vjenë 1999.

Në mënyrë të përmbledhur, si pasojë e kësaj situatë të okupimit del kjo pamje: Afro 300.000 nxënëse dhe nxënës me 20.000 mësimdhënës si dhe afro 20.000 studente dhe studentë me 900 profesorë universitarë dhe asistentë dhe mbi 110.000 punëtorë nga fusha të ndryshme të punësimit u nxorën në rrugë për shkak të përkatësisë së tyre shqiptare dhe për shkak të bindjeve politike. Në vitet deri më 1997, kur shpërtheu lufta e hapur, çdo vit vriteshin mesatarisht afro 30 kosovarë të përkatësisë shqiptare përmes torturës apo keqtrajtimeve të ngjashme, gjë që të tjerëve duhej t’u shërbente si frikësim. Më shumë rreth kësaj gjendet në raportet vjetore të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë nga kjo kohë.

Në një raport të publikuar në maj 2000 të Federatës Ndërkombëtare të Bibliotekave, zëvendësudrejtori i Federatës Ndërkombëtare të Bibliotekave me seli në Kopenhagë, Carsten Frederiksen, sqaron se si në bibliotekat e Kosovës mes 1991 dhe 1995 u shkatërruan 100.000

Kosovës megjithatë ishte *de jure legale* dhe *legjitime*¹⁸⁷, ndërsa prania e regjimit serb në Kosovë sipas të drejtës kushtetuese ishte *ilegale*¹⁸⁸ dhe *jolegjitime*.

Administrata tipike okupuese e etabluar nga ana serbe bashkë me praninë ushtarake ishte aq e fuqishme, saqë strukturat *legale* dhe *legjitime* të Kosovës mund t'i ushtronin veprimtarinë e tyre vetëm në hijen e këtij sundimi. Nga viti 1989 e deri te kapitullimi faktik ushtarak i RFJ-së së *Milošević-it* në Kosovë në qershor 1999, në Kosovë u zhvillua një sistem i shtetësisë paralele.¹⁸⁹ Institucionet e krijuara nga qeveria në ekzil e Republikës së Kosovës vepronin kryesisht në fushën e arsimit, shëndetësisë si dhe të bujqësisë e kulturës.¹⁹⁰

Më 7 shtator 1990 nga Parlamenti i Kosovës, „i shpërndarë”¹⁹¹ nga Serbia, u aprovua „*Kushtetuta e Republikës së Kosovës*” (e njohur si *Kushtetuta e Kaçanikut* sipas vendit të miratimit).¹⁹²

libra në shqip dhe që nga viti 1991 nuk ishte furnizuar asnjë libër i vetëm në shqip. Në këtë frymë ai flet për „një spastrim etnik në bibliotekat e Kosovës”. Krah. Koha Ditore, 9 qershor 2000, f. 9. Pas luftës u krijua një pasqyrë e dëmit të shkaktuar qëllimisht trashëgimisë kulturore në Kosovë, i cili në shumicën e rasteve nuk ishte pasojë e sulmeve ajrore të NATO-s apo të veprimeve luftarake, por shkon në llogari të trupave serbe. Çka nuk u shkatërrua, u dërgua në Beograd si p.sh. ekspozitatet e shumta muzeore. Krah. Neue Zürcher Zeitung: Zerstörte Kulturgüter in Kosovo [Gjësendet kulturore të shkatërruara në Kosovë], 4/5 nëntor 2000, f. 4.

Me gjasë diktaturat shprehen ashtu që shkatërrojnë libra, vlera mendore dhe simbole kulturore, siç ndodhi edhe në Evropën Perëndimore gjatë diktaturave në gjysmën e parë të shek. 20.

¹⁸⁷ Krah. për shembull Joseph Marko, Tomislav Borić (ed.): Slowenien-Kroatien-Serbien. Die neuen Verfassungen [Sllovenia-Kroacia-Serbia. Kushtetutat e reja], Vjenë etj. 1991; Joseph Marko: Der Minderheitenschutz in den jugoslawischen Nachfolgestaaten [Mbrotjtja e pakicave në shtetet pasardhëse jugosllave], Bon 1996.

¹⁸⁸ Në një rezolutë të Parlamentit Evropian „Vendim rreth gjendjes në Jugosllavi” nga 11 shtatori 1991, në: GZ Nr. C 267/100 thuhet mes tjerash: „[...] G. duke marrë parasysh që në Kosovë dhe në vende të tjera edhe më tej shkelet legaliteti demokratik [...] 6. përsërit bindjen e tij se është e patjetërsueshme e drejta për vetëvendosje demokratike të të gjitha republikave dhe krahinave autonome të federatës; [...]”.

¹⁸⁹ Rreth rezistencës civile në kuadër të sistemit të shtetësisë paralele në Kosovë i referohem librit të Howard Clark: Civil Resistance in Kosovo, Londër etj. 2000.

¹⁹⁰ Në njërën anë këto struktura kosovare mund t’iu përshtateshin situatës së okupimit, sepse qysh në pranverë 1990 erdhi deri te „një segregacion sipas mostrës afrikanojugore” (Ch. v. Kohl, W. Libal: Kosovo: gordischer Knoten des Balkans [Kosova: nyja gordiane e Ballkanit], Vjenë, Cyrih 1992, f. 313), në anën tjetër për regjimin serb ato vlenin si jo shumë të rrezikshme, për shembull në krahasim me punët e Ministrisë së Mbrotjtjes apo të Ministrisë së Brendshme të Republikës së Kosovës. Fundja shqiptarët e Kosovës mund të eksploatoheshin pak a shumë „bruto” nga regjimi okupues serb, d.m.th. pa bërë kjo p.sh. shpenzime për institucionet shëndetësore ose arsimore të shqiptarëve të Kosovës.

¹⁹¹ Në literaturën rreth konfliktit midis Kosovës dhe Serbisë gjejmë shpesh emërtimin „parlamenti i shpërndarë i Kosovës”, në vend që të përdoret emërtimi i përshtatshëm „parlamenti i penguar në punën e tij”. Serbia nuk kishte fundja asnjë mbulesë kushtetuese *de jure* për këtë dhe nuk mund të arrinte as de facto shpërndarjen e parlamentit të Kosovës.

Paralelisht me këtë më 28 shtator 1990, duke thyer qartë vazhdimësinë kushtetuese dhe duke shkelur dispozitat e KF-së së vitit 1974 dhe të kushtetutës republikane serbe, Parlamenti i Republikës së Serbisë aprovoi një kushtetutë „të re” serbe, e cila sipas të drejtës shtetërore vlerësohet si hapi i parë për dezintegrimin e shtetit federativ jugosllav¹⁹³ dhe me të cilën „Serbia [u] konstituua [...] si republika e parë e federatës jugosllave si shtet i pavarur në kuptimin institucional dhe organizativ.”¹⁹⁴ Përmes kësaj përfundimisht dhe pakthyeshem u nis shkatërrimi i shtetit të përbashkët federativ të Jugosllavisë që përbëhej prej tetë njësive konstituuese dhe i cili gjatë Luftës së Ftohtë vlente si një vend gjeostrategjikisht i rëndësishëm. Përveç kësaj iu hoq çdo gjasë reale mbetjes së mundshme të Kosovës, por edhe të republikave të tjera¹⁹⁵ të federatës së dikurshme jugosllave në një Jugosllavi centraliste të dominuar nga serbët, por njëkohësisht u humb përfundimisht edhe pozita relativisht e mirë nisëse, në krahasim me shtetet e tjera të bllokut lindor, për një integrim të ardhshëm të Jugosllavisë së dikurshme si shtet i tërësishëm në BE.

Hapi i ardhshëm i strukturave *legale* kosovare ishte shpallja e pavarësisë shtetërore më 22 shtator 1991 mbi bazën e një rezolute të Parlamentit të Kosovës:

„Kosova si shtet sovran dhe i pavarur me të drejtën e pjesëmarrjes konstituive në lidhjen e shteteve – republikave sovrane (në Jugosllavi) mbi bazën e lirisë dhe barazisë së plotë të republikave – shteteve në lidhjen e tyre”.¹⁹⁶

Nga 26 – 29 shtatori 1991 u mbajt një referendum, në të cilin 99,98 % e popullsisë së Kosovës, me një pjesëmarrje prej 87 %, u shpreh për këtë deklaratë. Më 23 tetor 1991 Parlamenti i Kosovës aprovoi qeverinë e parë të Republikës së Kosovës.

Për t’i ndërtuar institucionet e *Republikës së Kosovës si shtet sovran, neutral dhe i hapur ndaj të gjithë fqinjëve* (ky ishte vetëdefini i kuptimit të shtetit të

¹⁹² Për një analizë më të hollësishme të „Kushtetutës së Kaçanikut”, sidomos lidhur me mbrojtjen e pakicave të paraparë në Republikën e Kosovës, shiko J. Marko: Der Minderheitenschutz in den jugoslawischen Nachfolgestaaten [Mbrojtja e pakicave në shtetet pasardhëse jugosllave], Bon 1996, f. 201 vv.

¹⁹³ Krahe. J. Marko (ed.): Gordischer Knoten Kosovo/a: Durchschlagen oder entwirren? [Nyja gordiane Kosova: Të çahet apo të shthuret?], Baden-Baden 1999, f. 22 v.

¹⁹⁴ F. Rauert: Das Kosovo: eine völkerrechtliche Studie [Kosova: një studim sipas të drejtës ndërkombëtare], Vjenë 1999, f. 44.

¹⁹⁵ Raportet e Serbisë me pjesët e tjera përbërëse të federatës së dikurshme, të cilat edhe më qartë do ta ilustronin hegjemoninë serbe, nuk mund të trajtohen më hollësisht në kuadër të këtij punimi. Krahe. për këtë për shembull S. Kux: Ursachen und Lösungsansätze des Balkankonflikts: Folgerungen für das Abkommen von Dayton [Shkaqet dhe nismat për zgjidhjen e konfliktit të Ballkanit: Përfundimet për Marrëveshjen e Dejtonit], Europa Institut pranë Universitetit të Bazelit Nr.16/1996.

¹⁹⁶ Krahe. tekstin e kësaj rezolute si dokument 01 Nr. 06/91 të Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikë, Prishtinë, 22 shtator 1991.

kosovarëve në atë kohë), më 24 maj 1992, për aq sa kjo ishte e mundshme në një *situatë okupimi*, u mbajtën për herë të parë zgjedhjet pluraliste dhe të lira.¹⁹⁷ Zgjedhjet e reja, të cilat sipas rregullës duhej të mbaheshin pas katër vjetësh, u shtynë me arsyetimin se situata në Kosovë ishte tejte e tensionuar. Ato u mbajtën në vitin 1998 ende në kuadër të sistemit të shtetësisë paralele,¹⁹⁸ dhe aty bëhej fjalë më shumë për një „rikonfirmim” të legjitimitetit të organeve dhe të institucioneve të dala nga zgjedhjet e vitit 1992 për bisedimet që priteshin në atë kohë për zgjidhjen e konfliktit të Kosovës, sesa për zgjedhje të rëndomta ose të rregullta.

II. Pozita e Kosovës sipas të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës shtetërore gjatë sistemit të shtetësisë paralele

Sipas disa ekspertëve të të drejtës ndërkombëtare, më së voni që nga referendumi i shtatorit 1991 deri në fund të janarit 2000, kur organet e Republikës së Kosovës sovranitetin ia dorëzuan protektoratit *de facto* të OKB-së (shiko pikën vijuese III), Kosova përmes protektoratit faktikisht ekzistues të OKB-së¹⁹⁹ duhet të trajtohet²⁰⁰ si

¹⁹⁷ Në zgjedhjet parlamentare konkurruan 511 kandidatë nga 22 parti për 143 vende. Me 76,41 % të votave dhe me 96 mandate shumicën absolute e arriti Lidhja Demokratike e Kosovës (më tutje: LDK). Kryetari i saj, I. Rugova, u zgjodh drejtpërsëdrejti si presidenti i parë i Republikës së Kosovës si kandidat i vetëm me afro 95 % të votave. 13 mandate i takuan Partisë Parlamentare dhe nga 7 mandate Partisë Demokratike dhe Partisë Fshatare. 14 mandate u rezervuan për pakicën serbe dhe 3 për myslimanët. Myslimanët fituan edhe një vend shtesë, derisa mandatet serbe mbetën të paplotësuar për shkak të mospjesëmarrjes në zgjedhje.

¹⁹⁸ Në zgjedhjet e dyta parlamentare dhe presidenciale më 1998, të cilat pjesërisht për shkak të luftës u bojkotuan madje edhe nga partitë shqiptare të Kosovës dhe në rajone të caktuara nuk mund as të organizoheshin, bëhej fjalë për përcaktimin e 30 vendeve të lira parlamentare sipas sistemit zgjedhor proporcional. Demokristianët shqiptarët të Kosovës arritën 6,41 %, socialdemokratët e Kosovës 4,24 %, liberalët 3,61 % të votave të dhëna. Partia Nacionaldemokratike e shqiptarëve të Kosovës me gati 2,27 % të votave nuk arriti të kalojë pragun prej 3 %. Edhe këtë herë I. Rugova ishte kandidati i vetëm për postin e presidentit të Republikës së Kosovës, pasi që dy kundërkandidatët e tjerë, Adem Demaçi dhe Luljeta Pula kishin tërhequr kandidaturat e tyre.

¹⁹⁹ Aktualisht në Kosovë ekziston *de facto* një protektorat i OKB-së, *de jure* mund të flitet për një administratë të përkohshme nën përgjegjësinë e Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Kosovën, me një trupë ushtarake të sigurisë të NATO-s.

²⁰⁰ Ishte dhe është e pranishme si identiteti i përbashkët etnik, gjuhësor dhe kulturor, kriteri i një populli kompakt në një territor kompakt, mbështetja e udhëheqjes shqiptare të Kosovës e dëshmuar në rrugë demokratike dhe shpallja e pavarësisë edhe përmes pakicave që jetojnë atje, përveç asaj serbe, dhe para së gjithash objektivi i etablimit të një shteti ligjor sipas standardeve evropërore. Përveç kësaj, në bazë të mizorive të ushtruara vetëm gjatë dhjetëvjeçarit të fundit nga ana e qeverisë serbe në Kosovë, mbetja e Kosovës në çdo lloj konstelacioni të përfytyrueshëm shtetëror me Serbinë duhet të vlerësohet si i pamundshëm për t'u kërkuar dhe si shembull negativ i praktikës së të drejtës shtetërore.

shtet i pavarur²⁰¹. Sipas këtij interpretimi²⁰² njohja formale diplomatike nuk paraqet asnjë kusht për pavarësinë.

Një mendim tjetër i kundërt i të drejtës ndërkombëtare, i cili ndahet kryesisht nga diplomatët ndërkombëtarë, i cili njohjen nga OKB-ja ose nga bashkësia ndërkombëtare e shikon si të pashmangshme për pavarësinë²⁰³, mohon pavarësinë *legale* dhe *legjitime* të Kosovës sipas të drejtës ndërkombëtare, përkatësisht e hesht këtë shpesh edhe qëllimisht si një konstatim ‚problematik‘ për politikën ditore.

Pavarësia e Republikës së Kosovës nuk u mor parasysht, përkatësisht nuk u pranua ende zyrtarisht deri më sot nga bashkësia ndërkombëtare.²⁰⁴ Një njohje ndërkombëtare e të drejtës së jashtme të vetëvendosjes për Kosovën në interpretimin e mendimit të parë sipas të drejtës ndërkombëtare do të kishte konsekuenca vetëm *politike* dhe jo konsekuenca *juridike*, sepse cilësia shtetërore në kuptimin sipas të drejtës ndërkombëtare nuk do të varej nga njohja përmes shteteve të tjera. Edhe parakushtet klasike të mëvetësisë, *pushteti shtetëror*, *populli shtetëror* dhe *territori shtetëror*, ishin *de facto* të pranishme në rastin e Kosovës. Argumenti i paraqitur shpesh i mungesës *de facto* të pushtetit shtetëror të shtetit të Kosovës në fazën e *shtetësisë paralele* mund të shfuqizohet përmes faktit se kosovarët — krahas tatimeve të detyruara serbe — vullnetarisht paguanin tatim për strukturat e Republikës së Kosovës. Lojaliteti vullnetar i shprehur përmes kësaj ilustron se *pushteti real shtetëror* i shtetit të Kosovës ishte shumë më i fuqishëm sesa i atyre shumë shteteve të tjera, gjithsesi se ai i Serbisë, përkatësisht i RFJ-së së *Milošević-it*.²⁰⁵

²⁰¹ Te ky rezultat lidhur me situatën e dhjetëvjeçarit të fundit në Kosovë vijnë krahas ekspertëve kosovarë edhe ekspertët ndërkombëtarë. Krahas për shembull F. Münzel, Lässt sich die Unabhängigkeit Kosovas völkerrechtlich begründen? [A mund të arsyetohet pavarësia e Kosovës me të drejtën ndërkombëtare?], në: J. Marko (ed.): Gordischer Knoten Kosovo/a: Durchschlagen oder entwirren? [Nyja gordiane Kosova: Të çahet apo të shthuret?], Baden-Baden 1999. Werner Andrä: Gedanken zur Unabhängigkeit des Kosovo [Mendime rreth pavarësisë së Kosovës], në: J. Marko (ed.): Gordischer Knoten Kosovo/a: Durchschlagen oder entwirren? [Nyja gordiane Kosova: Të çahet apo të shthuret?], Baden-Baden 1999, f. 191-7.

²⁰² Kjo vijë e argumentimit i referohet shpalljes së pavarësisë të parlamentit të Kosovës, referendumit si dhe procesit të përgjithshëm të dezintegrimit të federatës jugosllave, në të cilën Kosova, kjo sipas përkrahësve të kësaj pozite, paraqiste një pjesë përbërëse konstituive të barabartë me kufij të vet të definuar dhe të garantuar.

²⁰³ Krahaso për shembull edhe rastin e Tajvanit, i cili, edhe pse mban marrëdhënie diplomatike me shtete të shumta dhe marrëdhënie jozyrtare me shumicën e shteteve si dhe gjithanshëm vepron si „shtet i pavarur“, nuk perceptohet si shtet i pavarur, sepse mes tjerash nuk është anëtar i OKB-së.

²⁰⁴ Si vend i vetëm Shqipëria e njohu pavarësinë e Kosovës. Mirëpo, kjo njohje u bë vetëm nga parlamenti shqiptar dhe jo edhe nga Ministria e Jashtme në Tiranë.

²⁰⁵ Në kundërshtim me këtë vijë të argumentimit, sociologu shqiptar nga Kosova, Shkëlzen Maliqi, thotë se Kosova nuk mund të konstituohej si shtet, sepse i mungonte pushteti ekzekutiv dhe nuk kishte kurrsesi një monopol të pushtetit. Me anë të kësaj, etniteti i quajtur shpesh „shtet paralel“ apo „shtet në hije“ i ngjante më tepër një shoqërie të organizuar dhe të

Në rastin e njohjes ndërkombëtare të Kosovës si shtet sovran nga ana e bashkësisë ndërkombëtare nuk bëhet fjalë, siç paraqitet kjo shpesh, për një ndryshim të „kufijve ekzistues”, sepse më së voni që nga shkatërimi i Jugosllavisë së dikurshme nuk ishin më ekzistues kufijtë e jashtëm të RSFJ-së dhe sipas KF-së të vitit 1974 në fuqi Kosova kishte kufijtë e vet. Andaj do të bëhej fjalë vetëm për një transformim të vetëvendosjes së brendshme të njësisë federative të Kosovës, ku kjo federatë më nuk ekziston, në një vetëvendosje të jashtme, siç është p.sh. rasti i Sllovenisë.

Kjo vetëvendosje që i takon Republikës së Kosovës në bazë të kësaj vije të argumentimit plotësohet përmes të drejtës për vetëvendosje të popullit të kosovarëve.²⁰⁶ Juristi kushtetues dhe eksperti për çështje kushtetuese të hapësirës ish-jugosllave Joseph MARKO argumenton si vijon:

„Edhe në vetë marrjen përsipër të vijës serbe, përkatësisht jugosllave, të argumentimit, e cila shqiptarët e Kosovës dëshiron t’i dijë të trajtuar si pakicë, kosovarëve u mbetet e ruajtur pozita sipas të drejtës ndërkombëtare, se janë bartës juridikë të të drejtës së vetëvendosjes.”²⁰⁷

III. Qëndrimi brenda-kosovar gjatë sistemit të shtetësisë paralele

Presidenti kosovar i Republikës së Kosovës, I. RUGOVA, ndihej siç duket aq i sigurt në politikën e tij paqësore për shkak të pëlqimit ndërkombëtar, saqë edhe më tej insistonte në monopolin e tij në politikën e Kosovës, edhe kur këtë nuk e gëzonte më aq bindshëm si në fillimin e viteve 1990-të. Për shembull në vjeshtë 1997, pa përkrahjen e institucioneve që qëndronin nën ndikimin e I. RUGOVËS, u mbajtën demonstrata paqësore të studentëve të Universitetit të Prishtinës me qëllimin që të ushtrohet presion për zbatimin e marrëveshjes së arritur në vitin 1996 për kthimin e studentëve në ndërtesat universitare. Mirëpo, demonstrata u shtyp brutalisht nga policia serbe.

pavarur. Krah. S. Maliqi 1998, <http://www.fuhem.es/portal/areas/paz/kosovo/opinion/shkelzen.htm>

²⁰⁶ Krah. për shembull Hannes Tretter rreth ushtrimit të së drejtës për vetëvendosje: Die Verfolgung der albanischen Volksgruppe im Kosovo [Ndjekja e grupit etnik shqiptar në Kosovë], në: J. Marko (ed.): Gordischer Knoten Kosovo/a: Durchschlagen oder entwirren? [Nyja gordiane Kosova: Të çahet apo të shthuret?], Baden-Baden 1999, f. 142 vv.

²⁰⁷ Joseph Marko: „Kosova Republiké!” zwischen Recht und Moral [„Kosova Republiké!” midis të drejtës dhe moralit], në: Skënder Gashi, Lothar Classen (ed.): Dardania. Das Selbstbestimmungsrecht der Kosovaren, Bd. 2 [Dardania. E drejta e vetëvendosjes e kosovarëve, vëll. 2], Vjenë 2001, f. 71.

Deri në pranverë 1998, p.sh., I. RUGOVA mohonte në publik ekzistencën e UÇK-së²⁰⁸ dhe insistonte në fillimet e paraqitjes së saj se kjo ishte një shpikje e shërbimit sekret serb.²⁰⁹ Eksperti për Ballkanin Matthias RÜB e shikon këtë „injorim” jo vetëm si vlerësim të gabuar tragjik të gjendjes, por edhe si „humbje të rëndë të realitetit” te presidenti, kurse situatën e përmbledh si vijon:

„Mohimi i UÇK-ës ishte vetëm njëra prej shumë shenjave se Rugova filloi të humbiste kontaktin me realitetin në Kosovë. Gati se asnjëherë nuk largohej nga kryeqyteti i krahinës, Prishtina. Me popullin e tij në zona rurale nuk binte në kontakt më intelektual në kolltukun e presidentit. Qëndrimi i diskutueshëm i Rugovës ndaj UÇK-së acaroi në anën tjetër grindjen politike në mesin e shqiptarëve të Kosovës për »Republikën e Kosovës«. A ekzistonte ajo ende, apo nga shteti në hije i shqiptarëve të Kosovës ishte bërë një »Republikë e LDK-së«? Vërtet funksiononin arsimit dhe shëndetësia alternative, por institucionet politike të republikës së vetëshpallur ishin bërë praktikisht inekzistente.”²¹⁰

Dyshimet për realizimin e shtetit të Kosovës përmes politikës paqësore të I. RUGOVËS kontribuuan në mënyrë vendimtare për radikalizmin dhe militarizimin e rezistencës shqiptare të Kosovës kundër okupimit të Kosovës nga ana e Serbisë. Gjatë „Luftës së Ftohtë” midis regjimit serb në Kosovë dhe kosovarëve (1989 – 1997) ishte rritur një „*gjeneratë e re e Republikës së Kosovës*”, e cila faktikisht nuk kishte se çfarë të humbte.²¹¹ Në një situatë të tillë, siç tregojnë shembujt e ngjashëm

²⁰⁸ Ushtria Çlirimtare e Kosovës (më tutje: UÇK). Më shumë rreth UÇK krah. për shembull Klaus Lange: Die UÇK – Anmerkungen zu Geschichte, Struktur und Zielen [UÇK-ja – shënime rreth historisë, strukturës dhe caqeve], në: Aus Politik und Zeitgeschichte, Beilage zur Wochenzeitung Das Parlament, 34/20 gusht 1999, f. 33-9.

Lidhur me transformimin e ish-UÇK-së në „Trupa Mbrojtëse të Kosovës”, më 20 qershor 1999 Forca e Kosovës (më tutje: KFOR) nënshkroi me UÇK-në një marrëveshje demilitarizimi, sipas së cilës UÇK-ja do të demilitarizohej deri më 21 shtator 1999 dhe të shndërrohej në një organizatë të mbrojtjes civile për katastrofa me emrin „Trupa Mbrojtëse e Kosovës (më tutje: TMK). Shiko Rregulloren nr. 1999/8 të UNMIK-ut nga 20 shtatori 1999 Për krijimin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Kosovarët TMK-në përkundër karakterit „përkohësish” të pastër civil e shohin si thelbin e një ushtrie të ardhshme të Kosovës dhe të integruar në NATO.

²⁰⁹ Krah. Matthias Rüb: Kosovo Ursachen und Folgen eines Krieges in Europa [Kosova, shkaqet dhe pasojat e një lufte në Kosovë], Munihi 1999, f. 73 v. Gjatë sulmeve ajrore të NATO-s në vitin 1999 I. Rugova megjithatë e quajti UÇK-në në një intervistë me revistën gjermane Der Spiegel si „[...] ushtria jonë çlirimtare UÇK [...]”, shiko Der Spiegel, 5 prill 1999, f. 156.

²¹⁰ M. Rüb: Kosovo Ursachen und Folgen eines Krieges in Europa [Kosova, shkaqet dhe pasojat e një lufte në Kosovë], Munihi 1999, f. 73 v.

²¹¹ Sipas revistës serbe NIN, e cila citon hulumtimet e US Information Agency (USIA), në atë kohë „madje 94 për qind e shqiptarëve [paskan qenë] të gatshëm të vdesin për arritjen e caqeve të tyre.” Slobodan Relić: Čiji je interes Kosovo? [Në interes të kujt është Kosova?], në: NIN, 19 mars 1998, f. 9. Në anën tjetër anketat në anën serbe e qartësojnë ftohjen kolektive dhe armiqësore të serbëve me shqiptarët dhe dominimin e stereotipeve raciste gjatë

në histori, është tejet e vështirë që dhuna të pengohet së shpërthyeri. Më së voni nga viti 1996 në jetën politike të Kosovës fjalën e mori UÇK-ja dhe në nëntor 1997 u shfaq për herë të parë në opinion. Që nga kjo kohë UÇK-ja rekrutonte gjithnjë e më shumë simpatizues dhe luftëtarë. Situata çoi në fund të involvimi direkt i bashkësisë ndërkombëtare në konfliktin midis Serbisë dhe Kosovës përmes aktiviteteve ndërmjetësuese dhe në fund përmes intervenimit ushtarak.

Pas këtij intervenimi, në dhjetor 1999 një marrëveshje brendakosovare parashihte shuarjen e ekzistimit dhe të veprimtarive të organeve shtetërore të Kosovës mbi bazën e krijimit të një protektorati *de facto* të OKB-së. Më 14 janar 2000 hyri në fuqi një rregullore (Regulation²¹²) e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së²¹³, francezit Bernard KOUCHNER, në të cilën mes tjerash thuhet:

„[...] Strukturat e tashme të Kosovës, qofshin ato ekzekutive, ligjvënëse ose gjyqësore, (siç është „Qeveria e Përkohshme e Kosovës”, „Presidenca e Republikës së Kosovës”), në masën e mundshme dhe në pajtim me këtë rregullore, do të transformohen dhe do të integrohen në mënyrë progresive në Strukturën e Përbashkët të Përkohshme Administrative, e cila do të fillojë punën nga data 31 janar 2000, kur edhe strukturat e tjera të Kosovës të natyrës ekzekutive, ligjvënëse ose gjyqësore do të pushojnë së ekzistuari; [...]”²¹⁴

Administrata e OKB-së, përkatësisht protektorati *de facto* i OKB-së, nga këndvështrimi kosovar paraqet vetëm një fazë të përkohshme deri te njohja e pavarësisë së Kosovës nga OKB-ja, përkatësisht nga shtetet e tjera. Në këtë kuptim shqiptarët e Kosovës kishin qenë të gatshëm edhe para luftës të pranonin një lloj protektorati si etapë në rrugën kah njohja ndërkombëtare e pavarësisë.²¹⁵

vlerësimit të tyre. Krah. Ivana Lazić: Brak sa Albancem [Martesa me shqiptarin], në: Naša Borba, 21/22 mars 1998.

²¹² Rregullorja nr. 2000/1 nga 14 janari 2000 mbi Strukturën e Përbashkët të Përkohshme Administrative të Kosovës.

²¹³ Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (më tutje: PSSP).

²¹⁴ Rregullorja nr. 2000/1 nga 14 janari 2000, neni 1 (c). Më 1 shkurt 2000 këtë e konfirmoi I. Rugova që vepronte në funksionit e presidentit të Republikës së Kosovës edhe një herë në një deklaratë në Prishtinë dhe deklaroi: „Konfirmoj që Qeveria e Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Presidenca e Republikës së Kosovës së bashku me të gjitha strukturat përkatëse të ekonomisë, sigurisë dhe administratës pushojnë së ekzistuari që nga 1 shkurti 2000. Kjo ndodhë në kuadër të shpërbërjes së përgjithshme të të gjitha strukturave paralele, sipas marrëveshjes së nënshkruar më 15 dhjetor 1999 për themelimin e Strukturave të Përbashkëta të Përkohshme Administrative të Kosovës në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/1 nga 14 janari 2000 [...]” Në mungesë të burimit në gjuhën shqipe citati është përkthyer nga gjermanishtja.

²¹⁵ Kosova duhet përkohësisht të vendoset nën një administrim ndërkombëtar (d.m.th. një protektorat i OKB-së), në mënyrë që të ndalet agresioni i serbëve, deklaroi kryeministri i atëhershëm i Kosovës që qëndronte në ekzil, Bujar Bukoshi, më 15 qershor 1993 në Vjenë, krah. Archiv der Gegenwart nga 25 qershori 1993, f. 37982; Krah. Neue Zürcher Zeitung, 24

B. Sjellja e aktorëve ndërkombëtarë²¹⁶ në konfliktin 1989 – 1999

Kthesa në vitin 1989 nuk liroi vetëm forca pozitive, por edhe negative, si nacionalizëm, etnocentrizëm dhe fanatizëm fetar, potenciali shkatërrues i të cilëve u shpreh para së gjithash në konfliktet e ish-Jugosllavisë. Luftërat në Jugosllavinë e dikurshme nuk sollën vetëm vuajtje të pamendueshme për njerëzit dhe për vendin, por ishin njëkohësisht *fiaskoja e politikës evropiane* me pasojat më të rënda pas vitit 1989. Në shembullin e ish-Jugosllavisë, BE-ja si aktor paqevënës dhe më i aftë për integrim do të kishte mundur të mobilizonte dhe të dëshmonte forcën politike dhe aftësinë vepruese. Megjithatë, kjo faktikisht nuk ndodhi, kurse zgjidhjet e konflikteve, sa kohë mund të flitet për *zgjidhje*, shpesh nuk ishin evropiane, por amerikane.

I. Qëndrimi keqkuptues dhe pragmatik i bashkësisë ndërkombëtare

Në procesin e dezintegrimit të hapësirës së dikurshme jugosllave, reagimi i bashkësisë ndërkombëtare ndaj konfliktit të Kosovës kohë të gjatë përbëhej nga deklarata politike të synimeve dhe kërkesa pa efekt ndaj Beogradit, në vend që të inicioheshin masa konkrete të mbështetjes për politikën, përkatësisht rezistencën e padhunshme të kosovarëve. Veç kur rezistenca në Kosovë nga paqësore gjithnjë e më shumë po shndërrohej në të tillë të dhunshme, bashkësia ndërkombëtare filloi të largohet nga qëndrimi i saj parimisht më shumë pasiv lidhur me *regjimin e terrorit të Milošević-it* në Kosovë. Kur më 1998 shpërtheu lufta e hapur në Kosovë, bashkësia ndërkombëtare reagoi më shpejt dhe në mënyrë më vendimtare sesa me Bosnje e Hercegovinën, gjë që duhet parë si shenjë e një aftësie mësimi, edhe pse shumë të ngadalshme, të bashkësisë ndërkombëtare në raport me politikën e Ballkanit.

Një përjashtim në këtë sjellje pasive paraqet vetëm „gjuha më e qartë” e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila kishte të bënte vetëm me *modusin* e ndaljes së konfliktit në Kosovë.

“Më 27 dhjetor 1992, presidenti amerikan në largim George Bush, premtoi se ShBA-ja nuk do të lejojë që Kosova të bëhet një Bosnjë e dytë. Duke pranuar raportet e inteligjencës në lidhje me një goditje të planifikuar, ai u kërcënu

qershor 1996, f. 5; Krahe. intervistën me I. Rugova: Wir wünschen uns ein internationales Protektorat [Dëshirojmë një protektorat ndërkombëtar], në: Die Presse, 28 janar 1998, f. 6.

²¹⁶ Në përgjithësi rreth sjelljes së bashkësisë ndërkombëtare në lidhje me konfliktet në Ballkan dhe me konfliktin e Kosovës krahe. Heinz Brill: Der Balkan-Konflikt und die Interessen der Mächte [Konflikti i Ballkanit dhe interesat e fuqive], në: Österreichische Militärische Zeitschrift (ÖMZ) 5/2000 dhe 6/2000, f. 547-58 dhe f. 721-32. Krahe. me këtë rast sidomos skemën në f. 730.

me sulme të njëanshme ajrore kundër caqeve strategjike në Serbi. Clinton rifuqizoi këtë në shkurt”²¹⁷.

I. Konferenca për Jugosllavinë dhe Marrëveshja e Dejtonit

Më 27 prill 1992 u konstituua „Republika Federale e Jugosllavisë” — RFJ-ja e *Milošević-it* — e përbërë nga Serbia dhe Mali i Zi e cila pretendonte të ishte pasardhësi ligjor i Jugosllavisë së dikurshme – RSFJ-së²¹⁸, me ç’rast Kosova interpretohej në mënyrë të vetëkuptueshme si pjesë e Serbisë dhe në kushtetutën e „Jugosllavisë” nga viti 1992 nuk përmendet asnjë herë të vetme. Pretendimi i këtij „shteti të rithemeluar” për të qenë pasardhës ligjor i ish-RSFJ-së u refuzua megjithatë nga Komisioni i Badinterit.²¹⁹ Në njërën anë krijesa shtetërore e RFJ-së së *Milošević-it*, e cila njëkohësisht paraqiste një „Serbi të Madhe” të krijuar pjesërisht me sukses, nuk i plotësonte kriteret për njohje, në anën tjetër nuk kishte parashtruar kurrfarë kërkesë zyrtare për njohje si „pasardhëse ligjore” e RSFJ-së.

Në kuadër të shpërbërjes së RSFJ-së edhe Kosova, sikurse edhe republikat e tjera, më 21 dhjetor 1991 parashtrori një kërkesë për njohjen ndërkombëtare të pavarësisë te kryesuesi i Konferencës për Jugosllavinë, lordi P. CARRINGTON, dhe te ministrat e jashtëm të dymbëdhjetë shteteve anëtare të Komunitetit Evropian (shiko shtojcën). Megjithatë, qeveria e Republikës së Kosovës zyrtarisht nuk mori as përgjigje as pozitive e as negative, gjë që në përgjithësi u interpretua si refuzim i pavarësisë së Kosovës.

²¹⁷ Howard Clark: *Civil Resistance in Kosovo*, Londër etj. 2000, f. 89. Edhe gazeta serbe *Borba* raportonte më 1 mars 1993 për një letër të presidentit amerikan Bill Clinton dërguar presidentit serb S. Milošević-, në të cilin i pari e paralajmëronte nga përdorimi i dhunës në Kosovë dhe theksonte se „[...] në rast të një konflikti në Kosovë të shkaktuar përmes veprimeve të palës serbe, ShBA-të do të ishin të gatshme të dërgojnë njësite ushtarake kundër serbëve në Kosovë dhe madje edhe në vetë Serbi.” Shiko Archiv der Gegenwart nga 3 marsi 1993, f. 37627.

²¹⁸ Službeni list BRJ [Gazeta Zyrtare e RFJ-së], nr. 1/1992. Përkthimi në anglisht në: *Yugoslav Law 2-3/1992*. Ekstrate të tij në gjermanisht te J. Marko: *Der Minderheitenschutz in den jugoslawischen Nachfolgestaaten* [Mbrojtja e pakicave në shtetet pasardhëse jugosllave], Bon 1996, f. 249 v.

²¹⁹ Në ekspertizën nr. 9 dt. 4 korrik 1992 (*International Legal Materials*, më tutje: ILM) 31/1992, f. 1523-5, Komisioni i Badinterit thotë se të gjitha republikat e dikurshme jugosllave qenkan shtete pasardhëse të RSFJ-së së dikurshme dhe asnjë shtet nuk mund të pretendojë vetë të drejtat e deritanishme të anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare. Në ekspertizën nr. 10 dt. 4 korrik 1992 ILM 31/1992, f. 1525 v, Komisioni i Badinterit konstaton mes tjerash, se RFJ-ja e *Milošević-it* qenka një shtet i ri dhe njohja e RFJ-së *Milošević-it* u orientuaka sipas kriterëve të njohjes së Komunitetit Evropian (shiko për këtë direktivat e BE-së për njohjen e shteteve të reja në Evropën Lindore dhe në Bashkimin Sovjetik nga 16 dhjetori 1991, në: ILM 1992, f. 1486 v, si dhe Deklaratën e BE-së rreth njohjes së republikave jugosllave nga 16 dhjetori 1991, në: ILM 1992, f. 1485 v). Më tutje OKB-ja, Këshilli i Evropës dhe Konferenca e atëhershme për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (më tutje: KSBE) në frymën e rekomandimeve të Komisionit të Badinterit kanë refuzuar po ashtu pretendimin e kontinuitetit të RFJ-së së *Milošević-it*.

Marrëveshja e Dejtonit²²⁰ nga viti 1995 kishte një efekt katalizator ndaj situatës së „Luftës së Ftohtë” që ekzistonte në Kosovë që nga viti 1989 por edhe ndaj strategjive politike të shqiptarëve të Kosovës. Në këtë marrëveshje u injoruan përpjekjet paqësore kosovare për ta ndalur konfliktin në mënyrë të civilizuar, po që se kjo do të ishte gjithsesi e mundshme me regjimin e atëhershëm jugosllav përkatësisht serb, ashtu që problematika e pazgjidhur e Kosovës nuk u trajtua nga marrëveshja. Në nivel ndërkombëtar politika pa dhunë, e ndjekur nga I. RUGOVA, u kuptua më shumë si dobësi e kosovarëve dhe jo si shans që konflikti, edhe pse në një proces diçka më të gjatë, të zgjidhej sipas vullnetit të popullit dhe sipas përgjithësisht rregullave të pranuar të të drejtës ndërkombëtare. Kosovarëve përmes kësaj iu bë e qartë se njohja ndërkombëtare e të drejtës për një Kosovë të pavarur të synuar përmes strategjisë së rezistencës paqësore do të ruhej në masë aq gjatë derisa të ishin të gatshëm që të bënin më shumë për çështjet e tyre, d.m.th. thënë troç, të merrnin armët në duar.

Ngjarjet pasuese në Kosovë treguan se negociatorët perëndimorë, së paku sipas vlerësimit të S. MILOŠEVIĆ-it, në mënyrë indirekte kishin hyrë në një lloj tregtie këmbimi me të: „Stabiliteti dhe paqja në Bosnjë” kundër dorës së lirë në Kosovë²²¹. Përmes asaj që marrëveshja e Dejtonit nuk e „shpërbleu” strategjinë politike paqësore të I. RUGOVËS, së paku u pranua politika agresive e udhëheqësit serb S. MILOŠEVIĆ.²²² Mes tjerash kjo ndodhi, sepse Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk dëshironin të rrezikonin procesin e Dejtonit për „arsye pragmatike” dhe nga këndvështrimi amerikan bëhej fjalë para së gjithash për një çështje të Evropës.

²²⁰ Marrëveshja e Dejtonit ndali luftën në Bosnjë dhe Hercegovinë (prill 1992 – nëntor 1995) dhe „çimento” „spastrimet etnike”, zhvendosjes masive të popullatës, ndarjen e Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës në dy përkatësisht tri territore etnikisht të „pastra”. Përveç kësaj mbi bazën e kësaj marrëveshjeje „qeveritë e përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në luftë në Zagreb dhe Beograd shpëtuan kryesisht pa kushtëzime.” U. Schneckener: Regulierung ethnischer Konflikte in Südosteuropa. Die Politik der Anerkennung [Rregullimi i konflikteve etnike në Evropën Juglindore. Politika e njohjes], në: Internationale Politik – Europa Archiv 9/1999, f. 11.

²²¹ J. Reuter raportonte se si në fillim të vitit 1992 qarkullonte thashethemja se Perëndimi paskësh lidhur një „ujdi” me S. Milošević-in. „Për miratimin e tij për stacionimin e helmetave të kaltra në Krajinë [në atë kohë territore të kontrolluara nga serbët përreth qytetit Knin në Kroaci] presidenti i atëhershëm serb paska marrë premtimin se problemi i Kosovës nuk do të vendoset në agjendën ndërkombëtare.” J. Reuter: Die internationale Gemeinschaft und der Krieg im Kosovo [Bashkësia ndërkombëtare dhe lufta në Kosovë], në: Südosteuropa 7-8/1998, f. 282.

²²² Krahe për këtë për shembull S. Kux: Ursachen und Lösungsansätze des Balkankonflikts: Folgerungen für das Abkommen von Dayton [Shkaqet dhe nismat për zgjidhjen e konfliktit të Ballkanit: Përfundimet për Marrëveshjen e Dejtonit], Europa Institut pranë Universitetit të Bazelit Nr.16/1996. Rreth zhvillimeve të konfliktit në Kosovë pas Dejtonit deri në fillim të vitit 1997 krahe. Predrag Jurekovic: Die Entwicklungen des Konfliktes im Kosovo seit „Dayton” [Zhvillimet e konfliktit në Kosovë që nga „Dejtoni”], në: Österreichische Militärische Zeitschrift (ÖMZ) 3/97, f. 309-16.

Këta shembuj e qartësojnë se si pavarësia e Kosovës, përkatësisht konflikti i Kosovës, u *injorua* si nga ana e Konferencës për Jugosllavinë të thirrur nga BE-ja ashtu edhe nga bashkësia ndërkombëtare, në Marrëveshjen e Dejtonit të arritur me iniciativën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në dobi të një „*veprimi pragmatik*”. Me këtë rast një „mospreokupim” me problemin stimuloi vështrimin e bashkësisë ndërkombëtare që doli të jetë tepër optimist, sipas të cilit konflikti i Kosovës ishte zbutur sepse dy palët në konflikt nuk kishin hapësira fërkimi dhe shqiptarët u besonin mjeteve pasive.²²³

2. Shtetet e BE-së dhe Parlamenti Evropian

Në fund, disa nga shtetet më të mëdha të BE-së filluan ta shikonin RFJ-në e *Milošević-it*, përkatësisht „Serbinë e Madhe” të ngritur dhe pjesërisht të realizuar nga S. MILOŠEVIĆ-i, si krijesë shtetërore legjitime dhe njohën më 1996 RFJ-në e *Milošević-it*. Ky hap ishte juridikisht tejet i diskutueshëm, sepse nuk ishin të pranishme parakushtet e nevojshme sipas standardeve evropiane për një njohje, si sundimi i ligjit, demokracia etj.²²⁴

Përmes njohjes së RFJ-së së *Milošević-it* u zhvendos shumë larg edhe mundësia e një ndaljeje „paqësore” të konfliktit midis Kosovës dhe Serbisë. Kështu gjendja në Kosovë nuk u përmirësua as para e as pas njohjes; e kundërta, ajo eskaloi vazhdimisht më tutje, sikurse bënte tashmë me vite. Me gjasë kjo nuk ishte relevante për qeveritë e shteteve anëtare të BE-së, të cilat më 1996 lidhën marrëdhënie diplomatike me RFJ-në e *Milošević-it*.²²⁵

²²³ Krah. Stefan Troebst: Chronologie einer gescheiterten Prävention: Vom Konflikt zum Krieg im Kosovo, 1989 – 1999 [Kronologjia e një prevencionit të dështuar: Nga konflikti deri te lufta në Kosovë, 1989-1999], në: Osteuropa 8/1999, f. 779.

²²⁴ Franca dhe Britania e Madhe më 10 prill 1996 lidhën si të parat marrëdhënie diplomatike me RFJ-në e *Milošević-it*. Pasuan më 16 prill 1996 Austria, më 17 prill 1996 Gjermani dhe vende të tjera të BE-së. Shiko Archiv der Gegenwart 66/1996, f. 40974.

Parakushtet e nevojshme sipas standardeve evropiane për njohjen e shteteve të reja sovraane si sundimi i ligjit ose demokracia këtu nuk ishin kurrsesi të plotësuar. Kështu për shembull në një rekomandim për nevojën e një ndaljeje të shpejtë të konfliktit rreth ardhmërisë së Kosovës (GZ. Nr. C 078 nga 18 marsi 1996, f. 0015) të Parlamentit Evropian, pra afro një muaj para njohjes së RFJ-së së *Milošević-it* nga ana e shteteve anëtare të BE-së u theksua: „1. [...] , njohja e plotë diplomatike e Republikës së re Federative të Jugosllavisë [do të duhej ...] të varet nga ajo se a është arritur një rregullim i gjerë dhe i kënaqshëm midis Slobodan Milošević-it dhe përfaqësuesve të zgjedhur të popullit të Kosovës [...]”, gjë që megjithatë nuk u morë në dijeni nga qeveritë përkatëse kombëtare të shteteve anëtare të BE-së.

²²⁵ Në vitin 1996 u shfuqizuan sanksionet e shqiptuara më 1991 kundër Serbisë dhe Malit të Zi deri në një „mur të jashtëm” (përrjashtimi nga tregjet ndërkombëtare financiare). Caku i përrjashtimit nga tregjet financiare ishte që të imponoheshin reforma të brendshme demokratike dhe të ekonomisë së tregut, të zbatoheshin Marrëveshja e Dejtonit dhe të gjendej një zgjidhje e problemit të Kosovës.

Përmes njohjes së RFJ-së së *Milošević-it* qeveritë perëndimore shpresonin mes tjerash, se afro 500.000 shqiptarët e Kosovës të dëbuar midis viteve 1989 dhe 1996, të cilët qëndronin në

Parlamenti Evropian që nga viti 1989 në rezoluta dhe deklarata të shumta²²⁶ kishte tërhequr vërejtjen se mënyra e veprimit të Serbisë përballë Kosovës nuk kishte kurrfarë mbulose kushtetuese dhe kishte dënuar „ndjekjen brutale dhe raciste të shqiptarëve në Kosovë”²²⁷ si dhe shkeljet e tjera të të drejtave të njeriut nga ana e Serbisë në Kosovë.

Në një rezolutë²²⁸ lidhur me njohjen e RFJ-së së *Milošević-it* nga ana e disa shteteve anëtare të BE-së, Parlamenti Evropian konstaton:

„Parlamenti Evropian [...] i brengosur që Kosova më 1989 ka humbur statusin e saj kushtetues si shtet federal dhe që situata e të drejtave të njeriut dhe kushtet e jetesës më pastaj janë përkeqësuar shumë, [...] 8. insiston që Beogradi të nisë negociatat me përfaqësuesit e zgjedhur të Kosovës, para se BE-ja të normalizojë marrëdhëniet e saj diplomatike me Jugosllavinë dhe të shfuqizojë të gjitha sanksionet ekzistuese ekonomike; 9. shpreh keqardhjen për njohjen e ngutur diplomatike të Republikës Federale të Jugosllavisë nga ana e disa shteteve anëtare; [...]”.

Ky është një shembull karakterizues për *dërgimin e sinjaleve të ngatërruara*. Në njërën anë u dënua politika e Serbisë nga ana e Parlamentit të BE-së, në anën tjetër, ajo njihet nga shtetet anëtare, kur bëhet fjalë për hapa vendimtarë sipas të drejtës ndërkombëtare. BE-ja vepronte kështu në mënyrë kontradiktore dhe pa koncept të qartë.²²⁹ Edhe Serbia i dërgonte sinjale të ngatërruara bashkësisë ndërkombëtare (krah. figurën nr. 1), ashtu që diplomatët serbë shpeshherë betoreshin se dëshironin të përfundonin politikën çnjerëzore në Kosovë.

shtetet e BE-së kryesisht pa status definitiv, të mund t'i kthenin prapë në atdheun e tyre. Kjo megjithatë në pjesën më të madhe nuk u zbatua, sepse krahas keqtrajtimit të qëllimta nga ana e organeve shtetërore për çdo shqiptar të Kosovës të kthyer Serbia kërkonte nga qeveritë perëndimore një lloj kompensimi.

²²⁶ Krah. rezolutat e Parlamentit Evropian për këtë kohë nga viti 1989 deri te njohja e Jugosllavisë: Vendim rreth gjendjes në Kosovë në jug të Jugosllavisë, 13 prill 1989, në: GZ. Nr. C 120/204; Vendim rreth të drejtave të njeriut në Kosovë, 12 korrik 1990, në: GZ. Nr. C 231/175; Vendim rreth Kosovës, 11 tetor 1990, në: GZ. Nr. C 284/129; Vendim rreth krizës në Kosovë, 21 shkurt 1991, në: GZ. Nr. C 72/131; Vendim rreth gjendjes në Jugosllavi, 11 shtator 1991, në: GZ. Nr. C 267/100; Vendim rreth ngjarjeve në Jugosllavi, 10 tetor 1991, në: GZ. Nr. C 280/127; Vendim rreth krizës në Kosovë, 9 prill 1992, në: GZ. Nr. C 125/228; Vendim rreth zgjerimit të konfliktit në Jugosllavinë e dikurshme, 19 nëntor 1992, në: GZ. Nr. C 337/196; Vendim rreth gjendjes në Jugosllavinë e dikurshme, 18 prill 1996, në: GZ. Nr. C 141/216.

²²⁷ Pika 1 e vendimit rreth krizës në Kosovë, 9 prill 1992, në: GZ. Nr. C 125/228 të Komisionit Evropian.

²²⁸ Vendim rreth gjendjes në Jugosllavinë e dikurshme, 18 prill 1996, në: GZ. Nr. C 141/216.

²²⁹ W. Petritsch, K. Kaser, R. Pichler: Kosovo Kosova, Mythen Daten Fakten [Kosova, mite, data, fakte], Klagenfurt etj. 1999, f. 195 v.

3. KSBE/OSBE

Në kuadër të KSBE-së nuk u ndërmor parandalimi i konfliktit, përkatësisht u ndërmor vetëm me gjysmë zemre²³⁰, edhe pse KSBE/OSBE-ja që nga viti 1992 u preokupua me konfliktin shumë asimetrik dhe etno-politik midis Kosovës dhe Serbisë. KSBE-ja që gjendej në një fazë të transformimit u angazhua, duke u nisur nga një takim i ekspertëve për pakicat kombëtare në korrik 1991, si organizata e parë ndërkombëtare në konfliktin e Kosovës dhe e dënoi veprimin e Serbisë në Kosovë. Në vitin 1992 KSBE-ja dërgoi një mision afatgjatë në Kosovë për ndërmjetësim dhe për dokumentim të shkeljeve të drejtave të njeriut, i cili mund të qëndronte në Kosovë vetëm deri në qershor 1993.²³¹ Veç më 1998 u angazhua një mision tjetër vëzhgues i OSBE-së, *Kosovo Verification Mission* (më tutje: MVK), në ndërmjetësimin e konfliktit midis Kosovës dhe Serbisë.²³²

²³⁰ Krah. për këtë Stefan Troebst: Chronologie einer gescheiterten Prävention: Vom Konflikt zum Krieg im Kosovo, 1989 – 1999 [Kronologjia e një prevencioni të dështuar: Nga konflikti deri te lufta në Kosovë, 1989 – 1999], në: Osteuropa 8/1999, f. 777-95; Janine M. Calic: Die Jugoslawienpolitik des Westens seit Dayton [Politika e Perëndimit ndaj Jugosllavisë që nga Dejtoni], në: Aus Politik und Zeitgeschichte, Beilage zur Wochenzeitung Das Parlament, 34/20 gusht 1999, f. 24 vv; Ludwig Steindorff: Der lange Weg zum Kosovo-Krieg [Rruga e gjatë deri te lufta e Kosovës], në: Südosteuropa Mitteilungen 3/1999, f. 194-206, etj.

²³¹ Organet serbe nuk toleruan më praninë e misionit dhe e dëbuan nga vendi në qershor 1993, sepse KSBE-ja suspendoi „ulësen e RFJ-së” në KSBE, pasi që Rezoluta e OKB-së 757 nga 30 maji 1992 Jugosllavinë e kishte përjashtuar nga organizatat ndërkombëtare dhe i kishte shqiptuar sanksione të gjera ekonomike. Krah. J. M. Calic: Die Jugoslawienpolitik des Westens seit Dayton [Politika e Perëndimit ndaj Jugosllavisë që nga Dejtoni], në: Aus Politik und Zeitgeschichte, Beilage zur Wochenzeitung Das Parlament, 34/20 gusht 1999, f. 22 vv. Sqarimi i KSBE-së thoshte se ulësja e Jugosllavisë në KSBE do të suspendohet për shkak të rolit të saj në hapësirën e ish-Jugosllavisë dhe për shkak të shkeljeve të drejtave të njeriut në luftërat e Ballkanit. Me këtë rast parashtruhet pyetje se si mund të suspendohet anëtarësia e një shteti në KSBE, i cili në atë kohë nuk ishte njohur as si shtet pasardhës i RSFJ-së (gjë që Serbia e pretendonte për vete) e as si shtet i sapoformuar, pra nuk ishte shtet anëtar i KSBE-së?! Edhe nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së RFJ-ja e *Milošević-it* as nuk mohojë shprehimisht, e as nuk pranojë si anëtar i plotë me të gjitha të drejtat që i takojnë. Krah. Miodrag Mitić: International Law and the Status of the FR of Yugoslavia in the United Nations, në: Review of the International Affairs, nga 15 shtatori 1998, f. 27-44. Si „[...] iu hap Serbisë së „re” dera për t’u kthyer në bashkësinë ndërkombëtare, ishte gjithsesi pas shembull në historinë e pasluftës së Evropës. [...] ndaj Serbisë [ranë] sanksionet dhe binin premtimet për ndihmë pa asnjë pyetje. Madje nuk u parashtrua as kërkesa për lirim dhe të burgosurve shqiptarë të zhvendosur”, argumenton Viktor Maier: Der Balkan auf dem Prüfstand [Ballkani në pikë prove], në: Internationale Politik – Europa Archiv 3/2001, f. 1.

²³² Krah. S. Troebst: Chronologie einer gescheiterten Prävention: Vom Konflikt zum Krieg im Kosovo, 1989 – 1999 [Kronologjia e një prevencioni të dështuar: Nga konflikti deri te lufta në Kosovë, 1989 – 1999], në: Osteuropa 8/1999, f.780 v.

4. Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Në literaturën rreth konflikteve në hapësirën e dikurshme jugosllave haset vazhdimisht një teori konspirative, e cila pohon se dezintegrimi i Jugosllavisë së dikurshme ka qenë i planifikuar nga shtetet perëndimore, sidomos nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Gjermania²³³. Kjo megjithatë duket plotësisht e paarsyeshme për shkak të faktit se pjesët përbërëse konstitutive, me përjashtim të Serbisë dhe në fillim edhe të Malit të Zi, kurrsesi nuk dëshironin t'i përkisnin një RFJ-je të *Milošević-it* përkatësisht një „Serbie të Madhe” që sa po krijohet. Vetëm atëherë kur Serbia dalloi se nuk mund ta mbizotëronte përgjithmonë Jugosllavinë si tërësi në një formë shtetërore demokratike liberale, ajo lejoi të shkatërrohej Jugosllavia, në mënyrë që mbi rrënojat jugosllave ta ndërtonte Serbinë e Madhe.²³⁴

Ministri i Jashtëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës James BAKER²³⁵ qysh në qershor 1991 udhëheqjes sllovene në Lubjanë ia bëri „me dije hapur se as Shtetet e Bashkuara të Amerikës e as dikush tjetër nuk do ta njihnin ndërkombëtarisht Slloveninë”. Mbi bazë të kësaj, ministri i atëhershëm slloven i mbrojtjes Janes JANŠA supozonte se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë dhënë dritën e gjelbër për një „ndërhyrje të kufizuar të armatosur”, e cila do të duhej të pengonte shkëputjen e Sllovenisë.²³⁶ Ky mesazh dhe mesazhet e tjera të shteteve të huaja nga

²³³ Edhe S. Milošević-i kishte të njëjtën bindje: Ai supozonte në një intervistë të 20 shkurtit 1993 në gazetën Pravda mes tjerash, se zhvillimet më të reja në Ballkan qenqëshin shkaktuar nga ribashkimi i Gjermanisë, e cila paskësh filluar t'i ndëshkojë fituesit e Luftës së Dytë Botërore, dhe shtonte: „Viktima e parë e kësaj politike të revanshizmit ishte ish-Jugosllavia; ajo duhej të shkatërrohej [...] Gjermania qëndronte prapa të gjitha këtyre ngjarjeve.” Cit. sipas Archiv der Gegenwart nga 3 marsi 1993, f. 37627.

²³⁴ Qysh në tetor 1990 CIA paralajmëronte qeveritë e BE-së se S. Milošević-i qëndronte pak para shpërthimit të një lufte civile në Jugosllavi. Kra. Jane M. O. Sharp: Testfall Kosovo. Die westliche Politik auf dem Prüfstand [Rasti testues Kosova. Politika perëndimore në pikën e provës], në: Internationale Politik – Europa Archiv 6/1998, f. 27.

²³⁵ Gjatë vizitës së tij në Beograd më 21 qershor 1991 ministri i atëhershëm i jashtëm amerikan James Baker mbështeste shprehimisht Deklaratën e KSBE-së të miratuar dy ditë më parë në Berlin, në të cilën u mbështetën integriteti territorial dhe demokratizimi i Jugosllavisë.

²³⁶ Kra. Der Standard: Nationalismus löst Kommunismus ab [Nacionalizmi zëvendëson komunizmin], 23/24 qershor 2001, f. 2.

Lidhur me përdorimin e dhunës James Baker në librin e tij: Politics of Diplomacy: Revolution, War and Peace 1989 – 1992, New York 1995 supozon të kundërtën dhe thotë se kryeministrit të atëhershëm jugosllav Ante Marković ia kishte tërhequr vërejtjen për përdorim të dhunës për ruajtjen e kufijve jugosllav. Kra. për këtë edhe Enver Hasani: The dissolution of Yugoslavia and the case of Kosova, Tiranë 2000 si dhe Damir Grubiša: Diplomacija na kraju povjesti [Diplomacia në fund të historisë], Zagreb 1996, f. 91. Me gjasë aktorët përkatës, në këtë rast në radhë të parë Sllovenia, Kroacia dhe Serbia, i kuptuan thëniet e ministrit të jashtëm amerikan ashtu siç iu përshtatej imazhit të tyre. Pas analizave të vëzhguesve të huaj: „Ministri i jashtëm amerikan James Baker [...] inkurajoi me këtë [S. Milošević-in] që të veprohej dhunshëm kundër secesionit të Sllovenisë dhe Kroacisë”. J. M. O. Sharp: Testfall Kosovo. Die westliche Politik auf dem Prüfstand [Rasti testues Kosova. Politika perëndimore në pikën e provës], në: Internationale Politik – Europa Archiv 6/1998.

pushtetmbajtësit në Beograd, që mbanin në duar edhe dizgjinët e armatës, u kuptuan ashtu siç këta donin t'i kuptonin, si dritë të gjelbër për një Jugosllavi të dominuar nga serbët.

Sipas brigadierit ushtarak gjerman dhe diplomatit të OSBE-së Heinz LOQUAI emisari special i ShBA-së për Ballkanin, Robert S. GELBART, më 23 shkurt 1998 zhvilloi biseda me S. MILOŠEVIĆ-in, në të cilat ai UÇK-në e quajti „organizatë terroriste” dhe veprimin e forcave jugosllave të sigurisë „pushtet policor”²³⁷ dhe kështu u lejoj serbëve „[...] të justifikonin veprimet e tyre kundër shqiptarëve të Kosovës si operacione legjitime kundër terrorit.”²³⁸ Se deri ku kjo thënie ishte menduar vërtet kështu me të gjitha pasojat që dolën prej saj, vështirë se mund të thuhet,²³⁹ mirëpo, është e qartë se këtë pushtetmbajtësit në Beograd e kuptuan ashtu siç është interpretuar nga H. LOQUAI, pra se kishin dritë të gjelbër për mënjanimin e „trupit të huaj”, të shqiptarëve të Kosovës, me çdo „çmim”. Kjo thënie dhe thëniet e ish-ministrit të jashtëm amerikan J. BAKER 1991 janë shembuj të mëtejme për *dërgimin e sinjaleve të keqkuptueshme* nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për regjimin e Beogradit.²⁴⁰

²³⁷ Heinz Loquai: Der Kosovo-Konflikt – Wege in einen vermeidbaren Krieg [Konflikti i Kosovës – Rrugët deri te një luftë e shmangshme], Baden-Baden 2000, f. 23. H. Loquai, udhëheqës i grupit të këshilltarëve ushtarakë në përfaqësinë gjermane të OSBE-së në Vjenë 1998/1999, supozon se në Kosovë nuk ekzistonin katastrofa humanitare dhe gjenocidi, por ato u shkaktuan tek përmes ndërhyrjes së NATO-s më 1999! Kra. p.sh.: Gespräch mit Heinz Loquai [Bisedë me Heinz Loquai], në: Blätter für deutsche und internationale Politik 3/2001, f. 293-303. Sipas këtij interpretimi bashkësia ndërkombëtare nuk duhej të ndërmerre asgjë, derisa sipas strategjisë së njohur të S. Milošević-it çdo ditë do të vritej „vetëm” një numër i caktuar i njerëzve dhe do të shkatërroheshin „vetëm” disa vendbanime, ashtu që gjoja nuk erdhi deri te asnjë katastrofë humanitare.

²³⁸ J. M. O. Sharp: Testfall Kosovo. Die westliche Politik auf dem Prüfstand [Rasti testues Kosova. Politika perëndimore në pikën e provës], në: Internationale Politik – Europa Archiv 6/1998, f. 30.

²³⁹ Në lajmet e shtypit ky rast përshkruhet si vijon: „Kështu para gjakderdhjes nga forcat speciale të policisë serbe në rajonin e Drenicës, i dërguari i posaçëm i ShBA-ve për Ballkanin, Robert Gelbard, dha një intervistë, në të cilën ai u deklarua dhe grupimet e armatosura shqiptare i definoi si terroristë. Ai tha: „[ne ...] dënojmë [...] grupin që veten e quan UÇK (Ushtria Çlirimtare e Kosovës) [...]”. Unë i konsideroj se këto janë veprime terroriste dhe është politikë e fortë dhe e vendosur e ShBA-ve për të kundërshtuar plotësisht të gjitha veprimet terroriste dhe të gjitha organizatat terroriste.” Edmond Hajrullahu, „News: Kosova Daily Report #1352” në listën e e-mailave albanews@listserv.acsu.buffalo.edu, 23 shkurt 1998. Pak pas kësaj ai megjithatë deklaroi se „[...] duke e portretizuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si terroriste [...] duhet të hiqet dorë [...] dhe] të tregohet kah pasojat e jo kah shkaqet për situatën e tensionuar në Kosovë”. Wim de Haar, „text USIA on Kosovo” lista e e-mailave albanews@listserv.acsu.buffalo.edu, 7 mars 1998.

²⁴⁰ Kra. Kleine Zeitung, Grac, 4 mars 1998.

II. Skicë e aspekteve ndërkombëtare të luftës në Kosovë më 1999

„Për paqen. Kundër luftës. Kush nuk do të ishte për këtë? Mirëpo, si mund të ngelen pa luftë ata që janë të vendosur për gjenocid?”²⁴¹

Problemi i Kosovës u reduktua nga bashkësia ndërkombëtare në një problem të drejtave të njeriut, edhe pse në radhë të parë paraqiste një konflikt për të drejtat politike të Kosovës dhe se veç si pasojë e tij pasuan shkeljet e të drejtave të njeriut. Pasi që bashkësia ndërkombëtare ishte e lidhur ngushtë me parimin e „*sovrانيتيت dhe integritetit territorial të Jugosllavisë*” mbi Kosovën, edhe çështja e Kosovës do duhej zgjidhur brenda Serbisë si një çështje e të drejtave të pakicave.²⁴² Kjo mënyrë vështrimi i mundësoi regjimit serb të terrorit në Kosovë që të justifikohet me gjoja sovranitetin e ligjshëm të Serbisë mbi Kosovën.

Për një mundësi tjetër të interpretimit të konfliktit na udhëzon J. MARKO:

„Në qoftë se i bashkohemi kësaj pikëpamjeje të një ballafaqimi të dy sovraniteteve jokompatibile, atëherë konflikti merr menjëherë një dimension krejt tjetër: Në këtë rast bëhet fjalë për një konflikt ndërkombëtar midis dy shteteve me të gjitha pasojat sipas të drejtës ndërkombëtare që dalin prej tij.”²⁴³

Kjo pikëpamje njih të drejtën e vetëvendosjes dhe të vetëmbrojtjes së kosovarëve. Më pas mund të pohohet pyetja se a do ta kishte sjellë një përfundim më të hershëm të gjenocidit në Kosovë një njohje e kësaj të drejte të vetëvendosjes dhe të vetëmbrojtjes së kosovarëve nga ana e bashkësisë ndërkombëtare dhe para së gjithash një reaksion më i shpejtë ushtarak i NATO-s. Një njohje e tillë do ta kishte mënjeluar edhe çdo dyshim rreth legalitetit të operacionit të NATO-s „Allied Force” (24 mars – 10 qershor 1999) sipas të drejtës ndërkombëtare.

²⁴¹ S. Sontag: Das einundzwanzigste Jahrhundert begann in Sarajevo. Von Italien aus gesehen: Keine Hoffnung auf ein schnelles Ende des Kosovo-Krieges [Shekulli njëzetënjë filloi në Sarajevë. Shikuar nga Italia: Nuk ka shpresa për një përfundim të shpejtë të luftës në Kosovë], në: Frank Schirmacher (ed.): Der westliche Kreuzzug: 41 Positionen zum Kosovo-Krieg [Kryqëzata perëndimore: 41 pozita rreth luftës në Kosovë], Stuttgart 1999, f. 68.

²⁴² Përmes kësaj që nga fillimi ishte e përjashtuar njohja ndërkombëtare e të drejtës së garantuar me kushtetutë dhe të vullnetit të shpallur në mënyrë demokratike e kosovarëve për një formë të pavarur të shtetit.

²⁴³ J. Marko: „Kosova Republikë!” Zwischen Recht und Moral [„Kosova Republikë! Midis të drejtës dhe moralit], në: Skënder Gashi, Lothar Classen (ed.): Dardania. Das Selbstbestimmungsrecht der Kosovaren [Dardania. E drejta e kosovarëve për vetëvendosje], vëll. 2, Vjenë 2001, f. 79.

1. Interpretimet sipas të drejtës ndërkombëtare të të drejtës së secesionit dhe të intervenimit humanitar

Në literaturën e publikuar në vitet e fundit mbi Kosovën gjenden dy *pozicione të kundërta*, përkatësisht dy *shkolla mendimi*, të cilat merren me interpretimin e të drejtës për vetëvendosje të jashtme në rastin e Kosovës dhe me çështjen e lidhur me të për të drejtën ose madje detyrimin për intervenim humanitar. Këto dy shkolla mendimi dallojnë në këto pikë:

- a) Shkolla e parë e mendimit mohon të drejtën e secesionit edhe atëherë kur ajo mund të ushtrohet *ultima ratio*. Në rastin e Kosovës, sipas këtij interpretimi mungojnë si konteksti i dekolonizimit ashtu edhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, të cilat nuk kanë marrë atë përmasë të njëjtë si në Afrikë. Vetëm në rastin ekstrem kjo shkollë e mendimit e njeh mossanksionimin e intervenimit humanitar, i cili sipas këtij interpretimi është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.
- b) Shkolla e dytë e mendimit në anën e kundër njeh mundësinë e një secesioni si *ultima ratio* të një të drejte të vetëvendosjes së jashtme. Ngaqë në rastin e Kosovës shikohet si e përmbushur tërësia e veprave të *gjenocidit* (neni II i Konventës së gjenocidit), të *krimin kundër njerëzimit* si dhe të *shkeljeve të Konventës së Gjenevës* (si tërësi e veprës penale sipas të drejtës ndërkombëtare edhe në statutin e Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë), atëherë njihet e drejta e kosovarëve për secesion.

Disa autorë këto „drejtime të mendimeve” divergjente i interpretojnë edhe si një konflikt mes *institucionalizmit* dhe *realizmit*.²⁴⁴ Nga këndvështrimi politologjik, sipas mendimit tim, përfaqësuesit e të dy drejtimeve të mendimeve mund të karakterizohen edhe si vijon:

- a) „*Dogmatikët e sovranitetit sipas të drejtës ndërkombëtare*”, të cilët me çdo çmim qëndrojnë për sovranitetin e shtetit, edhe kur ky kryen krime të rënda kundër njerëzimit, si p.sh. vrasje e organizuara nga shteti ose „spastrimet etnike”, e madje i vlerëson si legjitime edhe sistemet e shteteve diktatoriale²⁴⁵
- b) „*Pragmatikët e të drejtës ndërkombëtare*”, të cilët me vetëdijen se çdo sistem juridik kombëtar ose mbikombëtar në fund të fundit duhet të shërbejë për garantimin e sigurisë private dhe publike dhe të dinjitetit njerëzor në kuptimin

²⁴⁴ Krah. për shembull Heinz-Jürgen Axt: Internationale Implikationen des Kosovo-Krieges: wertorientierte Realpolitik statt Konfliktbearbeitung in Institutionen [Implikimet ndërkombëtare të luftës së Kosovës: real-politika e orientuar në vlera në vend të përpunimit të konfliktit në institucione], në: Südosteuropa 1-2/2000, f. 68 vv.

²⁴⁵ Lidhur me luftën në Kosovë më 1998 – 1999 këtë mendim politik e interpretojnë para së gjithash RFJ-ja e *Milošević-it*, Iraku, Kina, Rusia dhe Bjellorusia.

liberal të sundimit të ligjit, përpiqen të veprojnë në kuptimin e këtyre vlerave. Me këtë rast njihet dhe respektohet sovraniteti i shteteve, por sidomos të drejtat fundamentale të njeriut, si p.sh. e drejta për jetë, duhet të kenë përparësi përballë sovranitetit të shtetit.²⁴⁶

Në përgjithësi duket se problematika e të drejtës ndërkombëtare që ekziston për çështjen e Kosovës, mund të zgjidhet vetëm përmes zhvillimit të mëtejshëm të të drejtës ekzistuese ndërkombëtare në frymën e *pandashmërisë së të drejtave të njeriut*. Ekzistenca dhe palëkundshmëria e të dyja kundërpozitave paralajmëron më shumë një përshtatje të gjatë të të drejtës ndërkombëtare ndaj kësaj sfide, që është njëra prej sfidave më të mëdha të shek. XXI.

2. Qëndrimi i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe i operacionit të NATO-s „Allied Force”

„Kështu ishte dhe mund të jetë që gjenocidi të ndodhë pothuajse nën mbrojtjen e Kartës, sepse organi »kryesor përgjegjës« i OKB-së nuk ka dëshirë të vëzhgojë ose të veprojë, respektivisht përkundër vullnetit të tij që të vëzhgojë dhe të veprojë, bllokohet vetë nëpërmjet një vetoje të kanosur ose faktike.”²⁴⁷

2.1. Qëndrimi i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

„Dogmatikët e sovranitetit sipas të drejtës ndërkombëtare”, në mesin e tyre Kina dhe Rusia, bllokuan Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (më tutje: KS), kur ishin të nevojshme masa konkrete ndërkombëtare për ndërprerjen e konfliktit të Kosovës. Kjo mund të interpretohet si keqpërdorim i të drejtës së vetos në KS nga ana e Kinës dhe Ruisë për interesat e shtetit të tyre dhe në disfavor të paqes dhe të stabilitetit në Ballkan.

Sjellja e Kinës dhe e Ruisë në KS rezultonte në kundërshtim me detyrimet nga Karta e OKB-së: Sipas nenit 2 numri 2 të gjitha shtetet anëtare të OKB-së përmbushin „në mirëbesim të gjitha detyrimet që ata marrin përsipër me anë të Kartës, me qëllim që të sigurojnë të drejtat dhe privilegjet që u takojnë nga

²⁴⁶ Lidhur me luftën e Kosovës në këtë grup mund të numërohen pak a shumë të gjitha shtetet, të cilat qeverisen në kuptimin e një demokracie perëndimore liberale pluraliste.

²⁴⁷ Dieter Senghaas: Recht auf Nothilfe [E drejta për ndihmë emergjente], në: Reinhard Merkel (ed.): Der Kosovo-Krieg und das Völkerrecht [Lufta e Kosovës dhe e drejta ndërkombëtare], Frankfurt am Main 2000, f. 107.

anëtarësia”, gjë që vlen edhe për anëtarët e KS-së dhe në masë të posaçme për anëtarët me të drejtë vetoje.²⁴⁸

Fakti se KS-ja në konfliktin e Kosovës dështoi në *pikëpamje praktike*, çoi deri te dobësimi i OKB-së si zotëuese e monopolit për përdorimin e dhunës midis subjekteve të të drejtës ndërkombëtare. KS-ja kishte mundur *teorikisht* të reagoonte ndryshe mbi bazën e të drejtës ndërkombëtare, duke marrë parasysh krimet e organizuara prej shtetit, që po i kryente Serbia në Kosovë që nga tetori 1997, e që u ashpërsuan nga marsi 1998. Më së voni me Rezolutën e OKB-së 1160 (1998), e cila parashihte masa në rast të kërcënimit ose shkeljes së paqes dhe në rast të veprimeve sulmuese (Kreu VII i Statutit të OKB-së), konflikti nuk perceptohej më si çështje krejtësisht e brendshme e një shteti.

2.1.1. Rezoluta e KS-së 1160 (1998) e 31 marsit 1998

Qysh në Rezolutën e OKB-së 1160 të marsit 1998, KS-ja nisej nga zbatimi i Kreut VII të Statutit të OKB-së, pra nga masat në rast të kërcënimit ose të shkeljes së paqes, si dhe në rast të veprimeve sulmuese. Në bazë të kësaj, KS-ja kërkonte në këtë rezolutë nga RFJ-ja e *Milošević-it*, që menjëherë të ndërmerre hapat e mëtejme të nevojshëm për ta gjetur një zgjidhje politike të çështjes së Kosovës nëpërmjet dialogut. Përveç kësaj, KS-ja kërkonte nga TPNj-ja shprehimisht që të fillonte me grumbullimin e informatave lidhur me veprimet e dhunshme në Kosovë (pika 17). Në fund KS-ja urdhëronte udhëheqësinë e shqiptarëve të Kosovës që t’i dënonte të gjitha veprimet terroriste dhe theksonte se të gjitha pjesët e grupit etnik të shqiptarëve të Kosovës qëllimet e tyre duhej t’i ndiqnin vetëm me mjete paqësore.

²⁴⁸ Krah. rreth kësaj Armin A. Steinkamm: *Völkerrecht, Humanitäre Intervention und Legitimation des Bundeswehr-Einsatzes, Völker- und wehrrechtliche Aspekte des Kosovo-Konflikts 1999* [E drejta ndërkombëtare, intervenimi humanitar dhe legjitimimi i angazhimit të ushtrisë gjermane, aspektet e të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës ushtarake të konfliktit të Kosovës në vitin 1999], në: *Südosteuropa* 5-6/2000, f. 234 vv. I njëjti referat është publikuar edhe te: Jens Reuter, Konrad Clewing (ed.): *Der Kosovo Konflikt – Ursachen, Verlauf, Perspektiven* [Konflikti i Kosovës – shkaqet, rrjedha, perspektivat], Klagenfurt etj. 2000, f. 335 vv.

2.1.2. Rezoluta e KS-së 1199 (1998) e 23 shtatorit 1998

Fakti që spiralja e dhunës në Kosovë sillej më tutje dhe që kishte afro 300.000 refugjatë e dhjetëra mijëra njerëz që jetonin nën qiellin e hapur, e nxiti KS-në që ta miratonte Rezolutën e OKB-së 1199 nga 23 shtatori 1998. Kjo rezolutë konstaton shprehimisht se përmasa e përkeqësimit të gjendjes në Kosovë paraqiste *një kërcënim serioz për paqen dhe sigurinë në rajon dhe tregon për përdorimin eksisiv dhe pa dallim të dhunës nga ana e forcave serbe të sigurisë dhe e armatës jugosllave*. Më tutje KS-ja kërkonte edhe një herë ndërprerjen e menjëhershme të armiqësive si dhe rifillimin e bisedimeve negociuese konstruktive.

2.1.3. Rezoluta e KS-së 1203 (1998) e 24 tetorit 1998

Rezoluta e OKB-së 1203 (1998) paraqiste njërën prej përpjekjeve të fundit që konflikti megjithatë ende të ndalej në mënyrë „paqësore”. Rezoluta e miratuar nga KS-ja më 24 tetor 1998 përmbante një paralajmërim të qartë dhe të pakeqkuptueshëm për RFJ-në e *Milošević-it* që t'i përmbahej Rezolutës së OKB-së, si dhe — në rast se Beogradi nuk lëshonte pe — kërcënimin me sulme të mundshme ajrore nga ana e NATO-s.

2.2. Operacioni i NATO-s „Allied Force”

Ngjarjet në Kosovë dhe rreth Kosovës që çuan te intervenimi i NATO-s më 24 mars 1999, do të paraqiten në vijim.

2.2.1. Ngjarjet në prag të operacionit të NATO-s „Allied Force”

Më 8 tetor 1998, Këshilli i NATO-s aprovoi planet operacionale për një ndërhyrje të mundshme ushtarake në Kosovë, nevoja e të cilit u arsyetua si vijon:

- RFJ-ja e *Milošević-it* nuk i kishte përmbushur ende kërkesat urgjente të bashkësisë ndërkombëtare përkundër dy rezolutave të KS-së, 1160 nga 31 marsi 1998 dhe 1199 nga 23 shtatori 1998, që mbështeteshin në Kreun VII të Kartës së OKB-së.
- Raporti tejet i qartë i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së rreth dy rezolutave të KS-së kishte paralajmëruar mes të tjerash edhe për rrezikun e një katastrofe humanitare në Kosovë.
- Gjendja e keqe humanitare vazhdonte e pandryshuar për shkak të refuzimit të RFJ-së së *Milošević-it* që të ndërmernte masa për zgjidhje paqësore.
- Në një të ardhme jo të largët nuk pritej ndonjë rezolutë e mëtëjshme e KS-së, e cila do të përmbante masa detyruese lidhur me Kosovën.

- Rezoluta e OKB-së 1199 (1998) konstatonte në mënyrë të pakeqkuptueshme se përmasa e përkeqësimit të gjendjes në Kosovë paraqiste një kërcënim serioz për paqen dhe sigurinë në rajon.

Sekretari i atëhershëm i përgjithshëm i NATO-s Javier SOLANA deklaroi më tej se në këtë gjendje të jashtëzakonshme të krizës në Kosovë, siç përshkruhet në Rezolutën e OKB-së 1199 (1998), është i justifikueshëm kërcënimi me përdorim, e eventualisht edhe përdorimi i forcës nga ana e NATO-s. Aleanca kishte vendosur që ta mënjanonte shfaqjen e nevojave urgjente humanitare duke përdorë forca të armatosura.²⁴⁹

Më 16 tetor 1998 në Beograd u lidh një marrëveshje midis RFJ-së së *Milošević-it* dhe OSBE-së lidhur me vendosjen e MVK-së, me të cilën RFJ-ja e *Milošević-it* qartazi obligohej t'i respektonte rezolutat e OKB-së 1160 (1998) dhe 1199 (1998). NATO-ja ishte e përfshirë përmes krijimit të një misioni verifikues me mbështetje ajrore si plotësim i MVK-së. Planet operative të aprovuara paraprakisht më 8 tetor 1998 nga Këshilli i NATO-s për një intervenim të mundshëm ushtarak në Kosovë ishin shkaku vendimtar për pëlqimin e S. MILOŠEVIĆ-it që të lidhte marrëveshjen për vendosjen e MVK-së. Përmes këtij lëshimi pe të S. MILOŠEVIĆ-it, NATO më 27 tetor 1998 tërhoqi kërcënimin me sulme ajrore.

Mirëpo, lufta në Kosovë vazhdoi, ndërsa plani serb për „qërimin përfundimtar të hesapeve me shqiptarët e Kosovës” po rafinohej gjithnjë e më shumë duke e arritur kulmin me të ashtuquajturin aksion „Patkoi” (në serbishte i njohur si „Potkova”).²⁵⁰

²⁴⁹ Krah. për këtë A. A. Steinkamm: Völkerrecht, Humanitäre Intervention und Legitimation des Bundeswehr-Einsatzes, Völker- und wehrrechtliche Aspekte des Kosovo-Konflikts 1999 [E drejta ndërkombëtare, intervenimi humanitar dhe legjitimimi i angazhimit të ushtrisë gjermane, aspektet e të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës ushtarake të konfliktit të Kosovës në vitin 1999], në: Südosteuropa 5-6/2000, f. 229 vv.

²⁵⁰ Krah. rreth kësaj dosjeje e publikuar të letrës sekrete të Zyrës austriake informative ushtarake (HnaA), në: Profil, 10 prill 2000, ku mes tjerash thuhet: „[...] 29.1.99: „dalohet plani për spastrimin etnik në sipërfaqe të madhe. Përcaktohen forcat që do të marrin pjesë në të” 3.2.99: „Përgatitjet ngadalësohen për shkak të negociatave vijuese në Rambuje, që të mos bëhen publike gjatë negociatave” [...] 23.2.99: „Fillimi i aksionit caktohet për kohën mes 25.2.99 dhe 25.3.99.” [...] Analistët të Zyrës Informative Ushtarake tërhoqin konkluzionin: „Rrjedha e tërësishme tregon qartë se operacioni Potkova nuk ishte pasojë e sulmeve ajrore të NATO-s.” Krah. edhe Frankfurter Allgemeine Zeitung, 22 prill 1999 „Dëbimi i shqiptarëve të Kosovës me „operacionin Patkoi””.

Në një kongres ekspertësh të organizuar nga Instituti për Sigurimin Ndërkombëtar të Paqes pranë Akademisë austriake për Mbrojtje të Vendit në Rajhenau [Reichenau], koloneli i pensionuar Dragan Vuksić, ish-atashe ushtarak jugosllav në Bon dhe bashkëpunëtor i shefit të Shtabit të Përgjithshëm Momčilo Perišić të shkarkuar nga S. Milošević-i, tha mes tjerash: „Milošević-i shkarkoi [...] kritikët e tij në majën e ushtrisë dhe i zëvendësoi ata me njerëz besnikë, të cilët menjëherë i premtuan një sukses të shpejtë të „operacionit Patkoi”, të „zgjidhjes” së çështjes shqiptare në Kosovë përmes dëbimeve masive.” Krah. Die Presse, 20 mars 2000.

Eksperti ushtarak austriak Walter FEICHTINGER, operacionin serb „Patkoi” e përshkruan si vijon:

„Në tërësi mund të konstatohej se efikasiteti i operacionit „Patkoi” kundër Ushtrisë Çlirimtare u zvogëlua në mënyrë suksesive si pasojë e sulmeve të drejtpërdrejta ajrore të NATO-s, ndikimeve të tyre të tërthorta si mungesa e karburanteve, problemeve në komunikim, moralit në rënie e sipër etj. si dhe sulmeve të shtuara të UÇK-së. Në anën tjetër, aktivitetet e dëbimit vazhduan deri në ndërprerjen e luftimeve më 9.6.1999; ato nuk mund të ndaleshin menjëherë përmes operacioneve ajrore, por në rastet më të mira mund të frenoheshin”.²⁵¹

Pas marrëveshjes për krijimin e MVK-së, RFJ-ja e *Milošević-it* grumbulloi gjithnjë e më shumë trupa në Kosovë në kuadër të aksionit „Patkoi” dhe intensifikoi sulmet kundër popullatës civile. Kjo taktikë e S. MILOŠEVIĆ-it që në njërin anë të negocionte, të bënte lëshime përballë bashkësisë ndërkombëtare dhe njëkohësisht në anën tjetër ta vazhdonte luftën me intensitet të pafrenuar e të lartë dhe me këtë ta binte bashkësinë ndërkombëtare para fakteve të kryera, ishte evidente qysh gjatë luftërave në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë. Ky *dërgim sinjalesh të ngatërruara të bashkësia ndërkombëtare* nga ana e Serbisë ishte me gjasë i fundit para sulmeve ajrore të NATO-s.

Meqë situata dukej se nuk po gjente zgjidhje as me mjete paqësore e as me mjete ushtarake përmes luftimit midis njësiteve ushtarake dhe paramilitare serbe dhe UÇK-së, NATO-ja vendosi ta përfundonte katastrofën e vazhdueshme humanitare në Kosovë.²⁵²

Sulmet ajrore të NATO-s filluan më 24 mars 1999 kundrejt këtij sfondi:

- RFJ-ja e *Milošević-it* kishte shpërfillur të gjitha rezolutat e KS-së së OKB-së.
- Konferencat paqësore në Rambuje dhe Paris kishin dështuar për shkak të mosnënshkrimit nga ana e delegacionit serb, edhe pse vëmendje shumë e fortë i ishte dhënë dëshirave serbe²⁵³, përkatësisht marrëveshja ishte orientuar fort sipas „interesave serbe”.

²⁵¹ Walter Feichtinger: Die militärstrategische und operative Entwicklung im Konfliktverlauf [Zhvillimi strategjik ushtarak dhe operativ në rrjedhën e konfliktit], në: Erich Reiter (ed.): Der Krieg um das Kosovo 1998/99 [Lufta për Kosovën 1998/99], Mainz 2000, f. 114.

²⁵² Numri i viktimave të sulmeve serbe ndaj popullatës shqiptare të Kosovës në kohën mes shkurtit 1998 dhe qershorit 1999 u vlerësua me rrafsh 12.000 civilë. Shumica e këtyre të vrarëve ishin në javët e sulmeve ajrore të NATO-s, gjë që duhet të interpretohet si hakmarrje e qëllimtë kundër popullatës civile. Kra. Die Presse, 24 qershor 2000, f. 6.

²⁵³ Shumë indice tregojnë se Beogradi qysh moti ishte i vendosur për opsionin ushtarak dhe negociatat i zhvillonte më tej më tepër në dukje. Kra. rreth kësaj për shembull Gerhard Jandl: Der Kosovokonflikt – mögliche und wahrscheinliche Verhandlungslösungen [Konflikti

- Krimi i organizuar nga shteti u vazhdua me intensitet të pazvogëluar.
- Bashkësia ndërkombëtare ishte praktikisht e detyruar të intervenonte për të mos e humbur krejtësisht kredibilitetin e saj.

2.2.2. Sqarime rreth legalitetit dhe legjitimitetit të operacionit të NATO-s „Allied Force”

Në literaturë pjesërisht përfaqësohet teza se NATO-ja e ka sulmuar RFJ-në e Milošević-it më 24 mars 1999 vetëm për arsye se një interes të tillë e kanë pasur të ashtuquajturit „agresorë të NATO-s” dhe industria e armatimit. Kjo tezë nuk është e qëndrueshme, nëse merren parasysh paralajmërimet e shumëhershme nga ana e bashkësisë ndërkombëtare lidhur me krimet e luftës të kryera në Kosovë. Fundja NATO-ja përmes luftës në Kosovë i dha fund edhe diktaturës së mbrame klasike në Evropë. Se me atë rast mund të ketë përfituar edhe industria e armëve, kjo nuk do të thotë njëkohësisht se kjo industri dhe NATO-ja ishin shkaktarët e luftës.

Përkritazi me legjitimitetin e ndërhyrjes ushtarake të NATO-s në Kosovë është për t’u përmendur fakti se KS-ja disa herë shqiptoi paralajmërimet kundrejt RFJ-së së

i Kosovës – zgjidhje të mundshme dhe me gjasë të negociatave], në: Henriette Riegler (ed.): Der Kosovokonflikt – Bestandsaufnahme und Lösungsszenarien [Konflikti i Kosovës – regjistrimi i gjendjes dhe skenarët e zgjidhjes], OIIP Vjenë 2000, f. 2 vv; Karl Kaser: Die Verhandlungen in Rambouillet und Paris: Die Frage der Souveränität Jugoslawiens und der Unabhängigkeit für Kosovo [Negociatat në Rambuje dhe Paris: Çështja e sovranitetit të Jugosllavisë dhe e pavarësisë së Kosovës], në: Südosteuropa 1-2/2000, f. 55 vv; Wolfgang Petritsch: Die Blutspur ist nach Belgrad zurückgekehrt [Gjurma e gjakut është kthyer në Beograd], në: Der Standard – Beilage/Album, 25 mars 2000, f. 4. Si insajder i negociatave të Rambujes W. Petritsch shkruan për kritikën e Noam Chomsky për veprimin e Perëndimit në konfliktin e Kosovës (The New Military Humanism. Lessons from Kosovo, Monroe 1999): „Chomsky qëndron në një vijë me shumë kritikë evropiane që [vijën ...] nga sfera e majtë, anti-ushtarake si dhe nga sfera e djathtë, nacionale. Për herë të parë, në një grindje ironike të historisë kjo gjurmë e gjakut është kthyer në vetë Beograd, aty, ku qëndron pikënisja e tragjedisë së tanishme. [...] Vazhdimisht flitet për një ultimatum të Rambujes që iu prezantua serbëve. Kjo nuk është e saktë [...]. Duhet të thuhet rreth kësaj se Marrëveshja e Rambujes për Evropën në mënyrë unike ka përcaktuar të drejtat e grupeve etnike. Dhjetë për qind serbëve iu dhanë 40 për qind të drejtash politike”.

J. Marko: „Kosova Republikë!” Zwischen Recht und Moral [„Kosova Republikë! Midis të drejtës dhe moralit], në: Skënder Gashi, Lothar Classen (ed.): Dardania. Das Selbstbestimmungsrecht der Kosovaren [Dardania. E drejta e kosovarëve për vetëvendosje], vëll. 2, Vjenë 2001, f. 78 argumenton rreth kësaj nga këndvështrimi i të drejtës ndërkombëtare si vijon: „Përmes nënshkrimit të marrëveshjes së përkohshme të Rambujes, e cila do të kishte parashikuar një vetëqeverisje të gjerë, ndërkombëtarisht të siguar për Kosovën brenda Republikës Federale të Jugosllavisë, nga ana e shqiptarëve të Kosovës këta i kanë shterur fundja të gjitha mundësitë për arritjen e një të drejte të brendshme të vetëvendosjes, ashtu që para së gjithash edhe duke marrë parasysh agresionin çjerëzor të regjimit serb përkatësisht jugosllav nuk ekziston asnjë detyrim i mëtejmi i kosovarëve sipas të drejtës ndërkombëtare se duhej të kënaqeshin edhe me vetëm çfarëdo lloj forme të së drejtës së brendshme të vetëvendosjes.”

Milošević-it që t'u përmbahej të drejtave themelore të njeriut në Kosovë. Meqë këto paralajmërimet nuk po jepnin asnjë rezultat, përdorimi i dhunës nga ana e NATO-s duhet parë si *ultima ratio* për përfundimin e spirales së dhunës. Për këtë ekzistonte miratim i gjerë brenda bashkësisë ndërkombëtare, qoftë nga ana e shteteve të mëdha të BE-së, qoftë edhe nga shumica e shteteve anëtare të Këshillit të Sigurimit. Ky miratim shprehej p.sh. në refuzimin e kërkesës për dënimin e operacioneve ajrore të NATO-s në KS të OKB-së.²⁵⁴ Përveç kësaj, kërkesat politike të NATO-s drejtuar S. MILOŠEVIĆ-it u përkrahën nga OKB-ja: NATO kërkoi nga RFJ e *Milošević-it* që t'i ndërpriste operacionet ushtarake në Kosovë, t'i tërhiqte forcat policore dhe ushtarake serbe nga Kosova, ta lejonte stacionimin e KFOR-it, kthimin pa kushte të refugjatëve dhe të dëbuarve, qasjen e organizatave bamirëse si dhe të lidhte një marrëveshje paqësore mbi bazën e Marrëveshjes së Rambujesë. Më tutje, NATO përmbushi të gjitha kriteret që Parlamenti Evropian donte t'i dinte si të respektuara për një intervenim humanitar.²⁵⁵

Fundja ndërhyrja ushtarake e NATO-s në Kosovë, edhe pse pa mandatin eksplisit të KS-së, u krye qartazi në mbështetje të tri rezolutave të OKB-së nga viti 1998 dhe për përfundimin e akteve të dhunshme kriminale të organizuara nga shteti i RFJ-së së *Milošević-it*, të cilat madje ishin dënuar nga OKB-ja. Kjo tregohet edhe në rezolutat e OKB-së 1239 nga 14 maji 1999 dhe 1244 nga 10 qershori 1999, të aprovuara gjatë dhe menjëherë pas intervenimit të NATO-s.

Në rastin e Kosovës u realizua prova e veprës penale ndërkombëtare të „kriminalit kundër njerëzimit” (*crime against humanity*), e cila sipas nenit 7 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar Penal nga viti 1998 përfshin të „gjitha veprimet” që „përdoren si pjesë e një sulmi sistematik kundër çfarëdo popullsie civile”. Këtu bëjnë pjesë mes tjerash vrasja, shfarosja, dëbimi, tortura, shtatzënia e imponuar si dhe të gjitha format e dhunës seksuale. Secili nga këto krime ka ndodhur në rastin e

²⁵⁴ Kështu projekt-rezoluta e parashtruar nga Bjellorusia më 26 mars 1999, e cila sulmet ajrore të NATO-s i kishte shpallur se ishin në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, u refuzua në KS-në e OKB-së me vetëm 3 vota për dhe 12 vota kundër.

²⁵⁵ Vendim rreth të drejtës për intervenim për arsye humanitare, në: GZ. Nr. C 128 nga 9 maji 1994, f. 225, e cila thotë:

„[...] pushtetmbajtësit nuk mund të bihen në vete në mënyra të tjera përpos me mjete ushtarake [regjimi i Beogradit ishte një rast i tillë], [...] duhet të jetë e sigurt se aparati i OKB-së nuk është në gjendje të reagojë me kohë më mënyrë efektive [KS-ja ishte në një pozitë të tillë për shkak të politikës së Rusisë dhe Kinës], [...] të gjitha përpjekjet e tjera për zgjidhje [...] duhet të jenë shterur dhe të kenë mbetur të pasuksesshme [të gjitha përpjekjet për të ardhur deri te një zgjidhje me marrëveshje kishin dështuar për shkak të rezistencës së Beogradit], [...] mbrojtja e të drejtave të njeriut duhet të jetë objektivi kryesor [sa i përket NATO-s ishte ky rast]”. Krahu rreth kësaj, Armin A. Steinkamm, *Völkerrecht, Humanitäre Intervention und Legitimation des Bundeswehr-Einsatzes, Völker- und wehrrechtliche Aspekte des Kosovo-Konflikts 1999* [E drejta ndërkombëtare, intervenimi humanitar dhe legjitimitimi i angazhimit të ushtrisë gjermane, aspektet e të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës ushtarake të konfliktit të Kosovës në vitin 1999], në: *Südosteuropa* 5-6/2000, f. 241 v.

Kosovës. Këto norma të ndalimit nga disa autorë interpretohen si *jus cogens*, si e drejtë e detyrueshme ndërkombëtare²⁵⁶; në mendimin dërrmues të të drejtës ndërkombëtare justifikojnë gjithsesi ushtrimin e vetëmbrojtjes.

Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Kofi ANNAN, më 30 mars 1999 në UNHCR, Daily Highlights, veprimet serbe në Kosovë i quajti „fushatë sistematike e spastrimit etnik nga ushtria serbe dhe grupet paramilitare në Kosovë”. Pak më vonë, më 9 prill 1999 në Gjenevë ai deklaroi: „Ndodhemi nën renë e errët të krimit të gjenocidit”, dhe shtoi se Këshilli i Sigurimit nuk guxon të bëhet një strehimore për ata që nën pretekstin e sovranitetit ndërmarrin shkeljet më të këqija kundër të drejtave të njeriut.²⁵⁷

Operacionet ajrore fituan më vonë një legjitimitet politik prej akuzimit të S. MILOŠEVIĆ-it nga ana e TPNJ-së, krijimin e të cilës e kishin përkrahur Kina dhe Rusia (që kishin penguar mbështetjen eksplicite të ndërhyrjes së NATO-s në KS) dhe për mbështetjen e të cilit, si ironi e historisë, në procesin e Dejtonit ishte obliguar edhe aparati shtetëror i S. MILOŠEVIĆ-it.

Juristi Ulrich K. PREUSS në lidhje me legjitimitetin dhe legalitetin e intervenimit në Kosovë pretendon si vijon:

„Aksionet e NATO-s në Jugosllavi paraqesin përpjekjen që duke u thirrur në legjitimitetin e një morali universal të relativizohet legaliteti i rendit ekzistues sipas të drejtës ndërkombëtare: përmes kësaj ai së paku përkohësisht shfuqizohet. Se ndërhyrja humanitare nuk mundi ta shmangte katastrofën, e ndoshta atë madje edhe e ashpërsoi, natyrisht nuk është argument kundër lejueshmërisë së saj, sidomos jo kundër denjësisë së respektimit të impulsit moral që qëndron prapa kësaj.”²⁵⁸

Edhe J. SOLANA thekson, pas luftës në Kosovë „[...] se një hap i tillë ishte zgjidhja e vetme e mundshme. Mirëpo, njëkohësisht ishte e qartë se një hap i tillë

²⁵⁶ Kra. rreth kësaj për shembull, Peter Fischer: Der gerechte Krieg um Kosovo [Lufta e drejtë në Kosovë], në: Zeitung der Universität Wien, Die Universität [Gazeta e Universitetit të Vjenës, Universiteti], Vjenë qershor 1999, f. 15.

²⁵⁷ Kra. A. A. Steinkamm, Völkerrecht, Humanitäre Intervention und Legitimation des Bundeswehr-Einsatzes, Völker- und wehrrechtliche Aspekte des Kosovo-Konflikts 1999 [E drejta ndërkombëtare, intervenimi humanitar dhe legjitimimi i angazhimit të ushtrisë gjermane, aspektet e të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës ushtarake të konfliktit të Kosovës në vitin 1999], në: Südosteuropa 5-6/2000, f. 242. Kra. deklarata të mëtejme të K. Annan në lidhje me krimet e kryera në Kosovë, në të cilat mes tjerash fjala është për „vrasjet masive të civilëve në Kosovë”, në: UN Doc. S/1998/192 nga 3 tetori 1998 dhe UN Doc. S/1999/293 nga 17 mars 1999; Më tutje krahaso rreth kësaj „Deklaratën e Këshillit Evropian për Kosovën” dhe sqarime, deklarime etj. të shumta të publikuara në lidhje me këtë, në: Internationale Politik – Europa Archiv 5/1999, Dokumentation/Dokumente zum Konflikt auf dem Balkan [Dokumentacion/dokumente rreth konfliktit në Ballkan].

²⁵⁸ Ulrich K. Preuß: Zwischen Legalität und Gerechtigkeit [Mes legalitetit dhe drejtësisë], në: Blätter für deutsche und internationale Politik 7/1999, f. 828.

duhej të ishte përjashtim nga rregulla dhe jo përpjekje për krijimin e një të drejte të re ndërkombëtare.”²⁵⁹

Juristi Herbert F. KÖCK përshkruan në një çiltërsi të rrallë diskursin shkencor rreth kundërshtimeve juridike dhe politike kundër intervenimit të NATO-s:

„[...] pikërisht këtu vlen fjala e urtë e vjetër se me pasë njohuri është mirë, por me pasë ndërgjegje është më mirë. Që ta jetosh ndërgjegjen kërkohet megjithatë herë pas here guxim; prandaj shumë intelektualë e urrejnë sot NATO-n, meqë nëpërmjet intervenimit në Kosovë janë vënë vetë në një situatë (gati) ekzistenciale të vendimit, në të cilin prej tyre kërkohet diçka si pohim personal, një *aktbetim moral*. Kjo i demaskon ata dhe mungesën e guximit të tyre moral.”²⁶⁰

Se dy shtete anëtare me të drejtë vetoje në KS *nuk iu përgjigjën detyrimeve* për të vepruar në përputhje me Kartën e OKB-së, nuk i përshtatet sigurisht idesë së të drejtave të njeriut dhe obligimeve të shteteve, edhe nëse një pjesë dërrmuese e shkencëtarëve të të drejtës ndërkombëtare përfaqëson mendimin se intervenimi humanitar nuk është konsoliduar mjaftueshëm sipas të drejtës zakonore dhe do t'i shpëtojë monopolit të pushtetit të KS-së sipas të drejtës ndërkombëtare.

III. Vendosja e administrimit të UNMIK-ut në Kosovë më 1999

Më 9 qershor 1999 në Kumanovë, pranë kufirit me Kosovën, mes NATO-s dhe RFJ-së së *Milošević-it* bashkë me Republikën e Serbisë u lidh një Marrëveshje Ushtarake Teknike („*Military Technical Agreement*”²⁶¹), e cila rregullonte largimin e njësiteve ushtarake, paramilitare dhe policore jugosllave/serbe nga Kosova dhe marshimin e Pranisë Ndërkombëtare të Sigurisë („*international security presence*”) të KFOR-it.²⁶²

Më 10 qershor 1999 edhe Këshilli i Sigurimit në Rezolutën e OKB-së 1244 autorizoi stacionimin e një pranie ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë dhe autorizoi më tej Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së që të vendoste një Prani Ndërkombëtare Civile („*international civil presence*”) me objektivin për të krijuar një regjim të përkohshëm, i cili krahinës do të duhej t'i garantonte „*një autonomi substanciale dhe*

²⁵⁹ Javier Solana: Die Erfolge der NATO im Kosovo [Sukseset e NATO-s në Kosovë], në: Europäische Rundschau 1/2000, f. 55.

²⁶⁰ Herbert F. Köck: Rechtliche und politische Aspekte der NATO-Aktion im Kosovo [Aspekte juridike dhe politike të aksionit të NATO-s në Kosovë], në: Wiener Blätter zur Friedensforschung qershor 2/1999, f. 22.

²⁶¹ Marrëveshja Ushtarake Teknike midis Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë (KFOR) dhe qeverive të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe të Republikës së Serbisë, <http://www.un.org/peace/kosovo/s99682.pdf>

²⁶² Shiko po aty.

vetëqeverisje” brenda RFJ-së së Milošević-it deri në marrjen e një vendimi përfundimtar rreth statusit.

Për këtë arsye aktualisht në Kosovë ekziston *de facto* një protektorat i OKB-së dhe *de jure* një administratë e përkohshme nën përgjegjësinë e Këshillit të Sigurimit me një trupë ndërkombëtare ushtarake të sigurisë nën drejtimin e NATO-s.²⁶³

Rezoluta 1244 (1999) e OKB-së, ku shfaqen nocionet kryesore *vetëqeverisje, autonomi substanciale, proces politik*, u dëshmuua menjëherë pas qershorit 1999 si pozitive, mirëpo me këtë rast dolën në pah këto dobësi:

1. problemi kryesor, se Rezoluta 1244 (1999) e OKB-së nuk arrin përfundimin definitiv të konfliktit midis Kosovës dhe Serbisë dhe
2. problemi i mungesës së legjitimitetit të pushtetit politik përmes popullsisë së ,territorit të protektoratit’.

Lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës, Rezoluta 1244 (1999) e OKB-së vetëm i referohet të dhënës se është për t’u marrë parasysh „Marrëveshja e Përkohshme për Kosovën e Rambujesë”²⁶⁴, e cila deri në rregullimin përfundimtar të çështjes së statusit parashihte një afat kalimtar prej tre vjetësh.²⁶⁵ Rezoluta 1244 (1999) e OKB-së përcakton që „[...]” të vendoset prania ndërkombëtare civile dhe prania ndërkombëtare e sigurisë fillimisht për një periudhë kohore prej 12 muajsh, e cila do të vazhdohet në qoftë se Këshilli i Sigurimit nuk vendos ndryshe”.

Lidhur me çështjen e të drejtës së zbatueshme në kuadër të administrimit të përkohshëm, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së²⁶⁶ deklaroi se UNMIK-u gjatë

²⁶³ C. Stahn e përshkruan Kosovën si një ,territor i ndërkombëtarizuar’: „[...] Kosova është shndërruar në një ,territor të ndërkombëtarizuar’ nën administrimin e Kombeve të Bashkuara ku pretendimi mbi këtë territor nuk përkon me ushtrimin e autoritetit administrues.” Carsten Stahn: *Constitution Without a State? Kosovo Under the United Nations Constitutional Framework for Self-Government*, në: *Leiden Journal of International Law* 14/2001, f. 540. Në vend tjetër Zimmermann dhe Stahn e përshkruajnë situatën aktuale juridike të Kosovës si vijon: „Kosova posedon të gjitha karakteristikat e një territori të ndërkombëtarizuar, pa i pasur të humbura, megjithatë, lidhjet e saj zyrtare me RFJ-në, duke e bërë atë ende pjesë të Jugosllavisë. Prandaj, ajo as nuk është plotësisht e integruar në Jugosllavi, as nuk është një entitet i pavarur...” Andreas Zimmermann, Carsten Stahn: *Yugoslav Territory, United Nations Trusteeship or Sovereign State? Reflections on the Current and Future Legal Status of Kosovo*, në: *Nordic Journal of the International Law* 70/2001, f. 460.

²⁶⁴ Bazën për negociatën e krijonte një draft i autonomisë i miratuar nga Grupi i Kontaktit për Ballkanin, i cili për nga përmbajtja orientohej shumë fort në statusin e autonomisë së Kosovës mbi bazën e Kushtetutës Federative jugosllave nga viti 1974.

²⁶⁵ Dokumenti i Rambujesë në pjesët kryesore e ka humbur substancën e vet. Aktualisht duket jo realist kthimi në rregullimin e paraparë, sepse një kthim i Kosovës nën sundimin serb drejtëpërsëdrejti do të thoshte një kthim kah lufta.

²⁶⁶ Shiko Raportin rreth Misionit të Përkohshëm të Administrimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë nga 12 korriku 1999 në: UN Doc. S/1999/779

zbatimit të mandatit të vet do t'i respektojë ligjet e RFJ-së së *Milošević-it* dhe të Republikës së Serbisë „përderisa ato nuk janë në kundërshtim me standardet ndërkombëtarisht të njohura të drejtave të njeriut ose me rregullore që do të lëshohen nga PSSP-ja gjatë ushtrimit të mandatit të tij të sigurisë së OKB-së”.²⁶⁷ Kjo hasi te shqiptarët e Kosovës në rezistencë të madhe, sepse u interpretua si pranim parimor i praktikës jugosllave të padrejtësisë pas vitit 1989.²⁶⁸ Në dhjetor 1999 u arrit një zgjidhje kompromisi, sipas të cilës parimisht do të zbatohet ajo e drejtë në Kosovë, e cila ishte e vlefshme para heqjes së autonomisë më 1989 dhe dispozitat e mëvonshme të të „drejtës” jugosllave vlenin vetëm për ato raste, të cilat nuk qenë përfshirë nga e drejta në kuadër të statusit të vjetër të autonomisë e as nga *rregulloret* e reja të UNMIK-ut.²⁶⁹

PSSP-ja, sipas Rezolutës 1244 (1999) të OKB-së ushtron *de facto* të tri pushtetet shtetërore. Rregullorja²⁷⁰ e parë e miratuar nga UNMIK-u nga 25 korriku 1999 përcakton në nenin 1: „1.1 Gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në lidhje me Kosovën, duke përfshirë administrimin e organeve të drejtësisë, i vishet UNMIK-ut dhe ushtrohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.”²⁷¹

Pasi që në këtë pjesë të parë i kam sqaruar prapavijat historike, juridike dhe socio-politike të konfliktit serbo-kosovar, në pjesën e dytë në vijim, në bazë të modelit shumëdimensional të integritimit, do ta paraqes procesin e integritimit në BE si një shans për një stabilizim të përhershëm dhe të gjerë politik, ekonomik dhe social të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

²⁶⁷ Shiko Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/1 nga 25 korriku 1999 për Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë.

²⁶⁸ Krahe. Elmar Pichl: Kosovo – Kriegerrecht, Faustrecht und UN Recht. Rechtliche Aspekte des Wiederaufbauens [Kosova – e drejta e luftës, e drejta e më të fortit dhe e drejta e OKB-së. Aspekte juridike të rindërtimit], në: Südosteuropa 11-12/1999, S. 654-9.

²⁶⁹ Shiko rreth kësaj Rregullore nr. 1999/24 të UNMIK-ut nga 12 dhjetori 1999 për Ligjin në Fuqi në Kosovë si dhe Rregulloren nr. 1999/25 të UNMIK-ut nga 12 dhjetori 1999 për Ndryshimin e Rregullore nr. 1991/1 të UNMIK-ut mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë. Krahe. rreth kësaj edhe Andreas Wittkowsky: Give War a Chance? Optionen zur Konsolidierung des Kosovo [T'i jepet luftës një mundësi? Opsionet për konsolidimin e Kosovës], në: Internationale Politik und Gesellschaft, 4/2000, f. 352.

²⁷⁰ Neni 4 i Rregullore nr. 1999/1 të UNMIK-ut nga 25 korriku 1999 mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë përcakton: „Për kryerjen e detyrave, që i janë besuar administratës së përkohshme me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, UNMIK-u, sipas nevojës, nxjerr akte ligjore në formë rregulloresh.”

²⁷¹ Rregullorja nr. 1999/1 e UNMIK-ut nga 25 korriku 1999 mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë.

Pjesa II

„Me gjithë vendosmërinë e bindjes sonë duhet ta marrim si të mundshme se gabojmë. Pa këtë nuk ka bazë paqja e brendshme e shtetit demokratik kushtetues”.²⁷²

Kreu IV: Modeli shumëdimensional i integrimit për Kosovën dhe shtetet e saj fqinje

Pasojat e luftërave që ndodhën mes viteve 1991 dhe 2001 në hapësirën e dikurshme jugosllave, mund të përmbliidhen kështu: më se 200.000 të vrarë, më se 3 milionë të dëbuar, dëme materiale në lartësi prej 20 deri 60 miliardë dollarësh amerikanë, më se 1000 bashkëpunëtorë të OKB-së të vrarë ose të plagosur, më se 3 milionë mina të të gjitha llojeve të shpërndara nëpër rajon, tkurrje e Prodhimit të Brendshëm Bruto (më tutje: PBB) për më se 50% krahasuar me vitin 1989, më se 300 varreza masive në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Kosovë.²⁷³

Njëri prej shkaqeve të konflikteve në rajonin e Ballkanit Perëndimor është interpretimi i konfliktit midis Serbisë dhe Kosovës, thelbit fillestar të konfliktit në rajonin e Ballkanit Perëndimor, si çështje e politikës së brendshme serbe, interpretim ky që kohë të gjatë ishte shumë i përhapur në bashkësinë ndërkombëtare. Politologu Alex J. BELLAMY konstaton: „[...] perceptimi mbizotërues ndërkombëtar ishte se Kosova ishte një problem i brendshëm serb [...]. Kjo ishte bazuar mbi një kuptim të gabuar të kushtetutës jugosllave [...]”.²⁷⁴ Ky lloj i interpretimit të konfliktit ende të pazgjidhur midis dy pjesëve të dikurshme konstitutive të RSFJ-së, Serbisë dhe Kosovës, kishte ndikime të rënda negative në radhë të parë për njerëzit në Kosovë, por edhe për Serbinë, për njësitë e tjera të dikurshme konstitutive jugosllave e edhe për bashkësinë ndërkombëtare.

Sikur konflikti midis Kosovës dhe Serbisë në fund të viteve 1980-të të mos perceptohej si „punë e brendshme serbe” dhe sikur të pranohej se bëhej fjalë për një agresion të Serbisë në Kosovë, atëherë bashkësia ndërkombëtare do të mund t’ia prishte llogarinë gjeneratorit kryesor të luftërave pasuese në rajonin e Ballkanit Perëndimor, etno-nacionalizmit serb. Vetëm me përdorimin e dhunës ekzesive të organizuar nga shteti kundër kosovarëve të etnicitetit joserb në Kosovë ndryshoi perceptimi i këtij konflikti dhe pasoi intervenimi i bashkësisë ndërkombëtare, e cila

²⁷² Peter Graf Kielmansegg: Frieden durch Demokratie [Paqja përmes demokracisë], në: D. Senghaas (ed.): Den Frieden denken, *Si vi pacem, para pacem* [Ta mendosh paqen, *Si vi pacem, para pacem*], Frankfurt mbi Main 1995, f. 123.

²⁷³ Krah. International Crisis Group (ICG), After Milosevic. A Practical Agenda for Lasting Balkans Peace, Balkans Report Nr. 108, Bruksel 1 prill 2001, f. 3 (<http://www.crisisweb.org>). Ky raport i ICG-ës paraqet një studim të gjerë për Ballkanin Perëndimor si dhe për aktorët relevantë të bashkësisë ndërkombëtare në lidhje me këtë rajon.

²⁷⁴ Alex J. Bellamy: Kosovo and International Society, Nju Jork 2002, f. 2.

përmes kësaj u bë vetë palë në konflikt e përfshirë tërthorazi. Më së voni nga ky çast, BE-ja dhe disa shtete anëtare të saj, prej të cilave disa prej tyre paraqesin aktorët kryesorë të pranisë aktuale ndërkombëtare në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ia caktuan vetes detyrën që jostabilitetin ta zhdukun përmes perspektivës së integritimit në BE.

Qasja e politikës së jashtme të BE-së për Evropën Juglindore e parasheh integrimin e ardhshëm të vendeve të Ballkanit Perëndimor në strukturat politike, ekonomike dhe juridike të BE-së si mjet për tejkalimin e jostabilitetit politik dhe ekonomik. Ngjashëm me shembullin e suksesshëm të integritimit të Evropës Perëndimore, një integrim i tillë do të duhej të shkaktonte, krahas prosperitetit ekonomik, edhe një etablim dhe sigurim afatgjatë të paqes. Mirëpo, ky koncept i BE-së ka për bazë hipotezën tejet implicite dhe jo të reflektuar se procesi i integritimit evropian si i tillë paraqet një instrument të zgjidhjes së konfliktit, i cili do të shkaktonte një etablim dhe sigurim afatgjatë të paqes në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE qasja e politikës së jashtme të BE-së, duke u ndërtuar mbi qasjen rajonale dhe mbi qasjen e kondicionalitetit²⁷⁵, parasheh konkretisht këto masa: krijimin e bashkëpunimit rajonal, gjallërimin ekonomik, stimulimin e shoqërisë civile si dhe masat për etablimin dhe sigurimin e sundimit të ligjit. Këto masa do të duhej të çonin deri te përmbushja e kritereve të Këshillit Evropian të Kopenhagës nga 21 dhe 22 qershori 1993, të cilat paraqesin një standard për pranimin e shteteve të reja anëtare në BE. Përveç kësaj do të duhej të shtyhej përpara procesi i integritimit përmes Procesit të Stabilizimit dhe Asocimit për Evropën Juglindore (më tutje: PSA) dhe Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore²⁷⁶.

Ndërkohë që këto masa sigurisht mbeten të rëndësishme edhe për procesin e zgjidhjes së konfliktit dhe të etablimit të paqes, deri më sot, përveç në Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore, në qasjen e politikës së jashtme të BE-së nuk kanë gjetur gati aspak konsideratë *karakteristikat specifike socio-politike të rajonit të Ballkanit Perëndimor*, të cilat janë krijuar gjatë historisë dhe të cilat në kohën e tashme bashkëpërcaktojnë realitetet komplekse. Prandaj po paraqes hipotezën se proceset e integritimit në BE në rajonin e Ballkanit Perëndimor do të mund të ofrojnë një sigurim afatgjatë të paqes vetëm nëse do t'i marrin në konsideratë këto *karakteristika specifike socio-politike të rajonit të Ballkanit Perëndimor*.

Një vërtetim i diferencuar politik dhe historiko-analitik i *karakteristikave socio-politike të rajonit të Ballkanit Perëndimor* dhe një identifikim i *parakushteve* dhe *kushteve*, nën të cilat procesi i integritimit në BE në periudhë afatgjate mund të shpalosë efektin për etablimin e paqes, do të hulumtohen në kapitujt e ardhshëm. Njëra prej çështjeve kryesore është ndikimi i statusit të pazgjidhur të Kosovës dhe në

²⁷⁵ Shiko rreth kësaj fusnotën 504.

²⁷⁶ Më shumë rreth kësaj në Kreun VI, nënkreu A. I. të këtij libri.

lidhje me këtë pozicionet e bashkësisë ndërkombëtare ndaj zhvillimeve rajonale politike në proceset e integrimit në BE, si dhe në procesin afatgjatë të etablimit të paqes dhe të sigurimit të paqes.

Sipas mendimit tim përvoja evropërisht pas Luftës së Dytë Botërore mund të jetë vetëm një model krahasues për krijimin e një bashkëpunimi dhe integrimi të gjerë e efikas në rrafshin rajonal dhe ndërrajonal në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe nuk mund ta marrë kurrsesi rolin e një multiplikatori që funksionon automatikisht.²⁷⁷

Disa flasin për një *Union Evropian Juglindor*²⁷⁸, i cili do të mund të paraqiste një parashkallë deri në integrimin e plotë të Ballkanit Perëndimor në BE. Mirëpo, realitetet e karakterizuara prej konflikteve në rajonin e Ballkanit Perëndimor lënë pak hapësirë për shpresë. Hipoteza se procesi i integrimit evropian disponon me një efekt afatgjatë të zgjidhjes së konfliktit dhe të sigurimit të paqes, në realitetet komplekse të Ballkanit Perëndimor do të duhej t'i nënshtrrohej një verifikimi sistematik dhe para së gjithash kritik, e të mos i lihet shpresës së një *automatizmi integrativ*. „Zgjidhjet zëvendësuese” të përkohshme së paku për dy arsye nuk mund të çojnë drejt caktit dhe nuk mund të krijojnë paqe, në periudhë afatgjate, si parakusht për përparime ekonomike dhe politike në rajonin e Ballkanit Perëndimor: së pari, duke u nisur nga përvojat e dhjetëvjeçarëve të fundit, gjasat faktike të zbatimit të „zgjidhjeve” të tilla të përkohshme anojnë kah zeroja dhe së dyti, te aktorët në rajonin e Ballkanit Perëndimor mund të zgjojnë vetëm frika të vjetra, të cilat janë të lidhura me idenë e dominimit të një shteti përbërës. Alternativa ndoshta qëndron te ajo që e rekomandojnë ekspertët e procesit të zgjerimit të BE-së:

„Për ta zvogëluar hendekun midis pritshmërive të jashtme dhe politikave të BE-së, Bashkimi ka për të zhvilluar një nivel të ri të kapaciteteve pan-

²⁷⁷ Pyetjet se proceset evropërisht të integrimit a janë vërtet zgjidhëse të konfliktit dhe sigurose të paqes se integrimet evropiane si të tilla a kanë pasur këtë efekt përkatësisht cilat kushte të tjera karakteristike për Evropën Perëndimore pas Luftës së Dytë Botërore garantonin paqen në Evropë dhe se këto përvoja evropërisht a do të mund të përsëriteshin në vendet e Ballkanit Perëndimor, nuk do të jenë këtu objekt primar i hulumtimit.

Në shtetet anëtare të BE-së së sotme zhvillohet fenomeni i etno-nacionalizimit dhe regjionalizimit paralelisht me përparimet në integrimin në BE. Mund të parashtrrohet pyetja se integrimi evropian në vetvete në Evropën Perëndimore a kishte një efekt të zgjidhjes së konfliktit dhe të sigurimit të paqes. Do të përpiqem të ballafaqohem në mënyrë implicite me pyetjen se integrimi evropian a e ka garantuar paqen ose a ishin më përpara përvojat para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore si dhe ndarja e Evropës përmes konfliktit lindje-perëndim ato që mundësuan paqen në Evropën Perëndimore. Aspektet historike të integrimit evropërisht megjithatë nuk do t'i thelloj, sepse do të tejkalonin kornizën e këtij punimi.

²⁷⁸ Karl Lamers etj.: Ordnung und Einverständnis. Der Balkan braucht eine selbsttragende politische Ordnung: die Südost-Europäische Union [Rend dhe dakordim. Ballkanit i duhet një rend politik vetëbartës: Unioni Evropian Juglindor], në: Frankfurter Allgemeine Zeitung, 18 qershor 2001, f. 8.


evropiane. Ky hap nuk mund të arrihet duke e vazhduar „thjesht” tregimin e suksesit të zgjerimit të BE-së. Vetëm modeli i një Evrope shumështrësore mund të përmbushë joshjen e madhe për BE-në, e cila është e pranishme në shumicën e vendeve të dikurshme komuniste. Integrimi në BE duhet të jetë thelbi më i rëndësishëm i modelit.”²⁷⁹

Skica e prezantuar në vijim ofron një model të mundshëm se si do të mund të arrihej etablimi dhe sigurimi i paqes afatgjate në rajonin e Ballkanit Perëndimor, përkatësisht në rastin e Kosovës dhe vendeve të saj fqinje në kuadër të procesit të integritit në BE. Modeli shumëdimensional i integritit do të prezantohet fillimisht në formë skematike dhe më tej do të sqarohen shkurtimisht dimensionet e veçanta (A. aktorët, B. proceset dhe C. rezultatet) të *modelit të integritit për Kosovën dhe vendet e saj fqinje: aktorët dhe proceset*.

²⁷⁹ Iris Kempe, Wim van Meurs: Prospects and Risks Beyond EU Enlargement, 2002/2003 Strategy Paper, f. 17 (<http://balkans.mehedinti.info/studies/Multi-Layered%20Europe.pdf>).

Figura nr. 2:

MODELI I INTEGRIMIT PËR KOSOVËN DHE VENDET E SAJ FQINJE: AKTORËT DHE PROCESET



A. Aktorët e procesit të integrimit në BE

Nisem nga premisa që krahas qëndrimeve dhe objektivave të bashkësisë ndërkombëtare në hapësirën e Ballkanit Perëndimor duhet të merren parasysh edhe karakteristikat e posaçme të sistemeve politike si dhe interesat e politikës së jashtme të vendeve të Ballkanit Perëndimor, si elemente qenësore për proceset e integrimit në BE.

Në pjesën e sipërme të modelit shumëdimensional të integrimit aktorët e involvuar në rajonin dhe rreth rajonit të Ballkanit Perëndimor, përkatësisht në këtë rast në Kosovë dhe rreth Kosovës, paraqiten në një formë trekëndëshi, i cili i tregon lidhjet e tyre të ndërvarura dhe ndërvepruese lidhur me proceset e integrimit në BE. Aktorë kryesorë në proceset e integrimit në BE janë vendet e Ballkanit Perëndimor, BE-ja, Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore dhe aktorë të tjerë të bashkësisë ndërkombëtare, para së gjithash Grupi i Kontaktit për Ballkanin, OKB-ja dhe OSBE-ja, të cilat drejtpërsëdrejti ose në mënyrë të tërthortë janë po ashtu të involvuar në këto procese.

B. Procesi i integrimit në BE

Përkundër një angazhimi të fortë, para së gjithash në fushën e ekonomisë dhe të demokratizimit, dhe përkundër një pranie masive ushtarake nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, stabiliteti i gjerë në rajonin e Ballkanit Perëndimor mbetet edhe më tutje i brishtë. Mbi të gjitha, nuk ekziston një 'paqe pozitive' në këtë rajon evropian, siç dëshmon aktualisht më së miri rasti i Serbisë dhe Kosovës.

Prandaj, për integrimin e rajonit të Ballkanit Perëndimor në BE kërkohet etablimi i parakushteve përkatëse dhe një ambient i volitshëm, me ç'rast duhet të angazhohen qëllimisht strategjitë për zgjidhjen e konflikteve, për ta mundësuar një 'paqe pozitive'. Vetëm një 'paqe pozitive' do ta etablojë dhe sigurojë paqen në periudhë afatgjate duke qenë kështu edhe një parakusht ideal për integrimin në BE të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

I. Procesi i denacionalizimit dhe i supranacionalizimit (pika a)

Aktualisht në konfliktet midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dominojnë shumëfish edhe më tej etnonacionalizmat përkatës, të cilët e pengojnë realizimin e një caku '*të përbashkët*' të integrimit të rajonit në BE. *Denacionalizimin** e perceptimit historik në njërën anë, dhe në tjetrën *supranacionalizimin* e vlerave

liberal-demokratike, unë i identifikoj si strategji për zhdukjen e potencialit konfliktuoz midis aktorëve në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Me këtë rast e përfaqësoj qasjen se integrimi i të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE dhe etablimi i paqes afatgjate do të jetë i mundshëm vetëm atëherë kur aktorët të arrijnë një sjellje pragmatike me të kaluarën „e ngarkuar të integritimit”, dhe në qoftë se ndërmarrin një përfundim të kësaj të kaluarë në shërbim të një dizajnimi të përbashkët të të ardhmes evropiane. Çdo përpjekje për ta „harruar” historinë, në vend se ajo të hulumtohet objektivisht dhe prej saj të nxirren mësimet në kuptimin e një *strategjie të shmangies së përsëritjes*, do të pengonte me probabilitetin më të lartë procesin e krijimit të shtetit ligjor dhe me këtë do të pengonte edhe procesin e integritimit në BE.²⁸⁰ Një historiografi jonacionaliste dhe e mbështetur në fakte historike është bazë e procesit të neutralizimit të etno-nacionalizmave dezintegrativë që unë e cilësoj si *denacionalizim* të perceptimit historik dhe do ta shpjegoj në shembullin e Serbisë dhe të Kosovës.

Interpretimi i të kaluarës, i kufizuar në kuptimin etno-nacional, do të duhej tejkaluar në vazhden e *procesit të supranacionalizimit* përmes marrjes përsipër të normave dhe vlerave të shtetit ligjor. „(Re)Konstruktimi” i versioneve të përbashkëta të historisë, në të cilën merren parasysh si faktet historike negative ashtu edhe ato pozitive, do të mund ta mbështeste këtë proces.

Në qoftë se p.sh. njerëzit në rajonin e Ballkanit Perëndimor nën sundimin osman me shekuj jetonin në paqe pranë njëri-tjetrit dhe shumë shpesh edhe me njëri-tjetrin, do të duhej që kjo të ishte e mundshme edhe në kohën e tanishme në një strukturë supranacionale si ajo e BE-së, edhe në qoftë se njerëzit sot kanë një vetëperceptim kombëtar tjetër nga paraardhësit e tyre. Popujt e Ballkanit në të kaluarën luftonin shpesh në të njëjtën anë të frontit kundër një kundërshtari të përbashkët, siç tregon p.sh. Beteja në Fushën e Mëllenjavë.²⁸¹ Mirëpo, kjo betejë në dhjetëvjeçarët e fundit u (mbi-)mitologjizua dhe u vendos nën „monopolin historik” të një kombi të vetëm ballkanik, atij serb. Një „monopol historik” i tillë do të duhej të bëhej i pamundshëm në kuadër të „(re-)konstruktimit” të versioneve të përbashkëta të historisë. Edhe në qoftë se ky shembull duket si tepër shumë i stisur, sipas mendimit tim nuk mund të flasë asgjë kundër, në qoftë se kjo ngjarje shpesh e keqpërdorur në histori shërben si

²⁸⁰ Kështu për shembull H. Dubiel thekson domethënien e kapitalit historik për integrimin e shoqërive moderne: „Nuk janë më ngjashmëritë e përcaktimit fetar, tiparet etnike ose traditat kombëtare ato që integrojnë shoqëritë moderne, por vetëm kapitali i tyre historik i divergjencës së duruar.” Helmut Dubiel: *Konsens oder Konflikt? Die normative Integration des demokratischen Staates* [Pëlqim apo konflikt? Integrimi normativ i shtetit demokratik], në: B. Kohler-Koch (ed.): *Staat und Demokratie in Europa* [Shteti dhe demokracia në Evropë], Opladen 1992, f. 134.

* Sqarim: këtu shprehja „denacionalizim” nuk i referohet kthimit të pronës së nacionalizuar apo „shkombëtarizimit”, mirëpo i referohet zhveshjes nga interpretimi ideologjik nacionalist.

²⁸¹ Krah. p.sh. N. Malcolm: *Kosovo a short History*, Londër 1998, f. 61.

„lëndë” për ndërtimin e një kuptimi të përbashkët evropian të historisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Ngjarje të tjera të shumta të mëvonshme historike, të cilat shpesh me dëshirë heshten ose paraqiten të shtrembëruara, mund të marrin përsipër funksionin e njëjtë për të dëshmuar se krahas konflikteve kishte edhe përvoja të bashkëpunimit në fatin e përbashkët historik të popujve të Ballkanit.

II. Zhvillimi i rrjeteve të komunikimit (pika b)

Proceset e integritimit në Ballkanin Perëndimor ishin dhe janë edhe më tej të karakterizuara nga komunikimi i kufizuar²⁸² midis aktorëve, si midis vendeve të Ballkanit Perëndimor me njëri-tjetrin ashtu dhe midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe aktorëve të bashkësisë ndërkombëtare. Kjo mungesë paraqet njërin prej shkaqeve kryesore për përparimet e arritura tejet të kufizuara që nga viti i kthesës 1989 në proceset e transformimit dhe të integritimit në BE.

Komunikimi midis BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor u pengua jo vetëm përmes konflikteve në këtë rajon, por para së gjithash nëpërmjet politikës jokonsistente dhe mungesës së gjatë të konceptit të BE-së përballë rajonit të Ballkanit Perëndimor. Vetëm qasja e ndjekur nga Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore, e cila përmban një strategji më të gjerë për rajonin e Ballkanit Perëndimor, paraqet një hap të parë për ndërtimin e rrjeteve të qëndrueshme të komunikimit dhe kështu edhe për tejkalimin e mungesës së konceptit të BE-së.

Nisem nga fakti se zhvillimi i rrjeteve të plota dhe të gjera të komunikimit mes të gjithë aktorëve të involvuar në proceset e integritimit në BE mund të paraqesë një strategji të zgjidhjes së konfliktit dhe të etablimit të paqes. Mirëpo, kjo e kërkon si parakusht një bazë të përbashkët minimale të vlerave, objektivave dhe interesave ideo-politike, e cila edhe më tej nuk është qartë e dukshme midis disa vendeve të Ballkanit Perëndimor.

III. Krijimi i proceseve të bashkëpunimit (pika c)

Si pikë e fundit në modelin tim shumëdimensional të integritimit përmendet krijimi i proceseve të gjera dhe efikase të bashkëpunimit, ngaqë krahas mungesës së komunikimit ka edhe një mungesë të bashkëpunimit brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor si dhe mes vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së. Kjo ndoshta ka shkaqe në rrafsh të ndryshme, si p.sh. përfshirja e kufizuar e potencialit njerëzor, sidomos e popullatës së re, në proceset e demokratizimit dhe të krijimit të shtetit

²⁸² Nocioni komunikim do të duhej të kuptohet në kuptimin e gjerë dhe të përfshijë proceset e komunikimit kulturor, politik dhe ekonomik.

ligjor në rrafshin lokal dhe nacional. Shkaku kryesor për mungesën e bashkëpunimit megjithatë mbetet ai se aktorët nuk e njohin reciprokisht njëri-tjetrin dhe se vendet e Ballkanit Perëndimor nuk trajtohen rrjedhimisht njëjloj nga ana e BE-së. Një njohje reciproke si partnerë të barasvlershëm, p.sh. mes Serbisë, Malit të Zi dhe Kosovës, do të ishte sipas mendimit tim parakusht për procese të qëndrueshme të bashkëpunimit dhe kështu në fund të fundit edhe për një integrim të suksesshëm evropian të këtyre vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE.²⁸³

C. Rezultati: Përfundimi i integrimit në BE në rajonin e Ballkanit Perëndimor

Qasja e politikës së jashtme të BE-së për Evropën Juglindore parasheh një tejkalim të jostabilitetit përmes një integrimi të ardhshëm të vendeve të Ballkanit në strukturat politike, ekonomike dhe juridike të BE-së. Pas shembullit të suksesshëm të integrimit të Evropës Perëndimore si dhe raundeve të deritashme të zgjerimit të BE-së, një integrim i tillë krahas prosperitetit ekonomik do të duhej të shkaktonte një etablim dhe sigurim afatgjatë të paqes edhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Derisa Ballkani për një kohë të gjatë perceptohej si hapësirë dezintegrimesh „të trashëguara” dhe përpjekjesh të dështuara të integrimit²⁸⁴, në vitet e fundit perceptimi i Ballkanit nga ana e BE-së dhe e bashkësisë ndërkombëtare ndryshoi: Ballkani gjithnjë e më shumë po perceptohet si „rajon kyç” për integrimin e shteteve postkomuniste në BE. Në vijën e globalizimit ai, mes tjerash për shkak të pozitës së tij gjeografike dhe gjeopolitike, do të shikohet si urë midis kontinentit evropian dhe atij aziatik.²⁸⁵

Përkundër këtij perceptimi të Ballkanit si „rajon kyç”, gjendja në rajon mbetet edhe më tej e brishtë. „Valët e dhunës shoviniste që në Kosovë u ngritën në kulmin e

²⁸³ Njohja reciproke e palëve si partnerë të barasvlershëm është i kushtëzuar mes tjerash edhe përmes situatës së pakicave etnike: Në kontekstin kosovar, në lidhje me grupet etnike mbizotëron një diskrepancë evidente mes të drejtës kushtetuese dhe realitetit kushtetues (më shumë rreth kësaj shiko në kreun VI, nënkapitulli C. III të këtij libri), të cilën në radhë të parë e interpretoj si pasojë e mungesës së një „paqeje pozitive” mes Serbisë dhe Kosovës.

²⁸⁴ Për shembull përpjekjet e përsëritura të integrimit në hapësirën e dikurshme jugosllave në shek. 20.

²⁸⁵ Evropa Juglindore vlen si rajon natyror transitiv midis Evropës dhe Azisë si dhe midis Greqisë dhe shteteve të tjera anëtare të BE-së. Gjashtë prej dhjetë korridoreve të definuara të qarkullimit nga Pan-European Transport Conference (Kretë 1994 dhe Helsinki 1997) si dhe Transport Infrastructure Needs Assessment (TINA, 1995) kalojnë përmes vendeve të Evropës Juglindore. Krahas. The World Bank, The Road to Stability and Prosperity in South Eastern Europe. A Regional Strategy Paper, Uashington DC, mars 2000, f. 121. Ky punim i Bankës Botërore paraqet një studim të gjerë ekonomik, social dhe ekologjik për Evropën Juglindore me një qasje inovative.

tyre»²⁸⁶ dhe simptomat e saj të mëvonshme, e karakterizojnë edhe më tutje shumë fort klimën politike, ndonëse kanë kaluar shumë vjet qëkur bashkësia ndërkombëtare ka imponuar një fund të veprimeve të hapura luftarake.

Në pjesën e tretë dhe të fundit të modelit shumëdimensional të integritit do të paraqiten në dy shkallë rezultatet e proceseve të integritit të pjesës së dytë: *proceset e denacionalizimit dhe të supranacionalizimit*, zhvillimi i *rrjeteve të komunikimit* si dhe krijimi i *proceseve të bashkëpunimit*.

Proceset e integritit në BE do të duhej të çonin, si hapi i parë, te „mbështetja” e rajonit të Ballkanit Perëndimor në BE, para se në hapin të dytë vendet e veçanta të Ballkanit Perëndimor dhe shtetet anëtare të BE-së të vendosin formalisht dhe politikisht për aderim në BE dhe të arrihet një integrim i plotë i rajonit të Ballkanit Perëndimor në BE. Mbarimi i proceseve të integritit në BE përmes unifikimit juridiko-politik, përkatësisht „evropianizimit” të rajonit të Ballkanit Perëndimor, paraqet cakun e këtij modeli shumëdimensional të integritit.

Pasi ta kem sqaruar modelin shumëdimensional të integritit, të zhvilluar prej meje, më duket e arsyeshme që në vijim teorikisht ta ndriçoj procesin e transformimit dhe të integritit të rajonit të Ballkanit Perëndimor në BE. Kjo kornizë teorike synon të vazhdojë dhe ta thellojë pjesën e parë të këtij punimi, por edhe ta vendosë në një bazë më të gjerë operacionalizimin e modelit shumëdimensional të integritit në dy krerët e fundit – kreu VI: Proceset e integritit në BE si instrument i etablimit dhe sigurimit të paqes në rajonin e Ballkanit Perëndimor; dhe kreu VII: Konkluzionet dhe perspektiva: Shprehje për një të ardhme evropiane të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

²⁸⁶ Otto Luchterhandt: Völkermord: Humanitäre Intervention – Recht contra Moral? Der Fall »Kosovo« [Gjenocidi: Intervenimi humanitar – e drejta kundër moralit? Rasti »Kosova«], në: Zeitschrift für Genozidforschung 1/1999, f. 92.

Kreu V: Proceset e demokratizimit dhe të integrimit në Ballkanin Perëndimor ndërmjet globalizimit dhe nacionalizmit

Qysh gjatë Luftës së Ftohtë, si RSFJ-ja përmes funksionit të saj të „zonës së tamponit” midis bllokut perëndimor dhe lindor, ashtu edhe Shqipëria përmes interpretimit të saj fanatik të stalinizmit, vlenin si raste të veçanta në „botën komuniste”. Konfliktet luftarake dhe jostabiliteti i vazhdueshëm që nga fundi i sundimeve komuniste u bënë argumente shtesë për supozimin se rajoni i Ballkanit Perëndimor parimisht ndryshonte nga trendi i përgjithshëm ndërrajonal.

Mirëpo, në kuadër të proceseve të integrimit dhe të globalizimit, rajoni i Ballkanit Perëndimor po i afrohet gjithnjë e më shumë Evropës. Ky krye përshkruan, duke u nisur nga mendimet teorike për proceset e demokratizimit dhe të transformimit, tensionet midis proceseve të integrimit (në BE) dhe fenomeneve të nacionalizmit dhe të patriotizmit në epokën e globalizimit. Këto tensione në hapësirën e Ballkanit Perëndimor çojnë te një ndryshim i perceptimit të identitetit vetjak kombëtar dhe kulturor. Ato kanë edhe pasoja politike, të cilat njëkohësisht paraqesin shans dhe sfida, si për rajonin e Ballkanit Perëndimor ashtu edhe për BE-në: bëhet fjalë për potencialin që në të ardhmen të zvogëlohen dallimet socio-politike midis këtij rajoni dhe rajoneve të tjera evropiane dhe me këtë të sigurohet stabiliteti i përgjithshëm në këtë rajon kyç evropian.

A. Rëndësia e qasjeve të teorisë së transformimit dhe të demokratizimit për rajonin e Ballkanit Perëndimor

I. Parakushtet socio-politike për procesin e demokratizimit

Lidhur me konceptimin analitik të krijimit të teorisë është për t'u shënuar se nuk ekziston asnjë teori e vetme e transformimit sipas shkencave shoqërore që vlen në rrafshin universal. Në kohën pas vitit të kthesës 1989 në vijë të parë dolën shpjegimet sipas teorisë së sistemit dhe të modernizimit, të cilat megjithatë janë tejet larg nga teoria e transformimit sipas shkencave shoqërore që vlen në rrafshin e përgjithshëm.²⁸⁷

Politologu Klaus von BEYME dallon dy tradita të konceptimit analitik të krijimit të teorisë. E para është tradita WEBER-iane, e cila punon me tipet ideale të fituara *ex*

²⁸⁷ Krah. Wolfgang Merkel: *Theorien der Transformation: Die demokratische Konsolidierung postautoritärer Gesellschaften* [Teoritë e transformimit: Konsolidimi demokratik i shoqërive postautoritare], në: Klaus von Beyme (ed.): *Politische Theorien in der Ära der Transformation* [Teoritë politike në erën e transformimit], Opladen 1996, f. 31.

post facto, orientohet drejt rekonstruktimit historiko-tipologjik të realitetit social dhe nuk pretendon t'i parashikojë zhvillimet e ardhshme.²⁸⁸ Përkundër kësaj qëndron tradita e ashtuquajtur e pozitivizmit të vjetër, e cila është e specializuar për *modelimin e realitetit* dhe „[...] një prognozë të mirë e sqaron si më të rëndësishme sesa riprodhimin e realitetit social.”²⁸⁹ Kjo traditë humbi rëndësinë në vazhden e proceseve të transformimit, duke filluar me kthesën në vitin 1989, sepse „sa më ekzakt dukej një qasje, nga shpjegimet behaviorale të sjelljes në socializëm e deri te modelet botërore, aq më të mëdha [... ishin] gabimet”.²⁹⁰

Nga perspektiva e politikës së sigurisë, politologu Heinz GÄRTNER përkitazi me integrimin evropian për kohën pas vitit 1990 u jepte vlerë më të lartë shpjeguese qasjeve neo-funksionaliste, për dallim prej modeleve realiste. Këto teori neo-funksionaliste nisen nga ajo se integrimi ekonomik shpie te strukturat e përbashkëta politike dhe të politikës së sigurisë.²⁹¹

Në diskursin postkomunist të transformimit, kjo tezë e sociologut dhe politologut Claus OFFE gëzon pranueshmëri të përgjegjshme, se nën turbulencat e posaçme ekonomike të synimeve të transformimit postkomunist në vendet evropiane mund të llogaritet me një shtet ligjor stabil liberal-demokratik „[...] vetëm atëherë, kur *njëkohësisht* me demokracinë dhe kapitalizmin institucionalizohen edhe siguritë e gjera sociale [...]”.²⁹² Kjo tezë e C. OFFE sipas mendimit tim nuk mund të injohet gjatë mendimeve se si mund të arrihet integrimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE.

Deri më sot në rajonin e Ballkanit Perëndimor siguritë sociale të nevojshme për suksesin e procesit të transformimit në rastin më të mirë kanë mundur të zbatohen vetëm në mënyrë të kufizuar. Sa kohë që shtetet e rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe Kosova aktualisht si protektorat faktik ndërkombëtar, njërën prej detyrave kryesore të shtetit, konkretisht *shpërndarjen* ,e drejtë’ të *resurseve* në shoqëri, mund

²⁸⁸ Kra. Klaus von Beyme: *Theorien der Politik im Zeitalter der Transformation* [Teoritë e politikës në epokën e transformimit], në: K. von Beyme (ed.): *Politische Theorien in der Ära der Transformation* [Teoritë politike në erën e transformimit], Opladen 1996, f. 11.

²⁸⁹ K. von Beyme (ed.): *Politische Theorien in der Ära der Transformation* [Teoritë politike në erën e transformimit], Opladen 1996.

²⁹⁰ Po aty, f. 12.

²⁹¹ H. Gärtner e kupton Traktatin e Mastrohtit për Bashkimin Evropian nga viti 1992 si shembull të një përfytyrimi neo-funksionalist. Kra. Heinz Gärtner: *Modelle europäischer Sicherheit. Wie entscheidet Österreich?* [Modelet e sigurisë evropiane. Si vendos Austria?], Vjenë 1997, f. 22.

²⁹² Claus Offe: *Der Tunnel am Ende des Lichts. Erkundungen der politischen Transformation im Neuen Osten* [Tuneli në fund të dritës. Gjurmime të transformimit politik në Lindjen e Re], Frankfurt mbi Main, Nju Jork 1994, f. 93. Për shembull Wolfgang Merkel këtë tezë sipas mendimit tim me të drejtë e vlerëson si shumë plauzibile. Kra. W. Merkel: *Theorien der Transformation: Die demokratische Konsolidierung postautoritärer Gesellschaften* [Teoritë e transformimit: Konsolidimi demokratik i shoqërive postautoritare], në: Klaus von Beyme (ed.): *Politische Theorien in der Ära der Transformation* [Teoritë politike në erën e transformimit], Opladen 1996, f. 35.

ta perceptojnë, përkatësisht ta përmbushin, vetëm pjesërisht, nuk do të jetë i mundshëm ndonjë stabilizim i përhershëm.

Një shtresë e lartë shumë e vogël, për rrethana ballkanike shumë e pasur, një shtresë e ulët e gjerë e varfër, deri ekstremisht e varfër, si dhe një shtresë e mesme skajshmërisht e hollë, e karakterizojnë strukturën sociale të këtyre vendeve, me ç'rast shumica dërrmuese e intelektualëve janë të vendosur në gjysmën e poshtme të të ardhurave. Lidhur me këtë nuk mund të pritet ndonjë përmirësim i shpejtë i gjendjes, madje në bazë të disa indikatorëve situata po përkeqësohet edhe më tej. Prandaj në raportin e dytë vjetor të Komisionit të Komuniteteve Evropiane²⁹³ për PSA-në nga 26 marsi 2003 mund të lexohet kjo: „Pabarazia e shpërndarjes së të ardhurave në rajon është ashpërsuar dhe varfëria po përhapet gjithnjë e më shumë”.²⁹⁴

Mungesa e një shtrese të mesme është gjithkund e pranishme në shoqëritë e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Shumica e popullsisë, përfshirë edhe akademikët, konfrontohen me vështirësi serioze financiare, për dallim nga një pakicë e vogël, e cila brenda një kohe shumë të shkurtër pas vitit 1989 mund të pasurohej financiarisht në mënyrë ekstreme, kryesisht përmes veprimtarive ilegale. Kjo shkakton një proces të vazhdueshëm të *brain drain*, i cili i zvogëlon shanset e një përparimi ekonomik dhe politik në këto vende. Mungesa e shtresës së mesme në shoqëritë e Ballkanit Perëndimor ka edhe konsekuenca politike, siç mund të nxirret edhe nga citati vijues:

„Në kuptimin statistikor, struktura sociale dhe përmbajtja e kulturës politike janë të lidhura; e dëshmon propozimi gjerësisht i pranuar se rritja e klasës së mesme është një burim i demokracisë liberale dhe nocioni më i diskutueshëm se klasa punëtore është baza kryesore sociale e autoritarizmit”.²⁹⁵

Fakti se pa një kënaqësi të konsiderueshme sociale gati nuk mund të ngrihet në këmbë as stabiliteti i gjerë në një shoqëri, është përgjithësisht i njohur, siç është edhe lidhja midis tensioneve etnike dhe rënies ekonomike. Prandaj në rajonin e Ballkanit Perëndimor erozioni ekonomik dhe kriza e vazhdueshme ekonomike u shkaktoan në radhë të parë nga konfliktet luftarake e jo anasjelltas.²⁹⁶ Disa autorë përpiqen megjithatë t'i gjejnë shkaqet për një ngecje ekonomike të dekadave të fundit më parë

²⁹³ Kryesisht i quajtur vetëm Komisioni Evropian.

²⁹⁴ Bericht der Kommission der Europäischen Gemeinschaften. Der Stabilisierungs- und Assoziierungsprozess für Südosteuropa. Zweiter Jahresbericht, (KOM (2003) 139 endgültig) [Raport i Komisionit të Komuniteteve Evropiane. Procesi i Stabilizimit dhe i Asociimit për Evropën Juglindore. Raporti i dytë vjetor (KOM (2003) 139 final)], Bruksel, më 26.3.2003, f. 13.

²⁹⁵ Bruce Parrott: Perspectives on postcommunist democratization, në: Karen Dawisha, Bruce Parrott (ed.): Politics, power, and the struggle for democracy in South-East Europe, Kembrixh 1997, f. 22.

²⁹⁶ Për shembull kjo hipotezë konfirmohet edhe përmes asaj që në shumë shoqëri të dikurshme komuniste, të cilat ekonomikisht ishin në një krizë shumë më të madhe, nuk kishin ndodhur luftëra të përgjakshme si në hapësirën e RSFJ-së së dikurshme.

te organizatat financiare perëndimore. Shpesh përpjekjet e tilla të shpjegimeve të thjeshta u ngjajnë shumë fort teorive konspirative.²⁹⁷ Sidomos për hapësirën e dikurshme jugosllave duhet të shënohet se për shkatërrimin ekonomik nuk është përgjegjëse përfshirja në sistemin e ekonomisë së tregut. Prapavijës së luftërave të fundit dhe me këtë edhe krizës ekonomike në këtë hapësirë i vë pikën në mënyrë të saktë politologja Henriette RIEGLER:

„Prapavija e shkatërrimit të Jugosllavisë së dikurshme krijohej nga përpjekja që mbështetet në idenë serbomadhe që Jugosllavia ose të ricentralizohej, ose të themelohej rishtas një shtet serb që bazohej në majorizimin etnik.”²⁹⁸

Politologu Philippe SCHMITTER, i cili në procesin e ndërrimit nga një sistem autoritar në një demokratik, në kuptimin ideal-tipik bën dallimin midis liberalizimit, demokratizimit dhe konsolidimit,²⁹⁹ sipas politologut Wolfgang MERKEL ka „paraqitur në hulumtimet politologjike të transformimit ndarjen më me influencë të proceseve të ndërrimit të sistemit.”³⁰⁰

Sipas Ph. SCHMITTER nga një tufë faktorësh *endogjenë* dhe *ekzogjenë* varet se si do të zhvillohet procesi i një ndërrimi të suksesshëm nga një sistem autoritar në sistem demokratik, sa kohë zgjat dhe a mund të përmbyllet me sukses. Lidhur me faktorët më të rëndësishëm *endogjenë* shtrohen këto pyetje: në cilat përvoja demokratike paraautoritare mund të mbështetet një vend? Çfarë karakteri dhe cilën

²⁹⁷ Për një qëndrim tejet kritik dhe ideologjikisht të karakterizuar ndaj veprimtarisë së institucioneve financiare në Evropën Juglindore, si për shembull të Bankës Botërore dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar, shiko për shembull Sabine Riedel, Michael Kalman: Soziale Frage und Gewaltprävention in Südosteuropa [Çështja sociale dhe parandalimi i dhunës në Evropën Juglindore], në: Österreichische Osthefte, Vjenë 2/2000, f. 143-72.

²⁹⁸ Henriette Riegler: Internationale Protektorate als Modelle zur Stabilisierung von Nachkriegsgebieten im ehemaligen Jugoslawien: Bosnien-Herzegowina und Kosovo im Vergleich [Protektoratet ndërkombëtare si modele për stabilizimin e territoreve të pasluftës në Jugosllavinë e dikurshme: Bosnja-Hercegovina dhe Kosova në krahasim], në: Österreichisches Handbuch für Internationale Politik, Vjenë 2000, f. 147.

²⁹⁹ Krahe, Philippe C. Schmitter: The Consolidation of Political Democracy in Southern Europe (and Latin America), manuskript i papublikuar, Firencë 1985; Philippe C. Schmitter: The Consolidation of Democracy in Southern Europe, manuskript i papublikuar, Firencë 1988. Të dy veprat të cituara të W. Merkel: Theorien der Transformation: Die demokratische Konsolidierung postautoritärer Gesellschaften [Teoritë e transformimit: Konsolidimi demokratik i shoqërive postautoritare], në: Klaus von Beyme (ed.): Politische Theorien in der Ära der Transformation [Teoritë politike në erën e transformimit], Opladen 1996, f. 36. Rreth çështjes së hulumtimit të transformimit krahe, edhe Adam Przeworski: Democracy and the Market. Political and Economic Reforms in Eastern Europe and Latin America, Kembrixh 1995; Richard Gunther etj. (ed.): The Politics of Democratic Consolidation. Southern Europe in comparative perspective, Baltimor 1995.

³⁰⁰ W. Merkel: Theorien der Transformation: Die demokratische Konsolidierung postautoritärer Gesellschaften [Teoritë e transformimit: Konsolidimi demokratik i shoqërive postautoritare], në: Klaus von Beyme (ed.): Politische Theorien in der Ära der Transformation [Teoritë politike në erën e transformimit], Opladen 1996, f. 36.

kohëzgjatje të ekzistencës e kishte sistemi i mëparshëm autoritar? Si rrodhi shkatërrimi i regjimit të vjetër, si rrodhi faza e transicionit? Cilat strategji ndiqnin elitat vendimmarrëse në fazën e transicionit dhe të konsolidimit dhe si u perceptuan këto nga masat?³⁰¹ Si faktorë të rëndësishëm *ekzogjenë* në procesin e ndërrimit të sistemit përmenden këto dimensione: stabiliteti demokratik i shteteve fqinje, përfshirja në aleanca supranacionale dhe ndërkombëtare ekonomike e politike, shërbimet mbështetëse ndërkombëtare.³⁰²

Këto grupe faktorësh *endogjenë* dhe *ekzogjenë*, të përmendur nga Ph. SCHMITTER, sipas mendimit tim kanë rëndësi esenciale edhe për sa i përket konsolidimit të shtetit ligjor funksionues, përkatësisht integritetit të rajonit të Ballkanit Perëndimor në BE. Këtu duhet pasur parasysh edhe se në diskursin rreth procesit të ndërrimit të sistemit ka definicione të ndryshme të një procesi të konsoliduar demokratik. Lidhur me këtë, politologu Manfred G. SCHMIDT konstaton:

„Pa shqyrtimin e efekteve reciproke të faktorëve përcaktues të shtetit kombëtar dhe ndërkombëtar, si p.sh. të një mjedisi ndërkombëtar që shkon me demokracinë ose që është i dëmshëm për demokracinë, nuk do të mund të kuptohet suksesi ose mospuksesi i demokratizimit të shteteve dikur autoritare.”³⁰³

W. MERKEL lidhur me konsolidimin demokratik flet për një sekuencë të tri fazave që interferojnë njëra-tjetrën: Konsolidimi strukturor (kushtetuta, organizimi i shtetit) ndikon në rrafshin e konsolidimit reprezentativ (partitë, shoqatat), pas të cilit vjen procesi afatgjatë i konsolidimit civilo-kulturor. W. MERKEL konstaton se vetëm nëse kalohen me sukses të trija fazat e konsolidimit, mund të flitet për një demokraci vërtet të konsoliduar dhe rezistente ndaj krizave.³⁰⁴ Të trija fazat janë ende në pelena në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, sidomos në ato kryesoret jostabile si p.sh. Serbia. Edhe në vetë rastin më pozitiv do të mund të zgjaste edhe një dekadë a më shumë derisa të mund të flitet për një demokraci të konsoliduar dhe rezistente ndaj krizave në këto vende.

Në lidhje me këtë, do të duhej të përmendet edhe teza, në përgjithësi e njohur, se vala e tretë përkatësisht e katërt e demokratizimit kanë nxjerrë „demokraci tejet

³⁰¹ Krah. Ph. C. Schmitter: The Consolidation of Democracy in Southern Europe, manuskript i papublikuar, Firencë 1988, f. 93.

³⁰² Krah. Ph. C. Schmitter: The Consolidation of Political Democracy in Southern Europe (and Latin Amerika), manuskript i papublikuar, Firencë 1985, S. 64.

³⁰³ Manfred G. Schmidt: Der Januskopf der Transformationsperiode [Koka me dy fytyra e periudhës së transformimit], në: K. von Beyme (ed.): Politische Theorien in der Ära der Transformation [Teoritë politike në erën e transformimit], Opladen 1996, f. 203.

³⁰⁴ Krah. Wolfgang Merkel: Transformationsstrategien, Probleme, Erfahrungen und Grenzen [Strategjitë e transformimit, problemet, përvojat dhe kufijtë], në: Internationale Politik 6/1995, f. 5.

fragjile”³⁰⁵. Të tillat „demokraci fragjile”, sipas mendimit tim, përballojnë procesin e demokratizimit dhe sidomos etablimin dhe përforcimin e sundimit të ligjit vetëm me ndihmën e përhershme dhe të gjerë prej demokracive më të etabluara dhe ekonomikisht më të forta ose prej bashkimeve supranacionale si BE-ja si „[...] perandoria e parë demokratike në histori mbi bazën e bashkimit në shumëllojshmëri [...]”³⁰⁶. Përveç kësaj, në procesin e demokratizimit dhe të transformimit duket të jetë e nevojshme krahas vullnetit edhe aftësia e qëndrueshmërisë, e shoqëruar nga vizionet, në mënyrë që të mos i lihen alternativa demokracisë liberale³⁰⁷ dhe sundimit të ligjit. Vëshirësitë që mund të shfaqen me këtë rast na i përkujton M. G. SCHMIDT: „Posaçërisht delikat është problemi i demokratizimit dhe privatizimit të ekonomisë që ndodhin njëkohësisht, në qoftë se të dy shoqërohen me pritsmëri të mëdha që shpejt dëshpërohen.”³⁰⁸

M. G. SCHMIDT tek transformimi i teorive të demokracisë në epokën e transformimit dallon mes katër familjeve të teorive të demokracisë: a) e *drejtimit të vënies së procesit në qendër*, b) e *qasjes së vënies në qendër të institucioneve ose të formës*, c) e *teorisë së demokracisë së orientuar në input dhe output* dhe d) e *teorisë së vënies së transicionit dhe të funksionit në qendër*, e doktrinës së parakushteve të funksionit të demokracisë dhe të transicionit kah shteti demokratik. *Teoria që vë në qendër transicionin dhe funksionin* bazohet në qasje funksionaliste: Hulumtohen para së gjithash struktura dhe dinamika e kalimit nga shteti autoritar në demokraci.³⁰⁹

Vendet e Ballkanit Perëndimor arritën lidhjen e plotë me të ashtuquajturën „valën e tretë të demokratizimit”³¹⁰ përkatësisht me thelbin e „valës së katërt të

³⁰⁵ Gretchen Casper: *Fragile Democracies*, Londër 1995.

³⁰⁶ Peter Coulmas: *Die vielen Nationen und die Einheit der Welt. Die Grenzen des Universalen [Kombet e shumta dhe uniteti i botës. Kufijtë e universalës]*, në: *Europa – Archiv* 1994, f. 545.

³⁰⁷ M. G. Schmidt konstaton se „[...] nuk [ka] teori të demokracisë, por [ka] shumë teori të demokracisë me shtat krejtësisht të ndryshëm.” M. G. Schmidt: *Der Januskopf der Transformationsperiode [Koka me dy fytyra e periudhës së transformimit]*, në: K. von Beyme (ed.): *Politische Theorien in der Ära der Transformation [Teoritë politike në erën e transformimit]*, Opladen 1996, f. 186. Edhe teoricienë të tjerë të demokracisë aprovojnë këtë mendim. Krahas. p.sh. David Held: *Models of Democracy*, Kembrixh, Oksford 1996.

³⁰⁸ M. G. Schmidt: *Der Januskopf der Transformationsperiode [Koka me dy fytyra e periudhës së transformimit]*, në: K. von Beyme (ed.): *Politische Theorien in der Ära der Transformation [Teoritë politike në erën e transformimit]*, Opladen 1996, f. 200.

³⁰⁹ Krahas. po aty, f. 186 v. Krahas teorisë së demokracisë të orientuar kah inputi dhe outputi, që i bashkon të gjitha tri dimensionet e politikës (forma, procesi dhe përmbajtja politike – polity, politics, policy), më duken se teoria që vë në qendër transicionin dhe funksionin është baza më relevante teorike për analizën e proceseve të demokratizimit dhe të transformimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

³¹⁰ Krahas. Samuel P. Huntington: *The Third Wave*, Londër 1991; W. Merkel: *Transformationsstrategien, Probleme, Erfahrungen und Grenzen [Strategjitë e transformimit, problemet, përvojat dhe kufijtë]*, në: *Internationale Politik* 6/1995, f. 3-8.

demokratizimit³¹¹ tek pasi që NATO „më shumë *volens* sesa *nolens*”³¹² e detyroi përfundimin e luftës gjenocidale³¹³ në Kosovë dhe rreth Kosovës, të cilën e zhvilloi RFJ-ja e *Milošević-it* përkatësisht Republika e Serbisë. Operacioni i NATO-s „Allied Force” i zhvilluar mes 24 marsit dhe 10 qershorit 1999, në përgjithësi vlerësohet si vijon: „nuk [... kishte] funksionuar shumë mirë në sulmet e saj kundër caqeve në rrafshin taktik, por ajo i ka arritur të gjitha objektivat strategjike dhe operacionale.”³¹⁴ Operacioni i NATO-s shkaktoi mes tjerash edhe përsheptimin e rënies së regjimit të Milošević-it dhe me këtë edhe orientimin e Serbisë në drejtim të demokratizimit dhe të transformimit. Megjithatë, p.sh. eksperti për çështje të politikës së jashtme dhe të sigurisë Karl KAISER udhëzon te çështja problematike e legjitimitetit sipas të drejtës ndërkombëtare:

„Lufta e Kosovës nuk ia dha fund vetëm spastrimit etnik, por solli edhe „ndërrimin e regjimit”. [...] Edhe nëse intervenimi i NATO-s solli një rezultat, i cili sipas standardeve të çdo kulture dhe sipas normave universale të të drejtave të njeriut do vlerësuar pozitivisht, atij prapëseprapë i mungon legjitimiteti sipas rregullave të Kombeve të Bashkuara.”³¹⁵

Pavarësisht nga çështjet dogmatike-juridike të të drejtës ndërkombëtare, të cilat këtu nuk mund të shpjegohen më tutje, disa autorë operacionin „Allied Field” e quajtën madje një „luftë bashkuese evropiane”.³¹⁶

Një pikë e rëndësishme është për Evropën para së gjithash edhe përsiatja rreth një arkitekture të re të sigurisë.³¹⁷ Qysh gjatë operacionit „Allied Force”, BE-ja ndërmori

³¹¹ Krah. Klaus von Beyme: Systemwechsel in Osteuropa [Ndërrimi i sistemit në Evropën Lindore], Frankfurt am Main 1994.

³¹² Manuel Eising, Philipp Reszat: Die internationale Notstandsverwaltung im Kosovo [Administrata ndërkombëtare emergjente në Kosovë], në: Osteuropa Recht, 1/2003, f. 3.

³¹³ Krah. p.sh. O. Luchterhandt: Völkermord: Humanitäre Intervention – Recht contra Moral? Der Fall »Kosovo« [Gjenocidi: Intervenimi humanitar – e drejta kundër moralit? Rasti »Kosova«], në: Zeitschrift für Genozidforschung 1/1999.

³¹⁴ Klaus Naumann: NATO, Kosovo, and Military Intervention, në: Global Governance, United Nation University, Boulder, vëll. 8, janar – mars 2002, f. 14.

³¹⁵ Karl Kaiser: Der Balkan als Modell [Ballkani si model], në: Internationale Politik 11/2003, f. 24.

³¹⁶ „Shumë më fort se sa që kishin dëshiruar patosi evropian apo përlloraritja ekonomike, thuhet se ballafaqimi me regjimin e Milošević-it e ka mprehur vetëdijen se qenkan të nevojshme bashkimi i kontinentit dhe krijimi i sigurisë, demokracisë dhe ekonomisë së tregut. Luftimi në Fushën e Mëllenjave qenka për këtë arsye diçka e tillë si një „luftë bashkuese evropiane”.” Michael Ludwig: War der Krieg in Kosovo ein „europäischer Einigungskrieg”? [A ishte lufta e Kosovës një „luftë bashkuese evropiane”?], në: Frankfurter Allgemeine Zeitung, 29 qershor 1999.

³¹⁷ „Në kushtet praktike, kriza e Kosovës ka krijuar tashmë një gatishmëri më të madhe për të menduar seriozisht për arkitekturën e ardhshme të sigurisë të Evropës.” Roberta N. Haar: The Kosovo Crisis and its Consequences for a European Security Architecture, në: Kurt R.

hapa të rëndësishëm lidhur me të ardhmen e procesit të demokratizimit dhe të transformimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Kështu argumenton p.sh. politologu Rafael BIERMANN: „Se partnerët në BE u bënë të gatshëm, përkundër rezervave të shprehura me vite të tëra, që procesin e zgjerimit tashmë ta hapnin edhe kah Evropa Juglindore, kjo është për t’u kuptuar vetëm para një prapavije politike-psikologjike të operacioneve që po rrjedhin në Kosovë.”³¹⁸

Edhe për vetë shtetet e dikurshme komuniste që dëshirojnë demokratizim, paraqet sfidë të posaçme që në të njëjtën kohë t’i fillojnë proceset e transformimit në rrafshin politik, ekonomik dhe të shoqërisë civile.³¹⁹ Tensionet etnikisht të motivuara në rajonin e Ballkanit Perëndimor paraqesin sfida shtesë në këto procese. Hapësira e dikurshme jugosllave përveç kësaj është e karakterizuar ende fuqishëm nga pasojat e luftërave, si në kuptimin material, ashtu edhe në atë mendor.

Do ta tejkalonim kornizën e këtij punimi po të shpjegojm çështjen hipotetike nëse regjimet si në Serbi³²⁰ në vitet e 1990-ta ose në Gjermani para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore do të mund të ‚demokratizoheshin’ pa përdorimin e dhunës ushtarake. Prapëseprapë, procesi i demokratizimit që filloi pas Luftës së Dytë Botërore shfaq ngjashmëri me atë të transicionit, në të cilin gjendet tash sa vjet rajoni i Ballkanit Perëndimor.³²¹ Sikur në Gjermani, Austri, Itali dhe Japoni pas Luftës së Dytë Botërore, edhe tani po bëhen përpjekje që në disa vende të Ballkanit Perëndimor demokratizimi dhe procesi i krijimit të shtetit ligjor të dekretohet dhe të nisët përmes *inxhinieringut* politiko-juridik, edhe pse këto vende, për dallim nga shembujt e përmendur në fillim, nuk shfaqin gati aspak tradita të pavarura të „shtetit”. Këtë rast e kemi sidomos në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Kosovë, në vende që qëndrojnë nën patronatin e protektorëve ndërkombëtarë.³²²

Spillmann, Joachim Krause (ed.): Kosovo: Lessons Learned for International Cooperative Security, Bernë etj. 2000, f. 118.

³¹⁸ Rafael Biermann: Die europäische Perspektive für den westlichen Balkan. Die EU im Zwiespalt [Perspektiva evropiane për Ballkanin perëndimor. BE-ja në mospajtim], në: Osteuropa. Zeitschrift für Gegenwartsfragen des Ostens, 8/2001, f. 925.

³¹⁹ Krahe, W. Merkel: Transformationsstrategien, Probleme, Erfahrungen und Grenzen [Strategjitë e transformimit, problemet, përvojat dhe kufijtë], në: Internationale Politik 6/1995, f. 5.

³²⁰ Rreth dinamikës interne të nacionalizmit serb në procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë shiko Florian Bieber: Serbischer Nationalismus vom Tod Titos zum Sturz Miloševićs, Dissertation an der Universität Wien [Nacionalizmi serb pas vdekjes së Titos deri te rrëzimi i Milošević-it, disertacion pranë Universitetit të Vjenës], Vjenë 2001.

³²¹ Disa autorë me të drejtë tërheqin një paralele midis politikës luftarake nacional-socialiste gjermane dhe asaj serbe. Kështu për shembull C. Offe, kur shkruan: „Një kombinim i të dy alternativa — zaptim dhe dëbim — ishte tipari i politikës luftarake gjermane në Luftën e Dytë Botërore por edhe i politikës serbe në ish-Jugosllavi” C. Offe: Der Tunnel am Ende des Lichts. Erkundungen der politischen Transformation im Neuen Osten [Tuneli në fund të dritës. Gjurmime të transformimit politik në Lindjen e Re], Frankfurt am Main, Nju Jork 1994, f. 178.

³²² Krahe, rreth kësaj H. Riegler: Internationale Protektorate als Modelle zur Stabilisierung von Nachkriegsgebieten im ehemaligen Jugoslawien: Bosnien-Herzegowina und Kosovo im

Vende të veçanta të hapësirës së Ballkanit si Bullgaria dhe Rumania u dëmtuan nga situata vazhdimisht instabile e viteve të 1990-ta në hapësirën e RSFJ-së së dikurshme. Edhe Shqipëria, e cila si vend i vetëm i rajonit të Ballkanit Perëndimor nuk ishte e prekur drejtpërsëdrejti nga luftërat në hapësirën e RSFJ-së së dikurshme, vuante nën pasojat e instabilitetit dhe mund ta çonte përpara procesin e vet të demokratizimit vetëm me thyerje të mëdha.³²³

Në Kroaci fillimi i procesit të demokratizimit dhe i transformimit, sidomos në vitet e para pas kthesës më 1989, ishte po ashtu i shoqëruar me vështirësi serioze. Për dallim nga Shqipëria, në Kroaci duhej të arrihej njohja ndërkombëtare dhe konsolidimi i shtetit të pavarur, në mënyrë që të nisej procesi i demokratizimit.

Sa më shumë që depërtohet në „vendet kyçe” të rajonit të Ballkanit Perëndimor, aq më të zymta duken sukseset e procesit të demokratizimit dhe të transformimit. Vetëm pas një lufte katërvjeçare mes 1992 dhe 1995 u ulën armët në shtetin e Bosnjës dhe Hercegovinës që më 1992 *de jure* ishte bërë shtet sovran, pasi vendi *de facto* ishte ndarë në dy-tri pjesë. Dy shtetet fqinje, Kroacia dhe para së gjithash Serbia, ishin fort të involvuara dhe bashkëpërgjegjëse në këtë vend gati të vetëm multietnik të Ballkanit Perëndimor me emrin Bosnjë dhe Hercegovinë. Kundërshtarët në rajonin e Ballkanit Perëndimor S. MILOŠEVIĆ dhe Franjo TUDJMAN ishin dakord kur bëhej fjalë për Bosnjën dhe Hercegovinë:³²⁴ „[...] së pari serbët e më vonë edhe kroatët – me ndihmën masive të „shteteve amë” të tyre, vendosën kundër pavarësisë së Bosnjës dhe Hercegovinës dhe për bashkimin e territoreve „të tyre” me shtetin amë.”³²⁵

Për dallim nga Bosnja dhe Hercegovina, e cila në vazhden e bërjes formale sovraane u involvua në një luftë, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë³²⁶ arriti të

Vergleich [Protektoratet ndërkombëtare si modele për stabilizimin e territoreve të pasluftës në Jugosllavinë e dikurshme: Bosnja-Hercegovina dhe Kosova në krahasim], në: Österreichisches Handbuch für Internationale Politik, Vjenë 2000, f. 147-66.

³²³ Krahe. Michaela Salamun, Arben Hajrullahu: Verfassung und demokratisch-politische Aspekte der Verfassungswirklichkeit seit 1990 [Kushtetuta dhe aspektet demokratiko-politike të realitetit kushtetues që nga viti 1990], në: Peter Jordan etj. (ed.): Österreichische Osthefte, Albanien, Österreichisches Ost- und Südosteuropa-Institut [Fletoret Austriake të Lindjes, Shqipëria, Instituti Austriak për Evropën Lindore dhe Juglindore], Vjenë 2003, f. 343-77.

³²⁴ „Si pasojë e grindjeve në rritje mes serbëve dhe kroatëve, republika shumëkombëshe e Bosnjës dhe Hercegovinës ra gjithnjë e më shumë në vorbullën e ideologjive nacionaliste”, shënonte për shembull Janine M. Calic: Der Krieg in Bosnien und Herzegovina. Ursachen, Konfliktstrukturen, Internationale Lösungsversuche [Lufta në Bosnjë dhe Hercegovinë. Shkaqet, strukturat e konfliktit, përpjekjet ndërkombëtare për zgjidhje], Frankfurt mbi Main 1995, f. 81.

³²⁵ H. Riegler: Internationale Protektorate als Modelle zur Stabilisierung von Nachkriegsgebieten im ehemaligen Jugoslawien: Bosnien-Herzegowina und Kosovo im Vergleich [Protektoratet ndërkombëtare si modele për stabilizimin e territoreve të pasluftës në Jugosllavinë e dikurshme: Bosnja-Hercegovina dhe Kosova në krahasim], në: Österreichisches Handbuch für Internationale Politik, Vjenë 2000, f. 148.

³²⁶ Republika e Maqedonisë u njoh nga OKB-ja më 8 prill 1993 nën emrin e përkohshëm Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (*The Former Yugoslav Republic of Macedonia* –

fitojë pavarësinë si njësi e vetme federale e RSFJ-së së dikurshme, pa zhvilluar një grindje luftarake me Serbinë.³²⁷ Megjithatë, Maqedonia gjatë vitit 2001 nuk mbeti e kursyer nga konfliktet e brendshme që i ngjanin luftës. Mirëpo, tensionet ndëretnike u zbutën falë një ndërhyrjeje të shpejtë dhe konsekuente të bashkësisë ndërkombëtare me nënshkrimin e Marrëveshjes së Ohrit³²⁸. Në këtë rast, edhe BE-ja përmes angazhimit të vet dhe në bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës mundi ta arrinte një sukses të prekshëm të politikës së jashtme në tokën evropiane.

Në „thelbin e rajonit të Ballkanit Perëndimor” Kosova, e përmes kësaj në mënyrë implicite edhe Serbia, mbetën edhe më tej në një paqartësi rreth vazhdimit të procesit të demokratizimit dhe të transformimit, sepse statusi i tyre sipas të drejtës shtetërore, përkatësisht forma e tyre shtetërore, nuk është e definuar qartë.

Bashkësia ndërkombëtare dhe sidomos BE-ja në Serbi përpiqet ta çojë përpara *inxhinieringun* politiko-juridik përmes një politike „të karotës dhe shkopi”. Një proces i demokratizimit dhe i transformimit u nis në Kosovë në gjysmën e dytë të vitit 1999, në Republikën e Malit të Zi para vitit 1999 dhe në Serbi pas rrëzimit të regjimit të S. Milošević-it në vitin 2000.

Konstelacionet e reja në rajonin e Ballkanit Perëndimor zgjojnë shpresat për një të ardhme evropiane. Disa madje flasin për një shans të dytë historik. Kështu p.sh. ndërrimi i pushtetit në Zagreb dhe në Beograd nga i dërguari i posaçëm për Ballkan i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Carl BILD, u cilësua si „[...] një mundësi e dytë historike për të çuar përpara drejt paqes së vërtetë dhe drejt prosperitetit në Ballkan”³²⁹.

Megjithatë, njëkohësisht mbetet i pamohueshëm fakti se qeveritë serbe edhe pas rrëzimit të regjimit të S. Milošević-it nuk janë distancuar deri më sot nga politika serbomadhe e dhjetëvjeçarit të fundit. Te shumica dërrmuese e serbëve, bashkë me udhëheqësinë e tyre politike, vazhdon sidomos tradita e mitit të Kosovës, sipas të cilit „të tjerët” u kanë shkaktuar padrejtësi dhe serbët e shohin veten si viktimë të të kaluarës dhe të të tashmes. Kjo tregon se ndërrimi i pushtetit në Beograd më 2000, i

FYROM) dhe me këtë emër përmendet edhe në komunikimin ndërkombëtar. Greqia fillimisht refuzoi njohjen e Republikës së Maqedonisë me emrin „Maqedonia”, sepse ky emërtim implikon „pretendime territoriale ndaj Maqedonisë greke”, mirëpo pas negociatave 15-muajshe pranoi emrin e përkohshëm „Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë”. Emërtimi i vet është Republika e Maqedonisë (më tutje: Maqedonia).

³²⁷ Njëra prej arsyeve kryesore për këtë duket se qëndron aty se qendra për drejtimin e luftërave në RSFJ-në e dikurshme, në Beograd, në atë kohë nuk ishte e interesuar që të hapej edhe një vijë e frontit në jug, derisa tashmë zhvillonte luftëra së pari në Slloveni e pastaj edhe në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë.

³²⁸ Framework Agreement 13.08.2001 (http://faq.macedonia.org/politics/framework_agreement.pdf).

³²⁹ Carl Bildt: A Second Chance in the Balkans, në: Foreign Affairs, vëll. 80, janar/shkurt 2001, f. 148 v.

cili nga shumë qeveri evropiane cilësohet si „revolucion”, në të vërtetë paraqet vetëm një ndërrim politik dhe kursesë ndërrim të qëndrueshëm të sistemit.³³⁰

II. Ardhmëria e sovranitetit dhe demokracia konsensuale në rajonin e Ballkanit Perëndimor

Pavarësisht nga ajo se çfarë lidhjesh dhe konstelacionesh shtetërore krijohen mes Serbisë e Kosovës, por edhe në përgjithësi mes vendeve të Ballkanit Perëndimor në të ardhshmen, sipas mendimit tim konstatimi vijues i politologut Michael ZÜRN ka gjasa të mëdha: „Krahas parimit të sovranitetit *ndërvarësia mes shoqërive* është tipari i dytë konstituiv i sistemit modern ndërkombëtar.”³³¹ Duke u nisur nga përvojat e deritashme si dhe nga indikatorët e rëndësishëm për ardhmërinë në skenën e Politikës Ndërkombëtare, çështja e hedhur nga M. ZÜRN — „[...] se sistemi ndërkombëtar edhe pas mbarimit të konfliktit Lindje-Perëndim do të jetë në radhë të parë një sistem i cili edhe më tutje do të dominohet nga shtetet nacionale sovrane me shoqëri të ndërvarura?”³³² — është për t’u pohuar bindshëm, me ç’rast rajoni i Ballkanit Perëndimor nuk paraqet asnjë përjashtim.

Sovraniteti i shteteve, e kjo edhe më tepër në një Evropë gjithnjë më fuqishëm të integruar, në fillim të shekullit XXI nuk është për t’u kuptuar në sensin klasik të kohës para themelimit të OKB-së. Në gati asnjë fushë nuk mjaftojnë kapacitetet e shteteve të veçanta nacionale, që vetë t’i përballojnë sfidat rishtas të krijuara të ekonomisë, të sigurisë e deri te çështjet e migracionit. Prandaj aleancat supranacionale po fitojnë vazhdimisht rëndësi.³³³

³³⁰ Është e habitshme se si RFJ-së së *Milošević-it* menjëherë pas këtij ndërrim në Beograd përnjëherë iu hapën dyert dhe portat në organizata të ndryshme ndërkombëtare. Këtu duhet po ashtu të përkujtohet se si më 1996 RFJ-ja e *Milošević-it* u pranua si shtet sovran sidomos nga disa shtete anëtare të BE-së. „BE-ja nuk përdorej më gati aspak si forum nga Franca, erdhi madje te një ‚faul revanshi’ i Francës ndaj Gjermanisë, kur kjo veprimi vetëm gjatë njohjes së pjesës së mbetur të Jugosllavisë më 1996 dhe anëtarët e tjerë të BE-së detyrimisht duhej të pasonin.” Hanns W. Maull, Bernhard Stahl: *Durch den Balkan nach Europa? Deutschland und Frankreich in den Jugoslawienkriegen* [Përmes Ballkanit për në Evropë? Gjermania dhe Franca në luftërat e Jugosllavisë], në: *Politische Vierteljahresschrift. Zeitschrift der Deutschen Vereinigung für Politische Wissenschaft*, 1 mars 2002, f. 98.

³³¹ Michael Zürn: *Konfliktlinien nach dem Ende des Ost-West-Gegensatzes – global handeln, lokal kämpfen* [Vijat e konfliktit pas përfundimit të dallimit Lindje-Perëndim – veprimi globalisht, lufto lokalisht], në: K. von Beyme (ed.): *Politische Theorien in der Ära der Transformation* [Teoritë politike në erën e transformimit], Opladen 1996, f. 100.

³³² Po aty, f. 104.

³³³ Kështu për shembull M. Zürn shkruan: „Megjithatë në gati të gjitha fushat problematike të politikës ndërkombëtare në ndërkohë është etabluar një rrjet i institucioneve dhe regjimeve ndërkombëtare, të cilat interaksionet shoqërore dhe shtetërore i „qeverisin” mbi bazën e normave, parimeve, rregullave dhe mënyrave të veprimit që i kanë zhvilluar bashkërisht. Bashkimi Evropian është shembull më i dukshëm për atë që shtetet përmes institucioneve të

Mirëpo, përkundër kësaj rritjeje të fuqisë së institucioneve ndërkombëtare, shteti kombëtar edhe më tej vepron si faktor kryesor në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe pa praninë e tij nuk do të ishte gati aspak e përfytyrueshme të merreshin në dorë sfidat dhe rreziqet si terrorizmi, krimi i organizuar, ose çështjet globale të mjedisit. Këto mendime lidhur me sfidat në shekullin XXI, sipas mendimit tim do të duheshin marrë parasysh edhe në procesin e demokratizimit dhe të transformimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor, i cili po zgjat që nga fundi i regjimeve komuniste dhe mund të shikohet si ende i papërmbyllur. M. ZURN argumenton si vijon:

„Shkatërrimi i shtetit, i cili i parapriu luftërave civile p.sh. në Jugosllavinë e dikurshme, dhe në Somali, përkatësisht Ruandë, në mënyrë madhështore na e solli para syve se arritjet civilizuese të shtetit kombëtar, me gjithë kritikën e drejtë, nuk guxojnë të na humbin prej sysh. Nga kjo del: Shteti kombëtar jo vetëm që do të mbetet, por ka edhe arsye të mira që mbetja e tij të mirëpritet.”³³⁴

Shteti kombëtar i shekullit XXI mund të kuptohet vetëm në kontekstin e globalizimit. Procesi i globalizimit mbështet depërtimin botëror të standardeve themelore të sundimit të ligjit duke qenë se institucioneve ndërkombëtare po u shtohet rëndësia. Mirëpo, kjo do të duhej parë në mënyrë kritike, thotë zëvendës drejtori i *Institute Français des Relations Internationales* Dominique MOÏSI: „Modeli evropian tregon se edhe në një epokë globale, logjika ekonomike e tregut vetë nuk mund t’u përgjigjet të gjitha pyetjeve të ngritura nga globalizimi. Me pak fjalë, një treg botëror nuk e krijon një komunitet botëror.”³³⁵

Konkluzioni se shteti kombëtar, përkundër rritjes së fuqisë së organizatave supranacionale nuk e humb rëndësinë e vet, vlen edhe për rajonin e Ballkanit Perëndimor. Tani del pyetja se cila formë e demokracisë do të ishte më e përshtatshme që për shtetet e Ballkanit Perëndimor ta çonte përpara procesin e krijimit të sundimit të ligjit?

Për vendet e Evropës së Mesme, që më herët qeveriseshin në mënyrë autoritare, politologu Arend LIJPHART rekomandon kushtetuta, të cilat bazohen në modelin e një *demokracie konsensuale* dhe në *sistemin zgjedhor proporcional*. Rekomandimet e tij ai i mbështet në rezultatet e studimeve të veta krahasuese rreth fuqive dhe dobësive të demokracive konsensuale dhe mazhoritare në vendet perëndimore.³³⁶ Hulumtuesi i paqes Dieter SENGHAAS e vlerëson *demokracinë konsociacionale* si po

tilla përpiqen t’i fitojnë prapë në një rrafsh të ri kapacitetet vepruese që i kanë humbur.” Po aty, f. 112.

³³⁴ Po aty, f. 123.

³³⁵ Dominique Moïsi: *Dreaming of Europe*, në: *Foreign Policy*, Nr. 115, Uashington 1999, f. 56.

³³⁶ Krah. Arend Lijphart: *Democracies*, New Heaven, Londër 1984; Arend Lijphart: *Democratization and Constitutional Choices in Czechoslovakia, Hungary and Poland 1989 – 1991*, në: *Journal of Theoretical Politics*, vëll. 4, 1992, f. 207-23.

ashtu potencialisht të dobishme për zgjidhjen e konflikteve etno-nacionaliste.³³⁷ W. MERKEL na e bën me dije se për shoqëritë e ndara në kuptimin etniko-linguistik, fetar a rajonal, elementet konsensuale në rendin e të drejtës kushtetuese janë më inklusive dhe më eficiente. Edhe sistemi qeveritar parlamentar me zgjedhje proporcionale e përmbush më mirë kërkesën e *inkluzionit* sesa sistemi presidencial.³³⁸

Në bazë të kësaj, në rajonin e Ballkanit Perëndimor përdoret kryesisht modeli i *demokracisë konsensuale* dhe i *sistemit zgjedhor proporcional*. Sipas A. LIJPHART *demokracitë konsensuale* dalin më mirë se *demokracitë mazhoritare* në çështjet e partisipimit, të hapjes ndaj pakicave si dhe në çështje të politikës ekonomike.³³⁹ Ballafaqimi me këto tri komplekse temash është i pashmangshëm për një stabilizim dhe demokratizim të qëndrueshëm të vendeve të Ballkanit Perëndimor; megjithatë, nuk janë gjetur përgjigje të kënaqshme.

Gjatë zbatimit praktik të këtyre mendimeve teorike rreth *demokracisë konsensuale*, ekspertët e angazhuar në rajonin e Ballkanit Perëndimor konstatojnë më parë efekte negative. Kështu p.sh. J. MARKO shkruan:

„Në kundërshtim të filozofisë demokratike konsociacionale të kooperimit të elitave për shkak të ndarjes së pushtetit përmes proporcionit etnik, në Bosnjë ka pasur vetëm një „kompromis negativ“: kështu elitat politike sipas formulës *divide et impera* në etnitet dhe përmes tij e kanë ndarë pushtetin dhe e dominojnë edhe në këtë mënyrë klientelën e tyre përkatëse etnike.”³⁴⁰

Aplikimi i demokracisë konsociacionale, sipas mendimit tim, në vendet e Ballkanit Perëndimor mund të shpallë efektet pozitive vetëm në faza të caktuara të

³³⁷ Krah. D. Senghaas: *Wohin driftet die Welt? [Kah shmanget bota?]*, Frankfurt mbi Main 1994, f. 91.

³³⁸ Krah. W. Merkel: *Transformationsstrategien, Probleme, Erfahrungen und Grenzen [Strategjitë e transformimit, problemet, përvojat dhe kufijtë]*, në: *Internationale Politik* 6/1995, f. 6 v.

³³⁹ Krah. Arend Lijphart: *Democracies: Forms, performance, and constitutional engineering*, në: *European Journal of Political Research* 25/1994, f. 1-17; Krah. rreth kësaj edhe Manfred G. Schmidt: *Demokratietheorie. Eine Einführung [Teoria e demokracisë. Një hyrje]*, Opladen 1995, Kap. 3.1-3.7.

³⁴⁰ Joseph Marko: *Das Verfassungsprovisorium von Dayton [Provizoriumi kushtetues i Dejtonit]*, në: *Balkan, Südosteuropäischer Dialog, Jed. 2 /Heft 6, Vjenë etj.* 2002, f. 68. Vëzhgime të ngjashme konstatohen edhe nga autorë të tjerë në rajone të tjera të botës: „Edhe ky model [demokracia konsociacionale] sigurisht nuk mund të sheshojë sa herë kontradiktat. Është provuar në Qipro, kanë dashur t'i lidhin grekët dhe turqit në një kushtetutë të tjerrë hollë të demokracisë konsociacionale. Mirëpo, kontradikta etnike mes dy popujve, armiqësia historike e ka shqyer këtë fill kushtetues.” P. Graf Kielmansegg: *Frieden durch Demokratie [Paqja përmes demokracisë]*, në: D. Senghaas (ed.): *Den Frieden denken, Si vi pacem, para pacem [Ta mendosh paqen, Si vi pacem, para pacem]*, Frankfurt mbi Main 1995, f. 118.

transformimit dhe nën parakushte të caktuara, dhe vetëm nëse është e pranishme një vetëdije e caktuar politike, të cilën J. MARKO e përshkruan në mënyrë të saktë:

„Suksesi i sistemit demokratik konsociacional mbështetet prandaj në fund të fundit te një kulturë politike, ku është i pranishëm vullneti për barazim: ku shumica heq dorë nga dominimi mbi pakicën dhe në kuptimin e modelit të dialogut mbi bazën e njohjes asaj i del përballë si e barabartë.”³⁴¹

Demokracia konsensuale dhe sidomos të ashtuquajturat të drejta pozitive të pakicave duken aq më të nevojshme për një shtet ligjor funksionues, derisa shteti në kuptimin juridiko-normativ është i determinuar nga një komb titullar etnikisht i definuar, siç është përkatësisht rasti kryesisht në shtetet e Evropës Juglindore, për dallim nga një model shteti, ku shumica e të gjithë shtetasve perceptohet si komb si në rrafshin juridik ashtu edhe në atë të identitetit, siç është p.sh. rasti në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Francë apo në Britani të Madhe.

Këto përsiatje duhen parë në kontekstin e ballafaqimit me çështjen e një procesi të demokratizimit dhe të transformimit potencialisht të suksesshëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Roli vendimtar i elitave në procesin e deritanishëm të bashkimit evropian theksohet nga politologu Anton PELINKA, i cili konstaton: „[...] bashkimi evropian ishte një projekt i udhëheqësive elitare partiake, e s’ishte gati aspak projekt i „masave punëtore”³⁴². Se si do të mund të arrihej integrimi në BE në rajonin e Ballkanit Perëndimor, sa kohë nuk ka të pranishme udhëheqësi elitare partiake me vizione evropiane, mbetet çështje e hapur dhe njëkohësisht sfidë për të ardhmen e proceseve të integritit të rajonit të Ballkanit Perëndimor në BE.

³⁴¹ Joseph Marko: *Autonomie und Integration. Rechtsinstitute des Nationalitätenrechts im funktionalen Vergleich* [Autonomia dhe integrimi. Institutet juridike të së drejtës së nacionaliteteve në krahasimin funksional], Vjenë etj. 1995, f. 533.

³⁴² Anton Pelinka: *Die Linke – kein Nachruf* [E majta – jo nekrologji], në: *Die Presse* (Spectrum), 15 mars 2003, f. I.

„Mirëpo, ashtu siç deri më tani askush nuk ia ka dalë të vërë në letër gjithçka rreth nacionalizmit, ashtu është edhe me çdo rresht që merret me nacionalizmin ballkanik ose atë e trajton si problem, i vjetruar ky qysh gjatë të shkruarit.”³⁴³

B. Vendet e Ballkanit Perëndimor ndërmjet nacionalizmit dhe integritit në BE

I. Mobilizimi për krijimin e shteteve kombëtare

Lidhja e Kombeve e Gjenevës më 1920 gjatë themelimit të saj numëronte 42 anëtarë. Organizata e saj pasardhëse, OKB-ja, gjatë themelimit më 1945 kishte 51 anëtarë. Deri në vitin 2003 numri i shteteve sovraane u rrit në 191.³⁴⁴ Këto shifra lënë që të arrihet në përfundimin se numri i shteteve kombëtare, të cilat kanë për bazë ideologjinë më të suksesshme në botë, nacionalizmin, u rrit vazhdimisht gjatë shekullit XX. Mirëpo, paqja, ligji dhe rendi si detyra thelbësore të shtetit, nga shumë shtete përmbushen vetëm në mënyrë shumë të kufizuar ose nuk përmbushen fare.³⁴⁵ Njëkohësisht, më shumë se tremijë popuj synojnë një shtet të pavarur, dhe shumë prej tyre nuk përjashtojnë mundësinë e përdorimit të dhunës.

Në vijën e këtij trendi botëror, rajoni i Ballkanit Perëndimor nuk paraqet kurrfarë përjashtimi. „Situata jugosllave mund të përkufizohet në tri fjali: (1) një shoqëri pa një shtet; (2) një ekonomi pa një treg; (3) një popull pa liri e demokraci.”³⁴⁶ Këto tri pika, sipas mendimit tim, i japin në pjesë të madhe përgjigjen pyetjes se pse në territorin e RSFJ-së me fundin e regjimit komunist nuk ishte i realizueshëm një proces i përbashkët i transformimit, përkatësisht një mobilizim i përbashkët i njërive federale drejt një integriti evropian dhe euroatlantik, dhe pse qysh në fillim të viteve të 1990-ta dukej si i pashmangshëm krijimi i shteteve të reja sovraane.

Socialpsikologu Hans FÜCHTNER e vlerëson kombin si një konstruksion ideologjik:

³⁴³ Milčo Lalkov: Nationalismus auf dem Balkan heute oder das Erwachen eines alten Dämons [Nacionalizmi në Ballkan sot ose zgjimi i një demoni të vjetër], në: Valeria Heuberger etj. (ed.): Der Balkan. Friedenszone oder Pulverfass? [Ballkani. Zonë e paqes apo fuçi baroti?], Frankfurt am Main etj. 1998, f. 196.

³⁴⁴ Krah. faqen e OKB-së në adresën <http://www.un.org/Overview/growth.htm>

³⁴⁵ Krah. Peter Coulmas: Das Problem des Selbstbestimmungsrechts. Mikronationalismen, Anarchie und innere Schwäche der Staaten [Problemi i të drejtës së vetëvendosjes. Mikronacionalizmat, anarkia dhe dobësia e brendshme e shteteve], në: Europa – Archiv 1993, f. 87.

³⁴⁶ Keith Sword (ed.): The Times Guide to Eastern Europe, Londër 1991, f. 154. Kësaj renditjeje nga viti 1991 i janë shtuar pasojat ekonomike, politike dhe sociale të luftës.

„Sado i rëndësishëm që është gjykimi se kombi është „shpikur” dhe mundësuar veç përmes propagandës nacionaliste, po aq gabim është megjithatë, të mos merret parasysh se nacionalizmi vetë nuk ishte pa parakushte, por lidhej me rrethanat historike.”³⁴⁷

Siç treguan përvojat e dhjetëvjeçarëve të fundit, vendet e Ballkanit Perëndimor arritën lidhjen me këto rrethana historike në kohëra të ndryshme dhe me shpejtësi të ndryshme. Për shembull, historiani Arnold SUPPAN, lidhur me procesin e krijimit të kombit, e përshkruan kombin në Ballkan në mënyrë të saktë si „[...] ideologjikisht, një përzierje e idesë franceze të shtetit nacional, kombit të fesë ortodokse dhe kombit kulturor sipas Herderit [...]”.³⁴⁸ Këtë kombinim me elemente të botëkuptimit francez dhe gjerman për shtetin në Evropën Juglindore e vlerëson kthjellët historiani Holm SUNDHAUSSEN si vijon: „Një zgjedhje edhe më fatkeqe nuk do të mund të bënin.”³⁴⁹ A. SUPPAN, lidhur me krijimin e shtetit nacional në Ballkan, përfaqëson mendimin „[...] se ky zhvillim ende nuk është përmbyllur [...]”.³⁵⁰ Njëkohësisht autorë të tjerë konstatojnë me të drejtë se synimi për „zgjidhje përfundimtare në çështjet kombëtare” kanos stabilitetin rajonal.³⁵¹

³⁴⁷ Hans Füchtner: Vaterlandssyndrom. Zur Sozialpsychologie von Nationalismus, Rechtsradikalismus und Fremdenhaß [Sindroma e atdheut. Për socialpsikologjinë e nacionalizmit, radikalizmin e djathtë dhe urrejtjen e të huajve], Hajdelberg 1996, f. 13.

³⁴⁸ Arnold Suppan: Konvergenz und Divergenz in der Geschichte [Konvergenca dhe divergenca në histori], në: Valeria Heuberger etj. (ed.): Der Balkan. Friedenszone oder Pulverfass? [Ballkani. Zonë e paqes apo fuçi baroti?], Frankfurt mbi Main etj. 1998, f. 11.

Në pikëpamje politike konceptimet franceze dhe gjermane për kombin – subjektivisht politikja e Revolucionit Francez dhe objektivisht kulturorja e romantikës gjermane – vlejën si figura kyçe Abbé Sieyès dhe Johan Gottfried von Herder. Abbé Sieyès mendon në pamfletin e tij „Çfarë është rendi i tretë?” (janar 1789) se kombi ishte së pari aty dhe është zanafilla e të gjithave. J. G. von Herder i barazon po ashtu kombin dhe popullin, mirëpo për dallim nga Abbé Sieyès ai nuk flet për politikë, por për gjuhën dhe poezinë, të cilat sipas tij qenkan themelet e popullit dhe të kombit. Krah. Hagen Schulze: Staat und Nation in der europäischen Geschichte [Shteti dhe kombi në historinë evropiane], Munihi 1994, f. 168 vv.

³⁴⁹ Holm Sundhaussen: Staatsbildung und ethnisch-nationale Gegensätze in Südosteuropa [Krijimi i shtetit dhe kontradiktat etnike-nacionale në Evropën Juglindore], në: Aus Politik und Zeitgeschichte. Beilage zur Wochenzeitung Das Parlament, 10-11/3 mars 2003, f. 7.

³⁵⁰ Arnold Suppan: Konvergenz und Divergenz in der Geschichte [Konvergenca dhe divergenca në histori], në: Valeria Heuberger etj. (ed.): Der Balkan. Friedenszone oder Pulverfass? [Ballkani. Zonë e paqes apo fuçi baroti?], Frankfurt mbi Main etj. 1998, f. 11. Pikëpamje të ngjashme lidhur me krijimin e kombit përfaqësojnë edhe autorë të tjerë, kur mendojnë: „Procesi nuk do të jetë përmbyllur me gjasë asnjëherë. Krijimi i kombit ka nevojë për një ripërtëritje permanente edhe në një stadium të pjekur.” Konrad Melchers: Nationsbildung mit Januskopf. Heutige Gründe und Treibkräfte des Nationalstaats [Krijimi i kombit me kokë me dy fytyra. Arsytet dhe forcat shtytëse të shtetit nacional], në: Entwicklungspolitik 1/2/2003, f. 24.

³⁵¹ „Derisa palët në konflikt insistojnë pa kompromis në një finalitë përkatëse në procesin e krijimit të shtetit dhe të kombit, për aq stabiliteti rajonal do të jetë një himerë.” Wim van Meurs: Der Balkan am Verhandlungstisch [Ballkani në tavolinën e negociatave], në: Europäische Rundschau, 1/2002, f. 63.

Përkundër të gjitha proceseve të integrimit dhe të globalizimit, shteti kombëtar shërben edhe në shekullin XXI si *protagonist kryesor* në ngjarjet botërore. Kategoritë e shumicave dhe të pakicave kombëtare janë produkt i shtetit kombëtar dhe ato përcaktojnë dallimet, të cilat e mbajnë aktuale pyetjen rreth marrëdhënieve midis shumicave dhe pakicave, përkatësisht rreth të drejtave të pakicave. Në përgjithësi mund të konstatohet se „shkalla e kënaqësisë” së pakicave etnike duhet të shikohet si „barometër i demokracisë” për vendin përkatës. Në rajonin e Ballkanit Perëndimor gjendja e pakicave etnike në procesin e krijimit të shtetit kombëtar është posaçërisht e vështirë – dhe fundi i këtij procesi nuk mund të duket, derisa nuk është lidhur paqe e qëndrueshme midis vendeve të Ballkanit Perëndimor me kufij (kombëtarë³⁵²) të definuar qartë dhe të pranuar reciprokisht.

Në cilin grupim, përkatësisht etnitet, bëhet klasifikimi në vijën e krijimit të shtetit nacional, në parim „nuk” mund të zgjedhet vetë.

„Normalisht, nuk nevojitet kurrfarë përkufizimi i posaçëm, për ta përcaktuar dhe kufizuar përkatësinë etnike. Kjo bëhet në bazë të historisë, traditës, edukimit, zakoneve, qysh herët para se opsioni i vetëdijshëm të bëhet vendim i dëshiruar.”³⁵³

Antropologu social Ernest GELLNER³⁵⁴ i spikat sidomos kushtet historike të krijimit të etnicitetit dhe të kombit. Me rast ndryshimi nga shoqëria agrare në shoqëri industriale, gjë që kërkon një popullsi homogjene kulturore, krijohen diferencat etnike si kategori sociale.³⁵⁵ Për E. GELLNER nacionalizmi nuk është kurrësi zgjimi i kombeve në vetëdijesim, por shpikja e kombeve, aty ku më përpara nuk kishte.³⁵⁶

Për J. MARKO është njëfarë „specifike e nocionit të kombit” homogjenizimi si „ndërtim i »njësisë« nga »shumësia« që logjikisht presupozon »diferencë«”.³⁵⁷ Paraqitja kështu e ndikuar e një realiteti heterogjen si homogjen i përkrah pretendimet e pushtetit të ideologjisë së shtetit kombëtar. Sa për lidhjen midis kombit dhe etnicitetit J. MARKO konstaton:

³⁵² Ky nocion këtu duhet të kuptohet në frymën politike dhe jo në frymën etnike.

³⁵³ Alexander Langer: Die Mehrheit der Minderheiten, warum wird unsere Welt vom ethnischen Sauberkeitwahn und vom grundlosen Vertrauen in Mehrheiten beherrscht? [Shumica e pakicave, pse bota jonë sundohet nga iluzioni i pastërtisë etnike dhe nga besimi i paarsyeshëm te shumica?], Berlin 1996, f. 135.

³⁵⁴ Ernest Gellner: Nationalismus und Moderne [Nacionalizmi dhe modernia], Berlin 1991.

³⁵⁵ Krahe. Ernest Gellner: Nationalismus und Moderne [Nacionalizmi dhe modernja], Berlin 1991.

³⁵⁶ Krahe. Ernest Gellner: Thought and Change, Londër 1972, f.169.

³⁵⁷ J. Marko: Autonomie und Integration. Rechtsinstitute des Nationalitätenrechts im funktionalen Vergleich [Autonomia dhe integrimi. Institutet juridike të së drejtës së nacionaliteteve në krahasimin funksional], Vjenë etj. 1995, f. 124.

„[...] që asnjë »komb« nuk posedon një bazë etnike të dhënë a priori nga »natyra«, por që në atë masë sa »nacionalizohet« në format shoqërore, grupet e popullsisë po ashtu »etnizohen«: kjo do të thotë që këto për të kaluarën dhe për të ardhmen paraqiten ashtu, sikur të kishin krijuar një bashkësi »natyrore«, e cila vetëkuptueshëm ka një identitet prejardhës, kulturor dhe të interesshëm.»³⁵⁸

Ky proces i *etnizimit* pasqyrohet në rajonin e Ballkanit Perëndimor deri së fundi në konflikte të përgjakshme. Shteti, kombi dhe shoqëria ose populli shihen si „tipe ideale të ndërtimit të njësisë“³⁵⁹, në të cilin etniciteti e merr përsipër funksionin e një „strategjie të kufizimit dhe të ekskluzionit“³⁶⁰. Përmes kësaj kërcënohen dhe vihen në pyetje masivisht të drejtat dhe madje edhe ekzistenca e grupeve të caktuara të përjashtuara gjatë procesit të *kombëtarizimit* dhe *etnizimit*. Prandaj për pakicat janë të pashmangshme dispozita mbrojtëse të caktuara dhe para së gjithash funksionuese, të cilat mund t'i përshtaten situatës ekzistuese. Nëse këto masa mbrojtëse nuk do të ishin të zbatueshme, sipas mendimit tim pandashmëria e shteteve ekzistuese kombëtare nuk do të mund të shikohej si e shenjtë. Vetëm përmes kësaj mund të arrihet demokracia dhe shteti ligjor në kuptimin liberal, jo vetëm për grupet e konstruktura si *shumicë*, por edhe për *pakicat*.³⁶¹

Historiani Hagen SCHULZE e trajton transformimin e „idesë klasike kombëtare“ dhe thekson se nuk duhet të përballohet ideja e kombeve, por fikcioni i njësisë fatale, objektive dhe të pashmangshme të popullit, kombit, historisë, gjuhës dhe shtetit.³⁶²

„Në qoftë se ka ndonjë mësim që të ketë dalë i kristalizuar nga dështimet e shumta të përpjekjeve për bashkimin në Evropë, atëherë ky është ai se bashkimi i tillë mund të ecën përpara vetëm me kombet dhe veçoritë e tyre legjitime dhe jo kundër tyre, ashtu sikurse kombet, nga ana e vet, duhet të

³⁵⁸ Po aty, f. 109.

³⁵⁹ Po aty, f. 122.

³⁶⁰ Krah. po aty, f. 125 v.

³⁶¹ W. Kymlicka shkruan: „Unë kam argumentuar po ashtu se të drejtat politike mund të justifikohen në kuptim të promovimit të barazisë dhe të diversitetit kulturor brenda kulturës së zakonshme.“ Will Kymlicka: Multicultural Citizenship, a liberal theory of minority rights, Oksford 1995, f. 127. Rreth të drejtës së secesionin nga pushteti qendror krah. Rainer Bauböck: Why stay together? A pluralist approach to secession and Federation, në: Will Kymlicka, Wayne Norman: Citizenship in diverse Societies, Oksford 2000, f. 366 vv, i cili mendon se derisa në një federatë respektohen kushtet e drejta, nuk ekzistojnë arsye për ndarje nga pushteti qendror. Krah. rreth kësaj po ashtu Jürgen Habermas: Die Einbeziehung des anderen. Studien zur Politischen Theorie [Përfshirja e tjetrit. Studime rreth Teorisë Politike], Frankfurt mbi Main 1996, f. 171. „Derisa të gjithë qytetarët gëzojnë të drejtat e njëjta dhe askush nuk diskriminohet, nuk ekziston asnjë arsye normative bindëse për separimin nga bashkësia ekzistuese“.

³⁶² Krah. H. Schulze: Staat und Nation in der europäischen Geschichte [Shteti dhe kombi në historinë evropiane], Munihi 1994, f. 337.

nisin të mësojnë se as ato kurrsesi nuk janë »të vetme e të pandashme«, por përbëhen nga një numër i shumtë njësisish etnike, gjuhësore e rajonale.»³⁶³

Të gjitha këto përsiatje tregojnë një rëndësi konkrete për rajonin e Ballkanit Perëndimor përkatësisht përpjekjet e tyre për integrim në BE, ngaqë në këtë rajon numri i pakicave etnike është relativisht i madh, edhe pse që nga përfundimi i ,imperiumeve komuniste' u themelua një seri e tërë e shteteve. Në të gjitha këto shtete, të cilat duhet të ballafaqohen me probleme serioze të transformimit nga një sistem totalitar në një sistem liberal-pluralist, gjendja e pakicave e matur me standardin e një shteti liberal-demokratik nuk është e kënaqshme. Gjithkund mund të konstatohet nevojshmëria e një deemocionalizimi, deideologjizimi dhe depolitizimi të ,çështjeve kombëtare»³⁶⁴ dhe shteti modern i kohës së re nuk është vetëm „shtet kushtetues”, „shtet i të drejtave themelore” ose „shtet territorial, tatimor dhe administrativ”, por edhe më tej shtet kombëtar etnikisht i definuar.³⁶⁵

„Historia dhe gjuha janë „viktimat” e para të projektit botëror me emrin komb.»³⁶⁶

II. Nacionalizmi dhe patriotizmi në epokën e globalizimit

Ballafaqimi me fenomenin e nacionalizmit nuk guxon të ndodhë vetëm në rrafshin e shkencës. Nacionalizmi përkatësisht produkti i tij, shteti kombëtar, nuk do të zhduken në vazhden e globalizimit. Eksperti për fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare Peter CALVOCORESSI argumenton:

„Në globalizimin afatshkurtër nuk mund të shihet aq shumë një forcë shkatërruese, por një kufizuese. Kjo nuk do ta shkatërrojë shtetin, ashtu siç shtetet-qytete u zhdukën shekuj më parë, por jo edhe qytetet, prandaj shteti sovran do të zhduket, por jo edhe shteti.»³⁶⁷

³⁶³ Po aty, f. 339.

³⁶⁴ Për më shumë rreth kësaj krah. Valeria Heuberger etj. (ed.): Brennpunkt Osteuropa, Minderheiten im Kreuzfeuer des Nationalismus [Vatra e zjarrit Evropa Lindore. Pakicat në qendër të nacionalizmit], Vjenë, Muni 1996.

³⁶⁵ Krah. Joseph Marko: Staat und Recht im Zeitenbruch [Shteti dhe e drejta në thyerjet kohore], në: Joseph Marko, Klaus Poier (ed.): Politik, Staat und Recht im Zeitenbruch [Politika, shteti dhe e drejta në thyerjet kohore], Vjenë etj. 2001, f. 47.

³⁶⁶ Johannes Pollak: Zur politischen Identität der Europäischen Staatengemeinschaft, Europäische Hochschulschriften, Bd./Vol. 364 [Rreth identitetit politik të bashkësisë së shteteve evropiane, Shkrimi Universitare Evropiane, vëll. 364], Frankfurt mbi Main etj. 1998, f. 71.

³⁶⁷ Peter Calvocoressi: World Politics 1945 – 2000, Edinburg 2001, f. XX.

Përkatësia kombëtare luan edhe më tej një rol të rëndësishëm për identitetin e njeriut, gjë që *per se* nuk duhet të thotë asgjë negative. Mirëpo, me këtë rast ekziston një mospërputhje midis shumicës së qytetarëve dhe një grupi të vogël të intelektualëve. Kështu publicisti Peter COULMAS konstaton në mënyrë të saktë:

„Kthimi i kombëtares interpretohet në diskutimin intelektual kryesisht si atavizëm dhe gjykohet si një shkelje kundër logjikës historike. Copëzimi konsiderohet si hap prapa. Por, shumicës së qytetarëve kombi u duket si adresa e vërtetë identifikuese, që nuk vihet në pyetje.”³⁶⁸

Përfytyrimi se njerëzit në një të ardhme të afërt do të zhvillojnë një identitet kryesisht kosmopolit, është larg realitetit edhe në vetë shoqëritë tradicionalisht liberal-demokratike e aq më tepër edhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Mirëpo, fenomenet botërore si globalizimi në domethënien e tij gjithëpërfshirëse nuk i lënë të pandikuara as konceptet perceptuese për shtetin, kombin dhe identitetin. D. MOÏSI konstaton p.sh. se „kundër prapavijës së ndërlikuar dhe nganjëherë kaotike të globalizimit, Evropa duhet ta mendojë sërish përfytyrimin e saj të sovranitetit, të hapësirës dhe, ndoshta më e rëndësishme, të identitetit.”³⁶⁹

Filozofi Pascal BRUCKNER ofron një imazh të zymtë dhe në kundërlëvizjen ndaj globalizimit e shikon ballafaqimin e ardhshëm të madh:

„[...] dy taborë [qëndrojnë] përballë në një luftim titanik, që ndaj njëri-tjetrit janë aq armiqësorë si kapitalistët dhe komunistët, dhe atë tabori nacionalist e ksenofob, i lidhur me tokën e vet amë, si dhe tabori i kozmopolitëve që ndaj të huajës janë lakmitar dhe kureshtar, e që digjen që kufizimin nacional ta ndërrojnë me ndonjë petk tjetër.”³⁷⁰

Ky rrafsh i ri i ballafaqimit i paraqitur më lart nga P. BRUCKNER gati se nuk i ka prekur vendet e Ballkanit Perëndimor. Në këto vende antagonizmat ndodhin më parë në rrafshin e krijimit dhe konsolidimit të shteteve e të identiteteve përkatëse kombëtare. Edhe nëse i prek, përçarja e paraqitur nga P. BRUCKNER gjendet mes atyre „të lidhur me tokën e atdheut” dhe „kozmpolitëve”, mirëpo njerëzit kryesisht kufizohen nëpërmjet identitetit përkatës etnik, ndërsa numri i njerëzve të bindur nga idetë kozmopolite është fare i vogël. Njëkohësisht, me përfundimin e Luftës së Ftohtë po ngjallet prapë etno-nacionalizmi, për të cilin, për shumë autorë, arsyet

³⁶⁸ P. Coulmas: Die vielen Nationen und die Einheit der Welt. Die Grenzen des Universalen [Kombet e shumta dhe uniteti i botës. Kufijtë e universales], në: Europa – Archiv 1994, f. 549.

³⁶⁹ D. Moïsi: Dreaming of Europe, në: Foreign Policy, Nr. 115, Uashington 1999, f. 45.

³⁷⁰ Pascal Bruckner: Le Vertige de Babel. Cosmopolitisme ou mondialisme, Paris 1994, f. 10. cit. te P. Coulmas: Die vielen Nationen und die Einheit der Welt. Die Grenzen des Universalen [Kombet e shumta dhe uniteti i botës. Kufijtë e universales], në: Europa – Archiv 1994, f. 548.

qëndrojnë te një politikë e dështuar zhvillimore. Kështu p.sh. për D. SENGHAAS etno-nacionalizmi aktual në Evropë dhe gjetiu nuk është produkt i vonshëm, por produkt i shthurjes së një zhvillimi më pak të suksesshëm.³⁷¹ Në lidhje me shoqëritë paskomuniste F. FUKUYAMA i referohet „natyrës transnacionale të betejave të reja nacionaliste”.³⁷² Vetëm vala e demokratizimit pas vitit të kthesës 1989, kështu thotë C. OFFE, e ka bërë të mundshme ringjalljen e nacionalizmit:

„Nuk është nacionalizmi i ri, por fakti që përmes përdorimit të të drejtave demokratike ai tani mund të krijojë dëgjim shumëfish të potencuar. Sthurja e aparatit të represionit vetëm e bën të dukshëm një realitet politiko-kulturor deri më tani të zhvendosur nga skena.”³⁷³

Ernst RENAN, i cili nga politologu Walter EUCHNER llogaritet si „njëri prej mentorëve të bashkimit të Evropës”³⁷⁴, më 1882 shprehej kështu rreth kombit:

„Një komb është pra një bashkësi e madhe solidare, e bartur nga ndjenja e sakrificës që është sjellë, dhe e sakrificës, të cilën jemi të gatshëm ende ta sjellim. [...] Ekzistenca e një kombi është, ma lejoni këtë metaforë, një plebishit që përsëritet çdo ditë [...]. Kombet nuk janë të përjetshme. Ato kanë filluar njëherë, e njëherë do të mbarojnë. Konfederata evropiane do t'i zëvendësojë me gjasë. Mirëpo, ky nuk është ligji i shekullit, në të cilin jetojmë. Aktualisht ekzistenca e kombeve është diçka e mirë, madje e nevojshme. Ekzistenca e tyre është garancia e lirisë [...]”³⁷⁵

Sot vetëm pak veta kanë një vizion të qartë rreth një konfederate evropiane, përkatësisht rreth konstruksionit që do të krijohet vërtet nga BE-ja e sotme. Fjala është sot për një formë *sui generis*, e cila do të përfshijë vetëm një pjesë të Evropës gjeografike dhe në të cilën sidomos ekzistimi i kombit do të vlejë edhe më tej si një garant i lirisë, sikur në kohën RENAN-iane.³⁷⁶

³⁷¹ Krah. D. Senghaas: *Wohin driftet die Welt?* [Kah shmanget bota?], Frankfurt mbi Main 1994, f. 72.

³⁷² F. Fukuyama: *The end of history and the last man*, Londër 1992, f. 274.

³⁷³ C. Offe: *Der Tunnel am Ende des Lichts. Erkundungen der politischen Transformation im Neuen Osten* [Tuneli në fund të dritës. Gjurmime të transformimit politik në Lindjen e Re], Frankfurt mbi Main, Nju Jork 1994, f. 157.

³⁷⁴ Walter Euchner: *Qu'est-ce qu'une Nation? Das Nationenverständnis Ernst Renans im Kontext seines politischen Denkens* [Ç'është kombi? Kuptimi i kombeve i Ernst Renanit në kontekstin e mendimit të tij politik], në: Ernest Renan [1882]: *Was ist eine Nation? Und andere Politische Schriften* [Çfarë është kombi? Dhe shkrime të tjera politike], Vjenë, Bolzano 1995, f. 37.

³⁷⁵ Po aty, f. 57 v.

³⁷⁶ Duke u nisur nga rasti i Kosovës disa autorë theksojnë: „[...] nevojën për shkencëtarët socialë për të ndërtuar një teori të përgjithshme të nacionalizmit. Një teori e tillë jo vetëm që do të bëjë dallimin në mes të proceseve liberale dhe joliberale të ndërtimit të kombit, por po ashtu

Nga këndvështrimi teorik, sa u përket identiteteve kombëtare, varësisht nga prapavija ideologjike ekzistojnë qasje të ndryshme. Teoria e rëndomtë liberale shfaq disa rezerva mbi këtë nocion. Qasja universaliste e të drejtave të njeriut që del nga teoria liberale e sheh nacionalizmin kryesisht vetëm në variantet e tij ekstreme dhe agresive.³⁷⁷ Për dallim nga kjo, në teorinë komunitariste³⁷⁸ tema që përsëriten janë në një rëndësi anë rëndësia e identifikimit patriotik dhe veprimet përkatëse, e në anën tjetër *detyrat speciale* ndaj bashkëqytetarëve. Për komunitaristët identiteti individual është i lidhur përbrenda me identitetin përkatës kombëtar dhe kombi paraqet një formë të rëndësishme të një shoqërie që etablohet.³⁷⁹ Profesori i filozofisë politike Axel HONNETH thelbin e debatit midis liberalëve dhe komunitaristëve e sheh në mendimin vijues:

„Pa një masë të formimit »patriotik« të kolektivit, e cila tejkalon orientimin e përbashkët për të mirën e »drejtësisë«, shoqëritë liberal-demokratike nuk janë në gjendje t'i mbajnë në jetë aktivisht institucionet e tyre që garantojnë lirinë.»³⁸⁰

do të përshkruajë një kuadër të vetme të të drejtave të pakicave dhe do të bëjë një deklaratë të përgjithësuar rreth asaj se kur dhe nën cilat kushte kombet kanë të drejtë për vetëvendosje territoriale.” Zhidas Daskalovski: Towards an Integral Theory of Nationalism? Case-Study Kosovo, në: International Journal on Minority and Group Rights, Kluwer Law International, Netherlands, 6/1999, f. 503. Këto mendime mund të duken të nevojshme në debatet teorike, mirëpo një teori e nacionalizmit që zgjidh konflikte dhe është e orientuar kah praktika duket se është tejet vështirë për t'u konceptuar, dhe përveç kësaj interesat gjeopolitike të fuqive globale dhe rajonale edhe më tutje do të përcaktojnë se kush mund të jetë bartës i të drejtës së vetëvendosjes e kush jo.

³⁷⁷ Krah. Will Kymlicka: Multicultural Citizenship, a liberal theory of minority rights, Oksford 1995; Georg P. Fletcher: Loyalität. Über die Moral von Beziehungen [Lojaliteti. Rreth moralit të marrëdhënieve], Frankfurt mbi Main 1994.

³⁷⁸ Për shembull shkencëtari social Michael Walzer, i cili është vetë përfaqësues i komunitarizmit, e vlerëson komunitarizmin jo si një filozofi politike të pavarur dhe alternative, por si një kritikë ndaj liberalizmit që kalimthi shfaqet vazhdimisht. Krah. Michael Walzer: Die kommunitaristische Kritik am Liberalismus [Kritika komunitariste ndaj liberalizmit], në: Axel Honneth (ed.): Kommunitarismus. Eine Debatte über die moralischen Grundlagen moderner Gesellschaften [Komunitarizmi. Një debat rreth bazave morale të shoqërive moderne], Frankfurt mbi Main, Nju Jork 1993, f. 157 vv.

³⁷⁹ Krah. sidomos artikujt e Alasdair MacIntyre: Ist Patriotismus eine Tugend? [A është patriotizmi një virtyt?] dhe të Charles Taylor: Aneinander vorbei: Die Debatte zwischen Liberalismus und Kommunitarismus [Kalojnë pranë njëri-tjetrit: Debatë ndërmjet liberalizmit dhe komunitarizmit], të dy në: A. Honneth (ed.): Kommunitarismus. Eine Debatte über die moralischen Grundlagen moderner Gesellschaften [Komunitarizmi. Një debat rreth bazave morale të shoqërive moderne], Frankfurt mbi Main, Nju Jork 1993, si dhe artikujt e tjerë në këtë përmbledhje.

³⁸⁰ A. Honneth (ed.): Kommunitarismus. Eine Debatte über die moralischen Grundlagen moderner Gesellschaften [Komunitarizmi. Një debat rreth bazave morale të shoqërive moderne], Frankfurt mbi Main, Nju Jork 1993, f. 15.

Disa autorë e vlerësojnë si të tepruar refuzimin liberal të nacionalizmit. Filozofja Yael TAMIR propozon një nacionalizëm, i cili do të duhej të posedonte një arsyetim liberal. Nacionalizmi liberal pranon shoqëritë multinacionale dhe njeh të drejtat e pakicave kombëtare. Në këtë kuptim ajo përpiket të paraqesë se në ç'mënyrë nacionalizmi mund të pajtohet me të menduarit liberal.³⁸¹ Ky mendim i Y. TAMIR mundet të jetë me rëndësi të madhe sipas mendimit tim për procesin e integritimit në BE në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ku etno-nacionalizmat gjegjës shpesh e përcaktojnë imazhin e skenave politike. Y. TAMIR konstaton qartë se:

„Liberalët, disa prej të cilëve ishin parë si fituesit e mëdhenj të shekullit XX, duhet të përballen me nevojën për të „ndarë këtë lavdi” me nacionalizmin dhe ndoshta po ashtu edhe me fundamentalizmin fetar.”³⁸²

Një linjë të ngjashme argumentimi të një nacionalizmi liberal e përfaqëson politologu David MILLER, mirëpo pa e nënvizuar shprehimisht domethënien e përkatësisë kombëtare. Ai i referohet pretendimit për vetëpërcaktim politik dhe thekson identitetin kombëtar si burim të solidaritetit shoqëror.³⁸³

Autorë të tjerë theksojnë se si „një vetëdije e moderuar kombëtare mund të forcojë bashkësinë pluraliste politike”.³⁸⁴ Kjo vetëdije e moderuar kombëtare mund të perceptohet si patriotizëm, interpretim pozitiv i nacionalizmit, i cili mbështetet në obligime të solidaritetit të bazuar në mënyrë etike dhe politike. Filozofi Alasdair MACINTYRE³⁸⁵ patriotizmin e definon

„[...] si një lloj lojaliteti përballë një kombi të caktuar, të cilin mund ta kenë vetëm ata që kanë këtë kombësi të caktuar. [...] Patriotizmi përfshin në përgjithësi dhe në mënyrë karakteristike një nderim të posaçëm, i cili nuk i

³⁸¹ Krah. Yael Tamir: *Liberal Nationalism*, Princeton 1993.

³⁸² Po aty, f. 3.

³⁸³ Krah. David Miller: *On Nationality*, Oksford 1995; David Miller: *Secession and the Principle of Nationality*, në: Margaret Moore (ed.): *National Self-Determination and Secession*, Oksford, Nju Jork 1998, f. 62-78.

Më shumë rreth debatit të liberalizmit dhe komunitarizmit te Martin Frank: *Multikulturalismus und Nationalismus [Multikulturalizmi dhe nacionalizmi]*, në: K. von Beyme (ed.): *Politische Theorien in der Ära der Transformation [Teoritë politike në erën e transformimit]*, Opladen 1996, f. 362-87. Në përgjithësi rreth teorive të nacionalizmit krah. John Hutchinson, Antony D. Smith (ed.): *Nationalism*, Oksford, Nju Jork 1994, f. 47-131.

³⁸⁴ J. Maćków: *Die Voraussetzungen demokratischer Entwicklung in Mittel-, Nordost-, Südost- und Osteuropa [Kushtet paraprake të zhvillimit demokratik në Evropën e Mesme, Verilindore, Juglindore dhe Lindor]*, në: *Aus Politik und Zeitgeschichte, Beilage zur Wochenzeitung Das Parlament*, 3-4/15 janar 1999, f. 9.

³⁸⁵ Për atë madje as përkatësia në një bashkësi shtetërore nuk dallon thellësisht nga përkatësia në një familje. Krah. H. Dubiel: *Konsens oder Konflikt? Die normative Integration des demokratischen Staates [Pëlqim apo konflikt? Integrimi normativ i shtetit demokratik]*, në: B. Kohler-Koch (ed.): *Staat und Demokratie in Europa [Shteti dhe demokracia në Evropë]*, Opladen 1992, f. 132.

përket thjesht kombit vetjak, por tipareve, epërsive dhe arritjeve të posaçme të kombit të vetvetes.”³⁸⁶

Rreziku sipas mendimit tim qëndron megjithatë aty se kufiri midis një vetëdijeje të moderuar kombëtare dhe të një etno-nacionalizmi shkatërrimtar është shpeshherë i paqëndrueshëm. Historiani Peter ALTER e paraqet nacionalizmin si një krijesë me kokë dyfytyrëshe:

„Nacionalizmi është një krijesë me kokë me dy fytyra. Në njërin anë përmban një potencial të madh emancipues, ashtu që individëve dhe popujve u ndihmon kah vetëvendosja. Në anën tjetër bart rreziqe të dukshme në vetvete: për shoqërinë demokratike dhe për bashkimin e shteteve ai dëshkohet si fuqi shkatërruese, si një rrezikim i përhershëm i bashkëjetesës paqësore të njerëzve.”³⁸⁷

Tek ky fenomen me kokë dyfytyrëshe të nacionalizmit parashtrohet pyetja se si një „nacionalizëm liberal” – i ngjashëm me atë që në vendet evropëndimore cilësohet si patriotizëm, do të mund të merrte përsipër rolin e një force shtytëse integrative në vendet e Ballkanit Perëndimor. Si tejet kompleks dhe pengues duket te një „devijim” i tillë i forcave etno-nacionale fenomeni i konstatuar nga D. SENGHAAS i një „morali të dyfishtë të shumë lëvizjeve nacionaliste”³⁸⁸, një dukuri kjo shumë e përhapur në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Kështu p.sh. gati në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, të drejtat që kërkohen për pjesëtarët e *kombit vetjak*³⁸⁹ që jetojnë si pakica etnike në vendet fqinje, u mohohen pjesëtarëve të etniteteve të tjera në vendin e tyre.

Për H. FÜCHTNER janë tri fushat qendrore të krenarisë të përmendura nga John MACK, dhe atë: 1. nevoja për të bërë pjesë diku; 2. ndjenja për të qenë i mbrojtur dhe kjo do të thotë para së gjithash për të mbijetuar, si dhe 3. një përmirësim i ndjenjës së

³⁸⁶ A. MacIntyre: Ist Patriotismus eine Tugend? [A është patriotizmi një virtyt?], në: A. Honneth (ed.): Kommunitarismus. Eine Debatte über die moralischen Grundlagen moderner Gesellschaften [Komunitarizmi. Një debat rreth bazave morale të shoqërive moderne], Frankfurt mbi Main, Nju Jork 1993, f. 85.

³⁸⁷ Peter Alter: Grundfragen des Nationalismus [Çështje themelore të nacionalizmit], në: Valeria Heuberger etj. (ed.): Der Balkan. Friedenszone oder Pulverfass? [Ballkani. Zonë paqësore apo fuçi baroti], Frankfurt mbi Main etj. 1998, f. 183.

³⁸⁸ D. Senghaas: Wohin driftet die Welt? [Kah shmanget bota?], Frankfurt mbi Main 1994, f. 83.

³⁸⁹ Nacioni komb duhet të kuptohet në këtë rast në kuptimin etnik.

vetëvlerësimit³⁹⁰ „[...] që janë më drejtpërsëdrejti të lidhura me nacionalizmin dhe me përvojën e identitetit kombëtar [...]”³⁹¹.

Nevoja e vendeve të Ballkanit Perëndimor për të bërë pjesë diku, do të duhej të plotësuar përmes mundësisë që si shtete të ardhshme anëtare të BE-së dhe të strukturave euro-atlantike ta fitojnë ndjenjën se janë të mbrojtur dhe mund të mbijetojnë. Si rezultat ato do të duhej të përmirësonin ndjenjën e vetëvlerësimit të tyre ashtu që krahas identiteteve përkatëse kombëtare, jo vetëm gjeografikisht, por edhe politikisht, ekonomikisht dhe juridikisht, të bëhen evropianë.

Përveç këtyre tri pikëmbështetjeve të nënvizuara nga J. MACK përkatësisht H. FÜCHTNER sipas hulumtuesve të nacionalizmit për një analizë të gjerë të nacionalizmit është thelbësore edhe orientimi historiko-krahasues.³⁹² D. SENGHAAS thekson modernizimin në procesin e krijimit të identitetit përkatësisht të kombit dhe na shpjegon se mundësimi i identitetit kombëtar duhet të vihet në lidhje me procesin e modernizimit.³⁹³ D. SENGHAAS është i mendimit se nacionalizmi në radhë të parë është i drejtuar kah tri dimensione të lidhura me frikën e ekzistencës, dhe atë:

³⁹⁰ Krah. John E. Mack: Nationalism and the self. An essay on the collective narcissism of everyday life, në: The Psychohistory Review, Spring, Nju Jork 1983, f. 47-69.

³⁹¹ H. Fuchtner: Vaterlandssyndrom. Zur Sozialpsychologie von Nationalismus, Rechtsradikalismus und Fremdenhaß [Sindroma e atdheut. Për socialpsikologjinë e nacionalizmit, radikalizmin e djathtë dhe urrejtjen e të huajve], Hajdelberg 1996, f. 75. Identiteti kombëtar serb në krahasim me popujt e tjerë të Ballkanit Perëndimor është një „rast special”: „Vetë-idealizimi i serbëve mori formën e një ndjenje të pafajësisë së plotë edhe kur ata ishin të përfshirë në një nga mizoritë e mëdha të fundit të shekullit 20. Kjo vepronte përmes tri proceseve të njohura: racionalizimi („ne jemi vetëm duke e mbrojtur veten”), projektioni („ata janë agresorët”) dhe hutimi selektiv (duke e shmangur vëmendjen nga ndonjë dëshmi apo konkluzion logjik që mund të tregojë se si popujt e tjerë i ndjenin veprimet serbe).” Ralph K. White: Psychological Aspects of the Kosova Crisis, në: Peace and Conflict. Journal of Peace Psychology, 6, 1/2002, f. 53.

³⁹² Krah. rreth kësaj Karl W. Deutsch: Nationalism and its Alternatives, Nju Jork 1969, i cili në këtë fushë vlen si klasik, dhe D. Senghaas: Wohin driftet die Welt? [Kah shmanget bota?], Frankfurt mbi Main 1994, f. 54.

³⁹³ Krah. D. Senghaas: Wohin driftet die Welt? [Kah shmanget bota?], Frankfurt mbi Main 1994, f. 58. „Teoricienët e modernizimit, të mishëruar përmes Karl Deutsch dhe përmes politologëve të tjerë të pasluftës, theksojnë se komunikimi i shtuar do të fshijë çarjen etnike dhe do të rezultojë me arritjen e suksesshme të „krijimit të kombit.” Daniel Conversi: Conceptualizing nationalism. An introduction to Walker Connor’s work, në: Daniel Conversi (ed.): Ethnonationalism in the Contemporary World. Walker Connor and the study of nationalism, Londër, Nju Jork 2002, f. 8.

Lidhur me analizën e krijimit të identitetit kombëtar, sipas D. Senghaas është e patejkalueshme vepra e Karl W. Deutsch: Nationalism and Social Communication. An Inquiry into the Foundations of Nationality, Kembrixh etj. 1953. Veprat e Ernest Gellner: Nationalismus und Moderne [Nacionalizmi dhe modernia], Berlin 1991; Eric J. Hobsbawm: Nationen und Nationalismus. Mythos und Realität seit 1780 [Kombet dhe nacionalizmi. Miti dhe realiteti që nga 1780], Frankfurt mbi Main 1991 si dhe Benedict Anderson: Die Erfindung der Nation. Zur Karriere eines erfolgreichen Konzepts [Shpikja e kombit. Rreth karrierës së një koncepti të suksesshëm], Frankfurt mbi Main 1988, sipas vlerësimeve të D. Senghaas nuk sjellin „konceptualisht asnjë aspekt të ri dhe ato që ata besojnë se i zbulojnë,

„kah mbrojtja e humbjes së pritur të fuqisë, përkatësisht kah pritja e fitimit të fuqisë, kah humbja e perceptuar e mirëqenies, përkatësisht fitimi i synuar i mirëqenies, kah humbja e ndjerë e kulturës, përkatësisht kërkimi i sigurimit të kulturës dhe i përkrahjes së kulturës.”³⁹⁴

Sipas mendimit tim ky përshkrim vlen mirë për vendet e Ballkanit Perëndimor. Së fundi duhet të përmendet edhe fenomeni i rajonalizimit³⁹⁵. Ky fenomen që kryesisht tejkalon kufijtë kombëtar, po bëhet gjithnjë e më i fuqishëm në vijën e globalizimit krahas një integrimi të fuqizuar mbikombëtar. Me këtë rast marrëdhëniet ekonomike, përkatësisht interesat e ndërsjellë materialë, të gërshetuar përtej kufijve të shteteve kombëtare, luajnë një rol të rëndësishëm. Rajonalizimi i fuqizuar ndikon si në dukuritë sociale të nacionalizmit, ashtu edhe në ato të patriotizmit. Nga perspektiva e politikës së sigurisë duhet të përmendet se: „Demokracitë e zhvilluara janë të lidhura me shtetet. Deri më tani nuk ka demokraci të zhvilluar pa shtetësi.”³⁹⁶ Edhe pse nacionalizmi ose patriotizmi shfaqen edhe pa shtetësi, madje atëherë shfaqen më fort, shtetësia mbetet për demokracinë, përkatësisht për shtetin ligjor premisa e pashmangshme dhe kjo vlen sidomos për rajonin e Ballkanit Perëndimor.

III. Konceptit i kombit kulturor dhe i kombit shtetëror në kontekstin e proceseve të integrimit në BE në rajonin e Ballkanit Perëndimor

Gjatë një përpjekjeje të tipologjizimit të nacionalizmit, në qasjet e teorisë shtetërore dallohet mes dy koncepteve themelore, atij të kombit kulturor dhe atij të kombit shtetëror.³⁹⁷

janë të përmbajtura sistematikisht pa përjashtime në veprën e K. W. Deutsch”. D. Senghaas: Wohin driftet die Welt? [Kah shmanget bota?], Frankfurt mbi Main 1994, f. 58 v. Mirëpo D. Senghaas i lë të papërmendura pozicionet si ato të Walker Connor që janë diametralisht kundër paraqitjeve të K. W. Deutsch. Në lidhje me rezultatet kërkimore të K. W. Deutsch dhe W. Connor, A. D. Smyth shkruan: „Për Connor, ky model i ‚krijimit të kombit‘ [i Deutsch-it] ishte dezorientues dhe i gabuar. [...] Tani këto shtete kombëtare duket të jenë në përputhje (megjithëse jo plotësisht) me idenë e Deutsch-it për një nacionalitet kulturor dominues që asimilon grupet etnike më të vogla, periferike dhe gjuhët e tyre me anë të agjencive të shtetit modern. [...] Për Connor i tilli ‚krijim i kombit‘ detyrimisht nënkupton një masë të madhe të ‚shkatërrimit të kombit‘ reciprokisht.” Antony D. Smyth: Dating the nation, in: Daniel Conversi (ed.): Ethnonationalism in the Contemporary World. Walker Connor and the study of nationalism, Londër, Nju Jork 2002, f. 55.

³⁹⁴ D. Senghaas: Wohin driftet die Welt? [Kah shmanget bota?], Frankfurt mbi Main 1994, f. 82.

³⁹⁵ Kështu për shembull në krijesën politike supranacionale të BE-së, Traktati i Mastrihtit nga viti 1992 parasheh në nenin 4 një „Komision të Rajoneve”.

³⁹⁶ H. Gärtner: Modelle europäischer Sicherheit. Wie entscheidet Österreich? [Modelet e sigurisë evropiane. Si vendos Austria?], Vjenë 1997, f. 44.

³⁹⁷ Kështu për shembull politologu Bruce Parrott përmend dallimin e përgjithshëm midis dy llojeve të nacionalizmit, „civic” dhe „ethnic”: „Qofshin të lidhura me rrëzimin e një shteti të themeluar apo jo, manifestimet e nacionalizmit dhe përpjekjet për demokratizim mund të

Ideja e kombit shtetëror qëndron në lidhje të ngushtë me procesin e krijimit të kombit në Angli, Francë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku *identiteti kombëtar* mbështetet në kritere formale si vendbanimi ose shtetësia. Për dallim prej kësaj, ideja e kombit kulturor, ku identiteti kombëtar kuptohet si trashëgimi e paraardhësve,³⁹⁸ pavarësisht nga shtetësia, si p.sh. në Gjermani, Itali por edhe në Evropën Juglindore, mori rolin mbizotërues në procesin e krijimit të kombit.³⁹⁹ Mirëpo, dallimi midis Gjermanisë, Italisë dhe Evropës Juglindore qëndron aty që, ndërsa nacionalizmi në Gjermani dhe në Itali çoi te njësitë më të mëdha politike, tek imituesit e këtij lloji të nacionalizmit në Evropën Juglindore ai krijoi njësi më të vogla politike.

Te kombet industriale duket se funksionoi më mirë qasja e kombit kulturor si pasojë e gjendjes së mirë ekonomike që stimulon integrimin, për dallim nga shoqëritë ekonomikisht më të dobëta të Evropës Juglindore, të cilat me dekada janë të ndara nga konfliktet etnikisht të motivuara. Gjatë këtyre grindjeve të dhunshme, në rajonin e Ballkanit Perëndimor rolin udhëheqës e morën nacionalizmat ortodoksë sllavo-jugorë, ndryshe nga, fjala vjen, etno-nacionalizmi shqiptar, i cili kryesisht kishte një rol periferik, përkatësisht u shfaq vetëm si reagim ndaj nacionalizmave të dhunshëm ortodoksë sllavo-jugorë.⁴⁰⁰

Politologu David BROWN, lidhur me fenomenin e nacionalizmit në territoret e ish-Jugosllavisë shkruan me të drejtë: „Dilema thelbësore për multikulturalizmin jugosllav ishte, megjithatë, tensioni midis nacionalizmit qytetar dhe nacionalizmit etnokulturor brenda secilës prej republikave dhe krahinave përbërëse.”⁴⁰¹ C. OFFE përpiqet ta shpjegojë zhvillimin e këtyre dy llojeve të nacionalizmit:

ndikojnë te njëri-tjetri në mënyra shumë të ndryshme. Vëzhguesit e kujdesshëm kanë dalluar mes dy llojeve të nacionalizmit: nacionalizmi „qytetar” përfshirës që është në përputhje me respektimin e të drejtave individuale, si dhe nacionalizmi etnik përjashtues, i cili ka tendencë të nënrendisë këto të drejta në kërkesat kolektiviste të kombit.” B. Parrott: Perspectives on postcommunist democratization, në: Karen Dawisha, Bruce Parrott (ed.): Politics, power, and the struggle for democracy in South-East Europe, Kembrixh 1997, f. 10.

³⁹⁸ Kjo i përgjigjet idesë së *jus sanguinis*, e cila bazohet në gjak përkatësisht në prejardhje, për dallim nga modeli francez i *jus soli*.

³⁹⁹ Krah. H. Schulze: Staat und Nation in der europäischen Geschichte [Shteti dhe kombi në historinë evropiane], Munihi 1994, f. 126 vv.

⁴⁰⁰ Deri te një konstatim i ngjashëm vjen për shembull edhe historiani S. Troebst: „Nuk ishin gati se asnjëherë nacionalistët shqiptarë që e çuan Ballkanin në luftëra civile dhe ndërshtetërore, por gati se gjithmonë ishin nacionalizmat rivalizues të sllavëve jugorë ortodoksë.” Stefan Troebst: Die Albanische Frage – Entwicklungsszenarien und Steuerungsinstrumente [Çështja shqiptare – skenaret e zhvillimit dhe instrumentet e drejtimit], në: Zur Problematik der Stabilisierung des Westbalkans. Schriftenreihe der Landesverteidigungsakademie – Studien und Berichte zur Sicherheitspolitik [Rreth problematikës së stabilizimit të Ballkanit Perëndimor. Seria e Akademisë Krahinore të Mbrojtjes – Studime dhe raporte për politikën e sigurisë], Vjenë 2000, f. 42.

⁴⁰¹ David Brown: Contemporary nationalism: Civic, Ethnocultural and Multicultural Politics, Londër etj. 2000, f. 165.

„Nacionalizmi perëndimor u zhvillua si dukuri përcjellëse e revolucioneve borgjeze dhe si faktor kohezioni i shteteve të forta kombëtare, derisa nacionalizmi »etnokratik« zhvillohet në shoqëritë, të cilat nuk kanë përjetuar as shkallët e modernizimit të një revolucioni borgjez e as krijimin e përforcuar të shtetit dhe identiteti i tyre kolektiv mbështetet në këtë pikëpamje vetëm mbi një traditë të ndarë *kulturore*.»⁴⁰²

Vetëm bashkimet supranacionale sikur BE-ja duken se janë në gjendje të ofrojnë zgjidhje afatgjata për vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo ide u dëshmuua në vendet evropërëndimore, me ç'rast përvojat e hidhura reciproke të Luftës së Dytë Botërore dhe konstelacioni politik gjatë Luftës së Ftohtë nuk lejonin vend për alternativa pragmatike.⁴⁰³ Mirëpo, disa autorë i shohin kushtet e krijimit të Evropës Perëndimore si të pashoqe dhe të papërsëritshme, si p.sh. historiani euroskeptik Tony JUDT.⁴⁰⁴

Autorë të shumtë tërheqin vëmendjen për fenomenin se brenda Evropës si pasojë e konfrontimit bipolar të Luftës së Ftohtë dhe të komuniteteve dhe aleancave në hapësira të gjera dolën në prapavijë nacionalizmat potencialë virulentë.⁴⁰⁵ Shtrohet pyetja nëse në kuadër të zgjerimit evropian janë përgjithmonë të tejkalueshme etno-nacionalizmat shkatërrimtarë që gjatë Luftës së Ftohtë kishin dalë në prapavijë. Përgjigjja e kësaj pyetjeje sipas mendimit tim do ta karakterizojë edhe imazhin afatgjatë politik të Evropës, me ç'rast kënaqësia ekonomike dhe interesi i përbashkët për struktura supranacionale do të luajnë një rol esencial që ndërlihet me këtë në proceset e integritimit ose dezintegritimit.

Vetëm BE-ja, dhe asnjë hegjemon tjetër rajonal, mund të marrë përsipër në konstelacionin aktual në rajonin e Ballkanit Perëndimor rolin e një qendre integruese. Çdo alternativë ndaj një integritimi në BE do të thoshte instabilitet i përhershëm për vendet e Ballkanit Perëndimor. Përvojat e përbashkëta të hidhura gjatë diktaturës komuniste nën moton dogmatike të „vëllazërimit dhe bashkimit” si dhe konfliktet luftarake në procesin e shpërbërjes jugosllave që nga viti 1991 nuk do të duhej të lejonin, si për vendet e Ballkanit Perëndimor, ashtu edhe për BE-në, asnjë

⁴⁰² C. Offe: Der Tunnel am Ende des Lichts. Erkundungen der politischen Transformation im Neuen Osten [Tuneli në fund të dritës. Gjurmime të transformimit politik në Lindjen e Re], Frankfurt mbi Main, Nju Jork 1994, f. 137.

⁴⁰³ Ngjashëm argumenton p.sh. Brock, kur shkruan: „Paqja e gjatë» ndërmjet shteteve të OECD-së nuk ka të bëjë vetëm me realizimin e demokracisë, por edhe me konfliktin Lindje – Perëndim dhe me »epokën e artë« të ekspandimit ekonomik në kohën e pasluftës.” Lothar Brock: Frieden. Überlegungen zur Theoriebildung [Paqja. Mendime rreth krijimit të teorisë], në: D. Senghaas (ed.): Den Frieden denken, *Si vi pacem, para pacem* [Ta mendosh paqen, *Si vi pacem, para pacem*], Frankfurt mbi Main 1995, f. 321.

⁴⁰⁴ Krah. Tony Judt: Große Illusion Europa. Gefahren und Herausforderungen einer Idee [Iluzioni i madh Evropa. Rreziqet dhe sfidat e një ideje], Muni, Vjenë 1996, f. 40 ff.

⁴⁰⁵ Krah. p.sh. D. Senghaas: Wohin driftet die Welt? [Kah shmanget bota?], Frankfurt mbi Main 1994, f. 53; P. Coulmas: Die vielen Nationen und die Einheit der Welt. Die Grenzen des Universalen [Kombet e shumta dhe uniteti i botës. Kufijtë e universales], në: Europa – Archiv 1994, f. 549.

alternativë tjetër përveç asaj të një integrimi të shteteve të pavarura të rajonit të Ballkanit Perëndimor në strukturat evropiane dhe euro-atlantike. Kjo në rajonin e Ballkanit Perëndimor do të duhej të arrinte një *finalitet të procesit të integrimit evropian*⁴⁰⁶.

Rezultatet më të reja kërkimore rreth identitetit kombëtar japin sipas mendimit tim udhëzime të dobishme për proceset e integrimit evropian. Sipas rezultateve më të reja kërkimore *komunikimi* dhe *gjuha* zëvendësojnë më shumë kulturën ose fenë si elemente vendimtare për definimin e identiteteve kombëtare. Sipas këtyre rezultateve duhet të rishikohen teoritë e deritashme për kombin dhe identitetin kombëtar. Rezultatet e analizave⁴⁰⁷ të gjera të sociologëve Rainer ROSEGGER dhe Max HALLER tregojnë se nuk mund të gjendet asnjë dallim domethënës ndërmjet „kombeve kulturore tradicionale” dhe „kombeve shtetërore perëndimore”. Kështu ata konstatojnë se „edhe te kombet ,e reja’ më pak të zhvilluara të Evropës Lindore nuk ekziston botëkuptim qenësisht tjetër për kombin nga ai nëpër demokracitë e vjetra të Evropës Perëndimore.”⁴⁰⁸ Në këtë studim konstatohet se „kombet kulturore të definuara në bazë të gjuhës, përkatësisht fesë, mund të dallohen dukshëm nga njëri-tjetri, por jo kombet shtetërore në njërin anë dhe kombe kulturore në anën tjetër.”⁴⁰⁹ Dallimi klasik dhe në teori shumë i përhapur ndërmjet kombeve shtetërore dhe kombeve kulturore nuk është pra empirikisht i dëshmuar sipas këtij studimi. Hipoteza e re e këtij studimi thotë si vijon:

„Njerëzit që shikuar nga prapavija e tyre dhe nga rrethanat jetësore marrin pjesë më fort në proceset e modernizimit dhe të globalizimit [...], përfaqësojnë më shumë një koncept funksional-komunikativ të kombit, ndërsa njerëzit që u përkasin konteksteve më shumë tradicionale të jetës dhe të profesionit, përfaqësojnë shpesh një model tradicional-askriptiv të kombit.”⁴¹⁰

⁴⁰⁶ Rreth kësaj teme krahu ligjëratën e mbajtur nga ministri i jashtëm gjerman Joseph Fischer në Universitetin Humboldt të Berlinit më 12 maj 2000 me titullin: Vom Staatenverbund zur Föderation – Gedanken über die Finalität der europäischen Integration [Nga lidhja e shteteve deri te federata – Mendime rreth finalitetit të integrimit evropian] (mund të gjendet në adresën: <http://www.whi-berlin.de/fischer.htm>).

⁴⁰⁷ Krahasohen dhe vlerësohen të dhënat nga 16 vende evropiane: Britania e Madhe, Irlanda, Holanda, Norvegjia, Suedia, Gjermania (me dallime mes landeve federale perëndimore dhe lindore), Austria, Italia, Spanja, Bullgaria, Letonia, Sllovakia, Sllovenia, Çekia dhe Hungaria. Siç mund të shihet, nuk merren në konsideratë të dhënat nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Por sipas vlerësimit tim ato nuk do të kishin dhënë dallime të mëdha në rezultat dhe japin rezultate të ngjashme, sa më fort të jenë të përfshira vendet e Ballkanit Perëndimor në proceset e integrimit evropian. Krahu Rainer Rosegger, Max Haller: Konzepte nationaler Identität in West- und Osteuropa [Konceptet e identitetit kombëtar në Evropën Perëndimore dhe Lindore], në: Österreichische Zeitschrift für Soziologie 1/2003.

⁴⁰⁸ Po aty, f. 50.

⁴⁰⁹ Po aty, f. 37.

⁴¹⁰ Po aty, f. 44.

Në këtë koncept funksional-komunikativ shfaqen dy tipare të rëndësishme, „të cilat mund të shihen si esenciale për funksionimin e një shteti modern, e këto janë respektimi i institucioneve politike dhe i ligjeve, ai dhe zotërimi i gjuhës vendore.”⁴¹¹ Në lidhje me të ardhmen e shtetit kombëtar dhe të identitetit kombëtar të Evropës, ky studim e shikon „faktin e një komunikimi gjithëpërfshirës dhe intensiv mes të gjithë qytetarëve si dhe mes qytetarëve dhe qeverisë si element qendror të kombit modern”⁴¹².

Gjithnjë e më shumë vihen në dyshim përpjekjet e shteteve moderne kombëtare, që si „aktorë të ushtrimit të pushtetit” si *të vetmit* të mendueshëm të vendosin për njerëzit që jetojnë në territorin e tyre. Parimi themelor gjerësisht i përdorur *uti possidetis* mbronte p.sh. në Afrikë pavarësinë e shteteve dhe stabilitetin rajonal, por nuk i motivonte sundimtarët politikë të ndërtonin atje institucione demokratike, sepse përmes këtij parimi mbroheshin nga një ndërhyrje eventuale e jashtme si dhe nga një copëtim i vendit.⁴¹³

Shteti kombëtar i shekullit XXI ballafaqohet me gjithnjë e më shumë vështirësi, nëse merr vendime arbitrare rreth të drejtave dhe lirive themelore njerëzore të njerëzve që jetojnë nën sundimin e tij. Argumentet klasike të „mospërzjerjes në punët e brendshme të shteteve kombëtare” gëzojnë gjithnjë e më pak miratim, në qoftë se vihen në dyshim të drejtat themelore të njeriut. Përmes kësaj po humbin edhe shumë pretendime të shteteve kombëtare në një botë që gjithnjë e më fort po bëhet e ndërvarur. Sipas mendimit tim, kjo duhet vlerësuar si sukses i njerëzve përballë ideologjive.

Siç dëshmoi studimi i cituar i R. ROSEGGER dhe M. HALLER, *komunikimi dhe gjuha* vlejnë gjithnjë e më shumë si tipare vendimtare në krijimin e identitetit. Edhe në qoftë se teoritë e deritashme rreth përkufizimit të një kombi nuk duhen rishikuar në tërësi, ky studim na konfirmon edhe një herë më shumë se perceptimi i njerëzve dhe kësajsoj edhe identitetet përkatëse, nuk janë fenomene statike, por dinamike. Si pjesë e këtyre fenomeneve dinamike u lind edhe ideja e kombit.

Gjithnjë e më pak njerëz në vendet e zhvilluara mund të gjejnë krenarinë e tyre duke e theksuar përkatësinë e vet kombëtare. Elemente të tjera si suksesi ekonomik ose akademik duket se japin më shumë arsye për të qenë krenar. Mirëpo, këto vende përbëjnë pakicën. Shumë njerëz të tjerë, sidomos në rajonin e Ballkanit Perëndimor, nuk shohin gati kurrfarë alternativash për ta arritur ngritjen e ndjenjës për identitetin e tyre përveçse në qendër të vendosin përkatësinë e tyre etno-kombëtare, të cilën e konstruktojnë si ‚homogjene’ dhe ‚medoemos të lavdishme’. Përderisa kjo mbetet

⁴¹¹ Po aty, f. 48.

⁴¹² Po aty, f. 49. Teoricienti Karl W. Deutsch e paraqyturon kombin si një „shoqëri komunikative”. Krahu për këtë p.sh. Karl W. Deutsch: *Nationalism and Social Communication. An Inquiry into the Foundations of Nationality*, Kembrixh etj. 1953.

⁴¹³ Krahu. Enver Hasani: *Parimi i mosndryshimit të kufijve në të drejtën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare*, në: *Shqiptarët në Ballkan*, Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, Tiranë 2001, f. 49.

kështu, sipas mendimit tim gjithëherë do të jenë të mundshme *luftëra në emër të dhe për etno-kombin vetjak*. Ky është çasti i despotëve, të cilët me qejf paraqiten si „shpëtimtarë të kombit”. Si pasojë e këtyre luftërave, të cilat zhvillohen *në emër të dhe për kombin vetjak*, prapë po largohet për dekada një formë shoqërore, në të cilën individi jo vetëm që e percepton veten si pjesëtar të një kombi, por para së gjithash si *qytetar* të barabartë me të gjitha *të drejtat dhe detyrimet*. Këtë rast e kemi në rajonin e Ballkanit Perëndimor. M. ZURN shprehet si vijon: „Në një ekonomi të globalizuar botërore më nuk mund të jesh ndryshe *dhe* i suksesshëm, por je ndryshe *ose* i suksesshëm.”⁴¹⁴ Në qoftë se ky formulim i diskutueshëm i M. ZURN përdoret për rajonin e Ballkanit Perëndimor, atëherë BE-ja si „[...] perspektiva pa alternativa e ardhmërisë për Ballkanin Perëndimor”⁴¹⁵ do të duhej t’u jepte shansin e drejtë këtyre vendeve së paku që të jenë të suksesshme, fundja edhe për shkak të interesave të veta gjeopolitike.

„[...] BE-ja si një ‚formë politike’ është ende në fazën e vet formuese dhe ‚natyra’ e vet — për të mos e përmendur ‚finalitetin politik’ të vet — është ende e kontestuar.”⁴¹⁶

IV. Sqarime rreth qasjeve të integritit në BE për vendet e Ballkanit Perëndimor

Ndërsa në Evropë ndahen mendimet nëse i duhen dhënë gjasa reale për anëtarësim në BE Turqisë, si kandidate për aderim në BE ose jo,⁴¹⁷ anëtarësimi i ardhshëm i vendeve të Ballkanit Perëndimor nuk vihet në dyshim, së paku jo publikisht, për çka këto vende duhet t’i falënderohen para së gjithash pozitës së tyre gjeografike⁴¹⁸.

⁴¹⁴ M. Zurn: Konfliktlinien nach dem Ende des Ost-West-Gegensatzes – global handeln, lokal kämpfen [Vijat e konfliktit pas përfundimit të dallimit Lindje-Perëndim – vepro globalisht, lufto lokalisht], në: K. von Beyme (ed.): Politische Theorien in der Ära der Transformation [Teoritë politike në erën e transformimit], Opladen 1996, f. 114.

⁴¹⁵ Iris Kempe, Wim van Meurs: Neue EU-Nachbarn. Strategien gegenüber Südost- und Osteuropa jenseits der Erweiterung [Fqinj të e rinj të BE-së. Strategjitë përballë Evropës Juglindore dhe Lindore përtej zgjerimit], në: Internationale Politik Europa – Archiv 5/2002, f. 30.

⁴¹⁶ Beate Kohler-Koch: The Evolution and Transformation of European Governance, në: Political Science Series No. 58, Institute for Advanced Studies, Vjenë 1998, f. 9.

⁴¹⁷ Kështu kryesuesi i Konventës së BE-së, Valéry Giscard d’Estaing, kritikoi mënyrën e sjelljes ndaj Turqisë në lidhje me anëtarësimin në BE dhe propozoi një alternativë për aderimin në BE të Turqisë. Ai mendoi: „Nuk është e drejtë që Turqisë t’i premtohet diçka që privatisht mendohet ndryshe.” Die Presse, 6 shtator 2003, f. 12.

⁴¹⁸ Për një krahasim historiko-politik përtej kufijve të Evropës krah. Manfred Münkler: Reich, Nation, Europa. Modelle politischer Ordnung [Perandori, komb, Evropë. Modele të rendit politik], Vajnhajm 1996, f. 102-14.

Edhe nëse shtetet anëtare të BE-së së paku sipërfaqësisht e mbështesin integrimin e Ballkanit Perëndimor në BE, ky proces nuk është i thjeshtë: „Anëtarësimi në BE për vendet e Ballkanit do të jetë i dhimbshëm për të gjithë të përfshirët”⁴¹⁹.

R. BIERMANN vërejtje më 2001 skeptikën e përhapur gjerësisht dhe që ende po zgjat lidhur me perspektivën për integrim në BE për vendet e Ballkanit Perëndimor:

„[...] përmes arsyes së zgjerimit në vetvete si dhe përmes finalitetit të unionit në tërësi, perspektiva e aderimit për Ballkanin po hyn në ujërat në rritje të skeptikës së Evropës. Lufta e Kosovës, nën përshtypjen e të cilës u realizua kjo perspektivë e aderimit, përkundër të gjithë kritikëve, ka përfunduar [...]. Parandalimi i konfliktit, kështu duket, ka konjunkturë vetëm në kohërat e krizës. Në këto rrethana, politikanë kryesorë shprehin keqardhjen për nisjen e negociatave me Bullgarinë dhe Rumaninë sikurse edhe për hapjen e një perspektive të aderimit për Ballkanin perëndimor.”⁴²⁰

D. SENGHAAS konstaton se me monarkinë austro-hungareze, me Perandorinë Osmane dhe me Bashkimin Sovjetik vetëm janë tretur krijesa të mëdha politike të detyruara dhe kurrësi vërtet të integruara.⁴²¹ Kësaj renditjeje mund t'i bashkëngjitet edhe dështimi i idesë për krijimin e shtetit jugosllav gjatë shekullit XX. Për dallim nga këto perandori të mëdha të dështuara duket se deri më sot ishte e suksesshme receta e suksesit të BE-së përmes devizës *unitet në shumëllojshmëri*. Kjo devizë në një botë gjithnjë më fort të globalizuar, edhe për vendet e Ballkanit Perëndimor paraqet alternativën e vetme në drejtim të prosperitetit ekonomik dhe të stabilitetit politik. Me këtë rast në radhë të parë bëhet fjalë për tejkalimin e *fatkeqësisë historike të gjysmës juglindore të Evropës*. Rrënjët e kësaj fatkeqësie të madhe T. JUDT me të drejtë i sheh te fakti se ndarja e saj në shtete kombëtare erdhi tepër vonë dhe për të gjithë në të njëjtën kohë.⁴²² Konstatimi i tij i kthjellët historiko-krahasues e shpjegon vetëperceptimin e evropianëve si vijon:

„Çuditërisht njëri prej aspekteve më të vjetër dhe më bashkues të të përbashkëtës mes evropianëve, është vetëdija e ndarjes. Është karakteristike

⁴¹⁹ ICG, After Milosevic. A Practical Agenda for Lasting Balkans Peace, Balkans Report Nr. 108, Bruksel 1 prill 2001, f. 257 (<http://www.crisisweb.org>).

⁴²⁰ R. Biermann: Die europäische Perspektive für den westlichen Balkan. Die EU im Zwiespalt [Perspektiva evropiane për Ballkanin perëndimor. BE-ja në mospajtim], në: Osteuropa. Zeitschrift für Gegenwartsfragen des Ostens, 8/2001, f. 936 v.

⁴²¹ Kraus. D. Senghaas: Wohin driftet die Welt? [Kah shmanget bota?], Frankfurt mbi Main 1994, f. 97.

⁴²² Kraus. T. Judd: Große Illusion Europa. Gefahren und Herausforderungen einer Idee [Iluzioni i madh Evropë. Rreziqet dhe sfidat e një ideje], Munihi, Vjenë 1996, f. 73 v.

për banorët e kontinentit që gjithmonë kanë qenë të prirë të vënë kufi mes vete.⁴²³

Michael EMERSON nga *Centre for European Policy Studies* mendon rreth çështjes së ardhmërisë së Evropës, duke pohuar se BE-ja, nëse nuk bëhet shtet federal homogjen, do të mund të bëhet „një perandori e re mesjetare” me një hapësirë qendrore homogjene të definuar mirë dhe me një periferi me shtete që i përkasin Evropës në një kornizë jo mirëfilli të sqaruar. Kështu sipas M. EMERSON ka shumë opsione, prej të cilave megjithatë asnjëri nuk do të çonte deri te Shtetet e Bashkuara të Evropës.⁴²⁴

Përkundër mëdyshjes rreth ardhmërisë së saktë të BE-së, duket se vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së po u bëhet gjithnjë e më e qartë se alternativa e vetme është integrimi në BE për të arritur stabilitet të qëndrueshëm politik dhe ekonomik. Kjo alternativë po fiton shanse gjithnjë e më reale për zbatim, sepse

„[...] Evropa ka zbuluar se nëse nuk do të eksportoje stabilitet në Ballkan, atëherë Ballkani do të eksportoje jostabilitet në Evropë. Nuk ka zëvendësim për një Evropë Juglindore paqësore, stabile dhe demokratike përbri saj.”⁴²⁵

Pyetjes se cila është rruga më e mirë për ta tejkaluar instabilitetin kronik në Ballkan, vetë BE-ja i është përgjigjur me një fjalë të vetme: *integrim*.⁴²⁶ Mirëpo, përkundër disa përparimeve që nga viti 1999, BE-ja nuk ka krijuar ende ambient të vlitshëm për integrimin. Deri më tani politika e BE-së ndaj rajonit të Ballkanit Perëndimor ende nuk e ka kuptuar se „[...] Anëtarësimi në BE për Kosovën ose për Malin e Zi do të kërkojë njohjen ndërkombëtare të statusit sovran jashtë RFJ-së.”⁴²⁷ Qëndrimin e BE-së e qartëson citati në vijim i institutit të shquar kërkimor ndërkombëtar International Crisis Group (më tutje: ICG):

„Më 22 janar 2001, ministrat e jashtëm të BE-së e bënë të qartë preferencën e tyre për „mbajtjen e një kornize të përgjithshme federale” në RFJ dhe i dërguari i posaçëm i OKB-së për Ballkanin, Carl Bildt, i tha Reuters-it se

⁴²³ Po aty, f. 64.

⁴²⁴ Krah. Christoph Prantner: Die Zeit des Erwachens [Koha e zgjimit], në: Der Standard, 30 prill dhe 1/2 maj 2004, f. A. 14.

⁴²⁵ ICG, After Milosevic. A Practical Agenda for Lasting Balkans Peace, Balkans Report Nr. 108, Bruksel 1 prill 2001, f. 250.

⁴²⁶ Krah. po aty. Për një vështrim historiko-deskriptiv të përparimit në integrimin në BE në Ballkan dhe të iniciativave deri më 2000 shiko Will Bartlett, Višnja Samardžija: The Reconstruction of South East Europe, the Stability Pact and the Role of the EU: An Overview, në: Economic Policy in Transitional Economies MOCT-MOST 2/2000, f. 245-63.

⁴²⁷ ICG, After Milosevic. A Practical Agenda for Lasting Balkans Peace, Balkans Report Nr. 108, Bruksel 1 prill 2001, f. 253 (Shënimi 231).

deklarata e BE-së „shpreh shumë qartë se bashkësia ndërkombëtare nuk ka asnjë interes për krijimin e shteteve të reja në rajon”.⁴²⁸

Askund në botë nuk kishte programe aq të gjera ndërkombëtare për demokratizimin, si në Ballkan,⁴²⁹ me ç’rast BE-ja, përkatësisht shtetet anëtare të BE-së kanë marrë përsipër rolin udhëheqës. Megjithatë, rezultatet e deritashme të bashkësisë ndërkombëtare në rajonin e Ballkanit Perëndimor mbeten më tepër modeste.⁴³⁰ Përkundër angazhimit më të madh shihen pak suksese, e kjo sipas mendimit tim është për t’u sqaruar vetëm përmes politikës së zhvilluar në mënyrë inkonsistente dhe para së gjithash përmes diagnozave të gabuara politike.

Derisa BE-ja, përkatësisht shtetet anëtare të BE-së vazhdojnë me një politikë pa strategji dhe të varfër në vizione përballë rajonit të Ballkanit Perëndimor, angazhimi amerikan në këtë rajon, i pashmangshëm për procesin evropian të bashkimit, nuk është i siguruar. Ministria e dikurshme amerikane e punëve të jashtme Madeleine ALBRIGHT në një intervistë e vlerësoi si real rrezikun që Uashingtoni t’ia kthejë shpinën Ballkanit.⁴³¹ M. ALBRIGHT shprehu këtë mendim në kontekstin e unionit të përkohshëm shtetëror midis Serbisë dhe Malit të Zi, të imponuar nga BE-ja, si dhe rreziqeve aktuale në vendet e rajonit. Ngjashëm konstatohet edhe në një raport të USIP-it: „Siç demonstron kohët e fundit nga mungesa e përgjithshme e mbështetjes publike për angazhimin e ShBA-së në Kosovë, gjeneratat e reja të amerikanëve nuk janë aq të interesuara për çështjet evropiane.”⁴³²

Për këtë arsye shumë ekspertë përipiqen me të drejtë që dizajnuesve të politikës së BE-së t’ua tërheqin vëmendjen për përgjegjësinë e BE-së në rajonin e Ballkanit Perëndimor:

„Bashkimi Evropian duhet të vendosë mes dy alternativave të skicuara qartë: ose të angazhohet seriozisht në luftimin e shkaqeve kryesore të jostabilitetit,

⁴²⁸ Po aty, f. 263.

⁴²⁹ Krah. European Stability Initiative (ESI), Der westliche Balkan im Jahr 2004. Unterstützung, Kohäsion und die neuen Grenzen Europas. Ein Aufruf zur Reform der Politik der Europäischen Union [Ballkani Perëndimor në vitin 2004. Përkrahja, kohezioni dhe kufijtë e rinj të Evropës. Një thirrje për reformë të politikës së Bashkimit Evropian], Berlin etj. 3 nëntor 2002, f. 13 (mund të gjendet në faqen: www.esiweb.org).

⁴³⁰ M. Abramowitz dhe H. Hurlburt ofrojnë sqarimet për këtë: „Përtej problemeve të brendshme të BE-së, ajo po ashtu prioritetet e saj për Ballkanin i ka marrë gabimisht, duke u fokusuar tepër shumë në mundësitë ekonomike afatgjata dhe jo mjaftueshëm te të metat aktuale politike.” Morton Abramowitz, Heather Hurlburt: Can the EU Hack the Balkans?, në: Foreign Affairs, vëll. 81, shtator/tetor 2002, f. 4.

⁴³¹ „[...] Kështu ajo mendon se Brukseli do të duhej të ishte më i rëndësishëm për tërë rajonin sesa Beogradi.” Anneliese Rohrer: Albright zur Lage auf dem Balkan: Europa, bitte übernehmen Sie, Interview [Albright rreth gjendjes në Ballkan: Evropë, ju lutem merreni përsipër, intervistë], në: Die Presse, 23 tetor 2003, f. 8.

⁴³² United States Institute of Peace (USIP), Special Report, Europe in the 21st Century. A strategy for Achieving Stable Peace, Uashington DC, nëntor 2000, f. 9 (www.usip.org).

ose edhe më tej t'i shpenzojë resurset për zgjidhjet afatshkurta të konflikteve që vazhdimisht shpërthejnë në tërë rajonin."⁴³³

Në përgjithësi ka një pikënisje nga ajo se kërcënimi komunist që bashkërisht ndihej, në mënyrë vendimtare kishte çuar përpara procesin evropian të bashkimit nga fundi i Luftës së Dytë Botërore deri më 1989. Tani, që nga 1989, ky kërcënim nuk është më i pranishëm. Paramendimi ekonomik për ta zmadhuar hapësirën ekonomike evropiane mund të vlejë deri në një shkallë të caktuar si motivim për procesin e bashkimit. Mirëpo, ky interes i përbashkët është i rëndësishëm, por sipas mendimit tim i pamjaftueshëm që ta luajë rolin e garantuesit të paqes në Evropë. Fuqia integruese e përvojave të përbashkëta historike dhe kulturore anashkalohet shpesh, kur bëhet fjalë për vendet që nuk mund të arrinin ende përparime të mëdha në procesin e demokratizimit dhe të transformimit. Kjo ka edhe më shumë pasoja të rënda në vendet e Ballkanit Perëndimor, nëse merret parasysh se në këtë hapësirë të shkëputur nga bota dhe të izoluar nuk ka interesa dhe strategji të përbashkëta rajonale ekonomike. Me përjashtim të Serbisë, shumica e partive politike të vendeve të Ballkanit Perëndimor e kanë përcaktuar si objektiv prioritar integrimin evropian dhe euro-atlantik. Hipotekat e të kaluarës së fundit luajnë me këtë rast ende një rol të madh.

Qëndrimi përballë vendeve të Ballkanit Perëndimor është skeptik, deri refuzues në qarqet evropërore. Koordinator i Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore Erhard BUSEK konstaton me të drejtë: „Dikush dëshiron që „perdja e hekurt“ të zëvendësohet me një „perde të gomës“, edhe më tepër nëse puna, *low-tech* dhe mundësitë afariste shpërngulen në demokracitë e reja.”⁴³⁴

Pas zgjerimit të BE-së për dhjetë anëtarë të rinj në maj 2004 është për t'u pritur një skepsë më e fortë ndaj valëve të reja të zgjerimit. Disa skeptikë janë të mendimit se BE-ja vetë është në rrugën më të mirë për të dështuar në kriterin e katër të aftësisë për zgjerim,⁴³⁵ një rrezik ky që ndërkohë është bërë më i madh. Njëkohësisht gjithnjë e më shumë ekspertë kërkojnë një mënyrë panevropiane të trajtimit nga ana e BE-

⁴³³ ESI, Der westliche Balkan im Jahr 2004. Unterstützung, Kohäsion und die neuen Grenzen Europas. Ein Aufruf zur Reform der Politik der Europäischen Union [Ballkani Perëndimor në vitin 2004. Përkrahja, kohezioni dhe kufijtë e rinj të Evropës. Një thirrje për reformë të politikës së Bashkimit Evropian], Berlin etj. 3 nëntor 2002, f. 6.

⁴³⁴ Erhard Busek: Europa im Wandel – Sicherheit im Wandel. Sicherheitspolitische Dimension der EU-Osterweiterung [Evropa në transicion – siguria në transicion. Dimensiononi i politikës së sigurisë i zgjerimit të BE-së kah lindja], në: Österreichische Militärische Zeitschrift (ÖMZ) 4/2002, f. 397.

⁴³⁵ Kraus. Anneke Hudalla, August Pradetto: Desintegration durch Integration? Dilemmata der Osterweiterung der Europäischen Union und die Europapolitik der neuen Bundesregierung [Dezintegrimi përmes integritit? Dilemat e zgjerimit lindor të Bashkimit Evropian dhe politika evropiane e qeverisë së re federale], në: Studien zur Internationalen Politik. Institut für Internationale Politik an der Universität der Bundeswehr Hamburg [Studime për Politikën Ndërkombëtare pranë Universitetit të Ushtrisë Federale në Hamburg], Hamburg 2/1999, f. 27.

së.⁴³⁶ Çështja nëse një shteti kandidat për anëtarësim në BE do t'i pranohet pjekuria për aderim, është e motivuar shumë fort, në qoftë se jo kryekëput, politikisht. Përmes një vendimi të tillë politik BE-ja po përpiket të zhvillojë një politikë të „*karotës dhe shkopi*”, mirëpo:

„Në retrospektivë, është e diskutueshme se as ‚karota; e fundja as ‚shkopi’ nuk e kanë zbatuar suksesshëm strategjinë e BE-së për Ballkanin. ‚Karota’ shpesh mungonte; ose kur ishte e pranishme, ishte e vonë dhe e prezantuar në një mënyrë të pakoordinuar.”⁴³⁷

Deri më sot vazhdohet kjo politikë e pakoordinuar e BE-së në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Një hap i parë do të ishte një analizë e kthjellët e problemeve të këtij rajoni. Mirëpo, BE-ja ngurron – shumë më tepër sesa p.sh. Shtetet e Bashkuara të Amerikës – gjatë sqarimit të çështjeve problematike, të cilat njëkohësisht paraqesin edhe parakushtet e pashmangshme për fqinjësi të mirë dhe përmes kësaj edhe për stabilitet afatgjatë në këtë rajon. Problemet e protektorateve faktike, Bosnjës e Hercegovinës dhe Kosovës,

„[...] bashkësia ndërkombëtare ka për t'i zgjidhur qysh para një aderimi në BE. Në lidhje me këtë në Bruksel zotëron një mungesë e imagjinatës. Mirëpo, nuk ka asgjë të vërtetë në idenë se problemet e Bosnjës së ndarë do të zhdukeshin thjesht brenda BE-së. Po aq edhe në atë që të integrohet Kosova si anëtare, e cila nuk është shtet më vete.”⁴³⁸

Në të njëjtën kohë rajonit të Ballkanit Perëndimor po i ikën koha për të mbajtur hapin me proceset e integritit të shteteve të tjera fqinje. Deri më sot u projektuan ide të shumta se si mund të arrihet integriti në BE i vendeve të Ballkanit,⁴³⁹ mirëpo

⁴³⁶ „Parimi më i rëndësishëm është transformimi i qasjes njështrësore në një model shumështrësor. BE-ja duhet ta zgjerojë atraktivitetin e saj nga ofrimi i zgjerimit deri sa të bëhet aktor pan-evropian.” I. Kempe, W. van Meurs: Prospects and Risks Beyond EU Enlargement, 2002/2003 Strategy Paper, f. 18 (mund të gjendet në faqen: <http://balkans.mehedinti.info/studies/Multi-Layered%20Europe.pdf>).

⁴³⁷ Dimitris Papadimitriou: The EU's Strategy in the Post-Communist Balkans, në: Southeast European and Black Sea Studies, vëll. 1, 3/2001, f. 78.

⁴³⁸ Erhard Busek: Interview [Intervistë], në: Kurier, 14 dhjetor 2002.

⁴³⁹ J. Warwick e paraqet në mënyrë të përmbledhur si vijon: „[...] anëtarët e ardhshëm mund të pranohen në grupe të zgjedhura, qasje valësh. Një mundësi tjetër është që kandidatët të pyeten të aderojnë në një organizatë të veçantë, e cila është e lidhur ngushtë me BE-në, si një parahyrje e nevojshme apo përgatitje për hyrje të plotë (qasja e dhomës së pritjes). Një sugjerim tjetër është që vendet e Evropës Juglindore do të mund të inkurajohen për të krijuar unionin e tyre, me mundësinë që unionet perëndimore dhe juglindore do të shkriheshin dhe dallimet e tyre të dikurshme do të ngushtoheshin (qasja e integritit paralel apo një Evropë e rratheve koncentrikë). Në fund, ishte sugjeruar të krijohet një Evropë à la carte me marrëveshje të kufizuara, funksionale, të ngushta, sektoriale dhe të lirshme ndërmjet të gjitha vendeve të interesuara.” Johannes Warwick: The Kosovo Crisis and the European Union: The

asnjëra prej tyre nuk çoi deri te rezultatet e dëshiruara. Sipas mendimit tim, për këtë është përgjegjës para së gjithash fakti se u anashkaluan parakushtet e integritetit si p.sh. çështjet e statusit që duhet të sqarohen paraprakisht. Njëkohësisht, si qeveritë ashtu edhe njerëzit në rajonin e Ballkanit Perëndimor kanë iluzionin se BE-ja do t'i zgjidhë të gjitha problemet. Rajoni i Ballkanit Perëndimor, me anëtarësimin në BE të Rumanisë dhe të Bullgarisë, është i rrethuar tërësisht nga territori i BE-së. Kjo nuk do ta thjeshtësojë aderimin në BE, në qoftë se vendet e Ballkanit Perëndimor nuk arrijnë stabilitetin e gjerë që është i nevojshëm. Përmes kësaj vendet e Ballkanit Perëndimor do të izoloohen edhe më shumë, gjë që do të ishte optimale për veprimtaritë ilegale dhe kriminale. Konsekuencat e një zhvillimi të tillë shumë të mundshëm paraqiten në një raport të institutit kërkimor European Stability Initiative (më tutje: ESI), i cili e ka parashikuar saktë edhe *krizën e vitit 2004*:

„Aftësia e rajonit për t'iu bashkuar projektit evropian do të zhduket më shumë e më shumë. Derisa në territorin e zgjeruar të Bashkimit Evropian ndiqen objektivat si kohezioni ekonomik, zhvillimi ekonomik dhe mobiliteti i punës, pika kryesore në Ballkan do të ngushtohet në temat krimi, korrupsioni dhe administrimi i kufijve. Nëse kjo do të ishte përgjigjja e vetme e Evropës ndaj krizës së vitit 2004, atëherë sipas të gjitha gjasave Ballkani do të mbetet një ishull i jostabilitetit në qendër të Evropës, eksportet e të cilës do të përbëhen nga gastarbajterë dhe importet do të përbëhen nga trupat paqësorë.”⁴⁴⁰

Një qasje e re e BE-së ndaj rajonit të Ballkanit Perëndimor është e nevojshme: „Një zgjerim i BE-së pa një model krejtësisht të ri për integrim nuk do të krijojë më shumë stabilitet, por përkundrazi do të shkaktojë jostabilitet të ri panevropian.”⁴⁴¹ Përveç kësaj njerëzit në rajon duhet ta kenë të qartë se ata janë aktorët kyçë gjatë përballimit të problemeve të tyre.⁴⁴²

BE-ja përpiqet të shmangë integrimin e konflikteve dhe pret që vendet e Ballkanit Perëndimor t'i zgjidhin problemet e tyre para se të bëhen pjesë e BE-së. Ky ishte thelbi i komisarit të BE-së për çështje të zgjerimit, Günter VERHEUGEN, kur nënvizoi që vendet e Ballkanit duhet të tregojnë se mund t'i zgjidhin problemet përmes

Stability Pact and its Consequences for EU Enlargement, në: K. R. Spillmann, J. Krause (ed.): Kosovo: Lessons Learned for International Cooperative Security, Bernë etj. 2000, f. 163 v.

⁴⁴⁰ ESI, Der westliche Balkan im Jahr 2004. Unterstützung, Kohäsion und die neuen Grenzen Europas. Ein Aufruf zur Reform der Politik der Europäischen Union [Ballkani Perëndimor në vitin 2004. Përkrahja, kohezioni dhe kufijtë e rinj të Evropës. Një thirrje për reformë të politikës së Bashkimit Evropian], Berlin etj. 3 nëntor 2002, f. 18.

⁴⁴¹ J. Warwick: The Kosovo Crisis and the European Union: The Stability Pact and its Consequences for EU Enlargement, në: K. R. Spillmann, J. Krause (ed.): Kosovo: Lessons Learned for International Cooperative Security, Bernë etj. 2000, f. 174.

⁴⁴² „Popujt e Ballkanit kanë për t'i zgjidhur vetë konfliktet e tyre para se ata të mund të bëhen pjesë e Bashkimit Evropian. Ata nuk duhet të mendojnë se mund t'i importojnë ato në BE, ashtu që BE-ja të mund të zgjidhë konfliktet e tyre për ata. Sidoqoftë, ata me siguri kanë nevojë për ndihmën e Evropës.” Po aty, f. 176.

bashkëpunimit rajonal me vendet fqinje,⁴⁴³ në qoftë se dëshirojnë t'i bashkohen BE-së. Edhe në raportin e parë vjetor të Komisionit të Komuniteteve Evropiane rreth PSA-së konstatohet në mënyrë eksplicite: „Integrimi me BE-në është i mundshëm vetëm nëse anëtarët e ardhshëm mund të dëshmojnë se janë të gatshëm dhe në gjendje të bashkëveprojnë me fqinjët e tyre siç e bëjnë këtë shtetet anëtare të BE-së.”⁴⁴⁴ Njëkohësisht edhe në anën e vendeve të Ballkanit Perëndimor vihet në dyshim në mënyrë skeptike aderimi në BE. Në përgjithësi mund të vërehet se sa më afër vjen anëtarësimi potencial në BE, aq më shumë dyshime shprehen, sepse sikur ata brenda, ashtu edhe ata jashtë territorit të BE ballafaqohen me konsekuencat e këtij anëtarësimi. Alexander SMOLAR, anëtar hulumtues pranë *Centre National de la Recherche Scientifique* në Paris, fenomenet aktuale në vendet e dikurshme komuniste i përshkruan si vijon:

„„Kthimi në Evropë” nuk është më kushtrimi i betejës i demokracive të reja postkomuniste. Diskutimi publik përqendrohet më pak në fatin e Evropës, por më shumë në mbështetjen financiare nga BE-ja dhe në statusin e shteteve të veçanta kombëtare.”⁴⁴⁵

Pavarësisht nga skepsa e drejtë a e padrejtë lidhur me proceset e integrimit në BE nëpër vendet e Ballkanit Perëndimor, aderimi në BE është megjithatë në interesin pragmatik si të BE-së ashtu edhe të vendeve të Ballkanit Perëndimor.⁴⁴⁶ Prandaj anëtarësimi në BE për vendet e Ballkanit Perëndimor është vetëm çështje e kohës, por që në të ardhmen jo të largët të bëhet realitet, kërkohet një angazhim shumë më i madh si i vendeve të Ballkanit Perëndimor ashtu edhe i BE-së.

⁴⁴³ Reuters 23 tetor 2001, cituar te David Phinnemore: Stabilisation and Association Agreements: European Agreements for the Western Balkans?, në: *European Foreign Affairs Review* 8/2003, f. 100.

⁴⁴⁴ Në tekstin origjinal i theksuar me germa të zeza. Commission of the European Communities, *The Stabilisation and Association Process for South East Europe. First Annual Report, (COM (2002) 163 Final)*, Bruksel 4 prill 2002, f. 11.

⁴⁴⁵ Alexander Smolar: Eine Kraftprobe für Europas Solidarität. Zwischenstaatliche Umverteilung führt zu starken Spannungen in der EU [Një provë force për solidaritetin e Evropës. Rishpërndarja ndërshtetërore çon deri te tensionet e forta në BE], në: *Die Presse* 28 qershor 2003, f. 40.

⁴⁴⁶ „[...] BE-ja duhet të mbetet e përfshirë në Evropën Juglindore. Për interesat e veta, ajo duhet të sigurojë stabilitetin e rajonit, respektimin e të drejtave të njeriut dhe shfaqjen e vendimmarrjes demokratike me alokimin shumë më të madh të burimeve të pakta, të bazuar në treg. Por, kjo nuk mund t'i injorojë nevojat specifike të rajonit për shkak të dëmit të shkaktuar në Kosovë, shpërbërjen tragjike të RSFJ-së dhe premtimet e saj të përsëritura për të ndihmuar hapësirën në modernizimin e saj ekonomik, politik, të sigurisë dhe social.” Jozef M. van Brabant: *Southeastern Europe, Transitions, and the EU – Is Ever-widening Desirable?*, në: *Economic Policy in Transitional Economies MOCT-MOST*, 11/2001, f. 323.

C. Demokratizimi dhe integrimi në BE i rajonit të Ballkanit Perëndimor – i vështirë, por jo i pamundshëm

Derisa e ardhmja e BE-së, roli i ardhshëm i shteteve kombëtare dhe i rajoneve ndërkufitare janë të pasigurta, megjithatë një gjë është e sigurt: që vendet e Ballkanit Perëndimor vetes ia dëshirojnë të jenë pjesë e strukturave euro-atlantike. Pyetjet se si BE-ja mund të reformohet dhe si mund të forcohet më tej parimi demokratik, debatohen vazhdimisht në BE. Në rajonin e Ballkanit Perëndimor bëhet fjalë për atë që në hap të parë të krijohet fundamenti për demokracinë, shteti ligjor funksionues, i cili në kuptimin liberal-demokratik nuk kishte qenë asnjëherë. Në parim bëhet fjalë se si të reformohet forma e qeverisjes, ashtu që nga diktaturat e dikurshme të etabluhen shtetet ligjore, një proces që në rajonin e Ballkanit Perëndimor duhet të mbështetet përmes integritimit në BE. Shembulli i suksesit të shteteve të dikurshme komuniste, të cilat tashmë janë anëtare të BE-së, tregon se procesi i demokratizimit dhe i transformimit nuk është punë Sizifi, edhe pse njerëzit e prekur në rajonin e Ballkanit Perëndimor shpesh e krijojnë këtë përshtypje.

Demokratizimi nuk është *ngjarje* por *proces*, rrjedha e të cilit është e vështirë të parashikohet. Ky proces hedh pyetje të shumta, gjatë të cilave më pak rëndësi kanë përgjigjet sesa debati që shkaktohet. Pyetjet si p.sh. se a duhet të peshojnë më shumë interesat kombëtarë edhe në të ardhmen apo interesat *vetjake* kombëtare do të bëhen *njèkohësisht* interesa të përbashkët evropiane, janë pyetje kontroverse të debatit aktual të BE-së.⁴⁴⁷ Diskutime të tilla sipas mendimit tim do të duhej të nxiteshin edhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, edhe nëse kjo aktualisht mund të tingëllojë 'irelevante'. Një debat rreth temave të BE-së në rajonin e Ballkanit Perëndimor do të duhej të krijonte më shumë qartësi rreth sfidave të ardhshme të këtij rajoni dhe kështu të shkaktonte një efekt katalizator në proceset e integritimit të rajonit të Ballkanit Perëndimor në BE.

Proceset e integritimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE mund të interpretohen si tejkalim i pasojave të vonshme të totalitarizmave dhe autoritarizmave të shekullit XX në këtë hapësirë evropiane. Derisa në hemisferën perëndimore të Evropës njerëzit pas Luftës së Dytë Botërore bënë përvojat në kuadër të një krijese demokratike të shtetit ligjor, njerëzit në shtetet e dikurshme komuniste përjetonin format e sundimit diktatorial, madje përgjatë shumë brezave, gjë që e bën edhe më të vështirë vendosjen dhe etablimin e vlerave humane⁴⁴⁸, të

⁴⁴⁷ Krah. p.sh. Philippe C. Schmitter: How to Democratize the European Union ... and Why Bother?, Boston 2000.

⁴⁴⁸ Me termin „vlera” i nënkuptoj të drejtat universale të njeriut përkatësisht të drejtat universale themelore, të cilat për një demokraci janë pjesë përbërëse esenciale. Pra një sistem i vlerave, i cili e karakterizon demokracinë dhe jo patjetër vlerat e politikës. Një analizë kritike rreth rolit të vlerave në politikë dhe deri ku do të duhej të shfaqeshin ato në politikë, e ofron Krzysztof

prosperitetit demokratik e me këtë edhe sigurimin afatgjatë të paqes në tërë kontinentin evropian. Rreziku i kthimit të regjimeve totalitare ose autoritare nuk mund të shikohet asnjëherë si diçka e pamundshme si në demokracitë e reja, ashtu edhe në demokracitë e etabluara. Kufiri mes ‚demokracisë‘ dhe ‚jo-demokracisë‘ është shpesh tejte i hollë. Elementet populiste në Perëndim që pengojnë dhe rrezikojnë shtetin ligjor dhe forcat etno-nacionaliste të gatshme për dhunë në lindje dhe juglindje të kontinentit evropian, në epokën e globalizimit shikohen dhe ndryshen si relikte të të kaluarës. Mirëpo, ato shpesh marrin prurje nga radhët e ‚humbësve‘ të ndryshimeve shoqërore dhe kështu ose e sfidojnë shtetin ligjor ose e bëjnë të pamundshëm etablimin e tij të sërishëm.

Kur në vitin 1989 regjimet komuniste në Evropën Lindore dhe Juglindore gjendeshin në fund të ‚*procesit vetëshkatërrimtar*‘, demokracitë evropërore ishin të befasuara nga kjo kthesë ‚e befte‘ dhe e papritur dhe aq më pak të përgatitura për një veprim të shpejtë. Për shkak të dallimeve mes shteteve anëtare të KE-së, përkatësisht BE-së, ishte gati e pamundshme të konceptohet një strategji afatgjate dhe unike për rajonin evropian, e cila në prag të shekullit XXI u emërtua si Ballkan Perëndimor. Sidomos në hapësirën e RSFJ-së, në të cilën etno-nacionalizmat para dhe pas kthesës më 1989 edhe një herë u zgjuan, demokracitë e etabluara evropiane u sollën në mënyrë naive e deri injorante dhe tepër gjatë vetëm i kundronin ndodhitë. Prandaj Shtetet e Bashkuara e Amerikës duhej të paraqiteshin edhe një herë më shumë si paqebërës dhe garantues kryesor i paqes në Evropë. Kjo sipas mendimit tim flet shumë për gjendjen e demokracive të etabluara evropiane, të cilat hapësirës së Evropës Juglindore nuk kishin për t’i ofruar *asnjë fuqi tërheqëse*, së paku jo në vështrim të shkurtër. Konsekuencat e këtij mosveprimi dhe jouniteti për ndonjë ndërhyrje të mundshme në territoret e dikurshme jugosllave janë enorme dhe nuk do të tejkalohen aq shpejt.⁴⁴⁹

Sociologu Ulrich BECK e quan paradoksale situatën e krijuar në Evropë me përfundimin e Luftës së Ftohtë. Renesanca politike e Evropës nuk ka çuar te një ringjallje e ideve të Evropës, por te një paralizim i përgjithshëm. U. BECK e arsyeton këtë me fatalizmin që është zhvilluar në Evropën e modernes.⁴⁵⁰

Michalski: Wie die Werte in die Welt kommen [Si vijnë vlerat në botë], në: Die Presse (Spectrum), 5/6 maj 2001, f. I-II.

⁴⁴⁹ Njëkohësisht vlen edhe më tej se ‚Ballkani [...] përfaqëson një test fundamental të aspiratave të gjera politike të komunitetit transatlantik: për të zgjeruar një Evropë që është demokratike, paqësore dhe e angazhuar për një integrim më të afërt social dhe ekonomik.‘ ICG, After Milosevic. A Practical Agenda for Lasting Balkans Peace, Balkans Report Nr. 108, Bruksel 1 prill 2001, f. 7.

⁴⁵⁰ Mirëpo, ai e sheh shansin për një zbulim të ri të politikës, e cila është e çliruar nga skema ose-ose (ose kapitalizëm ose socializëm) dhe me këtë çon te zgjidhje të reja kreative të problemeve. Krah. Ulrich Beck: Die Erfindung des Politischen. Zu einer Theorie reflexiver Modernisierung [Zbulimi i politikës. Te një teori e modernizimit reflektiv], Frankfurt mbi Main 1993.

Gjatë Luftës së Ftohtë çdo qeveri evropërisht do të kish qenë e gatshme të paguante një çmim shumë më të lartë për gjendjen e sotme relativisht të parrezikshme të sigurisë në Evropën Juglindore. Tani demokracia, dhe me këtë edhe siguria në Evropë, mund të etablohet dhe të sigurohet me shpenzime më të vogla, me kusht që resurset të përdoren në kohën e duhur dhe për diagnoza të përcaktuara saktë të konfliktit.

Në të gjitha shoqëritë në transformim të Evropës është bërë ndërkohë *„i vetëkuptueshëm“* sistemi shumëpartiak dhe mbajtja e zgjedhjeve të lira dhe të fshehta në intervale të rregullta kohore. Mirëpo, zhvillimi, përkatësisht forcimi i strukturave demokratike kushtëzon elemente të caktuara socio-ekonomike. Është e vëzhgueshme se si zhvillimi demokratik i një vendi shkon krah për krah me zhvillimin e tij ekonomik.

Pavarësisht se si do të duket në të ardhmen *forma politike* e BE-së dhe në ç’raport me të do të qëndrojnë vendet e Ballkanit Perëndimor, duket se një gjë vlen si e sigurt për shtetin e shekullit XXI: se shteti duhet të përkohet me kërkesat e një bote të globalizuar. Si pasojë e përparimit teknologjik po rritet vazhdimisht ndërvarësia si ndërmjet aktorëve shtetërorë, ashtu edhe ndaj aktorëve rajonalë. Me këtë rast shoqërisë civile i përket një rol vendimtar, sepse ajo reagon ndaj rreziqeve politike, sociale, ekologjike dhe ushtarake. Kuraja civile, në qoftë se është e nevojshme madje edhe mosbindja civile, janë të nevojshme për ekzistencën dhe ardhmërinë e shoqërisë civile si hallkë lidhëse në zinxhirin e sundimit demokratik. Për këtë arsye është në interes të shtetit që ta përkrahë shoqërinë civile, me ç’rast edhe në të ardhmen demokracia do të mund të bazohet vetëm në kompromiset mes grupeve të ndryshme të interesit. Përmes kësaj arrihet edhe më shumë drejtësi sociale, dhe sa më shumë drejtësi sociale, aq më të mëdha shanset për demokracinë.⁴⁵¹

Mediet po fitojnë edhe rëndësi gjithnjë më të madhe për shtetin ligjor. Në epokën e tregtimit mediatic, global dhe strategjikisht të planifikuar të emocioneve të vetëdijshme dhe të pavetëdijshme, sipas mendimit tim është jetike për shoqëritë demokratike që qytetarët të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë të pavarur, për të verifikuar në mënyrë kritike, nëse, kur dhe nga kush minohen bazat e të drejtës dhe të dinjitetit njerëzor në mjedisin e tyre. Kjo mungon në shoqëritë e Ballkanit Perëndimor dhe paraqet një dimension të rëndësishëm në procesin e këtij rajoni për krijimin e shtetit ligjor.

Krahas shoqërisë civile dhe të medieeve, rol të rëndësishëm merr infrastruktura e komunikimit në proceset e integritimit në BE.⁴⁵² K. W. DEUTSCH e paraqet me të

⁴⁵¹ Duke u nisur nga teza e shkencëtarit social Robert D. Putnam, kapitali social është çelësi për demokracinë, i cili ndërtohet para së gjithash mbi resurse morale, si p.sh. mirëbesimi, normat dhe rrjetet. Krahas Robert D. Putnam: *Making democracy work: civic traditions in modern Italy*, Princeton etj. 1994.

⁴⁵² „Punimi në projekte të përbashkëta që do të mund, për shembull, të lehtësojnë integrimin fizik me Evropën (p.sh. rrugët, lidhjet hekurudhore), mund t’i bashkojë njerëzit.“ Leeda Demetropoulou: *Europe and the Balkans: Membership Aspiration, EU Involvement and*

drejtë komunikimin si zamkë, e cila i mban tok organizatat dhe e aftëson një grup për të menduar dhe për të vepruar së bashku.⁴⁵³ Një komunikim i zhvilluar dhe i suksesshëm do t'u ndihmonte njerëzve me prapavijë të ndryshme etnike dhe kulturore në rajonin e Ballkanit Perëndimor, që njëri-tjetrin të mos e shikojnë më tej „pa kushte” si armiq, siç është shpesh rasti aktualisht. Kjo kushtëzohet para së gjithash nga një infrastrukturë e mirë ndërrajonale e komunikimit, e cila në të njëjtën kohë do të lehtësonte edhe qasjen në rrjetet ndërkombëtare të infrastrukturës. Shikuar historikisht, komunikimi në domethënien e tij të shumëllojshme paraqiste faktorin më të rëndësishëm për zhvillimin e shoqërive moderne. Vendet e Ballkanit Perëndimor në shumë pikëpamje e kanë lëshuar përsëri këtë hap pas vitit 1989.⁴⁵⁴ Disfata e njerëzimit, para së gjithash e evropianëve, në fund të shekullit XX në rajonin e Ballkanit Perëndimor mund të interpretohet edhe si një dështim i komunikimit ndërnjerëzor.

Pa komunikim të suksesshëm nuk mund të ketë proces të suksesshëm të stabilizimit të vijueshëm dhe të integritit në BE për rajonin e Ballkanit Perëndimor. Problemet e komunikimit të këtij rajoni, të cilat rezultojnë nga e kaluara, janë në përgjithësi të njohura, megjithatë nuk mund të arriheshin ende kurrfarë zgjidhjesh të kënaqshme. Një zgjidhje e këtij problemi në procesin e një qetësimi të vijueshëm të rajonit të Ballkanit Perëndimor paraqet një dimension esencial.⁴⁵⁵ Kjo ndërkohë u dallua edhe nga BE-ja, dhe prandaj rëndësisë së infrastrukturave për procesin e stabilizimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor i kushtohet gjithnjë e më shumë vëmendje.⁴⁵⁶

Një komunikim i suksesshëm është parakusht për suksesin e integritit në BE, ngase përmes kësaj edhe do të mënjanoreshin shume pengesa të tjera të integritit. Regjioni i Ballkanit Perëndimor është i pasur me resurse dhe potenciale njerëzore.

Europeanization. Capacity in South Eastern Europe, në: Southeast European Politics, vëll. III, Nr. 2-3, nëntor 2002, f. 103.

⁴⁵³ Krah. Karl W. Deutsch: Ein einfaches kybernetisches Modell [Një model i thjeshtë kibernetik], në: Politische Kybernetik [Kibernetika politike], Frajburg 1969, f. 125-53 dhe f. 340-1.

⁴⁵⁴ „Përkundër investimeve masive ndërkombëtare përkeqësohet pandërprerë infrastruktura e tërë regjionit.” ESI, Der westliche Balkan im Jahr 2004. Unterstützung, Kohäsion und die neuen Grenzen Europas. Ein Aufruf zur Reform der Politik der Europäischen Union [Ballkani Perëndimor në vitin 2004. Përkrahja, kohezioni dhe kufijtë e rinj të Evropës. Një thirrje për reformë të politikës së Bashkimit Evropian], Berlin etj. 3 nëntor 2002, f. 12.

⁴⁵⁵ Rreth gjendjes së përgjithshme të infrastrukturës së trafikut dhe rreth rëndësisë së saj për proceset rajonale dhe tejrjonale të integritit dhe të stabilizimit në Evropën Juglindore krah. The World Bank, The Road to Stability and Prosperity in South Eastern Europe. A Regional Strategy Paper, Uashington DC, mars 2000, f. 121 vv.

⁴⁵⁶ Kështu për shembull në mes të qershorit 2003 në Thessaloniki Agenda for the Western Balkans u theksua rëndësia e rrugëve të trafikut: „Hartimi i një strategjie të integruar të transportit rajonal që përputhet me Rrjetet Trans-Evropiane dhe duke marrë parasysh Korridoret Pan-Evropiane (në veçanti Korridoret V, VII, VIII dhe X), është një prioritet i lartë.” The Thessaloniki Agenda for the Western Balkans: Moving towards European integration Annex A. (10369/03 (Presse 166) provisional version) 16.06.2003, f. 16 f.

Në këtë vështrim një ndërtim dhe zgjerim i rrjeteve të komunikimit do të ishte hapi më logjik në procesin e integrimit dhe të stabilizimit. Përmes kësaj do të pasonin gati automatikisht zhvillimet pozitive në rrafshin ekonomik dhe mendor dhe me këtë edhe deri një *kulturë e komunikimit politik*, e cila nxit aftësinë e njeriut që „të menduarit ndryshe” ta pranojë si element të rëndësishëm të një shoqërie demokratike. Njerëzit që nuk kanë mundësi komunikimi, nuk e njohin njëri-tjetrin, nuk mund t’i besojnë njëri-tjetrit dhe e shikojnë njëri-tjetrin lehtë si armiq.

Në krerët e fundit të këtij libri e kam shpjeguar modelin shumëdimensional të integrimit (figura 2) të zhvilluar prej meje si dhe i kam kapur çështjet teorike rreth proceseve të demokratizimit, transformimit dhe të integrimit në BE në epokën e globalizimit. Një aspekt i rëndësishëm i këtyre çështjeve ishin fenomenet sociale të nacionalizmit dhe të patriotizmit si dhe perceptimi, përkatësisht ndryshimi i identiteteve kombëtare dhe kulturore në kontekstin evropian. Nga këta krerë rezultoi se sidomos komunikimi i suksesshëm, i cili kushtëzon një tufë të faktorëve socio-politikë, është element i rëndësishëm për suksesin e procesit të krijimit të shtetit ligjor dhe përmes kësaj edhe për integrimin në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në kreun e ardhshëm do të paraqiten shkurt fillimisht iniciativat rajonale të bashkëpunimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor, të pasuara nga një analizë empirike e procesit të integrimit në BE në Kosovë. Në vazhdim të tij, në rastin e konfliktit serbo-kosovar do të shpjegohen parakushtet për krijimin e një ‘paqeje pozitive’ në kontekstin e procesit të integrimit në BE. Konflikti serbo-kosovar do të zgjidhet si shembull i rastit, sepse nisem nga supozimi se ‘paqja pozitive’ midis Serbisë dhe Kosovës paraqet njëkohësisht edhe një premisë të një etablimenti afatgjatë të paqes dhe të një sigurimi të paqes në Ballkanin Perëndimor.

Kreu VI: Proceset e integritit në BE si instrumente për vendosjen dhe sigurimin e paqes në rajonin e Ballkanit Perëndimor

Në këtë krye do të bëhet fjalë kryesisht për një përpjekje të operacionalizimit të tri komponentëve të rëndësishëm në proceset e integritit në BE të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Këto tri pika, në kuadër të *Modelit të integritit për Kosovën dhe vendet fqinje të saj, aktorët dhe proceset* (figura 2), i kam përkufizuar si vijon:

- Mënjanimi i potencialit konfliktuoz përmes *denacionalizimit* të perceptimit historik dhe përmes *nacionalizimit* të vlerave evropiane liberal-demokratike;
- Zhvillimi i një rrjeti të ri të komunikimit përmes zgjerimit të proceseve ekzistuese të komunikimit në fushat e politikës, të të drejtës dhe të ekonomisë (Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit; Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore); dhe
- Krijimi i proceseve të gjera dhe efikase të bashkëpunimit përmes njohjes së ndërsjellë të aktorëve dhe trajtimit të tyre të barabartë nga ana e BE-së.

Të gjitha këto tri pika duhet të shikohen në kontekstin e angazhimit ndërkombëtar në rajonin e Ballkanit Perëndimor, i cili përshkruhet në citatin e ekspertës për çështjet e konfliktit dhe të sigurisë, Andrea K. TALENTINO:

„Organizatata ndërkombëtare po krijojnë jo vetëm paqen, por një komb, edhe pse ideja mund të jetë e përfolur. Ne mund ta dallojmë këtë lloj të ndërtimit të paqes nga të tjerët. Krijimi i kombit ndodh kur krijimi i paqes do të thotë përcaktim, formësim dhe lehtësim i krijimit të proceseve dhe organizatave të reja, në vend të reformimit të strukturave ekzistuese. Ky lloj i krijimit me të madhe në vend të rindërtimit filloi në Bosnjë dhe është zgjeruar tani në Timorin Lindor dhe në Kosovë.”⁴⁵⁷

Duke u nisur nga pyetja „*Si të mos mendojmë për Ballkanin*”, drejtori i *Qendrës për Strategji Liberale* në Sofje Ivan KRASSTEV definon tri paradigma të interpretimit, të cilat nga bashkësia ndërkombëtare përdoren si vijë kryesore për politikën e saj të Ballkanit, edhe pse dobia e tyre politike është e diskutueshme.

– Të parën ai e quan „*Paradigma e „trashëgimive të këqija*””, e cila p.sh. formulohet në raportin *Paqja e Papërfunduar*⁴⁵⁸ dhe i definon trashëgimitë e luftës, të komunizmit dhe të historisë si pengesë kryesore të një demokracie efektive në

⁴⁵⁷ Andrea Kathryn Talentino: *Intervention as Nation-Building: Illusion or Possibility?*, në: *Security Dialogue*, vëll. 33, 1/2002, f. 28.

⁴⁵⁸ Carnegie Endowment for International Peace, *Report of the International Commission on the Balkans, The Unfinished Peace*, Uashington DC 1996.

Ballkan. Përfaqësuesit e kësaj paradigme, krahas një përkrahjeje të ekonomisë dhe të shoqërisë civile, rekomandojnë edhe rishkrimin e librave të historisë;

– E dyta është „*Paradigma e Transicionit Demokratik*”. Sipas kësaj luftërat në territoret e dikurshme të RSFJ-së sqarohen si një produkt i sistemit të vjetër jodemokratik dhe si një tentim i pushtetmbajtësve komunistë për të mbetur në pushtet. Sipas kësaj qasjeje, një demokraci funksionuese do të ishte garantuese e mjaftueshme për paqen në rajonin e Ballkanit Perëndimor.⁴⁵⁹

– Paradigmën e tretë I. KRASTEVE e quan „*Paradigma e zhvillimit/integrimit*”, e cila më së miri paraqitet në një *letër strategjike* të Bankës Botërore⁴⁶⁰ dhe i tejkalon dy qasjet e para të „*trashëgimisë*” dhe të „*transicionit*”. Kjo paradigmë përmes një *politike të shqyrtimit* orvatet ta bëjë fitues çdo aktor të përfshirë në Ballkan.⁴⁶¹ Secila prej këtyre tri paradigmave tenton të gjejë zgjidhje për paqësimin e Ballkanit, mirëpo I. KRASTEVE rreth kësaj konstaton me të drejtë:

„Çdo paradigmë kërkon të shpjegojë se pse gjërat *nuk* funksionojnë si duhet (sipas idealit të këtyre paradigmave), por asnjëra nuk duket e interesuar të gjejë se pse gjërat ndodhin ashtu siç janë. Dhe askush, më në fund, nuk merr në mënyrë adekuate në konsideratë perspektivën e qytetarit.”⁴⁶²

Derisa anashkalohen interesat dhe mendimet e qytetarëve në rajonin e Ballkanit Perëndimor, planet e bashkësisë ndërkombëtare për qetësim në rajonin e Ballkanit Perëndimor nuk do të gjejnë shumë gjasa për zbatim. Procesi drejt anëtarësimit në BE paraqet një sfidë dhe definohet njëkohësisht si cak e si ideal. BE-ja ndjek „*paradigmën e zhvillimit/integrimit*”, kur thekson se demokracisë i nevojitet një ekonomi e fortë dhe institucione shtetërore stabile dhe funksionale.⁴⁶³ Mirëpo, realiteti socio-politik në rajonin e Ballkanit Perëndimor pengon si zhvillimin ekonomik ashtu edhe etablimin e institucioneve shtetërore stabile dhe funksionuese, të cilat njëkohësisht paraqesin kushtet paraprake për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Kështu p.sh. para vitit 2004 në një raport të ESI-së fitej për një „krizë të

⁴⁵⁹ Duke marrë parasysh çështjen e pazgjidhur të statusit të Kosovës I. Krastev përmend rreth kësaj kundërgjegjësi të fuqishme: „Shpërbërja e Jugosllavisë ka treguar se kur një shoqëri e ndjen se ajo duhet të zgjedhë midis demokratizimit dhe vetëvendosjes, ajo do ta preferojë këtë të fundit. Besimi se ndryshimi demokratik në Beograd do të heqë pavarësinë nga agjenda e kosovarëve, doli të jetë joreale. Sekuenca e ndryshimeve politike në Kroaci është një shembull tjetër i fuqishëm që tregon se demokratizimi i suksesshëm është i mundshëm, vetëm pasi të jetë arritur konsolidimi i shtetit.” Ivan Krastev: *The Balkans: Democracy Without Choices*, në: *Journal of Democracy*, vëll.13, 3/2002, f. 43.

⁴⁶⁰ The World Bank, *The Road to Stability and Prosperity in South Eastern Europe. A Regional Strategy Paper*, Uashington DC, mars 2000.

⁴⁶¹ Krah. I. Krastev: *The Balkans: Democracy Without Choices*, në: *Journal of Democracy*, vëll.13, 3/2002, f. 42-5.

⁴⁶² Po aty, f. 45.

⁴⁶³ Krah. po aty, f. 42-5.

vitit 2004”, krizë ekonomike që qëndronte përpara në Bosnjë-Hercegovinë dhe në Kosovë. Kjo „krizë e vitit 2004” që së paku në Kosovë u bë reale, ishte e kushtëzuar nga tre faktorë: së pari përmes ndaljes së ndihmës për ndërtim dhe përmes papunësisë në rritje në rajon; së dyti përmes mungesës së barazimit me ekonomi private të kolapsit të industrisë socialiste; dhe së treti përmes pakënaqësisë në rritje të popullsisë me proceset demokratike, të cilat nuk i merrnin parasysh nevojat e qytetarëve dhe nuk ndalnin rënien sociale e ekonomike.⁴⁶⁴

Raportet e forcave në rajonin e Ballkanit Perëndimor edhe shumë vjet pas 1999 jepnin më shumë gjasa të zymta për rindërtimin politik e ekonomik. Sjellja e administratorëve ndërkombëtarë vlerësohet si arrogante nga popullsia vendore. Administrata e UNMIK-ut në Kosovë është shembulli më i mirë për këtë: „nuk është e mundshme që të përshkruhet si një sistem demokratik dhe i bazuar në ligj i qeverisjes administrata aktuale e UNMIK-ut, e cila mban tërësinë e autoritetit në çështjet civile në Kosovë.”⁴⁶⁵ Një sjellje autoritare, deri nënçmuese ndaj popullsisë vendore, si dhe mungesa e respektit që shpesh shfaqet ndaj kulturës dhe traditës vendore nga ana e pjesës së madhe të bashkëpunëtorëve të aparatit ndërkombëtar⁴⁶⁶ nuk mbetet pa u vërejtur nga popullsia. B. REKA konstaton me të drejtë: „Duket se UNMIK-u ka një mungesë të ndjenjave dhe mungesë të mirëkuptimit për historinë lokale, të gjuhës lokale dhe të traditës së saj, sidomos për traditën juridike të Kosovës.”⁴⁶⁷ Disa flasin madje për strukturat e pushtetit të UNMIK-ut si absolutiste.⁴⁶⁸ Autorë të tjerë me të drejtë përkujtojnë se „[...] vija ndërmjet administratës ndërkombëtare mbi një territor dhe neo-kolonializmit është një vijë e hollë, sidomos kur Kosova rrezikon të bëhet e varur nga donatorët.”⁴⁶⁹

⁴⁶⁴ Krah. ESI, Der westliche Balkan im Jahr 2004. Unterstützung, Kohäsion und die neuen Grenzen Europas. Ein Aufruf zur Reform der Politik der Europäischen Union [Ballkani Perëndimor në vitin 2004. Përkrahja, kohezioni dhe kufijtë e rinj të Evropës. Një thirrje për reformë të politikës së Bashkimit Evropian], Berlin etj. 3 nëntor 2002, f. 5.

⁴⁶⁵ Marcus G. Brand: Institution-Building and Human Rights Protection in Kosovo in the Light of UNMIK Legislation, në: Nordic Journal of International Law 70/2001, f. 488.

⁴⁶⁶ Krah. për këtë R. Vetter „Korruption, Vetternwirtschaft und mitunter rassistische Verhaltensweisen von Ausländern” sorgen für eine immer stärker werdende Spannung zwischen den Einheimischen und dem UNMIK-Verwaltungsapparat in Kosova [„Korrupsioni, nepotizmi dhe mes tjerash mënyra raciste e sjelljes së të huajve” kujdesen për tensione gjithnjë më të forta mes vendorëve dhe aparatit administruar të UNMIK-ut në Kosovë]. Reinhold Vetter: ‚Konditionierte Unabhängigkeit’ für Kosovo [Pavarësia e kushtëzuar për Kosovën], në: Südosteuropa 1-3/2003, f. 78.

⁴⁶⁷ Blerim Reka: UNMIK as an international governance in post-war Kosova: NATO’s Intervention, UN Administration and Kosovar Aspirations, Shkup etj. 2003, f. 153.

⁴⁶⁸ Krah. Axel Schwarz: Rückkehr des Absolutismus? – Machtstrukturen in UNMIK’s Kosovo [Kthimi i absolutizmit? – Strukturat e pushtetit në Kosovën e UNMIK-ut], në: Südosteuropa 10-12/2002, f. 527-42.

⁴⁶⁹ Valur Ingimundarson: Pitting Democratic Standards against Sovereign Rights: The nature of International Rule in Kosova (mund të gjendet në adresën: <http://www.newbalkanpolitics.org.mk/napis.asp?id=11&lang=English>).

Mungesën e empatisë e reflektojnë edhe strategjitë e bashkësisë ndërkombëtare për vendet e Ballkanit Perëndimor. Përvojat në vendet e tjera tregojnë se sa më fort të përfshihen vendet përkatëse gjatë hartimit të strategjive, aq më të mëdha janë shanset që strategjitë të zbatohen. Deri më sot kjo me vetëdije apo pa vetëdije u anashkalua në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe sidomos në Kosovë.

Në asamblatë e Këshillit Evropian në Kopenhagë më 1993⁴⁷⁰, në Korfuz më 1994 dhe Esen më 1999 u përcaktuan kushtet për kandidatët për aderim nga Evropa Qendrore dhe Lindore në BE.⁴⁷¹ Kushte të rëndësishme paraprake për aderim krahas statusit asociues janë para të gjithash kriteret e përmendura shpesh të Këshillit Evropian të Kopenhagës nga 21 dhe 22 qershori 1993, të cilat njëkohësisht vlejnë si standard për përparimin e procesit të integrimit në BE. Këto kushte paraprake të emërtuara si Kriteret e Kopenhagës për anëtarësim në BE janë: stabiliteti i institucioneve, të cilët garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e pakicave; ekonomia funksionuese dhe konkurruese e tregut në tregun e brendshëm evropian (aftësia e konkurrencës); aftësia për t'i përmbushur obligimet e shteteve anëtare si dhe pranimi i objektivave të unionit politik, të unionit ekonomik dhe monetar⁴⁷²; përshtatja e strukturave administruese me objektivin që të merret përsipër i tërë *acquis communautaire* dhe kriteri që duhet të përmbushet nga BE-ja i aftësisë për të pranuar kandidatë të rinj dhe për të ruajtur dinamikën e integrimit.

Në njërën nga kjo del pyetja se deri ku kanë përparuar vendet e Ballkanit Perëndimor në procesin e përmbushjes së këtyre kriterëve, dhe në anën tjetër se BE-ja, pas zgjerimit me dhjetë vende të reja anëtare në maj 2004 dhe me dy vende të tjera në janar 2007 a do të jetë e aftë për të pranuar vende të tjera brenda një kohe të shkurtër. Zgjerimi i BE-së në maj 2004 dhe në janar 2007 e ka dobësuar dukshëm fuqinë integruese të BE-së.

Rritja ekonomike dhe stabiliteti politik e institucional janë indikatorët më të mirë për të treguar se deri ku rajoni i Ballkanit Perëndimor i plotëson Kriteret e Kopenhagës. Në rajonin e Ballkanit Perëndimor jetojnë rrafsh 25 milionë njerëz dhe

⁴⁷⁰ Të gjitha dokumentet dhe rezolutat në lidhje me zgjerimin e BE-së mund të gjenden në adresën <http://ec.europa.eu/enlargement/index.htm>.

⁴⁷¹ Krah. Otmar Höll: Österreichs Außenbeziehungen gegenüber Zentral und Osteuropa seit 1995 [Marrëdhëniet e jashtme të Austrisë përball Evropës Qendrore dhe Lindore që nga viti 1995], në: Europäische Rundschau 2/2002, f. 43.

⁴⁷² Shiko për shembull Traktatin e Mاستrihtit. Duke marrë parasysh referimin se shtetet e reja anëtare duhet të përmbushin edhe pretendimet e Traktatit të Amsterdami, atëherë edhe parimet e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe të sundimit të ligjit duhet të nënvizohen si parakushte esenciale të një anëtarësimi në BE (Traktati i Amsterdami për ndryshimin e Traktatit të Bashkimit Evropian, të traktateve për themelimin e Komuniteteve Evropiane si dhe të disa akteve juridike që ndërlidhen me ato, GZ nr. C 340 nga 10 nëntori 1997, (mund të gjendet nën adresën: <http://www.europarl.europa.eu/topics/treaty/pdf/amst-de.pdf>).

PPB-ja i përgjigjet një vëllimi prej afro 50 miliardë eurosh. Brenda këtij rajoni situata ekonomike është shumë e ndryshme nga vendi në vend.⁴⁷³

Zhvillimet kombëtare dhe rajonale në fushën e ekonomisë do të varen edhe në të ardhmen shumë fort nga stabiliteti ekonomik. Këta indikatorë në vitet e fundit dolën pozitivë për rajonin e Ballkanit Perëndimor. Por pa mënjanimin e shkaqeve të konfliktit, të çështjes së statusit të Kosovës dhe të tufës së pasojave negative që rezultojnë prej saj, në Kosovë dhe rreth Kosovës ekzistojnë rreziqe të përhershme dhe reale të një hapi prapa, siç e tregon shpërthimi i dhunës ndëretnike në Kosovë, i nxitur nga grupet e interesit me sfond kriminal⁴⁷⁴ së fundi në mes të marsit 2004.⁴⁷⁵ Bashkësia ndërkombëtare la që të pritet me zgjidhjen e çështjes së statusit të Kosovës, edhe pse ekspertët për Ballkanin tashmë me vite tregonin për ndikimin destabilizues të statusit të pazgjidhur:

„Është e vështirë të diskutohen strategjitë rajonale për demokratizim dhe siguri pa vënë në dukje se statusi i pazgjidhur i Kosovës është njëri nga burimet kryesore të jostabilitetit rajonal. Karta e Paktit të Stabilitetit deklaroi: „Një zgjidhje e konfliktit të Kosovës është kritike për aftësinë tonë për të arritur tërësisht objektivat e Paktit të Stabilitetit dhe për të punuar drejt masave të përhershme, afatgjata për një të ardhme në paqe dhe në harmoni

⁴⁷³ Makroekonomia kroate është më e madhja me një PPB prej afro 23 milionë euro dhe siguron me këtë gati gjysmën e PPB-së të regjionit të Ballkanit Perëndimor. Të ardhurat mesatare për kokë banori në regjionin e Ballkanit Perëndimor arrijnë 2000 €. Të ardhurat për kokë banori në Kroaci arrijnë te afro 5100 €, ndërsa mesatarja në vendet e tjera në anën tjetër të rrafsh 1350 €. Krah. Zweiter Jahresbericht, (KOM (2003) 139 endgültig) [Raport i Komisionit të Komuniteteve Evropiane. Procesi i Stabilizimit dhe i Asociimit për Evropën Juglindore. Raporti i dytë vjetor (KOM (2003) 139 final)], Bruksel, më 26.3.2003, f. 11.

⁴⁷⁴ Gjatë qëndrimit tim shumëjavësh në Kosovë disa ditë pas shpërthimit të dhunës nga 17 deri 19 mars 2004 pas bisedave të shumta formale dhe private krijova përshtypjen se gjatë këtyre ngjarjeve organizatorë ishin para së gjithash aktorët e krimit të organizuar ekonomik. Ata ia arritën që këtë dhunë, e cila në radhë të parë drejtohej kundër kosovarëve të komunitetit serb dhe kundër të mirave të tyre kulturore, ta ngjyrosnin me tipare etnike, politike dhe fetare. Varfëria e shtrirë gjerësisht, papunësia e lartë në Kosovë (PPB-ja arrinte më 2003 për frymë vetëm rrafsh 700 €, shkalla e papunësisë mbi 50 %) si dhe pakënaqësia e popullsisë me administratën jo-eficiente të UNMIK-ut ishin sigurisht arsye shtesë për shpërthimin e dhunës. Një raport të parë më serioz për aktet e dhunës nga marsi 2004 në Kosovë e nxori ICG-ja. Krah. International Crisis Group (ICG), Collapse in Kosovo, Europe Report Nr. 155, Prishtinë etj. 22 prill 2004 (<http://www.crisisweb.org>).

⁴⁷⁵ Kështu edhe në raportin e tretë vjetor të Komisionit të Komuniteteve Evropiane për PSA-në nënvizohet funksioni kyç i çështjes së statusit të pazgjidhur të Kosovës për stabilitetin në regjionin e Ballkanit Perëndimor: „Ngjarjet e fundit në Kosovë janë një kundërgoditje e rëndë dhe tregojnë se çështja e Kosovës është edhe më tej vendimtare për stabilitetin në regjion.” Bericht der Kommission der Europäischen Gemeinschaften. Der Stabilisierungs- und Assoziierungsprozess für Südosteuropa. Dritter Jahresbericht, (KOM (2004) 202 endgültig), [Raport i Komisionit të Komuniteteve Evropiane. Procesi i stabilizimit dhe asociimit për Evropën Juglindore. Raporti i tretë vjetor, (KOM (2004) 202 final)], Bruksel, më 30.03.2004, f. 30 (http://europa.eu.int/eur-lex/de/com/rpt/2004/com2004_0202de01.pdf).

ndëretnike, pa frikën nga ringjallja e luftës”. Zgjidhja përfundimtare u shty me shpresën se një ndryshim i regjimit në Beograd mund ta bëjë më të lehtë për ta zgjidhur. Ky nuk ka qenë rasti.”⁴⁷⁶

Tejkalimi i paqartësisë politike në rajonin e Ballkanit Perëndimor, sipas mendimit tim, është një parakusht i pashmangshëm për stabilitetin politik, institucional dhe ekonomik, për bashkëpunimin rajonal dhe ndërrajonal dhe kështu edhe për një të ardhme evropiane të këtij rajoni, siç do ta shpjegoj në këtë krye.

Së pari në kapitullin A do t’i sqaroj më hollësisht rrafshet e ndryshme të iniciativave bashkëpunuese të vëna në jetë. Këto iniciativa bashkëpunuese i kanë vënë vetes si cak stabilitetin politik dhe nxitjen e ekonomisë në Ballkan, mirëpo mbesin kryesisht vetëm në memorandumet e mirëkuptimit me vullnet të mirë, pa ofruar zgjidhje politike. Shembulli më i theksuar për këtë është çështja e statusit të Kosovës, e cila është bërë faktori kryesor pengues për stabilitetin afatgjatë politik dhe ekonomik dhe për integrimin në BE në rajonin e Ballkanit Perëndimor, e në të cilën do të futem më gjerësisht në kapitujt B dhe C. Skenarët e proceseve të integritimit në BE për Kosovën dhe për vendet e saj fqinje do të diskutohen në konkluzionet si rezultat i këtij libri.

A. Nismat rajonale të bashkëpunimit

Bashkëpunimi mes shteteve dhe rajoneve kushtëzohet me një fqinjësi të mirë dhe me përvoja reciproke pozitive. Në vendet e Ballkanit Perëndimor faktorët politiko-psikologjikë u dëshmuar si pengesa kryesore për bashkëpunimin⁴⁷⁷ dhe integrimin rajonal. Eksperti për Evropën Juglindore Franz Lothar ALTMANN konstaton në mënyrë të saktë se „[...] bashkëpunimi i intensifikuar me njëri-tjetrin edhe më tej konsiderohet si kalë i Trojës për rivendosjen e gjendjes së mëparshme.”⁴⁷⁸ Për T. JUDT barrierat janë si ekonomike ashtu edhe psikologjike:

⁴⁷⁶ East West Institute, The European Stability Initiative, Democracy, Security and the Future of the Stability Pact for South Eastern Europe. A Political Framework, 4 prill 2001, f. 22 (mund të gjendet në adresën: www.esiweb.org).

⁴⁷⁷ Në përgjithësi rreth iniciativave kooperuese dhe rreth strategjive të stabilizimit në Evropën Juglindore krahas ICG, After Milosevic. A Practical Agenda for Lasting Balkans Peace, Balkans Report Nr. 108, Bruksel 1 prill 2001, f. 235-48; Othon Anastasakis, Vesna Bojicic-Dzelilovic: Balkan Regional Cooperation & European Integration, The London School of Economics and Political Science, korrik 2002, f. 20-9 (mund të gjendet në adresën: <http://www.lse.ac.uk/collections/hellenicObservatory/pdf/brie.pdf>).

⁴⁷⁸ Franz-Lothar Altmann: Regionale Kooperation in Südosteuropa, Organisationen, Pläne, Erfahrungen [Kooperimet rajonale në Evropën Juglindore, organizatat, planet, përvojat], në: Südosteuropa 4-6/2002, f. 271.

„Një bashkëpunim me fqinjët po ashtu të varfër në jug ose në lindje do të ishte jo vetëm ekonomikisht i pafrytshëm, por ai fsheh edhe kujtime të papëlqyeshme për kohërat e vëllazërisë socialiste, kur nocioni »Evropa« (Lindore) ishte i barabartë me represione, keqadministrim, varfëri dhe zhgënjim.»⁴⁷⁹

Për t'i tejkaluar këto barriera, BE-ja mbështetet para së gjithash në masat që për objektiv strategjik kanë bashkëpunimin mes vendeve të Ballkanit Perëndimor, sidomos që nga përfundimi i luftërave në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Kosovë. Kështu p.sh. në raportin e dytë vjetor të Komisionit të Komuniteteve Evropiane për PSA-në nga 26 marsi 2003 shprehimisht i jepet rëndësi kooperimit mes vendeve të Ballkanit Perëndimor. Përpjekjet në kuadër të PSA-së plotësohet përmes iniciativave të tjera rajonale dhe subrajonale të bashkëpunimit, me ç'rast Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore merr një rol thelbësor. Të gjitha këto iniciativa të bashkëpunimit luajnë një rol të rëndësishëm gjatë normalizimit të marrëdhënieve dhe kontribuojnë kështu në realizimin e objektivave të PSA-së.⁴⁸⁰

Bashkëpunimi rajonal do të duhet të dobësojë tendencat etno-nacionaliste, të kontribuojë në zhvillimin ekonomik e në stabilitetin politik, dhe të përgatisë integrimin në BE. Në vijim do të prezantohen iniciativat kryesore të bashkëpunimit në hapësirën e Ballkanit.

– Në grupin e punës Alpe Adria të themeluar në vitin 1978 nga vendet e Ballkanit Perëndimor është e përfshirë vetëm Kroacia. Kjo organizatë përqendrohet kryesisht në bashkëpunimin në fushat e turizmit dhe të ruajtjes së ambientit, edhe pse mes tjerash ekziston edhe një grup i punës për pakicat etnike.

– Nisma e Evropës Qendrore (Central European Initiative, CEI) e themeluar në nëntor 1989 përfshin sot 17 vende, nga Bjellorusia e deri te Maqedonia dhe Shqipëria. Ideja e themelimit ishte përpjekja për të tejkaluar barrierat ekzistuese politike dhe ideologjike në rajonin e Danubit dhe Adriatikut, por megjithatë deri më tani ka treguar pak rezultate konkrete. Përmes anëtarësimit në BE të shteteve të dikurshme komuniste bashkëpunimi me rajonin e Ballkanit Perëndimor për këto shtete u bë më shumë joatraktiv.⁴⁸¹

– Procesi i Rojamonit u iniciua nën kryesimin francez të Këshillit të BE-së në dhjetor 1996, pasi që një iniciativë e parë u ndërmor në mars 1995. Procesi i

⁴⁷⁹ T. Judt: Große Illusion Europa. Gefahren und Herausforderungen einer Idee [Iluzioni i madh Evropa. Rreziqet dhe sfidat e një ideje], Muni, Vjenë 1996, f. 84 f.

⁴⁸⁰ Krah. Zweiter Jahresbericht, (KOM (2003) 139 endgültig) [Raport i Komisionit të Komuniteteve Evropiane. Procesi i Stabilizimit dhe i Asociimit për Evropën Juglindore. Raporti i dytë vjetor (KOM (2003) 139 final)], Bruksel, më 26.3.2003, f. 17.

⁴⁸¹ Krah. F. L. Altmann: Regionale Kooperation in Südosteuropa, Organisationen, Pläne, Erfahrungen [Kooperimet rajonale në Evropën Juglindore, organizatat, planet, përvojat], në: Südosteuropa 4-6/2002, f. 274.

Rojamonit nuk tregoi deri më tani rezultate që vlejné të përmenden.⁴⁸² „Qëllimi afatgjatë është që të lehtësojë Marrëveshjet rajonale dhe nënrajonale të Fqinjësisë së Mirë dhe të Stabilitetit” thuhet si objektivi i Procesit të Rojamonit, i cili merret kryesisht me projekte në fushën e kulturës, në fushat e shoqërisë civile dhe të drejtave të njeriut. Përkundër disa ko incidencave të detyrave dhe të objektivave procesi i Rojamonit mbetet i pavarur nga Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore dhe mban një përfaqësues special të BE-së për stabilitet dhe fqinjësi të mirë në Evropën Juglindore, i cili është i vendosur pranë Këshillit të Ministrave të BE-së.

– Objektiva të ngjashëm si Procesi i Rojamonit, pra marrëdhënie të mira fqinjësore, ndjek edhe Konferenca për Fqinjësi të Mirë, Stabilitet, Siguri dhe Bashkëpunim në Evropën Juglindore (Conference on Good Neighbourliness, Stability, Security and Co-operation in South Eastern Europe (CSEE))⁴⁸³, një iniciativë e pastër e Evropës Juglindore⁴⁸⁴, e cila kaloi në Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (Southeast European Co-operation Process, më tutje: SEECF). Përveç SEECF-së, e cila është vetëm një forum diskutimi në rrafshin më të lartë politik, në Evropën Juglindore nuk ka bashkëpunim multilateral institucional, të kufizuar vetëm në rajon dhe i cili do të ishte i formuar me dëshirë të vetë rajonit dhe ku do të merrnin pjesë të gjitha vendet e rajonit.⁴⁸⁵

– Një iniciativë e mëtejme e bashkëpunimit në Evropën Juglindore është Bashkëpunimi Ekonomik i Detit të Zi (Black Sea Economic Co-operation, më tutje: BSEC), i cili pas ratifikimit nga parlamentet e të gjithë anëtarëve⁴⁸⁶ më 1999 e mori

⁴⁸² „I ashtuquajturi procesi i Rojamonit në këtë rajon ndodhi kryesisht pa vëmendjen e opinionit. Të paktën shtatë takime vijuese u zhvilluan, fatkeqësisht pa sukses të madh. Si pasojë e Luftës së Kosovës, këtij procesi për një kohë nuk iu kushtua kurrfarë vëmendje.” J. Warwick: The Kosovo Crisis and the European Union: The Stability Pact and its Consequences for EU Enlargement, në: K. R. Spillmann, J. Krause (ed.): Kosovo: Lessons Learned for International Cooperative Security, Bernë etj. 2000, f. 167.

⁴⁸³ Kjo përpjekje u nis në vitin 1996 në Sofje nga ministrat e jashtëm të vendeve të Evropës Juglindore së pari si iniciativë me emërtimin Konferenca e Fqinjësisë së Mirë, Stabilitetit, Sigurisë dhe Bashkëpunimit të vendeve të Evropës Juglindore (Conference of Good Neighbourliness, Stability, Security and Cooperation of the Countries of Southeastern Europe).

⁴⁸⁴ Krahe. Andreas Wittkowsky: Der Stabilitätspakt für Südosteuropa und die „führende Rolle” der Europäischen Union [Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore dhe „roli udhëheqës” i Bashkimit Evropian], në: Aus Politik und Zeitgeschichte. Beilage zur Wochenzeitung Das Parlament, 14 korrik 2000, f. 6.

⁴⁸⁵ Krahe. F. L. Altmann: Regionale Kooperation in Südosteuropa, Organisationen, Pläne, Erfahrungen [Kooperimet rajonale në Evropën Juglindore, organizatat, planet, përvojat], në: Südosteuropa 4-6/2002, f. 272. Përparime konkrete gjatë kooperimit rajonal ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor u arritën në bazë të iniciativave nga jashtë. Kështu për shembull u arrit zgjerimi i rjetit të marrëveshjeve bilaterale për tregti të lirë dhe marrëveshjeve të tjera bilaterale ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor para së gjithash me iniciativën e BE-së. Instituti Lindje – Perëndim (East – West Institut) ia ka vënë vetes si objektivi që të etablojë kooperime të mëtejme rajonale. Krahe. <http://www.iew.org>

⁴⁸⁶ Gjithsej njëmbëdhjetë vende nga regjione shumë të ndryshme gjeografike me struktura shumë të ndryshme politike, dhe atë gjashtë vendet që shtrihen buzë Detit të Zi: Bullgaria, Gjeorgjia,

statusin juridik të një organizate ekonomike rajonale. Si iniciatore e BSEC-së është Turqia, e cila kishte qëllimin që ta fuqizonte pozitën e vet në rajonin e Detit të Zi.⁴⁸⁷

– Iniciativa Kooperuese e Evropës Juglindore (Southeast European Co-operative Initiative, më tutje: SECI) del nga propozimi i ambasadorit të ShBA-së Richard SCHIFTER dhe prandaj perceptohet më shumë si një iniciativë amerikane dhe më pak si një iniciativë e përbashkët amerikano-evropiane, edhe pse krahas Shteteve të Bashkuara të Amerikës të ashtuquajtur anëtarë përkrahës janë Austria, Italia, Republika Çeke dhe Zvicra. SECI u themelua në dhjetor 1996 me qëllim që në mesin e dymbëdhjetë vendeve të rajonit⁴⁸⁸ të nxisë bashkëpunimin sidomos për çështje ekonomike dhe ekologjike dhe të lehtësojë integrimin në strukturat panevropiane. Ky bashkëpunim u kufizua deri më tani në këmbimin e ekspertëve dhe në kooperimin ndërmjet organizatave ndërkombëtare financiare (pa alokimin e financimeve). Projekti më i rëndësishëm i SECI-së është qendra rajonale e SECI-së për luftimin e krimit dhe korrupsionit ndërkufitar, e cila ka marrë një dimension të ri në vazhden e luftimit global të terrorizmit pas 11 shtatorit 2001.⁴⁸⁹

– Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore u themelua më 1999 nga bashkësia ndërkombëtare qysh gjatë luftës së Kosovës. Ngaqë këtu bëhet fjalë për një iniciativë të rëndësishme të bashkëpunimit në hapësirën e Ballkanit, ai do të trajtohet në veçanti në pikën vijuese.

– Nisma Adriatiko-Joniane (NAJ) u nis më 19 dhe 20 maj 2000 në Ankona me iniciativën e qeverisë italiane gjatë Konferencës për Zhvillim dhe Siguri në pellgun adriatiko-jonian. Ajo thekson nevojën për një rrjet multilateral për bashkëpunim të vendeve që shtrihen buzë pellgut adriatiko-jonian. Ky bashkëpunim duhet të zhvillohet në këto katër fusha: 1. Ekonomi, turizëm e transport detar; 2. Mbrojtje e mjedisit dhe ruajtje e burimeve natyrore në Adriatik dhe në Detin Jon; 3. Bashkëpunim ndëruniversitar; 4. Luftim i krimit të organizuar në pellgun adriatiko-jonian.⁴⁹⁰

– Procesi i Bashkëpunimit të Danubit (Danube Co-operation Process, DCP), është një iniciativë e mëtejme për nxitjen e bashkëpunimit rajonal. Shenja e nisjes për Procesin e Bashkëpunimit të Danubit u dha gjatë një konference të hapjes në

Rumania, Rusia, Turqia dhe Ukraina, pastaj Shqipëria, Armenia, Azerbajxhani, Greqia dhe Moldavia.

⁴⁸⁷ Krah. F. L. Altmann: Regionale Kooperation in Südosteuropa, Organisationen, Pläne, Erfahrungen [Kooperimet rajonale në Evropën Juglindore, organizatat, planet, përvojat], në: Südosteuropa 4-6/2002, f. 274.

⁴⁸⁸ Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, RFJ e *Milošević-it*, Greqia, Kroacia, Maqedonia, Moldavia, Rumania, Sllovenia, Turqia dhe Hungaria.

⁴⁸⁹ Krah. F. L. Altmann: Regionale Kooperation in Südosteuropa, Organisationen, Pläne, Erfahrungen [Kooperimet rajonale në Evropën Juglindore, organizatat, planet, përvojat], në: Südosteuropa 4-6/2002, f. 278 vv.

⁴⁹⁰ Krah. po aty, f. 285 vv.

Vjenë më 27 maj 2002. Përmes tij do të duhet të arrihet sidomos mundësimi i lundrimit të lirë në Danub si dhe bashkëpunimi në fushën e mjedisit.

– Më 2 maj 2003 në kryeqytetin shqiptar Tiranë u nënshkrua Karta e Adriatikut nga ministrat e jashtëm të Shqipërisë, të Kroacisë dhe të Maqedonisë në praninë e C. POWELL.⁴⁹¹ Objektivi i këtij bashkëpunimi pritet të jetë përshpejtimi i reformave për integrimin në strukturat euro-atlantike dhe sidomos në NATO. Sikurse shtetet baltike, me gjasë edhe Shqipëria, Kroacia e Maqedonia do të pranohen në të njëjtën kohë në NATO.

Në krahasim me shtetet e tjera ish-komuniste evropiane, vendet e Ballkanit Perëndimor e humbën hapin drejt integritimit në BE, edhe pse është ironike që RSFJ-ja kultivonte marrëdhëniet më të mira me KE-në në krahasim me ato shtete.⁴⁹² Vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor vetëm në dhjetor 2006 lidhën një marrëveshje për tregti të lirë, ashtu që aderuan në Marrëveshjen e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (Central European Free Trade Agreement, më tutje: CEFTA), e cila ishte themeluar nga shtetet e Vishegradit: Polonia, ish-Çekosllovakia (sot Çekia, Sllovakia) dhe Hungaria. Pas largimit të Bullgarisë dhe Rumanisë në janar 2007, CEFTA ka këta anëtarë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova/UNMIK-u, Kroacia, FYROM (Maqedonia), Moldavia, Mali i Zi dhe Serbia.

I. Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore

Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore, i miratuar më 10 qershor 1999 në Këln nën kryesimin e presidencës gjermane të Këshillit të BE-së, nga ministrat e jashtëm të BE-së dhe të vendeve të G-8-shit si dhe nga përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare si OSBE-ja, OKB-ja dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) duhet t'u sigurojë „ndihmë për vetëndihmë” vendeve të rajonit. Në mesin e iniciativave të shumta të bashkëpunimit të përshkruara më lart, Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore⁴⁹³ është njëra prej iniciativave më të rëndësishme, sidomos për rajonin e Ballkanit Perëndimor që ka mbetur prapa në procesin e integritimit në BE. Për këtë arsye më duket e nevojshme që Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore të shpjegohet më gjerësisht sesa iniciativat e tjera të bashkëpunimit.

⁴⁹¹ Për të nënvizuar përkrahjen e kësaj karte nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ajo u nënshkruar edhe nga C. Powell. Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës George W. Bush e quajti të mirëseardhur këtë nënshkrim. Krah. <http://www.whitehouse.gov/news/releases/2003/05/20030502-4.html>

⁴⁹² Krah. Othon Anastasakis, Dimitar Bechev: EU Conditionality in South East Europe: Bringing Commitment to the Process, European Studies Center, St Antony's College, University of Oxford, prill 2003, f. 5 (<http://www.sant.ox.ac.uk/areastudies/analyses.shtml>).

⁴⁹³ Në përgjithësi rreth Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore krah. ICG, After Milosevic. A Practical Agenda for Lasting Balkans Peace, Balkans Report Nr. 108, Bruksel 1 prill 2001, f. 239 vv.

Si organ suprem i Paktit të Stabilitetit dhe si pikë qendrore bashkërenduese shërben koordinatori i posaçëm i Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore i emëruar nga BE-ja. Për të garantuar një ballafaqim të gjerë me sfidat, u krijuan tri të ashtuquajtura Tavolina të punës: 1. Demokracia dhe të drejtat e njeriut (ndërtimi i institucioneve dhe „qeverisja e mirë”, mediet, liria); 2. Rindërtimi, zhvillimi dhe bashkëpunimi ekonomik (liberalizimi i tregtisë dhe bashkëpunimi, zhvillimi i sektorit privat, infrastruktura rajonale dhe zhvillimi, reforma e legjisllacionit) dhe 3. Siguria (lufta kundër krimit të organizuar, kufijtë, migrimi, dogana, deminimi dhe kontrolli i armëve të vogla) me dy tavolina pune të nënrenditura për siguri dhe mbrojtje si dhe drejtësi dhe punë të brendshme.⁴⁹⁴ Në kuadër të këtyre tavolinave të punës zhvillohen bisedime të institucionalizuara rajonale, gjatë të cilave lidhen marrëveshje multilaterale dhe bilaterale si dhe marrëveshje ndërshtetërore.

Duke marrë parasysh trendin e përgjithshëm të globalizimit, edhe vendet e Ballkanit Perëndimor detyrohen për koordinim më të mirë të politikës së tyre ekonomike.⁴⁹⁵ Kështu shpresohet edhe krijimi i një tregu më të madh dhe më atraktiv për investimet e huaja.

1. Koncepti i Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore

Jostabiliteti që zgjat që nga viti i kthesës 1989 dhe konfliktet luftarake në rajonin e Ballkanit Perëndimor e bënin gjithnjë e më të qartë se për një përaftrim të suksesshëm të rajonit në strukturat evropiane dhe euro-atlantike është e pashmangshme një strategji e unifikuar dhe konsistente, e cila nuk i trajton vetëm pasojat, por edhe shkaqet. Kështu me Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore për herë të parë për tërë rajonin e Ballkanit u mendua dhe u veprua konkretisht, strategjikisht dhe me orientim nga e ardhmja.

Këshilli i Posaçëm i ministrave të jashtëm të BE-së nga data 8 prill 1999 në Luksemburg konstatoi në konkluzionin e vet:

„Evropa Juglindore ka nevojë për një Pakt të Stabilitetit, nëpërmjet të cilit hapen gjasat për një proces afatgjatë të stabilizimit politik dhe ekonomik. Një strategji e tillë me shtrirje të gjerë do të mund të ndërtohej mbi iniciativat rajonale ekzistuese.”⁴⁹⁶

⁴⁹⁴ Për informata më të hollësishme rreth strukturës dhe detyrave të tri tavolinave të punës së Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore shiko Johanna Deimel: Der Stabilitätspakt für Südosteuropa: Ansatz und aktueller Stand beim Regionaltisch und den drei Arbeitsbereichen [Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore: Pikënisja dhe gjendja aktuale në tavolinën rajonale dhe në tri fushat e punës], në: Südosteuropa Mitteilungen 2/2001, f. 175-98.

⁴⁹⁵ Krah. F. L. Altmann: Regionale Kooperation in Südosteuropa, Organisationen, Pläne, Erfahrungen [Kooperimet rajonale në Evropën Juglindore, organizatat, planet, përvojat], në: Südosteuropa 4-6/2002, f. 283.

⁴⁹⁶ Mund të gjendet në adresën: <http://europa.eu/bulletin/de/9904/p104067.htm>

Më 17 maj 1999 nga ministrat e jashtëm të BE-së u miratua një qëndrim i përbashkët⁴⁹⁷ përkitazi me Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore, në të cilin BE-ja deklarohet e gatshme të marrë përsipër rolin udhëheqës pranë Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore. Nën kryesimin e presidencës gjermane të Këshillit të BE-së dhe në prani të përfaqësuesve të shteteve të shumta dhe të organizatave ndërkombëtare u themelua Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore⁴⁹⁸ në kuadër të një konference më 10 qershor 1999 në Këln. Ministri i jashtëm gjerman Joseph FISCHER theksoi në fjalimin e tij, gjatë miratimit të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore, rëndësinë e tij për politikën e paqes:

„Sot është një ditë shumë e mirë për Evropën. Në konfliktin e Kosovës më në fund ka ardhur kthesa, të cilën e kemi pritur aq gjatë. [...] Mirëpo, vendimtarja është që njerëzit, para së gjithash 1,5 milion kosovarët e dëbuar, nga sot mund të shpresojnë prapë. [...] Por, një zgjidhje politike në Kosovë do të dëshmohet si e qëndrueshme vetëm atëherë kur ajo të jetë e vendosur në një strategji të gjerë të paqes për tërë rajonin dhe një strategji të tillë duam ta nisim me konferencën e sotme. [...] Politika e deritashme e bashkësisë së shteteve përballë ish-Jugosllavisë përmbante dy deficite shumë të rënda: ajo trajtonte pasojat në vend të shkaqeve të konflikteve [...]”⁴⁹⁹

Koordinatori aktual i BE-së për politikë të jashtme, J. SOLANA, deklaroi:

„Përveç kësaj duhet të merret parasysh leksioni i mësuar në Bosnjë se duhet të shikohet drejt të ardhmes, përtej fundit të konfliktit, dhe të ketë angazhim për rindërtimin e gjerë [⁵⁰⁰] të rajonit.”⁵⁰¹

Gjatë konferencës hapëse të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore në nivelin e shefave të shteteve dhe të qeverive më 30 korrik 1999 në Sarajevë u miratua e ashtuquajtura „Deklarata e Sarajevës për Paktin e Stabilitetit” (Sarajevo Declaration on the Stability Pact). Në këtë deklaratë përsëri shprehet qëllimi që edhe

⁴⁹⁷ <http://europa.eu/generalreport/de/1999/pt0758.htm#fn1>

⁴⁹⁸ Ora e lindjes së Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore bazohet në një fjalim të kryeministrit të atëhershëm francez Edouard Balladur në pranverë 1992. Krahi. J. M. van Brabant: Southeastern Europe, Transitions, and the EU – Is Ever-widening Desirable?, në: Economic Policy in Transitional Economies MOCT-MOST, (shënimi 20), 11/2001, f. 309.

⁴⁹⁹ I botuar në: Internationale Politik – Europa Archiv 8/1999, f.130 vv.

⁵⁰⁰ Në literaturën profesionale me të drejtë bëhet vërejtja se shprehja rindërtim mund të jetë mashtruese. „Sidomos për shtete dhe etnitate të veçanta është e gabuar shprehja »rindërtim ekonomik«, sepse këto makroekonomi në procesin e modernizimit ende nuk e kanë arritur fazën e kërcimit.” Wim van Meurs: Der Balkan – von Stabilisierung zu Integration [Ballkani – nga stabilizimi deri te integrimi], në: Europäische Rundschau, 1/2003, f. 80.

⁵⁰¹ J. Solana: Die Erfolge der NATO im Kosovo [Sukseset e NATO-s në Kosovë], në: Europäische Rundschau 1/2000, f. 55.

më tej të mbështetet siguria, sundimi i ligjit, demokracia dhe proceset paqësore në Ballkan.⁵⁰²

Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore e ka bërë të qartë se bashkëpunimi rajonal është i pashmangshëm për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE dhe në strukturat euro-atlantike. Bashkëpunimi rajonal do të duhej të shërbente si katalizator në procesin e pajtimit.

Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore bazohet në dy koncepte të zhvilluara nga BE-ja⁵⁰³: në qasje rajonale dhe në parimin e kondicionalitetit.⁵⁰⁴ Shumë janë të mendimit se ka kundërthënie të caktuara të pranishme në këto dy qasje. „Parimet rajonalitet dhe kondicionalitet janë në kundërshtim: kondicionaliteti përkrah të

⁵⁰² Krah. Erklärung der Teilnehmer des Balkan-Gipfels zum Stabilitätspakt am 30. Juli 1999 in Sarajevo [Deklarata e pjesëmarrësve të samitit të Ballkanit për Paktin e Stabilitetit më 30 korrik 1999 në Sarajevë], në: Internationale Politik – Europa Archiv 8/1999, f. 132 vv.

⁵⁰³ Krah. Heinz-Jürgen Axt: Der Stabilitätspakt für Südosteuropa: politischer Aktionismus oder langfristig tragfähiges Konzept? [Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore: akcionizëm politik apo koncept stabil afatgjatë?], në: Südosteuropa 7-8/1999, f. 403.

⁵⁰⁴ Qasja rajonale u formulua si një prej konsekuencave politike të Marrëveshjes paqësore të Dejtonit në konkluzionet e Këshillit të Ministrave të Jashtëm të BE-së nga shkurti 1996 dhe nga prilli 1997. Ai përmbante detyrën për RFJ-në e *Milošević-it* dhe për Kroacinë si dhe për të gjitha vendet e tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor që të përmbushin Marrëveshjen paqësore të Dejtonit për Bosnjën dhe Hercegovinën në të gjitha aspektet dhe u përcaktua nga parimi, që BE-ja vendeve të involvuara dëshironte t’ua jepte qasjen në tregun e brendshëm të BE-së në atë masë siç u sigurojnë partnerët fqinjëve të tyre të drejtpërdrejtë po ashtu qasje në tregun e vet.

Parimi i kondicionalitetit, zyrtarisht parimi i „zbatimit të kondicionalitetit në shikim të zhvillimit të një strategjie koherente në BE për marrëdhëniet me vendet në rajon”, u zhvillua nga Këshilli i Ministrave më 29 prill 1997 në Luksemburg dhe bazohet mbi dy elemente kryesore: Së pari kushte të përgjithshme dhe të obligueshme për të gjitha shtetet dhe së dyti kondita të posaçme për shtetet e veçanta. Këtu vlen parimi se marrëdhëniet me BE-në mund të përmirësohen në atë masë, sa të dallohen përparime gjatë përmbushjes së kushteve të përcaktuara.

Komisioni i Komuniteteve Evropiane harton dy herë në vit një raport, në të cilin vëzhgohen dhe vlerësohen përparimet gjatë përmbushjes së kërkesave të kondicionalitetit. Sa më të mira që dalin notat e Komisionit të Komuniteteve Evropiane për një vend të caktuar të rajonit, aq më intensive bëhen marrëdhëniet midis atij vendi dhe BE-së. Në këtë proces si joshje për vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor janë krijuar preferencat tregtare, implementimi i programit PHARE si dhe zhvillimi i marrëdhënieve kontraktore. Programi PHARE (Poland and Hungary Assistance for the Restructuring of the Economy) ishte i kufizuar më 1989 së pari për Poloninë dhe Hungarinë, por më vonë është zgjeruar për të gjitha kandidatët për anëtarësim në BE përkatësisht për kandidatët potencialë. Për vlerësimin e përmbushjes së konditave merren parasysh sidomos parimet demokratike, të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit, respektimi dhe mbrojtja e pakicave si dhe reformat në ekonominë e tregut. Për më shumë rreth kësaj krah. Franz-Lothar Altmann: Die Balkanpolitik der EU-Regionalansatz und Prinzip der Konditionalität [Politika ballkanike e qasjes rajonale të BE-së dhe parimi i kondicionalitetit], në: Südosteuropa 10-11/1998, f. 503-15.

avancuarit dhe i shpërfill të prapambeturit”,⁵⁰⁵ krijon pra pabarazi, derisa qasja rajonale synon një zhvillim të unifikuar të rajonit. Të tjerët mendojnë se „të metat e kushtëzimit në Ballkanin Perëndimor janë rezultat i drejtpërdrejtë i mungesës së angazhimit.”⁵⁰⁶ Përveç kësaj mbetet e saktë se „kushtëzimi i BE-së në Ballkan është një instrument shumëdimensional i drejtuar kah pajtimi, rindërtimi dhe reforma.”⁵⁰⁷

Posaçërisht lufta në Kosovë, përkatësisht për të, ndikoi si katalizator për Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore dhe për vëmendjen ndërkombëtare, e cila në vitet e fundit iu përkushtua juglindjes së Evropës. Pakti i Stabilitetit do të duhej të ishte një instrument preventiv i dialogut dhe i stabilizimit në frymën e Akteve Finale të Helsinkit. Për dallim nga konferencat ballkanike të Fuqive të Mëdha në shekullin XIX dhe XX, Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore është një pikë shumë e rëndësishme, që vendimet nuk merren përtej kokave të popujve të prekur.⁵⁰⁸

Së fundi, në këtë kuptim më 10 dhe 11 maj 2007, gjatë një takimi të përbashkët të përfaqësuesve të shteteve të Evropës Juglindore, BE-së, ShBA-së dhe organizatave të shumta ndërkombëtare në kryeqytetin kroat Zagreb, u vendos që nga viti 2008 Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore të shndërrohet në një Këshill për Bashkëpunim Rajonal (Regional Co-operation Council). Kështu synohet që t'i bartet më fort përgjegjësia aktorëve në rajon dhe të vazhdojë bashkëpunimi në Evropën Juglindore në rrafshin politik dhe profesional në fushën e zhvillimit ekonomik dhe social, të infrastrukturës, të gjyqësorit, të punëve të brendshme, si dhe të sigurisë. Seli e sekretariatit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal u caktua Sarajeva.

⁵⁰⁵ I. Kempe, W. van Meurs: Neue EU-Nachbarn. Strategien gegenüber Südost- und Osteuropa jenseits der Erweiterung [Fqinjhtë e rinj të BE-së. Strategjitë përballë Evropës Juglindore dhe Lindore përtej zgjerimit], në: Internationale Politik Europa – Archiv 5/2002, f. 30.

⁵⁰⁶ O. Anastasakis, D. Bechev: EU Conditionality in South East Europe: Bringing Commitment to the Process, European Studies Center, St Antony's College, University of Oxford, prill 2003, f. 3.

⁵⁰⁷ Po aty, f. 8.

⁵⁰⁸ Krah. U. Schneckener: Regulierung ethnischer Konflikte in Südosteuropa. Die Politik der Anerkennung [Rregullimi i konflikteve etnike në Evropën Juglindore. Politika e njohjes], në: Internationale Politik – Europa Archiv 9/1999, f. 9.

„Pa një bashkëjetesë paqësore të grupeve etnike nuk do të ketë stabilitet. Dashamirësi ose besim nuk guxon askush të presë për një kohë të caktuar. Toleranca do të ishte tejet shumë për fillim. Andaj ideja e Paktit të Stabilitetit është e saktë.”⁵⁰⁹

2. Vlerësimi i Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore

Për vendet e Ballkanit Perëndimor bashkësia ndërkombëtare, e sidomos BE-ja, kohë të gjatë nuk kishte strategji të koordinuar qartë, unike dhe mbi së gjitha afatgjate. Veprimet individuale e *ad hoc* në këtë hapësirë u kuptuan vetëm si aksione humanitare, edhe pse strategjitë afatgjata për çështjet që në radhë të parë duhet të zgjidhen politikisht, do të kishin qenë më të dobishme.

Kjo vlen si për fillimin e konflikteve luftarake në fillim të viteve të nëntëdhjeta, p.sh. kur mbi Bosnjë dhe Hercegovinë u hodhën ushqime nga ajri, ndërsa në tokë po ndodhnin krimet më të mëdha në kontinentin evropian që nga Lufta e Dytë Botërore, ashtu edhe për masat para, gjatë dhe pas aksioneve të NATO-s në Kosovë e përreth Kosovës. Këto aksione u definuan në radhë të parë si masa humanitare, por jo si akte në kuadër të një strategjie të gjerë politike e ushtarake, e cila do të mund ta ndalte qendrën drejtuese të „strategjisë së luftës së tokës së djegur në rajonin e Ballkanit Perëndimor”, pra regjimin e Beogradit. Kështu rajoni i Ballkanit Perëndimor nga ana e bashkësisë ndërkombëtare për një kohë të gjatë e perceptua më tepër si një rast humanitar. Aksionet humanitare ishin të sakta dhe të rëndësishme, por ato trajtonin vetëm pasojat e luftërave me motivim të etno-nacionalizmit të madh, duke u nisur nga një „diagnozë” e gabuar dhe përmbytësishme e papërshtatshme. Të nevojshme do të ishin zgjidhjet e qarta politike dhe para së gjithash një perspektivë evropiane.

„Lansimi i Paktit të Stabilitetit më 10 qershor 1999 ishte shembulli i parë i strategjisë së BE-së për ndryshim.”⁵¹⁰ Këtë dukej se e ofronte Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore:⁵¹¹ Strategjia e re politiko-ekonomike e Paktit të Stabilitetit i dha tërë Ballkanit perspektiva dhe shpresa të reja.

Përkundër këtij hapi në drejtimin e saktë, shanset e suksesit të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore shikohen me një skepsë të caktuar, për shkak të hipotekeve

⁵⁰⁹ Reinhard Stuth: Stabilität in Sicht? Fragen an die europäische Balkanpolitik [Stabiliteti në dukje? Pyetje për politikën evropiane për Ballkanin], në: Konrad Adenauer Stiftung Auslands Informationen, 4/2000, f. 18.

⁵¹⁰ D. Papadimitriou: The EU's Strategy in the Post-Communist Balkans, në: Southeast European and Black Sea Studies, vëll. 1, 3/2001, f. 77.

⁵¹¹ Për një analizë të punës së Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore deri në fillim të vitit 2003 krahas. Janine M. Calic: Welche Zukunft für den Balkan-Stabilitätspakt? [Çfarë të ardhme për Paktin e Stabilitetit për Ballkanin?], në: SWP-Studie. Stiftung Wissenschaft und Politik. Deutsches Institut für Internationale Politik und Sicherheit, Berlin mars 2003.

të të kaluarës. Kështu p.sh. shkruajnë publicistët Wolfgang LIBAL dhe Christine von KOHL:

„Bashkësitë ndërkombëtare e kanë humbur në masë të madhe avansin e pritjes dhe të besimit të popullsisë në vendet që dikur qeveriseshin në mënyrë komuniste. Pa një besim të ri të fituar, megjithatë, asnjëra nga përpjekjet e Paktit të Stabilitetit – të kësaj „ideje madhështore” – nuk do të japin fruta.”⁵¹²

Pakti i Stabilitetit ka kontribuar në krijimin e zonave të tregtisë së lirë në hapësirën ballkanike, të cilat janë të rëndësishme për proceset e integritimit në BE të kësaj hapësire. Mirëpo, nëse integrimi në BE nuk ndodh në një të ardhme jo të largët, atëherë nuk do të mund të mënjanohej instabiliteti dhe konfliktet.⁵¹³

Edhe në qoftë se nuk mundi t’i mënjanohej plotësisht dobësitë e konstruksionit të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore, diplomati austriak E. BUSEK, i cili më 2002 mori përsipër funksionin e koordinatorit special⁵¹⁴ në Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore, i arriti prapëseprapë sukseset e para të kapshme. Falë mënyrës së tij pragmatike të veprimit dhe empatisë për problemet e për sfidat e rajonit të Ballkanit Perëndimor, E. BUSEK arriti autoritet në rajon⁵¹⁵ dhe tek institucionet e ndryshme ndërkombëtare.

Në anën tjetër, zërat kritikë janë të mendimit se lëmshi i iniciativave stabilizuese për Evropën Juglindore është përkeqësuar edhe më shumë përmes një strukture shtesë: Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore. Sipas mendimit tim një përforsim i bashkëpunimit midis Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore dhe PSA-së vërtet do ta shmangte dyfishimin.

⁵¹² W. Libal, Ch. von Kohl: Balkan. Stabilität oder Chaos in Europa [Ballkani. Stabilitet apo kaos në Evropë], Hamburg, Vjenë 2000, f. 155. ICG parashtron pyetjen: „Përderisa ajo dukej si një ide e mirë në atë kohë, pyetja është nëse cilësia e implementimit të saj mund të përmirësohet para se pjesëmarrësit kryesorë të humbasin krejtësisht interesimin dhe besimin në të.” ICG, After Milosevic. A Practical Agenda for Lasting Balkans Peace, Balkans Report Nr. 108, Bruksel 1 prill 2001, f. 235.

⁵¹³ Krah. United States Institute of Peace (USIP), Special Report, Europe in the 21st Century. A strategy for Achieving Stable Peace, Uashington DC, nëntor 2000, f. 8 v.

⁵¹⁴ Mandati i koordinatorit special është shumë i gjerë: „Koordinatori i posaçëm’ i ri i Paktit të Stabilitetit, i cili do të emërohet në janar 2002, duhet të ketë një mandat më të qartë të BE-së, teknikisht mbajtësi i tanishëm i postit është ‘Përfaqësues Special’ i BE-së, por në të vërtetë ai i përgjigjet çdokujt dhe askujt.” Marta Dassù, Nicholas Whyte: America’s Balkan Disengagement?, në: Survival, vëll. 43, 4/2001-02, f. 129.

⁵¹⁵ Kështu për shembull për Kosovën vetëm pas emërimit të E. Busek si koordinator special i Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore u bë e mundshme që sikur vendet e tjera të rajonit të përfaqësohet me një „koordinator kombëtar” të vet në Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore.

Disa ngulmojnë tashmë për një „riorientim strategjik të Paktit të Stabilitetit”.⁵¹⁶ Veçanërisht në orët e para të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore u kritikua barra burokratike, shpenzimet panevojshëm të larta dhe fakti që Pakti i Stabilitetit krijonte vetëm telediagnoza për rajonet e prekura. Fjala ishte edhe për mungesë të udhëheqjes dhe të përgjegjësisë.⁵¹⁷ Kjo ndoshta në të ardhmen do të përmirësohet ashtu që Këshilli për Bashkëpunim Rajonal të jetë një organizatë që të udhëhiqet në regji lokale nga vendet e rajonit. Shkencëtari ekonomik Vladimir GLIGOROV ndjen mungesën e theksit tek bashkëpunimi zhvillimor⁵¹⁸ dhe na përkujton se:

„[...] qasja rajonale e Bashkimit Evropian por edhe e të ashtuquajturit Pakt të Stabilitetit mbetet ende të bëjë ndonjë ndryshim. Iniciativat janë ende të strukturuar ashtu që çështjet e sigurisë të jenë më të rëndësishme se ato të zhvillimit.”⁵¹⁹

Në përfundim mund të shënohet vërejtja se gjatë vlerësimit të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore do të shfaqet një mostër përgjithësisht e njohur e sjelljes: Së pari del euforia, e cila përmes konfrontimit me problemet shumëdekadëshe ekonomike dhe politike shpejt shndërrohet në dëshpërim nga ana e përkrahësve dhe të përkrahurve.

Në përgjithësi, sipas vlerësimit tim, shpesh nuk vërehet fakti se problemet e krijuara gjatë dekadave në shoqëritë me struktura ekonomike që funksionojnë keq, me krim fort të organizuar dhe me dukuri të korrupsionit, nuk mund të përballohen brenda një kohe të shkurtër. Një pikë tjetër e dobët, nën të cilën vuajnë të gjitha iniciativat bashkëpunuese, është fakti se iniciativat për bashkëpunim rajonal parimisht mbeten vepër e një grupi të vogël elitare dhe masa e gjerë e popullatës nuk është e informuar mjaftueshëm rreth kësaj, përkatësisht nuk është e bashkëpërfshirë në të.⁵²⁰

⁵¹⁶ J. M. Calic: Welche Zukunft für den Balkan-Stabilitätspakt? [Çfarë të ardhme për Paktin e Stabilitetit për Ballkanin?], në: SWP-Studie. Stiftung Wissenschaft und Politik. Deutsches Institut für Internationale Politik und Sicherheit, Berlin mars 2003, f. 30.

⁵¹⁷ Krah. R. Stuth: Stabilität in Sicht? Fragen an die europäische Balkanpolitik [Stabiliteti në dukje? Pyetje për politikën evropiane për Ballkanin], në: Konrad Adenauer Stiftung Auslands Informationen, 4/2000, f. 18 vv.

⁵¹⁸ Kështu për shembull juristi Reinhard Stuth konstaton: „Një pjesë e madhe e ndihmave ndërkombëtare rrjedh prapë në llogaritë e huaja të pagave. Sa mjete tona financiare i arrijnë vërtet njerëzit në Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, në Kosovë, në Maqedoni dhe i shërbejnë ngritjes ekonomike?”, po aty, f. 20.

⁵¹⁹ Vladimir Gligorov: The Economics of Kosovo: Does Viability Matter?, në: The International Spectator, prill – qershor 2/2000, f. 100.

⁵²⁰ Edhe pse Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore është iniciativa më e njohur e bashkëpunimit rajonal, sipas një ankete të zhvilluar në janar dhe shkurt 2002 në tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor vetëm në Kosovë gati gjysma e të anketuarve kishte besim në këtë iniciativë. Në vendet e tjera kjo përqindje arrinte dukshëm nën 30 për qind. Në vazhdim do të paraqiten rezultatet e kësaj ankete në formë tabelare:

Qasja e Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore, përkatësisht e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, përmes strategjive të veta afatgjate të sigurisë së brendshme dhe të jashtme, si dhe përmes strategjive afatgjate të demokratizimit, e mbështetur mbi iniciativa ekonomike, ofron arsye të mira për optimizëm. Krijimi i një kornize ndërrajonale ekonomike ofron trajtim të njëjtë dhe barazi të shanseve për të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Përmes kësaj pëmbushen parakushtet e rëndësishme për një demokraci stabile, ekonomi të tregut dhe bashkëpunim rajonal dhe me këtë edhe për një paqe të qëndrueshme ndërmjet vendeve të rajonit. Mirëpo, paqartësitë juridiko-politike si në Serbi, Mal të Zi dhe Kosovë si dhe fragjiliteti i vazhdueshëm i Bosnjës dhe Hercegovinës paraqesin një pengesë gjatë zbatimit të ideve dhe të objektivave të Paktit të Stabilitetit, përkatësisht të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal. Plogështia⁵²¹ që synimet të kthehen në veprime konkrete duket një tjetër pengesë gjatë pëmbushjes së idesë së Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore. Lëshimet kohore do të duhej të kompensoheshin mundësisht shpejt, para se problemet në rajon, që urgjentisht duhet të zgjidhen, t'u „ikin” edhe njëherë kundërmasave.

II. Strategjitë rajonale të BE-së për Ballkanin Perëndimor

Komisioni i Komuniteteve Evropiane në maj 1999, pra ende gjatë konfliktit të armatosur në rajonin e Ballkanit Perëndimor, paraqiti përsëri një strategji për vendet

	Njohuri për ekzistimin e Paktit të Stabilitetit	Besim te Pakti i Stabilitetit	Marrja e informatave rreth Paktit të Stabilitetit	Besim te BE-ja
Kroacia	81,9	15,9	12,8	38,6
Federata Boshnjake - Republika Serbe	79,5	23,1	18,9	43,1
Serbia	76,3	8,3	13,7	16,6
Mali i Zi	85	12,7	10,8	30,8
Kosova	83,2	26,1	11	39,1
Maqedonia	79,5	49,9	38,9	72,1
	93,8	21,5	23,3	35,3

Tabela e adaptuar nga ky studim: International Institute for Democracy and Electoral Assistance (IDEA, <http://www.idea.int>) South Eastern Europe: New Means for Regional Analysis. Krah. http://www.idea.int/europe_cis/balkans/

⁵²¹ Kështu për shembull Calic shkruan: „Mes aprovimit dhe implementimit të një projekti nga ana e Komisionit Evropian kalojnë deri në tetë vjet, që është një problem, i cili frenon edhe shpejtësinë e implementimit në Paktin e Stabilitetit.” J. M. Calic: Welche Zukunft für den Balkan-Stabilitätspakt? [Çfarë të ardhme për Paktin e Stabilitetit për Ballkanin?], në: SWP-Studie. Stiftung Wissenschaft und Politik. Deutsches Institut für Internationale Politik und Sicherheit, Berlin mars 2003, f. 14.

e Ballkanit Perëndimor.⁵²² PSA-ja e iniciuar gjatë Këshillit Evropian të Feiras në qershor 2000 është instrumenti më i rëndësishëm i BE-së për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Gjatë samitit rajonal të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore më 24 nëntor 2000 në Zagreb u konfirmua edhe një herë formalisht PSA-ja, e cila mund të kuptohet si instrument për zbatimin e Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore.⁵²³ Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore dhe PSA-ja mund të emërtohen si „dhomë e pritjes dy pjesëshe për anëtarësim në BE”⁵²⁴. Me këtë qasje të re të BE-së, vendet e Ballkanit Perëndimor mbajnë shpresa të shumta për një integrim të shpejtë në BE. Mirëpo, ESI p.sh. përkujton se BE-ja në kuadër të programit CARDS⁵²⁵ nuk është e obliguar për asgjë.⁵²⁶

Formalisht nënshkruhet një tip i marrëveshjes *sui generis* — një Marrëveshje e Stabilizimit dhe Asociimit (më tutje: MSA) — ndërmjet vendit stabilizues dhe asociues dhe BE-së, përkatësisht shteteve anëtare të BE-së. Përmes PSA-së u përshpejtua dhe u thjeshtësua mbështetja e vendeve të Ballkanit Perëndimor asisoj që programe të ndryshme ndihmëse të BE-së⁵²⁷ zëvendësohen me një program të vetëm

⁵²² E ashtuquajtura qasja rajonale e BE-së nga viti 1997 doli tek pas nënshkrimit të Marrëveshjes Paqësore të Dejtonit përkatësisht të Parisit mes palëve ndërluftuese në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ideja për PSA-në u shfaq tek gjatë rrjedhës së luftës në Kosovë përkatësisht rreth Kosovës. Ky krahasim i iniciativave të BE-së në rajonin e Ballkanit Perëndimor tregon se strategjia e BE-së për rajonin e Ballkanit Perëndimor është një përgjigje ndaj konflikteve.

⁵²³ „PSA-ja së shpejti zvogëlon iniciativat e ndryshme nën ombrellën e Paktit të Stabilitetit.” ICG, After Milosevic. A Practical Agenda for Lasting Balkans Peace [ICG, Pas Milošević-it. Një agjendë praktike për paqe afatgjate në Ballkan], Balkans Report Nr. 108, Bruksel 1 prill 2001, f. 247.

⁵²⁴ M. Abramowitz, H. Hurlburt: Can the EU Hack the Balkans? [A mund ta copëtojë BE-ja Ballkanin?], në: Foreign Affairs, vëll. 81, shtator/tetor 2002, f. 3.

⁵²⁵ Community Assistance for Reconstruction, Development, and Stabilisation. CARDS [Asistenca e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim. CARDS] Rregullorja (KE) nr. 2666/2000, dt. 5 dhjetor 2000, GZ L 306, f. 1.

⁵²⁶ „Programi CARDS nuk përmban kurrfarë obligimi, as implicit e as eksplicit, për ta përkrahur rajonin gjatë afrimit ekonomik me Bashkimin e zgjeruar Evropian. Për dallim prej kësaj, BE-ja është obliguar për përkrahje në rritje e sipër të shteteve të reja anëtare si dhe të Rumanisë, Bullgarisë dhe Turqisë.” ESI, Der westliche Balkan im Jahr 2004. Unterstützung, Kohäsion und die neuen Grenzen Europas. Ein Aufruf zur Reform der Politik der Europäischen Union [Ballkani Perëndimor në vitin 2004. Përkrahja, kohezioni dhe kufijtë e rinj të Evropës. Një thirrje për reformë të politikës së Bashkimit Evropian], Berlin etj. 3 nëntor 2002, f. 17 f.

⁵²⁷ E. Busek kërkoi nga ana e tij qysh më 2002 zhvillimin e një strategjie të re: „Pas hapit të ardhshëm të zgjerimit të BE-së do të jetë e nevojshme që të zhvillohet një strategjie e re për rajonin. Vështirësi mund të dallohen tashmë aty që ka programe të ndryshme të BE-së për rajonin: Për vendet kandidate PHARE/ISPA, për shtetet e „Ballkanit Perëndimor” programi CARDS dhe për Moldavinë programi TACIS, [...]” Erhard Busek: Zukunft des Stabilitätspaktes. Das Engagement der Europäer in Südosteuropa [Ardhmëria e Paktit të Stabilitetit. Angazhimi i evropianëve në Evropën Juglindore], në: Internationale Politik – Europa Archiv 5/2002, f. 26.

të BE-së⁵²⁸, programin CARDS me 775 milionë euro në vit prej vitit 2000 deri më 2006.⁵²⁹

PSA-ja paraqet thelbin e politikës së BE-së për Ballkanin Perëndimor. Nënshkrimi i një MSA-je krijon marrëdhënie formale kontraktore ndërmjet vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe të BE-së. Një MSA përbëhet nga këto elemente: masa tregtare autonome, ndihma ekonomike dhe financiare, mes tjerash në kuadër të programit PHARE dhe OBNOVA (rindërtimi), si dhe ndihma buxhetore dhe ajo për bilancin e pagesave.⁵³⁰

PSA-ja përmban edhe obligime politike, krijimin e zonave të tregtisë së lirë dhe, sidomos në fushën ekonomike, harmonizimin e legjislacionit me BE-në. Më tutje,

⁵²⁸ Nga viti 2007 Instrumenti për Ndihmën Para-anëtarësimit (më tutje: IPA) i zëvendëson instrumentet e përafrit PHARE, ISPA (Instrumenti për Politikë Strukturore të Para-anëtarësimit) dhe SAPARD (Programi Special i Anëtarësimit për Zhvillim Bujqësor dhe Rural), instrumentin e financimit CARDS dhe mbështetjen për Turqinë me një instrument të vetëm të përafrit. Ndihma e përafrit në kuadër të IPA-s me këtë shtrihet si mbi kandidatët për aderim ashtu edhe mbi kandidatët potencialë të aderimit në një anëtarësim në BE.

⁵²⁹ Në krahasim me këtë, përkrahja e tërësishme nga ana e BE-së për Ballkanin Perëndimor në periudhën kohore 1991 – 2000 arrinte mesatarisht 550 milionë euro në vit. Në qoftë se krahasohet përkrahja e BE-së për rajone të tjera me përkrahjen për rajonin e Ballkanit Perëndimor, atëherë bëhet e qartë se Ballkani Perëndimor paraqet një pikë kryesore të programeve mbështetëse të BE-së. Kështu p.sh. më 2003 projektet për Rusinë u paguan me 94 milionë euro, për Ukrainën me 48 milionë euro dhe për Moldavinë me 20 milionë euro. Krah. I. Kempe, W van Meurs: Neue EU-Nachbarn. Strategien gegenüber Südost- und Osteuropa jenseits der Erweiterung [Fqinj të e rinj të BE-së. Strategjitë përballë Evropës Juglindore dhe Lindore përtej zgjerimit], në: Internationale Politik Europa - Archiv 5/2002, f. 31 dhe 33. Mirëpo, ndihma e BE-së për rajonin e Ballkanit Perëndimor po zvogëlohet nga viti në vit. Shuma e shpenzuar për këtë rajon si dhe plani deri në vitin 2006 duken si vijon: 956 milionë euro (2000), 766 (2002), 600 (2004) 500 (2006). Për vitet pas 2006 nuk pritet rritje e këtyre shumave. Krah. European Stability Initiative (ESI), The Road to Thessaloniki: Cohesion and the Western Balkans [Iniciativa Evropiane e Stabilitetit (ESI), Rruga deri në Selanik: Kohezioni dhe Ballkani Perëndimor], Berlin 12 mars 2003 (www.esiweb.org).

⁵³⁰ Fushat e mbështetura në kuadër të programit CARDS, me objektivin kryesor të përkrahjes së një MSA-je për këto vende, shpjegohen nga Komisioni i Komuniteteve Evropiane si vijon:

- „rindërtimi, ndihma për refugjatët dhe për personat e zhvendosur dhe stabilizimi i rajonit.
- zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe reforma të orientuara në ekonominë e tregut;
- krijimi i një kornize institucionale dhe legjislative për të mbështetur demokracinë, sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut dhe të pakicave, pajtimin dhe konsolidimin e shoqërisë civile, pavarësinë e medieve dhe forcimin e sundimit të ligjit dhe të masave për të luftuar krimin e organizuar.
- zhvillimi shoqëror;
- nxitja e bashkëpunimit rajonal, transnacional, ndërkufitar dhe ndërrajonal⁷

European Commission. Federal Republic of Yugoslavia. Country Strategy Paper 2002 – 2006 [Komisioni Evropian. Republika Federale e Jugosllavisë. Letër strategjia e vendit 2002-2006], f. 6.

vendet nënshkruese, përmes nënshkrimit të MSA-së e marrin statusin e një „kandidati potencial për anëtarësim në BE”.⁵³¹

Një MSA është menduar deri dikur për vendet e Ballkanit Perëndimor si zëvendësim i një marrëveshjeje evropiane. Marrëveshjet evropiane, të cilat ishin nënshkruar më 2004 me vendet që sapo kishin aderuar, përmes raporteve vjetore të progresit dhe planeve të aksionit të Komisionit të Komuniteteve Evropiane shprehin ngjashmëri formale dhe përmbajtësore me MSA-në. Edhe pse një MSA kushtëzohet me kriteret më të ulëta, megjithatë secili vend i veçantë duhet të përmbushë standarde minimale para se të nisen bisedimet për asociim dhe anëtarësim.⁵³² Mirëpo, mes marrëveshjeve evropiane dhe MSA-ve ka edhe dallime të qarta. Kështu p.sh. të një MSA nxitja e zhvillimit dhe prosperitetit ekonomik është vetëm një synim i dëshiruar.⁵³³ Bisedimet për secilin prej 31 kapitujve të veçantë të negociatave, për dallim nga zgjerimi lindor i BE-së, duhet të hapen vetëm atëherë kur zbatimi i rezultateve të negociatave të duket realist.⁵³⁴

Edhe në qoftë se PSA-ja për rajonin e Ballkanit Perëndimor paraqet ndoshta një hap të rëndësishëm në drejtim të anëtarësimit në BE, gjendja faktike në këtë rajon nuk guxon të paraqitet e zbuluar. Përparimet në proceset e integritit në BE nuk lënë të arrihen vetëm me një vullnet të fortë dhe me përpjekje të mëdha të vendeve përkatëse, të cilat megjithatë jo gjithmonë punojnë qartë në drejtimin që e përfytyron BE-ja.⁵³⁵ Vendeve të Ballkanit Perëndimor do të duhej t'u bëhet e qartë se përmes

⁵³¹ Kështu për shembull në raportin e tretë vjetor të Komisionit të Komuniteteve Evropiane rreth PSA-së mund të lexohet si vijon: „Si kandidatë potencialë të anëtarësimit vendet e Ballkanit Perëndimor kanë gjasat për një anëtarësim të ardhshëm në Bashkimin Evropian, një objektiv të cilin Këshilli Evropian i Feiras në qershor 2000 e mbështeste dhe të cilin Këshilli Evropian i Selanikut në qershor 2003 e konfirmonte. Këtë premtim BE-ja do ta mbajë, kur secili vend t'i përmbushë kriteret e nevojshme.” Bericht der Kommission der Europäischen Gemeinschaften. Der Stabilisierungs- und Assoziierungsprozess für Südosteuropa. Dritter Jahresbericht, (KOM (2004) 202 endgültig), [Raport i Komisionit të Komuniteteve Evropiane. Procesi i stabilizimit dhe asociimit për Evropën Juglindore. Raporti i tretë vjetor, (KOM (2004) 202 final)], Bruksel, më 30.03.2004, f. 5. Këtu shumë qartë është fjala për mbajtjen e një premtimi, në rast të përmbushjes së kriterëve, e jo për shembull për një obligim për përkrahje nga ana e BE-së.

⁵³² Krahe. Commission of the European Communities, The Stabilisation and Association Process for Countries of South-Eastern Europe, 8 nëntor 1999.

⁵³³ Për dallimet mes një MSA-je dhe një marrëveshjeje evropiane krahe. D. Phinnemore: Stabilisation and Association Agreements: European Agreements for the Western Balkans?, në: European Foreign Affairs Review 8/2003, f. 81 vv.

⁵³⁴ Krahe. A. Wittkowsky: Der Stabilitätspakt für Südosteuropa und die „führende Rolle” der Europäischen Union [Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore dhe „roli udhëheqës” i Bashkimit Evropian], në: Aus Politik und Zeitgeschichte. Beilage zur Wochenzeitung Das Parlament, 14 korrik 2000, f. 8.

⁵³⁵ Kështu për shembull eksperti për Evropën Juglindore J. Reuter konstaton rreth Kosovës: „I përket aksiomave të Bashkimit Evropian, që shqiptarët e Kosovës kanë një interesim të fortë për integritet në BE dhe do të sillen në mënyrë përkatëse. Realiteti është ndryshe. Prioriteti i parë politik për liderët e shqiptarëve është pavarësia e Kosovës. Për pavarësi nuk ka surrogat, në qoftë se nuk do të arrihet ky objektiv politik, pastaj kjo ka si pasojë një konglomerat të tërë

një MSA-je BE-ja nuk i hyn një obligimi për t'u ndihmuar vendeve të Ballkanit Perëndimor që edhe vërtet ta arrijnë anëtarësimin në BE.⁵³⁶

Kur bëhet fjalë për PSA-në, disa autorë e theksojnë nevojën e integritit të vendeve të Ballkanit në Zonën Ekonomike Evropiane.⁵³⁷ Autorë të tjerë e formulojnë këtë në mënyrë edhe më eksplicite: „Vendeve të Ballkanit u duhet diçka tjetër nga një paradhomë e BE-së”⁵³⁸, ata flasin për nevojën e një „grupi të modernizimit”⁵³⁹ me funksione koordinuese si alternativë ndaj PSA-së.

Politologu Heinz-Jürgen AXT konstaton se politika e tanishme strukturore e BE-së në lidhje me rajonin e Ballkanit Perëndimor në masë të madhe ka nevojë për reforma dhe përmend disa argumente, të cilat flasin kundër një vazhdimi të kësaj politike strukturore si p.sh.: përqendrim i munguar i donacioneve, lëmsh donacionesh, huqje e objektivave, përzierje e kompetencave, subvencionim i përhershëm.⁵⁴⁰

Edhe pse MSA-të mund t'u përshtaten kërkesave specifike sipas vendeve, të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor ende nuk e arrijnë një marrëveshje të tillë me BE-në. Kështu vendet e Ballkanit Perëndimor në marrëdhëniet e tyre kontraktore me BE-në gjenden në stadi të ndryshme. Në vijim do të pasqyrohet procesi i integritit në BE i Kosovës dhe perceptimi kosovar i këtij procesi.

B. Procesi i integritit në BE në Kosovë

Pozita e Kosovës nën administrim ndërkombëtar paraqet një rast të posaçëm edhe sa i përket procesit të integritit në BE. Në Kosovë përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare, dhe me këtë edhe ata të institucioneve të BE-së, posedojnë pushtet politik, i cili nuk është i legjitimuar në mënyrë demokratike. Ky fenomen është tipik për një vend nën administrim ndërkombëtar. Se a perceptohen „pushtetmbajtësit

të pakënaqësisë, dëshpërimit, zemërimit dhe indinjatës.” Jens Reuter: Nationalistische Unruhen in Kosovo – Politik der internationalen Gemeinschaft gescheitert? [Trazirat nacionaliste në Kosovë – Politika e bashkësisë ndërkombëtare e dështuar?], në: Südosteuropa 10-12/2003, f. 514.

⁵³⁶ Krahe. D. Phinnemore: Stabilisation and Association Agreements: European Agreements for the Western Balkans?, në: European Foreign Affairs Review 8/2003, f. 100.

⁵³⁷ Krahe. Paul Welfnes: Stabilizing and Integrating the Balkans – Economic Analysis of the Stability Pact, EU Reform and International Organisations, Berlin 2001.

⁵³⁸ J. M. van Brabant: Southeastern Europe, Transitions, and the EU - Is Ever-widening Desirable?, në: Economic Policy in Transitional Economies MOCT-MOST, 11/2001, f. 319.

⁵³⁹ Po aty, f. 321.

⁵⁴⁰ Krahe. Heinz-Jürgen Axt: Vom Wiederaufbauhelfer zum Modernisierungsagenten. Die EU auf dem Balkan [Nga ndihmësi në rindërtim deri te agjenti i modernizimit. BE-ja në Ballkan], në: Aus Politik und Zeitgeschichte. Beilage zur Wochenzeitung Das Parlament, 10-11/3 mars 2003, f. 25.

ndërkombëtarë' në radhë të parë si përfaqësues të interesave kosovare ose të interesave të shteteve të tyre kombëtare, përkatësisht të organizatave ndërkombëtare, kjo nuk është gjithmonë e qartë për t'iu përgjigjur. Sidomos në rast të dallimeve të interesave, pikëpamjet e palës kosovare mbesin ose të nënpërfaqësuar ose madje edhe aspak të përfaqësuar.

BE-ja është pjesë përbërëse e pranisë ndërkombëtare në Kosovë. Në këtë rrugë BE-ja ka marrë përsipër tërthorazi përgjegjësi jashtë kufijve të vet dhe si aktor në procesin e zhvillimit ekonomik, të etablimit të paqes dhe të sigurimit të paqes ajo gjithnjë e më shumë po fiton rëndësi. Mirëpo, fushat në të cilat BE-ja ka marrë përsipër përgjegjësi në Kosovë, janë të prekura nga vështirësi të shumta. Edhe pse Kosova është e pasur me pasuri nëntokësore⁵⁴¹, ajo ka edhe popullsinë më të varfër dhe ekonominë më së paku të zhvilluar në Evropë.⁵⁴² Vetëm nga përfundimi i luftës u ngrit vazhdimisht standardi jetësor në Kosovë falë edhe ndihmës masive ekonomike nga ana e shteteve industriale.

Në vitet e para të administratës së UNMIK-ut, „për shkak të marrëdhënieve të paqarta pronësore”⁵⁴³ ndërmarrjet në pronë publike dhe shoqërore vetëm sa u „komercializuan”. Ky proces, megjithatë, nuk arriti asnjë investim që urgjentisht i nevojitet ekonomisë kosovare. Vetëm në vitin 2002 u iniciua një proces privatizimi së pari në fushën juridike⁵⁴⁴. Për ta shmangur çështjen politike të marrëdhënieve pronësore, u krijua një sistem i administrimit në mirëbesim. Oda Ekonomike e Kosovës⁵⁴⁵ dyshon se sistemi i administrimit në mirëbesim në Kosovë do të kontribuojë për rritje ekonomike, sepse deri në sqarimin e çështjeve pronësore — pra deri sa të definohet çështja e statusit — mjetet financiare të procesit të privatizimit nuk mund të rrjedhin prapë në ekonomi.

Sqarimi përfundimtar i çështjes së sovranitetit midis Serbisë dhe Kosovës luan një rol të rëndësishëm për proceset e integritimit në BE të këtij rajoni. Si në vendet e

⁵⁴¹ Si pasuri më të rëndësishme nëntokësore në Kosovë në statistikën e UNMIK-ut përmenden: lignit 18,3 mrd. t, prej tyre 12 mrd. t rezerva, boksit 6 mrd. t, prej tyre 1,7 mrd. t rezerva, si dhe 21,6 mrd. t plumb dhe zink. Më tutje, vlerësohet ekzistimi i 14 mil. t nikel, 4,5 mil. t magnezit, prej tyre 1,7 mil. t rezerva. Duke u bazuar në Fact Sheet Kosovo, maj 2003 (mund të gjendet në adresën: http://www.unmikonline.org/eu/index_fs.pdf).

⁵⁴² Sidomos politika eksploative mes viteve 1989 dhe 1999 si dhe shkatërrimi i qëllimshëm i bazës jetësore të njerëzve gjatë luftës më 1998 – 1999 (për shembull gjatë luftës u dëmtuan apo tërësisht shkatërruan 120.000 prej 250.000 shtëpive njëfamiljare) e ulën edhe më shumë standardin jetësor të kosovarëve.

⁵⁴³ Ngaqë problemi prapësepapë qëndron në lidhje të ngushtë me statusin përfundimtar të Kosovës, kjo është e natyrës së pastër politike.

⁵⁴⁴ Për shembull përmes shpalljes së Rregullores nr. 2002/12 të UNMIK-ut nga 13 qershori 2002 mbi Themelimin e Agjencisë së Mirëbesimit të Kosovës; Rregullores nr. 2002/13 të UNMIK-ut nga 13 qershori 2002 mbi Themelimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë e Mirëbesimit të Kosovës si dhe Rregulloren nr. 2003/13 të UNMIK-ut nga 9 maji 2003 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore.

⁵⁴⁵ <http://www.odaekonomike.org>

Ballkanit Perëndimor ashtu edhe në BE si objektiv proklamohet integrimi në BE i vendeve të Ballkanit Perëndimor. Mirëpo, BE-së i mungon një strategji e qartë dhe mbërthimi i strategjisë së saj në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Për procese të suksesshme të integritit në BE të rajonit të Ballkanit Perëndimor do të duhej që BE-ja së pari të zhvillonte një politikë integruese më të targetuar, më të qartë dhe më konsistente sesa deri më tani dhe së dyti këtë politikë më energjike edhe vetë ta përhapë me sukses në rajon.

I. Integrimi i Kosovës në BE mes utopisë dhe realitetit

Vlerat e shtetit ligjor liberal mbeten edhe më tej pikat e dobëta të shoqërive ballkanoperëndimore, siç e tregon më së miri shembulli i Kosovës. Juristi kosovar Enver HASANI thekson në një intervistë se në Kosovë nevojitet më shumë punë se gjetiu për t'i bërë realitet vlerat evropiane. Ai sheh pengesë që BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës e perceptojnë Kosovën si problem të sigurisë. Për Evropën 'çështja e Kosovës' nuk do të guxonte të ishte në radhë të parë çështje e sigurisë. Kjo çështje për Evropën do të duhej të ishte para së gjithash çështje e vlerave.⁵⁴⁶ Në mënyrë të ngjashme edhe koordinatori strategjik i BE-së në Shtyllën IV të administratës së UNMIK-ut, Lars TUMMERS, mungesën e vlerave demokratike krahas vështirësive ekonomike e shikon si një dobësi të madhe të Kosovës në rrugën drejt BE-së. Vetëm popullsia e re, e cila beson në një ardhmëri në BE, mund të ofrojë për Kosovën një rrugëdalje nga kjo situatë.⁵⁴⁷

Për drejtoreshën e zyrës së STM-së⁵⁴⁸ për Procesin e Stabilizimit dhe të Asociimit pranë *Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes* (më tutje: IPVQ) Venera HAJRULLAHU, integrimi në BE në rajonin e Ballkanit Perëndimor nuk paraqet asnjë risi për BE-në. Modeli që përdoret në këtë rajon është përsëritje e

⁵⁴⁶ Intervistë me Enver Hasani, Prishtinë, më 15 qershor 2004. E. Hasani është profesor për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe aktualisht rektor i Universitetit të Prishtinës.

⁵⁴⁷ Intervistë me Lars Tummers, Prishtinë, më 10 gusht 2004. Diplomati holandez L. Tummers është duke vepruar në Kosovë që nga viti 1999, fillimisht si këshilltar politik i shefit të Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe i Komandës së KFOR-it, pastaj si Sekretar i Përhershëm dhe këshilltar pranë Zyrës së Kryeministrit kosovar Bajram Rexhepi. Më 2004 veproi si emisar i BE-së pranë Shtyllës IV të administratës së UNMIK-ut si koordinatori i strategjisë.

⁵⁴⁸ „Stabilisation Tracking Mechanism for Kosova”. Ky mekanizëm nga BE-ja definohet si vijon: „Mekanizmi Përcjellës i PSA-së (më tutje: STM) për Kosovën është një grup i përbashkët punues teknik i UNMIK-ut, Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) dhe i Komisionit Evropian, në kuadër të Procesit të Stabilizimit dhe të Asociimit të BE-së. Qëllimi i tij është të mbështesë Kosovën në reformat e saj strukturore në përputhje me BE-në përmes këshillave dhe udhëzimeve të politikave. Kjo do të ndihmojë për të mbajtur Kosovën në mënyrë të vendosur në rrugën e duhur në progresin e saj drejt Evropës.” http://europa-eu-un.org/articles/lt/article_3818_lt.htm

modeleve integruese deri më tani të zbatuara me sukses dhe e përvojave nga ana e BE-së.⁵⁴⁹

Kur është fjala për përafrimin në BE dhe për integrimin e Kosovës në BE, nga ana kosovare këto procese vlerësohen kryesisht si një objektiv i rëndësishëm politik i BE-së dhe si një politikë e studiuar dhe e shoshitur shumë mirë. V. HAJRULLAHU është e mendimit se integrimin e Kosovës dhe të tërë rajonit BE-ja e ka përcaktuar si një objektiv të rëndësishëm politik. BE-ja e dallon se nuk ka alternativë tjetër përpos integritit të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Vetë BE-ja u themelua si projekt për shmangien e konflikteve. Andaj BE-ja dëshiron ta integrojë Kosovën por edhe tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Edhe pse BE-ja e ka para syve përafrimin dhe integrimin e Kosovës dhe të tërë rajonit si objektiv politik, megjithatë asaj i mungojnë instrumentet politike, thotë analisti politik kosovar Lulzim PEÇI.⁵⁵⁰

BE-ja është duke u përpjekur që të mos lërë të krijohet ndonjë „vrimë e zezë” në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ngaqë MSA-ja është paraparë vetëm për shtete sovraane, tani për tani me Kosovën nuk mund as të nënshkruhet një MSA e as të zhvillohen bisedime zyrtare rreth kësaj. Mirëpo, raporti i tretë vjetor i Komisionit të Komuniteteve Evropiane për PSA-në nga 30 marsi 2004 thekson: „BE-ja duhet të sigurojë që Kosova të jetë e mbërthyer fort në PSA-në.”⁵⁵¹ Përjashtimi i Kosovës nga masat e stabilizimit dhe të asociimit të BE-së deri në zgjidhjen e çështjes së statusit do të rrezikonte stabilitetin e tërë rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Edhe pse statusi ende i papërcaktuar sipas të drejtës ndërkombëtare nuk e vështirëson zbatimin e PSA-së në rastin e Kosovës, „[Kosova] përfiton nga të gjitha elementet e Procesit të Stabilizimit dhe të Asociimit me përjashtim të mundësisë për të filluar marrëdhënie kontraktore me BE-në.”⁵⁵² Kështu Kosova formalisht nuk involvohet në PSA, edhe pse ajo shijon përparësitë e saj.

BE-ja krijoi një zgjidhje të posaçme për Kosovën, që të mos jetë edhe më tepër peng i çështjes ende të pazgjidhur të statusit të Kosovës. Një i ashtuquajtur mekanizëm përcjellës i PSA-së (STM, Stabilisation Tracking Mechanism) u krijua për Kosovën,⁵⁵³ i cili në raportin e tretë vjetor të Komisionit të Komuniteteve Evropiane për PSA-në përshkruhet si vijon:

⁵⁴⁹ Intervistë me Venera Hajrullahu, Prishtinë, më 24 qershor 2004.

⁵⁵⁰ Intervistë me Lulzim Peçi, Prishtinë, më 23 qershor 2004. L. Peçi është drejtor i Institutit Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED).

⁵⁵¹ Bericht der Kommission der Europäischen Gemeinschaften. Der Stabilisierungs- und Assoziierungsprozess für Südosteuropa. Dritter Jahresbericht, (KOM (2004) 202 endgültig), [Raport i Komisionit të Komuniteteve Evropiane. Procesi i stabilizimit dhe asociimit për Evropën Juglindore. Raporti i tretë vjetor, (KOM (2004) 202 final)], Bruksel, më 30.03.2004, f. 30.

⁵⁵² Po aty, f. 8.

⁵⁵³ Për informata më të hollësishme dhe më aktuale rreth aktiviteteve në kuadër të këtij procesi krahu. <http://www.euinkosovo.org/>. Në një „Vendim të Parlamentit Evropian rreth Procesit të Stabilizimit dhe Asociimit për Evropën Juglindore” nga 20 nëntori 2003 përshëndetet fillimi i „SAP Tracking Mechanism”, mirëpo Parlamenti Evropian beson me të drejtë se pa

„Për t’u siguruar që reformat në Kosovë janë në përputhje me *acquis communautaire*, Komisioni me përfshirjen e UNMIK-ut dhe të [...] IPVQ ka vendosur një mekanizëm përcjellës të PSA-së (STM), i cili ka funksione të rëndësishme këshilluese dhe njëkohësisht mat përparimet e arritura.”⁵⁵⁴

Fakti që Kosova përmes mekanizmit kontrollues të PSA-së është e involvuar në procesin e integritimit në BE, tek kosovarët krijojnë më shumë shpresa dhe besim në BE-në. Për zëvendësdrejtoreshën e Zyrës Evropiane pranë administratës së UNMIK-ut, Michaela FRIBERG, ky fleksibilitet tregon fortësinë e Komisionit të Komuniteteve Evropiane: Ngaqë PSA-ja është e paraparë vetëm për shtetet e pavarura, Komisioni i Komuniteteve Evropiane krijoi për Kosovën procesin e STM-së si rrugëdalje juridike.⁵⁵⁵ Komisioni i Komuniteteve Evropiane dalloi po ashtu nevojën për ta vazhduar pa zvogëlime ndihmën për Kosovën dhe kështu Kosova u përfshi në „Programet e Komunitetit”.⁵⁵⁶

Fushat politikisht relevante të PSA-së koordinohen kryesisht nga zyrtarët e BE-së në kuadër të Shtyllës së BE-së brenda administratës së UNMIK-ut. Kjo do të thotë që kur mbahen takime rreth PSA-së në Kosovë, shpesh në të dyja anët e tryezës së negociatave ulen zyrtarë të BE-së. Profesori për Marrëdhënie Ndërkombëtare David CHANDLER fenomenet e tilla i emëron si „partneritet i pabarabartë” dhe lidhur me protektoratet ndërkombëtare në rajonin e Ballkanit Perëndimor konstaton:

„[ata] të tregojnë me qartësi më të madhe problemet e qeverisjes dhe të shoqërisë civile në kontekstin e një ‘partneriteti’ të pabarabartë. Bosnja dhe Kosova të nxjerrin në pah problemin kryesor me ‘partneritetin’ e pabarabartë: mungesën e përgjegjësisë për hartimin e politikave.”⁵⁵⁷

përcaktimin e statusit përfundimtar të Kosovës nuk do të mund të zgjidhen në mënyrë efektive probleme të shumta të nënrenditura.

⁵⁵⁴ Bericht der Kommission der Europäischen Gemeinschaften. Der Stabilisierungs- und Assoziierungsprozess für Südosteuropa. Dritter Jahresbericht, (KOM (2004) 202 endgültig), [Raport i Komisionit të Komuniteteve Evropiane. Procesi i stabilizimit dhe asociimit për Evropën Juglindore. Raporti i tretë vjetor, (KOM (2004) 202 final)], Bruksel, më 30.03.2004, f. 8.

⁵⁵⁵ Në njëren anë BE-ja nuk dëshiron ta përjashtojë Kosovën nga PSA-ja, gjë që hasë në miratim të fortë te pala kosovare, kurse në anën tjetër BE-ja orvatet që të mos krijojë prejudikime eventuale të çështjes së statusit të Kosovës.

⁵⁵⁶ Intervistë me Michaela Friberg, Prishtinë, më 3 gusht 2004. Politologia suedeze M. Friberg është duke vepruar në rajonin e Ballkanit Perëndimor që nga viti 1999. Fillimisht ajo punoi për OJQ-të në fushën e të drejtave të njeriut, pastaj për OSBE-në. Aktualisht ajo ushtron funksionin e zëvendësdrejtoreshës së Zyrës Evropiane (Shtylla IV) pranë administratës së UNMIK-ut.

⁵⁵⁷ David Chandler: The European Union and Governance in the Balkans: A Unequal Partnership, në: European Balkan Observer, Belgrade Centre for European Integration and Vienna Institute for International Economic Studies, vëll. 1, Nr. 2, nëntor 2003, f. 8.

Në fund të vitit 2002, BE-ja i rekomandoi IPVQ-së t'i ndërmarrë masat e nevojshme për t'i përmbushur kushtet paraprake për një MSA. Si pasojë e kësaj, pranë qeverisë kosovare u ngrit një zyrë që merret vetëm me këto punë. Kjo zyrë më 2006 u shndërrua në një Agjenci për Integritet Evropian.

Gjatë bisedimeve midis institucioneve kosovare dhe atyre të BE-së shmangen mundësisht çështjet politike, sidomos ato që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me të ardhmen politike të Kosovës. Qëllimisht bëhet përpjekja që pika kryesore të vendoset në ato fusha që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me PSA-në. Për shembull, në kuadër të STM-së katër herë në vit mbahet një takim në nivelin më të lartë⁵⁵⁸, gjatë të cilit preken vetëm tema të caktuara të „natyrës teknike” në fushën e temave si bujqësia ose energjia. Takimet e STM-së kanë një karakter diskutimi. Komisioni i Komuniteteve Evropiane paraqet sugjerime konkrete dhe propozime për përmirësime. Që procesi i STM-së është një proces teknik dhe si i tillë përpiqet të distancohet nga politika ditore, këtë e konfirmon edhe M. FRIBERG. Për t'u habitur është që në përgjithësi nuk ka asnjë kundërshtim: të gjithë e pranojnë natyrën teknike të takimit. „Mirëpo ne jemi pjesë e një procesi politik dhe çështjet teknike në këtë proces gjithsesi vlerësohen politikisht.”⁵⁵⁹

Nga pala kosovare atmosfera e diskutimeve me përfaqësuesit e BE-së cilësohet parimisht si partneritare dhe konstruktive. Rendi i ditës në përgjithësi përcaktohet nga BE-ja, kurse institucionet kosovare kanë të shumtën vetëm të drejtën e fjalës. Kohët e fundit, megjithatë, merren parasysh çështjet e institucioneve kosovare gjithnjë e më shpesh gjatë përcaktimit të rendit të ditës për takimet e STM-së.⁵⁶⁰

Edhe pse takimet midis përfaqësuesve kosovarë dhe atyre të BE-së cilësohen si „partneritare”, pjesëmarrësit kosovarë kritikojnë kryesisht mungesën e *feedback*-ut, të informatave rreth procesit të integritetive në BE dhe të udhëzimeve konkrete nga ana e BE-së. „Edhe kur preken çështje konkrete, nga përfaqësuesit e BE-së nuk dëgjohen asnjëherë propozime praktike. Temat politike abstrakte dominojnë rendin e ditës, i cili përcaktohet nga përfaqësuesit e BE-së. Gjatë bisedave nuk vjen gati aspak te ballafaqimet, por rezultatet konkrete shpesh nuk përputhen me atë çfarë është vendosur në mbledhje.”⁵⁶¹

Oliver IVANOVIĆ, njëri prej përfaqësuesve udhëheqës të bashkësisë serbe në Kosovë, konfirmon se ai viteve të fundit përfaqësohet një herë në muaj kishte

⁵⁵⁸ Në këtë takim të rangut të lartë marrin pjesë për shembull kryeministri, të gjithë ministrat kosovarë, PSSP-ja, udhëheqësit e delegacionit nga Komisioni i Komuniteteve Evropiane etj. (gjithsej afro njëqind veta).

⁵⁵⁹ Intervistë me Michaela Friberg, Prishtinë, më 3 gusht 2004.

⁵⁶⁰ Intervistë me Venera Hajrullahu, Prishtinë, më 24 qershor 2004. Një mendim të ngjashëm përfaqëson edhe M. Friberg. Intervistë me Michaela Friberg, Prishtinë, më 3 gusht 2004.

⁵⁶¹ Intervistë me Nenad Radosavljević, Prishtinë, më 15 prill 2004 (e zhvilluar nga Tatjana Matić). N. Radosavljević është që nga korriku 2002 „këshilltar i lartë i shefit të UNMIK-ut për kthim” dhe drejtor i stacionit të radios dhe televizionit MIR në komunën kosovare veriore të Leposaviqit.

kontakte me përfaqësuesit e Komisionit të Komuniteteve Evropiane dhe të Parlamentit Evropian si në Kosovë ashtu edhe në Bruksel. Sikurse bashkëbiseduesit e tjerë kosovarë edhe O. IVANOVIĆ konfirmon se rendi i ditës përcaktohet nga ana e BE-së dhe se ai asnjëherë nuk ka marrë një *feed back* nga këto kontakte. Edhe pse atmosfera e bisedimeve me përfaqësuesit e BE-së është „partneritare”, për shkak të statusit aktual të Kosovës nuk është e mundshme që të sendërtohen kontaktet partneritare me BE-në.⁵⁶²

Edhe nëse kontaktet e rregullta formale dhe joformale midis përfaqësuesve kosovarë dhe të BE-së në vitet e fundit kanë mundur të etablohen gjithnjë e më shumë, këto kontakte shpesh nuk ishin optimale: partnerët vendorë të vendimet kanë në të shumtën të drejtën e fjalës dhe nuk posedojnë informatat e nevojshme, sepse nga BE-ja nuk marrin njoftime. Kjo zvogëlon shanset e një identifikimi faktik të aktorëve lokalë me idenë dhe me politikat e BE-së dhe kështu edhe me shanset për zbatimin e reformave të nevojshme për procesin e integrimit në BE.

1. Perceptimi kosovar i ekspertizës së BE-së

Lidhur me ekspertizën e BE-së në Kosovë ka mendime të ndara. Në sytë e shumicës së kosovarëve BE-ja ka një njohuri të detajuar për gjendjen në Kosovë. Mirëpo, si dobësi e madhe e BE-së shpesh përmendet se qëndrimet dhe mendimet e përfaqësuesve kosovarë ose injorohen plotësisht ose merren parasysh në përmasa vetëm të kufizuara, sepse BE-ja informatat e saj i merr para së gjithash nga administrata e UNMIK-ut dhe jo nga kosovarët. Në këtë mënyrë, nga pala kosovare gjithnjë theksohet nevoja që edhe këndvështrimet e kosovarëve duhet të gjejnë më shumë konsideratë nga ana e BE-së.⁵⁶³

Kur është fjala për Kosovën, BE-ja është shumë e informuar dhe profesionale, mendon edhe O. IVANOVIĆ. Vetëm mënyrën e qasjes e cilëson problematike dhe në këtë mënyrë edhe shpesh jo shumë të suksesshme, sepse nuk merren parasysh dallimet e mentaliteteve.⁵⁶⁴

Në vitet e fundit ka rënë dukshëm numri i ekspertëve në shtyllën e BE-së pranë administratës së UNMIK-ut. Shumë prej tyre kanë dështuar si diplomatë në vendet e tyre të prejardhjes, mendon L. PEĆI. Sipas mendimit të tij, BE-ja posedon njohuri të madhe për Evropën Juglindore, mirëpo jo edhe për recetat e suksesit për integrimin në BE. Rregullat e BE-së dhe çështja e statusit të pazgjidhur janë në kundërtënie. Për një integrim të Kosovës në BE, kjo e fundit duhet t'i ndryshojë kriteret e

⁵⁶² Intervistë me Oliver Ivanović, Mitrovicë, më 9 prill 2004 (e zhvilluar nga Tatjana Matić). I. Ivanović është njëri prej përfaqësuesve udhëheqës të bashkësisë serbe në Kosovë dhe ushtroi mes tjerash këto funksione: deputet në Parlamentin kosovar, anëtar i „Qendrës Koordinuese për Kosovë” si dhe nënkryetar i partisë politike „Alternativa Demokratike”.

⁵⁶³ Intervistë me Venera Hajrullahu, Prishtinë, më 24 qershor 2004.

⁵⁶⁴ Intervistë me Oliver Ivanović, Mitrovicë, më 9 prill 2004.

vlefshme aktualisht, nëse nuk zgjidhet çështja e statusit të Kosovës. Në situatën e tanishme Kosova nuk mund të lidhë MSA me BE-në „dhe njëkohësisht çdokush e di se tani për tani nuk ka ndonjë alternativë tjetër ndaj kësaj marrëveshjeje, në qoftë se një vend ballkanoperëndimor synon të hyjë në BE.”⁵⁶⁵

Edhe E. HASANI kritikon qasjen e BE-së: „BE-ja ka një përfytyrim të qartë se pse dëshiron ta integrojë Kosovën. Mirëpo, ajo ka zgjedhur një qasje të gabuar, sepse Kosova në vijë të parë shikohet si një rast i sigurisë. ‚Çështja e Kosovës’ nuk mund të zgjidhet përmes pranisë ushtarake dhe përmes izolimit nga bota e jashtme, siç është rasti që nga viti 1999. Kosova duhet të dërgohet në Evropë, dhe jo Evropa në Kosovë.”⁵⁶⁶

Në përgjithësi mund të konstatohet se shumë vëzhgues kritikojnë burokracinë e BE-së që nuk e merr seriozisht ‚çështjen e Kosovës’ dhe që angazhohet vetëm minimalisht me financa dhe me staf në vend.

2. Strategjitë dhe politikat e BE-së në Kosovë

Kosova shumëherë perceptohet si rajon kyç për garantimin e paqes në Ballkan dhe përmes kësaj edhe për proceset e integritimit në BE të kësaj hapësire. Kështu p.sh. edhe aktivisti kosovar për të drejtat e njeriut, Adem DEMAÇI, është i mendimit se pa zgjidhjen e ‚çështjes së Kosovës’ mes shqiptarëve etnikë dhe serbëve etnikë nuk mund të garantohet paqja në këtë rajon. „Pa paqe në Kosovë nuk mund të ketë paqe në tërë rajonin dhe nuk mund të përmbillet me sukses integrimi në BE.”⁵⁶⁷

Pozitën gjeografike të Kosovës L. PEÇI e shikon si përparësi në procesin e integritimit në BE. Mirëpo, qeveritë kombëtare të shteteve anëtare të BE-së kanë interesa dhe politika të ndryshme, edhe atëherë kur zyra e të ngarkuarit të BE-së për politikë të jashtme J. SOLANA flet njëzëshëm lidhur me Kosovën. Çështja e statusit të pazgjidhur qëndron në kundërshtim me strategjinë e BE-së për rajonin e Ballkanit Perëndimor, pra me PSA-në. STM-ja mund ta përgatisë Kosovën për integrimin në BE, por jo edhe diçka më shumë. Për të shmangur kundërthëniet, do të ishin të nevojshme vizione të qarta politike dhe veprime konkrete për tërë rajonin e Evropës Juglindore.⁵⁶⁸

E. HASANI na bën me dije se çështja e anëtarësimit të Kosovës në BE nuk është tematizuar mjaftueshëm dhe mendon se BE-ja do të duhej të formulonte në mënyrë më të kapshme projektin e saj për Kosovën. BE-ja e ka krijuar „mekanizmin përcjellës” më shumë si marketing politik, në mënyrë që tek qytetarët e Kosovës të

⁵⁶⁵ Intervistë me Lulzim Peci, Prishtinë, më 23 qershor 2004.

⁵⁶⁶ Intervistë me Enver Hasani, Prishtinë, më 15 qershor 2004.

⁵⁶⁷ Intervistë me Adem Demaçi, Prishtinë, më 2 gusht 2004. Aktivisti 71-vjeçar për të drejtat e njeriut A. Demaçi kaloi 28 vjet në burg gjatë regjimit komunist jugosllav.

⁵⁶⁸ Intervistë me Lulzim Peci, Prishtinë, më 23 qershor 2004.

lërë përshtypjen se po u arrihen përparime në këtë proces dhe Kosova një ditë do të jetë pjesë e BE-së.⁵⁶⁹

M. FRIBERG është e një mendimi krejtësisht tjetër dhe ajo thekson se të gjithë përfaqësuesit e BE-së janë dakord që Kosova e ka vendin në BE. Kjo është vullnet i Komisionit të Komuniteteve Evropiane por edhe i institucioneve dhe i popullsisë kosovare. Komisioni i Komuniteteve Evropiane thekson njëkohësisht se integrimi i Kosovës në BE është i pavarur nga çështja e statusit.

Edhe L. TUMMERS është i mendimit se BE ka një qëndrim të unifikuar se Kosova një ditë do të bëhet pjesë e BE-së. Mirëpo, ka qasje të ndryshme, se si arrihet kjo.⁵⁷⁰

Midis administratës së UNMIK-ut dhe qeverisë kosovare mbizotëron pëlqimi se e ardhmja e Kosovës qëndron në BE. Edhe pse shumica e njerëzve në Kosovë i besojnë para së gjithash mbështetjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, megjithatë ka edhe shumë njerëz që shpresojnë te integrimi në BE. Edhe nëse politika kosovare si objektiv të drejtpërdrejtë para syve e ka para së gjithash pavarësinë⁵⁷¹, anëtarësimi në BE është shumë qartë njëri prej objektivave afatgjatë.

L. TUMMERS problemin e shihet te burokratët e institucioneve ndërkombëtare në Kosovë, për të cilët ideja evropiane zakonisht nuk paraqet kurrfarë prioriteti: e para, ata shpesh e ndërrojnë organizatën për të cilën punojnë në Kosovë dhe prandaj nuk mund të specializohen asnjëherë, dhe e dyta, për ata bëhet çështja në radhë të parë është te vazhdimi i kontratës së punës. Politikanët vendorë në anën tjetër mendojnë vetëm për zgjedhjet e ardhshme. Për OKB-në përkatësisht për administratën e UNMIK-ut ideja evropiane nuk është kurrfarë teme, sepse atyre u intereson vetëm çështja e statusit të Kosovës, ndërsa çfarë ndodhë pastaj, është problem i BE-së. Kështu në Kosovë nuk mund të krijohet asnjë strategji afatgjatë e integritimit në BE, thekson L. TUMMERS, por ai është po ashtu edhe i mendimit se Kosova mund të mësojë nga shembulli slloven ose kroat, si në çështjet ekonomike ashtu edhe në ato demokratike.⁵⁷²

„Mirëpo, problemi nuk qëndron vetëm në Kosovë, por edhe në vetë Brukselin. BE-ja duhet të dijë se çfarë ka ndër mend vërtet me pjesën e mbetur të vendeve ballkanike. Në këto vende ajo duhet të shfaqet me një

⁵⁶⁹ Intervistë me Enver Hasani, Prishtinë, më 15 qershor 2004.

⁵⁷⁰ Intervistë me Lars Tummers, Prishtinë, më 10 gusht 2004.

⁵⁷¹ Lidhur me çështjen e pavarësisë në Kosovë si në popullsi ashtu edhe tek të gjitha partitë politike e deri te shkencëtarët, është një pëlqim i gjerë. Krahu rreth kësaj Fabian Schmidt: Die „Albanische Frage“ im Spiegel der regional-albanischen Diskussion [„Çështja Shqiptare“ në pasqyrën e diskutimeve rajonale shqiptare], në: Südosteuropa 7-8/2000, f. 375-400.

⁵⁷² Mendime të ngjashme përfaqëson edhe V. Knaus: „Kosovarët do të duhej t'i përvetësonin përvojat nga shtetet e dikurshme komuniste, të cilët tashmë janë pjesë e BE-së ose në procesin e integritimit në BE kanë bërë shumë më tepër përparime se Kosova.“ Intervistë me Verena Knaus, Prishtinë, më 24 gusht 2004. V. Knaus punoi mes viteve 2001 dhe 2004 për institutin kërkimor „European Stability Initiative“ (ESI) në Kosovë.

program të mirë për të ardhmen. Kosova nuk është Slloveni dhe Serbia nuk është Kroaci, andaj duhet të zhvillohen strategji të harmonizuara posaçërisht për këto vende.⁵⁷³

Ndryshe nga shumë bashkëpunëtorë të shtyllës së BE-së pranë administratës së UNMIK-ut, Verena KNAUS nga ESI thekson në mënyrë krejt eksplicite nevojën e një ndryshimi të strategjisë përballë rajonit të Ballkanit Perëndimor në Bruksel dhe në Uashington. Për të sjellë më shumë dinamikë në procesin e integritit të Kosovës në BE, do të ishte p.sh. shumë stimuluese një politikë e migrimit të kontrolluar për ekonominë kosovare. Në Kosovë tani për tani nuk ka diskutim rreth asaj se si do të duheshin përballuar problemet socio-ekonomike dhe si Kosova mund t'i përafrohet më fort BE-së, konstaton V. KNAUS. BE-ja duhet të marrë qëndrim të qartë mbi integrimin e Kosovës në BE, kurse kosovarët, elitat politike dhe masat e gjera të popullatës, duhet të kuptojnë se çfarë kërkohet për integrimin në BE.

Edhe pse BE-ja e ka marrë vendimin strategjik që Ballkani Perëndimor duhet integruar në BE, ajo nuk e klasifikuar si objektiv të rëndësishëm procesin e përafritit dhe të integritit të Kosovës. Që këtë objektiv vërtet ta arrinte, ajo do të duhej të tregonte më shumë prani, përmes më shumë mjeteve dhe angazhimit më të madh. Shumë mjete financiare, që aktualisht përdoren për praninë ushtarake, do të ishin të panevojshme, sikur BE-ja të angazhohej më seriozisht në zhvillimin ekonomik. Duke u nisur prej këtyre argumenteve, ESI propozon që për Serbinë, Malin e Zi, Kosovën dhe Shqipërinë të njihet statusi i parakandidatit për BE dhe këto vende të përfshihen në fondet e kohezionit. „Përmes programeve afatgjate të zhvillimit BE-ja do të tregonte se integrimin e këtyre vendeve e mendon seriozisht. Programet e deritashme vjetore të BE-së nuk mund ta stabilizojnë Kosovën.“⁵⁷⁴

Vetëpërmbytja e BE-së përballë Kosovës sqarohet mes tjerash përmes qëndrimit të Brukselit që në politikën për Kosovën të marrë në konsideratë edhe ngjarjet në Serbi e në Mal të Zi. Duket se BE-ja dëshiron ta ruajë baraspeshën midis Serbisë, Malit të Zi dhe Kosovës, për të mos preferuar asnjërin nga aktorët rajonale.

II. Limitet e lëshimeve kosovare në vijën e procesit të integritit në BE

Edhe nëse do të praninin kompromise të shumta në vijën e procesit të integritit në BE, shumica e kosovarëve nuk mund ta mendojnë se do të duhej të përshëndeteshin nga kërkesa për pavarësi shtetërore. Për palën kosovare çështja e pavarësisë së Kosovës është e panegociueshme. Kështu p.sh. u përgjigj V. HAJRULLAHU në pyetjen se cilat qenkan lëshimet e skajshme që do të mund t'ia bënte Kosova BE-së:

⁵⁷³ Shtyllën e BE-së në Kosovë L. Tummers e përshkruan si një agjenci ekzekutive, e cila vetëm e bashkëimplementon mandatin e OKB-së në Kosovë. Intervistë me Lars Tummers, Prishtinë, më 10 gusht 2004.

⁵⁷⁴ Intervistë me Verena Knaus, Prishtinë, më 24 gusht 2004.

„Vetëm çështja e pavarësisë nuk ofron kurrfarë hapësire për kompromise. Në këtë çështje Kosova, edhe nëse i tërë procesi i integrimeve në BE do të varej nga kjo, nuk do të bënte asnjë kompromis. Përndryshe Kosova mund të negociojë për të gjitha lëshimet e tjera të mundshme dhe eventualisht edhe të lëshonte pe. Nga pika, në të cilën nga Kosova nuk do të kërkohet që të heqë dorë nga pavarësia, nuk qëndrojnë më pengesa në rrugë. Të gjitha çështjet e tjera kanë të bëjnë me standarde të caktuara, të cilat ne dëshirojmë t'i arrijmë duke marrë parasysh procesin e integrimit në BE.”⁵⁷⁵

Ky qëndrim i përgjigjet mendimit të një shumice shumë të madhe të kosovarëve dhe është për t'u kuptuar në kontekstin e përvojave kosovare të dhjetëvjeçarëve të fundit. Në të njëjtën pyetje, A. DEMAÇI u përgjigj: kosovarët tashmë paskan bërë kompromise; lëshimi më i madh i kosovarëve ka qenë largimi nga ideja e bashkimit kombëtar me Shqipërinë dhe përkushtimi ndaj idesë për krijimin e një shteti të vetë. Evropa duhet të heqë dorë nga përfytyrimi për të integruar Kosovën në një krijesë të përbashkët shtetërore me Serbinë dhe me Malin e Zi. BE-ja nuk i ndihmon Serbisë përmes ruajtjes së pretendimeve të saj për Kosovën.⁵⁷⁶

Derisa nga pala kosovare është për t'u dëgjuar qartë se pavarësia e Kosovës nuk lejon kompromis, përkatësisht paraqet vetë një kompromis, në të njëjtën frymë theksohet gatishmëria për përmbushjen e kriterëve për anëtarësim në BE. Përfaqësuesit e administratës ndërkombëtare në Kosovë shpresojnë se krijimi i një zyre për çështje të integrimit në BE pranë Zyrës së Kryeministrit kosovar do të kontribuojë për një kuptim më të mirë të idesë evropiane:

„Ne duam të shikojmë, që *acquis communautaire* dhe elementet e partneritetit evropian të bëhen pjesë integrale e çdo programi qeveritar. Në afat të shkurtër megjithatë do të mendohet se si mund të zgjidhet çështja e statusit, por ne duhet në periudhë afatgjate edhe t'i bashkëllogarim pasojat e çdo zgjidhjeje për procesin e integrimit në BE.”⁵⁷⁷

Shumë kosovarë e vlerësojnë PSA-në si shumë pozitiv, edhe pse Kosova për momentin nuk mund të lidhë MSA me BE-në. Përmes etablimit të STM-së Kosova sikur vendet e tjera të rajonit merr pjesë në procesin e PSA-së. Shumë prej „standardeve për Kosovën” u përgjigjen detyrave që duhet të përmbushen në kuadër të MSA-së. Kosova ka ndërmarrë shumë masa për t'i përmbushur këto kritere, një punë e vështirë kjo, për të cilën megjithatë nuk ka alternativë.⁵⁷⁸ Mossuksesi më i

⁵⁷⁵ Intervistë me Venera Hajrullahu, Prishtinë, më 24 qershor 2004.

⁵⁷⁶ Intervistë me Adem Demaçi, Prishtinë, më 2 gusht 2004.

⁵⁷⁷ Intervistë me Lars Tummers, Prishtinë, më 10 gusht 2004.

⁵⁷⁸ Intervistë me Venera Hajrullahu, Prishtinë, më 24 qershor 2004. Bashkëpunëtorët e pranisë ndërkombëtare në Kosovë konstatojnë kryesisht që Kosova në vitet e fundit ka bërë përparime të mëdha etj. përmes asaj që Kosova përmes STM-së marrka pjesë në PSA. „Kur

shënuar i BE-së në rajonin e Ballkanit Perëndimor është për A. DEMAÇIN prapëseprapë, që deri më sot ajo nuk i ka perceptuar interesat e vërteta të popullit serb. „Përndryshe BE-ja do të ishte shprehur qartë për çlirimin e Serbisë nga kolonia me emrin Kosovë.”⁵⁷⁹

Për kosovarë të tjerë „tragjedia jugosllave”, me luftërat për trashëgimin e Jugosllavisë, është për t’u kuptuar vetëm në lidhje me politikën e jashtme të BE-së. Deri më 1995 politika e BE-së mund të cilësohet si „Miteran-izëm”.⁵⁸⁰ Veç në kohë të fundit BE-ja u jep për të kuptuar kosovarëve se ka objektiva të qartë politikë dhe ekonomikë si për Serbinë dhe Malin e Zi, ashtu edhe për Kosovën. „Si vendet e rajonit ashtu edhe BE-ja kanë të njëjta objektiva – pyetja është vetëm se sa shpejt mund të bëhet realitet integrimi në BE.”⁵⁸¹

Dimensionin evropian është në Kosovë shumë i dobët dhe abstrakt, „madje investimet e BE-së perceptohen nga shumica e kosovarëve si investime amerikane, sepse gjithçka që vjen nga Perëndimi asociohet me Amerikën.”⁵⁸² Në Kosovë diskursi politik është i fokusuar fort kah Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sepse shpresohet se ato do ta zgjidhin problemin e statusit të Kosovës. Shikuar historikisht kjo sjellje del e kuptueshme, sepse evropianët dështuan në Kosovë para vitit 1999. Popullsia madje nuk e di që dy të tretat e investimeve në Kosovë janë mbështetje e BE-së. Për këtë është përgjegjëse edhe vetë BE-ja, sepse nuk prezantohet në mënyrë të qëlluar.⁵⁸³

Fakti që asnjë shtet evropian nuk gëzon aq shumë besim dhe respekt në Kosovë si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e bën atë partnere të pashmangshme edhe për BE-në, në qoftë se BE-ja dëshiron të arrijë zgjidhje afatgjata në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe përmes kësaj t’i çojë përpara edhe proceset e integritit në BE.

Për pyetjen se në cilin drejtim do të shkojë Kosova në 10 – 15 vjetët e ardhshëm dhe se çfarë do të thotë kjo për BE-në, V. HAJRULLAHU mendon se dy vitet e ardhshme do të jenë vendimtare për zhvillimet e dhjetëvjeçarit të ardhshëm. Shteti i të drejtës që nuk funksionon dhe mungesa e perspektivës ekonomike janë dy vështirësitë më të mëdha. „Në qoftë se në dy vitet e ardhshme i përballojmë këto dy probleme kryesore, atëherë edhe në vitet në vijim do të përmbushim gjithnjë e më shumë kriteret për procesin e integritit në BE. Prandaj dy vitet e ardhshme janë vendimtare për zhvillimet e mëvonshme në procesin e integritit të Kosovës në BE.”⁵⁸⁴

para pesë vjetësh erdha në Kosovë, nuk do të kisha mundur të përfytyroj se pas një kohe kaq të shkurtër do të merresha me çështjet e procesit të integritit në BE, siç është rasti tani.”

⁵⁷⁹ Intervistë me Michaela Friberg, Prishtinë, më 3 gusht 2004.

⁵⁸⁰ Intervistë me Adem Demaçi, Prishtinë, më 2 gusht 2004.

⁵⁸¹ Intervistë me Enver Hasani, Prishtinë, më 15 qershor 2004.

⁵⁸² Intervistë me Oliver Ivanović, Mitrovicë, më 9 prill 2004.

⁵⁸³ Intervistë me Enver Hasani, Prishtinë, më 15 qershor 2004.

⁵⁸⁴ Intervistë me Verena Knaus, Prishtinë, më 24 gusht 2004.

⁵⁸⁴ Intervistë me Venera Hajrullahu, Prishtinë, më 24 qershor 2004.

Të tjerët definojnë dy skenarë: skenari pozitiv mund të shfaqet nëse çështja e statusit të Kosovës do të gjente shpejt një zgjidhje, kurse skenari negativ, nëse situata e Kosovës do të mbetet edhe më tej e padefinuar. Kjo në çdo kohë do të mund të sillte konflikte të reja. Ngjarjet e marsit 2004 kanë treguar se një numër i paktë njerëzish mund ta rrëzojë krejt procesin politik.⁵⁸⁵

Nëse gjendja e përgjithshme socio-politike nuk përmirësohet shpejt në mënyrë të kapshme, shumë druajnë se Kosova do të bëhet një „vrimë e zezë” në rajon dhe në agjendën e BE-së gjithmonë do të shfaqet si një çështje sigurie dhe jo si një çështje e procesit të integrimit në BE. „Nuk kam asnjë arsye të jem optimist që Kosovën në dhjetë vjetët e ardhshëm ta shoh në BE”, thotë E. HASANI.⁵⁸⁶

Për dallim nga këto vështrime pesimiste, përfaqësuesit e administratës ndërkombëtare në Kosovë kanë më shumë besim. Ata theksojnë se e gjithë puna në Kosovë synon afrimin drejt BE-së dhe integrimit në BE. „Nuk mund të them se ku do të jetë Kosova në këtë proces pas dhjetë a pesëmbëdhjetë vjetëve. Së pari duhet të vendoset çështja e statusit të Kosovës dhe pastaj shpresoj që Kosova të jetë e gërshetuar shumë ngushtë me BE-në ose deri atëherë të jetë anëtare e familjes evropiane”, tha M. FRIBERG.⁵⁸⁷

Ndërsa vizionet për të ardhmen e kosovarëve janë të karakterizuara kryesisht nga frika dhe pasiguria për shkak të mungesës aktuale të perspektivës socio-politike, jo vetëm përfaqësuesit e pranisë ndërkombëtare në Kosovë por edhe vëzhgues të pavarur japin një pamje më pozitive. Kështu V. KNAUS vlerëson se në pesëmbëdhjetë vjetët e ardhshëm bashkësia serbe do të jetojë e kënaqur në Kosovën e pavarur brenda kufijve të tanishëm dhe Kosova do të jetë anëtare e BE-së. OKB-ja do të duhet të tërhiqet dhe prania e BE-së të fuqizohet, me ç’rast BE-ja megjithatë duhet të tregojë më shumë prani si partnere e palës kosovare dhe jo të konceptohet si zëvendësim i UNMIK-ut. Ndërsa administrata ndërkombëtare në Kosova mban pushtet, krijimi i institucioneve demokratike do të jetë i pamundshëm.⁵⁸⁸

Në përgjithësi, bashkëpunëtorët e shtyllës së BE-së pranë administratës së UNMIK-ut në Kosovë i shikojnë gjasat e Kosovës në procesin e integrimit në BE shumë më pozitivisht se vëzhguesit e pavarur të huaj ose kosovarë. Kështu p.sh. L. TUMMERS e shikon faktin se pas luftës më 1999, integrimi i Kosovës në BE ka filluar „nga zeroja” edhe si një shans të mirë: Në Kosovë nuk është e nevojshme të ndryshohen ligjet, në mënyrë që ato të bëhen të përputhshme me normat e BE-së. Administrata e UNMIK-ut që nga fillimi i ka kushtuar vëmendje përputhjes së normave ligjore kosovare me normat e BE-së.⁵⁸⁹

⁵⁸⁵ Intervistë me Lulzim Peci, Prishtinë, më 23 qershor 2004.

⁵⁸⁶ Intervistë me Enver Hasani, Prishtinë, më 15 qershor 2004.

⁵⁸⁷ Intervistë me Michaela Friberg, Prishtinë, më 3 gusht 2004.

⁵⁸⁸ Intervistë me Verena Knaus, Prishtinë, më 24 gusht 2004.

⁵⁸⁹ Intervistë me Lars Tummers, Prishtinë, më 10 gusht 2004. V. Knaus këtë e mohon me këmbëngulje: Administrata e UNMIK-ut i verifikon ligjet në radhë të parë se mos qëndrojnë

Pavarësisht nga përfytyrimet e ndryshme, për shkak të përvojave pas vitit 1999 duhet të shikohet si fakt që pa një zgjidhje të përhershme të çështjes së statusit të Kosovës, integrimi në BE, sidomos në Kosovë, por edhe në vendet e tjera fqinje, të mbetet dëshirë e porealizueshme.

Normat ligjore paraqesin vetëm një dimension të gjendjes së ndërlëkuar në Kosovë. Sidomos mungesa e një *politike të qëndrueshmërisë*, para së gjithash në fushën ekonomike dhe politike, i pengon perspektivat afatgjata politike dhe ekonomike dhe përmes kësaj edhe gjasat reale të integritimit në BE.⁵⁹⁰

Ardhmëria evropiane e rajonit të Ballkanit Perëndimor nuk vihet në pyetje publikisht as në vetë rajonin e as në qarqet e BE-së. Mirëpo, kur bëhet fjalë për strategjinë e BE-së për Ballkanin Perëndimor, mendimet ndahen. BE-ja ia ka caktuar vetes si objektiv afatmesëm, përkatësisht afatgjatë, që ta integrojë tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Lidhur me këtë janë nisur edhe masat, të cilat i shfaqin dy dobësi qenësore: në njërin anë intensiteti i masave strukturore nuk mjafton për ta çuar vërtet përpara procesin e integritimit në BE në rajonin e Ballkanit Perëndimor, kurse në tjetrën masat tashmë ekzistuese shpesh nuk komunikohen në mënyrë adekuate. Kështu perceptimet e strategjive të BE-së në Bruksel dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor shpesh qëndrojnë larg njëra-tjetrës. Janë të nevojshme strategji inovative për të mbështetur më intensivisht dhe më drejt vendet e Ballkanit Perëndimor si gjatë planifikimit, ashtu edhe gjatë zbatimit të masave të nevojshme për reformim.

Për arritjen e proceseve të integritimit në BE në rajonin e Ballkanit Perëndimor andaj duket të jenë me rëndësi esenciale dy pika: e para, BE-ja do të duhej të zhvillonte një politikë integruese më të qartë, më konsistente dhe para së gjithash më të kapshme, e cila do të mbështetej përmes një pranie më të madhe dhe përmes angazhimit të përforcuar ekonomik. Së dyti, kjo politikë e re do të duhej të përfaqësohet më mirë në vetë rajonin, para së gjithash përballë elitave politike, ashtu që në Bruksel dhe në kryeqytetet e rajonit të përjashtohet çdo dykuptimësi. Në vend të memorandumëve të mirëkuptimit do të duhej që BE-ja ashtu dhe qeveritë në rajonin e Ballkanit Perëndimor të merrnin *obligime* konkrete politike dhe ekonomike, për ta bërë më të kapshme perspektivën evropiane në këtë rajon. Kështu procesi i integritimit në BE do të mund të bëhej pjesë integrale e çdo programi qeveritar në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Mirëpo, derisa qeveritë nuk pranojnë as raporte,

në kundërshtim me Rezolutën e OKB-së (1999) dhe mos krijojnë një përgjegjësi ligjore për OKB-në. Se a qenkan këto ligje në përputhje me normat e BE-së, nuk paraqitka asnjë prioritet për administratën e OKB-së. Intervistë me Verena Knaus, Prishtinë, më 24 gusht 2004.

⁵⁹⁰ Shembulli i furnizimit me elektricitet në Kosovë në kohën pas vitit 1999 është karakteristik për gjendjen reale në vend. Në Kosovë ka burime mbimesatave të energjisë. Prapëseprapë nuk mund të sigurohet furnizimi stabil me rrymë, edhe pse ky sektor merr përkrahjen më të madhe financiare nga bashkësia ndërkombëtare, sidomos nga BE-ja. Derisa një pjesë e ndihmave u gjetën në llogaritë private të zyrtarëve ndërkombëtarë që punojnë në Kosovë, në vend maksimalisht gjysma e faturave paguhen nga ana e konsumatorëve të elektricitetit.

feedback ose informata të tjera të mjaftueshme rreth integrimit në BE, atëherë nuk do të jenë për t'u mahnitur për BE-në.

Me nocionin BE, në rajonin e Ballkanit Perëndimor nuk do të duhej të asociohej asnjë „organizatë ndihmëse” ose ndonjë aparat frikësues, në qoftë se një ditë në këtë rajon duhet të bëhen realitet vlerat evropiane si *demokracia, të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit*.

Perceptimi reciprok në Kosovë por edhe në BE duhet të jetë më pozitiv se deri më tani. BE-ja ka shansin real në Kosovë, që vlerat e veta t'ia sjellë më afër popullsisë së gjerë, por edhe perceptimin e nocionit *Evropa*, i cili shpesh zgjon drojë politike, ta ndryshojë pozitivisht. Njëra prej detyrave kryesore të BE-së dhe të institucioneve kosovare në vitet e ardhshme do të jetë që ta tejkalojnë këtë distancë politike dhe komunikative midis BE-së dhe Kosovës.

Këshilli Evropian në Feira konfirmoi në qershor 2000 në mënyrë eksplicite objektivin e një integrimi mundësisht të gjerë të vendeve të Ballkanit Perëndimor në këtë strukturë politike dhe ekonomike të Evropës dhe i pranoi këto vende si kandidatë potencialë për anëtarësim në BE. Kjo u përforcua përsëri gjatë takimit të Këshillit Evropian në dhjetor 2002 në Kopenhagë. Këshilli Evropian theksoi vendosmërinë e BE-së që t'i mbështesë këto vende edhe më tej gjatë realizimit të objektivave të tyre në politikën evropiane. Në mars 2003 Këshilli Evropian në Bruksel deklaroi:

„Ardhmëria e vendeve perëndimore të Ballkanit qëndron në BE' [...]. Përgatitja e vendeve të Ballkanit Perëndimor për integrim në strukturat evropiane është një prioritet i rëndësishëm i Bashkimit Evropian. Bashkimi i Evropës nuk do të jetë i kryer, derisa këto vende të mos kenë aderuar në Bashkimin Evropian.”⁵⁹¹

Në „*Agjendën e Selanikut për shtetet perëndimore të Ballkanit: Në rrugë deri te Integrimi Evropian*”, që u miratua më 16 qershor 2003 në Luksemburg nga ministrat e jashtëm të BE-së, pra vetëm tri ditë para Këshillit Evropian në Selanik më 19 dhe 20 qershor 2003, edhe një herë konfirmohet pozita e vendeve të Ballkanit Perëndimor si „kandidatë potencialë”⁵⁹² për një anëtarësim në BE. Në këtë agjendë përforcohet qasja e njohur e BE-së: „Parimet e „meritave vetanake” dhe „nxënia” do të aplikohen, paralelisht me qasjen rajonale, e cila mbetet një element thelbësor i politikës së BE-së përkritazi me rajonin.”⁵⁹³ Për Kosovën këtu në mënyrë pompoze konstatohet se „vendi i Kosovës në Evropë” është:

⁵⁹¹ Njoftim i Komisionit për Këshillin dhe për Parlamentin Evropian. Ballkani Perëndimor dhe integrimi evropian. Bruksel, më 21.05.2003 (KOM (2003) 285 finale) f. 2 (mund të gjendet në faqen: http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/de/com/2003/com2003_0285de01.pdf).

⁵⁹² Krahi. The Thessaloniki agenda for the Western Balkans: Moving towards European integration. Annex A. 16 qershor 2003.

⁵⁹³ Po aty.

„BE-ja përsërit mbështetjen e saj për zbatimin e plotë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Kosovën si dhe të politikës ‚standardet para statusit‘. Mbi këtë bazë, populli i një Kosove shumetnike dhe demokratike do të ketë vendin e vet në Evropë.”⁵⁹⁴

Edhe pse BE-ja që nga Këshilli Evropian në Vjenë në dhjetor 1998 ka paralajmëruar një strategji të përbashkët për Ballkanin Perëndimor, ajo ngurron, kur është fjala për një strategji të BE-së për Kosovën: „Në qarqet e OKB-së në Kosovë shprehet në mënyrë konfidenciale droja se në rast të një zhvendosjeje të angazhimit amerikan në rajone të tjera të botës, evropianëve do t’u mungojë një koncept unik zhvillimor së paku për Kosovën.”⁵⁹⁵

Interesat amerikanë në Ballkan që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë klasifikohen si interesa periferikë⁵⁹⁶. Por të paktën nga këndvështrimi i shumicës dërrmuese të njerëzve dhe të qeverive në rajonin e Ballkanit Perëndimor, është i pashmangshëm angazhimi amerikan për një Evropë, e cila do të duhej të ishte „e bashkuar dhe e lirë” si dhe „paqësore, e pandarë dhe demokratike”⁵⁹⁷. Në qoftë se nuk merret parasysh një pjesë e serbëve etnikë, atëherë asnjë shtet nuk gëzon aq shumë besim dhe respekt si garantues potencial i paqes sikurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe veçanërisht në Kosovë. Ky fakt i bën Shtetet e Bashkuara të Amerikës partnerë të pashmangshëm edhe për vetë BE-në, në qoftë se ajo dëshiron të arrijë zgjidhje afatgjata në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe përmes kësaj t’i çojë përpara proceset e integritimit në BE.

Konkludimet e kryesisë së Këshillit Evropian në Selanik nga 19 dhe 20 qershori 2003, përkundër shpresave të mëdha të vendeve të Ballkanit Perëndimor, nuk përmbajnë risi themelore në politikën për Ballkanin Perëndimor që zhvillohet nga ana e BE-së. Aty, në kreun V, Shtetet e Ballkanit Perëndimor, thuhet:

„Këshilli Evropian përforcon [...] perspektivën evropiane të shteteve perëndimore të Ballkanit, të cilat do të jenë pjesë e BE-së, sapo ato [t’i kenë përmbushur ...] kriteret e përcaktuara. ... Procesi i Stabilizimit dhe i Asociimit

⁵⁹⁴ Po aty.

⁵⁹⁵ Gregor Ryssel: Brüchige Stabilität auf dem Balkan? [Stabiliteti i brishtë në Ballkan?], në: Konrad Adenauer Stiftung Auslands Informationen, 11/2002, f. 40.

⁵⁹⁶ Krahe. Ivo H. Daalder: The United States, Europe, and the Balkans, në: Problems of Post-Communism, vëll. 49, 1/2002, f. 3-11.

⁵⁹⁷ Kështu citohen presidentët amerikanë George Bush (i vjetri) në vitin 1989 dhe B. Clinton në vitin 1995. Krahe. po aty, f. 8. Në përputhje me modelin e paqes demokratike, Strategie Enlargement for Democracies paraqiste një dimension të rëndësishëm të politikës së jashtme të presidentit amerikan B. Clinton. Krahe. H. Gärtner: Modelle europäischer Sicherheit. Wie entscheidet Österreich? [Modelet e sigurisë evropiane. Si vendos Austria?], Vjenë 1997, f. 43.

të Unionit do ta krijojë edhe më tej kornizën për përafrimin e shteteve perëndimore të Ballkanit deri te aderimi i tyre i ardhshëm.”⁵⁹⁸

BE-ja përpiket që përmes përkrahjeve dhe ndihmave të arrijë stabilitet politik në rajonin e Ballkanit Perëndimor, mirëpo pa dëshiruar të marrë vendimet drejtpërsëdrejti të nevojshme rreth *rendit politik* të rajonit të Ballkanit Perëndimor.⁵⁹⁹ Për të arritur sukses në rajonin e Ballkanit Perëndimor, është e pashmangshme një strategji e koordinuar dhe e përbashkët evropiane dhe amerikane:

„Kushtëzimi [lidhja e ndihmës ndërkombëtare me caqet specifike të performancës] është efektiv, në qoftë se komuniteti ndërkombëtar, sidomos Shtetet e Bashkuara dhe BE-ja, flet me një zë, sepse kjo vendos presion mbi liderët lokalë për të bërë ndryshime të vështira dhe jo të popullarizuara duke u dhënë atyre mbulesë politike për të vepruar kështu.”⁶⁰⁰

Vështirësitë e politikës së BE-së rajonin e Ballkanit Perëndimor qëndrojnë jo vetëm te mungesa e koordinimit dhe e konsistencës, por edhe te mungesa e marrjes parasysh të kontekstit specifik kohor dhe rajonal. Andaj progreset në integrim janë relativisht të vogla, nëse maten me përkrahjen e lartë financiare.

BE-ja midis 1991 dhe 2001 u ka lënë në dispozicion vendeve të Ballkanit Perëndimor plot 6,1 miliardë euro. Në suaza të programit CARDS janë paraparë gjithsej 4,65 miliardë euro për kohën mes 2000 dhe 2006, mes tjerash me qëllim të përkrahjes së bashkëpunimit rajonal në rajonin e Ballkanit Perëndimor si dhe mes vendeve të Ballkanit Perëndimor, të BE-së dhe shteteve të reja të BE-së në Evropën e Mesme dhe Lindore.⁶⁰¹

Krahas mjeteve të BE-së, sipas vlerësimeve, edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës për periudhën kohore 2001 dhe 2010 do të shpenzojnë mes 8 deri 12 miliardë për operacione ushtarake në Ballkan dhe 2 deri 3,5 miliardë dollarë

⁵⁹⁸ Konkluzat e kryesisë së Këshillit Evropian në Selanik nga 19 dhe 20 qershori 2003 (mund të gjenden në faqen: http://www.europarl.europa.eu/summits/pdf/the_de.pdf).

⁵⁹⁹ A. Wittkowsky shkruan: „Dilemën parimore, që është e varur nga vullneti për stabilizim i elitave në vend, BE-ja nuk mund ta anashkalojë me ofertat e saj. Me gatishmërinë e saj për integrim dhe me programet e saj ndihmëse ajo mund të ofrojë vetëm joshje, mirëpo nuk mund t'i zbusë vatrat e vërteta, si Serbinë, Malin e Zi ose Kosovën.” A. Wittkowsky: Der Stabilitätspakt für Südosteuropa und die „führende Rolle“ der Europäischen Union [Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore dhe „roli udhëheqës“ i Bashkimit Evropian], në: Aus Politik und Zeitgeschichte. Beilage zur Wochenzeitung Das Parlament, 14 korrik 2000, f. 13.

⁶⁰⁰ Edward C. Meyer etj.: Balkans 2010, Report of an Independent Task Force, Council on Foreign Relations/Centre for Preventive Action, Nju Jork 2002, f. 8.

⁶⁰¹ Kraha. F. L. Altmann: Regionale Kooperation in Südosteuropa, Organisationen, Pläne, Erfahrungen [Kooperimet rajonale në Evropën Juglindore, organizatat, planet, përvojat], në: Südosteuropa 4-6/2002, f. 284.

amerikanë si ndihmë për vendet e Ballkanit.⁶⁰² Krahas shteteve të BE-së dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës edhe Japonia është një donator i rëndësishëm zhvillimor për vendet e Ballkanit Perëndimor. Kështu për shembull, ndihma japoneze zhvillimore vetëm për vitin 2001 arrinte 31 milionë dollarë amerikanë.⁶⁰³

BE-ja pra është donatori më i rëndësishëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor, mirëpo çuditërisht përkundër ndryshimeve politike pas vitit 1999 shuma e vënë në dispozicion gati se s'ka ndryshuar: Krahasuar me periudhën kohore mes 1991 dhe 1999, kur BE-ja shpenzoi 4,5 miliardë për rajonin e Ballkanit Perëndimor, shuma e paraparë për periudhën kohore mes viteve 2000 dhe 2006 në lartësi prej 4,65 miliardë nuk është shumë më e madhe.⁶⁰⁴ Në këtë pikëpamje vendet e Ballkanit Perëndimor nuk mund të llogarisin në një përkrahje të rritur nga ana e BE-së. Në raportin e dytë vjetor të Komisionit të Komuniteteve Evropiane rreth PSA-së nga 26 marsi 2003 mund të lexohet shumë qartë: „Kur dhe në çfarë tempo mund të integrohet rajoni tërësisht në Bashkimin Evropian, varet fundja nga vetë vendet perëndimore të Ballkanit.”⁶⁰⁵ Më tej vendeve të Ballkanit Perëndimor u përkujtohet vazhdimisht *komuniteti i vlerave* të BE-së: „Qeveritë e rajonit duhet, e kjo ndodh gjithnjë e më shumë, t'i marrin përsipër këto vlera – vlera që kanë të bëjnë me demokracinë, sundimin e ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut, mbrojtjen e minoriteteve dhe ekonominë e tregut.”⁶⁰⁶

⁶⁰² Kraha. E. C. Meyer etj.: Balkans 2010, Report of an Independent Task Force, Council on Foreign Relations/Centre for Preventive Action, Nju Jork 2002, f. 5.

⁶⁰³ Shiko <http://www.mofa.go.jp/policy/oda/index.html>

⁶⁰⁴ Kraha. R. Biermann: Die europäische Perspektive für den westlichen Balkan. Die EU im Zwiespalt [Perspektiva evropiane për Ballkanin perëndimor. BE-ja në mospajtim], në: Osteuropa. Zeitschrift für Gegenwartsfragen des Ostens, 8/2001, f. 934.

⁶⁰⁵ Zweiter Jahresbericht, (KOM (2003) 139 endgültig) [Raport i Komisionit të Komuniteteve Evropiane. Procesi i Stabilizimit dhe i Asociimit për Evropën Juglindore. Raporti i dytë vjetor (KOM (2003) 139 final)], Bruksel, më 26.3.2003, f. 2.

⁶⁰⁶ Po aty, f. 4. Komisioni i Komuniteteve Evropiane e vlerëson PSA-në si rezultat, mirëpo konstaton edhe nevojën e një konsolidimi: „Procesi i Stabilizimit dhe i Asociimit është dëshmuar si i suksesshëm gjatë stabilizimit të vendeve perëndimore të Ballkanit. Ky proces duhet megjithatë të konsolidohet.” Po aty, f. 18.

Më 30 mars 2004 Komisioni i Komuniteteve Evropiane miratoi raportin e tretë vjetor për PSA-në, i cili u vlerësua si „indikator i rëndësishëm për atë se deri sa janë të gatshme këto vende për një përafrim me Bashkimin Evropian”. Raporti propozon „partneritete evropiane”, një risi në radhën e iniciativave të BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor. Caku i këtyre partneriteteve evropiane është mbështetja e reformave dhe përgatitjet për një anëtarësim të ardhshëm të vendeve të Ballkanit Perëndimor përmes përcaktimit të prioriteteve afatshkurtra dhe afatmesme. Kraha. Bericht der Kommission der Europäischen Gemeinschaften. Der Stabilisierungs- und Assoziierungsprozess für Südosteuropa. Dritter Jahresbericht, (KOM (2004) 202 endgültig), [Raport i Komisionit të Komuniteteve Evropiane. Procesi i stabilizimit dhe asociimit për Evropën Juglindore. Raporti i tretë vjetor, (KOM (2004) 202 final)], Bruksel, më 30.03.2004, f. 4 dhe 28.

Në këto Partneritete Evropiane V. Gligorov sheh një përpjekje të kombinimit të tri qasjeve të mëparshme të BE-së. Dhe atë: „[...] (i) qasja bilaterale e integritimit në BE, (ii) politika e menaxhimit të krizës me (iii) prezantimin e qasjes rajonale të zhvilluar pas përfundimit të

Prej vitesh janë nisur iniciativat e BE-së, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe aktorëve të tjerë bashkësisë ndërkombëtare, për ta përkrahur procesin e transformimit dhe të demokratizimit që po zgjat më se një dhjetëvjeçar në vendet e Ballkanit Perëndimor. Përkundër këtyre përpjekjeve të vazhdueshme, shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor ende nuk janë në mënyrë të pakthyeshme në rrugën e krijimit të shtetit ligjor dhe të integritit euro-atlantik. Në rastin më pozitiv kjo do të zgjasë me dekada, derisa vendet e Ballkanit Perëndimor të mund të përfshihen në BE dhe në strukturat euro-atlantike.

Analiza *politiko-paqësore* e cituar më lart e deficiteve në veprim nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, e cila në hapësirën e dikurshme jugosllave trajtonte *pasojat e jo shkaqet e konfliktit*,⁶⁰⁷ duket se nuk e ka humbur krejt aktualitetin.

Pushtetmbajtësit ballkanoperëndimorë, qofshin të zgjedhur ose të emëruar nga bashkësia ndërkombëtare, mbajnë po ashtu një pjesë të përgjegjësisë për këtë politikë. Shpërthimet e dhunës që po përsëriten gjithnjë dhe stagnimi i procesit të krijimit të një kulture të qëndrueshme liberal-demokratike të të drejtave të njeriut dhe të drejtave civile japin argumente për skepticizëm. Ngrirja e çështjeve politike sipas motos „koha shëron plagët” nuk mund të justifikohet, edhe në qoftë se këto çështje politike janë të zgjidhshme vetëm përmes një vendimi salomonik. Çështja e pazgjidhur e statusit të Kosovës paraqet shembullin markant për atë se si një çështje që duhet të zgjidhet politikisht është bërë pengesë për zhvillimin ekonomik dhe përmes kësaj edhe për një proces të suksesshëm të transformimit, të demokratizimit dhe të integritit në BE, ndërsa kjo nuk vlen vetëm për vetë Kosovën, por edhe për vendet fqinje të saj. Për këtë arsye e vlerësoj të arsyeshme që në vijim të merrem me çështjen se si përmes krijimit dhe sigurimit të një ‚paqeje pozitive’ do të mund të arrihej shuarja e përhershme e konfliktit serbo-kosovar në kuadër të procesit të integritit në BE.

luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë në fund të vitit 1995.” Vladimir Gligorov: European Partnership with the Balkans, në: European Balkan Observer, Belgrade Centre for European Integration and Vienna Institute for International Economic Studies, vëll. 2, Nr. 1, maj 2004, f. 5.

⁶⁰⁷ Krahi. citatin e ministrit të jashtëm gjerman J. Fischer, fusnota 499.

„Shpërbërja e Jugosllavisë filloi në Kosovë. Ajo duhet edhe të përfundojë atje.”⁶⁰⁸

C. Çështja e statusit të Kosovës në kontekstin e procesit të integritimit në BE

I. Pasqyrë hyrëse rreth ,çështjes së Kosovës’

„Çështja e Kosovës’ e pazgjidhur është po aq e vjetër sa edhe vetë politika serbe përballë Kosovës. Rrënjët e kulmit të fundit në konfliktin serbo-kosovar janë për t’u gjetur në kohën pas vdekjes së diktatorit komunist J. B. TITO, dhe atë në faktin që „[...] largimi i të gjithë shqiptarëve nga Kosova, pra e 90 përqindëshit të popullatës dy milionëshe, ishte qëllimi i proklamuar i udhëheqësve serbë, përfshirë edhe Milošević-in që nga viti 1980.”⁶⁰⁹ Kjo politikë serbe e vinte njëkohësisht bashkësinë ndërkombëtare para një dileme, që kërkonte një *vendim parimor*: a duhet të tolerohej një politikë e tillë shtetërore me tipare shoviniste në fund të shekullit XX në Evropë.

Me fundin e regjimit komunist u shkatërrua edhe RSFJ-ja. Më së voni nga ky çast ,çështja e Kosovës’ e pazgjidhur që nga rënia e sundimit osman në Ballkan më 1912 përjetoi një hov të ri. Që atëherë kjo çështje sfidonte stabilitetin në Ballkanin Perëndimor dhe tregonte përmes kësaj se pa një zgjidhje të qëndrueshme për Kosovën nuk mund të arrihet një paqe e përhershme në rajon.

Publicisti dhe politikani kosovar Veton SURROI i përshkruan përvojat e Kosovës brenda RSFJ-së si vijon: „Kosovarët, me kushtetutën, parlamentin, ligjet, qeverinë, policinë, universitetin dhe bankën qendrore të tyre kanë kaluar nëpër një eksperiencë që Kosovën e bën pakthyeshem një shtet në të drejtën e vet.”⁶¹⁰ Ngjashëm e paraqesin situatën edhe njohësit e tjerë të Kosovës:

„Pa qenë e nevojshme që zhvillimet e deritashme të çonin në krijimin e një shtetit të pavarur „Kosova”, megjithatë nuk është e vështirë të anticipohet se shqiptarët e Kosovës asnjëherë më nuk do të pajtohen me rolin e të sunduarit në territorin e Kosovës.”⁶¹¹

⁶⁰⁸ Louis Sell: Kosovo The Key to Balkan Stability, në: Problems of Post-Communism, vëll. 49, 1/2002, f. 15.

⁶⁰⁹ P. Calvocoressi: World Politics 1945 – 2000, Edinburg 2001, f. XVI.

⁶¹⁰ Veton Surroi: Kosova Political Life: Past as Prologue?, në: Presented Paper at the Policy Conference of United Nations Association of the United States and Institutio Affari Internazionali, Romë 12 – 14 dhjetor 1999.

⁶¹¹ M. Eising, Ph. Reszat: Die internationale Notstandsverwaltung im Kosovo [Administrata ndërkombëtare emergjente në Kosovë], në: Osteuropa Recht, 1/2003, f. 24.

Zgjidhja e qëndrueshme e „çështjes së Kosovës” është një parakusht për një proces të suksesshëm të demokratizimit dhe të transformimit si për Kosovën ashtu edhe për vendet fqinje të saj. Pa këtë zgjidhje shanset e integritetit në BE të këtyre vendeve i ngjajnë më shumë një utopie sesa një realiteti. Duke u nisur nga kujtesa kolektive e shumicës së njerëzve në Kosovë, R. BIERMANN e vlerëson çdo administrim të Kosovës nga ana e Serbisë si moralisht të paparamendueshme, ashtu edhe politikisht të paqëndrueshme:

„Përfytyrimi i një kthimi të Kosovës nën administrimin serb është po ashtu moralisht i pamendueshëm si politikisht i paqëndrueshëm, sidomos kur e kemi parasysh se spastrimet etnike nga 1998/99 paraqesin vetëm një përsëritje të tmerrshme të ngjarjeve nga 1912/13, gjë që në kujtesën kolektive të shqiptarëve të Kosovës përmbledhet si një strategji e ndërmarrë gjerësisht e politikës racore dhe shkatërruese serbe përgjatë një shekulli të tërë.”⁶¹²

Një përgjigje e caktuar për „çështjen e Kosovës” — ajo e qëndrimit nën sovranitetin serb — duhet prandaj të përjashtohet,⁶¹³ në qoftë se Kosovës dhe Serbisë u duhet mundësuar një perspektivë evropiane.

Midis 1912 dhe 1999, kur Kosova drejtpërsëdrejti ose tërthorazi qëndronte nën sundimin serb, nuk mundën të ndodhnin gati kurrfarë përvojash pozitive mes kosovarëve me prapavijë etnike shqiptare dhe atyre me prapavijë etnike serbe. Para vitit 1912 ekzistonte së paku një koekzistencë paqësore. Edhe pas vitit 1999 nuk është e pagjasë së paku një koekzistencë paqësore midis kosovarëve të etnisë shqiptare dhe serbe, nën parakushtin se do të zgjidhen në mënyrë të qëndrueshme problemet socio-politike. Njohja e një kombi politik të kosovarëve, mbarimi i instrumentalizimit të kosovarëve të etnitetit serb për qëllime të brendshme politike nga ana e Republikës së Serbisë si dhe një zhvillim i qëndrueshëm politik do t’i plotësonin parakushtet më të rëndësishme për një koekzistencë paqësore midis 90 për

⁶¹² Rafael Biermann: Der künftige Status Kosovos. Vorbereitung auf das Unvermeidliche [Statusi i ardhshëm i Kosovës. Përgatitja për të pashmangshmen], në: Internationale Politik - Europa Archiv 9/2000, f. 52.

⁶¹³ Ka disa pikëpamje se si do të mund të dukej zgjidhja e çështjes së statusit të Kosovës. Për shembull për F. Bieber është realisht e zbatueshme vetëm e ashtuquajtura pavarësi e kushtëzuar. Krah. Florian Bieber: What Final Status is Possible for Kosovo? Plans and Their Critiques, në: European Balkan Observer, Belgrade Centre for European Integration and Vienna Institute for International Economic Studies, vëll. 2, Nr. 1, maj 2004, f. 14-7. Me opsionet e ndryshme të një statusi të ardhshëm të Kosovës ballafaqohet një raport special i United States Institute for Peace (USIP). Krah. United States Institute of Peace (USIP), Special Report, Kosovo Final Status. Options and Cross-Border Requirements, Uashington DC, korrik 2002. Për vështirësitë e mundshme gjatë negociatave për statusin raporton një raport tjetër special i USIP-it. Krah. United States Institute of Peace (USIP), Special Report, Stimulating Kosovo. Lessons for Final Status Negotiations, Uashington DC, nëntor 2002 (të dyja mund të gjenden në faqen: www.usip.org).

qind të kosovarëve me prapavijë etnike shqiptare dhe afro 5 për qind me prapavijë etnike serbe^{614 615}.

E drejta e kosovarëve për një shtet të vetin dhe konflikti me Serbinë që rezultoi nga kjo, në vitet e fundit kishin për pasojë përfshirjen e drejtpërdrejtë të bashkësisë ndërkombëtare. Menaxhimi ndërkombëtar i krizës nuk arriti një „paqe përmes vendimit të arbitrazhit”, ajo shkaktoi sa për fillim një „ngrirje” të konfliktit.⁶¹⁶ Prania ndërkombëtare në Kosovë orvatet ta marrë përsipër rolin e një „pale të tretë”, e cila duhet të veprojë si mbështetëse gjatë gjetjes së zgjidhjes për çështjen e statusit të Kosovës. Mirëpo, një „palë e tretë” do të duhej të ishte „neutrale”, „e paanshme” dhe jo drejtpërdrejt e përfshirë në konflikt.⁶¹⁷

Edhe pse OKB-ja, BE-ja dhe organizata të tjera ndërkombëtare në rastin e konfliktit midis Serbisë dhe Kosovës pas vitit 1999 përqipen të marrin pozitën e një „pale të tretë”, atyre u mungon një element qenësor i definimit të nocionit „palë e tretë”⁶¹⁸, pra cilësia për të qenë „aktor i përvolluar” në konflikt. Bashkësia ndërkombëtare, sipas mendimit tim, shansin që në këtë konflikt të ndërmjetësojë si një „palë e tretë” e ka humbur më së voni që nga shpërthimi i luftës së armatosur midis Kosovës dhe Serbisë dhe që nga intervenimi që i pasoi asaj lufte. Në konstelacionin aktual në Kosovë dhe rreth Kosovës, bashkësia ndërkombëtare do të duhej ose të merrte anën për atë shtet ligjor që bazohet në qasjen e *demos-it* ose t’u linte hapësirë të lirë qasjeve etno-nacionaliste, të cilat kanë për objektiv krijimin e shteteve kombëtare monoetnike. Edhe pse bashkësia ndërkombëtare së fundi që nga

⁶¹⁴ Rreth gjendjes dhe rreth sjelljes politike të pakicës serbe në Kosovës kra. Anna Matveeva, Wolf-Christian Paes: The Kosovo Serbs: An ethnic minority between collaboration and defiance, në: Small arms and security in South Eastern Europe. Bonn International Center for Conversion, Friedrich Naumann Foundation and Saferworld, qershor 2003, f. 18.

⁶¹⁵ Kjo do të ishte për shembull një kundërpikëpamje ndaj propozimeve të profesorit për të drejtën shtetërore dhe administrative dhe të politologut Berthold Löffler, i cili shprehet për një zbutje të gjoja „armës demografike të shqiptarëve” dhe duke u bazuar në idetë etnonacionaliste refuzon një „fiksion skematik në modelin perëndimor të bashkëjetesës multi-etnike”. Kra. Berthold Löffler: Das Elend der Balkanpolitik des Westens am Beispiel des Kosovo [Mjerimi i politikës ballkanike të Perëndimit në shembullin e Kosovës], në: Osteuropa, Zeitschrift für Gegenwartsfragen des Ostens, 8/2001, f. 952 dhe 950.

⁶¹⁶ Kra. Walter Feichtinger: Streitkräfte als Instrument zur Lösung innerstaatlicher Konflikte. Die bestimmenden Faktoren des militärischen Konfliktbildes in Jugoslawien 1998/99, Dissertation an der Universität Wien [Forcat e armatosura si instrument për zgjidhjen e konflikteve ndërshtetërore. Faktorët përcaktues të pamjes së konfliktit ushtarak në Jugosllavi më 1998/99, disertacion pranë Universitetit të Vjenës], Vjenë 2001.

⁶¹⁷ Kra. Norbert Ropers: Rollen und Funktionen Dritter Parteien bei der konstruktiven Bearbeitung ethno-politischer Konflikte [Rolet dhe funksionet e palëve të treta gjatë përpunimit konstruktiv të konflikteve etnopolitike], në: Die Friedens-Warte, 71, 4/1996, f. 417 dhe 419.

⁶¹⁸ Në shkrimet e teorisë paqësore, një „palë e tretë” definohet si vijon: „Kundërshtimi mes palëve etnikisht të definuara duket aq gjithëpërfshirës dhe i thellë, sa që de-eskalimi i konfliktit duket të jetë jo i mundshëm pa bashkëveprimin e aktorëve të përvolluar; për këta të fundit është përgjithësisht emërtimi „palë e tretë”.” Po aty, f. 417.

intervenimi në Kosovë më 1999 e ka marrë qartë anën për qasjen e *demos-it*, deri më sot mungonte hapi vendimtar, përkatësisht konsekuenca logjike në kuadër të tejkalimit të ideve etno-nacionaliste serbe dhe shqiptare: pra njohja ndërkombëtare e një kombi politik të kosovarëve.

Për këtë arsye, orvatja e administratës ndërkombëtare në Kosovë, që në kohën pas luftës së vitit 1999 të marrë përsipër rolin e një ‚pale të tretë‘ nuk u dëshmuoi si e përshtatshme. Pozita e butë e bashkësisë ndërkombëtare si ‚palë e tretë‘ në konfliktin serbo-kosovar kishte për pasojë zvarritjen e ‚paqes pozitive‘, e cila, sipas mendimit tim, midis Kosovës dhe Serbisë mund të arrihet vetëm me njohjen reciproke si partnerë të barasvlershëm.

Me njohjen e të drejtës kosovare për vetëvendosje, bashkësia ndërkombëtare do t’i ndihmonte më shumë Serbisë për t’i normalizuar marrëdhëniet e saj me Kosovën, sesa përmes tentimit që të marrë rolin e një ‚pale të tretë‘ në konfliktin serbo-kosovar.

Përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për të krijuar paqe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, vendimit midis pretendimeve për sovranitet të shteteve të pranura dhe të drejtës për vetëvendosje të popujve⁶¹⁹ nuk do të mund t’i ikin përgjithmonë.⁶²⁰ Kjo vlen sidomos edhe për praninë ndërkombëtare në Kosovë, e cila në njërin anë konfrontohet me kërkesat e kosovarëve për njohjen e të drejtës së jashtme për vetëvendosje dhe në anën tjetër — siç përshkruhet në vijim — me pretendimet e Serbisë në Kosovë dhe për Kosovën si dhe me përpjekjet serbe për një ndarje faktike të Kosovës.

Politika e fundit serbe kundër Kosovës mori një trajtë të re me Memorandumin e Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve nga viti 1986⁶²¹. Dhjetë vjet më vonë

⁶¹⁹ Rreth të drejtës për vetëvendosje të Kosovës krah. Fee Rauter: Das Kosovo: eine völkerrechtliche Studie [Kosova: një studim sipas të drejtës ndërkombëtare], Vjenë 1999; Frank Münzel: Lässt sich die Unabhängigkeit Kosovos völkerrechtlich begründen? [A mund të arsyetohet pavarësia e Kosovës sipas të drejtës ndërkombëtare?], në: J. Marko (ed.): Gordischer Knoten Kosovo/a: Durchschlagen oder entwirren? [Nyja gordiane Kosova: Të çahet apo të shturet?], Baden-Baden 1999, f. 199-230; J. Marko, në: po aty, f. 15-25 dhe f. 231-59; Joseph Marko: „Kosova Republikë!“ Zwischen Recht und Moral [„Kosova Republikë! Midis të drejtës dhe moralit], në: Skënder Gashi, Lothar Classen (ed.): Dardania. Das Selbstbestimmungsrecht der Kosovaren [Dardania. E drejta e kosovarëve për vetëvendosje], vëll. 2, Vjenë 2001; Dajena Kumbaro: The Kosovo Crisis in an International Law Perspective: Self-Determination, Territorial Integrity and the NATO Intervention, North Atlantic Treaty Organisation. Office of Information and Press, 16 qershor 2001, f. 35 vv; Gerd Seidel: A New Dimension of the Right of Self-Determination in Kosovo?, në: Christian Tomuschat (ed.): Kosovo and the International Community, Hagë 2002, f. 203-15; Violeta Demaj: Kosovo/a. Recht auf Unabhängigkeit? [Kosova. E drejta për pavarësi?], Vjenë, Grac 2003, etj.

⁶²⁰ Krahe. N. Ropers: Rollen und Funktionen Dritter Parteien bei der konstruktiven Bearbeitung ethno-politischer Konflikte [Rolet dhe funksionet e palëve të treta gjatë përpunimit konstruktiv të konflikteve etnopolitike], në: Die Friedens-Warte, 71, 4/1996, f. 428.

⁶²¹ Për më shumë rreth kësaj shiko fusnotën 166.

kryetari i dikurshëm i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve Aleksandar DESPIĆ foli në Beograd për një ndarje të Kosovës.⁶²² Në këtë kontekst janë për t'u kuptuar veprimet e Republikës së Serbisë në Kosovë, e cila që nga intervenimi i bashkësisë ndërkombëtare më 1999 ndarjen e Kosovës mbi bazën e parimit etnik e definoi dukshëm si objektiv politik.⁶²³ Këta objektiva bëhen shumë të qartë, në qoftë se p.sh. lexohet deklarata e zëvendëskryeministrit serb dhe njëkohësisht përfaqësues i qeverisë serbe për çështje të Kosovës Nebojša ČOVIĆ. Ai mendon: „Unë nuk jam për ndarje, por nëse Kosova dhe Metohia po shtyhet drejt pavarësisë, atëherë ajo nuk mund të jetë krejtësisht e pavarur”⁶²⁴ N. ČOVIĆ kërkon kantonalizimin e Kosovës sipas shembullit boshnjak, „decentralizimin” dhe hartimin e një „strategjie kombëtare”, e cila do të kishte si pasojë ndarjen faktike të Kosovës dhe përmes kësaj krijimin e një strukture shtetërore jofunksionuese dhe jostabile, siç është rasti tani në Bosnjë e Hercegovinë. Zbatimi i këtyre planeve do të thoshte dëbime të reja masive të popullsisë kosovare:

„[...] plani i qeverisë serbe për krijimin e enklavave autonome serbe në Kosovë është e metë e rrezikshme. Serbët e Kosovës nuk mund të ndahen në enklava pa një zhvendosje masive edhe të serbëve edhe të shqiptarëve, duke rritur armiqësinë dhe duke komprometuar edhe më tej sigurinë e serbëve.”⁶²⁵

Kur më 1999 u bë e qartë se nuk do të lejohet „dealbanizimi” i Kosovës përmes dëbimit më të madh që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore në tokën evropiane, ideja e një ndarjeje të Kosovës fitoi rëndësi për gati të gjitha grupet politike në Serbi. Për shembull, kryeministri i Serbisë Zoran ĐINĐIĆ pak para vrasjes së tij rroku temën

⁶²² Večernje Novosti, 7 qershor 1996, f. 2. Për pasazhet në gjermanisht shiko B. Löffler: Das Elend der Balkanpolitik des Westens am Beispiel des Kosovo [Mjerimi i politikës ballkanike të Perëndimit në shembullin e Kosovës], në: Osteuropa, Zeitschrift für Gegenwartsfragen des Ostens, 8/2001, f. 944.

⁶²³ Qysh më 1996 qeveria serbe diskutoi opsionet për ndarje të Kosovës. Në qershor 1996, pra dhjetë vjet pas hartimit të Memorandumit nga viti 1986, kryetari i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, Aleksandar Despić, propozoi ndarjen e Kosovës mes Serbisë, Malit të Zi dhe Shqipërisë. Kra. rreth kësaj Zoran Lutovac: All Kosovo Options, në: Vreme, 10 maj 1997. Një hartë rreth ndarjes së mundshme të Kosovës është e publikuar në revistën Österreichische Militärische Zeitschrift (ÖMZ) 3/97, f. 312, sipas të cilës i tërë veriu me ndërmarrjet industriale do t'i përkiste Serbisë. Sot pikërisht në këtë pjesë të Kosovës përreth qytetit të Mitrovicës gjendet strukturat paralele serbe nën ndikimin direkt të Beogradit si dhe grupe paramilitare serbe. Për planet e ndryshme serbe të ndarjes së Kosovës bashkë me disa paraqitje kartografike kra. N. Spahi: Serbian Tendencies for Partitioning of Kosova, Budapest 1999, f. 97-128.

⁶²⁴ Nebojša Čović: Never will Kosovo be independent, në: Vreme, 15 mars 2003, cituar te International Crisis Group (ICG), Kosovo's Ethnic Dilemma: The Need for a Civic Contract, Balkans Report Nr. 143, Prishtinë/Bruksel 28 maj 2003, f. 13 (<http://www.crisisweb.org>).

⁶²⁵ European Stability Initiative (ESI), The Lausanne Principle. Multiethnicity, Territory and the Future of Kosovo's Serbs, Berlin/Prishtinë 7 qershor 2004, f. 2 (mund të gjenden në faqen: www.esiweb.org).

e Kosovës dhe kërkoi „federalizimin”⁶²⁶ e Kosovës në një bashkësi shqiptare dhe në një bashkësi serbe⁶²⁷, edhe pse në Kosovë vetëm diçka më shumë se 5 për qind të popullsisë së tërësishme janë kosovarë të etnitetit serb. Z. ĐINĐIĆ mori në konsideratë një konferencë të re *à la* Dejton, në qoftë se kosovarët insistonin në kërkesën për pavarësi.⁶²⁸ „Më 16 janar 2003 ai deklaroi para kamerave të televizionit serb se ka ardhur koha e negociatave për Kosovën. Para se *de facto* të krijohej një shtet i pavarur, Beogradi duhet të përfshihet.”⁶²⁹ Disa autorë supozojnë se Z. ĐINĐIĆ ka pasë planifikuar që përmes politikës së tij të Kosovës të „shkaktonte një situatë të krizës politike rreth Kosovës, sepse »bashkësia ndërkombëtare u përkushtohet situatave vetëm atëherë kur digjet«.”⁶³⁰

Kur Z. ĐINĐIĆ pak javë para atentatit vdekjeprurës kundër tij tentoi ta luante letrën nacionaliste serbe, duke propozuar një rishqyrtim të Marrëveshjes së Dejtonit lidhur me ndarjen e Kosovës, planet e tij u kritikuan ashpër në njërën anë nga prania ndërkombëtare në rajon (p.sh. UNMIK-u) dhe në anën tjetër nga kundërshtarët serbë.⁶³¹ „Koštunica e cilësoi aksionin e DJINDJIĆ-it si të »papërgjegjshëm«. Nenad Čanak, kryetari i Parlamentit të Vojvodinës, deklaroi se ideja për një ndarje të Kosovës patjetër do ta ngrinte edhe temën e një ndarjeje të Vojvodinës.”⁶³² Shefi i atëhershëm i UNMIK-ut, Michael STEINER, nuk e çmonte shumë debatit rreth çështjes së statusit:

„Ne nuk e dimë se si do të duket statusi i ardhshëm. Por ne e dimë se si nuk do të duket ai. Nuk do të ketë kthim në status quo-në e para vitit 1999. Nuk do

⁶²⁶ Kosova ka një madhësi prej 10.887 km² dhe paraqiste jo vetëm njësinë ekonomikisht më të varfër të RSFJ-së, por ishte edhe për nga madhësia njësia më e vogël federale. Ky territor është edhe madje për „minishtetet e ,botës ballkanike” shumë i vogël dhe në rast të ndarjes së mëtejme definitivisht do ta bënte një territor që nuk është në gjendje për të mbijetuar në mënyrë të pavarur.

⁶²⁷ Krah. Reinhold Vetter: Kud ideš Srbijo? Serbien nach der erfolglosen Präsidentenwahl und dem Mord an Đinđić [Kah shkon Serbi? Serbia pas zgjedhjeve të pasuksesshme presidenciale dhe pas vrasjes së Đinđić-it], në: Osteuropa, Zeitschrift für Gegenwartsfragen des Ostens, 4/2003, f. 497.

⁶²⁸ Krah. Andreas Ernst: „Standards vor Status!” – Die Doktrin der UNO-Mission in Kosovo führt in die Sackgasse [„Standardet para statusit!” – Doktrina e misionit të OKB-së në Kosovë çon në qorrsoak], në: Südosteuropa 7-9/2002, f. 364.

⁶²⁹ Po aty.

⁶³⁰ Franz-Lothar Altmann, Dushan Rjelić: Zuspitzung im Kosovo im Schatten der Irak-Krise [Ashpërsimi në Kosovë nën hijen e krizës në Irak], në: SWP-Aktuell, Deutsches Institut für Internationale Politik und Sicherheit, mars 2003, f. 5.

⁶³¹ Vetë Z. Đinđić pranoi në Večernje Novosti, 7 mars 2002, se raporti i tij me kolegët nga organizatat ndërkombëtare është çrregulluar për shkak të qëndrimit të tij ndaj Kosovës, cituar në Monitordienst von Beta/DW, Beograd 8 mars 2003.

⁶³² F. L. Altmann, D. Rjelić: Zuspitzung im Kosovo im Schatten der Irak-Krise [Ashpërsimi në Kosovë nën hijen e krizës në Irak], në: SWP-Aktuell, Deutsches Institut für Internationale Politik und Sicherheit, mars 2003, f. 6.

të ketë ndarje të Kosovës dhe kantonizim. Nga ana tjetër, nuk do të ketë pavarësi të lirë pa kushte.”⁶³³

Gjatë diskutimeve rreth ndarjes së Kosovës politikanët serbë tërheqin shpesh paralelen mes Kosovës dhe Republikës Serbe në Bosnjë dhe Hercegovinë. Dallimi mes Kosovës dhe Republikës Serbe në Bosnjë dhe Hercegovinë

„është se identiteti i tanishëm etnik i Republikës Serbe është arritur nga gjenocidi i tentuar, ndërsa karakteri shqiptar i shumicës dërrmuese në Kosovë nuk u arrit në mënyrë të tillë dhe i parapriu për kohë të gjatë konfliktit të viteve të 1990-ta.”⁶³⁴

Përveç kësaj „Dejtoni nuk është dëshmuar të jetë një sukses mahnitës në afat të gjatë dhe mbijetesa e tij nuk duhet të jetë një arsye për të mohuar pavarësinë e Kosovës.”⁶³⁵ Për këtë arsye shumë hulumtues të Ballkanit me të drejtë paralajmërojnë nga çdo këmbim a krahasim midis Kosovës dhe Republikës Serbe në Bosnjë dhe Hercegovinë:

„Pavarësisht kohës, çështja e Kosovës nuk duhet të lidhet në asnjë mënyrë me të ardhmen e Republikës Serbe [...]. Nocioni i përçafuar nga disa serbë që Republika Serbe të jetë „kompensim” ndaj Serbisë për humbjen e Kosovës është vetvetiu destabilizues dhe për këtë arsye i papranueshëm.”⁶³⁶

Nga sukcesi ose mossukcesi i administratës së UNMIK-ut do të varet fort respekti për OKB-në në të ardhmen. Administrata e UNMIK-ut nuk jep kurrfarë garancie se procesi i krijimit të kombit në Kosovë do të jetë i suksesshëm. Ajo në përgjithësi paraqitet si aparat burokratik dhe joeficient dhe merret shpesh edhe si shkas për ta kritikuar OKB-në.⁶³⁷

⁶³³ Michael Steiner cituar në Report of Project on Ethnic Relations – Albanians and their neighbours: Is the status quo acceptable?, Lucern 15 – 16 nëntor 2002, publikuar nga Project on Ethnic Relations, Rep. 7/8, New Jersey 2003, f. 6.

⁶³⁴ ICG, After Milosevic. A Practical Agenda for Lasting Balkans Peace, Balkans Report Nr. 108, Bruksel 1 prill 2001, f. 124.

⁶³⁵ Justin L. C. Eldridge: Kosovo: Land of Uncertainty, në: European Security, vëll. 10, 2/2001, f. 45.

⁶³⁶ E. C. Meyer etj.: Balkans 2010, Report of an Independent Task Force, Council on Foreign Relations/Centre for Preventive Action, Nju Jork 2002, f. 18. Argumente të ngjashme jep edhe ICG-ja: „Bashkësia ndërkombëtare duhet t'i refuzojë me këmbëngulje hamendjet se pavarësia e Kosovës do të mund të krijonte një precedent për pretendimet e separatistëve të tjerë në rajon, sikur në Maqedoni apo Bosnjë.” International Crisis Group (ICG), A Kosovo Roadmap (I) Addressing Final Status, Balkans Report Nr. 124, Prishtinë/Bruksel 1 mars 2002, f. iv (<http://www.crisisweb.org>).

⁶³⁷ Shtetet e Bashkuara të Amerikës e quajten administratën e UNMIK-ut si një shembull për joeficiencën e OKB-së, në mënyrë që fillimisht në Irak për OKB-në të lejonin vetëm një rol

Ndërsa Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndjekin një politikë realiste dhe para së gjithash pragmatike në Ballkan, angazhimi evropian në këtë hapësirë kufizohet në „zgjidhje” të përkohshme, të cilat në afat të gjatë shpesh krijojnë më shumë probleme sesa që i mënjanojnë.

Me presion energjik nga BE-ja dhe Këshilli i Evropës, më 4 shkurt 2003 u miratua një *Kartë Kushtetuese e Bashkësisë Shtetërore Serbi dhe Malit të Zi*, e cila e shtyn në kohë të largët zgjidhjen me marrëveshje të përbashkët mes Serbisë dhe Kosovës për çështjen e statusit të Kosovës. Me rastin e aprovimit të Kartës Kushtetuese J. SOLANA u shpreh si vijon:

„Jam shumë i kënaqur për miratimin e drafrit të Kartës Kushtetuese [...]. sa i përket Kosovës, unë përsëris mendimin tim që baza për statusin e ardhshëm të Kosovës të mbetet Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së.”⁶³⁸

Rreth rolit të BE-së, përkatësisht të shteteve të saj anëtare në këtë proces, ICG-ja konkludon:

„Duke vazhduar të këmbëngulin për ruajtjen e RFJ-së në një formë dhe për të kundërshtuar krijimin e ndonjë shteti të ri, aktorët e mëdhenj evropianë janë duke rrezikuar rolin e tyre si paqeruajtës të ndershëm në diskutime të tilla.”⁶³⁹

Kosova nuk u përfshi as tërthorazi e as drejtpërsëdrejti në procesin e marrëveshjes së kësaj Karte Kushtetuese midis Serbisë dhe Malit të Zi. Kjo Kartë Kushtetuese megjithatë përmban pika, të cilat pala kosovare i klasifikon si një tentim tjetër të një agresioni kushtetues të Serbisë kundër Kosovës. Për shembull, në preambulën e kësaj Karte Kushtetuese mund të lexohet:

„E themeluar mbi barazinë e të dy shteteve anëtare, shtetit të Malit të Zi dhe shtetit të Serbisë, e cila përfshin Krahinat Autonome të Vojvodinës dhe të

humanitar. Sipas raporteve të gazetave, pala amerikane në lidhje me këtë argumentonte si vijon: „Qysh në shkurt ministri amerikan i mbrojtjes Donald Rumsfeld në një thumbim të qartë kundër OKB-së la për të kuptuar se rindërtimi dhe krijimi i shtetit në Irak nuk do të rrjedhë ashtu si në Kosovë, „ku një shofer që i bartë ndihmësit ndërkombëtarë andej-këndeje, fiton më shumë se një profesor universiteti.”” Christian Ultsch: Die USA wollen Irak unter Kontrolle behalten [ShBA-të duan ta mbajnë Irakun nën kontroll], në: Die Presse, 27 mars 2003, f. 5.

⁶³⁸ http://ue.eu.int/ueDocs/cms_Data/docs/pressdata/EN/declarations/73551.pdf

⁶³⁹ ICG, After Milosevic. A Practical Agenda for Lasting Balkans Peace, Balkans Report Nr. 108, Bruksel 1 prill 2001, f. 268 (në origjinal kursiv).

Kosovës, aktualisht nën administrimin ndërkombëtar në përputhje me Rezolutën 1244 të Kombeve të Bashkuara [...]”⁶⁴⁰

Derisa preambula ka vetëm një karakter deklarativ dhe kështu ky formulim në një Kartë të përkohshme Kushtetuese mund të interpretohet vetëm si opium për përfaqësuesit e politikës agresive dhe ekspansioniste të Serbisë përballë Kosovës, në nenin 25 rreth largimit të njëres prej këtyre dy republikave nga unioni shtetëror konkludohet:

„Në rast të largimit të shtetit të Malit të Zi nga bashkësia shtetërore Serbia dhe Mali i Zi, dokumentet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me Republikën Federale të Jugosllavisë, sidomos Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, do të kenë të bëjnë dhe do të vlejnjë në tërësi për shtetin e Serbisë, si pasardhëse.”⁶⁴¹

Qysh në fillim të viteve të 1990-ta regjimi serb tentonte që RFJ-në e *Milošević-it* të themeluar më 1992 ta proklamonte si shtet pasardhës të RSFJ-së, të cilën praktikisht vetë e kishte shkatërruar. Ky tentim nuk u pranua asnjëherë nga bashkësia ndërkombëtare, përkatësisht nga OKB-ja.

Ngjashëm, Serbia tenton tani të definohet si shtet pasardhës sipas të drejtës ndërkombëtare i unionit të përkohshëm shtetëror Serbi-Mali i Zi dhe përmes kësaj ta riinterpretojë Rezolutën e OKB-së 1244 (1999), në të cilën nuk përmendet në asnjë vend nocioni Serbi.⁶⁴²

Ky qëndrim i Serbisë përballë Kosovës pasqyron politikën e pandryshuar agresive etno-nacionaliste për Kosovën. Për shembull, sjellja e kryeministrit aktual

⁶⁴⁰ Përkthimi në gjermanisht të Reinald Eckhardt: Die Verfassungs-Charta der Staatengemeinschaft „Serbien und Montenegro” vom 4. Februar 2003 [Karta Kushtetuese e bashkësisë shtetërore „Serbia dhe Mali i Zi” nga 4 shkurti 2003], në: Osteuropa Recht, 2/2003, f. 168.

⁶⁴¹ Po aty, f. 178.

⁶⁴² Disa autorë janë të mendimit se kjo Kartë Kushtetuese mund të ketë ndikim në statusin e ardhshëm të Kosovës: „Marrëveshja e Solanës prek gjithashtu fatin eventual të Kosovës. Sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Kosova është pjesë e Jugosllavisë, jo e Serbisë, kështu që statusi i saj do të ishte i pasigurt në qoftë se Mali i Zi ndahet dhe shteti jugosllav, si pasojë, shkatërrohet. Marrëveshja e Solanës përpiqet ta zgjidhë këtë problem duke njohur Serbinë si pasardhëse të RFJ-së në lidhje me dokumentet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me Jugosllavinë.” Sabrina P. Ramet, Philip W. Lyon: Discord, Denial, Dysfunction. The Serbian-Montenegrin-Kosovar Triangle, në: Problems of Post-Communism, vëll. 49, 5/2002, f. 16. Në një raport të ICG-së kjo gjendje vlerësohet si vijon: „Rezoluta 1244 e KS të OKB-së i referohet vazhdimësisë së Kosovës në RFJ, por jo në Serbi. Është argumentuar shpesh se shpërbërja përfundimtare e federatës midis Serbisë dhe Malit të Zi do të nënkuptonte fundin e RFJ-së, me pasojë që Kosova do të hidhej në mëshirën e fatit. Këtu nuk ka bazë për këtë argument. Edhe në qoftë se RFJ pushon së ekzistuari, zbatueshmëria e Rezolutës 1244 të KS të OKB-së nuk do të ndryshonte.” ICG, A Kosovo Roadmap (I) Addressing Final Status, Balkans Report Nr. 124, Prishtinë/Bruksel 1 mars 2002, f. 15.

serb Vojislav KOŠTUNICA nga ICG-ja përshkruhet si vijon: „i mbështetur nga nacionalistët, Armata Jugosllave (VJ), policia dhe Partia Popullore Socialiste (SPS) e Milošević-it – [ai] vazhdon të kërkojë që Kosova të mbetet pjesë jo vetëm e RFJ-së, por edhe e Serbisë.”⁶⁴³ Edhe kisha ortodokse serbe merr një rol të rëndësishëm në këtë politikë. Në fillim të gushtit 2003 ajo publikoi një „Memorandum për Kosovën dhe Metohinë”, në të cilin mes tjerash mund të lexohet: „Ç’është Jerusalemi për popullin hebre, është Kosova për popullin serb.”⁶⁴⁴

Pas largimit të Malit të Zi nga unioni Serbi-Mal i Zi në maj 2006, më 8 nëntor 2006 hyri në fuqi një tekst i ri dubioz kushtetues, në preambulën e të cilit Kosova cilësohet si pjesë përbërëse integrale e Serbisë. Kjo kushtetutë e Republikës së Serbisë e konfirmon edhe një herë vijimësinë e politikës agresive etno-nacionaliste serbe përballë Kosovës.

Kryetari i Partisë Demokratike të shqiptarëve në Maqedoni, Arbën XHAFERI, mendon se çdo herë kur Serbia miraton një kushtetutë të re, fillojnë luftëra dhe konflikte.⁶⁴⁵ Falë pranisë ndërkombëtare ushtarake në Kosovë nuk u jetësua ky konstatim as më 2003 e as më 2006.

Mirëpo, përmes kësaj politike serbe në njërën anë u zhvendos në kohë të largët zgjidhja me marrëveshje të përbashkët për konfliktin serbo-kosovar, kurse në anën tjetër përmes kësaj në mënyrë të tërthortë u fuqizuan forcat radikale në Kosovë. Pra, një ringjallje e grindjeve të armatosura nuk mund të përjashtohet përkundër pranisë ushtarake ndërkombëtare.

Në përgjithësi përkitazi me çështjen e statusit të Kosovës mund të nxirret konkluzioni se shumë aktorë të bashkësisë ndërkombëtare i besojnë fort ndikimit pozitiv të faktorit kohë në konfliktin serbo-kosovar. Kjo ide mbështetet në besimin e një procesi të vetësqarimit. „Me kalimin e kohës serbët do të pranojnë se një Serbi pa Kosovën është pafundësisht më stabile, më demokratike dhe ndoshta më prosperuese.”⁶⁴⁶ Mirëpo, më së voni që nga ndërrimi i pushtetit në Beograd në tetor

⁶⁴³ ICG, After Milosevic. A Practical Agenda for Lasting Balkans Peace, Balkans Report Nr. 108, Bruksel 1 prill 2001, f. 37. Autorë të tjerë deklarojnë se Vojislav Koštunica „është në fakt një nacionalist më i bindur se sa që ishte ndonjëherë Milošević-i.” S. P. Ramet, Ph. W. Lyon: Discord, Denial, Dysfunction. The Serbian-Montenegrin-Kosovar Triangle, në: Problems of Post-Communism, vëll. 49, 5/2002, f. 8.

⁶⁴⁴ Një qëndrim të ngjashëm morën edhe parlamenti serb dhe qeveria serbe disa javë më vonë, më 27 gusht 2003. Ata përfaqësuan pozitën se „i vetmi status i ardhshëm i pranueshëm për Kosovën do të jetë ai i një krahine të Serbisë, duke shtuar si kushte kthimin e refugjatëve serbë dhe të ushtrisë serbe.” Wim van Meurs: Kosovo’s Fifth Anniversary – On the Road to Nowhere?, në: The Global Review of Ethnopolitics, vëll. 3, Nr. 3-4, mars/qershor 2004, f. 69. Ky qëndrim i institucioneve serbe u kumtua disa javë para fillimit të bisedimeve mes Kosovës dhe Serbisë në tetor 2003 dhe në thelb përfaqësohet i pandryshuar deri më sot.

⁶⁴⁵ Cit. te Dušan Reljić: Extremisten nutzen das politische Vakuum. In Kosovo wachsen wieder die Spannungen zwischen Serben und Albanern [Ekstremistët shfrytëzojnë vakuumin politik. Në Kosovë rriten prapë tensionet mes serbëve dhe shqiptarëve], në: Frankfurter Rundschau, 5 shtator 2003.

⁶⁴⁶ J. L. C. Eldridge: Kosovo: Land of Uncertainty, në: European Security, vëll. 10, 2/2001, f. 45.

2000, realiteti tregon se pasiguria rreth të ardhmes së statusit të Kosovës shumë shpesh është bërë pengesë për përparime të mëtejme në proceset e demokratizimit, transformimit dhe të integritimit në BE të Serbisë dhe në Kosovë.⁶⁴⁷ Çështja e pazgjidhur e statusit të Kosovës frenon edhe etablimin e një kulture politike të drejtave të njeriut dhe të drejtave civile si në Serbi ashtu edhe në Kosovë.

II. Inkluzioni kundër ekskluzionit – Dy qasje të kundërta rreth çështjes së statusit të Kosovës

Njohja e pavarësisë së Kosovës për disa qarqe të bashkësisë ndërkombëtare është e papajtueshme me parimin e mosndryshimit të kufijve në Evropë përkatësisht me Aktet Finale të Helsinkit. Kundërshtarët e kësaj qasjeje nisen nga ideja se procesi i shpërbërjes së RSFJ-së nuk është ende i përfunduar dhe se „ta njohësh Kosovën nuk do të thotë „ndryshim i kufijve të saj”. Si pasojë, në lidhje me kufijtë, nuk është çështja e një situatë që dallon nga Rregullat e Helsinkit.”⁶⁴⁸

Për këtë arsye, lidhur me njohjen e Kosovës si shtet sovran mund të konstatohen dy interpretime: Në kuadër të interpretimit të parë, njohja e sovranitetit të Kosovës do të thoshte qartë ndryshim i kufijve, sepse kufiri administrativ midis Kosovës dhe Serbisë do të shndërrohej në një kufi shtetëror. Te interpretimi i dytë njohja e Kosovës si shtet sovran do të shihej në kuadër të *procesit të përgjithshëm të shpërbërjes së RSFJ-së*. Duke u bazuar në Kushtetutën e RSFJ-së nga viti 1974 dhe në vullnetin e popullit të Kosovës, do të bëhej vetëm shndërrimi i kufijve të një anëtari të dikurshëm konstitutiv të federatës në një kufi të pranuar ndërkombëtarisht dhe përmes kësaj nuk do të ekzistonte një ndryshim kufiri. Për këtë arsye kjo do të ishte vetëm një përsëritje e shembullit slloven, maqedonas ose kroat, edhe pse Kosova paraqiste një njësi federale asimetrike⁶⁴⁹ në RSFJ.

Në qoftë se — si në interpretimin e parë — supozohet mundësia e një ndryshimi të kufijve, ky si *veprim i njëanshëm* do të qëndronte qartazi në kundërshtim me Aktet Finale të Helsinkit. Mirëpo, atëherë Aktet Finale të Helsinkit do të ishin shkelur p.sh. gjatë njohjes së Sllovenisë dhe të pjesëve të tjera konstitutive të federatës së dikurshme të RSFJ-së, sepse nuk ekzistonte një ndarje me marrëveshje të përbashkët prej qeverisë federale. Kështu R. BIERMANN konstaton:

⁶⁴⁷ Deri te konkludimet e ngjashme erdhi edhe ICG-ja: „Është gabim të mendohet se krahina dhe rajoni përreth mund të stabilizohen para se të jetë zgjidhur çështja e statusit.” ICG, A Kosovo Roadmap (I) Addressing Final Status, Balkans Report Nr. 124, Prishtinë/Bruksel 1 mars 2002, f. ii.

⁶⁴⁸ Bülent Olcay: Kosova: From where to where?, në: Euroasian Studies, 17/2000, f. 16.

⁶⁴⁹ Kosova ishte e përfaqësuar „barasvlefshëm” si republikat në rrafshin federativ ashtu edhe në një mënyrë të caktuar në organet shtetërore të Republikës së Serbisë.

„Përveç kësaj shtetet perëndimore vetë, qysh gjatë njohjes së shteteve pasardhëse të Jugosllavisë së dikurshme, kanë pranuar një ndryshim të gjerë të kufijve në Evropë, madje kundër vullnetit të Beogradit. Fundja një arsytim edhe më tej i pranueshëm sipas të drejtës ndërkombëtare për mosnjohjen e një pavarësie të Kosovës nuk është aq i pakundërshtueshëm.”⁶⁵⁰

Për dallim nga argumentet e R. BIERMANN dhe N. RONZITTI, hulumtuesi i paqes Bruno SCHOCH përfaqëson një *„qasje çintegruese”*, e cila bazohet mbi vijën e argumentimit etno-nacionalist të një teorie të efektit domino. B. SCHOCH na përkujton së pari idenë fillestare të të drejtës së vetëvendosjes: „E drejta e vetëvendosjes është për t’u kuptuar në radhë të parë në aspektin republikano-qtetar, që edhe ashtu është thelbi i saj fillestar, derisa ngushtohet etnikisht sa të mos dallohet dhe përmes kësaj shtrembërohet.”⁶⁵¹ Mirëpo, në rastin e rajonit të Ballkanit Perëndimor, ai në thelb argumenton pikërisht me të kundërtën, kur shkruan:

„Një Kosovë e pavarur – pse pa shqiptarët në Serbinë Jugore dhe në Maqedoni? Një Mal i Zi i pavarur me rrafsh 650.000 banorë – si mund t’u mohohet pastaj dy milionë kosovarëve shteti i tyre? Në qoftë se Perëndimi pranoi që të ndryshojë përbërja territoriale e Jugosllavisë së mbetur – si mund të insistojë atëherë për Dejtonin, që serbëve dhe kroatëve të Bosnjës u ndalon secesionin dhe bashkimin me „vendin amë” të tyre?”⁶⁵²

Megjithatë, në përgjithësi pranohet, edhe nga kundërshtarët e pavarësisë së Kosovës si B. SCHOCH, që shtetësia paraqet kushtin paraprak për rrethana demokratike dhe që pa monopol të pushtetit dhe pa pushtet funksionues ekzekutiv, judikativ dhe legjislativ nuk mund të ketë siguri dhe prandaj as demokraci, shoqëri

⁶⁵⁰ R. Biermann: Der künftige Status Kosovos. Vorbereitung auf das Unvermeidliche [Statusi i ardhshëm i Kosovës. Përgatitja për të pashmangshmen], në: Internationale Politik – Europa Archiv 9/2000, f. 54. Eksperti i të drejtës ndërkombëtare Natalino Ronzitti jep sqarime të ngjashme dhe shprehet njëkohësisht në rastin e Kosovës për përdorimin e parimit uti possidetis: „Parimi i integritetit territorial mund të luajë gjithashtu një rol, në qoftë se duhet të parashihet pavarësia e Kosovës. [...] Parimi i uti possidetis, sipas të cilit kufijtë e subjektit të ri janë ato që ekzistonin në kohën para pavarësisë, lur entiteti ishte një krahinë e thjeshtë brenda një shteti, duhet të vjenë në konsideratë.” Natalino Ronzitti: Options for Kosovo’s Final Status, në: The International Spectator, prill – qershor 2/2000, f. 106.

⁶⁵¹ Bruno Schoch: Gegen weitere staatliche Zersplitterung. Plädoyer für multinationale Vielfalt in Belgrad, Podgorica und Pristina [Kundër copëtimin të mëtejshëm shtetëror. Shprehje për shumëllojshmëri shumëkombëtare në Beograd, Podgoricë dhe Prishtinë], Hessische Stiftung Friedens- und Konfliktforschung HSFK-Report 2/2003, f. 3.

⁶⁵² Po aty, f. 4. Autorë të tjerë argumentojnë se pavarësia e Kosovës nuk do të duhej të kishte si pasojë efektin domino: „Gjatë aplikimit universal të parimeve bazë, BE-ja nuk duhet t’i frikësohet ndonjë efekti domino, në qoftë se Kosova duhet të marrë pavarësinë [sic].” Dimitrios Triantaphyllou, në: What status for Kosovo?, Chaillot Paper 50, Institute for Security Studies of Western European Union, Paris 2001, f. 102 (gjendet në faqen: <http://www.iss-eu.org/chaillot/chai50e.html>).

civile e zhvillim ekonomik. Meqë administrimi ndërkombëtar paraqet një fazë të përkohshme, do të duhej, sipas mendimit tim, në radhë të parë të bëhet fjalë për *shtetndërtimin* në Kosovë dhe vetëm mandej edhe për *krijimin e kombit*. Vija argumentuese e B. SCHOCH është e pavlefshme lidhur me çështjen e statusit të Kosovës, sepse „ligji më i lartë”⁶⁵³ në Kosovë bazohet për dallim nga supozimet e B. SCHOCH në qasjen e *demos-it* dhe jo në qasjen e *ethnos-it*.⁶⁵⁴

Për dallim nga B. SCHOCH, lidhur me çështjen e statusit H. RIEGLER përfaqëson një *„qasje integruese”*:

„Sa kohë Beogradi nuk e ndryshon pozitën e vet kundrejt Kosovës, do të ketë pak shpresa për një stabilizim politik. [...] Në Kosovë serbët e Kosovës duhet ta pranojnë si realitet Kosovën me shumicë etnike shqiptare dhe përgjegjësinë e tyre për shtypjen e dhjetëvjeçarit të fundit, si dhe të distancohen nga planet e një riintegrimi serb të Kosovës, ndërsa shqiptarët e Kosovës duhet ta nxisin shumë më energjikisht sesa deri më tani integrimin e pakicës serbe në një komb politik të Kosovës dhe do të duhej të reflektonin se pavarësia e tyre politike mund të jetë vetëm një, duke i përfshirë pakicat e tyre.”⁶⁵⁵

Këto dy qasje diametralisht të kundërta me një efekt të *ekskluzionit*, përkatësisht *inkluzionit*, pasqyrojnë si debatin shkencor rreth qasjeve të mundshme të zgjidhjes së çështjes së Kosovës’ ashtu edhe përpjekjet politike, qofshin ato nga radhët e partive politike në rajonin e Ballkanit Perëndimor ose nga radhët e bashkësisë ndërkombëtare.

Nëse këto qasje nuk merren parasysh dhe tentohet të merren në shqyrtim mendime të tjera, p.sh. nga politika e sigurisë, atëherë nuk mbetet gati fare hapësirë manovruese për ta shmangur njohjen e pavarësisë së Kosovës, sepse „diçka përtej një të ardhmeje joshtetërore të Kosovës nënkupton angazhime më të mëdha dhe më të rënda të sigurisë ndërkombëtare.”⁶⁵⁶

Për hulumtuesin e Evropës Lindore dhe Juglindore Wim van MEURS pavarësia e Kosovës dhe e Malit të Zi janë në përputhje me qëndrimin aktual të bashkësisë ndërkombëtare, sa kohë që janë rezultat i një procesi të drejtë negociator dhe sa kohë

⁶⁵³ Rregullorja nr. 2001/9 e UNMIK-ut nga 15 maji 2001 për Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme.

⁶⁵⁴ Krah. A. Hajrullahu, M. Salamun: Der Verfassungsrahmen für die Provisorische Selbstverwaltung in Kosova [Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë], në: Südosteuropa 1-3/2002, f. 131.

⁶⁵⁵ H. Riegler: Internationale Protektorate als Modelle zur Stabilisierung von Nachkriegsgebieten im ehemaligen Jugoslawien: Bosnien-Herzegowina und Kosovo im Vergleich [Protektoratet ndërkombëtare si modele për stabilizimin e territoreve të pasluftës në Jugosllavinë e dikurshme: Bosnja-Hercegovina dhe Kosova në krahasim], në: Österreichisches Handbuch für Internationale Politik, Vjenë 2000, f. 163.

⁶⁵⁶ Daniel N. Nelson: Kosovo Futures, Western Dilemmas, në: The International Spectator 2/2002, f. 17.

të respektohen kufijtë ekzistues (d.m.th. të mos ndërmerren ndryshime gjeografike të kufirit, por vetëm ndryshime të statusit të kufirit).⁶⁵⁷ Këtu lind pyetja se a mund ta arrijë Serbia pjekurinë politike për të nisur një proces të drejtë negociues, në qoftë se merren parasysh qëndrimet deri më tani të ngurta të disa aktorëve të bashkësisë ndërkombëtare përballë pavarësisë së pari të Malit të Zi e aktualisht edhe të Kosovës. Përvojat e deritashme tregojnë se shoqëria serbe nuk mund ta shprehë fuqinë për ta çliruar veten nga *mentaliteti i mitit të Kosovës*. Citati vijues nga ICG-ja jep një pamje të asaj se si perceptohet Kosova në Serbi.

„Situata në Beograd është po aq e qartë. [...] është e lehtë për të gjetur politikanë të DOS-it të gatshëm që të pranojnë privatisht se Kosova është e humbur [...] është politikisht e pamundshme për ta që të thonë kështu publikisht. Disponimi popullor, ende jo në gjendje ose jo i gatshëm ta pranojë natyrën dhe shkallën e diskriminimit dhe persekutimit kundër shqiptarëve të Kosovës që e çoi NATO-n të ndërhyjë, është me shumicë dërrmuese kundër pavarësisë.”⁶⁵⁸

Zërat nga Serbia që flasin lirshëm dhe hapur për Kosovën, janë të rrallë. Avokati për të drejtat e njeriut Aleksandar LOJPUR përmend tri grupe interesi që nuk e duan pavarësinë e Kosovës: 1. mafia lokale në Kosovë; 2. „industria e ndihmave” që është e ndërlikuar dhe udhëhiqet nga burokratët e paguar mirë, të interesuar që zgjidhja e çështjes së statusit të Kosovës të shtyhet në pafundësi, dhe 3. mafia në Serbi që fshihet nën mantelin e patriotizmit. Fundja ai konstaton se rajonit nuk i duhen burokratë perëndimorë, por firma perëndimore si Siemens, Ford dhe Philips.⁶⁵⁹

Një çlirim i Serbisë nga trauma e *mitit të Kosovës*, e cila, sipas mendimit tim, mund të arrihet përmes njohjes së Kosovës nga ana e Serbisë si partner i barasvlershëm, pra si shtet i pavarur, do të duhej bërë edhe objektiv i bashkësisë ndërkombëtare dhe sidomos i BE-së, në qoftë se dëshirojnë të krijojnë paqe afatgjate në rajon.⁶⁶⁰

⁶⁵⁷ Krah. W. van Meurs: Der Balkan am Verhandlungstisch [Ballkani në tavolinën e negociatave], në: Europäische Rundschau, 1/2002, f. 62.

⁶⁵⁸ ICG, After Milosevic. A Practical Agenda for Lasting Balkans Peace, Balkans Report Nr. 108, Bruksel 1 prill 2001, f. 121.

⁶⁵⁹ Krah. Aleksandar Lojpur: Prihvatiti neminovnost [Të pranosh të pashmangshmen], në: Politika, 23 qershor 2003.

⁶⁶⁰ Ngjashëm u rekomandon për shembull ICG-ja të gjithë aktorëve të involvuar: „Serbia dhe bashkësia ndërkombëtare duhet të pranojnë se sqarimi i hershëm i strukturës ligjore dhe kushtetuese të RFJ-së dhe statusi final i Malit të Zi dhe i Kosovës është në interesin më të mirë të të gjitha palëve.” ICG, After Milosevic. A Practical Agenda for Lasting Balkans Peace, Balkans Report Nr. 108, Bruksel 1 prill 2001, f. 60.

1. Skicë e gjendjes kushtetuese të Kosovës nën administrimin ndërkombëtar

Pas vendosjes së administratës së UNMIK-ut në qershor 1999 dhe si pasojë e Marrëveshjes për Krijimin e Strukturës së Përbashkët të Përkohshme Administrative (*Joint Interim Administration Structure, JIAS*) të arritur në fund të vitit 1999 midis institucioneve kosovare dhe institucioneve të UNMIK-ut, si dhe si pasojë e mbajtjes së zgjedhjeve komunale në tetor 2000, u pa si i pashmangshëm krijimi i një kornize ligjore për mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme në Kosovë. Para mbajtjes së zgjedhjeve të përgjithshme duhej fillimisht të përcaktoheshin kompetencat dhe funksionet e institucioneve vetëqeverisëse që duheshin zgjedhur, ashtu që të mund të kryhej bartja e pushtetit të institucionet e zgjedhura kosovare, siç parashihej në Rezolutën e OKB-së 1244 (1999).

Serbia, përkatësisht RFJ-ja e *Milošević*-it, me mbështetjen e Ruisë tentoi të pengonte miratimin e një baze të tillë juridike në rrafshin ndërkombëtar, sepse ajo aty shihte një hap të mëtejshëm drejt pavarësisht të Kosovës.

Prapëseprapë, në prill 2001 një ekip i ekspertëve kushtetues të angazhuar nga OKB-ja bashkë me ekspertët kosovarë të tri partive, përkatësisht grupimeve më të mëdha politike si dhe të shoqërisë civile në Kosovë, nisi punën për një kornizë të tillë juridike. Ndërsa përfaqësuesi i pakicës serbe në Kosovë fillimisht bojkotoi punën e këtij ekipi të ekspertëve kushtetues, pak para aprovimit megjithatë mori pjesë në punime. Edhe përfaqësuesit e pakicave të tjera etnike në Kosovë ishin të përfshirë në këtë proces.

Edhe pse përfshirja e popullatës së Kosovës ishte paraparë përmes një diskutimi shoqëror mundësisht të gjerë, prapëseprapë hartimi i kornizës juridike u mbajt vetëm në një rreth të vogël ekspertësh. Sipas medieve në ekipin e ekspertëve pikat vijuese ishin diskutuar në mënyrë të nxehtë: së pari emërtimi i kornizës juridike shkaktoi diskutim të gjallë. Kosovarët insistonin në përdorimin e nocionit *kushtetutë* në vend të *rregullore*. Këtë e argumentonin me pohimin se Kosova qysh më herët kishte një kushtetutë të veten (1974, 1990). Në fund dokumenti u cilësua „*Kornizë Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme*” (*Constitutional Framework for Provisional Self-Government*). Pika të tjera diskutabile ishin p.sh. përcaktimi i një referendumi lidhur me statusin përfundimtar të Kosovës, çështja e një gjykate kushtetuese për Kosovën, definimi i rolit, përkatësisht ankorimi kushtetues i TMK-së, e të ngjashme. Në fund, Korniza Kushtetuese u nënshkrua më 15 maj 2001 nga PSSP-ja, danezi Hans HAEKKERUP, dhe përmes kësaj hyri në fuqi.

Një „Kornizë Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë”⁶⁶¹ që bazohet në Rezolutën e OKB-së 1244 (1999), që nga maji 2001 paraqet

⁶⁶¹ Rregullorja nr. 2001/9 e UNMIK-ut nga 15 maji 2001 për Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme. Më hollësisht rreth kësaj krah. A. Hajrullahu, M. Salamun: Der Verfassungsrahmen für die Provisorische Selbstverwaltung in Kosova [Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë], në: Südosteuropa 1-3/2002, f. 122-50.

„Kushtetutën”⁶⁶² e Kosovës.⁶⁶³ Korniza Kushtetuese mundëson bartjen e rregulluar të autorizimeve të IPVQ-ja, e krijuar kjo pas zgjedhjeve të para parlamentare të nëntorit 2001.

Njëra prej kompetencave të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes është harmonizimi i legjislacionit përkitazi me standardet dhe normat evropiane e ndërkombëtare, respektimi i të cilave do të ketë rëndësi qendrore *për zhvillimin e marrëdhënieve me komunitetin euroatlantik* (kreu 5.7). Ky formulim mund të interpretohet si sinjal për një integrim të ardhshëm të Kosovës në BE dhe në NATO.

Sa i përket të drejtave themelore, në Kornizën Kushtetuese (Kreu 3.2) numërohen instrumentet ndërkombëtarisht të pranuar për të drejtat dhe për liritë themelore të njeriut ⁶⁶⁴, për respektimin dhe sigurimin e të cilave obligohet IPVQ-ja. Dispozitat e tyre janë *drejtpërdrejt* të aplikueshme si pjesë e Kornizës Kushtetuese.

Koncepti i popullit në kuadër kushtetues *nuk* i përshtatet konceptit *etnik* të popullit, por atij të *popullit shtetëror*. Që koncepti i popullit sipas kritereve politike konstituohet si *demos*, e jo sipas kritereve etnike si *ethnos*, bëhet e qartë para së gjithash nga fakti se përdoret zakonisht termi *popull (people)* dhe ndërmerret një diferencim midis komuniteteve të ndryshme etnike vetëm në dispozitat rreth të drejtave të grupeve etnike dhe rreth masave pozitiveisht diskriminuese lidhur me participimin politik të grupeve etnike. Megjithatë, edhe në vetë këtë pikë gjendet termi neutral *komunitete (communities)*, i cili i referohet edhe grupit kosovar shqipfolës.

⁶⁶² Që Korniza Kushtetuese nuk paraqet kushtetutën në kuptimin tradicional, e qartëson emërtimi i saj si kornizë kushtetuese si dhe referimi në preambulë të Rezoluta 1244, e cila deri diku si e drejtë më e lartë deri në përcaktimin e statusit përfundimtar krijon bazën sipas të drejtës ndërkombëtare të kornizës kushtetuese.

⁶⁶³ Kosova paraqet një „shtet” qendror me administratë të decentralizuar lokale në formë të komunave (anglisht „municipalities”, serbisht „opštine”), të cilat krijojnë njësitë themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale. Më shumë rreth vetëqeverisjes lokale në Kosovë krah. Axel Schwarz: Der Aufbau einer kommunalen Selbstverwaltung im Kosovo [Struktura e një vetëqeverisjeje komunale në Kosovë], në: Osteuropa Recht, 2/2002, f. 123-34. Kompetencat e komunave janë të përcaktuara në ligjet e vlefshme të UNMIK-ut për vetëqeverisjen lokale dhe komunat. Krah. p.sh. Rregulloren nr. 2000/9 të UNMIK-ut nga 3 marsi 2000, mbi Themelimin e Departamentit Administrativ të Administratës Lokale dhe Rregulloren nr. 2000/45 të UNMIK-ut, dt. 11 gusht 2000, mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë.

⁶⁶⁴ Karta e Kombeve të Bashkuara, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut; Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike të Njeriut dhe protokollet e saj; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; Konventa për të Drejtat e Fëmijëve; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe protokollet e saj; Karta Evropiane e Gjuhëve Rajonale dhe Minoritare; Kornizën e Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare si dhe parime të tjera relevante në instrumentet juridike të pranuar ndërkombëtarisht.

2. Perceptimet kosovare të qasjes „Standardet para statusit”

Diplomati gjerman Michael STEINER, që ushtronte funksionin e PSSP-së, e plasoi formulën „standardet para statusit” në pranverë 2002. U hartua një listë me pesë „benchmarks” (standarde), të cilat përcaktonin kërkesat minimale për fillimin e bisedave rreth çështjes së statusit të Kosovës: institucione demokratike funksionale, sundimi i ligjit, liria e lëvizjes, kthimi dhe integrimi i të zhvendosurve, reformat ekonomike, të drejtat pronësore, dialogu me Beogradin dhe reforma e TMK-së.

Elitat vendore politike në Kosovë e panë qasjen „standardet para statusit” më shumë si një pengesë në rrugën drejt pavarësisë së Kosovës sesa si një numërim të masave reformuese që kërkoheshin deri atëherë. Kosovarët e kritikuan qasjen „standardet para statusit” kështu: këto standarde mund të jenë të sakta, sepse për integrimin në strukturat euro-atlantike, Kosova patjetër duhet të bëhet shtet në të cilin sundon ligji. Mirëpo, standardet e përcaktuara nga PSSP-ja qenkan të paarrtshme nga ana e institucioneve kosovare për shkak të mungesës së kompetencave të pushtetit: një përmbushje e kënaqshme e standardeve që gati pa përjashtim u quajtën të mira nga e tërë bashkësia ndërkombëtare, qenka e pamundshme pikërisht për shkak të çështjes së statusit të pazgjidhur.

Elitat vendore u angazhua që paralelisht me standardet të zgjidhej edhe çështja e statusit, gati sipas motos „standardet me statusin”.⁶⁶⁵ Ngjashëm si *Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën*,⁶⁶⁶ i cili propozon një të ashtuquajtur „pavarësi të kushtëzuar”⁶⁶⁷, shumë kosovarë shprehen për idenë e një „pavarësie plus

⁶⁶⁵ Krah. B. Reka: UNMIK as an international governance in post-war Kosovo: NATO’s Intervention, UN Administration and Kosovar Aspirations, Shkup etj. 2003, f. 323.

⁶⁶⁶ Në kuadër të një komisioni ndërkombëtar të ekspertëve të pavarur, të iniciuar më 6 gusht 1999 nga kryeministri suedez, Göran Persson, i ashtuquajtur Komisioni Goldstone, i cili fillimisht në tetor 2000 i propozoi OKB-së mundësitë e para të zgjidhjes për konfliktin e Kosovës, kryesuesi i komisionit, gjyqtari kushtetues afrikanojugor Richard Goldstone, si dhe anëtarët e komisionit nga vende të shumta si Benini, Britania e Madhe, Kanadaja, Çekia, Franca, Gjermania, Japonia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës propozuan „pavarësinë e kushtëzuar” për Kosovën: „Pavarësia e kushtëzuar është edhe cak por edhe proces. Caku është sovraniteti dhe pavarësia për popullin e Kosovës, brenda kufijve të caktuar nga bashkësia ndërkombëtare – kjo është kusht që Kosova të respektojë integritetin territorial të fqinjëve të saj, të ruajë paqen e brendshme dhe të respektojë të drejtat e njeriut dhe të sigurojë mbrojtjen e traditave dhe të institucioneve të komunitetit pakicë”, në: Independent International Commission on Kosovo: The Follow-Up. Why Conditional Independence?, Stokholm shtator 2001. Ky raport konfirmon raportin e parë që u hartua më 2000 pas ndërrimit të pushtetit në Beograd (në formë libri: The Kosovo Report: Conflict, International Response, Lessons Learned, Oksford 2000. Krah. edhe Richard J. Goldstone: Whither Kosovo? Whither Democracy?, në: Global Governance 8/2002, f. 143-7.

⁶⁶⁷ Politologu F. Bieber është i mendimit që „Aspektet e kësaj qasjeje kanë gjetur jehonë në qasjen „standardet para statusit”. F. Bieber: What Final Status is Possible for Kosovo? Plans and Their Critiques, në: European Balkan Observer, Belgrade Centre for European Integration and Vienna Institute for International Economic Studies, vëll. 2, Nr. 1, maj 2004, f. 17.

protektorat”.⁶⁶⁸ Për këtë model të zgjidhjes shprehet edhe ICG-ja: „*Më i përshtatshmi nga opsionet për statusin e Kosovës, siç është përcaktuar në një zgjidhje përfundimtare politike, mund të jetë „pavarësia e kushtëzuar”*.”⁶⁶⁹

Në një seri letrash drejtuar M. STEINER-it, V. SURROI kritikon ashpër qasjen e tij për „*standardet para statusit*”. Për V. SURROI-n udhëzimi i M. STEINER-it për politikanët kosovarë se Këshilli i Sigurimit i OKB-së qenka instanca e fundit për vendimin rreth statusit të Kosovës, nuk ka asnjë bazë juridike. Këshilli i Sigurimit i OKB-së sipas Rezolutës së OKB-së 1244 (1999) sipas V. SURROI-t është kompetent për organizimin formal të përcaktimit të statusit⁶⁷⁰, por jo për përcaktimin e çështjes së statusit të Kosovës.⁶⁷¹

Fakt është që procesi i zgjidhjes së çështjes së statusit të Kosovës implikon aktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Kështu konstaton p.sh. C. BILDt: „Nuk do të ketë paqe të qëndrueshme në rajon deri atëherë kur një marrëveshje politike për këtë hapësirë të jetë pranuar nga njerëzit në Kosovë, nga të gjitha vendet e rajonit, përfshirë edhe Serbinë, dhe nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së.”⁶⁷² Rezoluta e OKB-së 1244 (1999) nuk përjashton pavarësinë e Kosovës, edhe pse autorë si p.sh. hulumtuesi në çështjet ndërkombëtare të politikës së sigurisë Alexandros YANNIS Rezolutën e OKB-së 1244 (1999) e quan „*aksident të historisë*”.⁶⁷³ Disa autorë e nxjerrin madje të drejtën për

⁶⁶⁸ Krah. p.sh. pozitën përkatëse të deputetes kosovare Edita Tahiri, në: A. Ernst: „Standards vor Status!” – Die Doktrin der UNO-Mission in Kosovo führt in die Sackgasse [„Standardet para statusit!” – Doktrina e misionit të OKB-së në Kosovë çon në qorrsoak], në: Südosteuropa 7-9/2002, f. 363.

⁶⁶⁹ ICG, After Milosevic. A Practical Agenda for Lasting Balkans Peace, Balkans Report Nr. 108, Bruksel 1 prill 2001, f. 130; Për propozime të ndryshme të zgjidhjes së çështjes së statusit të Kosovës krah. edhe ICG, A Kosovo Roadmap (I) Addressing Final Status, Balkans Report Nr. 124, Prishtinë/Bruksel 1 mars 2002, f. 9 vv. Edhe në një raport të botuar më vonë ICG-ja përsërit idenë e një „pavarësie të kushtëzuar” si opsionin më real: „Pas shqyrtimit të përparësive relative të të gjitha opsioneve të ndryshme për Kosovën, ICG ka arritur në përfundim se pavarësia e kushtëzuar është zgjidhja më reale. Në qoftë se miratohet, kjo do të thotë se pranohet që Kosova nuk do të mbetet pjesë e Serbisë apo e RFJ-së dhe ajo do të gëzojë një nivel më të lartë të vetëqeverisjes, kurse ajo do të përpiqet për t’i përmbushur të gjitha standardet e paramenduara për sovranitetin e plotë.” International Crisis Group (ICG), A Kosovo Roadmap (II) Internal Benchmarks, Balkans Report No. 125, Prishtinë/Bruksel 1 mars 2002, f. 22 v (<http://www.crisisweb.org>).

⁶⁷⁰ Me ç’rast do të duhej të merrej parasysh Marrëveshja e Rambujesë. Bazën e negociatave për Marrëveshjen e Rambujesë e krijonte një draft autonomie i aprovuar nga Grupi i Kontaktit për Ballkanin. Krah. Contact Group Non-Negotiable Principles / Basic Elements nga 22 janari 1999, arkiva e Petritsch, në: Wolfgang Petritsch etj.: Kosovo Kosova, Mythen Daten Fakten [Kosova, mite, data, fakte], Klagenfurt etj. 1999, f. 265 v.

⁶⁷¹ Krah. Veton Surroi: Vdekja e kësaj (mos) qeverisje. Fillimi i shekullit: Letër Kërshëndellash për Michael Steinerin (5), në: Koha Ditore, 22 dhjetor 2002.

⁶⁷² C. Bildt: A Second Chance in the Balkans, në: Foreign Affairs, vëll. 80, janar/shkurt 2001, f. 154.

⁶⁷³ „Megjithatë, Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së që themeloi administratën ndërkombëtare në Kosovë, është në një masë të caktuar edhe një aksident i historisë.” Alexandros Yannis: The Creation and Politics of International protectorates in the Balkans:

vetëvendosje të kosovarëve nga Rezoluta e OKB-së 1244 (1999): „Në qoftë se popullsia e Kosovës është një popull [674], siç përmendet në Rezolutën 1244, dhe jo pakicë e thjeshtë, atëherë ajo është titullare e të një drejte për vetëvendosje.”⁶⁷⁵

Qasja „*standardet para statusit*”, në procesin e demokratizimit të Kosovës u dëshmuua si e suksesshme vetëm me kufizime. Vetë M. STEINER, i cili vlen si nismëtar i kësaj qasjeje, sqaroi në lidhje me çështjen e statusit qysh gjatë mandatit të tij si PSSP në një fjalim më 12 dhjetor 2002 në Universitetin Humboldt të Berlinit: „Përfytyrimi i mëparshëm se për këtë kemi ende shumë vjet kohë, është [...] i tejkaluar”.⁶⁷⁶

Pasardhësi i M. STEINER-it, kryeministri i dikurshëm finlandez Harri HOKKERI, e dalloj shpejt qorrsokakun, në të cilin do ta çonte Kosovën interpretimi fanatik i formulës „*standardet para statusit*”. Pas bisedave intensive me institucionet dhe përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare dhe në bashkëpunim me institucionet kosovare, ai më 10 dhjetor 2003 në Prishtinë, bashkë me presidentin I. RUGOVA dhe me kryeministrin B. REXHEPI prezantoi një plan për operacionalizimin e standardeve. Ky plan nuk përdorte më formulën „*standardet para statusit*”, por quhej „*standardet për Kosovën*”.⁶⁷⁷ Në përmbajtje, ky plan bazohet në qasjen „*standardet para statusit*” dhe nuk paraqet asnjë risi.⁶⁷⁸

Bridges Over Troubled Waters, në: Journal of International Relations and Development, 5, 3/2002, f. 265 v.

⁶⁷⁴ N. Ronzitti, Options for Kosovo's Final Status, në: The International Spectator, prill – qershor 2/2000, f. 111, i referohet në këtë rast nenit 10 të Rezolutës së OKB-së 1244 (1999), ku thuhet fjalë për fjalë: „10. Autorizon Sekretarin e Përgjithshëm, që me ndihmën e organizatave ndërkombëtare përkatëse të krijojë një forcë ndërkombëtare civile në Kosovë, në mënyrë që të vendoset një administratë e përkohshme për Kosovën, nën të cilën populli i Kosovës mund të gëzojë një autonomi substanciale brenda Republikës Federale të Jugosllavisë, dhe e cila do të kryejë administrimin e transicionit, ndërkohë që do të krijojë dhe do të mbikëqyrë zhvillimin e institucioneve demokratike të përkohshme të vetëqeverisjes për të krijuar kushtet për një jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët e Kosovës.” Termi „the people” këtu është megjithatë i dykuptimtë, sepse është një çështje e interpretimit se a është fjala këtu për popull („a people”) apo për njerëz („people”).

⁶⁷⁵ N. Ronzitti: Options for Kosovo's Final Status, në: The International Spectator, prill – qershor 2/2000, f. 111. Në krahasim me këtë për shembull edhe në raportin e tretë vjetor të Komisionit të Komuniteteve Evropiane rreth PSA-së përmendet shprehimisht „populli kosovar”. Kra. Bericht der Kommission der Europäischen Gemeinschaften. Der Stabilisierungs- und Assoziierungsprozess für Südosteuropa. Dritter Jahresbericht, (KOM (2004) 202 endgültig), [Raport i Komisionit të Komuniteteve Evropiane. Procesi i stabilizimit dhe asociimit për Evropën Juglindore. Raporti i tretë vjetor, (KOM (2004) 202 final)], Bruksel, më 30.03.2004, f. 43.

⁶⁷⁶ Cit. te A. Ernst: „Standards vor Status!” – Die Doktrin der UNO-Mission in Kosovo führt in die Sackgasse [„Standardet para statusit!” – Doktrina e misionit të OKB-së në Kosovë çon në qorrsokak], në: Südosteuropa 7-9/2002, f. 363.

⁶⁷⁷ Mund të gjendet në adresën: <http://www.unmikonline.org/press/2003/pressr/pr1078.pdf>

⁶⁷⁸ Kjo mund të lexohet qartë nga tetë krerët e numëruar në vijim, të cilët përputhen me tetë standardet. Ato janë: „I. Funkionimi i institucioneve demokratike; II. Sundimi i ligjit; III. Liria e lëvizjes; IV. Kthimet e qëndrueshme dhe të drejtat e komuniteteve dhe të pjesëtarëve

Më 31 mars 2004 në Prishtinë u prezantua një plan edhe më i detajuar për zbatimin e „standardeve për Kosovën” nën titullin „Plani për Implementimin e Standardeve për Kosovën”.⁶⁷⁹ Përparësia e këtij plani qëndron te një përshkrim më i qartë i objektivave që duhet të arrihen si dhe te participimi i plotë i institucioneve kosovare, prandaj shanset për zbatim u ngritën dukshëm. Riemërtimi i formulës „standardet para statusit” në „standardet për Kosovën” si dhe plani implementues që doli prej tij duhet të kuptohen si sinjale të qeverisë amerikane,⁶⁸⁰ e cila fillimin e bisedimeve për përcaktimin e statusit të Kosovës e vlerëson si të mundshëm, në qoftë se arrihen përparime të caktuara deri në mes të vitit 2005.

Pas trazirave të dhunshme nga 17 deri 19 mars 2004 në Kosovë, ambasadori norvegjez Kai EIDE publikoi në qershor 2004 një raport të porositur nga sekretari i përgjithshëm i OKB-së Kofi ANNAN, ku rekomandohet ndryshimi i strategjisë „standardet para statusit” në një politikë shumë më dinamike. Në këtë raport po ashtu theksohet që bartja e kompetencave te institucionet kosovare do të duhej të bëhej më shpejt dhe që çështja e statusit të pazgjdhur nuk mund të shtyhej më gjatë. K. EIDE rekomandon që të reduktohet fuqishëm prania e UNMIK-ut dhe të forcohet dimensionimi i BE-së. Një strategji e zhvillimit ekonomik dhe një prani e shtuar e BE-së janë, sipas K. EIDE-s, të nevojshme urgjentisht.⁶⁸¹

3. Aspekte ekonomike të konfliktit serbo-kosovar

Shkatërrimi i RSFJ-së zgjidhet shpesh si shembull për të kundërshtuar supozimin se tregtia dhe bashkëpunimi ekonomik pengojnë luftërat midis shteteve (federale).⁶⁸² Ky supozim është megjithatë jorelevant për Kosovën, sepse në kohën e RSFJ-së bashkëpunimi ekonomik i Kosovës me njësitë e tjera federale ishte fare dobët i theksuar.

BE-ja është përgjegjëse në Kosovë për shtyllën e katërt të administratës së UNMIK-ut për rindërtimin dhe për punët ekonomike dhe me këtë ka marrë përsipër për herë të parë edhe përgjegjësi të drejtpërdrejtë në këtë fushë jashtë kufijve të saj. Kosova ndodhet në një gjendje tejet të vështirë ekonomike, e cila sipas të gjitha gjasave nuk do të përjetojë përmirësime të shpejta për shkak të situatës socio-politike. Prandaj edhe sfida për BE-në në këtë fushë është po aq e madhe. Ekspertët

të tyre; V. Ekonomia; VI. Të drejtat pronësore; VII. Dialogu; VIII. Trupat Mbrojtëse të Kosovës”.

⁶⁷⁹ Mund të gjendet në adresën: http://www.unmikonline.org/pub/misc/ksip_eng.pdf

⁶⁸⁰ Për shembull përmes vizitës së nënsekretarit shtetëror për punë politike në Ministrinë e Jashtme të ShBA-ve Marc Grossman në nëntor 2003 në vendet e Ballkanit Perëndimor.

⁶⁸¹ Krah. raportin e ambasadorit norvegjez Kai Eide. Ky raport u publikua edhe të përditshmen kosovare Zëri më 13 dhe 14 gusht 2004, përkatësisht f. 4-6.

⁶⁸² Krah. A. Wittkowsky: Der Stabilitätspakt für Südosteuropa und die „führende Rolle” der Europäischen Union [Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore dhe „roli udhëheqës” i Bashkimit Evropian], në: Aus Politik und Zeitgeschichte. Beilage zur Wochenzeitung Das Parlament, 14 korrik 2000, f. 8.

ekonomikë kosovarë e bëjnë përgjegjëse për këtë gjendje në radhë të parë „çështjen e pazgjidhur të Kosovës” dhe shkatërrimin institucional e ekonomik pas vitit 1989.⁶⁸³

Jo rrallë përmendet edhe madhësia e Kosovës si një pengesë shtesë për zhvillimin ekonomik. Disa përpiqen që nga kjo madhësi të nxjerrin paaftësinë e Kosovës për të mbijetuar si shtet i pavarur. V. GLIGOROV argumenton kundër këtij supozimi:

„Së pari, madhësia e një ekonomie nuk është e rëndësishme për qëndrueshmërinë e saj, së paku në një botë të tregtisë së lirë dhe të demokracisë. [...] Një] shtet i vogël ose një zonë ekonomike si Kosova duhet të jetë i hapur, homogjen, demokratik, i përgjegjshëm dhe i vetëqeverisur.”⁶⁸⁴

Në qoftë se stabiliteti i gjerë në Kosovë dhe përreth Kosovës si dhe proceset e transformimit dhe të integritimit në BE do të duhej të merrnin një shans real, atëherë është i pashmangshëm përmirësimi i vazhdueshëm i gjendjes ekonomike.⁶⁸⁵ Në një raport të grupit të ekspertëve identifikohen vetëm dy perspektiva të ardhshme ekonomike për vendet e Ballkanit: aderimi në BE ose varfërimi nëse vazhdoen konfliktet.⁶⁸⁶ Ky konstatim është i saktë, sidomos në rastin e konfliktit serbo-kosovar, sepse çështja e statusit të pazgjidhur të Kosovës po bëhet gjithnjë e më

⁶⁸³ Krah. Muhamet Mustafa, Muhamet Sadiku: Economic aspect of regional cooperation and Kosova's issue, në: Democracy & Security. Kosova on the agenda. Albanian Institute for International Studies, Tiranë 1999, f. 126.

⁶⁸⁴ V. Gligorov: The Economics of Kosovo: Does Viability Matter?, në: The International Spectator, prill – qershor 2/2000, f. 101. Për aftësinë mbijetuese të ekonomisë kosovare V. Gligorov përmend dy kushte: „së pari, ajo duhet të jetë e integruar me ekonominë e rajonit të paktën në aspektin e tregtisë dhe të financimit; së dyti, ajo duhet të jetë një demokraci, pra një sistem i sovranitetit të popullit duhet të vihet në vend dhe institucionalisht e siguruar.” Po aty, f. 97.

⁶⁸⁵ Mirëpo, ESI i vlerëson gjasat e një rritjeje ekonomike si shumë të këqija: „UNMIK-u ka arritur në një pikë kritike në administrimin e Kosovës. Me donacionet ndërkombëtare të përcaktuara që të zvogëlohen ndjeshëm në vitin e ardhshëm dhe me vrullin e rindërtimit të pasluftës dhe bumit të strehimit që ka filluar të ngadalësohet, sektori privat i Kosovës ka nevojë urgjente për një regjim funksional të pronës në mënyrë që të zhvillohet më tutje.” European Stability Initiative (ESI), The Ottoman Dilemma. Power and Property Relations under the United Nations Mission in Kosovo. Lessons Learned and Analysis Unit of the European Union Pillar in Kosovo, Prishtinë 8 gusht 2002, f. 4 (mund të gjendet në adresën: www.esiweb.org).

⁶⁸⁶ Rreth kësaj në këtë raport thuhet fjalë për fjalë: „kombet e Ballkanit kanë vetëm dy zgjedhje për të ardhmen e tyre ekonomike. Ato mund të pranojnë perspektivën e asociimit formal ekonomik me Bashkimin Evropian, të lëvizin në mënyrë të qëndrueshme drejt standardeve të BE-së të qeverisjes dhe të performancës ekonomike dhe të hedhin themelet për pjesëmarrje të plotë në një Evropë të bashkuar dhe në një ekonomi të globalizuar botërore. Ose ato mund të ngjiten për modelin e vjetruara ekonomike dhe të vazhdojnë të lejojnë praktikën e kaluar të qeverisjes dhe konfliktet etnike t’ua përcaktojnë agjendat, duke e larguar veten kah marginat e varfria të Evropës.” E. C. Meyer etj.: Balkans 2010, Report of an Independent Task Force, Council on Foreign Relations/Centre for Preventive Action, Nju Jork 2002, f. 67.

shumë pengesë e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik,⁶⁸⁷ siç do të tregohet në vijim me disa shembuj.

Në Kosovë është krijuar një situatë absurde e ekonomisë së tregut, sepse konfliktet që duhet të zgjidhen vetëm politikisht, pengojnë veprimtaritë ekonomike. Çështja e pazgjidhur e statusit të Kosovës tërheq me vete një tufë pasojash negative për ekonominë: ajo pengon procesin e privatizimit, eksportet dhe investimet e huaja.⁶⁸⁸ Edhe pse në shtator 2000 Komisioni i Komuniteteve Evropiane në vazhden e strategjive të stabilizimit dhe të integritimit vendosi preferenca të njëanshme tregtare për vendet e Ballkanit Perëndimor,⁶⁸⁹ kjo Kosovës nuk i solli gati asnjë dobi. Për shembull, edhe më tej verërat ose tekstilet kosovare nuk mund të eksportoheshin në BE dhe në shtetet e tjera, sepse nuk mund të gjendej asnjë zgjidhje për emërtimin e origjinës së prodhimeve. Për kosovarët është e papranueshme që produktet e Kosovës të eksportohen si produkte me origjinë serbe, ndërsa BE-ja dhe shtetet e tjera nuk pranojnë produkte me emërtimin „Made in Kosova”.⁶⁹⁰ Aktivitete të tjera të ndryshme ekonomike të firmave kosovare si pjesëmarrja në panaire ndërkombëtare vuajnë edhe nga mungesa e zgjidhjeve politike.

⁶⁸⁷ Argumente të ngjashme jep edhe V. Gligorov: „Nuk ka asnjë rregull që thotë se një protektorat nuk mund të jetë ekonomikisht i qëndrueshëm, por shanset në këtë rast janë mjaft të pafavorshme.” V. Gligorov: *The Economics of Kosovo: Does Viability Matter?*, në: *The International Spectator*, prill – qershor 2/2000, f. 98.

⁶⁸⁸ M. Steiner definoi çështjen pronësore me të drejtë si objektiv prioritar. Në një ligjëratë në Universitetin e Prishtinës ai tha në prill 2002: „qëllimi më urgjent është vendosja e pronësisë së qartë. Titulli i qartë ligjor është bazë për zhvillimin ekonomik dhe për sundimin e ligjit.” Michael Steiner, *Address at the University of Pristina*, 18 prill 2002, cit. te ESI, *The Ottoman Dilemma. Power and Property Relations under the United Nations Mission in Kosovo. Lessons Learned and Analysis Unit of the European Union Pillar in Kosovo*, Prishtinë 8 gusht 2002, f. 25. Mirëpo, deri më sot mund të bëhej vetëm pak gjë për zgjidhjen e këtyre problemeve, me ç'rast edhe një herë si pengesë vendimtare paraqitet çështja e statusit të pazgjidhur.

⁶⁸⁹ European Union, *Council Regulation 2007 Exceptional Trade Measures for Countries in Transition for Countries or Territories Participating in or Linked to the European Union's Stabilisation and Association Process*, 23. September 2000, OJ L 240, 23.09.2000, f. 1. Kjo rregullore u ndryshua edhe një herë, kështu p.sh. pas ndërrimit të regjimit në nëntor 2002 në Serbi, ajo u zgjerua edhe për Serbinë. Krah. European Union, *Council Regulation 2563*, 29 nëntor 2000.

Informata më të hollësishme rreth ndihmave financiare për vendet e treta përmban në mënyrë të përsëritur raporti vjetor i Komisionit të Komuniteteve Evropiane për Këshillin Evropian dhe për Parlamentin Evropian (raporti vjetor 2002 gjendet në faqen: http://ec.europa.eu/economy_finance/publications/external_relations/macrofinancial_en.htm).

⁶⁹⁰ Krah. ICG, *Kosovo, a Strategy for Economic Development*, Balkans Report No. 123, Prishtinë/Bruksel 19 dhjetor 2001, f. 6. Vetëm pas një shtyrjeje të gjatë andej-këndej ndërkohë u gjet një zgjidhje e përkohshme për disa produkte. Për shembull, prejardhja e verës Amsfelder që tradicionalisht shitet në Gjermani është e etiketuar si vijon: „Kosovë/RFJ* *Sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara Kosova qëndron nën administrimin e përkohshëm të Kombeve të Bashkuara”.

Krahas kushteve politike aktualisht të pavolitshme, edhe „paqartësitë” financiare nga epoka e RSFJ-së e rëndojnë procesin e përcaktimit të statusit të Kosovës dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Sipas të dhënave qeveritare serbe, Serbia duhet t’i paguajë borxhet e jashtme të Kosovës, të cilat arrijnë mes 1,2 – 1,9 miliardë dollarë amerikanë.⁶⁹¹ Politikanët kosovarë e refuzojnë këtë. „Marrja përsipër e borxheve” është bërë një kontest i pazakonshëm mes Serbisë dhe Kosovës. Është për t’u konkluduar se Kosova ishte një kredimarrës i pavarur nga Serbia brenda RSFJ-së. Kur Kosova merrte kredi, ato aprovoheshin në një anë nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe në tjetrën nga parlamenti federativ (por jo nga ai serb). Ngaqë RSFJ më nuk ekziston, mund të nxirret konkluzioni se te institucionet financiare ndërkombëtare për këto borxhe duhet të përgjigjet vetë Kosova dhe jo ndonjë anëtar tjetër i federatës së shpërbërë.⁶⁹² Kontesti midis Serbisë dhe Kosovës për „marrjen përsipër të borxheve” mund të duket absurd në shikim të parë, sepse në rastin normal askush nuk do të kishte kundërshtime, në qoftë se borxhet do të merreshin përsipër nga një palë tjetër. Mirëpo, në këtë rast Serbia synon një „letër të pastër” ndaj Kosovës dhe tenton të fitojë kapital politik për përcaktimin e çështjes së statusit të Kosovës. Serbia insiston në obligimin e saj që t’i shlyejë borxhet e Kosovës, sepse sipas Rezolutës së OKB-së 1244 (1999) Kosova i takoka Serbisë. Përmes kësaj Serbia ushtron presion te institucionet financiare ndërkombëtare edhe lidhur me borxhet e veta financiare, edhe pse që nga ndërrimi i pushtetit më 2000 në Beograd u përmirësuan marrëdhëniet e Serbisë ndaj organizatave ndërkombëtare financiare.⁶⁹³

Ekspertët ndërkombëtarë rekomandojnë që të pezullohet grindja rreth „marrjes përsipër të borxheve” dhe të lihet të luajë faktori kohë,⁶⁹⁴ një rekomandim ky që u respektua nga institucionet ndërkombëtare financiare.

⁶⁹¹ Shumën e kredive të pranuar pa kamatë kosovarët e japin me mbi 800 milionë, me kamatë si 1 deri 1,2 miliardë dollarë amerikanë.

⁶⁹² Sipas nenit 271 të Kushtetutës federative të RSFJ-së nga viti 1974, Kosova kishte të drejtën që njëjtë sikur republikat e tjera të lidhte marrëveshje ndërkombëtare për fusha të caktuara. Kështu për shembull Kosova lidhi një marrëveshje me ish-Republikën Demokratike të Gjermanisë si dhe një tjetër me Bankën Botërore. Tekstet e këtyre marrëveshjeve janë të publikuara në: Gazeta Zyrtare e Kosovës Nr. 12/1972, 3/1977 dhe 34/1978. Krahi Hajredin Kuqi: Disa aspekte të së drejtës për vetëvendosje të Kosovës, në: Shqiptarët në Ballkan, Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, Tiranë 2001, f. 117.

⁶⁹³ Në nëntor 2001 u arrit për shembull një marrëveshje me Klubin e Parisit të Shteteve Kreditorë për një zvogëlim prej dy të tretave të borxheve të vendit për 4,5 miliardë dollarë amerikanë si dhe për kushte më të volitshme për pjesën e mbetur të borxhit. R. Vetter: Kud ideš Srbijo? Serbien nach der erfolglosen Präsidentenwahl und dem Mord an Đinđić [Kah shkon Serbi? Serbia pas zgjedhjeve të pasuksesshme presidenciale dhe pas vrasjes së Đinđić-it], në: Osteuropa, Zeitschrift für Gegenwartsfragen des Ostens, 4/2003, f. 494.

⁶⁹⁴ Për shembull, njëra prej rekomandimeve thotë: „Task Forca rekomandon që bashkësia ndërkombëtare të konsiderojë pagesat e pezulluara për pjesën e borxhit të Kosovës të Bankës Botërore deri atëherë kur të ketë marrëveshje përfundimtare për statusin e Kosovës. Rregullimi i borxhit të Kosovës atëherë do të mund të vendoset në kontekstin e duhur politik dhe ndoshta të përdoret si një shtytje e fuqishme për marrëveshje në bisedimet për statusin

Një kontest i mëtejshëm në konfliktin serbo-kosovar janë borxhet e Serbisë ndaj Kosovës. Sipas përlllogaritjeve të para kosovare, borxhet e Serbisë ndaj Kosovës arrijnë në mbi 300 milionë dollarë amerikanë nga fondi pensional i Kosovës,⁶⁹⁵ plus mbi 800 milionë dollarë amerikanë kursime të bankave kosovare. Këto të holla u tërhoqën nga Serbia në fillim të viteve të 90-ta si nga fondi pensional kosovar ashtu edhe nga bankat. Në të ardhmen Kosovës duhet t'i dorëzohet edhe pjesa kosovare në RSFJ, e cila tani për tani pa asnjë kompensim shfrytëzohet nga Serbia, si brenda ashtu edhe jashtë vendit.⁶⁹⁶ Së fundi ekzistojnë edhe më tej kërkesat kosovare ndaj Serbisë, që kjo t'i shlyejë dëmet e luftës që i shkaktoi në Kosovë, e që vlerësohen të jenë në një shumë dyshifrore miliardash.⁶⁹⁷ Në këtë mënyrë, midis Serbisë dhe Kosovës mbesin të hapura shumë çështje, të cilat e shtyjnë edhe më larg normalizimin e marrëdhënieve.⁶⁹⁸

4. Rezime rreth çështjes së statusit të Kosovës

Përderisa Serbia përkujdeset që pjesë të caktuara ose tërë territorin e Kosovës ta vendosë nën kontrollin e saj dhe kosovarët qëndrojnë rreptë pranë të drejtës së tyre

final.” E. C. Meyer etj.: *Balkans 2010, Report of an Independent Task Force, Council on Foreign Relations/Centre for Preventive Action, Nju Jork 2002, f. 77.*

⁶⁹⁵ Varësisht nga përlllogaritja kjo shumë jepet e ndryshme. Në Zëri, më 5 janar 2004, f. 5, kjo shumë jepet me 900 milionë euro. Ngaqë bëhet fjalë për vlerësim të gazetareve dhe ekspertëve të veçantë dhe jo për të dhëna zyrtare, këto shifra duhet të shikohen me kujdes. Këto të dhëna të ndryshme kanë të bëjnë në radhë të parë me atë që regjimi i dikurshëm serb në Kosovë dokumentet ose i shkatërroi qëllimisht ose i dërgoi në Serbi për të humbur gjurmët e eksploatimit dhe të falsifikimit.

⁶⁹⁶ Kur në nëntor 2000 RFJ-ja e Milošević-it hoqi dorë nga pretendimi i shprehur me vite, që është shteti i vetëm pasardhës i RSFJ-së, atëherë u sqaruan shumë çështje pronësore midis pesë shteteve pasardhëse deri më tani ndërkombëtarisht të pranuar të RSFJ-së (Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, RFJ e Milošević-it dhe Maqedonia). Kra. ICG, *After Milosevic. A Practical Agenda for Lasting Balkans Peace, Balkans Report Nr. 108, Bruksel 1 prill 2001, f. 237.* Kështu më 29 qershor 2001 u arrit një marrëveshje pas negociatave të gjata (Agreement on Succession Issues and Annexes A to G, June 29 2001, në: *International Legal Material 41, 3/2002*) për ndarjen e pronës së përbashkët të RSFJ-së. Sllovenia mori 16,39 për qind, Kroacia 28,49, Bosnja dhe Hercegovina 13,20, RFJ e Milošević-it 36,52 dhe Maqedonia 5,40. Vendimtare për ndarjen e pronës krahas faktorëve të tjerë ishin edhe shpenzimet për federatë gjatë epokës së RSFJ-së. Kra. Carsten Stahn: *The Agreement on Succession Issues of the Former Socialist Federal Republic of Yugoslavia*, në: *American Journal of International Law*, vëll. 96, botimi 2, prill 2002, f. 379-97. Rreth kësaj f. 380 v.

⁶⁹⁷ Sipas ekonomistit kosovar Nazmi Mustafa, ish-ministër federal i RSFJ-së gjatë kohës qeverisëse të Ante Marković-it, pjesa pronësore e Kosovës në RSFJ ka një vlerë minimale në lartësi të borxhit të jashtëm kosovar. Kra. Mehmet Gjata, Berat Buzhala: *Borxhi i Serbisë ndaj Kosovës është disa herë më i lartë se borxhi i Kosovës ndaj botës*, në: *Zëri Ditor*, 17 qershor 2003, f. 7.

⁶⁹⁸ „Nuk është thjesht e mundur që të shtyhen çështjet e vështira pronësore deri pas zgjidhjes së statusit final të Kosovës.” ESI, *The Ottoman Dilemma. Power and Property Relations under the United Nations Mission in Kosovo. Lessons Learned and Analysis Unit of the European Union Pillar in Kosovo, Prishtinë 8 gusht 2002, f. 4.*

për pavarësi, është vështirë e parafytyrueshme se do të mund të etablohen marrëdhënie paqësore dhe normale midis Kosovës dhe Serbisë. Pavarësia e Kosovës, e cila do të duhej kuptuar në një kontekst të caktuar rajonal dhe mbirajonal nga ndërvarësia, është premisa për etablimin e shteteve ligjore funksionuese si në Serbi ashtu edhe në Kosovë. Te kosovarët po rritet shqetësimi për shkak të statusit të pasigurt të Kosovës.⁶⁹⁹ Nevojiten urgjentisht zgjidhje inovative për një rrugëdalje nga qorrsoakaku. Për këtë arsye bashkësia ndërkombëtare do të duhej të interesohet më pak për rezultatin dhe më shumë për procesin e rregullimit të konfliktit.⁷⁰⁰

Kosova do të duhej të bëhej e pavarur, mirëpo kjo pavarësi do të duhej të luante një rol sekondar në strukturat e ndërvarura euro-atlantike. Sidomos përmes idesë evropiane të bashkimit, pavarësia e Kosovës do të duhej të humbiste rëndësinë si për kosovarët, ashtu edhe për fqinjët e Kosovës.

Pavarësia e Serbisë, e Malit të Zi dhe e Kosovës në kuadër të BE-së në shikim të gjatë duket të jetë një vizion realist dhe i arsyeshëm nga pikëpamja e politikës paqësore. Me këtë rast duhet të përkujtohet se në një Evropë të bashkuar dallimet mes *pavarësisë* dhe *sovranitetit* bëhen gjithnjë e më të mëdha. Është për t'u dyshuar se a mund të jenë sovraane edhe në „kuptimin klasik” Serbia, Mali i Zi dhe Kosova në një botë gjithnjë e më fort të ndërvarur.

Prania ndërkombëtare në Kosovë do të duhej të kontribuonte në zgjidhjen e problemit dhe jo të bëhet vetë pjesë e problemit. M. STEINER e dalloi saktë thelbin e krizës në Kosovë, kur konstatoi: „Këtu në Kosovë në parim ende nuk e kemi eliminuar shkakun e konfliktit, pra çështjen e statusit.”⁷⁰¹ Në pyetjen se si e sheh të ardhmen e tërthortë të rajonit të Ballkanit, M. STEINER u përgjigj:

„Në qoftë se ia kemi arritur që njerëzve t'ua japin ndjenjën se ata, forma e tyre e pavarur e qeverisjes, nuk janë më të rrezikuar, në qoftë se e humbin frikën se do të shkelen nga jashtë, atëherë mund të mundësojmë dialogje normale në rajon. Sjellja e njerëzve këtu nuk është e dominuar nga urrejtja, por nga frika.”⁷⁰²

Kosova është çelësi për siguri dhe stabilitet në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në qoftë se bashkësia ndërkombëtare sjelljen e Serbisë në vitin 1989 në Kosovë do

⁶⁹⁹ Krah. Report of Project on Ethnic Relations – Albanians and their neighbours: Is the status quo acceptable?, Lucern 15-16 nëntor 2002, publikuar nga Project on Ethnic Relations, Rep. 7/8, New Jersey 2003, f. 10.

⁷⁰⁰ Krah. Ulrich Schneckener: Sezession als Konfliktlösung – Unabhängigkeit für Montenegro und Kosovo? [Secesioni si zgjidhje e konfliktit – Pavarësi për Malin e Zi dhe Kosovën?], në: Leviathan. Zeitschrift für Sozialwissenschaft, 3/2001, f. 334 v.

⁷⁰¹ Dardan Gashi: Interview mit Michael Steiner, Chef der UN-Mission in Kosova [Intervistë me Michael Steiner, shef i misionit të UNMIK-ut në Kosovë], në: Balkan, Südosteuropäischer Dialog, Jed. 2/Heft 6, Vjenë etj. 2002, f. 11.

⁷⁰² Po aty.

ta kishte klasifikuar qartë si okupim, përkatësisht nëse do ta kishte treguar pjekurinë politike më 1968, 1981 ose më së voni më 1989, që Kosovën ta pranonte si partner të barabartë, pra si një republikë brenda RSFJ-së, atëherë RSFJ-ja me probabilitetin më të madh do të kishte qenë shteti i parë i dikurshëm komunist i Evropës, që do ta kishte arritur anëtarësimin në BE. Nga kjo do të kishin përfituar si serbët etnikë ashtu edhe shqiptarët etnikë.

Mirëpo, në vitin 1989 agresionit të Republikës së Serbisë në Kosovë iu bënë „koncesione”⁷⁰³ në heshtje si nga njësitë e tjera federale të RSFJ-së ashtu edhe nga bashkësia ndërkombëtare. Sot, më shumë se shtatëmbëdhjetë vjet më vonë, në rajonin e Ballkanit Perëndimor, veçanërisht në thelbin e rajonit, mungojnë edhe më tej zgjidhje të përhershme politike. Pa këto zgjidhje proceset e integritimit në BE mbeten tejet të brishta. Për procese të suksesshme të demokratizimit, të transformimit dhe të integritimit në strukturat evropiane dhe euro-atlantike janë të pashmangshme zgjidhjet e qëndrueshme politike.

III. Mospërputhje mes të drejtës kushtetuese dhe realitetit kushtetues: Gjendja e komuniteteve në Kosovë

Gjendja e komuniteteve⁷⁰⁴ që në Kosovë jetojnë si pakicë, paraqet një dimension të rëndësishëm në procesin e zgjidhjes së „çështjes së Kosovës”. Të gjitha standardet që duhet të përmbushen nga ana kosovare para se të merret vendimi rreth çështjes së statusit, i referohen situatës së komuniteteve dhe marrëdhënieve ndëretnike. Marrëdhëniet ndëretnike midis komunitetit shqiptar dhe komuniteteve të tjera janë më pak konfliktuoze në krahasim me marrëdhëniet midis komunitetit shqiptar edhe atij serb.

Lidhur me mbrojtjen e komuniteteve janë dy pika kryesore të dobëta si te administrata e UNMIK-ut ashtu edhe te institucionet kosovare: Së pari, masat mbrojtëse të parapara sipas kushtetutës për komunitetet⁷⁰⁵ nuk zbatohen në mënyrë konsekuente dhe së dyti, shpesh lejohet që komunitetet e mbrojtura përmes diskriminimit pozitiv ta sabotojnë procesin e krijimit të shtetit ligjor.⁷⁰⁶

⁷⁰³ Në një rast historikisht të krahasueshëm deri në një shkallë të konsiderueshme, „kompromise” u bënë me regjimin e Hitlerit në kohën para Luftës së Dytë Botërore, të cilat nuk mundën ta pengonin Luftën e Dytë Botërore.

⁷⁰⁴ Pasi që Korniza Kushtetuese bazohet në një qasje të *demos*-it dhe në asnjë vend nuk e përdorë nocionin pakicë në kuptimin etnik, por vetëm nocionin etnikisht neutral komunitete, formulimi komunitete që jetojnë si pakicë, sipas mendimit tim, është emërtimi më besnik „sipas kushtetutës” për kosovarët që kanë një prapavijë tjetër etnike për dallim nga shumica e popullit në Kosovë.

⁷⁰⁵ Më shumë rreth kësaj në vijim në pikat 1 dhe 2.

⁷⁰⁶ R. Vetter në artikullin e tij nga viti 2003 mendon: „Shumica shqiptare në Kosovë nuk guxon të bëhet më gjatë peng i pakicës serbe.” R. Vetter: ‚Konditionierte Unabhangigkeit’ fur Kosovo [‚Pavarësia e kushtëzuar’ për Kosovën], në: Südosteuropa 1-3/2003, S. 81.

Institucionet kosovare shprehen qartë për një normalizim të marrëdhënieve ndëretnike. Mirëpo, implementimi shpesh çalon për shkak të vështirësive ekonomike dhe për shkak të mungesës së kulturës demokratike. Kështu p.sh. në një deklaratë të nënshkruar në qershor 2003 nga përfaqësuesit kryesorë të institucioneve kosovare⁷⁰⁷ thirren të gjithë refugjatët dhe të zhvendosurit për t'u kthyer. Në këtë deklaratë mes tjerash thuhet: „Ka ardhur momenti i duhur që të ktheheni në shtëpitë tuaja. Sepse Kosova do të jetë e lirë dhe ju do t'i keni të drejtat e ngjashme sikur qytetarët e tjerë të Kosovës.”⁷⁰⁸ Mirëpo, realiteti duket ndryshe, siç e tregojnë aktet e dhunshme të marsit 2004. Instrumentalizimi i kosovarëve, si të komunitetit serb ashtu edhe atij shqiptar, vazhdon, për të përfutur kapital politik dhe për të krijuar fakte të përfunduara para vendimit për përcaktimin e çështjes së statusit të Kosovës.

Më shumë se tetë vjet pas përfundimit të veprimeve luftarake në Kosovë mbahen ende në jetë strukturat paralele të Serbisë në Kosovë në fushën e drejtësisë, të sigurisë dhe të arsimit dhe shfrytëzohen si instrument i instrumentalizimit të komunitetit serb në Kosovë.⁷⁰⁹ Edhe në pikëpamje financiare Serbia është shumë aktive në Kosovë dhe paguan p.sh. pagat dhe pensionet në *mënyrë selektive* mbi bazën e përkatësisë etnike për komunitetin serb në Kosovë.⁷¹⁰ Përmes financimit ilegal të strukturave paralele nga Serbia keqpërdoret komuniteti serb në Kosovë për qëllime nacionaliste të politikës së brendshme të Serbisë sikurse edhe para vitit 1999. Në vend që ta inkurajojë integrimin e komunitetit serb në jetën politike dhe ekonomike në Kosovë, përmes kësaj përkujdeset vetëm për tensione të mëtejme ndëretnike, të cilat i përshtaten mirë planeve serbe për ndarjen e Kosovës.

Sipas Rezolutës së OKB-së 1244 (1999) strukturat paralele serbe në Kosovë janë ilegale. Mirëpo, këto struktura tolerohen si nga administrata e UNMIK-ut, ashtu edhe nga KFOR-i. Shembulli më i mirë për këtë është veriu i Kosovës, i cili praktikisht qëndron në administrimin serb dhe në të cilën gati se nuk mund të etabloheshin aspak institucionet funksionuese të UNMIK-ut, përkatësisht të Kosovës. Në një

⁷⁰⁷ Nga kryetari i Kosovës dhe i LDK-së Ibrahim Rugova, nga kryeministri Bajram Rexhepi, nga kryetari i PDK-së (Partia Demokratike e Kosovës) Hashim Thaçi, nga kryetari i AAK-së (Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës) Ramush Haradinaj si dhe nga komandanti i TMK-së gjeneral lejtnant Agim Çeku.

⁷⁰⁸ Cit. te R. Vetter: ‚Konditionierte Unabhangigkeit‘ fur Kosovo [‚Pavarësia e kushtëzuar‘ për Kosovën], në: Sudosteuroopa 1-3/2003, f. 81 (në origjinal kursiv).

⁷⁰⁹ Në raportin e një organizate kosovare mund të lexohet për shembull: „institucionet paralele serbe veprojnë gati në çdo enklavë serbe brenda Kosovës, kurse pjesa veriore ka qenë edhe e lidhur ilegalisht me Telekomin Jugosllav dhe me sistemin energjetik serb.” Isa Blumi (ed.): Administration and Governance in Kosovo: Lessons Learned and Lessons to be Learned, Prishtinë/Gjenevë, janar 2003, f. 32.

⁷¹⁰ „Nëpunësit civilë serbë dhe mësuesit që punojnë për UNMIK-un marrin dy paga, një nga UNMIK-u dhe një nga Beogradi. Beogradi ende paguan pensionet dhe asistencat e sigurimit shoqëror (ndryshe nga UNMIK-u). Në teori kjo do të thotë se disa serbë janë tani më mirë se më parë, por për shkak të pasigurisë për të ardhmen, nuk kanë besim për të shpenzuar.” International Crisis Group (ICG), Kosovo, a Strategy for Economic Development, Balkans Report No. 123, Prishtinë/Bruksel 19 dhjetor 2001, f. 11 (<http://www.crisisweb.org>).

raport të gjerë, të publikuar nga OSBE-ja më 7 tetor 2003, konstatohet se „strukturat paralele vazhdojnë të ekzistojnë në Kosovë në disa fusha të sektorit publik dhe kanë pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtat e individëve dhe në sundimin e ligjit.”⁷¹¹

„Pëngmarrja reciproke” e kosovarëve të etnitetit shqiptar dhe serb vazhdon, gjë që së fundi u dëshmuar në aktet e dhunshme me motivim ndëretnik në mars 2004 edhe njëherë tjetër në mënyrë mesjetare në Kosovë, por edhe në Serbi. Gjendja e komunitetit serb në Kosovë është e lidhur drejtpërsëdrejti me çështjen e statusit të pazgjydhur. Instrumentalizimi i këtij komuniteti përmes Serbisë — dhe me këtë edhe pengimi i një normalizimi të marrëdhënieve të këtij komuniteti me komunitetet e tjera në Kosovë — kontribuon në fuqizimin e konflikteve ndëretnike si në Kosovë ashtu edhe në rajon.

Normalizimi i marrëdhënieve dhe „degetoizimi” mes kosovarëve të etnitetit shqiptar dhe serb duket se nuk është në interes të forcave etno-nacionaliste në të dyja anët, tipi ideal i të cilëve është krijimi i shteteve të „pastra” kombëtare monoetnike.

1. Të drejtat e garantuara me kushtetutë për komunitetet dhe institucioni i ombudspersonit

Dispozitat në Kreun 4 të Kornizës Kushtetuese mbrojnë komunitetet e banorëve që i përkasin të njëjtit grup etnik, fetar ose gjuhësor. Caku është ruajtja, mbrojtja dhe shprehja e lirë e identitetit etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor. Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre u garantohen mes tjerash këto të drejta: përdorimi i gjuhës dhe i alfabetit në gjykata, organizma dhe organe të tjera publike; përdorimi dhe shfaqja e shenjave të komunitetit sipas ligjit; arsimimi në gjuhën amtare; lajme në gjuhën amtare, përfshirë edhe në radion publike; shërbime shëndetësore publike dhe shërbime shoqërore; nxitja e traditave të komunitetit; krijimi i shoqatave për nxitjen e interesave të komunitetit; kontakti i papenguar me pjesëtarët e komunitetit përkatës jashtë Kosovës; financimi mes tjerash përmes kontributeve vullnetare të pjesëtarëve të një komuniteti, përmes organizimeve jashtë Kosovës ose përmes institucioneve të vetëqeverisjes.

Për mbrojtjen e këtyre të drejtave të garantuara, kompetent është edhe institucioni i ombudspersonit⁷¹². Ombudspersoni ka vetëm autorizime rekomanduese dhe këshilluese, autorizimin për pranimin e ankesave, për zhvillimin e hetimeve, për vëzhgim dhe marrje të hapave parandaluese. Ombudspersoni merret me shkelje posaçërisht të rënda ose sistematike të të drejtave të komuniteteve dhe anëtarëve të tyre dhe me akuzat e diskriminimit.

⁷¹¹ <http://www.osce.org/item/7815.html>. Raporti i tërësishëm (Parallel Structures in Kosovo, tetor 2003) gjendet në faqen http://www.osce.org/documents/mik/2003/10/698_en.pdf.

⁷¹² Shiko Rregulloren nr. 2000/38 të UNMIK-ut nga 30 qershori 2000 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë.

2. *Participimi politik i komuniteteve*

Kosova paraqet një zonë të vetme shumanëtarëshe. Parlamenti përbëhet nga 120 deputetë, me ç'rast 100 mandate u ndahen sipas parimit të zgjedhjeve proporcionale të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur (më tutje: partitë). 20 mandatet e tjera janë vende të rezervuara parlamentare për përfaqësim „plotësues”⁷¹³ të komuniteteve që jetojnë si pakicë.⁷¹⁴ Mandatet e rezervuara u shpërndahen partive të komunitetit përkatës në proporcion me numrin e votave të vlefshme që ata kanë marrë.

Në qoftë se krahasohen përqindja e votave dhe ajo e mandateve, konstatohet se partitë politike të komuniteteve që jetojnë si pakicë në Kosovë kanë afro dyfish më shumë mandate sesa që kanë marrë vota në zgjedhje. Ky është një rezultat i masave mbrojtëse të përcaktuara në Kornizën Kushtetuese me diskriminim pozitiv për këto komunitete në Kosovë.

Sipas Kornizës Kushtetuese edhe në kryesinë tetanëtarëshe të parlamentit janë paraparë nga një vend i rezervuar për një anëtar të një partie, e cila e përfaqëson komunitetin serb, dhe për një anëtar të një partie, e cila e përfaqëson komunitetin joshqiptar dhe joserb.

Në parlamentin kosovar njëri prej gjithsej dy komisioneve kryesore⁷¹⁵ është paraparë për çështjet e komuniteteve: *Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve*. Ky Komisioni i Komuniteteve përbëhet prej dy deputetëve nga secili komunitet i përfaqësuar në parlament; te komunitetet që përfaqësohen me vetëm një deputet në parlament, vetëm ky i përket komisionit. Përveç kësaj, komisionet kanë nga dy nënkryetarë që duhet t'u përkasin komuniteteve të ndryshme. Komisioni i komuniteteve në procedurën legjislativë mund t'i drejtojë rekomandime komisionit kompetent funksional ose parlamentit që të sigurojë se të drejtat dhe interesat e komunitetit janë trajtuar në mënyrë të përshtatshme.

Si mekanizëm mbrojtës për komunitetet Korniza Kushtetuese⁷¹⁶ parasheh mundësinë e një mocioni pranë kryesisë së parlamentit, të cilin një deputet e paraqet me mbështetjen e pesë deputetëve të tjerë brenda 48 orëve pas miratimit të një ligji, nëse ligji apo dispozita të veçanta shkelin interesat jetike të komunitetit të tij. Pastaj

⁷¹³ Përmes llogaritjes së dyfishtë të votave që jepen për partitë e komuniteteve që jetojnë në pakicë (në njërin anë gjatë shpërndarjes proporcionale të 100 mandateve dhe në anën tjetër gjatë shpërndarjes së mandateve të rezervuara) thyhet parimi i barazisë të së drejtës zgjedhore, sipas të cilit gjatë numërimit të votave u jepet vlerësim i njëjtë të gjitha votave të vlefshme.

⁷¹⁴ 10 për partitë që përfaqësojnë komunitetin serb, 4 për partitë e romëve, ashkalive dhe komunitetit egjiptian, 3 për partitë e komuniteti boshnjak, 2 për partitë e komunitetit turk dhe 1 për partitë e komunitetit goran.

⁷¹⁵ Tjetri është Komisioni për Buxhet. Komisione të tjera funksionale mund të caktohen sipas nevojës.

⁷¹⁶ Kreu 9, paragrafi 1.39.

parlamenti vendos se a do ta pranojë një propozim me konsensus të hartuar nga kryesia e parlamentit, apo do ta përcaktojë një panel treanëtarësh, i cili përbëhet nga një përfaqësues i sponsorit të ligjit, një përfaqësues nga pala kundërshtarë dhe një anëtar i emëruar nga PSSP-ja si kryesues. Në qoftë se parlamenti e kundërshton propozimin me konsensus të kryesisë së parlamentit ose rekomandimin e panelit, atëherë ligji mbetet ashtu siç është miratuar më parë nga parlamenti. Nëse brenda 48 orësh pas miratimit të ligjit nuk dorëzohet asnjë mocion ose nëse zhvillohet procedura e përshkruar e mocionit, atëherë ligji konsiderohet i miratuar.

Krahas vendeve të rezervuara në parlament, janë paraparë edhe poste të rezervuara ministrash për përfaqësuesit e komuniteteve që jetojnë si pakicë. Kështu së paku dy ministra duhet të rrjedhin nga grupet që nuk paraqesin shumicën në parlament: me këtë rast së paku një ministër duhet t'i përkasë komunitetit serb dhe një ministër një komuniteti tjetër joshqiptar.

E drejta e përdorimit të gjuhës vetjake amtare në institucionet kosovare është po ashtu e përcaktuar në Kornizën Kushtetuese. Sipas kësaj seancat e parlamentit dhe të qeverisë si dhe të organeve të tyre duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe serbe. Po ashtu të gjitha dokumentet zyrtare shtypen në të dyja gjuhët. Anëtarët qeveritarë të etniteteve tjera joshqiptare dhe joserbe mund të përdorin gjuhën e tyre. Ligjet publikohen në shqip, boshnjakisht, anglisht, serbisht dhe turqisht.

3. Diskursi rreth marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë

Shikuar nga perspektiva e Kornizës Kushtetuese, komunitetet që jetojnë si pakicë në Kosovë gëzojnë më shumë të drejta të garantuara me kushtetutë sesa pakicat në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor ose të BE-së. Disa autorë konstatojnë me të drejtë: „Një numër i njëjtë i të drejtave, është interesante të vihet në dukje, u janë mohuar pakicave në shumë prej shteteve evropiane, të cilat janë duke promovuar aq fuqishëm respektimin e tyre në Kosovë”.⁷¹⁷ Kjo tregon një natyrë të caktuar eksperimentale të angazhimit ndërkombëtar në Kosovë.

Problemi i vërtetë i komuniteteve – por edhe në përgjithësi të plotë i të drejtave të njeriut, në Kosovë qëndron më tepër në zbatimin praktik dhe jo në normat kryesisht të imponuara nga bashkësia ndërkombëtare. Kështu kemi një mospërputhje të fortë midis të drejtës kushtetuese dhe realitetit kushtetues.

Normat e imponuara shpesh nuk çojnë deri te caku, sepse pak njerëz mund të identifikohen me to. Kyçja e njerëzve në vend në procesin legjislativ do t'i rriste gjasat e zbatimit dhe do të nxiste një kulturë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut e të minoriteteve. Bashkësia ndërkombëtare përdor shpesh qasje të thjeshta sqaruese për situatat komplekse të marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë dhe damkos grupe të

⁷¹⁷ Richard Caplan: A New Trusteeship? The International Administration of War-torn Territories, Adelphi Paper 341/International Institute for Strategic Studies, Oksford etj. 2002, f. 62 v.

caktuara. Shkencëtari i të drejtës Marcus BRAND e përshkruan situatën e krijuar pas qershorit 1999 si vijon:

„Vëzhgues ndërkombëtarë në Kosovë dhe në tërë botën nuk anojnë që ta mbajnë KFOR-in dhe UNMIK-un përgjegjës si autoritete kontrolluese, por më parë i shohin shqiptarët e Kosovës kolektivisht ‘përgjegjës’ për situatën.”⁷¹⁸

Edhe situata e vështirë ekonomike, e cila në radhë të parë është për t’u kuptuar si pasojë e mungesës së zgjidhjeve politike, dhe standardi tejet i ulët jetësor që rezulton prej saj — madje më i ulëti në Evropë — ka një ndikim shumë negativ në marrëdhëniet ndëretnike.

Ndërsa marrëdhëniet midis kosovarëve shqiptarë dhe të komuniteteve të tjera si boshnjakët ose romët po normalizohet gjithnjë e më shumë, marrëdhëniet e ndikuara nga politika ditore midis kosovarëve të etnitetit shqiptar dhe të atij serb mbesin më shumë të tensionuara e deri eksplozive, edhe pse statistikisht që nga përfundimi i luftimeve në qershor 1999 ofrojnë kuota vazhdimisht në rënie të kriminalitetit të motivuar etnikisht.

Në një raport të publikuar më 28 maj 2003, ICG-ja shprehet për një „kontratë civile” midis komuniteteve që jetojnë si pakicë, shumicës së popullsisë dhe institucioneve kosovare. Kështu në një rën anë qeveria do të duhej t’i njëjto të drejtat speciale për këto komunitete dhe ato t’i përkrahë, kurse në anën tjetër komunitetet nuk do të duhej ta vënin në dyshim autoritetin e qeverisë. Raporti qorton mungesën e njohjes reciproke, e cila do të paraqiste kushtin e pashmangshëm paraparak për marrëdhënie më të mira ndëretnike dhe për etablimin e një ‘paqeje pozitive’.⁷¹⁹

Lidhur me marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë mund të konkludoj në fund se tensioni i vazhdueshëm midis kosovarëve të etnitetit shqiptar dhe atij serb, i cili e pengon etablimin dhe sigurimin e ‘paqes pozitive’, ka tri arsye kryesore:

1. Instrumentalizimi i komunitetit serb në Kosovë nga ana e Serbisë, e cila përmes kësaj ndjek objektiva të politikës së brendshme;
2. Mungesa e gjerë e gatishmërisë nga ana e kosovarëve të etnitetit serb që të pajtohen me rolin e një komuniteti që jeton si pakicë, që do të thotë për ata humbjen e statusit „qytetarë të rendit të parë”, të cilin e kishin gjatë regjimit serb në Kosovë, që i ngjante apartheidit;
3. Mungesa e gatishmërisë dhe e pjekurisë politike e shumicës së kosovarëve, që bashkëqytetarët e etnitetit serb t’i pranojnë si pjesë e vetëkuptueshme dhe e

⁷¹⁸ M. G. Brand: Institution-Building and Human Rights Protection in Kosovo in the Light of UNMIK Legislation, në: Nordic Journal of International Law 70/2001, f. 488.

⁷¹⁹ Krah. ICG, Kosovo’s Ethnic Dilemma: The Need for a Civic Contract, Balkans Report Nr. 143, Prishtinë/Bruksel 28 maj 2003 (Executive Summary and Recommendations).

barabartë e shoqërisë kosovare, me ç'rast sjellja aktuale e Serbisë në Kosovë dhe rreth Kosovës si dhe mungesa e një procesi të pajtimit ndikon negativisht te ky pranim.

Për këtë arsye, gjasat për një normalizim të marrëdhënieve midis kosovarëve të etnitetit shqiptar dhe atyre të etnitetit serb në njërën anë si dhe në anën tjetër midis Serbisë e Kosovës mbesin tejet të vogla pa një proces afatgjatë të pajtimit si dhe pa një 'paqe pozitive'.

„Kombet ekzistojnë në kohë e po ashtu edhe në hapësirë: pa një kuptim të të kaluarës, do të jetë e vështirë për të formësuar të ardhmen.”⁷²⁰

„Megjithatë qenien e një kombi e përbën fakti që të gjithë individët kanë shumëçka të përbashkët me njëri-tjetrin, e po ashtu, që ata shumë gjëra i kanë harruar.”⁷²¹

IV. Ndërmjet iluzionit dhe realitetit: 'Procesi i pajtimit' në konfliktin serbo-kosovar

Për ta bërë një ditë realitet anëtarësimin në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor, është i pashmangshëm një proces afatgjatë dhe i qëndrueshëm i pajtimit midis vendeve dhe popujve të këtij rajoni. Kroacia dhe Serbia dhe Mali i Zi kanë bërë hapin e parë në drejtim të këtij procesi të pajtimit. Ky hap u bë i mundshëm vetëm shumë vjet pasi që këto dy vende ishin pranuar reciprokisht si partnerë të barasvlershëm, d.m.th. si shtete të pavarura. „Në emër të të kaluarës, të cilën nuk mund ta harrojmë, dhe për një të ardhme të përbashkët më të mirë, dëshiroj të kërkoj falje për të gjitha ato të këqija që i kanë kryer qytetarët e Serbisë dhe të Malit të Zi.”⁷²² Me këto fjalë kërkoi falje presidenti i unionit të përkohshëm shtetëror Serbi-Mali i Zi Svetozar MAROVIĆ para presidentit kroat Stjepan MESIĆ, i cili gjatë vizitës së tij në Beograd gati me të njëjtat fjalë kërkoi falje për të gjitha „krimet e drejtuara kundër qytetarëve të unionit Serbi-Mali i Zi”.⁷²³

⁷²⁰ C. Bildt: A Second Chance in the Balkans, në: Foreign Affairs, vëll. 80, janar/shkurt 2001, f. 149.

⁷²¹ E. Renan [1882]: Was ist eine Nation? Und andere Politische Schriften [Çfarë është kombi? Dhe shkrime të tjera politike], Vjenë, Bolzano 1995, f. 45 v.

⁷²² Gertraud Illmeier: Stipe Mesić zu Besuch bei früherem Todfeind Serbien [Stipe Mesić në vizitë të Serbia, armiku i tij i mëhershëm], në: Die Presse, 11 shtator 2003, f. 6.

⁷²³ Krah. po aty. Në fund të majit 2004 edhe S. Marović vizitoi Zagrebin si burrë shteti i parë nga Beogradi që nga shkatërrimi i RSFJ-së. Krah. Neue Zürcher Zeitung, 26 maj 2004, f. 5.

Zhvillimet si në rastin serbo-kroat nuk mund të priten në të ardhmen e afërt në konfliktin serbo-kosovar. Nën patronazhin e bashkësisë ndërkombëtare, më 14 tetor 2003 në Vjenë filluan të ashtuquajturat bisedime për çështje teknike midis Serbisë dhe Kosovës, të cilat u zhvilluan me intensitet të ndryshëm. Rezultatet e të tillave „biseda për çështje teknike” nuk mund ta zëvendësojnë megjithatë në konfliktin serbo-kosovar procesin e pajtimit që është i pashmangshëm për një paqe të përhershme. Një proces i suksesshëm i pajtimit në konfliktin serbo-kosovar do të vlente si shembull pozitiv edhe për antagonizmat e tjerë ndëretnikë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, sepse ky konflikt paraqet thelbin e sfidave për etablimin dhe sigurimin e paqes afatgjate në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Mirëpo, ky skenar mbetet edhe më tej një gjë e dëshirueshme:

„Për sa kohë shqiptarët frikësohen dhe serbët shpresojnë se mund të kthehet sundimi i Beogradit, të dyja palët do të jenë të përgatitura si psikologjikisht ashtu edhe praktikisht për luftën e ardhshme, duke e zhvendosur vëmendjen nga problemet e tjera të ngutshme politike, ekonomike dhe sociale.”⁷²⁴

Me vite pas përfundimit të veprimeve të hapura luftarake midis Serbisë dhe Kosovës do të ishte koha që në vijën e proceseve të integrimit në BE së paku nga elitat të dallohet nevojshmëria e një procesi të pajtimit. Çdo shtyrje e mëtejme nuk do ta lehtësojë këtë proces dhe përmban vetëm rreziqe të mëtejme. Urgjencën e një ballafaqimi me rezultatet e deritashme e përshkruan në mënyrë të saktë R. BIERMANN:

„Pa zbulimin e të vërtetës historike pajtimi nuk është i mundshëm në Ballkan. [...] por kur do të duhej të fillonte pajtimi, në qoftë se jo sot, kur për herë të parë të gjitha qeveritë e rajonit janë zgjedhur në mënyrë demokratike, kur perspektiva e një anëtarësimi në BE liron forca të mëdha të transformimit dhe kur të gjitha vendet janë qenësisht të varura nga ndihma e gjerë?”⁷²⁵

Ballafaqimi me rezultatet e dhjetëvjeçarëve të fundit interpretohet shpesh si tentim për t’i ngjallur prapë konfliktet dhe jo si hap i nevojshëm në procesin e përpunimit të konfliktit. Tentimet e administratës ndërkombëtare për të ndjekur një *strategji të fitimit në kohë* dhe për të shpresuar se në efekt të fundit do të *harrohet e kaluara*, sipas mendimit tim, në rastin më të mirë mund të arrijnë ngrirjen e perceptimit të ‘të tjerëve’, mirëpo jo normalizimin e marrëdhënieve me ‘të tjerët’. Shpresat naive se normalizimi i marrëdhënieve midis popujve dhe vendeve në

⁷²⁴ ICG, After Milosevic. A Practical Agenda for Lasting Balkans Peace, Balkans Report Nr. 108, Bruksel 1 prill 2001, f. VIII.

⁷²⁵ Rafael Biermann: Aussöhnung und Neubeginn. Das Haager Tribunal und seine Folgen [Pajtim dhe rifillim. Tribunali i Hagës dhe pasojat e tij], në: Internationale Politik – Europa Archiv 5/2002, f. 24.

rajonin e Ballkanit Perëndimor mund të arrihet pa *lutje* formale *për falje* dhe pa *pranimin e fajësisë*, nuk janë të rralla. Çdo njeri që ka kaluar ca kohë në vendet e Ballkanit, duhet t'i kundërshtojë prapëseprapë këto shpresa. Historia dhe 'kujtesa kolektive' e popujve të Ballkanit janë më të vjetra se imazhet për këto vende dhe këta popuj, që gëlojnë në kokat e burokratëve ndërkombëtarë të ngarkuar me procesin e pajtimit, të cilët njerëzit e këtij rajoni i konfrontojnë shpesh me fjalinë „*e kaluara duhet të harrohet*”.

Qëndrimet diametralisht të kundërta për statusin e Kosovës në Serbi dhe në Kosovë tregojnë se parakushtet themelore për një 'proces të pajtimit' nuk janë të pranishme në konfliktin serbo-kosovar. Pak para fillimit të „bisedave për çështjet teknike” në tetor 2003 Serbia i definoi vijat e saj të negociatave.⁷²⁶ Qëndrimi i Serbisë përballë Kosovës mbetet i pandryshuar dhe përmes kësaj ekziston edhe më tutje rreziku i një konflikti të përsëritur luftarak. Derisa për kosovarët pavarësia e Kosovës tashmë është një zgjidhje kompromisi në raport me bashkimin me Shqipërinë, Serbia e shikon një autonomi brenda Republikës së Serbisë për Kosovën si zgjidhje përfundimtare.

Serbia pas Milošević-it nuk sheh asnjë arsye që të ndihet përgjegjëse për politikën agresive të dhjetëvjeçarëve të fundit. Shumë vepra madje edhe mohohen: „Sipas një publikimi zyrtar të Ministrisë serbe (post-Milošević) të Punëve të Brendshme (MPB), 'shqiptarët' e Kosovës 'asnjëherë nuk kanë qenë subjekt i spastrimit etnik nga ana e serbëve’.”⁷²⁷ Kështu *procesi i përballimit të të kaluarës*, i nevojshëm dhe i pashmangshëm për një paqe afatgjate në Serbi, nuk përmendet as në institucionet shtetërore e as në elitat politike, as në institucionet arsimore apo në medie. „Një ballafaqim me të kaluarën e vet nuk ndodh gati aspak: Vukovari, Srebrenica, Sarajeva, Drenica, Reçaku – këto të gjitha janë tema tabu, pikërisht edhe në medie.”⁷²⁸ *Procesi i përballimit të të kaluarës* do të kishte pasur te popullsia një bazë solide, sepse sipas disa ekspertëve në Serbi „qytetarët me mendime evropiano-demokratike, pra gati një e treta e votuesve, [...] janë të gatshëm që të preokupohen me të kaluarën”⁷²⁹.

⁷²⁶ Krah. Die Presse, 3 shtator 2003, f. 7.

⁷²⁷ Slavenko Terzić: Albanian Ethnic Cleansing of the Old Serbia, në: Ministry of Internal Affairs of the Republic of Serbia, Extremism, f. 7-10, cit. te A. Matveeva, W. Ch. Paes: The Kosovo Serbs: An ethnic minority between collaboration and defiance, në: Small arms and security in South Eastern Europe. Bonn International Center for Conversion, Friedrich Naumann Foundation and Saferworld, qershor 2003, f. 18.

⁷²⁸ R. Biermann: Aussöhnung und Neubeginn. Das Haager Tribunal und seine Folgen [Pajtim dhe rifillim. Tribunali i Hagës dhe pasojat e tij], në: Internationale Politik – Europa Archiv 5/2002, f. 22.

⁷²⁹ Politologu Vladimir Goati më 21.12.2002 në bisedë me R. Vetter, cit. te R. Vetter: Kud ideš Srbijo? Serbien nach der erfolglosen Präsidentenwahl und dem Mord an Đinđić [Kah shkon Serbi? Serbia pas zgjedhjeve të pasuksesshme presidenciale dhe pas vrasjes së Đinđić-it], në: Osteuropa, Zeitschrift für Gegenwartsfragen des Ostens, 4/2003, f. 499.

Tribunali Ndërkombëtar në Hagë nuk perceptohet si zamkë e rëndësishme në procesin e pajtimit, por si instrument i fuqive perëndimore. „Në të vërtetë, 75 për qind e serbëve, përfshirë edhe Koshtunicën, besojnë se Tribunali Ndërkombëtar Penal është i anshëm kundër tyre.”⁷³⁰ Krimet e luftës interpretohen nga institucionet shtetërore në një mënyrë, që sipas mendimit tim paraqet një fyerje të viktimave: „Milošević-i ka qenë i akuzuar më tepër për vrasje, evazion fiskal dhe për krime të tjera të brendshme sesa për krime lufte.”⁷³¹

Përderisa Serbia nuk heqë dorë nga pretendimet mbi Kosovën, për palën kosovare mbetet një temë tabu procesi i pajtimit me Serbinë. Pasiguria politike u lë tepër hapësirë ëndrrave, frikave dhe keqkuptimeve. Perceptimi i intervenimit të NATO-s më 1999 nga ana e qarqeve etno-nacionaliste etnike shqiptare⁷³² është një pasojë e kësaj pasigurie politike. Në këtë mënyrë, në këto qarqe intervenimi i NATO-s më 1999 perceptohet si një hap drejt etablimit të shteteve mono-etnike, edhe pse intervenimi i NATO-s ishte menduar nga shtetet e NATO-s në radhë të parë si aksion humanitar.

Instrumentalizimi i komunitetit serb në Kosovë përmes strukturave paralele është një pengesë e mëtejme për „procesin e pajtimit” në konfliktin serbo-kosovar.⁷³³ Kjo politikë e Serbisë përballë Kosovës përshtatet njëkohësisht në imazhin e partive militante etno-nacionaliste të kosovarëve të etnitetit shqiptar, sepse të dyja palët synojnë një ndarje sipas parimeve etnike. Me ose pa vetëdije, forcat etno-nacionaliste të të dyja palëve në konflikt janë pra komplementare.

Po ashtu, qëndrimi i bashkësisë ndërkombëtare nuk e stimulon gjithmonë „procesin e pajtimit” në konfliktin serbo-kosovar. Me ndërrimin e pushtetit në vitin 2000 në Serbi, shumë shtete evropëriëndimore krijuan shpresa naive, të cilat nuk e thjeshtësuan zgjidhjen e konfliktit serbo-kosovar:

„Ka dy iluzione që lidhen me rënien e Milošević-it. I pari është që derisa etno-nacionalizmi autoritar ndan, demokracia do të duhej të ndihmonte për të ribashkuar. [...] Iluzioni i dytë, të cilin me sa duket e mbajnë shumica e

⁷³⁰ International Herald Tribune, 14 shkurt 2002, f. 3, cit. te S. P. Ramet, Ph. W. Lyon: *Discord, Denial, Dysfunction. The Serbian-Montenegrin-Kosovar Triangle*, në: *Problems of Post-Communism*, vëll. 49, 5/2002, f. 17.

⁷³¹ Jacques Rupnik: *Yugoslavia After Milosevic*, në: *Survival. The International Institute for Strategic Studies*, vëll. 43, 2/2001, f. 19.

⁷³² Për dallim nga skena partiake serbe, këto qarqe në Kosovë në zgjedhjet parlamentare arritën vetëm afro një për qind të votave.

⁷³³ Rreth rolit destruktiv të Serbisë në procesin e krijimit të paqes në Kosovë përmes instrumentalizimit të pakicës serbe me cakun e vetëm që të arrihet ndarja e Kosovës, krah. p.sh. International Crisis Group (ICG), UNMIK's Kosovo Albatross: *Tackling Division in Mitrovica*, Balkans Reports No. 131, Prishtinë etj. 3 qershor 2002 (<http://www.crisisweb.org>).

qeverive perëndimore, është ai se me largimin e Milošević-it mund të ringjallet një version i mbetur i Jugosllavisë.”⁷³⁴

Sjellja e BE-së ndaj rajonit të Ballkanit Perëndimor pasqyrohej p.sh. në angazhimin energjik të BE-së për krijimin e një krijese të re artificiale, „Solania”.⁷³⁵ Veprimet e pakoordinuara dhe mungesa e një gjuhe të përbashkët mes BE-së dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës në rajonin e Ballkanit Perëndimor çuan deri te mossukseset.⁷³⁶

Mungesa e pranimit të fajësisë, mungesa e bashkëpunimit në çështjen e njerëzve të zhdukur dhe të kthimit të refugjatëve, falsifikimi i fakteve historike penguan procesin e pajtimit në konfliktin serbo-kosovar. Këto barra janë njëkohësisht objekt dhe vegël e politikës ditore serbe.

Deri më sot në Serbi u zbuluan disa varreza masive të kosovarëve të vrarë. Mirëpo, kufomat tashmë me vite nuk u dorëzohen familjeve, përkatësisht instituteve të mjekësisë ligjore për identifikimin e tyre. Ato përdoren si kapital politik, që në kohëra të caktuara të demonstrohet „vullneti i mirë”. Në mënyrë të ngjashme edhe njerëzit e dëbuar janë bërë top i politikës ditore. Beogradi flet për 250.000 refugjatë nga Kosova në Serbi. Në qarqet e demografëve dhe të politikanëve në Kosovë kjo shifër vihet në dyshim dhe vlerësohet të jetë realisht rreth gjysmës së saj. Afro 40 qind të njerëzve që përmenden nga Beogradi janë serbë nga Kroacia dhe nga Bosnja dhe Hercegovina,⁷³⁷ të cilët ishin shpërngulur në Kosovë si kolonizatorë nga regjimi i S. Milošević-it.

Në një vend me një skenë partiake të dominuar nga partitë ekstreme nacionaliste,⁷³⁸ idetë që do të duhej të mundësonin një proces të pajtimit, ose

⁷³⁴ J. Rupnik: Yugoslavia After Milosevic, në: Survival. The International Institute for Strategic Studies, vëll. 43, 2/2001, f. 22.

⁷³⁵ Aludim në angazhimin e J. Solanas, për të arritur unionin e përkohshëm shtetëror Serbi-Mal i Zi.

⁷³⁶ Njohësit e kësaj problematike ofrojnë shembuj bindës për këtë: „Në të vërtetë, në fillim të këtij viti, Brukseli ofroi 100 milionë dollarë kredi të reja për Beogradin në të njëjtën ditë, kur Uashingtoni pezulloi ndihmën për shkak të mosbashkëpunimit për kriminelët e luftës; më saktësisht, Franca dhe Gjermania zgjodhën këtë rast për të njoftuar se llogaridhënia për krime lufte nuk do të ndikojë në vendimet e tyre për ndihmë.” M. Abramowitz, H. Hurlburt: Can the EU Hack the Balkans?, në: Foreign Affairs, vëll. 81, shtator/tetor 2002, f. 4.

⁷³⁷ Krahe. Report of Project on Ethnic Relations – Albanians and their neighbours: Is the status quo acceptable?, Lucern 15 – 16 nëntor 2002, publikuar nga Project on Ethnic Relations, Rep. 7/8, New Jersey 2003, f. 15.

⁷³⁸ Për shembull në rundin e tretë zgjedhor për zgjedhjet presidenciale në Serbi më 8 dhjetor 2002, Vojislav Šešelj, i cili tashmë gjendet në burgun e Tribunalit Ndërkombëtar në Hagë, kurse edhe më tej është udhëheqësi zyrtar i Partisë Radikale të Serbisë, parti kjo ultranacionaliste serbe, te një pjesëmarrje prej 45,20 për qind, mori 1.068.000 vota (36,30 për qind). Kundërkandidati i tij Vojislav Koštunica që ka përfytyrime të ngjashme serbomadhe, fitoi 1.695.000 vota (57,50 për qind). Krahe. R. Vetter: Kud ideš Srbijo? Serbien nach der erfolglosen Präsidentenwahl und dem Mord an Đinđić [Kah shkon Serbi? Serbia pas zgjedhjeve të pasuksesshme presidenciale dhe pas vrasjes së Đinđić-it], në: Osteuropa,

injorohen ose mbyten në embrion. Profesoresha e psikologjisë pranë Universitetit të Beogradit, Ruzhica ROSANDIĆ propozoi themelimin e një „*Instituti Ballkanik për Hulumtimin e Teksteve Mësimore*” për vendet e Ballkanit, i ngjashëm me Institutin Georg Eckert për hulumtimin e librave shkollorë në Gjermani që u themelua më 1951 nga UNESCO.⁷³⁹ Mirëpo, propozimet e tilla do të shkonin kundër „theksimit të të qenit unik të kombit të vet”, i cili në vendet e Evropës Juglindore pas vitit 1989 e ruan fokusin etno-nacionalist në institucionet arsimore⁷⁴⁰ dhe çon deri aty që në librat shkollorë lartësohet e kaluara e vet.⁷⁴¹

Në radhë të parë mund të nxirret konkludimi se ballafaqimi kritik me të kaluarën e vet është një parakusht i pashmangshëm për procesin e pajtimit. Mirëpo, duke u nisur nga situata e përshkruar politike në Serbi, nuk mund të pritet ndonjë ndryshim i shpejtë i kursit në politikën serbe ndaj Kosovës. Për shkak të kapaciteteve të dobëta politike dhe ekonomike dhe për shkak të mungesës së vetëdijes politike, as në Kosovë gati se nuk mund të priten hapa drejt një procesi të qëndrueshëm të pajtimit. Pengesë kryesore këtu është mungesa e shtetit ligjor dhe përmes kësaj edhe mbrojtja efektive e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve në Kosovë.

Nëse Serbia nuk është e interesuar për një proces të pajtimit dhe nëse bashkësia ndërkombëtare, sidomos BE-ja, nuk nxit një proces të tillë, atëherë së paku institucionet kosovare do të duhej të tentonin në mënyrë më vendimtare se deri më tani, që t’i kapërcejnë hijet e veta dhe ta çojnë më tutje përpara procesin e pajtimit midis dy komuniteteve të ndryshme në Kosovë, sepse vetëm përmes kësaj mund të arrihet shteti ligjor dhe objektivat politike të Kosovës.

Zeitschrift für Gegenwartsfragen des Ostens, 4/2003, f. 484 vv. Edhe në zgjedhjet parlamentare më 28 dhjetor 2003 ultra-nacionalistët e Partisë Radikale të Serbisë dolën partia me më së shumti mandate, 81 nga 250. Kra. Die Presse, 16 janar 2004, f. 7.

Vladimir Goati e quan skenë partiake „në Serbi një përzierje e partive nacionaliste dhe socialiste, nacionalsocializëm në një version ballkanik, [...] një përzierje e çuditshme nga dy këndvështrime të ndryshme.” V. Goati, më 21.12.2002 në bisedë me R. Vetter, cit. te R. Vetter: Kud ideš Srbijo? Serbien nach der erfolglosen Präsidentenwahl und dem Mord an Đinđić [Kah shkon Serbi? Serbia pas zgjedhjeve të pasuksesshme presidenciale dhe pas vrasjes së Đinđić-it], në: Osteuropa, Zeitschrift für Gegenwartsfragen des Ostens, 4/2003, f. 493. Më shumë rreth sistemit partiak të Serbisë kra. po aty, f. 492 vv. Ky trend politik po vazhdon edhe deri më sot në Serbi.

⁷³⁹ Kra. Ruzica Rosandic: Grappling with Peace Education in Serbia, Peaceworks No. 33, United States Institute of Peace, prill 2000, f. 39 (www.usip.org).

⁷⁴⁰ Kra. p.sh. raportin për një projekt kërkimor për historinë e Evropës Juglindore nga Alexandra Demcisin: Den Mazedoniern ihre Mazedonen [Maqedonasve maqedonët e tyre], në: Die Presse, 6 tetor 2003, f. 26.

⁷⁴¹ Rreth sistemit shkollor dhe përmbajtjes së librave shkollorë në Serbi kra. R. Rosandic: Grappling with Peace Education in Serbia, Peaceworks No. 33, United States Institute of Peace, prill 2000, f. 15-22. Për një krahasim të librave të historisë për nxënësit e moshës mes 12 dhe 14 vjeç në shkollat në Serbi dhe në Kosovë dhe një analizë se si manipulohet historia, kra. N. Spahiu: Serbian Tendencies for Partitioning of Kosova, Budapest 1999, f. 15-37.

Kreu VII: Konkluzionet dhe perspektiva: Shprehje për një të ardhme evropiane të rajonit të Ballkanit Perëndimor

Kosova dhe e tërë hapësira e Evropës Juglindore gjenden në një fazë të transformimit dinamik. Për këtë arsye çdo aktivitet destruktiv nga ana e aktorëve politikë ndikon negativisht në dinamikën e krijimit të shtetit ligjor. Një prani e vazhdueshme e drejtpërdrejtë ose e tërthortë ushtarake dhe civile nga ana e demokracive të etabluara është e nevojshme, në mënyrë që të mund të nisët dhe të mbetet i ruajtur një mekanizëm i gjerë i sigurisë dhe që të mund të sigurohen kalimi në struktura demokratike dhe të sundimit të ligjit, respektimi i të drejtave të njeriut dhe ekonomia funksionale e tregut.

Integrimi i „ballkanasve” në strukturat evropiane ekonomike, demokratiko-liberale dhe politike të BE-së nuk është utopi, por një shans i kapshëm për etablimin e përhershëm të paqes dhe për sigurimin e përhershëm të paqes, i cili në histori nuk shfaqet shpesh. Mirëpo, duket se rrymat ekstremiste të skemës klasike ideologjike majtë-djathtë, në qoftë se në shek. XXI mund të bëhen ende klasifikime të tilla, nuk janë pjekur për këtë mundësi, të cilët, edhe në qoftë se janë pakicë, manifestohen vazhdimisht si dashakeqe.

Në rastin ekzistues, sipas mendimit tim, integrimi i Kosovës në strukturat evropiane me Beogradin si kryeqytet është jorealit dhe është, në qoftë se ndiqet caku i një etablimi dhe sigurimi afatgjatë të paqes, madje edhe i pamundshëm për shkak të politikës së Beogradit midis viteve 1989 dhe 1999 në Kosovë. Andaj, për të gjithë të interesuarit për një integrim evropian, duket e pashmangshme njohja reciproke.

Politika ditore ndoshta vepron shpesh paksa më ndryshe sesa ç’do të kërkonte realiteti i mbështetur në fakte, me ç’rast sipas mendimit tim nënçmohet rreziku që përsëri „të dërgohen sinjale të keqkuptueshme”. Në lidhje me paqen afatgjate, me këtë rast ekziston një vizion pesimist, që përmes politikës së interesave të njërës ose tjetrës Fuqi të Madhe në Ballkan të zhvillohet vetëdijshëm një „politikë e stabilizimit dhe e sigurisë e paaftë për të jetuar”. Konkretisht kjo do të paraqiste një relik të Lufta e Ftohtë, në të cilën është tentuar që paqja të mirëmbahet përmes hegjemonive rajonale.

D. SENGHAAS bën një krahasim të saktë historik lidhur me paaftësinë e zgjidhjes paqësore të mosmarrëveshjeve në kuadër të sigurisë kolektive dhe të humbjes së respektit që rezulton nga kjo, kundrejt institucioneve përkatëse në kontekstin evropëndimor dhe:

„[...] përkujton që në vitet e 1930-ta Italia fashiste e joshte ashtu Lidhjen e Popujve si një krijesë të fuqishme, siç e bënte për krahasim në vitet e kaluara

Serbia përballë KSBE/OSBE-së, BE-së, NATO-s dhe Kombeve të Bashkuara.⁷⁴²

Tri krijesa shtetërore me emërtimin *Jugosllavia*, pra Mbretëria e Jugosllavisë (1929 – 1941), RSFJ-ja (1945 – 1991) dhe RFJ-ja e *Milošević-it*, nuk mundën ta zgjidhin as ushtarakisht e as politikisht problemin e Kosovës. Për shkak të përvojave të deritashme historike dhe të situatës aktuale socio-psikologjike në Kosovë dhe rreth Kosovës, është jorealiste zgjidhja e përhershme e problemit të Kosovës përmes integritit në një „*Jugosllavi të katërt*” (p.sh. në RFJ-në e *Milošević-it* që në vitin 2000 ishte pranuar ndërkombëtarisht dhe e cila përkohësisht quhej Serbi-Mal i Zi) – ose madje në Serbi.

Këtë e konfirmojnë si ekspertët kosovarë, ashtu edhe ekspertët e pavarur ndërkombëtarë, të cilët mbetjen e Kosovës në RFJ-në e *Milošević-it* përkatësisht në Serbi e vlerësojnë mes tjerash si të rrezikshme për paqen.

Në mënyrë që të mund të zbatohen përpjekjet e shumicës dërrmuese të popullsisë vendase dhe të aktorëve të bashkësisë ndërkombëtare në lidhje me krijimin e një shteti të drejtës në Kosovë dhe që rajoni i Ballkanit Perëndimor të stabilizohet për periudhë afatgjate, e në të ardhmen të mund të integrohet politikisht dhe ekonomikisht në BE, përmes të cilës edhe nacionalizmave dhe shovinizmave ekstremë në rajon do t’u tregohen kufijtë, sipas mendimit tim janë këto *kushte të pashmangshme*:

- a) një angazhim politik dhe ekonomik afatgjatë dhe racional i demokracive perëndimore në Kosovë dhe në hapësirën e Ballkanit
- b) një zgjidhje e drejtë dhe etikisht e justifikueshme e çështjes së statusit të Kosovës, me ç’rast duhet të merret parasysh vullneti i popullit si dhe
- c) një pranim dhe një ballafaqim i plotë e me përgjegjësi lidhur me të kaluarën si bazë e mirëbesimit e të gjithë të involvuarve në konflikt për një të ardhme paqësore.

Etablimi dhe konsolidimi i shtetit ligjor në Kosovë dhe në hapësirën ballkanike do të jetë i suksesshëm, sipas mendimit tim, përkundër të gjitha kritikave të shprehura në Kosovë dhe jashtë vendit, në qoftë se zbatohen të përmendurat *kushte të pashmangshme*.⁷⁴³

⁷⁴² D. Senghaas: Frieden – Ein mehrfaches Komplexprogramm [Paqja – Një program shumëfish kompleks], në: Dieter Senghaas (ed.): Frieden machen [Të bësh paqen], Frankfurt mbi Main 1997, f. 568.

⁷⁴³ Në këtë kuptim në Kosovë ekziston mendimi se ky proces [dallon] „thelbësisht nga krijimi i shteteve në Evropë, ku fillimisht u krijua shteti dhe pastaj demokracia.” V. Surroi: Das Experiment Kosovo. Ehrgeizige Ziele – Unrealistische Erwartungen [Eksperimenti Kosovë. Caqe ambicioze – pritje jorealiste], në: Internationale Politik – Europa Archiv 3/2001, f. 27.

Lidhur me perspektivat për të ardhmen e Kosovës është për t'u përmendur se Kosova e ka popullsinë më të re të Evropës: dy të tretat e kosovarëve janë nën 30 vjeç. Kjo mund të ketë si rrjedhojë një zhvillim potencial, por edhe një shpërthim potencial të situatës.

Pa dashur të jap prognoza negative për të ardhmen, me luftën e fundit në Kosovë më 1999 janë „çimentuar” përsëri imazhet social-psikologjike të rrënjosura thellë për veten dhe për armikun midis Kosovës dhe Serbisë, përmes të cilës një kontakt midis dy kombeve duhet të shikohet si një „detyrim”. Në shoqërinë aktuale kosovare, përkatësisht serbe, kjo paraqet një realitet që nuk mund të shpërfilllet edhe në një rregullim të ardhshëm politik dhe në sfidat e ardhshme. Në mënyrë që të mund të drejtohet situata në Kosovë drejt një situatë *në të cilën paqja bëhet e „pathyeshme”*, duhet që si Serbia, ashtu edhe Kosova, t'i dallojnë kufijtë e realitetit. Më tutje do të duhej që edhe burokracia e bashkësisë ndërkombëtare, në vend që të insistojë në „rregullimin e konfliktit” larg realitetit, realitetin ta emërtojë me emër, ashtu që të pengojë situata të ardhshme „revolucionare”.

Për një kohë të caktuar strukturat e përkohshme administrative për Kosovën ishin shumë të dobishme dhe të pashmangshme për procesin e demokratizimit. Mirëpo, do të duhej edhe me kohë të dallohej se strukturat administrative provizore, „përgjithmonë” të përkohshme, më shumë anojnë që *status quo*-n ta „çimentojnë” në vend të paqes dhe shoqërohen me shpenzime në rritje dhe me rreziqe të brendshme e të jashtme. Që „projekti” i demokratizimit fundja të ketë sukses, bashkësia ndërkombëtare pas përfundimit të protektoratit *de facto* në Kosovë do të duhej të ketë arritur një paqe të qëndrueshme dhe stabilizimin e rajonit. Për këtë megjithatë mungon ende — së paku për opinionin — një vizion i qartë nga ana e bashkësisë ndërkombëtare.

Në diskutimin ndërkombëtar rreth problemeve në Ballkan herë pas here gjendet nocioni „Shqipëri e Madhe”, përkatësisht në kohë të fundit „Kosovë e Madhe”, që paraqet një produkt të propagandës serbe, kur bëhet fjalë për *njohjen e të drejtës për pavarësi* për Kosovën. Me atë rast injorohet fakti se kosovarët në rastin më të mirë në botëkuptimin kulturor, mirëpo jo edhe në botëkuptimin politik, e shohin veten si pjesë të kombit „shqiptaromadh”. Nëse në fund të shek. XIX kishte një „çështje shqiptare” në Ballkan, për shkak të zhvillimeve historike dhe socio-politike në hapësirat shqipfolëse, atëherë në fillim të shek. XXI kemi *disa* „çështje shqiptare”, të cilat të gjitha presin një përgjigje. Në afat të gjatë, stabilizuese mund të jetë vetëm një „përgjigje evropiane”, pra integrimi në BE. Me atë rast, sipas mendimit tim, megjithatë, nuk do të duhej të nënçmohet fakti se edhe një anëtarësim në BE jo në çdo konstelacion të mendueshëm shtetesh, automatikisht do të thoshte edhe një garantues për paqen, përkatësisht zgjidhjen e problemit të Kosovës.

Një ndarje e Ballkanit në shtete „thjesht” etnike, p.sh. në formë kantonesh, siç kanë kërkuar hapur disa herë pushtetmbajtësit në Beograd për pakicën serbe në Kosovë, do të ishte konstelacioni më i keq i mendueshëm për zgjidhjen e problemeve

në Ballkan. Në një rast të tillë „spastrimet etnike” do të vinin prapë në rend të ditës, siç ishte rasti në dhjetëvjeçarët e fundit.⁷⁴⁴

Fundja kosovarët dhe serbët përkundër të gjithave dhe pavarësisht asaj se kur do të arrihet një zgjidhje „përfundimtare”, mbesin fqinj dhe duhet të gjejnë forma të reja të jetës paqësore pranë njëri-tjetrit.

Edhe shtetet e etabluara ligjore, të cilët shfaqin fuqi të lartë të integritimit, qëndrojnë bashkë për shkak të interesave ekonomike dhe politike. Për shembull, shkencëtari i shkencave shoqërore Kas DEPRez deklaroi se përkundër konfliktit gjuhësor në rritje e sipër, Belgjika mund të qëndrojë si federatë, në qoftë se dhe përdërisa mbizotërojnë përparësitë e një shteti të përbashkët për flamanët dhe valonët.⁷⁴⁵

Në lidhje me Kosovën dhe Serbinë, megjithatë, tashmë për kohë të gjatë nuk ekzistojnë kurrfarë përparësish dhe para së gjithash asnjë interesim i dyanshëm për një shtet të përbashkët, nëse dikur ka ekzistuar. Prandaj, sipas mendimit tim, çdo „qëndrim bashkë” i imponuar në një shtet të përbashkët *vetvetiu* është i gjykuar për të dështuar. Një integrim mundet, vetëm vullnetarisht dhe i dëshiruar nga të dyja anët, të paraqesë një shans dhe bazë për të ardhmen. Edhe nëse është humbur shansi për një anëtarësim të përbashkët në BE i të gjitha shteteve të dikurshme federative jugosllave, megjithatë ekziston shansi për një bashkëpunim të ardhshëm në rrafshin e BE-së, gjë që njëkohësisht i përshtatet vizionit të të interesuarve për demokraci dhe sundim të ligjit në Kosovë, Serbi dhe në hapësirën ballkanike.

Më shumë se dhjetë vjet pas nënshkrimit të marrëveshjes së Dejtonit dhe më shumë se shtatë vjet pas miratimit të Rezolutës së OKB-së 1244 (1999) nuk mund të flitet për një „paqe pozitive” në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ndërsa edhe më pak në rastin e konfliktit serbo-kosovar. Një tërheqje e trupave paqësore ndërkombëtare do të kishte si pasojë luftën. Për këtë arsye gjendja në konfliktin serbo-kosovar më shumë i ngjan një *armëpushimi* sesa një *gjendjeje të paqes*.

„Çështja e Kosovës” vlen si test lakmushi i një ardhmërie evropiane të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Ideja e integritimit evropian ofron një alternativë paqësore dhe ekonomikisht premtuese ndaj tentimeve për bashkim etnikisht të determinuar të shekullit të fundit në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në rastin e konfliktit serbo-kosovar kjo megjithatë kushtëzohet nga njohja e kombit politik të kosovarëve.

Për ta lënë të bëhet realitet ideja e integritimit evropian në Ballkanin Perëndimor, është e pashmangshme një përkrahje e gjerë dhe konsistente e BE-së. BE-ja ka

⁷⁴⁴ Në një rast të tillë për shembull, do të ishte vështirë për të argumentuar, pse p.sh. kroatët ose serbët në Bosnjë dhe Hercegovinë nuk mund të bashkohen me Kroacinë përkatësisht Serbinë ose shqiptarët në Mal të Zi, në Maqedoni ose në Serbinë Jugore me Kosovën, sepse gjatë ndarjes territoriale të Kosovës vërtet do të vinte te ndryshimi i kufijve të njësive konstitutive të RSFJ-së.

⁷⁴⁵ Shiko Kas Deprez, në: Hanspeter Kriesi etj. (ed.): Nation and National Identity. The European Experience in Perspective, Cyrih 1999.

paraparë në afat të gjatë një ardhmëri evropiane për Kosovën dhe për tërë hapësirën e Ballkanit Perëndimor, mirëpo nuk ka ende plane konkrete dhe para së gjithash realiste se si mund të arrihet ky objektiv.⁷⁴⁶

Konflikti serbo-kosovar, i cili tashmë disa vjet nga bashkësia ndërkombëtare më shumë është „ngrirë” sesa zgjidhur, është bërë frenues i idesë së integrimit evropian jo vetëm për Serbinë dhe Kosovën, por edhe për tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Për shkak të një *brain drain* të vazhdueshëm, elitat janë duke munguar në përmasa të mëdha në zhvillimet politike.⁷⁴⁷ Deri më tani ishin elitat ato që e çuan përpara idenë e integrimit evropian në historinë e deritashme të integrimit në BE. Se si mund të zbatohet kjo ide në vendet e Ballkanit Perëndimor, në qoftë se elitat mbesin larg procesit të krijimit të shtetit ligjor përkatësisht mbahen larg nga kundërshtarët e shtetit ligjor funksional, ngelet një mister.

Strukturat demokratike, të sundimit të ligjit dhe të ekonomisë së tregut, mbesin edhe më tej tejet të brishta dhe prandaj janë të vogla edhe gjasat për një zbatim të parashikueshëm të shtyllave të skajshme të „heksagonit qytetërues”⁷⁴⁸.

Ky realitet i zymtë ndikon negativisht në konfliktin midis Serbisë dhe Kosovës. Rreth arsyeve të brishtësisë së strukturave të sundimit të ligjit do të duhej, sipas mendimit tim, të hulumtohet më shumë në nivelin ndërdisiplinor, për të nxjerrë mundësi inovative të rrugëdaljes nga kjo situatë. Kjo do t’i ndihmonte si BE-së ashtu edhe rajonit të Ballkanit Perëndimor që ta perceptojnë në mënyrë më të diferencuar nevojshmërinë e sigurisë së gjerë afatgjate dhe ardhmërinë e procesit të demokratizimit dhe të transformimit në këtë rajon evropian dhe t’i nisin në mënyrë të qëndrueshme masat e nevojshme për etablimin dhe sigurimin e shtetit ligjor.

Për suksesin e proceseve të integrimit në BE në rajonin e Ballkanit Perëndimor në kuptimin e një etablimi afatgjatë të paqes është e pashmangshme një zgjidhje e përhershme dhe e qëndrueshme në konfliktin serbo-kosovar, e cila mund të arrihet vetëm përmes një *„zgjidhjeje të drejtë”* të „çështjes së Kosovës”. Mirëpo, për një zgjidhje të drejtë të „çështjes së Kosovës” mund të flitet vetëm atëherë, kur vendimi

⁷⁴⁶ Krah. United States Institute of Peace (USIP), Special Report, Kosovo Decision Time. How and When?, Uashington DC, shkurt 2003, f. 2 (www.usip.org).

⁷⁴⁷ Krah. Vedran Horvat: Brain Drain. Threat to Successful Transition in South East Europe?, në: Southeast European Politics, vëll. V, nr. 1, qershor 2004, f. 91. Gjendja e mjerueshme ekonomike në Kosovë i shtyn shumë kosovarë, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike të shpërngulen në vende ekonomikisht të zhvilluara. Humbja e kapaciteteve njerëzore si për institucionet vendore ashtu edhe për ato ndërkombëtare në Kosovë megjithatë përmendet vetëm rrallë.

⁷⁴⁸ Heksagoni (gjashtëkëndëshi) qytetërues paraqet një qasje në hulumtimin e paqes, i cili bashkon gjashtë aspektet vijuese: monopoli i pushtetit, sundimi i ligjit, interdependencat dhe kontrolli i afektit, participimi demokratik, barazia sociale dhe kultura e konfliktit. Për më shumë detaje rreth heksagonit qytetërues krah. Dieter Senghaas: Frieden als Zivilisierungsprojekt [Paqja si projekt i qytetërimit], në: D. Senghaas (ed.): Den Frieden denken, *Si vi pacem, para pacem* [Ta mendosh paqen, *Si vi pacem, para pacem*], Frankfurt mbi Main 1995, f. 196 vv.

për këtë çështje të bazohet në radhë të parë në interesat e kosovarëve. Për këtë arsye, çështja primare nuk do të duhej të ishte se a do të duhej të njihej e drejta për vetëvendosje e kosovarëve apo jo, por cila është rruga që Serbinë, Kosovën dhe tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor i çon deri te shtetet ligjore funksionale.

Zgjidhja e konfliktit serbo-kosovar në kuptimin e idesë së integritimit evropian do t'i nxiste si Serbinë dhe Kosovën që në mënyrë konstruktive ta përballojnë të kaluarën që rëndon „paqen pozitive” dhe përmes kësaj të vendosin një moment historik në procesin e etablimit dhe sigurimit afatgjatë të paqes. Kjo do t'i rriste shanset e procesit të krijimit të shtetit ligjor, i cili sipas mendimit tim në konfliktin serbo-kosovar mund të iniciohet vetëm përmes një njohjeje reciproke.


Në këtë proces është e pashmangshme një kulturë politiko-demokratike. Zhvillimi i një kulture politiko-demokratike presupozon megjithatë një standard të caktuar ekonomik dhe shanse reale dhe të sinqerta që të merret përsipër dhe të dëshmohet përgjegjësia politike. Në Kosovën nën administrimin e UNMIK-ut këto ekzistojnë vetëm në mënyrë të pamjaftueshme.

Ideja themelore evropiane e ushtrimit të përbashkët të të drejtës së vetëvendosjes do të duhej të bëhej realitet edhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, me ç’rast kërkesa e kosovarëve për një sovranitet shtetëror duhet të kuptohet në kontekstin e „qeverisë komplekse”, ku forma të reja të drejtimit politik e kufizojnë gjithnjë e më shumë aftësinë e veprimit autonom të shteteve kombëtare.⁷⁴⁹ Njohja reciproke midis Kosovës dhe Serbisë si partnerë të barasvlershëm — dhe përmes kësaj njohja e pavarësisë së Kosovës brenda kufijve të garantuar me kushtetutën e RSFJ-së nga viti 1974 — është premisa për zgjidhjen e konfliktit serbo-kosovar në kuptimin e idesë së integritimit evropian. Të gjitha mendimet e tjera të zgjidhjes, sipas gjasave më të mëdha, do të ishin të lidhura me përmbysje të mëdha, me shkatërrim dhe viktima dhe kështu edhe do ta shtynin larg procesin e etablimit afatgjatë të paqes dhe të sigurimit të paqes si dhe perspektivën e BE-së për këto vende.

Figura pasuese (nr. 3) jep një pasqyrë rreth skenarëve të mundshëm të integritimit në BE për rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në mënyrë skematike ajo paraqet konkluzionet e këtij libri, duke u lidhur me modelin shumëdimensional të integritimit (figura 2).

⁷⁴⁹ Krah. J. Pollak: Zur politischen Identität der Europäischen Staatengemeinschaft, Europäische Hochschulschriften, Bd./Vol. 364 [Rreth identitetit politik të bashkësisë së shteteve evropiane, Shkrimi Universitare Evropiane, vëll. 364], Frankfurt am Main etj. 1998, f. 180.

Figura nr. 3:



Nën presupozimin e një procesi të suksesshëm të integrimit në BE, në skenarin e parë tregohet mundësia e zgjidhjes së konfliktit serbo-kosovar në kuptimin e idesë së integrimit evropian, e cila njëkohësisht prognozohet një etablim dhe sigurim afatgjatë të paqes në Serbi dhe Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në këtë rast kërkesat për ndryshime të kufijve në rajonin e Ballkanit Perëndimor do të humbnin rëndësinë dhe përmes kësaj do t'u jepej fund edhe shpresave të politikanëve me mendësi etno-nacionaliste, jo vetëm në Serbi dhe Kosovë, por edhe në Bosnjë e Hercegovinë dhe Maqedoni. Në rrugën e anëtarësimit në BE për vendet e Ballkanit Perëndimor nuk do të qëndronin më pengesa të pakalueshme dhe do të kishte shpresë për një paqe të qëndrueshme afatgjatë.

Në skenarin e dytë merret në shqyrtim mundësia e anëtarësimit në BE e vendeve të Ballkanit Perëndimor, edhe pse Serbia dhe Kosova megjithatë nuk pranojnë njëra-tjetrën si shtete të pavarura. Te ky skenar, si për Serbinë ashtu edhe për Kosovën shpresat do të ishin shumë të pavolitshme për t'i plotësuar kriteret e Kopenhagës, sepse edhe më tej do të ekzistonte rreziku i një shpërthimi të dhunës. Antagonizmat në konfliktin serbo-kosovar do të vazhdonin me probabilitet të lartë, edhe sikur të përmbusheshin kriteret për një anëtarësim në BE ose BE-ja të nxirrte rregulla të

jashtëzakonshme me shpresën se do ta zgjidhte në mënyrë të qëndrueshme konfliktin serbo-kosovar. Në rast të një anëtarësimi në BE pa njohje reciproke, përveç kësaj hapësira e Ballkanit Perëndimor do të ishte e prekshme më fort për aktivitete terroriste – ngjashëm me disa shtete anëtare të BE-së, të cilat janë bërë cak i sulmeve me motivim politik nga ana e grupimeve separatiste.

Skenari i tretë dhe i katërt prognozojnë për rastin e një integrimi parcial në BE (skenari 3) përkatësisht për rastin e dështimit të procesit të integrimit në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor (skenari 4) në një gjallërim të ideve etno-nacionaliste. Këto ide, të cilat si objektiv dhe ideal definojnë krijimin e shteteve mono-etnike „kombëtaromëdha”, përmbajnë potencial të fortë të dhunës dhe mund të çojnë në rastin ekstrem deri te konfliktet luftarake për territore, të lidhura këto me përmbysje më të mëdha, me shkatërrim dhe me viktima. Ndërsa skenari i tretë tregon rastin e një integrimi parcial në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor, integrim që mbetet pa ndikim ndaj një potenciali etno-nacionalist të dhunës që vazhdimisht ekziston më tutje, skenari i katërt pasqyron rastin ekstrem të dështimit të proceseve të integrimit në BE dhe rifillimin e veprimeve luftarake.⁷⁵⁰

Duke u nisur nga këta skenarë, bashkësia ndërkombëtare dhe sidomos BE-ja në proceset e përballimit të konflikteve dhe në proceset e integrimit në BE do të duhej të merrnin parasysh më fort *karakteristikat specifike socio-politike të rajonit të Ballkanit Perëndimor*, të cilat, siç u tregua në këtë punim, janë krijuar gjatë rrjedhës së historisë dhe bashkëpërcaktojnë realitetin kompleks të të tanishmes. Vetëm kështu mund të etablohet dhe sigurohet në periudhë afatgjate paqja në rajonin e Ballkanit Perëndimor në kuptimin e idesë së integrimit evropian. Në thelbin e këtyre *karakteristikave specifike socio-politike të rajonit të Ballkanit Perëndimor* bën pjesë kombi politik i kosovarëve, i cili do të duhej edhe të njihej sipas të drejtës ndërkombëtare. Një njohje reciproke sipas të drejtës ndërkombëtare e Serbisë dhe e Kosovës në vijën e integrimit në BE do t'u ndihmonte edhe këtyre vendeve të krijojnë një bazë „minimale” të përbashkët të vlerave, objektivave dhe interesave ideo-politike që nevojiten për procesin e përballimit të konfliktit, pa të cilat ato nuk mund të ndërveprojnë aktivisht dhe të marrin pjesë në procesin e integrimit në BE.

Rreziku i përsëritjes së ngjarjeve të dekadave të fundit mbetet real me zhvillimet aktuale socio-politike në konfliktin serbo-kosovar edhe në shekullin XXI. Trembëdhjetë vjet pas vitit të kthesës 1989, as bashkësia ndërkombëtare e as vendet e Ballkanit Perëndimor dhe posaçërisht Serbia e Kosova, nuk guxojnë t'i japin një shans këtij rreziku. Të gjithë këta aktorë kanë një interes të madh pragmatik që të zgjidhet konflikti serbo-kosovar dhe të lënë të bëhet realitet „paqja pozitive”. Në rast të dështimit të etabllimit dhe të sigurimit afatgjatë të paqes, do të ishin po ashtu të

⁷⁵⁰ Gjatë përpilimit të skenareve të tilla, të cilat në mënyrë implicite pretendojnë të parashikojnë zhvillimet e ardhshme, rritet probabiliteti i pohimeve të gabuara sidomos në shkencat shoqërore. Për këtë arsye skenaret e tilla do të duheshin kuptuar si ndihmesa interpretimi për kohën e tanishme dhe jo si prognoza për të ardhmen.

mëdha humbjet për të gjithë aktorët e involvuar në dhe rreth konfliktit serbo-kosovar. Asnjëri prej këtyre aktorëve nuk dëshiron të jetë në anën e humbësve. Për këtë arsye objektivi i përbashkët kryesor i këtyre vendeve, pra integrimi në BE dhe në strukturat euro-atlantike, do të duhej të ndiqej shumë më qartë dhe në mënyrë më vendimtare dhe t'i jepej përparësi përballë çdo alternative tjetër.

Pasthënie

Zgjidhja e qëndrueshme e çështjes së Kosovës' është parakusht për një proces të suksesshëm të demokratizimit dhe të transformimit, si për Kosovën ashtu edhe për vendet fqinje të saj. Pa këtë zgjidhje, gjasat e integrimit në BE të këtyre vendeve i ngjajnë më fort një utopie sesa një realiteti. Çështja e statusit të pazgjidhur të Kosovës nuk guxon të jetë më tej faktori kryesor pengues për stabilitetin afatgjatë politik dhe ekonomik dhe për integrimin në BE të rajoni të Ballkanit Perëndimor.

Çdo alternativë ndaj integrimit në BE do të ishte jostabilitet i përhershëm për vendet e Ballkanit Perëndimor. Nëse politikat e interesave të njëjës ose tjetrës Fuqi të Madhe në Ballkan e marrin përparësinë kundruall një politike funksionale të stabilizimit dhe të sigurisë, ky skenar pesimist i jostabilitetit bëhet më real. Faza përfundimtare e përcaktimit të statusit të Kosovës është e karakterizuar nga një politikë *ultima ratio* e demokracive perëndimore kundër lojës së pokerit të regjimeve euro-aziatike të udhëhequra në mënyrë autokrate.

Konflikti midis Serbisë dhe Kosovës do të bëhet një shekull i vjetër në vitin 2012. Njëkohësisht një zgjidhje e qëndrueshme është aq afër si asnjëherë më parë. Më 3 prill 2007, ish-presidenti finlandez dhe i ngarkuari i OKB-së Martti AHTISAARI prezantoi propozimin e vet për zgjidhjen e konfliktit serbo-kosovar. Ky propozim u përshëndet pa përjashtim nga bota e qeverisur në mënyrë demokratike dhe paraqet esencën e njëjës prej mundësive të zgjidhjes të udhëhequr nga parimi *ultima ratio*. Kjo kornizë e zgjidhjes përmban një bazë solide për ta çuar përpara Ballkanin Perëndimor në mënyrë të pakthyeshme në drejtim të demokracisë, të sundimit të ligjit dhe të integrimit euro-atlantik.

Ndërrimi i qeverisë në tetor 2000 në Serbi nuk ka ndikuar qenësisht deri më sot në qëndrimin përballë Kosovës. Për dallim nga kjo, në vitet e fundit në demokracitë perëndimore shënohet një vetëdije e përgjegjësive në rritje e sipër në lidhje me çështjet e hapura politiko-juridike në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Kjo ofron shanse reale për një zhvillim të qëndrueshëm pozitiv drejt një rajoni të Ballkanit Perëndimor që është stabil dhe i aftë për t'u integruar. Shanset e kapshme të vendeve të Ballkanit Perëndimor nuk do të duhej të bëhen viktimë e psikozave të politikës së pushtetit të Fuqive të Mëdha euro-aziatike, të cilat kërcënojnë me themelimin e një Tajvani të dytë.

Serbia, e cila qeveriset nga elitat politike etno-nacionaliste, do të duhet *volens* ose *nolens* të sillet deri aty që ta pranojë sovranitetin e Kosovës dhe të etablojë marrëdhënie fqinjësore të mira dhe paqësore me Kosovën dhe me vendet e tjera fqinje. Çdo alternativë tjetër dhe çdo zgjidhje tjetër e përkohshme do të thoshte *de facto* një vazhdim i „Luftës së Ftohtë” midis Serbisë dhe Kosovës dhe me këtë do ta bënte të pamundshme perspektivën evropiane. Ndoshta do të kishte qenë më mirë

dhe më e volitshme që më së voni më 1999 edhe Serbia të vendosej nën administrim të drejtpërdrejtë ndërkombëtar, ngjashëm me përvojat pas fundit të Luftës së Dytë Botërore në Evropën Perëndimore!

Në çështjet që në këtë libër u identifikuan si pengesa dhe probleme të hapura gjatë përballimit të konfliktit serbo-kosovar, propozimi i M. AHTISAARI-t ofron zgjidhje dhe përgjigje të kapshme. Sipas kësaj jo vetëm kombi politik i kosovarëve do të duhej të pranohej ndërkombëtarisht, por të zgjidhej njëkohësisht edhe çështja e personave të zhdukur, kthimi i gjëseneve kulturore, i borxheve të Kosovës pranë institucioneve financiare ndërkombëtare dhe çështja e të drejtave të komuniteteve. Prandaj kërkohen veprime të shpejta dhe konsekuente si dhe një zbatimi i plotë i propozimit. Çdo zvarritje do të thoshte automatikisht një shans për forcat ekstremiste, ndërsa sa kohë çështja e statusit të Kosovës mbetet e pazgjidhur, ajo mbetet edhe e keqpërdorshme nga këto forca.

Kurthet e RFJ-së së *Milošević-it* ndikojnë ende, sepse me kalimin e kohës ato kanë marrë vlefshmëri të caktuar ligjore sipas të drejtës ndërkombëtare. Propozimi i M. AHTISAARI-t përcakton në aneksin VII garantimin e kufijve të Kosovës ashtu siç ishin para 31 dhjetorit 1988, kur Kosova ishte pjesë e RSFJ-së – me një përjashtim. Në aneksin VII, neni 3.3 të propozimit të M. AHTISAARI-t pranohet marrëveshja midis RFJ-së së *Milošević-it* dhe Republikës së Maqedonisë nga 23 shkurti 2001. Duke u bazuar në këtë, Maqedonia do të jetë në gjendje sipas të drejtës ndërkombëtare që t'i kërkojë afro dy mijë hektarë tokë të Kosovës të premtuara nga RFJ-ja e *Milošević-it*. Këtu thyhet një parim deri më sot i respektuar në mënyrë konsekuente nga bashkësia ndërkombëtare – mosndryshueshmëria e kufijve të njësisive federative të RSFJ-së dhe atë përmes njohjes ndërkombëtare të një marrëveshjeje midis dy njësisive të dikurshme federale të RSFJ-së, e cila është lidhur në dëm të një njësie të tretë. Kjo do të mund të interpretohet si derë e pasme për politikën etno-nacionaliste. Pjekuria politike në këtë rast kërkohet si nga Maqedonia ashtu edhe nga Kosova, në mënyrë që të mos bëhen viktima të kurthit serbomadhi. Duhet të gjendet një zgjidhje midis Shkupit dhe Prishtinës që bazohet në vullnetin e fqinjësisë së mirë. Një prishje simbolike e kësaj marrëveshjeje me RFJ-në e *Milošević-it* nga ana e Republikës së Maqedonisë do të ishte e dobishme, në mënyrë që të përmbillet procesi i dezintegritimit të RSFJ-së me një akt pozitiv.

Shumica dërrmuese e njerëzve si në Kosovë ashtu edhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor është e interesuar për siguri dhe për prosperitet ekonomik dhe jo për ide dhe plane frikësuese etno-nacionaliste. Zhvillimi i mëtejshëm i rajonit të Ballkanit Perëndimor prejjudikon paqe, liri, demokraci dhe sundim të ligjit, kurse për këtë premisë është e pashmangshme një Kosovë sovranë. Dhe Kosova do të bëhet sovranë, fundja për atë arsye, sepse Kosova si pjesë e Serbisë nuk përshtatet në imazhin e mendimit shtetëror serb, në qoftë se bëhet fjalë që afro dy milion kosovarëve të etnitetit shqiptar t'u jepet qasje në një bashkëjetesë demokratike brenda një Serbie multietnike.

Kreu VIII: Përfytyrimi i integritit evropian dhe vazhdimi i konfliktit serbo-kosovar

A. Konflikti që vazhdon

Një jurist i njohur që prej kohësh dhe sistematikisht i studion çështjet e shtetit të të drejtës si dhe ato kushtetuese të shteteve të dala nga ish-Federata Jugosllave, ka konkluduar, mes të tjerash, se „shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk është fundi i historisë së gjatë të një marrëdhënieje të vështirë mes formacioneve të ndryshme shtetërore serbe dhe shqiptarëve të Kosovës, por vetëm fillimi i një kapitulli të ri.”⁷⁵¹ Nëse vërtet edhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 dhe njohjes së saj ndërkohë nga më se gjysma e anëtareve të OKB-së, kemi të bëjmë vetëm me fillimin e një kapitulli të ri në raportet mes shtetit serb dhe shqiptarëve të Kosovës, pra jo shtetit të Kosovës, atëherë konsideroj se duhet shtruar mbi të gjitha pyetja bazë: Çfarë në fakt (s')është arritur në tejkalimin e qëndrueshëm të konfliktit Serbi – Kosovë që nga qershori i vitit 1999 e këndej?

Kjo pyetje fiton peshë dhe relevancë sidomos në rastet kur hipoteza bazë është se konflikti Serbi – Kosovë mund të tejkalohet vetëm nëse arrihet një njohje e ndërsjellë si subjekte të barabarta. Edhe organizata me zë që merren me studimin dhe analizimin e konflikteve nëpër botë në 2010 konkludonin ngjashëm: „Çështja e njohjes diplomatike të shtetësisë së Kosovës është thelbi i problemit.”⁷⁵² Pra, përderisa nuk arrihet që të zgjidhet në mënyrë të qëndrueshme „thelbi i problemit”, as nuk mund të pritët tejkalimi i qëndrueshëm i konfliktit e aq më pak të bëhet realitet ‚paqja pozitive’ në konfliktin Serbi – Kosovë.

Në njërën anë Kosovës i duhet njohja nga Serbia; pa këtë njohje, Rusia dhe Kina nuk pritët të pranojnë ndonjëherë anëtarësimin e Kosovës në OKB. Në anën tjetër, Serbisë i duhet po ashtu ta njohë Kosovën; pa e njohur, ajo e ka pothuajse të pamundshme të etablohet si shtet funksional me territor të definuar, një kusht ky për anëtarësimin e saj në BE. Meqenëse të dy palëve u nevojitet e njëjta gjë, pse nuk po ndodh kjo? Arsyet mund të jenë të shumta. Megjithatë, në mënyrë të përmbledhur, si ndër më kryesoret, konsideroj se janë këto:

1. Elita politike e Kosovës nuk arrin dhe nuk ka vullnet të qartë të jetësojë marrëdhënie të bazuara në reciprocitet shtetëror me Serbinë. Madje, mosnjohja nga ana e Serbisë, e me këtë edhe krijimi i kushteve të pavolitshme për

⁷⁵¹ Joseph Marko: *The New Kosovo Constitution in a Regional Comparative Perspective*, në: *Review of Central and East European Law* 33, 2008, f. 437.

⁷⁵² *Kosova dhe Serbia pas Mendimit të GjND-së*, Raport për Evropë i Grupit të Krizave, Nr. 206, 26 gusht 2010, f. i.

funkcionimin e shtetit ligjor në Kosovë, duket se i përshtatet një numri domethënës të udhëheqësve kosovarë, duke ua lehtësuar atyre vazhdimin e udhëheqjes me praktika qeverisëse të karakterizuara nga korrupsioni dhe mungesa e përgjegjësisë.

2. Serbia duket se ende nuk është bindur plotësisht se vërtet i duhet ta njohë Kosovën. Asnjëri nga faktorët me ndikim ndërkombëtar nuk ka kërkuar shprehimisht, të paktën jo publikisht, dhe nuk e ka kushtëzuar në mënyrë serioze Serbinë për ta njohur Kosovën shtet të pavarur dhe sovran.
3. Një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare ka trajtim preferencial ndaj Serbisë. Serbia, pas bombardimit të saj nga NATO në vitin 1999, ende e konsideron veten viktimë, dhe një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare preferon trajtim të tillë dhe favorizues ndaj saj. Kjo ndodh ndër të tjera edhe për shkak të kapaciteteve ekonomike, ushtarake, politike e institucionale të Serbisë, të cilat janë më të avancuara sesa ato të Kosovës dhe të vendeve të tjera në rajon. Për më shumë, vardisja e njëkohshme e Serbisë edhe pas BE-së edhe pas Ruisë, përdoret si një lloj mase kërcënuese ndaj botës perëndimore, duke e mbajtur të hapur opsionin e një riorientimi politik të saj drejt Ruisë.

Kështu, siç është elaboruar edhe në kapitujt paraprakë të këtij libri e do të analizohet edhe në vijim të këtij kapitulli, mosnjohja e ndërsjellë mes Serbisë dhe Kosovës ende mbetet burimi dhe shkaktari kryesor i pothuajse të gjitha sfidave të tjera në raportet Serbi – Kosovë, e me këtë edhe shkaktari që pamundëson arritjen e paqes së qëndrueshme dhe pozitive.

B. Sjelljet e palëve në konflikt

Sjelljet e palëve në konfliktin serbo-kosovar vazhdojnë të udhëhiqen nga interesa afatshkurtër e pa ndonjë vizion të qartë se si të tejkalohet konflikti në mënyrë të qëndrueshme e afatgjate. ShBA-ja ngelet fokusuar në rajone të tjera problemore të rruzullit. BE, e lodhur nga zgjerimet paraprake si dhe nga destabiliteti i vazhdueshëm në rajonin e Ballkanin Perëndimor, si dhe konfliktet në rajonet e tjera të botës, vazhdon të mbetet e përçarë lidhur me pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës. Kështu mungesa e një qëndrimi unik nga ana e BE-së lidhur me pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës po e pamundëson perspektivën reale për ta shfrytëzuar procesin e integritimit në BE si strategji për tejkalimin e qëndrueshëm të konfliktit mes Serbisë dhe Kosovës. Ndërsa qeveritë në Kosovë njëra pas tjetrës preferojnë që para qytetarëve t'i heshtin dështimet për ndërtimin e një shteti ligjor e funksional dhe t'i mbajnë sa më të mjegulluara e jotransparente koncesionet e bëra dhe obligimet e

marra kundruall bashkësisë ndërkombëtare, qeveritë në Serbi radhazi synojnë vardisjen me Federatën Ruse dhe njëkohësisht përafrimin e shtetit me BE-në, duke u betuar njëkohësisht se pavarësia dhe sovraniteti i Kosovës s' do të pranohen kurrë, si dhe duke e pritur momentin e radhës për ndarjen eventuale, ose edhe për ripushtimin e pjesës së plotë të Kosovës.

Kështu, Serbia dhe Kosova i vazhdojnë mospajtimet lidhur me statusin për Kosovën. Më 4 dhjetor 2007, BE, ShBA dhe Rusia (Trojka) raportuan se „palët nuk ishin në gjendje të arrinin një marrëveshje mbi statusin përfundimtar të Kosovës”, meqenëse asnjëra nuk ishte gati të tërhiqej nga qëndrimi lidhur me çështjen thelbësore, atë se kush është sovran i Kosovës.⁷⁵³ Pas dy vjetësh të negociatave për statusin e Kosovës, të udhëhequra nga i dërguari i posaçëm i Kombeve të Bashkuara, dy dokumente u bënë të njohura për publikun: Raporti i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Statusin e Ardhshëm të Kosovës⁷⁵⁴; dhe Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës⁷⁵⁵ (në vazhdim: propozimi i M. AHTISAARI-t), i cili ishte baza e kushtetutës së ardhshme të Kosovës. Kuvendi i Kosovës tashmë e kishte aprovuar një Deklaratë më 5 prill 2007 me të cilën shprehej qëllimi i pranimet të të gjitha përgjegjësive dhe detyrimeve të përcaktuara në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të parashtruar para Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, duke u zotuar për implementimin e plotë të tij, dhe duke i konsideruar dispozitat e përfshira në të si të obligueshme për Kosovën. Më tej, në seancën plenare të mbajtur më 15 shkurt 2008, pra vetëm dy ditë para se të shpallej pavarësia, Kuvendi i Kosovës miratoi një vendim për shmangie nga Rregullorja e Punës për të mundësuar miratimin e ligjeve të identifikuar në propozimin e M. AHTISAARI-t dhe legjisllacionin e ndërlidhur me të.⁷⁵⁶

Duke pasur parasysh bllokimin e shkaktuar nga Federata Ruse dhe Kina në Këshillin e Sigurimit të OKB-së si dhe dështimin e bisedimeve për arritjen e një marrëveshjeje për statusin, shpallja e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran u bë në koordinim me shtetet mbështetëse të një Kosove të pavarur dhe sovran bazuar në propozimin e M. AHTISAARI-t. Përfaqësuesit e popullit të Kosovës shpallën pavarësinë më 17 shkurt 2008 duke deklaruar Kosovën shtet të pavarur e sovran. Kuvendi i Kosovës i pranoi të gjitha detyrimet që ngërthen propozimi i M. AHTISAARI-t. Veç kësaj, përfaqësuesit e popullit të Kosovës mirëpritën mbështetjen e vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare për zhvillimin demokratik të Kosovës,

⁷⁵³ Report of the European Union/United States/Russian Federation Troika on Kosovo, 4 December 2007 (<http://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kosovo%20S2007%20723.pdf>).

⁷⁵⁴ Shih Report of the Special Envoy of the Secretary-General on Kosovo's future status (<http://www.unosek.org/docref/report-english.pdf>).

⁷⁵⁵ Shih Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement (http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf).

⁷⁵⁶ Shih Kuvendi i Kosovës, Vendim, V-014, Prishtinë, më 15 shkurt 2008 (http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Vendim_Rregulorja.pdf).

nëpërmjet pranive ndërkombëtare të vendosura në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Bazuar në iniciimin e Serbisë në 2008, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së kërkoi nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (në vazhdim: GjND) ta jepte një mendim këshillëdhënës për pyetjen: „A është deklarimi unilateral i pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes të Kosovës në përputhje me të drejtën ndërkombëtare?”⁷⁵⁷ GjND-ja konstatoi se deklarata e pavarësisë së Kosovës „nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare, Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999) ose Kornizën Kushtetuese”. Pra, GjND-ja vetëm konkludoi se nuk ekzistonin ndalesa për shpalljen e pavarësisë, por jo edhe se Kosova kishte leje ta bënte këtë gjë ose se e kishte „të drejtën për t’u shkëputur nga shteti”.⁷⁵⁸

Udhëheqësit e Kosovës shpresonin se mendimi i GjND-së do të nxiste njohje të reja, meqë po kjo gjykatë konkludoi se Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, e datës 17 shkurt 2008, nuk e kishte shkelur të drejtën ndërkombëtare e as Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Nga Grupi Ndërkombëtar i Krizave mendimi këshillues i GjND-së i korrikut të vitit 2010 u pa si mundësi që Kosova dhe Serbia t’i tejkalonin dallimet, të vendosnin marrëdhënie dypalëshe dhe ta zhbloktonin rrugën e tyre drejt integritit në BE.⁷⁵⁹ Zhvillimet pas korrikut 2010 dëshmojnë se mendimi këshillues i GjND-së nuk rezultoi as me rritjen e trendit të njohjeve të Kosovës nga shtetet e tjera, e as nuk u shfrytëzua si bazë për tejkalimin e dallimeve thelbësore në raportet konfliktuale Serbi – Kosovë.

Për më shumë, mendimi këshillues i GjND-së nuk rezultoi as me tejkalimin e përçarjeve përbrenda vetë BE-së. Kështu, organizimi i bisedimeve Kosovë – Serbi shfaqet si sfidë edhe për vetë BE-në e përçarë; 23 prej 28 anëtarëve të saj e kanë njohur pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës, ndërsa 5 nuk e kanë bërë këtë. Brenda BE-së së përçarë duket të jenë krijuar dy taborë: njëri mbështet zgjidhjen gjithëpërfshirëse, kurse tjetri përfaqëson qëndrimin se vetëm qasja graduale, e filluar me çështjet e dialogut teknik, është e realizueshme.⁷⁶⁰ Serbia, nga ana e saj, vazhdon të deklarohet e vendosur të mos e njohë kurrë „deklaratën e njëanshme të pavarësisë” së Kosovës. Ky qëndrim i Serbisë, si dhe frika nga precedenti eventual secesionist, janë argumentet që përdoren nga pesë anëtarët e BE-së që nuk njohin Kosovën.

⁷⁵⁷ United Nations, A/RES/63/3, Resolution adopted by the General Assembly on 8 October 2008, Request for an advisory opinion of the International Court of Justice on whether the unilateral declaration of independence of Kosovo is in accordance with international law (http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/63/3).

⁷⁵⁸ Shih International Court of Justice, 22 July 2010 (<http://www.unmikonline.org/Documents/ICJ%20decision%20on%20Kosovo%2022%20July%202010.pdf>).

⁷⁵⁹ Kosova dhe Serbia pas Mendimit të GjND-së, Raport për Evropë i Grupit të Krizave, Nr 206, 26 gusht 2010, f. i.

⁷⁶⁰ Shih po aty.

Më 2010 Asambleja e OKB-së miratoi Rezolutën 64/298 me të cilën mirëpret gatishmërinë e BE-së për ta lehtësuar dialogun mes Kosovës e Serbisë.⁷⁶¹ Nga 2011 deri më 2014 u arritën disa marrëveshje teknike dhe konkluzione mes dy palëve, qëllimi i të cilave është normalizimi i marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë. Marrëveshjet e arritura kanë të bëjnë me: lirinë e lëvizjes; regjistrat civilë; librat kadastralë; vulat doganore; njohjen e ndërsjellë të diplomave; të ashtuquajturën marrëveshje IBM⁷⁶²; përfaqësimin dhe bashkëpunimin rajonal; telekomin; energjinë; krijimin e katër komunave të reja; krijimin e Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe; policinë dhe sigurinë; drejtësinë; si dhe për çështje të tjera të interesit të përbashkët. Kështu, më 19 prill 2013 Kosova dhe Serbia arritën një marrëveshje 15-pikëshe, e cila garanton një autonomi të veçantë për Asociacionin/Bashkësinë e komunave me shumicë të popullsisë serbe në këmbim të shpërbërjes së strukturave paralele serbe në komunat veriore të Kosovës. Më 27 qershor 2013, Kuvendi i Kosovës miratoi një „Ligj për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë”.⁷⁶³

Edhe pse marrëveshja duket të ketë për qëllim shtyrjen përpara të procesit të integritimit në BE si për Kosovën ashtu edhe për Serbinë, në formë të përmbledhur kritikës kryesore lidhur me përmbajtjen e saj janë se rrezikon karakterin multietnik të shoqërisë kosovare dhe se disa nga pikat e saj janë në kundërshtim me frymën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.⁷⁶⁴

Qeveria e Kosovës preferon që zbatimin e propozimit të M. AHTISAARI-t ta shoqërojë me një plan ekonomik zhvillimor si zgjidhje për veriun e Kosovës. Ndërsa, qeveria e Serbisë kërkon t'i çojë përpara aspiratat e veta për në BE, por duke mos e njohur pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës si dhe duke e synuar realizimin e një statusi të veçantë autonom për serbët, në veçanti për pjesën veriore të Kosovës.

Edhe pas vitit 1999, secila qeveri në Beograd e ka mbajtur çështjen e Kosovës

⁷⁶¹ United Nations, A/64/L.65/Rev.1, Resolution adopted by the General Assembly on 9 September 2010, Request for an advisory opinion of the International Court of Justice on whether the unilateral declaration of independence of Kosovo is in accordance with international law (http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/64/298&referer=http://www.un.org/en/ga/64/resolutions.shtml&Lang=E).

⁷⁶² Përderisa siç duket për BE-në dykuptëshmëria e interpretimit ka qenë vetë dredhia, pala kosovare dhe ajo serbe vazhdojnë ta interpretojnë në mënyra të ndryshme këtë marrëveshje. Sipas interpretimit kosovar „B” i referohet kufirit (border), ndërsa sipas interpretimit serb „B” i referohet vijës ndarëse (boundary). Megjithatë, në kontekstin e BE-së, IBM qëndron për „Menaxhimin e Integruar të Kufirit” (Integrated Border Management).

⁷⁶³ Ligji Nr. 04/L-199, 27 qershor 2013 (<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20ratifikimin%20e%20marreveshjes%20se%20pare%20per%20normalizimin%20e%20marredhenjeve%20Kosove%20Serbi.pdf>).

⁷⁶⁴ Shih Adem Beha: Disputes over 15-point agreement on normalization of relations between Kosovo and Serbia, në: Nationality Papers, Vol. 43, Issue 1, 2015.

vazhdimisht lart në listën e prioriteteve kombëtare. Serbia i ka përkrahur vazhdimisht, politikisht dhe financiarisht, strukturat paralele në Kosovë, si mjete shantazhi për ndërtimin e shtetësisë së Kosovës. Platforma politike e Serbisë, për aq kohë sa nuk do të mund ta ripushtojë edhe ushtarakisht Kosovën, synon të sigurojë autonomi maksimale territoriale dhe politike për komunitetin serb, jo me qëllimin primar të realizimit të të drejtave, po me qëllimin e pamundësimit të një shteti funksional të Kosovës.

Pritshmëritë nga BE-ja janë se duhet ta lehtësojë dhe ndihmojë një zgjidhje gjithëpërfshirëse të të gjitha çështjeve të hapura mes Serbisë dhe Kosovës, si ajo e personave të pagjetur, kthimi i fondeve të pensioneve të Kosovës, demarkacioni i kufirit, energjia, transporti, etj. Ndërsa pyetja se si do të mund të ndodhte një normalizim i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë në mungesë të njohjes së ndërsjellë Serbi – Kosovë, dhe me një BE të përçarë lidhur me pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës, vazhdon të ngelet pa përgjigje.

Me gjithë pritshmëritë, të përfytyruara ose reale, të Kosovës nga BE-ja, si dhe me mungesën e një qëndrimi të përbashkët të BE-së, institucionet e Kosovës kanë vazhduar të koordinohen pothuajse në të gjithë hapat e rëndësishëm, jo vetëm me shtetet mbështetëse të pavarësisë dhe sovranitetit të Kosovës brenda ose jashtë BE-së, por edhe me vetë BE-në si p.sh. në kuadër të politikës evropiane për Siguri dhe Mbrojtje. Kështu, në njërin anë Kuvendi i Kosovës miratoi Kushtetutën e Republikës së Kosovës më 9 prill 2008, e cila hyri në fuqi më 15 qershor 2008. Epërsia e kësaj kushtetute është e garantuar mbi të gjitha ligjet dhe aktet e tjera ligjore.⁷⁶⁵ Kjo është veçanërisht e rëndësishme për Kosovën pas vitit 1999 për shkak të mungesës së qartësisë lidhur me legjislacionin në fuqi.⁷⁶⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës ofroi bazën ligjore vendore për themelimin e institucionit të Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar në Kosovë me autoritetin final lidhur me interpretimin e propozimit të M. AHTISAARI-t.⁷⁶⁷ Me implementimin e propozimit të M. AHTISAARI-t në masë të kënaqshme, mbikëqyrja formale e pavarësisë së Kosovës nga Zyra Civile Ndërkombëtare përfundoi më 10 shtator 2012. Ndërsa në anën tjetër deri me përfundimin e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës në shtator 2012 lidhur me sundimin e ligjit në Kosovë, ashtu siç e parashihte propozimi i M. AHTISAARI-t, u krijua në kuadër të politikës evropiane për Siguri dhe Mbrojtje një Mision i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (në vazhdim: EULEX). Qëllimi i deklaruar i

⁷⁶⁵ Neni 16 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (<http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,1>)

⁷⁶⁶ Ligjet e aplikueshme në Kosovë përfshijnë ligjet e aplikueshme para suspendimit të autonomisë në vitin 1989, me kusht që ato të mos jenë diskriminuese; rregulloret e UNMIK-ut; Ligjet e Kuvendit të Kosovës dhe një seri instrumentesh ndërkombëtare të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

⁷⁶⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Nenet 146 dhe 147, e të cilat nene edhe janë fshirë me amendamentin 7 dhe 8 me rastin e përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04- V- 436 të datës 7 shtator 2012. Shih tekstin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (<http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,1>).

misionit EULEX ishte që t'i ndihmojë autoritetet e Kosovës në zhvillimin e mëtejshëm dhe forcimin e një gjyqësori të pavarur, të policisë dhe shërbimit doganor në përputhje me praktikën më të mira evropiane. Misioni përmbushte detyrat si mentorimi, monitorimi dhe këshillimi në fushën e sundimit të ligjit, si dhe disa kompetenca ekzekutive në lidhje me gjyqësorin, policinë, doganat dhe shërbimet korrektuese.⁷⁶⁸ Mandati i EULEX-it me të drejtat ekzekutive dhe funksionet e tjera u vazhdua deri në qershor 2014. Mirëpo qysh në qershor 2013, Kuvendi i Kosovës miratoi një rezolutë, përmes të cilës kërkon që Qeveria e Kosovës të paraqesë në Kuvendin e Kosovës në fillim të shtatorit, një plan transicioni për përfundimin e mandatit të EULEX-it më 15 qershor 2014.⁷⁶⁹

Megjithatë, edhe pse misioni i jashtëm më i madh dhe më i shtrenjtë në historinë e BE-së, EULEX-i nuk ka arritur t'i ndihmojë institucionet kosovare që të krijojnë p.sh. një sistem gjyqësor të bazuar në pavarësi, llogaridhënie, efikasitet e efektivitet. Kështu institucionet kyçe të Kosovës vazhdojnë të jenë të sfiduara në mënyrë të konsiderueshme nga mungesa e burimeve, menaxhimi i dobët, kapacitetet e mangëta, infrastruktura e kufizuar, si dhe madje edhe nga mungesa e vullnetit politik të përfaqësuesve kosovarë e ndërkombëtarë së bashku për të jetësuar shtetin ligjorë e funksional të të drejtës.

Në fakt perspektiva reale për të shfrytëzuar procesin e integritet në BE edhe si strategji për tejkalimin e qëndrueshëm të konfliktit mes Serbisë dhe Kosovës pothuajse është e pamundësuar. Secila qeveri në Beograd edhe pas 1999 vazhdon pa përjashtim të deklarojë se njohja e një Kosove të pavarur dhe sovranë nuk do të ndodhë kurrë. Kështu çështja e Kosovës vazhdon të mbahet dhe të (keq)përdoret si njëra nga prioritetet kombëtare të Serbisë. Me këtë arrihet në një anë mobilizimi i etno-nacionalizmit serb, sa herë që kjo i nevojitet politikës së brendshme serbe, ndërsa në anën tjetër kjo politikë e mosnjohjes së Kosovës nga Serbia (keq)përdoret edhe si mjet shantazhi kundruall botës perëndimore, po dhe kundër përpjekjeve të botës demokratike dhe palës kosovare për ndërtimin e një shteti funksional ligjor në Kosovë. Kështu politika e mosnjohjes nga ana e Serbisë në një anë arrin ta mbajë hapur, edhe pse ndoshta për momentin kjo shfaqet vetëm si opsion teorik, mundësinë për ripushtimin e pjesës së tërësishëm të Kosovës, e në anën tjetër arrin edhe ta pamundësojë etablimin e një shteti funksional e të gjithëpranuar ndërkombëtarisht të Kosovës. Përderisa Serbia të mos e pranojë pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës, respektivisht sa kohë vazhdon të ngelet pa përgjigje pyetja se si do të mund të ketë normalizim afatgjatë dhe të qëndrueshëm të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë edhe në mungesë të njohjes së ndërsjellë mes tyre, situata në rajonin e Ballkanit Perëndimor do të vazhdojë të përcillet me rreziqe dhe kërcënime reale për paqen dhe sigurinë në rajon e më gjerë.

⁷⁶⁸ Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, Shtojca X, Neni 13 (<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Comprehensive%20Proposal%20.pdf>).

⁷⁶⁹ Kuvendi i Kosovës, Rezolutë, Nr. 04-R-012, Prishtinë, më 25 korrik 2013, në: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezoluta_R_012.pdf

C. Sfidat dhe konteksti i integritit evropian

Pothuajse për një dekadë të plotë, që nga instalimi i administratës së gjithëpushtetshme ndërkombëtare më 1999 e deri në shpalljen e pavarësisë dhe sovranitetit të Kosovës në 2008, synimi i mos humbjes së mbështetjes politike e ekonomike perëndimore ishte një lloj nxitësi i fuqishëm për sjelljen e institucioneve të Kosovës konform pothuajse çdo kërkesë të shteteve perëndimore pa përjashtim. Kjo lloj sjelljeje e institucioneve të Kosovës ishte edhe parakusht për gjetjen e një zgjidhjeje lidhur me statusin politik të Kosovës pa e humbur përkrahjen e fuqive që më 1999 mundësuan çlirimin e Kosovës. Mirëpo, pas shpalljes së Kosovës së pavarur dhe sovrane më 2008 dhe njohjes së saj nga më shumë se gjysma e shteteve anëtare të OKB-së — shumica prej tyre shtete të lira të botës demokratike — duket se vetëm një joshje reale dhe e prekshme e integritit në BE ka ngelur si nxitëse e reformave në sistemin juridik, ekonomik e politik të Kosovës e të vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor në përgjithësi.

Sido që të jetë, pavarësisht deklaratave të institucioneve të Kosovës si dhe atyre ndërkombëtare, që pretendojnë se janë të angazhuara për krijimin dhe forcimin e shtetit ligjor, krimi i organizuar dhe korrupsioni ngelin të përhapur gjithandej. Madje, edhe vetë misioni i EULEX-it dyshohet për involvim në afëra korruptive.⁷⁷⁰ Kjo gjendje është para së gjithash rezultat i mungesës së kapaciteteve për të jetësuar shtetin ligjor, por edhe i mungesës së vullnetit politik, si nga ana e institucioneve të Kosovës ashtu edhe nga faktorët ndërkombëtarë të instaluar në Kosovë.

Përcaktimi i statusit politik të Kosovës ka qenë fokusi kryesor për shumë vjet. Kështu, vëmendje e shtuar është kushtuar kryesisht në ato reforma që janë identifikuar si kushte për progres drejt zgjidhjes së statusit. Përveç statusit politik, procesi i integritit evropian shfaqet si nxitësi kryesor i progresit në adresimin e sfidave të shumta për krijimin e një sistemi funksional të bazuar në shtetin e të drejtës. Kështu, sidomos pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, perspektiva e integritit evropian, sado e zbehtë që është, ngelet nxitja kyçe për reforma.

Edhe pse Kosova kishte filluar të bëhej formalisht pjesë e procesit të integritit evropian që nga inicimi i Procesit të Stabilizim-Asocimit, në të cilin mekanizëm u përfshi në Samitin e Selanikut në vitin 2003, një perspektivë paksa më konkrete për Kosovën u shpall nga Komisioni Evropian më 2005 me komunikatën e titulluar „Një e ardhme evropiane për Kosovën”.⁷⁷¹ Në qershor të vitit 2004 Këshilli Evropian miratoi Partneritetin Evropian për Kosovën, instrumenti i parë ky për përcaktimin e

⁷⁷⁰ Shih p.sh. EU mission in Kosovo rocked by corruption allegations, EU Observer, Brussels, 30 tetor 2014 (<https://euobserver.com/justice/126319>).

⁷⁷¹ Commission of the European Communities. Communication from the Commission. A European Future for Kosovo, Brussels 20.04.2005 (<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2005:0156:FIN:EN:PDF>).

prioriteteve kyçe afatshkurtra dhe afatmesme që duhet të adresohen nga institucionet e Kosovës në rrugën drejt integritit evropian. Ndërsa, një ditë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, më 18 shkurt 2008, BE përcaktoi prioritetet e mëtejshme të reformës për Kosovën në Partneritetin Evropian.⁷⁷² Përkatësisht, „Plani i Veprimit për Partneritetin Evropian” është përditësuar disa herë, së fundi në dhjetor 2011.⁷⁷³ Megjithatë, përderisa në vitet 2003 – 2009 instrumenti kryesor për dialog politik mes Qeverisë së Kosovës dhe Komisionit Evropian ishte „Mekanizmi Përcjellës i Stabilizim-Asocimit”, në nëntor 2009 ky proces u shndërrua në Dialog të Procesit të Stabilizim-Asocimit bazuar në Komunikatën e Komisionit Evropian në Këshillin dhe Parlamentin Evropian, të titulluar „Kosova* – Përmbushja e perspektivës evropiane”.⁷⁷⁴

Pavarësisht një serie të deklaratave nga strukturat e BE-së se Kosova ka një perspektivë të qartë të integritit evropian, Kosova mbetet aktualisht i vetmi vend i Ballkanit Perëndimor që nuk ka marrëdhënie kontraktuale me BE-në. Për më shumë, shtetasit e Kosovës mbeten njerëzit me lirinë më të kufizuar dhe ndër më të izoluarit jo vetëm në Evropë, por edhe në botë.

Mungesa e një qëndrimi të unifikuar nga të gjitha vendet anëtare të BE-së lidhur me pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës krijon vështirësi jo vetëm për Kosovën, por edhe për Serbinë, si në aspektin e bashkëpunimit rajonal, ashtu edhe në procesin e integritit evropian. Kështu, pasja e një qasjeje neutrale ndaj statusit të Kosovës nga ana e BE-së është shndërruar në pengesë për përparimin e politikave integruese drejt BE-së. Megjithatë, në tetor 2012 „Komunikata për Studimin e Fizibilitetit për një Marrëveshje Stabilizim-Asocimi me Kosovën” për herë të parë konfirmon se Marrëveshja për Stabilizim-Asocim mund të lidhet ndërmjet BE-së dhe Kosovës edhe në një situatë kur vendet anëtare të BE mbajnë pikëpamje të ndryshme mbi statusin politik, por duke e lënë të hapur çështjen e natyrës së saktë ligjore të marrëveshjes.⁷⁷⁵

⁷⁷² Council Decision 2008/213/EC of 18 February 2008 on the principles, priorities and conditions contained in the European Partnership with Serbia including Kosovo as defined by United Nations Security Council Resolution 1244 of 10 June 1999 and repealing Decision 2006/56/EC (<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2008:080:0046:0070:EN:PDF>).

⁷⁷³ Republic of Kosovo, The European Partnership Action Plan 2012. December 2011 (http://www.mei-ks.net/repository/docs/European_Partnership_Action_Plan_2012.pdf).

⁷⁷⁴ Communication of the European Communities. Communication from the Commission to the European Parliament and the Council. Kosovo* – Fulfilling its European Perspective, Brussels 14.10.2009 (http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/kosovo_study_en.pdf).

⁷⁷⁵ Komisioni Evropian COM (2012) 602, Bruksel 10.10.2012, Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin mbi Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës (http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/ks_feasibility_study_2012_sq.pdf).

Në një përpjekje për t'i adresuar këto sfida, BE-ja ka nisur në mars 2011 procesin e një „dialogu teknik” midis qeverive të Serbisë dhe Kosovës. Dialogu është përshkruar edhe në drejtim të „kushtëzimit” drejt procesit të integritimit evropian për të dyja vendet. Me qëllim që ta lehtësojë pjesëmarrjen e Kosovës në forumet rajonale në veçanti, BE në fillim, në shkurt 2012, ndërmjetësoi një marrëveshje mes Serbisë dhe Kosovës. Deri në arritjen e marrëveshjes lidhur me përfaqësimin e Kosovës në bashkëpunimin rajonal, Kosova vazhdoi të përfaqësohej në takimet rajonale nga ana e UNMIK-ut. Kjo marrëveshje i lejon Kosovës të nënshkruajë marrëveshje rajonale dhe të marrë pjesë në organizatat dhe takimet rajonale, me kusht që fjala „Republikë” të mos shfaqet pranë emrit të Kosovës në forumet ndërkombëtare dhe rajonale, dhe që emri i Kosovës të pasohet nga një fusnotë që i referohet Rezolutës 1244 dhe mendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.⁷⁷⁶ Një marrëveshje e tillë, edhe pse jo shumë popullore, u arrit nën presionin dhe kushtëzimin e BE-së, e cila në këmbim të progresit dhe kompromisit, i premtoi Serbisë „statusin e kandidatit” dhe Kosovës „fillimin e studimit të fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit”.

Megjithatë, jetësimi i marrëveshjeve të arritura deri më tani lë shumë për të dëshiruar. Për shembull, në „Komunikatën e Komisionit për Parlamentin dhe Këshillin Evropian lidhur me Strategjinë e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2012-2013” vihet në dukje progresi i kufizuar në zbatimin e marrëveshjeve dhe bëhet thirrje për progres të mëtejshëm, si një çështje urgjente.⁷⁷⁷ Pavarësisht problemeve me zbatimin e marrëveshjeve, në mars 2012 Serbisë iu dha statusi i shtetit kandidatit për BE, ndërsa për Kosovën, Komisioni Evropian në tetor 2012 miratoi një „Komunikatë lidhur me Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit me Kosovën”.⁷⁷⁸

Edhe pse është evidente se përmes të ashtuquajturit „dialog teknik”, ka përparim në raport me të kaluarën, problemet më të vështira mes Serbisë dhe Kosovës, në veçanti sa u përket komunave veriore të Kosovës, ngelen aktuale. Shembulli më i rëndësishëm i kësaj është „Marrëveshja e parë për parimet që qeverisin normalizimin e marrëdhënieve”, e arritur më 19 prill 2013. Kjo është një marrëveshje e shkurtër, që përcakton vetëm parimet kyçe, duke lënë shumë pyetje të hapura lidhur me

⁷⁷⁶ Përmbajtja e fusnotës tingëllon si në vijim: „This designation is without prejudice to positions on status, and is in line with UNSCR 1244 and the ICJ Opinion on the Kosovo Declaration of Independence.”

⁷⁷⁷ Communication from the Commission to the European Parliament and the Council, Enlargement Strategy and Main Challenges 2012 – 2013, Brussels 10.10.2012 (http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/strategy_paper_2012_en.pdf).

⁷⁷⁸ European Commission, Commission Communication on a Feasibility Study for a Stabilisation and Association Agreement between the European Union and Kosovo*, Brussels, 23.10.2012 (http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_analytical_2012_en.pdf).

jetësimin e saj. Marrëveshja kryesisht përqendrohet në themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe, në forcat policore, sektorin e drejtësisë dhe zgjedhjet. Pra, të gjitha çështjet e ngërthyera në këtë marrëveshje kanë karakter të politikës së brendshme të Kosovës, e në të cilën Serbia është faktorizuar si palë. Në mënyrë më specifike, dhe më së rëndësishmi, kjo marrëveshje përcakton një Asociacion/Bashkësi të komunave me shumicë serbe në Kosovë. Asociacioni/Bashkësia është paraparë të pajiset me kompetenca të plota në fushën e zhvillimit ekonomik, të arsimit, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural dhe me kompetenca të tjera të deleguara nga autoritetet qendrore. Për më shumë, edhe pse marrëveshja parasheh që të gjitha autoritetet gjyqësore duhet të jenë të integruara dhe të operojnë brenda kornizës ligjore të Kosovës, ajo megjithatë e ndan sistemin e drejtësisë në baza etnike, duke mandatuar se Gjykata e Apelit në Prishtinë vendos kolegji të përbërë nga shumicë serbe të gjyqtarëve „për t'u marrë me të gjitha komunat me shumicë serbe”.⁷⁷⁹

Ndër të tjera, me anë të marrëveshjes së mësipërme, të dyja palët kanë rënë dakord në mënyrë deklarative dhe të padefinuar në substancë se nuk do ta bllokojnë progresin e njëra-tjetrës drejt BE-së. Ndërsa këtu bëhet fjalë vetëm për një marrëveshje të parë, mbetet e paqartë dhe e padefinuar se çfarë do të përmbajë një marrëveshje e dytë, ose edhe e tretë e me radhë, në një të ardhme në marrëdhëniet Serbi-Kosovë.

Deri më 2008 përcaktimi i statusit politik të Kosovës ishte stimul i fortë për Kosovën që t'i plotësojë kërkesat e bashkësisë ndërkombëtare. Që nga shpallja e pavarësisë më 2008, vetëm një proces real, i prekshëm dhe me afate të qarta kohore i integritit evropian mund t'i shtyjë përpara qeveritë në Prishtinë dhe në Beograd që, në përputhje me kërkesat e BE-së, t'i ndërmarrin reformat e nevojshme ekonomike dhe politike. Kështu, në rrethanat e kushtëzimit të BE-së, vlen si për Prishtinën ashtu edhe për Beogradin që sa më i qartë, më konkret dhe më i afërt shpërblimi, rritet nxitja për t'i përmbushur kushtëzimet.

Megjithatë, pasiguria në rastin e Kosovës buron kryesisht nga mungesa e një qëndrimi të përbashkët të BE-së lidhur me çështjen e statusit të Kosovës dhe mungesa e një afati të besueshëm ose konkret për përparimin drejt integritit në BE. Komisioni Evropian disa herë ka theksuar perspektivën e Kosovës që t'i bashkohet BE-së. Megjithatë, Kosova vazhdon të ngelet vendi i fundit i Ballkanit Perëndimor drejt integritit në BE dhe i përcjellë nga një perspektivë më shumë e paqartë sesa e qartë lidhur me arritjen e marrëdhënieve kontraktuale me të.

Në njërin anë BE synon të jetë e angazhuar drejtpërdrejt në mbështetjen dhe reformimin e aspekteve të ndryshme që lidhen me shtetin ligjor në Kosovë. Në anën tjetër raportet e progresit të Komisionit Evropian shfaqin në mënyrë të përsëritshme problemet dhe dobësitë sistematike në fushën e shtetit ligjor. Kështu BE-ja nuk ka

⁷⁷⁹ Shih pika 10 „Marrëveshja e parë për parimet që qeverisin normalizimin e marrëdhënieve”, 19 prill 2013.

arritur të jetë mjaft efektive dhe efikase në mënyrë që të përshpejtojë progresin e nevojshëm ose të adresojë dobësitë dhe lëshimet e vazhdueshme në fushën e shtetit ligjor dhe të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, që të dyja parakushte bazë për stabilitet dhe avancim drejt integritit në BE.

Joefikasitetin dhe joeficiencën e mekanizmave të BE-së në Kosovë e konfirmon në masë të madhe edhe vetë Gjykata Evropiane e Auditorëve në njërin nga vlerësimet përkitazi me efektivitetin e ndihmës së BE-së në Kosovë lidhur me sundimin e ligjit. Kështu, raporti në fjalë në përgjithësi gjen se ndihma e BE-së në Kosovë në fushën e sundimit të ligjit nuk ka qenë mjaft efektive. Në raport arrihet në përfundimin se përderisa është bërë progres i rëndësishëm, mbeten sfida të konsiderueshme, veçanërisht lidhur me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Për më shumë, në raport shtohet gjithashtu se ndonëse ndihma për sektorin gjyqësor ka qenë „e dobishme”, gjyqësori vazhdon të vuajë nga ndërhyrjet politike, joefikasiteti dhe mungesa e transparencës.⁷⁸⁰ Shfaqja e nevojës për krijimin e një gjykate speciale jashtë territorit të Kosovës me qëllim të gjyqimit të krimeve reale ose të pretenduara në Kosovën e vitit 1998 dhe viteve pas 1999-ës ilustron dhe dëshmon njëkohësisht më së miri lëshimet vendore dhe ndërkombëtare për ta krijuar një shtet të qëndrueshëm e funksional të të drejtës, bazuar në një sistem të paanshëm e profesional gjyqësor.

Kështu, lëshimet së pari të UNMIK-ut e pastaj të EULEX-it, e që të dyjave së bashku me institucionet e reja dhe të dobëta të Kosovës, për garantimin e sigurisë *para* dhe *nëpërmjet* ligjit, ilustronjë dështimet administrative të misioneve të pushtetshme ndërkombëtare të instaluar në Kosovën e pas 1999. Megjithatë, perspektiva e integritit evropian, sado e venitur për Kosovën të jetë, vazhdon të mbetet nxitja kyçe për reforma. Porse, mungesa e një qëndrimi të përbashkët brenda BE-së lidhur me pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës, e si rrjedhojë e kësaj edhe qasja neutrale e BE-së kundruall statusit të Kosovës, është shndërruar secilën herë e më shumë në një qark të mbyllur vicioz, si për Kosovën ashtu edhe për Serbinë e për vetë BE-në. Përpjekjet e BE-së së vetëpozicionuar si neutrale për të trajtuar problemet e hapura mes Serbisë dhe Kosovës në kuadër të „dialogut teknik” vetëm sa kanë rezultuar me faktorizimin e Serbisë si palë bashkëvendimmarrëse në çështjet e brendshme të Kosovës. Për më shumë, ky faktorizim i Serbisë brenda Kosovës veç sa e ka forcuar politikën serbe të mosnjohjes së Kosovës, e cila politikë njëkohësisht e pamundëson më tej tejkalimin e qëndrueshëm dhe në frymë evropiane të konfliktit Serbi – Kosovë.

⁷⁸⁰ European Court of Auditors. European Union Assistance to Kosovo related to Rule of Law (Special Report no. 18), 2012 (http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/SR12_18/SR12_18_EN.PDF).

D. Perspektiva e tejkalimit të konfliktit

Nën patronazhin e qeverisë gjermane, si dhe në prezencën e përfaqësuesve të Komisionit Evropian, Austrisë dhe Francës, më 28 gusht 2014 u mbledhën në Berlin në Konferencën e Parë për Ballkanin Perëndimor ministrat e jashtëm dhe ministrat e ekonomisë së Shqipërisë, Bosnje e Hercegovinës, Kroacisë, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi, Serbisë dhe Sllovenisë. Në Deklaratën Përfundimtare të Udhëheqëses së Konferencës, në mënyrë të vetëdijshme për rolin e të kaluarës shënohet se „njëqind vjet pas shpërthimit të Luftës së Parë Botërore [...] Kryeministrat e Serbisë dhe të Kosovës përsëritën vendosmërinë e tyre për të rigjallëruar procesin e normalizimit të marrëdhënieve”.⁷⁸¹ Forume dhe deklarata të kësaj natyre në kuadër të „konferencave të çuditshme”⁷⁸² si kjo ngjallin në shikim të parë ndjenjat dhe shpresat se rajoni i Ballkanit Perëndimor, edhe pse ndoshta në mënyrë të ngadalshme, hap pas hapi po shkon drejt tejkalimit të konflikteve, paqes dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Megjithatë, korniza normative e krijuar ndër vite, si dhe gjendja e përgjithshme sociale, ekonomike e politike në terren, nuk ofrojnë hapësirë për optimizëm. Kështu, për shembull, shpresat fillestare që propozimi i M. AHTISAARI-t të miratohej edhe formalisht me një rezolutë të re të Këshillit të Sigurimit të KB-së, e cila do ta zëvendësonte Rezolutën 1244 (1999), u shuan shpejt. Për më tepër, në Kosovë ende vazhdojnë të figurojnë rreth 1675 persona në listën e personave të pagjetur. Deri në gjysmën e dytë të 2014 as 30% e trupave të personave të pagjetur nuk janë kthyer në Kosovë, edhe pse Serbia duhet të ketë të dhënat e sakta se ku gjenden varrezat masive.⁷⁸³ Në këtë mënyrë Serbia, duke i fshehur gjurmët e krimeve, përpiqet të fshehtë edhe përgjegjësinë e vet.

Ndërsa popullata shqiptare shumicë e Kosovës, posaçërisht gjeneratat e Kosovës pas vitit 1999, që së shpejti do të arrijnë moshën për të pasur të drejtë të votojnë dhe të votohen, shtatë vjet pas shpalljes së pavarësisë më 2008 kanë krijuar përshtypjen se vetëm Kosova ka bërë kompromise të vazhdueshme, pa arritur asnjë përfitim të qëndrueshëm e domethënës. Kosova vazhdon të mos jetë anëtare e OKB-së dhe ka sovranitet të kufizuar e të kontestuar ndërkombëtarisht. UNMIK-u është ende aktiv, edhe pse dukshëm i reduktuar, kurse BE deklaroi qëndrim neutral ndaj statusit, përdërisa shtetasit e Kosovës vazhdojnë të mbeten njerëzit më të izoluar dhe më të varfër në tërë kontinentin evropian. Për dallim nga gjeneratat më të moshuara, për

⁷⁸¹ Final Declaration by the Chair of the Conference on the Western Balkans, Berlin, 28 August 2014 (<http://www.bundesregierung.de/Content/EN/Pressemitteilungen/BPA/2014/2014-08-28-balkan.html>).

⁷⁸² Norbert Mappes-Niediek: Europa vernachlässigt den Balkan [Evropa e le pas dore Ballkanin], Berliner Zeitung, 28 gusht 2014 (<http://www.berliner-zeitung.de/meinung/kommentar-zur-balkan-konferenz-europa-vernachlaessigt-den-balkan,10808020,28252232.html>).

⁷⁸³ Shih Prenkë Gjetaj, Kryetar i Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, 14 Shtator 2014 (<http://indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=115843>).

gjeneratën e re dhe shumicë të Kosovës, periudha para qershorit 1999 nuk është më pikë reference a krahasimi. Për ta, pika reference e krahasimi janë standardet e jetës së moshatarëve të tyre në rajon e më gjerë. Pra, mungesa e perspektivës, izolimi e varfëria në një kontekst të turbullt politik janë duke e afektuar më së shumti gjeneratën e re të Kosovës, e me këtë edhe të ardhmen politike e ekonomike të saj.

Në rrjedhën e këtyre zhvillimeve, në njërën anë:

„Serbia duke shfrytëzuar si mashë elementë shqiptar të etur për pushtet, arriti dy qëllime strategjike: plasoi në botën perëndimore narrativin për shqiptarët po aq kriminelë sa edhe forcat serbe që kishin bërë plojën ndaj popullsisë civile shqiptare në vitet 1998-99, dhe arriti ta bindte bashkësinë ndërkombëtare se çdo zgjidhje e statusit të Kosovës duhet ta marrë parasysh rolin aktiv të Serbisë në punët e brendshme të Kosovës me qëllim të mbrojtjes së pakicës serbe dhe të trashëgimisë kulturore e fetare të saj.”⁷⁸⁴

Në anën tjetër, në Kosovë, të drejtat e komuniteteve pakicë shpesh perceptohen më shumë si një kompromis sesa si domosdoshmëri për një shtet të integruar e demokratik. Kështu, udhëheqësit politikë të Kosovës, të ballafaquar edhe me presion të faktorëve ndërkombëtarë, ofruan nominalisht të drejta bujare për pakicat, në këmbim të shtetësisë.⁷⁸⁵ Njëkohësisht liderët shqiptarë dhe serbë në Kosovë, si edhe ata në Serbi e në vendet tjera të rajonit, vazhdojnë të cementohen në qasjet etnike në politikë, si instrument i suksesshëm për ruajtjen e pushtetit personal e grupor.

Në këtë libër, në figurën nr. 1., të titulluar „Konflikti i Kosovës”, e paraqes një skemë trekëndëshe për të ilustruar në mënyrë të përmbledhur aktorët dhe ndërveprimet e palëve të përfshira në konfliktin serbo-kosovar. Për zhvillimet në Kosovën e pas vitit 2007 në mënyrë të ngjashme mund të operohet me një skemë si në vijim. Le të shenjojmë Kosovën si „aktori A”, Serbinë si „aktori B”, bashkësinë ndërkombëtare si „aktori C” dhe propozimin e M. AHTISAARI-t si „propozimi X”. Ndërsa sjelljet dhe veprimet e Serbisë dhe të të gjithë aktorëve të tjerë së bashku, të cilët nuk e kanë njohur pavarësinë dhe sovranitetin e Republikës së Kosovës të shpallur në 2008, le t’i shenjojmë si „Y”. Ndërveprimi dhe sjelljet e palëve të përfshira në konfliktin serbo-kosovar na ofrojnë pasqyrën vijuese: „aktori A” dhe „aktori B” vazhdojnë të ndodhen në konflikt për më shumë se një shekull. Pas *de facto* kapitullimit ushtarak dhe humbjes së kontrollit efektiv nga „aktori B” mbi „aktorin A”, ose më saktë mbi pjesën dërrmuese të territorit të „aktorit A”, „aktori C” riinicion edhe një proces shtesë negociues me synim të arritjes së një ujdje për të formalizuar zgjidhjen e konfliktit. Si formë e zgjidhjes së fundit racionale (*ultima*

⁷⁸⁴ Enver Robelli: Ndarja e Kosovës: Qosiqi e mendoi, Gjingjqi e propozoi dhe Thaçi e negocioi – tinëz!, në: Koha Ditore, 25 prill 2014, f. 11.

⁷⁸⁵ Shih Adem Beha: Minority Rights: An Opportunity for Adjustment of Ethnic Relations in Kosovo?, Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe, Vol 13, No 4, 2014, f. 107 (<http://www.ecmi.de/fileadmin/downloads/publications/JEMIE/2014/Beha.pdf>).

ratio) dhe si forma më e lartë e kompromisit të mundshëm „aktori C” në cilësinë e ndërmjetësuesit ofron „propozimin X”. „Aktori A” e pranon „propozimin X”, madje e prezanton atë sikur të ishte synimi i vet maksimal. Në situatën e dhënë, po në njëfarë forme edhe si rrjedhojë e logjikës së maksimizimit të kërkesave, „aktori B” e refuzon „propozimin X”, ndër të tjera mbasi „aktori A” e ka prezantuar dhe kuptuar „propozimin X” sikur të ishte synimi maksimal për zgjidhjen e konfliktit e jo vetë kompromisi. I konsumuar nga mungesa e stabilitetit për kohë të gjatë dhe nga kostoja e lartë e pranisë ushtarake e civile, një pjesë domethënëse e me ndikim e „aktorit C” inkurajon edhe mbështet drejtpërsëdrejti ose tërthorazi sjelljet dhe synimet „Y”. Në tërë këtë vorbull mbetet çështje e papërcaktuar se si do të sillen më tutje palët e involvuara në konflikt dhe çfarë efektesh do të kenë sjelljet dhe veprimet „Y”, jo vetëm për „aktorin A” por për tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Bazuar në këtë model ndërveprimi mes aktorëve të përfshirë në konfliktin Serbi – Kosovë, si dhe duke u ndërlidhur me skenarët e zhvilluar në figurën nr. 3, zgjidhja e konfliktit serbo-kosovar në kuptimin e idesë së integritimit evropian, e cila parashikon një etablim dhe sigurim afatgjatë të paqes si në Serbi ashtu edhe në Kosovë, edhe më shumë se një dekadë e gjysmë pas vitit 1999 shfaqet në këtë libër më shumë si një përfytyrim sesa si një gjasë reale dhe e afërt në kohë.

Skenari i dytë i zhvilluar në figurën nr. 3 — mundësia e anëtarësimit në BE e vendeve të Ballkanit Perëndimor megjithëse Serbia dhe Kosova nuk pranojnë njëra-tjetrën si shtete të pavarura dhe sovrane — përkon më së shumti me gjendjen e krijuar pas shpalljes së pavarësisë më 2008 në marrëdhëniet Serbi – Kosovë. Kështu, me probabilitet të lartë pritet që antagonizmat në konfliktin serbo-kosovar të vazhdojnë edhe sikur të përmbushen kriteret për një anëtarësim në BE ose madje nëse BE do të nxirrte rregulla të jashtëzakonshme për pranimin e anëtarëve të rinj me shpresën se do ta zgjidhte në mënyrë të qëndrueshme konfliktin serbo-kosovar. Për më shumë, skenari i tretë dhe i katërti në figurën nr. 3, integrimi parcial, përkatësisht dështimi i procesit të integritimit në BE për vendet e Ballkanit Perëndimor, vazhdojnë të ngelen si mundësi reale sa kohë të mbizotërojë *de facto* gjendja e „luftës së ftohtë” mes Serbisë dhe Kosovës, pra derisa të mos njihen reciprokisht si shtete të pavarura dhe sovrane. Kështu, përsëritja e ciklit të konflikteve mes Serbisë dhe Kosovës mbetet reale edhe në shekullin XXI, siç ishte edhe para një shekulli, si për nga aspekti i intensitetit ashtu edhe nga ai i motiveve të aktorëve të përfshirë në konflikt.

Në intervistën e fundit, para se të vdiste, njëri nga ideologët kyçë të nacionalizmit serb, Dobrica Ćosić, për dallim prej pikënisjeve të mëparshme se „serbët i fitojnë të gjitha luftërat dhe e humbin gjithmonë paqen”⁷⁸⁶, e shpall Kosovën si të humbur për Serbinë, dhe paqen si të vetmin kusht për ekzistencën e serbëve, të cilëve u bën ftesë të mos luftojnë përsëri, meqenëse mungon potenciali patriotik dhe biologjik!⁷⁸⁷

⁷⁸⁶ Krahaso fusnotën nr 166 në këtë libër.

⁷⁸⁷ Intervistë me Dobrica Ćosić, Nedeljnik, prill 2014 (<http://nedeljnik.co.rs/sr/tema-broja/poslednji-intervju-dobrice-osia>).

Qëndrime të kësaj natyre reflektojnë edhe qasjen koherente të politikës shtetërore serbe ndaj Kosovës. Për këtë pikëpamje, lufta për territore, e bazuar në idetë etno-nacionaliste nuk përjashtohet në vetvete. Ajo nuk u dashka zhvilluar vetëm për aq kohë sa mungojnë resurset njerëzore, shpirtërore ose materiale për të. E Serbia, nëse jo tani, pas disa vitesh ose dekadash lehtas mund të ndihet e aftë dhe në posedim të kapaciteteve për të bërë luftë përsëri. Prandaj, përderisa në njërin anë Serbia gjatë tërë shekullit XX nuk ka arritur që shqiptarëve t'u ofrojë qasje në një bashkësi shtetërore si shtetas të barabartë në një Serbi multietnike, pra t'i integrojë dhe t'i trajtojë si qytetarë të barabartë, dhe në anën tjetër tani në shekullin XXI vazhdon të mos e njohë humbjen morale dhe ushtarake, po as humbjen e të drejtës së sovranitetit mbi Kosovën, mbetet vetëm çështje kohe para se të shpërthejë ciklit i radhës i dhunës në konfliktin serbo-kosovar. Ndërkohë, përfytyrimi i integritetit evropian për Serbinë dhe Kosovën si partnerë të barabartë në një komunitet më të gjerë vazhdon të ngelet një desiderium dhe synim i atyre që dhunën e përjashtojnë në vetvete.

Bibliografia*

- ABRAMOWITZ Morton, HURLBURT Heather: Can the EU Hack the Balkans?, në: Foreign Affairs, vëll. 81, shtator/tetor 2002
- ALLAIN Françoise M., GALMICHE Xavier: La Question du Kosovo, Paris 1994
- ALTER Peter: Grundfragen des Nationalismus [Bazat e nacionalizmit], në: HEUBERGER Valeria etj. (ed.): Der Balkan. Friedenszone oder Pulverfass? [Ballkani. Zonë e paqes apo fuçi baroti], Frankfurt mbi Main etj. 1998
- ALTMANN Franz-Lothar: Die Balkanpolitik der EU-Regionalansatz und Prinzip der Konditionalität [Politika ballkanike në qasjen rajonale të BE-së dhe parimi i kondicionalitetit], në: Südosteuropa 10-11/1998
- ALTMANN Franz-Lothar: Regionale Kooperation in Südosteuropa, Organisationen, Pläne, Erfahrungen [Bashkëpunime rajonale në Evropën Juglindore, organizatat, planet, përvojat], në: Südosteuropa 4-6/2002
 - ALTMANN Franz-Lothar, RJELIĆ Dušan: Zuspitzung im Kosovo im Schatten der Irak-Krise [Acarimi në Kosovë nën hijen e krizës në Irak], në: SWP-Aktuell, Deutsches Institut für Internationale Politik und Sicherheit [Instituti Gjerman për Politikë dhe Siguri Ndërkombëtare], mars 2003
- ANASTASAKIS Othon, BOJICIC-DZELILOVIC Vesna: Balkan Regional Cooperation & European Integration, The London School of Economics and Political Science, korrik 2002 (<http://www.lse.ac.uk/collections/hellenicObservatory/pdf/brie.pdf>)
- ANASTASAKIS Othon, BECHEV Dimitar: EU Conditionality in South East Europe: Bringing Commitment to the Process, European Studies Centre, St Antony's College, University of Oxford, prill 2003 (<http://www.sant.ox.ac.uk/areastudies/analyses.shtml>)
- ANDERSON Benedict: Die Erfindung der Nation. Zur Karriere eines erfolgreichen Konzepts [Shpikja e kombit. Rreth karrierës së një koncepti të suksesshëm], Frankfurt mbi Main 1988
- ANDRÄ Werner: Gedanken zur Unabhängigkeit des Kosovo [Mendime rreth pavarësisë së Kosovës], në: MARKO Joseph (ed): Gordischer Knoten Kosovo/a: Durchschlagen oder entwirren? [Nyja gordiane Kosovë: të këputet apo të shthuret?], Baden-Baden 1999
- ASSMANN Jan: Das kulturelle Gedächtnis. Schrift, Erinnerung und politische Identität in frühen Hochkulturen [Memoria kulturore. Shkrimi, kujtesa dhe identiteti politik i kulturave të dikurshme të larta], Muni 1999

- AXT Heinz-Jürgen: Der Stabilitätspakt für Südosteuropa: politischer Aktionismus oder langfristig tragfähiges Konzept? [Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore: aksionizëm politik apo koncept stabil afatgjatë?], në: Südosteuropa 7-8/1999
- AXT Heinz-Jürgen: Internationale Implikationen des Kosovo-Krieges: wertorientierte Realpolitik statt Konfliktbearbeitung in Institutionen [Implikimet ndërkombëtare të luftës së Kosovës: real-politika e orientuar në vlera në vend të përpunimit të konfliktit në institucione], në: Südosteuropa 1-2/2000
 - AXT Heinz-Jürgen: Vom Wiederaufbauhelfer zum Modernisierungsagenten. Die EU auf dem Balkan [Nga ndihmësi në rindërtim deri te agjenti i modernizimit. BE-ja në Ballkan], në: Aus Politik und Zeitgeschichte. Beilage zur Wochenzeitung Das Parlament, 10-11/3 mars 2003
- BAJRAKTARI Jusuf: Largpamësia e vendimeve të Konferencës së Bujanit, në: REXHEPI Fehmi etj. (ed.): Konferenca e Bujanit, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë 1998
- BAJRAMI Hakif: Kosova – Prej Bujanit në Kaçanik, Prishtinë 1997
- BAKER James: Politics of Diplomacy: Revolution, War and Peace 1989 – 1992, New York 1995
- BARTL Peter: Die albanischen Muslime zur Zeit der nationalen Unabhängigkeitsbewegung (1878 – 1912) [Myslimanët shqiptarë në kohën e lëvizjes për çlirimin kombëtar (1878 – 1912)], Visbaden 1968
- BARTL Peter: Die Albaner [Shqiptarët], në: WEITHMANN Michael W. (ed.): Der Ruhelose Balkan. Die Konfliktregionen Südosteuropas [Ballkani i paqetë. Rajonet e konfliktit të Evropës Juglindore], Muni 1993
- BARTLETT Will, SAMARDŽIJA Višnja: The Reconstruction of South East Europe, the Stability Pact and the Role of the EU: An Overview, në: Economic Policy in Transitional Economies MOCT-MOST 2/2000
- BAUBÖCK Rainer: Why stay together? A pluralist approach to secession and Federation, në: KYMLICKA Will, NORMAN Wayne: Citizenship in diverse Societies, Oksford 2000
- BECK Ulrich: Die Erfindung des Politischen. Zu einer Theorie reflexiver Modernisierung [Zbulimi i politikës. Te një teori e modernizimit reflektiv], Frankfurt am Main 1993
- BECKMANN-PETEY Monika: Der jugoslawische Föderalismus [Federalizmi jugosllav], Muni, Vjenë 1990
- BEHA Adem: Minority Rights: An Opportunity for Adjustment of Ethnic Relations in Kosovo?, Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe, Vol 13, No 4, 2014
(<http://www.ecmi.de/fileadmin/downloads/publications/JEMIE/2014/Beha.pdf>)

- BEHA Adem: Disputes over 15-point agreement on normalization of relations between Kosovo and Serbia, në: Nationality Papers, Vol. 43, Issue 1, 2015
- BELLAMY Alex J.: Kosovo and International Society, Nju Jork 2002
- BESTERS-DIGLER Juliane: Das Herz Serbiens [Zemra e Serbisë], në: Neue Zürcher Zeitung, Folio, qershor 1999
- BEYME von Klaus: Systemwechsel in Osteuropa [Ndërrimi i sistemit në Evropën Lindore], Frankfurt am Main 1994
- BEYME von Klaus (ed.): Politische Theorien in der Ära der Transformation [Teoritë politike në erën e transformimit], Opladen 1996
 - BEYME von Klaus: Theorien der Politik im Zeitalter der Transformation [Teoritë e politikës në epokën e transformimit], në: BEYME von Klaus (ed.): Politische Theorien in der Ära der Transformation [Teoritë politike në erën e transformimit], Opladen 1996
- BIEBER Florian: Serbischer Nationalismus vom Tod Titos zum Sturz Miloševićs, Dissertation an der Universität Wien [Nacionalizmi serb pas vdekjes së Titos deri te rrëzimi i Milošević-it, disertacion pranë Universitetit të Vjenës], Vjenë 2001
- BIEBER Florian: What Final Status is Possible for Kosovo? Plans and Their Critiques, në: European Balkan Observer, Belgrade Centre for European Integration and Vienna Institute for International Economic Studies, vëll. 2, Nr. 1, maj 2004
- BIERMANN Rafael: Der künftige Status Kosovos. Vorbereitung auf das Unvermeidliche [Statusi i ardhshëm i Kosovës. Përgatitja për të pashmangshmen], në: Internationale Politik – Europa Archiv 9/2000
- BIERMANN Rafael: Die europäische Perspektive für den westlichen Balkan. Die EU im Zwiespalt [Perspektiva evropiane për Ballkanin perëndimor. BE-ja në mospajtim], në: Osteuropa. Zeitschrift für Gegenwartsfragen des Ostens, 8/2001
 - BIERMANN Rafael: Aussöhnung und Neubeginn. Das Haager Tribunal und seine Folgen [Pajtim dhe rifillim. Tribunali i Hagës dhe pasojat e tij], në: Internationale Politik – Europa Archiv 5/2002
- BILDT Carl: A Second Chance in the Balkans, në: Foreign Affairs, vëll. 80, janar/shkurt 2001
- BITTNER Ludwig etj. (ed.): Österreich-Ungarns Außenpolitik von der Bosnischen Krise 1908 bis zum Kriegsausbruch 1914 [Politika e jashtme e Austro-Hungarisë nga Kriza Boshnjake më 1908 deri te shpërthimi i luftës më 1914], V, Nr. 4944, Vjenë, Lajpcig 1930

- BLUMENWITZ Dieter, MANGOLDT von Hans (ed.): Fortentwicklung des Minderheitenschutzes und der Volksgruppenrechte in Europa [Zhvillimi i mëtejme i mbrojtjes së pakicave dhe i të drejtave të grupeve etnike në Evropë], Bielefeld 1992
- BLUMI Isa (ed.): Administration and Governance in Kosovo: Lessons Learned and Lessons to be Learned, Prishtinë/Gjenevë, janar 2003
- BOECKH Andreas (ed.): Internationale Beziehungen, Bd. 6 [Marrëdhëniet ndërkombëtare, vëll. 6] (Lexikon der Politik [Leksikon i politikës], ed. NOHLEN Dieter), Muni 1994
- BORIĆ Tomislav: Perspektiven eines zukünftigen Jugoslawien [Perspektivat e një Jugosllavie të ardhshme], në: MARKO Joseph, BORIĆ Tomislav (ed.): Slowenien-Kroatien-Serbien. Die neuen Verfassungen [Sllovenia-Kroacia-Serbia. Kushtetutat e reja], Vjenë etj. 1991
- BRABANT van Jozef M.: Southeastern Europe, Transitions, and the EU – Is Everwidening Desirable?, në: Economic Policy in Transitional Economies MOCT-MOST, 11/2001
- BRAND Marcus G.: Institution-Building and Human Rights Protection in Kosovo in the Light of UNMIK Legislation, në: Nordic Journal of International Law 70/2001
- BREMER Thomas etj. (ed.): Serbiens Weg in den Krieg. Kollektive Erinnerung, nationale Formierung und die ideologische Aufrüstung [Ruga e Serbisë për në luftë. Kujtesa kolektive, formimi kombëtar dhe armatosja ideologjike], Berlin 1998
- BRILL Heinz: Der Balkan-Konflikt und die Interessen der Mächte [Konflikti i Ballkanit dhe interesat e fuqive], në: Österreichische Militärische Zeitschrift (ÖMZ) 5/2000 dhe 6/2000
- BROCK Lothar: Frieden. Überlegungen zur Theoriebildung [Paqja. Mendime rreth krijimit të teorisë], në: SENGHAAS Dieter (ed.): Den Frieden denken, *Si vi pacem, para pacem* [Ta mendosh paqen, *Si vi pacem, para pacem*], Frankfurt am Main 1995
- BROWN David: Contemporary nationalism: Civic, Ethnocultural and Multicultural Politics, Londër etj. 2000
- BRUCKNER Pascal: Le Vertige de Babel. Cosmopolitisme ou mondialisme, Paris 1994
- BRUNNER Georg, LAMBERG Hans (ed.): Volksgruppen in Ostmittel- und Südosteuropa [Grupet etnike në Evropën e Mesme Lindore dhe Juglindore], Baden-Baden 1994

- BRUNNER Georg: Nationalstaaten und Minderheiten im östlichen Teil Europas [Shtetet kombëtare dhe pakicat në pjesën lindore të Evropës], në: BLUMENWITZ Dieter, MANGOLDT Hans von (ed.): Fortentwicklung des Minderheitenschutzes und der Volksgruppenrechte in Europa [Zhvillimi i mëtejshëm i mbrojtjes së pakicave dhe i të drejtave të grupeve etnike në Evropë], Bielefeld 1992
- BUKOSHI Bujar, në: Archiv der Gegenwart, 25 qershor 1993
- BUSEK Erhard: Europa im Wandel – Sicherheit im Wandel. Sicherheitspolitische Dimension der EU-Osterweiterung [Evropa në transicion – siguria në transicion. Dimensione të politikës së sigurisë i zgjerimit të BE-së kah lindja], në: Österreichische Militärische Zeitschrift (ÖMZ) 4/2002
- BUSEK Erhard: Zukunft des Stabilitätspaktes. Das Engagement der Europäer in Südosteuropa [Ardhmëria e Paktit të Stabilitetit. Angazhimi i evropianëve në Evropën Juglindore], në: Internationale Politik – Europa Archiv 5/2002
- BUSEK Erhard: Intervistë në: Kurier, 14 dhjetor 2002
- CALIC Janine M.: Der Krieg in Bosnien und Herzegovina. Ursachen, Konfliktstrukturen, Internationale Lösungsversuche [Lufta në Bosnjë dhe Hercegovinë. Shkaqet, strukturat e konfliktit, përpjekjet ndërkombëtare për zgjidhje], Frankfurt am Main 1995
- CALIC Janine M.: Die Jugoslawienpolitik des Westens seit Dayton [Politika e Perëndimit ndaj Jugosllavisë që nga Dejtoni], në: Aus Politik und Zeitgeschichte, Beilage zur Wochenzeitung Das Parlament, 34/20 gusht 1999
- CALIC Janine M.: Welche Zukunft für den Balkan-Stabilitätspakt? [Çfarë të ardhme për Paktin e Stabilitetit për Ballkanin?], në: SWP-Studie. Stiftung Wissenschaft und Politik. Deutsches Institut für Internationale Politik und Sicherheit, Berlin mars 2003
- CALVOCORESSI Peter: World Politics 1945 – 2000, Edinburg 2001
- ČANAK Nenad, në: NIN, 1 mars 2001
- CAPLAN Richard: A New Trusteeship? The International Administration of War-torn Territories, Adelphi Paper 341/International Institute for Strategic Studies, Oksford etj. 2002
- CASPER Gretchen: Fragile Democracies, Londër 1995
- CHANDLER David: The European Union and Governance in the Balkans: A Unequal Partnership, në: European Balkan Observer, Belgrade Centre for European Integration and Vienna Institute for International Economic Studies, vëll. 1, Nr. 2, nëntor 2003
- CHOMSKY Naom: The New Military Humanism. Lessons from Kosovo, Monroe 1999
- CLARK Howard: Civil Resistance in Kosovo, Londër etj. 2000

- CONVERSI Daniel (ed.): Ethnonationalism in the Contemporary World. Walker Connor and the study of nationalism, Londër, Nju Jork 2002
- CONVERSI Daniel: Conceptualizing nationalism. An introduction to Walker Connor's work, in: CONVERSI Daniel (ed.): Ethnonationalism in the Contemporary World. Walker Connor and the study of nationalism, Londër, Nju Jork 2002
- COULMAS Peter: Das Problem des Selbstbestimmungsrechts. Mikronationalismen, Anarchie und innere Schwäche der Staaten [Problemi i të drejtës së vetëvendosjes. Mikronacionalizmat, anarkia dhe dobësia e brendshme e shteteve], në: Europa – Archiv 1993
- COULMAS Peter: Die vielen Nationen und die Einheit der Welt. Die Grenzen des Universalen [Kombet e shumta dhe uniteti i botës. Kufijtë e universalës], në: Europa – Archiv 1994
- ČOSIĆ Dobrica: Intervistë, në Nedeljnik, prill 2014 (<http://nedeljnik.co.rs/sr/tema-broja/poslednji-intervju-dobrice-osia>)
- ČOVIĆ Nebojša: Never will Kosovo be independent, në: Vreme, 15 mars 2003
- DAALDER H. Ivo: The United States, Europe, and the Balkans, në: Problems of Post-Communism, vëll. 49, 1/2002
- DASKALOVSKI Zhidas: Towards an Integral Theory of Nationalism? Case-Study Kosovo, në: International Journal on Minority and Group Rights, Kluwer Law International, Netherlands, 6/1999
- DASSÛ Marta, WHYTE Nicholas: America's Balkan Disengagement?, në: Survival, vëll. 43, 4/2001-02
- DAWISHA Karen, PARROTT Bruce (ed.): Politics, power, and the struggle for democracy in South-East Europe, Kembrixh 1997
- DEIMEL Johanna: Der Stabilitätspakt für Südosteuropa: Ansatz und aktueller Stand beim Regionaltisch und den drei Arbeitsbereichen [Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore: Pikënisja dhe gjendja aktuale në tavolinën rajonale dhe në tri fushat e punës], në: Südosteuropa Mitteilungen 2/2001
- DEMAJ Violeta: Die Entwicklungen in Kosova seit der Aufhebung der Autonomierechte im Jahre 1989 unter Berücksichtigung staatsrechtlicher, menschenrechtlicher und völkerrechtlicher Aspekte [Zhvillimet në Kosovë që nga shfuqizimi i të drejtave të autonomisë në vitin 1989 duke marrë parasysh aspektet e të drejtës shtetërore, të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare], Vjenë 1999
- DEMAJ Violeta: Kosovo/a. Recht auf Unabhängigkeit? [Kosova. E drejta për pavarësi?], Vjenë, Grac 2003
- DEMCISIN Alexandra: Den Mazedoniern ihre Mazedonen [Maqedonasve maqedonët e tyre], në: Die Presse, 6 tetor 2003

- DEMETROPOULOU Leeda: Europe and the Balkans: Membership Aspiration, EU Involvement and Europeanization. Capacity in South Eastern Europe, në: Southeast European Politics, vëll. III, Nr. 2 – 3, nëntor 2002
- DEPREZ Kas, në: KRIESI Hanspeter etj. (ed.): Nation and National Identity. The European Experience in Perspective, Cyrih 1999
- DEUTSCH Karl W.: Nationalism and Social Communication. An Inquiry into the Foundations of Nationality, Kembrixh etj. 1953
- DEUTSCH Karl W. etj.: Political Community and the North Atlantic Area. International Organizations in the Light of Historical Experience, Princeton 1957
 - DEUTSCH Karl W.: Nationalism and its Alternatives, Nju Jork 1969
 - DEUTSCH Karl W.: Ein einfaches kybernetisches Modell [Një model i thjeshtë kibernetik], në: Politische Kybernetik [Kibernetika politike], Frajburg 1969
 - DEUTSCH Karl W.: Nationenbildung – Nationalstaat – Integration [Krijimi i kombit – shteti kombëtar – integrimi] (ed.) nga ASHKENASI A., SCHULZE P., Dyseldorf 1972
 - DEUTSCH Karl W.: Frieden und die Problematik politischer Gemeinschaftsbildung auf internationaler Ebene [Paqja dhe problematika e krijimit të komuniteteve politike në rrafshin ndërkombëtar], në: SENGHAAS Dieter (ed.): Den Frieden denken, *Si vi pacem, para pacem* [Ta mendosh paqen, *Si vi pacem, para pacem*], Frankfurt mbi Main 1995
- DJILAS Milovan: Die neue Klasse. Eine Analyse des kommunistischen Systems [Klasa e re. Një analizë e sistemit komunist], Munihi 1961
- DUBIEL Helmut: Konsens oder Konflikt? Die normative Integration des demokratischen Staates [Pëlqim apo konflikt? Integrimi normativ i shtetit demokratik], në: KOHLER-KOCH B. (ed.): Staat und Demokratie in Europa [Shteti dhe demokracia në Evropë], Opladen 1992
- ECKHARDT Reinald: Die Verfassungs-Charta der Staatengemeinschaft „Serbien und Montenegro“ vom 4. Februar 2003 [Karta Kushtetuese e bashkësisë shtetërore „Serbia dhe Mali i Zi“ nga 4 shkurti 2003], në: Osteuropa Recht, 2/2003
- EISING Manuel, RESZAT Philipp: Die internationale Notstandsverwaltung im Kosovo [Administrata ndërkombëtare emergjente në Kosovë], në: Osteuropa Recht, 1/2003
- ELDRIDGE Justin L. C.: Kosovo: Land of Uncertainty, në: European Security, vëll. 10, 2/2001
- ERNST Andreas: „Standards vor Status!“ – Die Doktrin der UNO-Mission in Kosovo führt in die Sackgasse [„Standardet para statusit!“ – Doktrina e misionit të OKB-së në Kosovë çon në qorrsoak], në: Südosteuropa 7-9/2002

- EUCHNER Walter: Qu'est-ce qu'une Nation? Das Nationenverständnis Ernst Renans im Kontext seines politischen Denkens [Qu'est-ce qu'une Nation? Kuptimi i kombeve i Ernst Renanit në kontekstin e mendimit të tij politik], në: RENAN Ernest [1882]: Was ist eine Nation? Und andere Politische Schriften [Çfarë është kombi? Dhe shkrime të tjera politike], Vjenë, Bolzano 1995
- FEICHTINGER Walter: Die militärstrategische und operative Entwicklung im Konfliktverlauf [Zhvillimi strategjik ushtarak dhe operativ në rrjedhën e konfliktit], në: REITER Erich (ed.): Der Krieg um das Kosovo 1998/99 [Lufta për Kosovën 1998/99], Mainz 2000
- FEICHTINGER Walter: Streitkräfte als Instrument zur Lösung innerstaatlicher Konflikte. Die bestimmenden Faktoren des militärischen Konfliktbildes in Jugoslawien 1998/99, Dissertation an der Universität Wien [Forcat e armatosura si instrument për zgjidhjen e konflikteve ndërshtetërore. Faktorët përcaktues të pamjes së konfliktit ushtarak në Jugosllavi më 1998/99, disertacion pranë Universitetit të Vjenës], Vjenë 2001
- FERDOWSKI Mir A.: Kriege seit dem Zweiten Weltkrieg. Dimensionen – Ursachen – Perspektiven [Luftërat që nga Lufta e Dytë Botërore. Dimensionet – shkaqet – perspektivat], në: Manfred Knapp etj. (ed.): Einführung in die Internationale Politik [Hyrje në Politikën Ndërkombëtare], Muni, Vjenë 1996
- FISCHER Joseph: Rede bei der Beschießung des Stabilitätspaktes für Südosteuropa in Köln am 10. Juni 1999 [Fjalim gjatë aprovimit të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore në Këln më 10 qershor 1999], në: Internationale Politik – Europa Archiv 8/1999
- FISCHER Joseph: Vom Staatenverbund zur Föderation – Gedanken über die Finalität der europäischen Integration [Nga lidhja e shteteve deri te federata – Mendime rreth finalitetit të integritit evropian] (<http://www.wi-berlin.de/fischer.htm>)
- FISCHER Peter: Der gerechte Krieg um Kosovo [Lufta e drejtë për Kosovën], në: Zeitung der Universität Wien, Die Universität [Gazeta e Universitetit të Vjenës, Universiteti], Vjenë qershor 1999
- FLETCHER Georg P.: Loyalität. Über die Moral von Beziehungen [Lojaliteti. Rreth moralit të marrëdhënieve], Frankfurt mbi Main 1994
- FRANK Martin: Multikulturalismus und Nationalismus [Multikulturalizmi dhe nacionalizmi], në: BEYME K. von (ed.): Politische Theorien in der Ära der Transformation [Teoritë politike në erën e transformimit], Opladen 1996
- FRASHËRI Kristo: The History of Albania, Tiranë 1964
- FREUNDLICH Leo: Albaniens Golgotha [Golgota e Shqipërisë], Vjenë 1913
- FROMEIN Jochen A. etj. (ed.): Das Minderheitenrecht europäischer Staaten, Teil 2 [E drejta e pakicave në shtetet evropiane, Pjesa 2], Berlin etj. 1994

- FÜCHTNER Hans: Vaterlandssyndrom. Zur Sozialpsychologie von Nationalismus, Rechtsradikalismus und Fremdenhaß [Sindroma e atdheut. Për socialpsikologjinë e nacionalizmit, radikalizmin e djathtë dhe urrejtjen e të huajve], Hajdelberg 1996
- FUKUYAMA Francis: The end of history and the last man, Londër 1992
- GÄRTNER Heinz: Modelle europäischer Sicherheit. Wie entscheidet Österreich? [Modelet e sigurisë evropiane. Si vendos Austria?], Vjenë 1997
- GASHI Dardan: Interview mit Michael Steiner, Chef der UN-Mission in Kosova [Intervistë me Michael Steiner, shëf i misionit të UNMIK-ut në Kosovë], në: Balkan, Südosteuropäischer Dialog, Jed. 2/Heft 6, Vjenë etj. 2002
- GASHI Skënder, CLASSEN Lothar (ed.): Dardania. Das Selbstbestimmungsrecht der Kosovaren, Bd. 2 [Dardania. E drejta e vetëvendosjes e kosovarëve, vëll. 2], Vjenë 2001
- GEIS Imanuel: Hegemonie und Genozid: Das Serbien-Syndrom 1991/92 [Hegjemonia dhe gjenocidi: Sindromi i Serbisë 1991/92], në: VOLLE Angelika, WAGNER Wolfgang (ed.): Der Krieg auf dem Balkan. Die Hilflosigkeit der Staatenwelt [Lufta në Ballkan. Pafuqia e botës së shteteve], Bon 1994
- GELLNER Ernest: Nationalismus und Moderne [Nacionalizmi dhe modernja], Berlin 1991
- GELLNER Ernest: Thought and Change, Londër 1972
- GLIGOROV Vladimir: The Economics of Kosovo: Does Viability Matter?, në: The International Spectator, prill – qershor 2/2000
- GLIGOROV Vladimir: European Partnership with the Balkans, në: European Balkan Observer, Belgrade Centre for European Integration and Vienna Institute for International Economic Studies, vëll. 2, Nr. 1, maj 2004
- GOATI Vladimir më 21.12.2002 në bisedë me VETTER Reinhold: Kud ideš Srbijo? Serbien nach der erfolglosen Präsidentenwahl und dem Mord an Đinđić [Kah shkon Serbi? Serbia pas zgjedhjeve të pasuksesshme presidenciale dhe pas vrasjes së Đinđić-it], në: Osteuropa, Zeitschrift für Gegenwartsfragen des Ostens, 4/2003
- GÖHLER Gerhard: Konflikt und Integration [Konflikti dhe integrimi], në: KOHLER-KOCH Beate (ed.): Staat und Demokratie in Europa [Shteti dhe demokracia në Evropë], Opladen 1992
- GOLDSTONE Richard J.: Whither Kosovo? Whither Democracy?, në: Global Governance 8/2002
- GROTHUSEN Klaus D. (ed.): Südosteuropa Handbuch. Jugoslawien, Bd. 1. [Doracaku i Evropës Juglindore. Jugosllavia, vëll. 1], Gëtingen 1975
- GRUBIŠA Damir: Diplomacija na kraju povjesti [Diplomacia në fund të historisë], Zagreb 1996

- GUNTHER Richard etj. (ed.): The Politics of Democratic Consolidation. Southern Europe in comparative perspective, Baltimor 1995
- GJATA Mehmet, BUZHALA Berat: Borxhi i Serbisë ndaj Kosovës është disa herë më i lartë se borxhi i Kosovës ndaj botës, në: Zëri Ditor, 17 qershor 2003
- GJETAJ Prenkë, në Indexonline, më 14 Shtator 2014
(<http://indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=115843>)
- HAAR Roberta N.: The Kosovo Crisis and its Consequences for a European Security Architecture, në: SPILLMANN Kurt R., KRAUSE Joachim (ed.): Kosovo: Lessons Learned for International Cooperative Security, Bernë etj. 2000
- HABERMAS Jürgen: Die Einbeziehung des anderen. Studien zur Politischen Theorie [Përfshirja e tjetrit. Studime rreth Teorisë Politike], Frankfurt mbi Main 1996
- HADRI Ali: Narodno-oslobodački pokret na Kosovu 1941 – 1945 [Lëvizja nacionalçlirimtare në Kosovë 1941 – 1945], Beograd 1973
- HAJRULLAHU Arben: Kosova, Vergangenheit und Zukunft. Kosovos Entwicklung zur Eigenstaatlichkeit und die zukünftigen Chancen auf eine Integration in die Europäische Union, Diplomarbeit an der Universität Wien [Kosova, e kaluara dhe e ardhmja. Zhvillimi i Kosovës kah pavarësia dhe shanset e ardhshme për një integrim në Bashkimin Evropian, punim diplome pranë Universitetit të Vjenës], Vjenë 2001
- HAJRULLAHU Arben, SALAMUN Michaela: Der Verfassungsrahmen für die Provisorische Selbstverwaltung in Kosova [Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë], në: Südosteuropa 1-3/2002
- HASANI Enver: The dissolution of Yugoslavia and the case of Kosova, Tiranë 2000
- HASANI Enver: Parimi i mosndryshimit të kufijve në të drejtën dhe mardhëniet ndërkombëtare, në: Shqiptarët në Ballkan, Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, Tiranë 2001
- HATSHIKJAN Magarditsch, TROEBST Stefan (ed.): Südosteuropa. Gesellschaft, Politik, Wirtschaft, Kultur. Ein Handbuch [Evropa Juglindore. Shoqëria, politika, ekonomia, kultura. Një doracak], Muni 1999
- HELD David: Models of Democracy, Kembrixh, Oksford 1996
- HEUBERGER Valeria etj. (ed.): Brennpunkt Osteuropa, Minderheiten im Kreuzfeuer des Nationalismus [Vatra e zjarrit Evropa Lindore. Pakicat në qendër të nacionalizmit], Vjenë, Muni 1996
- HEUBERGER Valeria etj. (ed.): Der Balkan. Friedenszone oder Pulverfass? [Ballkani. Zonë e paqes apo fuçi baroti?], Frankfurt mbi Main etj. 1998
- HOBBSBAWM Eric J.: Nationen und Nationalismus. Mythos und Realität seit 1780 [Kombet dhe nacionalizmi. Miti dhe realiteti që nga 1780], Frankfurt mbi Main 1991

- HÖLL Otmar: Österreichs Außenbeziehungen gegenüber Zentral und Osteuropa seit 1995 [Marrëdhëniet e jashtme të Austrisë përball Evropës Qendrore dhe Lindore që nga viti 1995], në: Europäische Rundschau 2/2002
- HONNETH Axel (ed.): Kommunitarismus. Eine Debatte über die moralischen Grundlagen moderner Gesellschaften [Komunitarizmi. Një debat rreth bazave morale të shoqërive moderne], Frankfurt mbi Main, Nju Jork 1993
- HORVAT Vedran: Brain Drain. Threat to Successful Transition in South East Europe?, në: Southeast European Politics, vëll. V, nr. 1, qershor 2004
- HÖSCH Edgar: Geschichte der Balkanländer [Historia e vendeve të Ballkanit], Munih 1993
- HOXHAI Enver: Das Memorandum der Serbischen Akademie und die Funktion politischer Mythologie im kosovarischen Konflikt [Memorandimi i Akademisë Serbe dhe funksioni i mitologjisë politike në konfliktin kosovar], në: Südosteuropa, 10-12/2002
- HOXHSON Xhon: Kolosi i brishtë, në: Kosova, Revistë historike politike, Prishtinë 5/1997
- HUDALLA Anneke, PRADETTO August: Desintegration durch Integration? Dilemmata der Osterweiterung der Europäischen Union und die Europapolitik der neuen Bundesregierung [Dezintegrimi përmes integritit? Dilemat e zgjerimit lindor të Bashkimit Evropian dhe politika evropiane e qeverisë së re federale], në: Studien zur Internationalen Politik. Institut für Internationale Politik an der Universität der Bundeswehr Hamburg [Studime për Politikën Ndërkombëtare pranë Universitetit të Ushtrisë Federale në Hamburg], Hamburg 2/1999
- HUNTINGTON Samuel P.: The Third Wave, Londër 1991
- HUTCHINSON John, SMITH Antony D. (ed.): Nationalism, Oksford, Nju Jork 1994
- ILLMEIER Gertraud: Stipe Mesić zu Besuch bei früherem Todfeind Serbien [Stipe Mesić në vizitë te Serbia, armiku i tij i mëhershëm], në: Die Presse, 11 shtator 2003
- INGIMUNDARSON Valur: Pitting Democratic Standards against Sovereign Rights: The nature of International Rule in Kosova (<http://www.newbalkanpolitics.org.mk/napis.asp?id=11&lang=English>)
- JAHN Egbert: Frieden [Paqja], në: BOECKH Andreas (ed.): Internationale Beziehungen, Bd. 6 [Marrëdhëniet ndërkombëtare, vëll. 6] (Lexikon der Politik [Leksikon i politikës], ed. NOHLEN Dieter), Munih 1994
- JANDL Gerhard: Der Kosovokonflikt – mögliche und wahrscheinliche Verhandlungslösungen [Konflikti i Kosovës – zgjidhje të mundshme dhe me gjasë të negociatave], në: RIEGLER Henriette (ed.): Der Kosovokonflikt – Bestandsaufnahme und Lösungsszenarien [Konflikti i Kosovës – regjistrimi i gjendjes dhe skenaret e zgjidhjes], OIIP Vjenë 2000

- JUDT Tony: Große Illusion Europa. Gefahren und Herausforderungen einer Idee [Iluzioni i madh Evropa. Rreziqet dhe sfidat e një ideje], Muni, Vjenë 1996
- JUREKOVIC Predrag: Die Entwicklungen des Konfliktes im Kosovo seit „Dayton“ [Zhvillimet e konfliktit në Kosovë që nga „Dejtoni“], në: Österreichische Militärische Zeitschrift (ÖMZ) 3/1997
- KAISER Karl: Der Balkan als Modell [Ballkani si model], në: Internationale Politik 11/2003
- KASER Karl: Die Verhandlungen in Rambouillet und Paris: Die Frage der Souveränität Jugoslawiens und der Unabhängigkeit für Kosovo [Negociatat në Rambuje dhe Paris: Çështja e sovranitetit të Jugosllavisë dhe e pavarësisë së Kosovës], në: Südosteuropa 1-2/2000
- KEMPE Iris, MEURS van Wim: Neue EU-Nachbarn. Strategien gegenüber Südost- und Osteuropa jenseits der Erweiterung [Fqinj të rinj të BE-së. Strategjitë përballë Evropës Juglindore dhe Lindore përtej zgjerimit], në: Internationale Politik Europa - Archiv 5/2002
- KEMPE Iris, MEURS van Wim: Prospects and Risks Beyond EU Enlargement, 2002/2003 Strategy Paper (<http://balkans.mehedinti.info/studies/Multi-Layered%20Europe.pdf>)
- KIELMANSEGG Graf Peter: Frieden durch Demokratie [Paqja përmes demokracisë], në: SENGHAAS Dieter (ed.): Den Frieden denken, *Si vi pacem, para pacem* [Ta mendosh paqen, *Si vi pacem, para pacem*], Frankfurt am Main 1995
- KNAPP Manfred etj. (ed.): Einführung in die Internationale Politik [Hyrje në Politikën Ndërkombëtare], Muni, Vjenë 1996
- KÖCK Herbert F.: Rechtliche und politische Aspekte der NATO-Aktion im Kosovo [Aspekte juridike dhe politike të aksionit të NATO-s në Kosovë], në: Wiener Blätter zur Friedensforschung qershor 2/1999
- KOHL von Christine, LIBAL Wolfgang: Kosovo: gordischer Knoten des Balkans [Kosova: nyja gordiane e Ballkanit], Vjenë, Cyrih 1992
- KOHL von Christine, LIBAL Wolfgang: Europa darf das Kosovo nicht vergessen [Evropa nuk guxon ta harrojë Kosovën], në: Europäische Rundschau 1992
- KOHLER-KOCH Beate (ed.): Staat und Demokratie in Europa [Shteti dhe demokracia në Evropë], Opladen 1992
- KOHLER-KOCH Beate: The Evolution and Transformation of European Governance, në: Political Science Series No. 58, Institute for Advanced Studies, Vjenë 1998
- KRASNIQI Mark: The Role of the Serbian orthodox church in anti-Albanian policies in Kosova, në: Kosova, historical, political Review 3 1994
- KRASTEV Ivan: The Balkans: Democracy Without Choices, në: Journal of Democracy, vëll.13, 3/2002

- KRBEK Ivo: Die Verfassung der Sozialistischen Föderativen Republik Jugoslawien vom 7.4.1963 [Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë nga 7.4.1963], në: Jahrbuch des öffentlichen Rechts [Vjetari i të Drejtës Publike] 13/1964
- KRIESI Hanspeter etj. (ed.): Nation and National Identity. The European Experience in Perspective, Cyrih 1999
- KRISTAN Ivan: Die Dritte Verfassungsrevision in Jugoslawien [Rishikimi i tretë i Kushtetutës në Jugosllavi], në: Die Verwaltung [Administrata] 1972
- KRISTAQ Prifti, MARENGLER Verli: The Truth on Kosova, Tiranë 1993
- KRITT Robert R.: Die Londoner Botschafterkonferenz 1912 – 1913, Dissertation an der Universität Wien [Konferenca e Ambasadorëve në Londër 1912 – 1913, disertacion pranë Universitetit të Vjenës], Vjenë 1960
- KUMBARO Dajena: The Kosovo Crisis in an International Law Perspective: Self-Determination, Territorial Integrity and the NATO Intervention, North Atlantic Treaty Organisation. Office of Information and Press, 16 qershor 2001
- KUMER Anton etj. (ed.): Europäisierung versus Nationalismus. Der ex-jugoslawische Raum auf der Suche nach Stabilität [Evropianizimi kundër nacionalizmit. Hapësira ish-jugosllave në kërkim të stabilitetit], Frankfurt mbi Main etj. 2000
- KUQI Hajredin: Disa aspekte të të drejtës për vetëvendosje të Kosovës, në: Shqiptarët në Ballkan, Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, Tiranë 2001
- KUX Stephan: Ursachen und Lösungsansätze des Balkankonflikts: Folgerungen für das Abkommen von Dayton [Shkaqet dhe nismat për zgjidhjen e konfliktit të Ballkanit: Përfundimet për Marrëveshjen e Dejtonit], Europa Institut pranë Universitetit të Bazelit Nr.16/1996
- KYMLICKA Will: Multicultural Citizenship, a liberal theory of minority rights, Oksford 1995
- KYMLICKA Will, NORMAN Wayne: Citizenship in diverse Societies, Oksford 2000
- LALKOV Milčo: Nationalismus auf dem Balkan heute oder das Erwachen eines alten Dämons [Nacionalizmi në Ballkan sot ose zgjimi i një demoni të vjetër], në: HEUBERGER Valeria etj. (ed.): Der Balkan. Friedenszone oder Pulverfass? [Ballkani. Zonë e paqes apo fuçi baroti?], Frankfurt mbi Main etj. 1998
- LAMERS Karl etj.: Ordnung und Einverständnis. Der Balkan braucht eine selbsttragende politische Ordnung: die Südost-Europäische Union [Rend dhe dakordim. Ballkanit i duhet një rend politik vetëbartës: Unioni Evropian Juglindor], në: Frankfurter Allgemeine Zeitung, 18 qershor 2001
- LANGE Klaus: Die UÇK – Anmerkungen zu Geschichte, Struktur und Zielen [UÇK-ja – shënime rreth historisë, strukturës dhe qëqëve], në: Aus Politik und Zeitgeschichte, Beilage zur Wochenzeitung Das Parlament, 34/20 gusht 1999

- LANGER Alexander Die Mehrheit der Minderheiten, warum wird unsere Welt vom ethnischen Sauberkeitswahn und vom grundlosen Vertrauen in Mehrheiten beherrscht? [Shumica e pakicave, pse bota jonë sundohet nga iluzionit i pastërtisë etnike dhe nga besimi i paarsyeshëm të shumicës?], Berlin 1996
- LAZIĆ Ivana: Brak sa Albancem [Martesa me shqiptarin], në: Naša Borba, 21/22 mars 1998
- LIBAL Wolfgang, KOHL von Christine: Balkan. Stabilität oder Chaos in Europa [Ballkani. Stabilitet apo kaos në Evropë], Hamburg, Vjenë 2000
